MAL BERISHA

"AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË – SOFT POWER"

AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË

Tiranë, 2021

Botues: Bardhyl Musai
Redaktor: Gjovalin Shkurtaj
Korrektorë: Iliran Agolli, Teuta Dhima
Ballina: Ina Musai
Art grafik: Rigers Popa
Foto e ballinës: Fadil Berisha

© Mal Berisha, 2021
Botuar nga EduALBA
www.Malberisha.com

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Berisha, Mal
AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË / Mal Berisha;
red. Gjovalin Shkurtaj. – Tiranë : Edualba, 2021
... f. : me foto ; ... cm.
ISBN 978-9928-121-75-2

1.Marrëdhënie me jashtë 2.Diplomacia 3.Diplomatë
4.Kujtime 5.Turqi 6.Angli

327(496.5 :4/9) (093.3)

Mal BERISHA

AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË

(Soft Power)

"Asgjë nuk duhet t'i shpëtojë syrit
dhe veshit të diplomatit!"

Mal Berisha

Prindërve të mi, Bajramit dhe Sibes, të cilët guxuan ta sfidonin regjimin komunist për shkollimin tim!

Falënderime të veçanta shkojnë tek zotërinjtë Agim dhe Erzen Laçi, babë e bir, pronarë të firmës "Kast-oil", të cilët e mundësuan botimin e këtij libri.

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE 15

DY FJALË PËR AUTORIN 18

KREU I PARË - NË KONSULLATËN SHQIPTARE NË STAMBOLL, 1992-1997 ..... **22**

Udhëtimi i parë drejt Stambollit 24

Pritja solemne në hotel "Mercury" 30

Të gjithë bashkë drejt Stambollit 32

Kohë ndryshimesh rrënjësore 34

Marrëveshja e "xhentëlmenëve" për kurimin e shqiptarëve me sëmundje veshkash në Stamboll 39

Vdekja e Presidentit turk, Turgut Őzal 44

Ramiz Alia e derdh shishen e bojës gjatë nënshkrimit të Aktit Final të Helsinikit, shtator 1991 46

Me mikun e tre presidentëve, Artistin e Popullit Kadri Roshi 50

Puna në Stamboll, në qytetin me bukuritë më të rralla në botë 57

Fiati "Doğan" me targë diplomatike "34" i Konsullatës Shqiptare në Stamboll 60

Enver Tali - Maratonomak i Lirisë 64

Sa fe ushtrojnë shqiptarët? 72

Shoferi Artur në konsullatën tonë 75

Hilton Hotel - Stamboll - Me presidentin shqiptar dr. Sali Berisha dhe atë izraelit, Ezer Weisman 79

Takimi me Joseph Dioguardin dhe Yasemin Dobra Mançon 81

Veprimtaria promovuese kulturore artistike në Stamboll 85

Si dolën 12 pikat e Shtabit të Ushtrisë Turke për mbrojtjen e Shqipërisë nga disintegrimi në vitin 1997 96

Në Ibrik Tepe, Trakë, me profesor John Freely dhe gazetarin Emin Sahatçiu, në vendlindjen e Theofan Stilian Nolit 108

Stamboll - njoftohet vdekja e Nënë Terezës 115

Ditët e fundit në Stamboll! 120

Telefonata e fundit në Stamboll dhe një legjendë tipike shqiptare 126

KREU I DYTË - NË AMERIKËN MIKE PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS, 1998 - 2000 132

Me forcat e mia drejt Amerikës mike 134

Një darkë me kongresmenin Benjamin Gilman për Kosovën 139

Në Këshillin e Marrëdhënieve me Jashtë të Kongresit Amerikan, në Capitol Hill 140

Konferenca e Rambujesë dhe kontributi i Joseph Dioguardit 144

Era e luftës erdhi deri në Ossining - New York - USA 149

Kujtime nga Baza Ushtarake Amerikane Fort Dix me Misionet Humanitare Amerikane 154

Përqafimi i vogëlushes Shehrije 158

Me Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës "Vatra" 163

Me Arbër Xhaferin në Ossening, New York dhe në Tetovë 175

Një ditë me senatorin John McCain për njohjen e Kosovës së pavarur, në Manhattan 176

Takim me gjeneralin Wesley K. Clark 180

KREU I TRETË - KTHIM NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, 2009 - 2012 182

2009 - 2012 në Ministrinë e Punëve të Jashtme - Tiranë 184

Lobim për njohjen e Kosovës në Lindjen e Mesme 185

Në Damask - Siri 186

Në Bejrut - Liban 193

Në Hagë për të pritur vendimin e GJND-së për Kosovën 202

Me Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomike të Detit të Zi (BSEC), në Moskë 209

KREU I KATËRT – LONDËR – I NGARKUAR ME PUNË ADINTERIM, 2012 - 2013 216

Drejt Londrës 218

Njohja me Shoqatën Anglo - Shqiptare (AAA) në Londër 220

London School of Economics, takim me nobelistin e paqes, Dalai Lama 222

Edhe nobelistët kanë të metat e tyre..... 225

Në gjurmët e familjes angleze Herbert - mike e shqiptarëve 229

Westminster Abbey undercroft - shënohet dita e Shën Nënë Terezës..... 240

Historia e vendosjes së bustit të Skënderbeut në Londër 244

Odiseja e librit "Charles Telford Erickson, amerikani qe i kushtoi jetën Shqipërisë" 258

Miqësia me artisten Rita Ora dhe familjen e saj 263

Ritakim rastësor me një pjesëtare të miliarda aziatikëve 266

KREU I PESTË – LONDËR - AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM DHE FUQIPLOTË, 2013-2015 268

Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës 270

Buckingham Palace - nga dëbimi në Shpërdhet tek Mbretëresha Elizabeth! 273

Vin d'onor ose vera e nderit 284

Historia e vendosjes së bustit të Skënderbeut në fshatin Munxhufun (Montecilfone) në zonën arbëreshe të Molises, Itali 285

Vizitë në qytetin antik Pompei dhe në majën e Vezuvit..... 290

Vizitë në Kozencë tek arbëreshët 294

Vepra muzikore "Vjeshta në Shqipëri" dhe historia e saj 308

Letrat kredenciale tek Presidenti i Irlandës, Michael D. Higgins..... 314

"Notes on Albania", edicioni i parë, 16 dhjetor 2013..... 322

Një debat për historinë me ambasadorin serb, Ognjen Prebičevič, në Londër 332

Mandela dhe Arbnori - përsiatje në ditën e nobelistit Nelson Mandela në Londër 336

"Gjeneral Kutuzovi im" dhe incidenti i partiturës së harruar në Cadogan Hall, Londër 343

Episode njohjeje me njerëz të ndryshëm 349

Fqinjët e mi në Pimlico - Londër 352

Një ditë me Edith Durham-in në Institutin Mbretëror Antropologjik të Britanisë së Madhe dhe Irlandës 357

Në ambasadën austriake – 100 -vjetori i fillimit të Luftës së Parë Botërore 360

Në Lojërat Olimpike të Commonwealth – it në Skoci, gusht 2014..... 365

Një jetë "në udhëtim me Shekspirin" deri në Stratford mbi Avon..... 373

Edicioni i Dytë i "Notes on Albania", në Teatrin Kings Place..... 386

Herman Bernstein në YIVO Institute of Jewish Research, Manhattan, New York 392

Lum Lumi - Ationi - Ali Podrimja - Visar Zhiti 397

Toka e shpresës dhe lavdisë 405

Profesoresha e Oxford-it, Kalypso Nicolaidis, rrëfen sesi u realizua vizita e Carolios Papulias në Shqipëri 410

"Notes on Albania - edicioni i Tretë - java e Kulturës Shqiptaro – Britanike 414

Homazh për Edward Lear-in – ekspozitë e artit figurativ e piktorit Bashkim Ahmeti – Izano 417

Shembuj paqeje dhe mirëkuptimi nordik 434

Debat me Ministrin e Jashtëm grek Nikos Kotzias në SEESOX..... 436

Dita e Pavarësisë në Ambasadën Amerikane në Londër 443

Historia e Skënderbeut brenda historisë së përgjithshme të turqve nga anglezi Richard Knolles, 1603 446

Takim rastësor me skulptorin e Margaret Thatcher-it Ivan Saxton 452

Pritjet diplomatike në Londër 458

KREU I GJASHTË – LAMTUMIRË! 464

Dita e fundit në Londër - 30 tetor 2015 466

Historia e përfaqësimit diplomatik të shtetit shqiptar në Londër dhe anasjelltas 469

Histori e shkurtër e shërbimit diplomatik, që nga themelimi i shtetit shqiptar deri në vitin 1939 486

Të notosh me dhe kundër rrymës..... 492

Më ka marrë malli 495

"Pushteti i butë" i punës kulturore promovuese i një ambasadori 497

Një shënim përmbyllës për librin 499

Lamtumirë! 501

Shtojcë - Kronikë e veprimtarive diplomatike gjatë 1358 ditëve në Londër 2012 – 2015 502

Tregues 525

MIRËNJOHJE

Janë dhjetëra e ndoshta edhe më shumë ngjarjet, që mbushin faqet e këtij libri, si dëshmi e veprimtarisë në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar.

Libri ka për qëllim të japë një pamje të gjerë, me informacion të pasur, për njerëz dhe ngjarje, shpeshherë dramatike dhe emocionuese, ndonjëherë edhe të bukura e me sens humori, të një jete të tërë në shërbim të pakursyer ndaj vendit tonë. Kur them vendit tonë, kam parasysh edhe Kosovën, pavarësisht nga kartvizita që mbaja në xhep.

Duke qenë se përfshirja në shërbimin diplomatik vinte pas një pune të gjatë në jetën kulturore dhe artistike, që në fillim e konsiderova detyrën e re, si mundësi për ta ndërthurur përvojën e mëparshme me punën e diplomatit. Hapësira që më jepte detyra dhe liria që gëzoja në atë funksion, në një shtet të ri demokratik shqiptar, përbënin një mundësi të madhe për të bërë shumë gjëra të vyera. Për këtë jam shumë mirënjohës ndaj shumë njerëzve të kësaj bote, që më ndihmuan.

Mirënjohja më e thellë shkon tek prindërit e mi, për heroizmin e treguar për shkollimin tim; te Donika, e cila nuk iu shmang asnjëherë vështirësive që paraqiste udhëtimi ynë në dhjetëveçarë; te djemtë, Erioni, në fillim fëmijë e më pas edhe me të shoqen, Kreuzën, dhe Kreshniku, të cilët u rritën në lëvizje nga një vend në tjetrin, duke përjetuar vështirësitë e shpërnguljeve dhe, madje, në një fazë të fundit, duke m'u bërë krahë e mbështetje ekonomike dhe financiare, për të ma mundësuar kryerjen me sukses të misionit tim; te të gjithë të afërmit dhe miqtë, kolegët dhe dashamirësit e mi.

Dua t'u bëj një homazh miqve të mi, që nuk jetojnë më, pa emrin, frymëzimin dhe ndihmesat e të cilëve, ky libër nuk do të ishte shkruar:

Z. Orhan Zarshatit, Kryekonsulli im i parë, modeli i punës së zyrtarit shqiptar të zellshëm, intelektualit të ditur dhe diplomatit të zoti;

Z. Enver Talit, atdhetarit dhe njeriut që u shkri për Kosovën, katër herë vuajtës në burgjet serbe. Me Enver beun realizuam shumë gjëra të vlefshme për Kosovën dhe Shqipërinë;

Profesorit amerikan, John Freely i Universitetit Boaĝaziçi, për ndihmën e dhënë në zbardhjen e shumë fakteve të rëndësishme për historinë e Shqipërisë;

Ing. Agim Karagjozit, ish-kryetarit të Federatës Pan – Shqiptare të Amerikës, Vatra;

Z. David Lloyd, mikut anglez të Shqipërisë, i cili luajti një rol kyç në vendosjen e Bustit të Skënderbeut në Londër.

Falënderoj Shoqatën "Vëllazëria Turko – Shqiptare" në Stamboll dhe drejtuesit e saj, që nuk kursyen asgjë për t'i forcuar marrëdhëniet me shtetin e fuqishëm turk;

Gazetaren turko – amerikane Yasemin Dobra Manço, e cila gjatë viteve 1995 -1997 e mbajti opinionin turk dhe komunitetin diplomatik të akredituar në Turqi, të informuar rreth ngjarjeve më të rëndësishme që ndodhnin në Shqipëri dhe në Kosovë.

Në anën tjetër të hemisferës, dëshiroj të falënderoj me respekt e mirënjohje:

Presidentin e Ligës Qytetare Shqiptaro – Amerikane, ish-kongresmenin me origjinë arbëreshe, Joseph DioGuardin, dhe këshilltaren e Çështjeve Balllkanike, Shirley A. Cloyes;

Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës, "Vatra", për mundësinë që më ofroi, për të dhënë ndihmesën time në dobi të çështjes së Kosovës, gjatë viteve 1998 - 2000.

Dua të falënderoj Shoqatën Anglo – Shqiptare në Angli, e themeluar nga Aubrey Herbert dhe Edith Durham dhe, në veçanti, Presidentin e saj të Nderit, Sir Noel Malcolm, për ndihmesën e dhënë prej tij në rritjen e profilit të punës së Ambasadës Shqiptare në Londër.

Po ashtu falënderoj z. Bejtullah Destani, Drejtor i Institutit të Studimeve Shqiptare në Londër, studiues i palodhur dhe diplomat kosovar.

Falënderoj botuesin tim, prof. dr. Bardhyl Musain, për kujdesin që ka bërë dhe bën për botimin me cilësi të lartë dhe estetikë të librave të mi në shtëpinë botuese EduAlba.

Dëshiroj të falënderoj gazetarin e Zërit të Amerikës, z. Ilirian Agolli dhe bibliografen e Bibliotekës Publike Durrës, zonjën Teuta Dhima, për korrigjimin e gabimeve të lëna gjatë shkrimit të librit.

Në fund, por jo nga rëndësia, dua të falënderoj akademikun e gjuhës shqipe, profesorin Gjovalin Shkurtaj për "suvanë" që i dha librit në momentet e fundit, përpara se të futej për botim.

Lista e njerëzve që meritojnë mirënjohjen time është aq e gjatë, sa vetë treguesi i këtij libri.

Çdo emër i përmendur dhe që ka lidhje me këtë libër, gëzon mirënjohjen time të thellë.

Autori

DY FJALË PËR AUTORIN

Mal Berisha i përket një brezi diplomatësh shqiptarë, të cilët hynë në shërbimin e jashtëm të Republikës sonë në fillim të viteve ’90 të shekullit të kaluar, fill pas kthesës së madhe, që mori historia e Shqipërisë. Edhe unë vetë jam pjesë e këtij brezi. Ne vinim nga horizonte kulturore dhe profesionale të ndryshme, kishim kryer studimet e larta në shkollat e Tiranës, kishim mësuar gjuhë të huaja vetëm për të lexuar libra, pra, pa shpresën se do të na shërbenin një ditë për të folur me të huajt. Nuk njoh ndonjërin nga pjesëtarët e këtij brezi, i cili të ketë patur shpresën se do të vinte një ditë, kur gjuha e huaj do t’i shërbente si mjet pune. Gjuha e huaj ishte mirëfilli një mundësi e re, shpesh një kalim kohe, që ne ia jepnim individualisht vetes, për të shuar kurreshtjen, të cilën e kishim vërtet të madhe dhe për të zgjeruar njohuritë e kulturën, anipse kjo kulturë zakonisht nuk na vlente fare për punët që bënim, në përditshmërinë tonë monotone.

I tillë është edhe shembulli i autorit të këtij libri, i cili kishte kryer studimet në Institutin e Lartë të Arteve dhe kishte arritur kulmin e “karrierës” në pallatin e kulturës në Laç, pasi kishte kaluar disa vjet si punonjës kulture në fshatin Borizanë të rrethit të Krujës. Ndërkohë, gjysmë legalisht, siç edhe e tregon në një episod të këtij libri, ai mësonte anglisht. Me një fjalë, pa e ditur, në mënyrë autodidakte, ai po përgatitej për t’u bërë diplomat, fillimisht si konsull në Stamboll, fill pas zgjedhjeve të vitit 1992, e më pas në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për ta mbyllur para pak vjetësh si Ambasador në Londër. Është një udhëtim në ngjitje, siç edhe duket, një nga ato udhëtime, që do ta ëndërronte çdo diplomat i karrierës, një udhëtim shumë i bukur, që i jep një kuptim të madh jetës.

Por, ne që e njohim ambasador Berishën dhe kemi qenë bashkëudhëtarë

me të, e dimë se ky udhëtim nuk ka rrjedhur në mënyrë aq të natyrshme. Dhe kjo jo për fajin e tij. Marramendja shkatërrimtare e pranverës së vitit 1997 nuk përfundoi me zgjedhjet e qershorit, ardhjen në pushtet të socialistëve dhe dorëheqjen e Sali Berishës nga posti i Presidentit të Republikës. "Fitimtarët" vazhduan edhe për shumë muaj zullumet mbi shtetin, duke "spastruar" administratën publike nga ata që nuk ishin militantët e tyre. Kështu e pësoi edhe trupi diplomatik. Anëtarët e brezit tim, të cilët i kishin dhënë një fytyrë të re diplomacisë shqiptare, duke dëshmuar me vepra përpara botës demokratike se përfaqësonim tashmë një vend të lirë, të dëshiruar për të lidhur marrëdhënie miqësore e bashkëpunimi, u përzunë gjerësisht nga shërbimi i jashtëm. Njëri prej tyre ishte edhe Mal Berisha.

Siç do të provohej, Mal Berisha e kishte marrë tashmë "tharmin" e diplomatit. Edhe pse pa "pasaportë diplomatike", gjatë afro një dekade, ai do të vazhdonte gjithë përkushtim, në New York apo në Prishtinë, t'i shërbente Shqipërisë dhe më gjerë, çështjes shqiptare, i përqendruar kryesisht atje ku edhe nevoja ishte më e madhe e më urgjente: te Kosova, qoftë para e gjatë luftës, për ta bërë të njohur për opinionin politik e publik botëror të vërtetën e masakrave gjenocidiale serbe e qoftë më pas, kur e vërteta e Kosovës në liri mishërohej tek aspirata e saj për pavarësi e shtetformim. Siç tregohet bukur në mjaft episode të këtij libri, edhe kjo do të ishte një përvojë e çmuar për të, e cila do ta ndihmonte për t'i kryer më mirë detyrat kur të kthehej në trupin diplomatik.

Nëse do të duhej të skicoja profilin e Mal Berishës si diplomat, do të veçoja dy cilësi, të cilat më duket se spikasin mbi të tjerat. Së pari, është përparësia që i ka dhënë ai vazhdimisht çështjes së Kosovës. Një vlerësim i tillë nuk është i rastësishëm dhe as nuk është pasojë thjesht e përgjegjshmërisë së tij për të zbatuar porositë, që i vinin edhe atij si çdo diplomati shqiptar nga udhëheqja politike e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përkushtimi i tij ndaj çështjes së Kosovës është frymëzimi i brendshëm dhe buron, para së gjithash, nga formimi i tij identitar në familjen ku është lindur e rritur. Dhe, së dyti, rëndësia, që i dha ai "*diplomacisë kulturore*"ose asaj që ai e quan "Pushteti i butë" dhe që e sqaroi shumë mirë në këtë libër. Në sajë të formimit të vet të mëparshëm si njeri i kulturës, ai e kuptoi drejt se, qoftë në një metropol si Stambolli e qoftë në një metropol si Londra, diplomati apo kryediplomati shqiptar nuk kishte asnjë aset më të çmuar se pasuria kulturore për ta bërë të njohur vendin e për t'ia shtuar

atij miqtë.

Libri, që kemi në dorë, nuk është një vëllim i mirëfilltë kujtimesh. Ambasadori Mal Berisha ka sjellë këtu një larmi episodesh, të përshkruara si tregime të shkurtra, të cilat lexohen me kërshëri dhe ëndje. Ai nuk synon të zbulojë para lexuesit të panjohurat apo enigmat e punës së një ambasadori, siç bëjnë rëndom ish - diplomatët e lartë, kur dalin në pension dhe duan të lënë dëshminë e rëndësisë së vet të jashtëzakonshme gjatë jetës në shërbimin e jashtëm. Jo. Nisur nga këto rrëfime, do thënë se ambasadori Mal Berisha nuk vuan nga asnjë delir protagonizmi. Ai shtyhet nga dëshira për të pohuar se, duke i shërbyer Shqipërisë, ka arritur të ketë edhe për veten e tij një jetë të bukur me gjithë andrallat e saj, gjë që i shkon një burri të realizuar.

Besnik Mustafaj

Ish-Ministër i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë dhe ish-Ambasador në Republikën Franceze

DEVIZA IME:

GUXIMI

MENDOJ SE ËSHTË ME RËNDËSI QË NJERIU TË GUXOJË. GUXIMI NUK ËSHTË CILËSI QË DUHET KEQPËRDORUR, AS QË DUHET PËRDORUR VETËM KUR GJENDESH NË ALTERNATIVËN: JETË APO VDEKJE!? GUXIMI DUHET EDHE KUR TË OFROHET NJË MUNDËSI QË KËRKON ZOTIM, PROFESIONALIZËM DHE FORCË KARAKTERI. NJERIU VIHET NË PROVË. LUFTA ËSHTË E GJATË, BETEJAT JANË TË SHKURTRA. POR MOS GUXO TË BËSH GJËRA TË TURPSHME PËR T'I FITUAR BETEJAT DHE AS MOS IU SHMANG BETEJËS, SEPSE TË VJEN TURP TË HUMBËSH!

MËDYSHJA ËSHTË ARMIKU I GUXIMIT.

KREU I PARË

NË KONSULLATËN SHQIPTARE NË STAMBOLL, 1992-1997

Kryetemë:

SHQIPËRIA NË SHTJELLËN E NGJARJEVE DRAMATIKE TË VITIT 1997

"Tre diplomatë shqiptarë të akredituar në Turqi patën një takim shumë të rëndësishëm me personalitete të larta turke. Ata i paraqitën palës turke shqetësimin e madh për rrezikun, që i kanosej vendit të tyre. Disa orë më vonë, diplomatët u njohën me një draft prej 12 pikash nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Turke lidhur me aksionin, që do të ndërmerrej në Lindje të Greqisë, në rast të një agresioni të kësaj të fundit ndaj Shqipërisë. Kjo bëri që planet greke të mbeteshin vetëm në lojën e fjalëve të qeveritarëve dhe në mendjet e sëmura të organizatave Vorio - Epirote".

MË DATËN 29 MARS 1997, PAS NJË TAKIMI URGJENT ME SHEFIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË TURKE, GJENERALIN ISMAIL HAKI KARADAĜI, ZV/KRYEMINISTRJA DHE MINISTRJA E JASHTME E TURQISË, TANSU ÇILLER, DEKLAROI PËRSËRI PARA SHTYPIT DHE MEDIAS TURKE:

"Turqia është e vendosur të ruajë integritetin territorial të Shqipërisë dhe nuk mund të qëndrojë pasive ndaj ngjarjeve, që kërcënojnë me copëtimin e Shqipërisë. Përkeqësimi i situatës në Shqipëri është i palejueshëm dhe do të ishte turp për Evropën, ndaj nga ana e saj Turqia është e gatshme të bëjë gjithçka për stabilizimin e gjendjes në Shqipëri".

"Turkish Daily News", 30 mars 1997

UDHËTIMI I PARË NË STAMBOLL

Në paraditën e 23 nëntorit 1992, e nisa udhëtimin tim të parë si diplomat në Stamboll. Ajo ditë shënoi për mua fillimin e një maratone që zgjati, herë në zyrë e herë jashtë saj, gjatë 27 vjetëve, nëpër qendrat nga më të ndryshmet e më të mëdhatë e botës: në Stamboll, New York, Kombet e Bashkuara, Tiranë, Prishtinë, Londër, Washington, Kajro, Jedah, Moskë, Damask, Bejrut, Hagë, Lefkosha, Gjenevë, Boston…

Atë ditë, bashkë me një shofer të Ministrisë së Punëve të Jashtme, kalova pikën kufitare të Kapshticës me mikrobusin *Peugeot*. Ishte hera e parë që shkelja në tokën greke. Emocionet ishin shumë të forta. Mëdyshja, nëse po shkelja në tokë greke apo isha ende në trojet e vendit tim, më shoqëroi për një kohë të gjatë. Ishte udhëtim i bukur dhe interesant. Atë natë qëndruam…

Në Kavallën e Muhamet Ali Pashës

Pasi kaluam Selanikun, arritëm në Kavalla, emër shumë i njohur për ne, shqiptarët. Ai është qyteti ku kishte lindur Muhamet Ali Pashë Kavalla, bir i dy prindërve shqiptarë. Ishte i famshëm, sepse kishte themeluar një shtet: Egjiptin modern. Kisha lexuar nga historia dhe kisha dëgjuar edhe më shumë nga njerëz të mençur. Dinastia e tij e kishte sunduar Egjiptin që nga viti 1805 deri në vitin 1952. Ai mblodhi mamlukët e shpërndarë në shkretëtirë dhe ndërtoi një shtet modern, i cili kishte ndikimin më të madh në botën arabe. Me kontributin e asaj dinastie u hap Kanali i Suezit, një ndër veprat më të mëdha, që ia ka ndërruar gjeografinë dhe vijën e udhëtimeve detare një pjese të madhe të botës.

Ai u hap më 17 nëntor të vitit 1869. Franca dhe Britania konkurruan, investuan, treguan xhelozitë e tyre në atë rajon, ku dëshirat për kolonizime

ishin aq të mëdha, por familja e Kavallive luajti rolin kryesor. Mehmet Ali Pasha kishte vdekur në vitin 1949 dhe trashëgimtari i tij, Said Pashai, mori drejtimin kryesor në hapjen e atij kanali. Dinastia u shua në vitin 1952 pas revolucionit të drejtuar nga Abdel Nasser. Rënia e saj solli edhe largimin prej aty të Mbretit Shqiptar në mërgim, Ahmet Zogu, i cili ishte marrë nën kujdes nga dinastia shqiptare e Egjiptit dhe jetonte në Aleksandri.

Pasi kaluam natën në një hotel të thjeshtë në gjirin detar të Kavallës, e lamë atë të nesërmen dhe udhëtuam gjithë ditën për të arritur në Stamboll mbrëmjen e 24 nëntorit 1992.

Konsullata e Përgjithshme e Shqipërisë në Teşvikye, Şişli, Stamboll

Konsullata e Përgjithëshme e Republikës së Shqipërisë, në atë kohë, gjendej në një rrugicë në Teşvikye, Şişli në qendër të Stambollit. Ajo ishte e vendosur në një ndërtesë që nuk binte në sy. Rrugica ishte e ngushtë dhe ndërtesat kishin fasada, të cilat i ngjanin shumë njëra-tjetrës. Atë natë qëndrova në konsullatë, në një apartament në gjendje aq të mjerueshme, sa nuk kishte asnjë krahasim me shtëpinë time private që kisha lënë në qytezën e Mamurrasit.

Me fjalë të thjeshta, nuk kisha asgjë për t'u gëzuar që do të jetoja në një shtëpi të tillë. Por do të jetoja në Stamboll, në një nga qytetet më të bukur, më të mëdhenj, më historikë dhe më të dëgjuar në botë.

Ndërrim regjimi, ndërrim postesh - në ikje…

Kryekonsulli i Shqipërisë në largim ishte një zotëri i quajtur Enver Zeneli. Kishte ardhur koha që ai të zëvendësohej. Humori i tij shkodran dhe lehtësia me të cilin ai i bënte punët e asaj Konsullate, ishin shumë të admirueshme. Enveri nuk shfaqte ndonjëfarë mërzie apo kundërshtimi. Ishte i dashur dhe shumë i gatshëm për ndihmë. Mbante mustaqe dhe fliste bukur turqisht. Kjo e bënte shumë të pranueshëm në mjediset e atij qyteti. Ishte shumë i shoqërueshëm dhe kjo e kishte ndihmuar që të ndihej si në shtëpinë e vet, por kishte ardhur koha të largohej.

Ishte koha e ndërrimit të sistemeve, por edhe nëse jo për këtë, thjesht për vitet e shërbimit, të cilat i kishte plotësuar, duhej transferuar. Kjo ishte edhe arsyeja se përse ai i merrte gjërat aq lehtë. Atë e ndihmonte edhe e shoqja, Teuta, një zonjë me origjinë nga Skrapari, por që e fliste një shkodranishte të lezetshme si gjuhën e nënës. Të dy plotësonin njëri - tjetrin dhe dinin që ditët e vështira të transferimit nga Stambolli në Tiranë, t'i kalonin me sportivitet dhe humor. Kjo e bëri mjaft interesante atë periudhë të shkurtër të qëndrimit së bashku.

… dhe në ardhje - Orhan Zarshati

Enverin do ta zëvendësonte një intelektual shqiptar, i cili shquhej për shumë gjëra. Mbante emrin e sulltanit të katërt të Turqisë, Orhanit, i cili kishte sunduar nga vitet 1326 - 1359. Kishte një mbiemër krejt unik: Zarshati. Ishte i biri i arkitektit Adnan dhe i Ylvijes, vajzës së tretë të Ismail Qemalit. Pra, në linjë tamli ata rridhnin nga familja e madhe e Vlorajve, ose themeluesit të shtetit shqiptar. Familja e tyre, mbështetëse e Sulltan Mehmetit VI (1918-1922), për arsye që asnjëherë nuk i mësova, ishin përzënë nga Qemal Ataturku dhe ishin vendosur në Shqipëri. Këtu ata ishin trajtuar me respekt thuajse gjatë gjithë historisë së familjes për shkak të lidhjes që kishin me Ismail Qemalin, edhe gjatë Mbretërisë Shqiptare, edhe gjatë periudhës së komunizmit dhe, aq më shumë, tani në demokraci.

Ai do të ishte Kryekonsulli, ose eprori im më i afërt. Një burrë me gjatësi mesatare, ai kishte një portret shumë simpatik, me fytyrë rrumbullake, pak të kuqe dhe me pamje aristokrate. Ndoshta për shkak të prejardhjes së tij nga një degë e familjes së Ismail Qemalit, ai kishte pasur mundësinë të udhëtonte shumë herë në Turqi edhe para rënies së komunizmit, pasi kishte punuar në Tiranë për Institutin e Masave dhe Standardeve. Veç asaj, ai kishte një trashëgimi tejet të rrallë nga familja. Si bir i një intelektuali, ai zotëronte aftësinë të fliste shumë gjuhë të huaja, ndër to, shkruante osmanishten, një gjuhë, shkrimi i së cilës u shua kur Qemal Ataturku e ndryshoi shkrimin e gjuhës turke me elife në formën e shkrimit modern me shkronja latine. Ai fliste edhe gjermanishten si gjuhë të familjes, pastaj rusishten dhe gjithë derivatet e sllavishtes, deri te sllovakishtja, sllovenishtja, çekishtja dhe polonishtja. Frëngjishtja e tij ishte gjuhë

sallonesh, ndërsa italishten e kishte si gjuhën e vet.

Njohuritë e tij ishin të pafund. Dinte gjithë historinë e sulltanatit turk. Ishte model i dijenive të sistemuara dhe kishte një kaligrafi që ishte vështirë të dallohej, nëse e shkruante dora e njeriut apo makina e shkrimit. Ishte njeri prej të cilit mësoje në çdo hap. Rrobat e tij ishin përherë të zgjedhura, përtej mundësive të tij financiare. Vishte kostum të zi, këmishë të bardhë borë dhe mbante shami në xhep, përherë në një ngjyrë me kravatën.

Ditët e para në Stamboll

Tri ditët e para në Stamboll ishin mjaft interesante dhe iu kushtuan, më shumë se asgjëje tjetër, njohjes së rrugëve dhe tregut. Më duhej të përgatitesha me gardërobën e re të punës së diplomatit në një qytet sqimatar, ku gjendeshin në atë kohë, 88 konsullata të huaja. Kisha nxituar të mbërrija në Stamboll në një datë historike: Ditën e përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1992.

I ri në detyrë

Unë vija nga një jetë kulturore shumë intensive. Miqtë e mi ishin artistë, aktorë, shkrimtarë, historianë, gjuhëtarë, muzikantë, këngëtarë, artistë të humorit, piktorë… Nuk kisha më shumë se katër pesë vetë të njohur, që shërbenin në Ministrinë e Punëve të Jashtme të asaj kohe. Njihja disa përkthyes, të cilët herë pas here ndalonin në qendrën time të punës me grupe turistike, duke tërhequr vëmendjen, kurreshtjen dhe zilinë tonë për mundësinë që ata kishin të qëndronin dhe të flisnin me turistë të huaj. Gjatë disa javëve pune në ministri, para se të nisesha për në Stamboll, m'u dha mundësia të njihesha me disa tema, por jo me gjithçka që duhej. Këto do t'i mësoja në vitet që vijuan në Stambollin e pafund, ku thuhej se kishte më shumë shqiptarë sesa në Shqipëri.

Konsullata dhe "enigmat" e saj

Në mjediset e Konsullatës gjendeshin disa zyra: Zyra e Kryekonsullit, ajo e Konsullit, një sallë pritjeje për vizitorët, apartamentet e banimit për të gjithë

personelin dhe... dy dhoma të fshehta. Të parat ishin mjedise normale, të pajisura me orendi të zakonshme, të shtruara me qilima të ndërmarrjes artistike "Migjeni", Tiranë, të veshura me perde shumë të rënda damasku, prej nga nuk hynte ndonjëherë drita e diellit. Por shumë unike ishin:

Dhomat e fshehta

Ato ishin vërtet tjetër gjë. Ato gjendeshin në bodrum, përballë njëra-tjetrës. Ishin aq të errëta dhe aq të mykta sa të shkaktonin një farë neverie, sapo i shikoje. Lëre pastaj kur të futeshe brenda dhe të mësoje se për çfarë përdoreshin ato!

Dhoma e Partisë…

Njëra ishte dhoma sekrete, që përdorej nga organizata e Partisë së Punës së Konsullatës, ndërsa tjetra përdorej nga Sigurimi i Shtetit, nga oficerët rezidentë të emëruar nën petkun e diplomatit. Të dyja ishin në të njëjtën trajtë e format. Dhomat ishin të izoluara nga penetrimi i zhurmës ose, më mirë të them, nga dalja e ndonjë zëri jashtë asaj dhome. Muret ishin të veshura me beze të zezë. Në mesin e dhomës së partisë gjendej një tavolinë, rreth të cilës mund të qëndronin të gjithë anëtarët ose kandidatët e partisë. Sipër tyre qëndronte varur një hinkë konike prej bezeje me kokën lart, si në një farkë kovaçhaneje, e lidhur në tavan me një kordon elastik të ndryshueshëm, i cili gjatë mbledhjes mund të ulej poshtë deri në shpinën e karrigeve të pjesëmarrësve, duke i mbuluar të gjithë. Pasi uleshin rreth tavolinës, anëtarët e partisë e zbrisnin hinkën mbi kokat e tyre.

Njësoj si në disa urdhëra apo sekte fanatike fetare, mistike, ata mbylleshin poshtë asaj mbulese të zezë. Në tavolinë qëndronte një abazhur, i cili lëshonte një dritë shumë të zbehtë, vetëm aq sa të shihnin e të lexonin direktivat e radhës të ardhura nga partia në Tiranë. Në tavolinë gjendej një magnetofon i markës GRUNDIG. Ai kishte një shirit magnetofoni, i cili kishte të regjistruar një zhurmë të pakuptimtë. Ai regjistrim nuk lëshonte as muzikë, as ndonjë melodi por thjesht një zhurmë irrituese.

Sapo mbledhja fillonte, ndizej magnetofoni dhe zhurma e tij përzihej me

fjalët e anëtarëve të partisë. Në këtë mënyrë shmangej mundësia që "*shërbimet e huaja*" të mund të interceptonin fjalët që thoshte sekretari i partisë, i cili në të shumtën e rasteve ishte shoferi ose gruaja e tij, gruaja e shifrantit ose gruaja e njërit prej kolegëve. Ky ritual do të thoshte se në atë dhomë pushteti suprem binte mbi atë dhe jo mbi titullarin. Kështu siguroheshin ata që askush të mos mund "t'i kapte" direktivat sekrete, që vinin nga Tirana, bie fjala për parimet e mbarështrimit të dhive banate ose rezultatet e jashtëzakonshme, që sillte tufëzimi i tyre…

…dhe ajo e Sigurimit

Dhoma tjetër ishte më e vogël dhe aty ulej vetëm një njeri: shifranti. Ai kishte tavolinën, hinkën e zezë mbi kokë, tabelën e shifrave, që i konvertonte në alfabetin Mors, magnetofonin GRUNDIG që bënte zhurmë, si dhe kodet e veta të transmetimit të takimeve me njerëz të ndryshëm, të cilat i raportonte te konsulli përkatës.

Për të hequr qafe marrëzira të tilla, brenda një kohe të shkurtër e transferuam Konsullatën nga Teşvikija në Nişantaşı, në rrugën Hüsref Gerede Caddessi.

PRITJA SOLEMNE NË HOTEL "MERCURY"

Mbrëmja e atij 28 nëntori të vitit 1992, do të mbetej e paharruar për shumë arsye. Pritja ishte planifikuar të bëhej në katin më të epërm të hotelit "Mercury". Ai hotel shumëkatësh gjendej pranë disa objekteve mjaft të rëndësishme historike në Beyoğly, që është një ndër zonat më të vjetra të Stambollit. Pranë tij gjendej hoteli "Pera Palas", prej nga ishte nisur Ismail Qemali në udhëtimin e tij historik për ta shpallur Shqipërinë të pavarur. Po aty kishte qëndruar edhe Mbreti Zog në udhëtimin e tij mërgimtar. Në librin e njerëzve të shquar, të cilët kishin qëndruar në atë hotel, figuronte edhe emri i Tij, përkrah emrit të Mata Harrit.

Më tej shtrihej Konsullata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërsa një paralele rruge më lart shtrihej Istiklal Caddesi, të cilën e përshkonte një dekovil nga fillimi në fund dhe ishte linja hekurudhore më e vjetër e ndërtuar në Turqinë Perandorake Osmane. Stacioni i metrosë së kësaj rruge është i dyti në botë për nga vjetërsia. Rruga është e mbushur me vepra arti dhe kisha të të gjitha feve; nga ajo e Shën Antonit të Padovës (Shën Ndoi ynë në Laç), duke vijuar me kishat katolike e protestante, ortodokse e armene, greke e gregoriane, austriake e, më tej, edhe me sinagoga të hebrejve, pa përmendur xhamitë. Çfarë diversiteti perandorak!?

Mbrëmje festive - natë lulesh

Pasi u ngjitëm së bashku në katin më të epërm të hotelit, gjithë personeli ynë bashkë me zonjat, pamë që disa njerëz sillnin lule me shirita të shkruar bukur. Në një kordon shkruhej: "*Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll*", në turqisht dhe në shqip. Në shiritin tjetër, paralel me të, shkruhej emri i individit ose firmës që i dërgonte. Lulet vendoseshin në një shtrat vertikal

të madh e shumë të gjerë, në formë vezake në krye, të mbajtura në një stekë, e cila është e gjatë mbi dy metra dhe e veshur fund e krye me lule.

Menjëherë më ra në sy një kurorë e tillë, e mrekullueshme, ku ishin derdhur gjithë ngjyrat e natyrës, rrethuar me një shirit prej mëndafshi, ku shkruhej emri i Konsullatës sonë dhe emri i dërguesit: TEN TUR. U shtanga nga bukuria e rrallë e asaj kurore lulesh. Nuk kisha parë ndonjëherë një kombinim aq të bukur. Pranë saj ishte edhe ajo e Shoqërisë "*Vëllazëria Turko - Shqiptare*". Më mbetej t'i njihja tërë ata, që i kishin dërguar ato dhurata aq kuptimplote.

Erdhi ora për të pritur mysafirët. Të parët nisën të vinin kryekonsujt nga vende të ndryshme të botës. Po shtrëngonim duart me ta dhe çdo gjë po bëhej sipas sqimës dhe rregullit diplomatik.

Nuk vonoi shumë deri sa dha ballë "Njeriu i luleve", siç do ta quaja më vonë. Ishte zoti Hayri Içli Kelmendi. Ai ishte një burrë, në atë kohë pak mbi të dyzet e pestat, me trup mbi mesatar nga gjatësia, elegant, me mustaqe spic, i qeshur, jashtëzakonisht i dashur dhe i shprehur bukur në gjuhën shqipe. Hayriu kishte të gjitha tiparet burrërore shqiptare. I veshur bukur dhe me një ecje atleti, ai na takoi të gjithëve. U njohëm dhe ndërruam nga një bisedë të shkurtër. Më pas u shkri në sallën e mbushur tej e përtej.

Pas pritjes dhe falënderimit për mysafirët dhe pas një përshëndetjeje shumë të bukur nga Kryekonsulli, z. Orhan Zarshati, ne u përhapëm nëpër sallë për të nderuar miqtë e asaj mbrëmjeje aq solemne me njerëz tashmë të lirë.

TË GJITHË BASHKË DREJT STAMBOLLIT

Pas disa javësh në Stamboll, u kthyem në Tiranë me Fiatin "Dogan" me targa të Stambollit, për të marrë edhe fëmijët. Ishte një kthim i këndshëm, ku na prisnin shumë takime interesante me shumë të afërt e me miq. Kërshëria për Stambollin dhe interesi që zotëronte mendjet e njerëzve për atë punë, e cila në fakt ishte fetishizuar aq shumë, mbushnin bisedat e atyre ditëve, në çdo takim që patëm. Si është Stambolli? Sa ura ka në Bosfor? Ku janë pallatet e sulltanëve? Po Xhaminë Blu, a e keni parë? Po Hagia Sofia është e bukur? Sa shqiptarë gjenden në Stamboll dhe a flasin shqip? A është Turqia një vend modern apo i prapambetur, siç na e kanë thënë? Po konsullata çfarë është? Si funksionon? Sa gjëra sekrete dini ju diplomatët?

Këto ishin pyetjet që duhej t'u përgjigjesha çdo ditë të asaj periudhe të shkurtër në atdhe. Pas atyre ditëve, erdhi hera që të niseshim përsëri drejt Stambollit. Ishim katër vetë që do të shkonim në Stamboll: Ne të dy dhe dy djemtë, i madhi, Erioni 13 vjeç, ndërsa Kreshniku 7 vjeç.

Në Tiranë ishte një ditë me mot të zakonshëm dimri shqiptar. Me ne do të vinte deri në Shkup një njeri i yni shumë i dashur, Skënder Thaçi. Me Skënderin më lidhte një fije e fortë gjaku, që na bashkonte në Geghysen të Malësisë së Gjakovës. Ishte gjyshja e atij, e mirënjohura Cucë Avdylja, e cila në moshën 16 - vjeçare, i kishte bërë ballë ekspeditës malazeze, që sulmoi Malësinë e Gjakovës. Ajo i mori hakun vëllait, Ukshin Avdylit, i cili mbeti i vrarë në përpjekje me malazezët. Cuca ia mori pushkën nga dora shkjaut, e vrau atë por mbeti edhe vetë e plagosur nga një bajonetë e një shkjau tjetër. Nga ana tjetër, Fatimja, gjyshja ime, një trimneshë malësore me një jetë plot mundime, ishte po nga e njëjta derë dhe ishin rritur bashkë në një oborr. Cucën e martuan në fshatin Vuthaj afër Plavës e Gucisë. Si në legjendën e Doruntinës, për shkak të

kufirit të mallkuar, ajo mbeti e izoluar atje. Ndërsa gjyshja ime u martua në Gashin e Malësisë së Gjakovës.

Kaluan dhjetëvjeçarë deri sa erdhi një kohë kur njerëzit e një gjaku, që i kishin mbijetuar kohës të ndarë, u takuan. Një prej tyre ishte Skënderi, një djalë me të kaluar dramatike, i burgosur që në moshën dyvjeçare, me baba dhe xhaxha të vrarë e të zhdukur nga forcat serbo - malazeze dhe me një rini të vrarë nga regjimi shovinist serb. Ai kishte ardhur në Shqipëri dhe me gëzimin për punën që kisha filluar në Stamboll, deshi që të udhëtonte me ne deri në Shkup. Kështu bëmë.

Të pestë shkuam deri në Shkup së bashku. Atë natë qëndruam në një hotel në qendër të qytetit. Në të gdhirë pamë që Shkupi ishte mbuluar me borë, ndoshta gati një metër trashësi. Erdhi momenti të ndaheshim. Në atë kohë, shqiptarët e Kosovës që hynin në Shqipëri përndiqeshin nga regjimi i Milosheviçit. Tani Skënderi duhej ta lente pasaportën jugosllave tek një mik i tij shqiptar në Shkup dhe të udhëtonte për në Gjakovë nëpërmjet të Hanit të Elezit, pa u kuptuar se kishte qenë në Shqipëri. Ndërsa ne vijuam rrugën nëpër Bullgari drejt Stambollit. Ikëm tërë merak se mos autoritetet do ta bllokonin në kufi Skënderin.

Me të arritur në Stamboll, mundëm të lidheshim në telefon. Mësova prej tij se, pas një interviste të gjatë dhe keqtrajtimi nga autoritetet serbe të kufirit, ia kishte dalë të hynte në Kosovë nëpërmjet atij kufiri shqiptaro - shqiptar. Një erë e re po frynte në tërë trojet shqiptare. Tani na prisnin shumë punë në qytetin e Stambollit.

Ishim katër që udhëtuam drejt Turqisë, por sa do të ishim bashkë kur të ktheheshim!? Rrugëtim i gjatë, deri në vijën e finishit. Kështu filloi rrugëtimi im në shërbimin diplomatik në qytetin magjepsës, me gëzime dhe brenga, me kënaqësi dhe zhgënjime, të cilat do të pasoheshin me shumë të tjera në një hark kohor 27-vjeçar.

20 janar 1993

KOHË NDRYSHIMESH RRËNJËSORE

Me Kryekonsullin tonë, Orhan Zarshatin, punuam në Stamboll në një kohë ndryshimesh të mëdha politike në Tiranë. Një ndër detyrat kryesore të shërbimit tonë diplomatik në atë periudhë ishte hapja e Shqipërisë ndaj botës, pas izolimit aq të gjatë. Kjo fillonte me të gjitha praktikat e punës, të cilat tanimë mbështeteshin jo në frikën ndaj botës, por në bashkëpunimin me të.

Ndryshim në marrëdhëniet me trupin konsullor…

Kryekonsulli i deriatëhershëm, z. Enver Zeneli, na tregonte:

- E besoni çfarë sikleti kisha kur shkoja në pritjet e trupit konsullor këtu në Stamboll? Porosia nga Tirana ishte e prerë:

"Nëse do t'ua jepni dorën konsujve amerikanë, rusë, kinezë, anglezë e izraelitë, më mirë kthehuni vetë në Shqipëri dhe jepni llogari, për tradhti ndaj atdheut!"

- Çfarë të bëja? Kur vija në pritje, shihja mirë kë kisha përpara. Ja ku ishte ai, amerikani! Unë bëja kthesë nëntëdhjetë gradë dhe shmangesha. Pas pak më dilte përpara izraeliti. Hopa një kthesë tjetër. Më tutje kisha rusin. Boooo! Duhej shmangur edhe ai! Pas kësaj ikja shpejt e shpejt sepse… më mirë të ikja se sa dikush të më raportonte se u takova me armiqtë. Tani ndryshuan kohët. Këto kohët e fundit, para se të vinit ju, një natë isha në një pritje ku merrte pjesë Kryekonsulli Amerikan, z. Mark Dion. Shqipëria kishte ndryshuar dhe unë iu afrova dhe i thashë:

"Unë jam Kryekonsulli i Shqipërisë në Stamboll".

"Uauau!" - më tha z. Dion. "Ne jemi parë shpeshherë dhe ju nuk keni denjuar të më jepnit as dorën!"

"Po", - i thashë, - "por tani Shqipëria ka ndryshuar".

"Jo", - ia priti z. Dion, - "nuk mund ta besoj këtë, derisa ju jeni ende këtu".

Enveri e tregonte me humor, por amerikani ia kishte kthyer "reston" e injorimit që i kishte bërë ai në shumë raste.

…dhe në marrëdhëniet me shqiptarët e Stambollit

Nuk dua të ndalem rreth punës së Konsullatës sonë në Stamboll në të kaluarën, por po ndaj me lexuesin rrëfimin e një shqiptari të atij qyteti, Muhamet Akaya, siç ma tregoi ai vetë në zyrën time dhe që flet më shumë se gjithçka…

"Që nga koha kur u bëra të mbaj mend, unë jetoja me dashuri për Shqipërinë dhe për Kosovën. Kur u rrita, vija këtu në Konsullatën Shqiptare për të takuar konsujt dhe punonjësit e saj. Vija gjysmë i maskuar, sepse qeveria turke na ndiqte ne që vinim këtu, për shkak të propagandës që bënte Tirana nëpërmjet kësaj përfaqësie dhe që mbështetej nga grupet majtiste, të cilat e turbullonin shpeshherë jetën politike në Turqi. Ato përfundonin me konfrontime të përgjakshme, grushte shteti, burgim të udhëheqësve etj. Pas shumë vitesh, që kisha hyrë dhe dalë në Konsullatë, 'guxova' dhe kërkova një vizë për të parë Shqipërinë. Unë mendoja se me atë marrëdhënie aq të ngushtë që kisha ndërtuar, viza ime as që do të diskutohej. Por nuk ndodhi ashtu! Më zvarritën gati dy vjet me justifikime, që nuk më bindnin fare. Kur e humba shpresën, ata më njoftuan se do të ma jepnin vizën. U gëzova pa masë. Bleva disa dhurata për personelin e konsullatës. Për vete bleva rroba të reja, sigurisht edhe gjëra që më duheshin për të shkuar në Shqipëri dhe udhëtova drejt vendit tim të shenjtë. Njerëzit e mi ishin kosovarë të ardhur në Shqipëri që në kohën e Mbretërisë dhe jetonin në Fier. Shkova atje. U njoha me njerëzit e babait tim. U çmallëm. Pashë me sytë e mi shumë skamje dhe mjerim, që ata mundoheshin ta fshihnin. Bujaria dhe dashuria ishte e papërshkrueshme, por më dhimbsej çdo gjë që ata bënin për mua."

"Një ditë më thanë se më kërkonte një zyrtar i lartë i Degës së Fierit. U

habita, pasi nuk isha një njeri që kisha ndonjë pozitë sa një autoritet i tillë të merrej me mua! As që e dija se çfarë ishte Dega. Isha thjesht një individ që punoja për familjen time. Në Turqi kurrë nuk kisha takuar ndonjë njeri të MIT-t. Pse në Shqipëri? Nuk desha të shkoja! Njerëzit e mi m'u lutën shumë dhe më thanë që, nëse nuk shkoja, nuk do të ishte mirë për ta kur unë do të largohesha. Shkuam në hotel-turizmin e Fierit. Ishte një klub i madh dhe i bukur. Dikush, jo nga rrethi i njerëzve të mi, më ftoi të futesha në një dhomë, ngjitur me klubin e turizmit, veçmas njerëzve të tjerë. Ishte një dhomë pritjeje e mobiluar shumë mirë, me kolltuqe. Pas pak erdhi një burrë i veshur bukur, i madh nga trupi, dhe me shumë vetëbesim. Pasi u ulëm, kamarieri e mori porosinë, i solli kafetë dhe iku. Njeriu i Degës më pyeti për familjen, punët që bëja, çfarë lidhjesh kisha në Kosovë etj. Të gjitha m'u dukën pyetje normale. Pas kësaj më tha:

"E di ti se ne jemi shumë të pakënaqur prej teje, pasi na ke bërë një dëm shumë të madh?

Mos, mor burrë, - i thashë, po çfarë paskam bërë?

Epo ja, ne nuk e prisnim prej teje këtë gjë. Si ka mundësi që na ke bërë një propagandë të tillë?

Çfarë propagande, bre!?

Po, po, ti ke thënë se prej vitesh je në pension të përhershëm në Turqi, edhe pse nuk je as pesëdhjetë vjeç në moshë. Ku i paska gjetur Turqia kaq para sa të paguajë njerëzit që shëtisin lart e poshtë me pensione aq të mira, edhe pse janë kaq të rinj?

"Unë u shokova" - po më thoshte Muhameti. "Gjatë një bisede me njerëzit që më mikpritën, iu kisha treguar se kisha punuar 23 vjet në galeritë e një miniere qymyri. Pas aq vitesh, sipas ligjit, kisha dalë në pension të parakohshëm, por mund të bëja edhe punë tjetër. Dhe unë ashtu bëra. Pra, isha në pension dhe në punë. Me sa duket në Shqipëri kjo iu duk diçka shumë e madhe".

"I kërkova një mijë herë të falur atij burri, duke i thënë se nuk e dija që është gabim të tregosh të vërtetën, por ai këmbëngulte se unë e kisha shkelur besimin dhe nderin që më kishin bërë, duke më lënë të vija në Shqipëri, në Shqipërinë që unë e doja me gjithë zemër."

"Gjithsesi, ai takim mbaroi e dolëm qejfprishur të dy palët", - vazhdoi

ai. – "U mërzita pa masë. Mikpritësit e mi po më prisnin në kafen e madhe të hotelit. E kuptuan menjëherë që diçka nuk kishte shkuar mirë. U kthyem në shtëpi e atë natë nuk fjeta. Isha i dërrmuar, sepse gabova, pa e ditur dhe pa qëllim. Të nesërmen iu thashë njerëzve të mi se dua të kthehem sa më shpejt në Stamboll. Diçka kuptuan se largimi im i menjëhershëm, pa mbushur as dy javë edhe pse kisha shkuar për të ndenjur tre muaj, mund të kishte lidhje me takimin e një dite më parë. Sado që këmbëngulën që të rrija edhe më, nuk u binda, por u ktheva në Stamboll. Familja ime u habit që u ktheva aq shpejt, por nuk iu tregova se çfarë ndodhi. Nuk vonoi shumë dhe një ditë më telefonuan nga Konsullata Shqiptare, këtu. Zëri nga ana tjetër më erdhi i vrazhdë, urdhërues dhe i pakënaqur."

- Na tradhtove, - më tha ai, - na more në qafë edhe ne, që të ndihmuam ta vizitoje Shqipërinë!

"U ndjeva aq i fyer dhe i mërzitur, por edhe sot nuk e di fajin që kisha bërë. Prej asaj kohe e deri më sot, nuk kam shkelur më në këtë derë. Po tani kam dëgjuar që edhe ju jeni bërë vend demokratik dhe, duke e konsideruar Konsullatën një vend të shenjtë për ne shqiptarët, erdha edhe një herë".

E prita Muhametin, e nderova, e dëgjova dhe u ndjeva i lumtur që unë vërtet e përfaqësoja Shqipërinë, por tashmë një Shqipëri krejt tjetër.

Pasaportat dhe Laissez - Passers (leje kalimet) në Konsullatën Shqiptare të Stambollit

Veprimtaria konsullore e shtetit është e sanksionuar shumë qartë në Konventën e Vjenës, të vitit 1961, të cilën e ka nënshkruar edhe Shqipëria. Respektimi i saj është parakusht i detyrueshëm për t'u zbatuar nga momenti i nënshkrimit nga të gjitha palët. Në të kundërt, askush nuk lejon të hapen zyra përfaqësimi, konsullore ose diplomatike, të një vendi tjetër brenda territorit të vet. Por, në marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore midis Shqipërisë dhe Turqisë, Konventa e Vjenës respektohej, në atë kohë, në mënyrë elastike, për të bërë që udhëtarët shqiptarë drejt atij vendi t'i ruanim prej ndëshkimeve të shumta, që rridhnin nga shkelja e afateve të qëndrimit të lejuara në vizën e marrë nga ambasada turke në Tiranë. Të tillë ishin me dhjetëra.

Shkelja e afatit të qëndrimit shoqërohej me gjoba në dalje të kufirit turk,

të cilat ishin më të mëdha sesa paratë që shqiptari kishte fituar gjatë punës katër, pesë a gjashtëmujore. Por në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendase dhe me drejtuesit e emigracionit turk në Stamboll, duke shfrytëzuar marrëdhëniet e mira mes dy vendeve, jeta e shtetasve tanë lehtësohej shumë me një gjest krejt artificial. Për shembull, kur një shqiptar shkelte vizën dhe paraqitej me pasaportë në kufi, i nënshtrohej gjobës për qëndrim të paligjshëm. Por nëse paraqitej me një *Lessie Passier*, me një të drejtë kalimi, kthim në atdhe, ai nuk i nënshtrohej asnjë lloj dënimi.

Këtë e kishin mësuar, ndaj çdo ditë aty vinin shqiptarë, që "kishin humbur pasaportën". "Çuditërisht" të gjithë i kishin humbur "në të njëjtin vend" dhe në të njëjtën mënyrë: "Ma vodhën atje në Kapalıkçarşi, kur po bleja ca gjëra!?" Ky ishte justifikimi i përgjithshëm.

Që kjo nuk ishte e vërtetë e dinim edhe ne në konsullatë, por e dinte edhe zyra e emigracionit turk. Por, duhet thënë se asnjëra palë nuk e bënte "të madhe". Djemtë e vajzat tona shkonin e vinin, duke shfrytëzuar këtë sjellje njerëzore të dy shteteve, pa i "shkelur rregullat".

MARRËVESHJA E "XHENTËLMENËVE" PËR KURIMIN E SHQIPTARËVE ME SËMUNDJE VESHKASH, NË STAMBOLL

Marrëveshje "xhentëlmenësh" shqiptaro - turke

Një ndër veprimtaritë më humane të konsullatës ishte zbatimi i një marrëveshjeje prej "*xhentëlmenësh*", e arritur mes ministrave të shëndetësisë së dy vendeve, Turqisë dhe Shqipërisë, për kurimin e shqiptarëve, që vuanin nga sëmundjet nefrite. Një studim i asaj kohe e cilësonte vendin tonë si vend me numër të madh të njerëzve me sëmundje veshkash, për shkak të përbërjes së lartë gëlqerore të ujërave të pijshëm.

Kjo quhej "marrëveshje xhentëlmenësh", pasi nuk kishte klauzola detyruese, pra zbatohej bazuar në një vullnet të mirë, aq sa mundej. Kjo bëri që shumë nevojtarë të vërshonin drejt Stambollit. Një dyndje njerëzish me veshka të sëmura që nuk iu funksiononin, udhëtonte drejt nesh.

Dyndje shqiptarësh të sëmurë me veshka drejt Stambollit

Për muaj dhe vite me radhë na duhej të prisnim njerëz, të cilët vinin në Stamboll, duke pasur me vete, thjesht dhe vetëm një numër telefoni të konsullatës sonë dhe shpresën e madhe se aty do të gjenin shpëtimin, që nuk e kishin gjetur deri atëherë. Në Ministrinë e Shëndetësisë në Tiranë, gjendej një nëpunës i marrëdhënieve me jashtë, me mbiemër Xhafa, i cili iu "kryente punë" për pesë minuta. Ai kishte një skedë të vogël me numrin e telefonit dhe adresën e konsullatës, ua jepte të shkruar bukur dhe i përcillte "të lumtur", duke iu premtuar se çdo gjë ishte gati për ta, në Stamboll.

Kishte mes tyre me insufiçiencë të plotë renale, që veshkat i kishin lënë fare,

të tjerë ishin në hemodializë e më pas nga ata që kërkonin transplant veshkash. Disa vinin me gjak të helmuar nga mosfunksionimi i veshkave dhe, shpesh, ishin thuajse në gjendje kome. Të tjerë, nga hemodializa primitive në Tiranë, kishin përfituar edhe sëmundje të tjera infektive, si hepatitet virale të llojeve të ndryshme. Lëkura e tyre, kur i merrnim në aeroport, ishte krejt e verdhë si lëvore portokalli. Në shumë raste procesi i shtrimit në spital zgjaste dhe e para gjë që duhej të bënim ishte t'i strehonim deri sa kjo të rregullohej.

Kujdes njerëzor përtej detyrës zyrtare

Të merrje në shtëpi njerëz të panjohur me infeksione të tilla, edhe pse vinin nga vendi ynë, e aq më tepër që ne kishim edhe fëmijë të vegjël, ishte përtej çdo detyrimi zyrtar, por jo edhe përtej detyrimit dhe mirësisë njerëzore. Gjendja e atyre njerëzve ishte mëse e dhimbshme. Ndodhte që t'i mbanim në shtëpi, të paktën natën e parë, dhe më pas t'i vendosnim nëpër spitale. Të tillë kemi pritur në atë kohë 156 vetë. Janë po aq histori njerëzore të dhimbshme, që përjetuam gjatë kujdesit për ta. Janë po aq urime njerëzish, që gjenin shërim në rrethana aq të pafavorshme, sa për ata aq edhe për ne.

Ndodhi të tilla shpesh kishin vuajtje dhe fund tragjik. Njëri prej këtyre dha shpirt në aeroplan, duke ardhur nga Tirana dhe ne, në vend që ta dërgonim në spital, e nisëm në morg, për ta kthyer mbrapsht, të pajetë, pranë familjes.

Bashkë me zotin Zarshati, si dhe me zonjat tona ishim thuajse çdo ditë të angazhuar që t'i ndihmonim ata njerëz. Zonjat tona i dërgonin dikujt një frut, dikujt një qese me rrush, dikujt një pije të butë, por asnjëherë nuk shkonin me duar bosh në spitale, përkundër mundësive tona tepër modeste, financiare. Ata ishin më së shumti njerëz të vuajtur dhe të dëshpëruar, jo vetëm pse i kishte lënë shëndeti, por edhe pse ishin pa njerëz që t'i kishin afër në spital, nuk dinin gjuhë dhe, në të shumtën e rasteve, ishin pa një "grosh" në xhep.

"Shërimi" dhe humbja e Gertmandrin Hasandoçit

Një nga rastet më të dhimbshme ishte ai i Gertmandrin Hasandoçit. Ai ishte një djalë rreth 13-vjeçar, të cilit nuk i funksiononte asnjëra veshkë. E sollën në Stamboll me shpresën se do t'i gjenin një dhurues veshke, por kjo ishte e

pamundshme, ndaj dhuruese u bë e ëma, Zhujë Krasniqi. Ajo erdhi nga Tirana dhe u shtrua në spital pranë të birit. E mbajtëm disa ditë në shtëpi dhe u miqësua me dy djemtë tanë, Erionin dhe Kreshnikun. Pastaj... e priste spitali!

Përshtatja e veshkës së nënës në trupin e të birit kërkonte të paktën gjashtë muaj trajtim të përbashkët dhënës - marrës. Pas asaj periudhe, nën kontroll të rreptë mjekësor, u ndërmor operacioni. Atë ditë shkuam në spital thuajse i tërë personeli i konsullatës. Operacioni u krye me sukses, por nuk kishte gjë më emocionuese sesa të shikoje sesi nëna i kishte dhënë një pjesë vitale të trupit të vet të birit dhe ishte kthyer për vete në një kufomë të gjallë. Pamja e dhomës ku ata të dy u trajtuan, pas operacionit, dukej si skenë lufte.

Kaluan disa kohë dhe mjekët thanë se ata, të dy, nënë e bir, mund të ktheheshin në atdhe. I ftuam në konsullatë. Ishim të gjithë të gëzuar për atë që ishte arritur. I përcollëm për në Shqipëri dy vetë, që kishin nga një veshkë. Por gëzimi ynë nuk zgjati shumë... Pas dy muajsh na erdhi një lajm i kobshëm. Trupi i Gertmandrinit e kishte "hedhur jashtë" veshkën e nënës së tij dhe ai kishte ndërruar jetë. Ai lajm u përjetua në konsullatë si çast zie. U lidhëm aq shumë me atë familje sa na dukej sikur dikush prej tanëve e kishte përjetuar atë tragjedi.

Afërdita D.

Afërdita D., ishte një zonjë tiranase, e cila kishte po të njëjtin problem me veshkat. Ajo erdhi dhe ne e shtruam në spital. U kurua disa ditë por, papritmas, një natë, ajo ndërroi jetë. Rreth orës pesë të mëngjesit mora një telefonatë nga spitali, prej nga na njoftonin se zonja në fjalë kishte vdekur. Problemi i spitalit ishte se i biri, një djalosh njëzetvjeçar që e shoqëronte të ëmën, kishte kaluar në delir dhe ishte bërë agresiv me personelin, të cilët i akuzonte për vdekjen e nënës. U veshëm të dy dhe menjëherë kaluam Urën e Bosforit drejt anës aziatike të qytetit, tek ai spital. Donika u mor me djalin dhe, si një nënë e mirë, e pajtoi atë, ndërkohë që e ndjera u hoq nga pavioni për t'u bërë gati për kthim në atdhe.

Djalin e morëm me vete në shtëpi dhe e trajtuam si birin tonë. Ai u lidh në telefon me Tiranën. Transporti kushtonte dhe djali kuptohet që nuk ishte i përgatitur për një shpenzim të tillë... e në një rast të tillë kush përveç nesh do

t'i gjendej atij djaloshi në atë situatë aq të vështirë?

Vite më vonë, krejt rastësisht më ndaloi në rrugë një oficer i Gardës së Republikës. Ai më përshëndeti duke ma kujtuar atë ngjarje tragjike. Ishte shumë emocionuese të takoheshe me të birin e të ndjerës Afërdita, me të cilin ishim njohur në një rrethanë aq tragjike.

Hasan Hüseyin Şener - një filantrop i dashur për shqiptarët

Moria e të sëmurëve nga veshkat që mbërrinin në Stamboll kërkonte patjetër mbështetje financiare, të cilën shteti shqiptar nuk e kishte. Por një shoqatë e njohur Humanitare Islamike, e kryesuar nga Hasan Hysein Şener, na ndihmonte shumë. Sa herë të sëmurët vinin në aeroport ose në stacionin e autobusit në Top Kapı, ne thërrisnim Hasan beun. E telefononim, e ai thoshte:

"Hë, erdhi ndonjë tjetër sot?"

Pasi merrej me organizimet, ai na tregonte spitalin ku duhej t'i dërgonim të sapoardhurit. Kjo odise e këtyre njerëzve ishte aq e dhimbshme dhe kaq e mundimshme sa vërtet të këputste shpirtin. E, megjithatë, ndoshta pikërisht ai kujdes përbën edhe anën më të ndritshme të asaj periudhe pune, në atë konsullatë.

Donacion vllazëror i Raif Terziut: Impianti i distilimit të ujit në Spitalin Klinik në Tiranë

Para largimit nga Stambolli arritëm të siguronim një impiant për distilimin e ujit të hemodializës, të cilën erdhën dhe e morën dy mjekë nga Tirana. Njëri ishte tekniku Elif, i cili kishte eksperimentuar dhe prodhuar vetë një makinë primitive të hemodializës në Shqipëri në vitet '70. Ai e kishte prezantuar atë në një panair novatorësh dhe që duhet të jetë në muze edhe sot. Tjetri ishte mjeku nefrolog prof. dr. Myftar Barbullushi. Ai impiant, siç do ta përmend edhe më vonë, ishte dhuratë e zotit Raif Terziu dhe u instalua në Spitalin Civil në Tiranë me ndihmën e dr. Barbullushit dhe teknikut Elif.

Makinat e hemodializës "HOSPAL" që nuk erdhën kurrë në Shqipëri

Në atë kohë arrita të siguroja një numër makinash hemodialize të markës më të mirë në botë, prodhimi suedez HOSPAL, të përdorura, por në gjendje shumë të mirë pune, nga ato që kuroheshin të sëmurët shqiptarë në Stamboll. Ishin ditët e fundit të punës sime në atë qytet dhe krejt çfarë mund të bëja ishte magazinimi i tyre në Kadikőy me ndihmën e avokatit shqiptaro - turk, Kadri Ateş. Me t'u kthyer n*ë* atdhe, edhe pse i larguar nga puna padrejtësisht, vajta tek drejtori i Spitalit Civil në Tiranë, një farë Xhani, dhe i kërkova takim. Sekretarja, një vajzë e re dhe e bukur, e veshur pranueshëm për një diskotekë, më pyeti kush isha unë dhe përse doja ta takoja drejtorin!? I thashë emrin (dhe mbiemrin, kuptohet) si dhe arsyen:

"Dua ta njoftoj drejtorin për disa makina "HOSPAL", që i kam siguruar për të sëmurët me veshka. Makinat janë në Stamboll. Spitali ka për detyrë vetëm t'i transportojë e t'i sjellë këtu. Çdo gjë tjetër është e kopsitur".

Vajza hyri në zyrën e drejtorit. Pas pak doli dhe më tha:

"Drejtori nuk të pret". Unë bëra një gjest habie që do të thoshte:"Përse?!"… Ajo rrudhi krahët, bëri një gjest prej kokete dhe më dha të kuptoja se duhej të dilja nga zyra. Këtu u mbyll edhe historia e makinave të hemodializës "HOSPAL", që nuk erdhën kurrë në Shqipëri.

Të sëmurët vazhduan edhe për shumë kohë të rropateshin rrugëve të Stambollit deri sa një ditë u ngrit Reparti i Hemodializës, në Tiranë, sipas modeleve të "mjekësisë falas". Në korrik të vitit 2016, kjo "mjekësi falas" bëri kurban dy paciente, zonja, të cilat u dogjën brenda repartit në mënyrën më tragjike. Njërën prej tyre e njihja, pasi ishte bashkëshortja e një mikut tim nga Mamurrasi. Sanije Sula e ndjerë, në vend që të merrte shërbimin, doli e djegur nga pavioni! Zot na ruaj!

VDEKJA E PRESIDENTIT TURK, TURGUT ŐZAL

Kisha vetëm disa muaj në detyrën e Konsullit të Shqipërisë në Stamboll. Ishte një periudhë kur më duhej të mësoja shumë gjëra, përfshirë edhe trafikun e qytetit. Gjatë atyre muajve kisha pritur e përcjellë shumë njerëz nga të gjitha kategoritë: diplomatë, nëpunës shteti, artistë, biznesmenë, politikanë, shokë e miq, të sëmurë e të shëndoshë, të njohur e të panjohur. E tillë ishte puna në atë qytet gjigand, një prej tre katër më të mëdhenjve në botë.

Papritmas ndodhi një ngjarje e dhimbshme për historinë e Turqisë. Vdiq Presidenti Turgut Őzal. Ishte data 17 prill 1993.

Ai ishte autoritet i padiskutueshëm, njeri skrupuloz, burrë i rëndë, me një karrierë tejet të pasur politike, me ngjitjet e rëniet e tij të shumta, si çdo politikan. Në Turqi ai vlerësohej si reformatori më i madh i ekonomisë së tregut të lirë. Po aq i madh konsiderohej për ne, edhe si mik i popullit shqiptar. Őzal vdiq në një mënyrë paksa të dyshimtë dhe ai dyshim vazhdon edhe sot të brejë mendjen dhe zemrat e shumë turqve, simpatizues të tij.

Qeveria turke vendosi të bëjë një varrim madhështor. Ajo ftoi shumë udhëheqës të botës. Një ndër ta ishte edhe Presidenti shqiptar i asaj kohe, dr. Sali Berisha.

Őzal ishte ndër politikanët turq, që e deshi shumë Shqipërinë. Sapo Shqipëria zuri të lëvizte drejt demokracisë dhe tregut të lirë, ai menjëherë reagoi dhe ndihmoi në shumë forma: me ndihma humanitare, ndihma ushtarake, lehtësim vizash dhe lejim të udhëtimit të qytetarëve shqiptarë dhe qarkullimit të mallrave drejt Shqipërisë dhe anasjellas.

Një ndër aktet më të mëdha diplomatike të asaj kohe ishte ftesa që Őzal i bëri Shqipërisë, në verën e vitit 1992, për anëtarësim në BSEC (Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi). Anëtarësimi në BSEC në atë kohë

ishte një shtysë e rëndësishme për hapjen e Shqipërisë me botën, edhe pse, në fakt, vendi ynë nuk kishte asnjë metër tokë, që lagej nga Deti i Zi.

Tani ai kishte vdekur dhe Turqia ishte mbushur plot e përplot me flamuj në gjysmë shtizë, në shenjë zie për Presidentin e saj.

Për të marrë pjesë në funeralin e Presidentit Őzal do të vinte Presidenti i Republikës, dr. Sali Berisha. Njohja ime e hershme me të, më bëri që, edhe pse vinte për një funeral, ta prisja me gëzim ardhjen e tij. E njihja që në fëmijëri dhe si atëherë edhe sot jam ndjerë si përpara një pedagogu shumë të zotë, më shumë sesa përpara një udhëheqësi. Kjo nuk ka të bëjë aspak me fuqinë që ai e fitoi si burrë shteti, president apo kryeministër, lider opozite apo deputet.

Më shumë se kaq, ndihesha si përpara një intelektuali, modeli i njeriut studioz, kërkues, trim, skrupuloz, i ndershëm dhe pa ndonjë shenjë mendjemadhësie. Kjo e fundit ndoshta ishte ajo që më bënte të mendoja atë ditë që e shoqërova në Stamboll, se ishte vetë thjeshtësia e tij që e bënte të ishte i tillë.

Ai doli nga salloni VIP, ku priteshin burrat e shtetit, dhe u takua me ne. E shoqëruam të hipte në makinën e konsullatës sonë, një BUICK amerikan i madh, i vjetër, por i mirëmbajtur, dhe u nisëm dalëngadalë drejt qendrës së Stambollit. Rruga ishte si përherë shumë e ngarkuar.

Përpara kishim një makinë të policisë së Stambollit, që na hapte rrugën dhe unë po e ndiqja me shumë kujdes. Bashkë me presidentin në ndenjësen mbrapa ishte ulur Konsulli i Përgjithshëm, z. Orhan Zarshati. Gjatë tërë rrugës folëm për të ndjerin Turgut Őzal. Presidenti donte të dëgjonte nga Orhan beu.

Ishin vitet e para të demokracisë. Neve do të na takonte të mësoheshim me shumë gjëra, edhe pritje përcjellje, edhe vizita zyrtare, edhe delegacione për veprimtari dypalëshe, edhe shumëpalëshe, por edhe për raste si ky: Funerale ku mbretëronte kulmi i solemnitetit.

Të nesërmen trupi i Turgut Őzalit u vendos të prehej përgjithmonë në Memorialin e njohur me emrin Adnan Menderes Anit Mezari, në Stamboll. Ne e përcollëm atë më dhimbje dhe respekt.

RAMIZ ALIA E DERDH SHISHEN E BOJËS GJATË NËNSHKRIMIT TË AKTIT FINAL TË HELSINIKIT, SHTATOR 1991

Me Këshillin e Konsujve Politikë në Stamboll

Kishte kaluar njëfarë kohe qëkur erdha në Stamboll deri sa u formua Këshilli i Konsujve Politikë, që shërbenin në atë qytet. Pata nderin që të isha një ndër nismëtarët e themelimit të këtij organizmi, i ftuar nga konsujt amerikanë, Michael Garrote dhe Katherine Davenport, bashkë me anglezin James Pritchard.

Këshilli, i cili shumë shpejt numëroi më shumë se 30 anëtarë, do të organizonte çdo muaj një drekë pune. Aty shkëmbenim mendime me njëri tjetrin. Secili prej nesh paraqiste një ekspoze të zhvillimeve më të fundit të vendit të vet. Në fakt ishte një nga gjërat më interesante që një konsull mund të përjetonte në ato kohëra. Një ndër këto takime u organziua nga vetë Konsullata Amerikane.

Një shëtitje me anijen amerikane "Haitha" në Bosfor

Të dy konsujt amerikanë e kishin organizuar më së miri këtë takim, i cili nuk do ishte një drekë e zakonshme në tokë, por në bordin e anijes së vogël "Haitha", pronë e konsullatës së tyre. Ajo anijëz ishte shumë mbreslënëse, e bërë e tëra prej druri, që më kujtoi anijet ilire "Liburna", siç na i kishin rrëfyer në shkollë. Hypëm të gjithë dhe zumë vendet përkrah bashit të atij mjeti lundrues. Secili prej nesh po shijonte bukuritë përrallore që shpaloste natyra dhe dora e njeriut, të para nga ai kënd i detit Marmara. Pas një prezantimi të mikëpritësve, na u afruan ushqime që do t'i vetëshërbenim, në një "menu" dhe lirshmëri tipike amerikane. Anija kishte nisur kursin e saj mes ujërave të qeta të asaj dite, e cila

do të më linte mbresa të thella, kur të dëgjoja atë që do të tregoj pak më vonë.

Sapo lamë Limanin e Haliçit, ose atë që perëndimorët e quajnë Briri i Artë, morëm drejtimin verilindor. Ishte një pasdite e bukur, disa orë përpara perëndimit të diellit. Pas një copë here lundrim, përpara nesh u shfaq një ndër gjërat më mbresëlënëse të Stambollit, ajo që njihet si Kulla e Vajzës, mbi të cilën ngrihet një fanar i madh orientues për anijet që lëvizin në atë ngushticë.

Legjenda e Kullës së Vajzës

Anija iu afrua Kullës. Kjo bëri që të nxiste dëshirën për të treguar legjendën që i kishte dhënë atë emër asaj ndërtese. Njëri nga kapitenët e anijes filloi ta tregonte legjendën:

"Siç e shikoni", tha ai, Kulla "Kiz Kulesi" ndodhet pranë brigjeve të lagjes Salaçak të Üsküdarit, në hyrjen jugore të Bosforit. Fjalë për fjalë në turqisht do të thotë "Kulla e Vajzës", emërtim që rrjedh nga një legjendë sipas së cilës, një perandor bizantin kishte një vajzë, për të cilën një profeci i thotë se, kur të bëhej 18 vjeç, ajo do të vdiste nga kafshimi i një gjarpri. Për ta shpëtuar vajzën nga një fund i tillë tragjik, ai vendosi të ndërtonte këtë kullë, mbi atë shkëmb në Bosfor, që të ishte e izoluar nga toka dhe të mos kishte asnjë mundësi që gjarpri të arrinte deri atje. E prapëseprapë vajza nuk i shpëtoi profecisë. Ajo u kafshua nga një gjarpër i fshehur në një shportë me dhurata për të, duke gjetur vdekjen e menjëhershme."

Pastaj një nga konsujt tregoi edhe një variant tjetër të lidhur po me këtë legjendë si më poshtë:

"Ndërtesa quhet edhe "Kulla Leander", tha ai, "gjë që lidhet me një histori dashurie të treguar nga Ovidi. Aty, sipas kësaj historie, jetonte një nga murgeshat e Afërditës. Një ditë ajo shkoi në një festë, ku takoi Leandron dhe menjëherë ranë në dashuri. Leandro-ja çdo natë notonte nëpër Bosfor për të takuar të dashurën, e cila e orientonte me një pishtar. Në një ndër ato net, kur ai po shkonte drejt kullës ku gjendej e dashura e tij, pishtari u shua për shkak të furtunës së fortë që shpërtheu. Leandro nuk u orientua dot dhe u mbyt në ujë. Vdekja e tij solli edhe dëshpërimin e thellë të vajzës, aq sa ajo vendosi të sakrifikohej edhe vetë, për hir të dashurisë për Leandron."

Ndërsa dëgjonim për këtë variant tjetër të legjendës, anija e vogël Haitha

u soll rreth e rreth Kullës së Vajzës dhe mori drejt Kepit të Sarayburnu – së, që është cepi i kompleksit muzeal të Top Kapi Sarayt, Hagia Sofias, Xhamisë Blu, e sa e sa veprave të tjera historike muzeale, bizantine dhe islame.

Në kthim, konsullja amerikane, Katherin Davenport, më mori veçmas e më tha se donte të më tregonte një histori, që i kishte ndodhur me Presidentin e Shqipërisë, Ramiz Alia, të cilën e kishte përjetuar ajo vetë.

Ramiz Alia e derdh shishen e bojës në Helsinki

"Ju e dini" , më tha ajo, "se Shqipëria juaj, ishte i vetmi vend evropian që nuk e pat nënshkruar Aktin Final të Helsinkit, në vitin 1975, kur 34 vende të tjera e bënë këtë. Sigurisht që atëherë ai akt i autoriteteve shqiptare u konsiderua si një veprim tepër ekstrem dhe se në hartën e Evropës, i vetmi vend i pangjyrosur në flamurin e KSBE–së mbeti Shqipëria."

"Në vitin 1991", vijoi Katherina, "unë isha diplomate e SHBA–ve në Ambasadën tonë në Helsinki. Në mesin e shtatorit të atij viti, mora detyrë nga Ambasada ime që të isha diplomatja, e cila do të asistonte në nëshkrimin që Presidenti shqiptar, Ramiz Alia, do t'i bënte Aktit Final të Helsinkit. Me këtë nënshkrim Shqipëria anëtarësohej me të drejta të plota, pasi ishin shkëmbyer të tëra instrumentet diplomatikë midis Ministrive të Punëve të Jashtme përkatëse, në New York dhe në Paris.

Salla e nënshkrimit ishte përgatitur me të gjithë solemnitetin e rastit. Ramiz Alia u afrua ngadalë, i shoqëruar nga enturazhi i vet. Ishte shumë i mrrolur dhe në fytyrë i lexohej qartë nervozizmi. Kishte një qëndrim shumë të ngjashëm me atë të udhëheqësve lindorë, i veshur rëndë, i kopsitur dhe i ngrysur.

Ai hyri në sallë dhe na përshëndeti. Dukej pak si i hutuar, por e gjeti veten shpejt dhe shkoi në vendin ku do të nënshkruante. U ul në karrigen pranë tavolinës ku e prisnin për nënshkrim dokumentet njëri pas tjetrit që unë do t'ia shpalosja me radhë.

Në sfond ishin shpalosur tërë flamujt e vendeve anëtare të KSBE–së dhe, për pak minuta, priste të vendosej edhe flamuri i anëtares më të re të organizatës - Shqipërisë."

"Unë", vazhdoi Katherina Davenport, "i hapa dosjen e Aktit Final të Helsinkit, Kartën e të Drejtave të Njeriut dhe tërë dokumentacionin tjetër

ku ai duhej të nënshkruante. Për të respektuar vijueshmërinë e veprimtarisë së organizatës, në tavolinë ishte vendosur po ajo shishe boje dhe po ajo penë me të cilën kishin nënshkruar krerët e shteteve të tjera, rreth 16 vjet më parë. Isha pas tij kur ai lëvizi dhe zgjati dorën për të marrë penën me të cilën do të nënshkruante. Pashë që dora po i dridhej. Dukej se ishte shumë i emocionuar dhe, për një çast, ndaloi. Pastaj, kur mori ta ngjyente penën në bojë, e zhyti atë më thellë sesa duhej dhe në të tërhequr bëri një proçkë:

E rrëzoi shishen dhe e derdhi bojën mbi tavolinë!!

Unë, e kuptova se ai kishte aq hezitim për ta nënshkruar atë dokument dhe ishte aq i pagatshëm dhe i pandërgjegjshëm për ta bërë atë, por që, sipas informatave që kishim marrë për Shqipërinë e asaj kohe, ai ishte i detyruar për shkak të kursit demokratik të pakthyeshëm që vendi juaj kishte ndërmarrë tashmë."

Katherina e përfundoi rrëfimin e saj ndërsa po i afroheshim zonës muzeale të Top Kapi Sarayit. Në horizont dukej një diell i bukur, që po perëndonte mbi minaretë e xhamive ndërkohë që isha përhumbur në mendime.

A kanë diktatorët brejtje ndërgjegjeje?

Vërtetë të kishte qenë hezitim ajo dridhje duarsh e Ramiz Alisë apo, ndoshta, ishte një brejtje ndërgjegjeje për vitet që Shqipëria ishte lënë jashtë asaj organizate?! A mund të kenë brejtje ndërgjegjeje diktatorët? Me këto mendime në kokë, më vinin përpara syve kujtimet e njerëzve të njohur që u tretën burgjeve apo edhe u ekzekutuan në vendin tim. Me siguri një nga shkaqet se përse, qysh nga viti 1975 deri në vitin 1991, u denuan aq shumë njerëz ishte dhe mosnënshkrimi i këtij dokumenti nga diktatori komunist, atëherë kur në Evropë kishin filluar të frynin erëra të reja.

Kohët kishin ndryshuar. Boja e derdhur nga duart e dridhura të Ramiz Alisë, dukej se kishte marrë me vete gjithë mënxyrat që kishte përjetuar populli ynë për gati gjysëm shekulli. Fatmirësisht ishte po kjo bojë që tashmë kishte nënshkruar një kapitull të ri për Shqipërinë, vendin më të izoluar të Evropës deri në atë kohë, edhe pse jo nga dora e duhur!(?)

Kohët kishin ndryshuar.

Këtë e tregonte më së miri edhe fakti që unë tani po lundroja me anijen amerikane Haitha, në ujërat e Bosforit.

ME MIKUN E TRE PRESIDENTËVE, ARTISTIN E POPULLIT, KADRI ROSHI

Një ditë pranova telefonatë prej një spitali në anën aziatike të Stambollit. Më njoftuan se atje ishte shtruar një zonjë me emrin Drita. Më kaluan në telefon të shoqin dhe sapo më tha fjalët e para, menjëherë ndjeva një drithërimë të lehtë, ngaqë e njoha zërin. Ishte nga zërat më të bukur të aktorëve shqiptarë, me pak kantilenë, me një ngecje të vogël në të folur dhe për mua një zë shumë familjar. Ende pa m'u prezantuar, i thashë:

- A jeni ju, profesor?
- Po, - m'u përgjigj.
- Po ç'ne këtu, nga po më telefononi?
- Kam Dritën sëmurë dhe e kam sjellë për ta operuar në zemër, këtu në Stamboll.

Mora makinën e shkova shpejt në spitalin Koşoyolu Hastanesi, në anën aziatike të qytetit. Personeli më priti me një kortezi të tepruar dhe të pazakonshme. E takova profesorin dhe zonjën e tij, Dritën, me të cilën njiheshim familjarisht.

Retrospektivë – Si isha njohur me Artistin e Popullit Kadri Roshi

Në pranverën e vitit 1981, rinia studentore shqiptare e Kosovës, shpërtheu në demonstrata. Ndërhyrja ndaj tyre dhe popullit të Kosovës nga forcat policore serbe ishte aq brutale dhe aq disproporcionale, sa shkaktoi shumë viktima. Shumë vetë u vranë, ndërsa burgjet u mbushën plot. Autonomia pushoi së ekzistuari. Shkëmbimet kulturore dhe akademike me Shqipërinë, edhe ashtu të pakta, por që kishin marrë një farë zhvillimi pas shpalljes së Kushtetutës së vitit

1974, u ndërprenë si me thikë. Propaganda jonë i hapi altoparlantat me volum maksimal. Populli në anën e këtejme të kufirit u irritua pa masë. Kombi ishte në rrezik. Duart tona ishin të lidhura.

Periudha pas këtyre ngjarjeve solli një aktivizim të artit e të kulturës. Njerëzit tani po mësonin më mirë se kush ishte Kosova dhe çfarë kishte ndodhur atje. Hermetizimi me Kosovën, pas prishjes në kohën e asaj që njihet si Informbyro e kishte bërë Kosovën për ne, një vend po aq të largët sa Suedia. U shkruan shumë këngë dhe vepra letrare, Ansambli i Shtetit e mbushi repertorin me materiale patriotike. Por vepra më e bukur dhe më domethënëse e asaj kohe ishte shkrimi i dramës "Toka e ndezur" vepër e një djaloshi nga Mokra, i quajtur Fahri Balliu. Drama e tij, u luajt nga aktorët e Teatrit "Skampa" të Elbasanit.

Një ditë të mërkurë, në orën 12, isha ulur pranë tryezës së punës, në zyrën time në Borizanë. Përpara kisha një radio ILIRIA dhe po prisja të dëgjoja emisionin "Teatri në Mikrofon" që e donim aq shumë. Sapo filloi dialogu i parë dallova një zë të ëmbël, shumë të njohur dhe të dashur për veshin tonë.

Ishte zëri i Kadri Roshit në dialog me Demir Hyskjen. Emocioni që shkaktoi ajo dramë në valët e Radio-Tiranës më goditi pa masë emocionalisht. U ndjeva i rrënqethur, i mbushur me urrejtje, për atë që kishin bërë dhe po bënin serbët ndaj vëllezërve dhe motrave tona në Kosovë. Isha i pafuqishëm të bëja ndonjë gjë. Loja e Kadri Roshit me aktorët e Elbasanit e tejkalonte gjendjen emocionale që shkakton një dramë, sado bukur të jetë shkruar ajo. Ajo tejkalonte jo vetëm sallën ku luhej, jo vetëm audiencën e Radio-Tiranës, por tejkalonte edhe kufijtë. Kudo që të ishin vendosur shqiptarët, ajo bënte thirrje për një betejë që nuk dihej kur do t'i vinte dita, por që në fakt dikur erdhi.

Po në atë kohë do të organizohej Olimpiada Kombëtare e Teatrove Amatore. Rrethi i Krujës duhej të merrte pjesë në atë Olimpiadë me amatorët e vet. Në fermën "Skënderbeg" të Thumanës kishte një predispozitë për zhvillmin e lëvizjes amatore. Si fermë e organizuar mirë, me fonde për kulturën dhe me një numër njerëzish të mirëshkolluar, ajo mund të ishte qendra që do të përfaqësonte Rrethin e Krujës.

Punët e kulturës në atë kohë i drejtonte një djalë shumë i mirë, i quajtur Vladimir Zhapa. Ai ishte në kërkim të një vepre për ta vënë në skenë. I frymëzuar nga "Toka e ndezur" e Fahri Balliut, ia rekomandova atë dramë. Nëse arti ka mision t'i frymëzojë dhe t'i edukojë masat, nuk kishte mjet më të mirë

sesa të vihej në skenë ajo dramë në atë qytet, në atë moment. Arsyeja ishte se Mamurrasi kishte një numër të mirë banorësh me origjinë nga Kosova, shumica të shpërngulur në vitet e Mbretërisë, por edhe më vonë gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Në fakt ajo vepër pasqyronte dramën e secilit prej atyre banorëve nga Kosova. Në rast se do të angazhoheshin, ata do të luanin në teatër vetveten.

Drama "Tokë e ndezur" e Fahri Balliut luajtur nga trupa amatore e kosovarëve të Mamurrasit

Ladi, siç e quanim ne, menjëherë shkoi në Elbasan, mori tekstin e dramës, organizoi grupin, mblodhi amatorët, shumica prej të cilëve nuk kishin dalë ndonjëherë në skenë. Gjetën një sallë dhe filluan punën. Unë nuk punoja në atë ndërmarrje, por ideja se po luanim një dramë për Kosovën më intrigonte, më joshte, më tërhiqte që të bëja çmos të isha aty. Nuk e mbaj mend se në çfarë rrethanash u propozua që trupa të vihej nën kujdesin e një regjisori, i cili do ta "mbështillte" mirë trupën, por di që propozova që ajo trupë dhe ajo dramë të viheshin në dorën e Artistit të Popullit Kadri Roshi.

Ardhja e Kadri Roshit në qytezën e punëtorëvë të bujqësisë së fermës "Skënderbeg", u prit si një lajm i madh, i jashtëzakonshëm dhe triumfues. Njerëzit ishin kureshtarë ta shikonin. Ata shfaqnin një adhurim që e tejkalonte shprehjen e respektit për liderët politikë, kushdo qofshin ata!

Ai ishte mbi këdo tjetër. Ishte aq lart në përfytyrimin e njerëzve sa ç'ishte edhe i thjeshtë, i dashur, i urtë, me këmbë në tokë. Siç u kuptua më vonë, ishin këto cilësi që e bënin atë një njeri tokësor që, me artin e vet, dinte të bënte gjëra hyjnore. Ai ishte një njeri që prekte telat e dhimbjes së njerëzve, emocionet, që i bënte ata të rrënqetheshin, të përloteshin, të prisnin çdo fjalë që dilte nga goja e aktorëve që ai përgatiti, sikur sillnin një lajm të madh, një njoftim për një ngjarje të re, tronditëse. Ai njeri frymëzonte aq shumë, saqë e bënte edhe fermerin më të panjohur me ligjet e teatrit, një aktor që shkëlqente në skenë.

Një trupë e tërë, një qytet i tërë, ranë në dashuri me artistin që deri atëherë e kishin parë vetëm nëpër filma. Ndërsa tani e kishin në mesin e tyre. Çdokush mund të përshëndetej me të, të shkëmbente cigare (të cilën e pinte jashtë mase), të kthente edhe një gotë. Shumëkush mund të bënte me të një bisedë, jo si me

atë njeriun e madh e të largët, që nuk dihet se ku rri, në Olimp apo në Everest, por si me njeriun e zakonshëm që natyra e kishte pajisur me dhunti prej artisti të madh dhe virtyte të thjeshta njerëzore. Sa më shumë rrinin, kuvendonin me të, aq më shumë ai bëhëj i tyre, i njerëzve të thjeshtë dhe, këta të fundit, bëheshin njerëzit e tij.

Ardhja e tij për të bërë prova pritej si një festë. Në fillim e tërë trupa e priste përjashtë. Ai i takonte të gjithë dhe të gjithëve iu fliste me emrat e roleve: … Ramë Ulnika, Togeri i Mbretit, Isa, Begia…

Njerëzit në klubin e qytetit prisnin me padurim që ta shihnin dhe ta takonin kur të mbaronin provat, sado vonë të mbaronin ato. Të tillë atmosferë krijoi ai në atë qytet.

Drama po ngrihej dhe trupa çdo ditë e më shumë pasurohej me dijenitë për teatrin. Ata po kuptonin gjithnjë e më mirë se misioni i tyre nuk ishte thjeshtë të luanin një dramë, por të edukonin një popull dhe t'i rrëfenin tragjedinë tonë kombëtare të ndodhur në gjysmën tonë, atë matanë kufirit.

Prandaj një ditë profesori, më tha:

- E kam përfunduar punën në tavolinë. Aktorët duan të "çohen në këmbë". Por skena e vatrës së kulturës në Mamurras, ku bëjmë prova ne, është aq e vogël sa asnjë mizanskenë nuk ndërtohet dot.

E kuptova menjëherë se ku e kishte fjalën. I thashë se do të ishte një privilegj dhe nder i madh për mua nëse shfrytëzonin skenën dhe sallën e Pallatit të Kulturës, ku punoja unë. Ai u lumturua dhe ndërhyri tek autoritetet që t'i vinin në dispozicion një autobus, i cili i merrte dhe i kthente amatorët nga Mamurrasi në Borizanë. Ishte një largësi prej dhjetë kilometrash në vajtje dhe po aq në kthim.

Ata vinin dhe bënin prova. Një ditë, në atë qendër erdhi një autobus plot me turistë, nga ata që vizitonin Shqipërinë në atë kohë. Borizana ishte caktuar si një qendër e vizitueshme. Udhërrëfyesi shqiptar i grupit të huaj me të cilin njihesha, më takoi me përzemërsi. Unë i tregova se aty po punonte Kadri Roshi. Ai u mrekullua pasi emri i profesorit ishte intrigues për çdo shqiptar, prandaj më tha:

- Po sikur t'i fusim turistët në sallë dhe të shohin pak nga ajo që bën profesori?

Rashë dakord. Në fakt salla ishte shumë e mirë, me mbi 400 vende, e pastër dhe e mirëmbajtur.

Turistët ishin të pajisur të gjithë me aparate fotografike, Polaroid, pra aparate me blic që filmonin dhe printonin menjëherë. Aktorët ishin të veshur me rekuizitën e tyre. Edhe në prova, profesori për t'i përshtatur me rrobat e rënda kombëtare të Kosovës, me tirqët, jeleket me gajtanat, qeleshet e bardha të leshta, rrobat e rënda e çorapët e leshta për gratë dhe vajzat, i bënte sikur ishin në shfaqje.

Turistët hynë në sallë. U ulën. U hap perdja dhe filloi ajo skenë, të cilën profesori e mendonte se ishte më e përgatitur. Kjo zgjati rreth dhjetë minuta për të ardhur në një kulminacion të një pasthirrme: Kuku! Kuku!

Të huajt, natyrisht që nuk morën vesh se çfarë u tha, por me siguri të mësuar me teatrin në vendin e tyre, shpërthyen në blica të polaroidëve dhe në duartrokitje. Ishte një moment që nuk mund të harrohet.

Pas tre muaj provash intensive, erdhi edhe koha për të konkurruar në Olimipadën Kombëtare të Teatrove Amatore, e cila do të mbahej në Lezhë. Aq isha miqësuar me profesor Kadriun, sa një ditë po mos ta takoja, më dukej si një vit. Një ditë më thirri më vete dhe më tha:

- Dua që analizën dhe vlerësimin e kësaj shfaqjeje ta bësh ti. E ke ndjekur që në fillesë dhe dua që kur të mblidhet komisioni i vlerësimit, ti të flasësh për vlerat e shfaqjes!

  Ndoshta ishte përjetimi më i rëndësishëm i jetës sime në historinë e shkrimtarisë sime të deriatëhershme.

U ula me kujdes dhe e shkrova.

Shkuam në Lezhë.

Salla ishte e mbushur plotpërplot. Biletat ishin shitur vetëm me autorizime. Qyteti ishte në një gjendje që dukej sikur diçka e madhe po ndodhte. Fama e shfaqjes kishte vajtur atje, përpara nesh.

U hap sipari. Sallës i kishte rënë heshtja e vdekjes. Dritat e skenës bënin lojën e tyre ndërsa aktorët Mujo Sula dhe Hysen Metalia, dy burra Kosove me çallmat e shallin e gjatë rugovian, futen në dialog. Drama zhvillohet dhe në role futen Kujtim Dina, Hasnije Ulaj e Flutura Berisha. Dëgjohej vetëm fjala e kristaltë e aktorëve, e shkruar aq bukur nga autori i dramës dhe e vënë në skenë me intonacionet deklamuese të një mjeshtri të madh, në gojën e atyre aktorëve amatorë. Ushtarë serbë të mbretit bëjnë punët e tyre të fëlliqura dhe njëri nga aktorët, detyrohet të marrë dy plaçka, gruan dhe fëmijët dhe të niset për t'u

larguar nga vendlindja. Njerëzit në atë sallë kanë ndalur frymën. Sytë e veshët janë hapur dhe ata presin batutën e radhës kur aktori i thotë Ramë Ulnikës:

"E ku po don më shkue, o Ramë Ulnika! Po qysh po don me e lanë këtë tokë? Këtë tokë të të parëve tanë që me ba me e shtrydhë (dhe ban me dorë) kullon veç gjak!"

Salla shpërthen në lotë, madje pashë njerëz që qanë me dënesë.

Ajo shfaqje i kalonte edhe emocionet më të fuqishme që shkakton teatri shekspirian.

Kadri Roshi e kishte elektrizuar trupën, e nëpërmjet saj sallën, publikun. Edhe vetë qytetin e Lezhës.

Në të dalë nga shfaqja, mbaj mend se si na u lëshuan njerëzit me përqafime, puthje, përgëzime të mbushura me dashuri dhe lotë. Por nuk harroj kurrë një burrë, malësor, me mustaqe të mëdha që i tha Kadri Roshit:

- A ti je Kadri Roshi, a?

- Po, - i tha Kadriu, i tëri në lot!

- Paj, bre burrë, boll keq na e ke ba sonte!

- Po pse bre burrë? - iu kthye profesori.

- Paj, m'bane me kjajtë, bre burrë, e ne malsorëve nuk na kanë hije lotët e na vjen marre me na i pa kush sytë e paterun. Po ti ia arrite, e mirë na e bane! Veç nji gja kishe dashtë me ta thanë:

- Fol he burrë! - Ia ktheu profesori me një gegnishte të bukur.

Kur ta jepni herë tjetër këtë shfaqje, vendosni ma parë një armaturë me kallashnikova e me karabina para teatrit! E na kur të dalim, secili ta këtë armën e vet gati me e vu në krah, e mandej na organizoni në toga, kompani e bataliana e na nisni për atje ku duhet! Me luftue! Se lotët tanë kurrkujt nuk i bajnë gja e shkjau merr vesh veç me plumb!

Të tillë forcë kishte ajo shfaqje.

Të nesërmen në Lezhë u bënë edhe vlerësimet. Pata fatin që, plot me emocion, të bëja oponencën e shfaqjes, të cilën ia dhurova të shkruar në letër autorit të shfaqjes z. Fahri Balliu.

Vetëkuptohet që ajo shfaqje mori vendin e parë. Aktorët dhe aktoret që luajtën në të, edhe sot i thërrasin njëri - tjetrit me emrat e roleve, edhe pse kanë kaluar afro 40 vjet që atëherë.

Me profesorin e dashur Kadri Roshi, nuk u shkëputëm lidhjet edhe pas asaj

ngjarjeje të madhe artistike.

Unë vija në Tiranë dhe pa e bezdisur, sadoqë ai kurrë nuk bezdisej, e takoja dhe rrinim e bisedonim për tema nga më të ndryshmet. Ai ishte një aktor i shkollës së Stanislavskit. Biseda me të ishte e një natyre shumë intelektuale. Dhe përherë biseda rridhte drejt asaj që ai e kishte në mendje dhe në zemër: Kosovës dhe këtë e ruajti deri në frymën e fundit. Fakti që Drita, zonja e tij shumë dashur dhe e nderuar, ishte nga Gjakova, mendoj që ndikonte edhe më shumë.

Më ndodhte që ai më ftonte në shtëpi dhe shumëherë kam ngrënë bukë nga duart e asaj Drite, që ishte vërtetë si Dritë. E njëjta gjë ndodhte kur vinte tek shtëpia ime në Mamurras. Babai im i ndjerë, i cili quhej Bajram, e priste me dashuri të pafund dhe e nderonte si një mik të rrallë e të veçantë. Ndërkohë Kadriu i thoshte babait tim:

Ty ta kanë vënë emrin Bajram për me e nderue Bajram Currin.

Tani ishim në Stamboll dhe duhej të kujdeseshim për Dritën. Po si kishin përfunduar ata në Stamboll?

Si u bë Kadri Roshi mik i tre presidentëve Berisha – Rugova - Demirel

Një ditë, kur zonja e tij Drita kishte qenë në një gjendje shumë kritike me një krizë në zemër, profesor Kadriu kishte vendosur të shkonte te Presidenti i Republikës, dr. Sali Berisha. Sapo u paraqit te rojet e Presidencës, atë e kishin lënë të hynte në takim. Kur hyri në zyrë ai gjeti aty edhe Presidentin e Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën. Kishin shkëmbyer disa biseda dhe Presidenti Rugova i kishte dhuruar një stilograf shumë të bukur. Pasi i kishte shpjeguar arsyen e vizitës, Presidenti Berisha kishte telefonuar nga zyra e tij direkt zyrën e presidentit turk, Süleyman Demirel, dhe i kishte kërkuar ta ndihmonte zonjën Roshi.

Ndërsa profesori bisedonte me Presidentin Rugova, erdhi përgjigjja nga Ankaraja: Drita do të operohej në Spitalin Koşoyolu Kalp Hastanesi, Stamboll. Kujdesi për Drita Roshin atje ishte i shumëfishtë, sepse ajo ishte mike e presidentëve. Edhe ne e patëm për nder të kujdeseshim për të, siç bënim për dhjetra shqiptarë të tjerë nëpër atë qytet të madh. Pas operacionit zonja Drita jetoi edhe disa vite të tjera.

TË PUNOJE NË STAMBOLL, NË QYTETIN ME BUKURITË MË TË RRALLA NË BOTË

Kënaqësia e të qenit në Stamboll ndërthurej me krenarinë time, që kisha nderin e privilegjin të punoja në atë qytet. Ishte një lloj ndiesie e bukur të bëheshe pjesë e një qyteti me histori të pafund, i cili lidhej sa me Shqipërinë aq edhe me gjithë njerëzimin.

Ai ishte pa dyshim qyteti me larminë më të madhe historike, kulturore dhe fetare në botë. Ishte qyteti ku shtresohen kulturat paleohistorike, hititët, paganët, greko-romakët, kristianët, ata katolikë dhe ortodoksë, bizantinët, islamizmi, bektashizmi, hebraizmi edhe, kuptohet, epoka moderne.

Ishte qyteti, ku brinjas rrinë në një largësi prej dyqind metrash dy nga veprat më të bukura të kultit fetar:

Hagia, ose Shën Sofia

Hagia Sofia është një katedrale kristiane ortodokse e ndërtuar në vitin 537, projekt i arkitektit Isidor i Miletit, dhe e realizuar në kohën e Perandorit Justinian i Parë dhe të shoqes, Teodora; konsiderohet si ndërtesa që ndryshoi historinë e arkitekturës. Ajo ka qenë qendra e Patriarkut Ekumenikal të Konstandinopojës deri në vitin 1453, kur u pushtua prej Sulltan Mehmetit II, të mbiquajtur "Fatih", ose "Pushtuesi", përveç një periudhe të shkurtër nga viti 1204 deri në vitin 1261 gjatë Kryqëzatës së Katërt, që e ktheu atë në një kishë latine.

Nga viti 1453 deri në vitin 1931 ajo u shndërrua në xhami dhe, pas këtij viti, reformatori i madh turk, Qemal Ataturk, themelues i Turqisë moderne, e ktheu në muze dhe nuk përdoret më për rite fetare nga asnjëra palë. Sado herë të vizitohet ai vend, prapë njeriu nuk ka të ngopur, duke e vështruar me

kurreshtje sikur e sheh për herë të parë.

Xhamia Blu

Xhamia e Sulltan Ahmetit, e njohur si Xhamia Blu, u ndërtua në vitin 1616 gjatë sundimit të sulltanit me të njëjtin emër. Ajo e ka marrë emrin Blu për shkak të pllakave dekorative të brendshme, që kanë këtë ngjyrë. Xhamia ka gjashtë minare dhe qëndron përkundruall Shën Sofisë. Të dyja përbëjnë objektet më të vizituara në kompleksin turistik të Stambollit.

Këto të dyja i ndante një linjë hekurudhore nga ajo që njihet si Yerebatan, në turqisht, ose Basilika e quajtur nga të krishterët, e ndërtuar në vitin 532 të erës sonë.

Basilika nëntokësore e Stambollit – Yerebatan

Yerebatan ishte gjëja më mbresëlënëse që kisha parë në jetën time. Njeriu mund t'i kalojë afër, dhe as që vëren se ka një derë, nga e cila mund të zbresësh nëpër disa shkallë dhe befas të shfaqet një pamje me 336 kolona guri, që mbajnë një tavan të lartë, në një vend gjysmë të errët, ku nëpër ujë pasqyrohen siluetat e tyre. Përmbi atë pellg me ujë shtrihej një platformë prej druri, e cila krijonte një rrugë nga mund të kalohej nëpërmes atyre kolonave deri në fund të atij vendi gjysmë të errët.

Brenda atij mjedisi mistik emetohej një muzikë që të kujtonte krrakama shpendësh me klithma të zgjatura e që dukej sikur vinin nga largësia dhe thellësia e shekujve, kohë kur ishte ndërtuar kjo mrekulli. Në fund gjendeshin dy kolona me dy Meduza në bazë. Ishin dy variantet e Meduzës me gjarprin në kokë, njëra me kokë lart vertikalisht, ndërsa tjetra me kokën anash, horizontalisht. Në fakt ato ishin transportuar nga Ephesus-i dhe ishin dy prej tri Meduzave, legjenda e së cilës është po aq manhnitëse sa edhe varrimi i këtyre të dyjave në atë vend.

Bukuritë e atij qyteti janë të pafundme dhe, ndoshta, askush nuk ka ditur t'i përshkruajë ato deri në fund për arsye se ato duket që nuk kanë të sosur. Një ndër autorët më të mirë, që e kanë përshkruar këtë qytet, mund të ketë qenë John Freely. Ai ka shkruar dhjetëra libra, ndër të cilët shkëlqen ai "Stambolli - Një qytet perandorak", ku përshkruhen, Beylerbey Saray, Çirağan Saray, Gallata

Kulesi, Urat e Bosforit etj. Veç të tjerash, profesor Freely ka shkruar edhe për shqiptarët e Turqisë, madje me shumë respekt.

Tebrik ederim - të paraqes nderimet e mia!

Kënaqësia që punoja dhe jetoja aty, për një farë kohe, ishte e lidhur veç të tjerash, edhe me historinë e vendit tim, për të cilën aq sa ndieja keqardhje po aq edhe krenari. Vitet e bashkëjetesës me turqit nën Perandorinë Osmane kishin lënë një vragë të rëndë në ndërgjegjen e çdo shqiptari. Kjo është e vërtetë. Vetë ideja se sa shumë ishim shtypur prej tyre, na bënte përherë të ktheheshim tek historia. Por kur i prezantoheshe, qoftë një turku të thjeshtë apo një gjenerali të ushtrisë, se ishe shqiptar dhe ai të përgjigjej: "Arnaut, me të vërtetë? Tebrik Ederim! Onurlarım! Të paraqes nderimet e mia". Kjo më bënte të ndihesha vërtet i lumtur dhe i nderuar.

FIATI DOĞAN ME TARGË DIPLOMATIKE "34" I KONSULLATËS SHQIPTARE NË STAMBOLL

Numri i targës turke, që fillon me "34", gjithmonë të kujton emrin e një qyteti të madh, të bukur plot me histori: Stambollit. Në vitet që punoja në atë Vilajet, siç më pëlqen ta quaj, përveç të tjerash, ndiehesha shumë komod që lëvizja me simbolin e atij qyteti, sidomos kur isha jashtë Turqisë. Me atë makinë më takonte të udhëtoja shpesh, madje edhe nëpër shtete si Bullgaria, Maqedonia dhe Greqia. Në një ndër ato udhëtime, kur po kaloja kufirin Maqedoni – Greqi, në një pikë kalimi të quajtur Gjevgjeli, respektova radhën. Iu afrova kabinës. Nxora dokumentet dhe prita çfarë do të më thoshte oficeri grek:

Ai më pa me kurreshtje, rrotulloi dokumentet, pa pasaportën time diplomatike, u përtyp, bëri sikur po merrej me diçka të rëndësishme dhe më pyeti në greqisht:

"Çfarë është kjo targa?"…

Për fat të mirë dija disa fjalë greqisht që m'i kishte mësuar dikur Teta Mimia, zonja e xha Kristos në Himarë, kur shkonim me fëmijët për pushime verore.

- Kjo është targë turke, - i thashë.

- Po e kujt është kjo targa, e cilit vend në Turqi?

Këtë nuk e mora vesh mirë andaj i kërkova të fliste anglisht. Anglishtja e tij ishte pak më e mirë se greqishtja ime, por gjithsesi, e kuptova që donte të dinte se e kujt ishte targa, që kishte makina ime Doğan, Fiat, prodhim turk me licencë italiane.

- Është targa e Stambollit, - i thashë.

- Çfarë? - m'u hakërrye ai. - Çfarë, e kujt?

- E Stambollit, - i thashë.

- Po pse, a ka ndonjë vend në këtë botë me këtë emër?- më pyeti ai, dhe e pashë se kishte filluar të ndihej shumë keq, çka i reflektohej edhe në fytyrë.

- Po, - i thashë, - ka dhe madje është një qytet shumë i madh dhe i bukur.

- A je i sigurt që ka një qytet me emër të tillë?

- Po sigurisht që jam i sigurtë. Si nuk qenkam?

- Po ti, ku do shkosh? - Më pyeti përsëri.

- Në Stamboll, do të shkoj. Pse?

- Nuk mund të shkosh në një vend që nuk ekziston! - ma preu shkurt polici grek. - Unë nuk të lejoj të shkosh në një vend, që nuk ekziston!

Më erdhi të qeshja, po të qeshja me të madhe. Por jo, natyrisht që nuk mund ta bëja këtë. Tek e fundit ai një polic ishte. Ai ishte në të drejtën e tij për të zbatuar urdhrat e eprorëve, ndërsa unë duhej të tregoja kortezinë dhe respektin për detyrën që kisha dhe uniformën e shtetit, që ai përfaqësonte. Por mendova se, sa i mjerë është njeriu i klonuar në këtë formë! Ndenja pak i heshtur dhe prita çfarë do të më thoshte.

- Hë pra, do ikësh?

- Po, - i thashë. - Po pres dokumentet.

- Dokumentet?! Më trego ku do të shkosh, që të t'i jap ato!

- Istanbul! Iu thashë, në Turqi. Do të kaloj nëpër Selanik, Kavallë, Aleksandropullis, Ipsallë, Çanakala, Tekirdag dhe në destinacion - Istanbul.

- Jo, ky i fundit nuk ekziston!

Debati me policin zgjati disa minuta. Ai ngulmonte se vendi ku i thosha unë se do të shkoja, nuk ekzistonte në këtë botë. Ndërsa unë këmbëngulja në timen. Më në fund i thashë:

- Po mirë. Më thuaj ti se ku do të shkoj unë!

- Jo. Ju duhet ta gjeni dhe ta mësoni që herë tjetër të mos gaboni! - m'u hakërrye përsëri.

- Unë e kam gjetur dhe nuk e harroj, - i thashë. Ju nëse dini ndonjë vend tjetër, ma thoni.

- Kostandinopul, - më bërtiti. - Kostandinoooopul. Mësoje këtë, nëse nuk do që herën tjetër të mos të lëmë të kalosh këtë kufi.

I mora letrat dhe kalova kufirin dhe doganën. Eca me kujdes deri në Selanik. Ishte një pasdite e nxehtë dhe qyteti ishte thuajse i zbrazur. Diku në njërën anë të një rruge të gjerë, që duhej të ishte pranë stacionit të trenit të Selanikut,

pashë dy djem ulur në një stol. M'u dukën aq të lodhur dhe të zvetënuar, sa mendova të ndaloja dhe t'u flisja. E kisha pikasur me të drejtë se ishin emigrantë shqiptarë.

Ndalova makinën përpara tyre. I përshëndeta në shqip. Ma kthyen me "Jasu, Jasu!". Zbrita nga makina e iu fola me respekt. Jam i sigurtë që ata e kuptuan dhimbjen time. Prandaj edhe nuk refuzuan të futeshin në bisedë. Iu tregova kush isha. Më përshëndetën dhe u përfshimë në një bisedë të shkurtër. Më treguan se nga ishin dhe çfarë bënin. Njëri prej tyre, që ishte pak më i shkathët, më tha:

- Ju përfaqësoni shtetin, apo jo?

- Po, - i thashë.

- Po, a jeni shqiptar?

- Po, - i thashë.

- Po a keni ndonjë keqardhje për ne?

- Po, natyrisht, - i thashë.

- Po përgjegjësi a keni ju për ne, për atë që bëjnë me ne këta këtu, në këtë vend?

- Po çfarë iu bëjnë? - e pyeta rrëmbimthi, sikur nuk e kisha as idenë e asaj, që po më thoshin ata djem. Sigurisht kjo ishte një pyetje retorike pasi unë e dija fare mirë se çfarë bëhej.

- Çfarë nuk bëhet, thuaj, - ma ktheu.

- E sheh atë kodrën atje lart?

- Po, - i thashë.

- Atje gjendet një ndërtesë, ku janë zyrat e Asfalisë. E di ti çfarë është ajo?

- Pak a shumë po, por ma shpjego më mirë.

- Ai është vendi ku ne duhet "të falemi".

- Të faleni?!

- Po, - më tha. Ne kurrë nuk do të marrim dot ndonjë leje qëndrimi apo pune pa vajtur atje. Dhe atje, e di çfarë të bëjnë dhe çfarë të thonë?!

- Çfarë? - e pyeta.

- Të kërkojnë tri gjëra:

- E para; të ndërrosh emrin dhe identitetin. E dyta; të shkosh në kishë dhe të ndërrosh fenë. Dhe e treta; të spiunosh kundër shokëve dhe vendit tënd.

- Pak të duken ty këto?!

– Jo, – i thashë, – nuk më duken pak, madje më duken tmerrësisht të tepërta, të rënda.

– Epo, kjo është jeta jonë.

– Ti vazhdo rrugën, makinën e paske të thjeshtë, por të mirë. Edhe targën e paske 34.

U ndava me ata djem, që rrinin kot në atë stol rruge. Dhe ndjeva sesa shumë kishte udhëtuar si në një pelegrinazh ajo targë 34 ku njerëzit, ndjenjat, besimet, vuajtjet... rrotulloheshin nëpër rrotat e makinës me targën 34 mbi vende të njohura e të panjohura, aty ku nuk do të doje kurrë të ishe... Shtypnin, shtypeshin, bënin përpara nëpër një "dyluftim" mbijetese, ku gjithmonë ajo sublimja duhet të triumfojë.

ENVER TALI - MARATONOMAK I LIRISË

Një ditë në Konsullatën tonë erdhi një zotëri flokëbardhë, me syze me numër të madh, diç më i shkurtër se mesatar dhe pak i kërrusur, i shëndetshëm, por1 pa tepri. Ishte një burrë bash si ata që njeriu ka dëshirë t'i shohë dhe pastaj të thotë: Ky ishte vërtet burrë Kosove! E pritëm bashkë me Kryekonsullin, z. Orhan Zarshati, dhe folëm gjatë. Ai kishte zënë një shtëpi në Fatih, një lagje shumë e njohur në Stamboll, e banuar nga shtresat e mesme dhe jo larg nga zona muzeale e qytetit. Pasi na tregoi se sa shumë kishte vuajtur nëpër burgjet serbe dhe ishte i etiketuar si irredentist, kishte vendosur të jetonte në Stamboll. Kishte njohje që në rini me Adem Demaçin, tregonte historira të tij dhe krenohej se i bashkonte i njëjti ideal.

Gjithçka që më lidhi me Enver Talin prej asaj dite zë vend në pjesën e kujtimeve të bukura të jetës sime. Ai ishte një patriot që të frymëzonte. Kishte besim të patundur në të ardhmen e Kosovës. Besonte se do të vinte një ditë që Kosova do të ishte shtet më vete. Besonte te kauza e Rugovës, ndonëse vinte nga pjesa e atyre që njihnin rrugën e luftës si të vetmen mundësi për t'i arritur qëllimet e tyre. Madje shkonte edhe më tej, besonte se shqiptarët do të bashkoheshin një ditë, në një shtet të vetëm.

Përfaqësues i Qeverisë së Republikës së Kosovës në mërgim

Një njohje e hershme me kryeministrin e atëhershëm të Kosovës në mërgim, dr. Bujar Bukoshi, i kishte dhënë mundësinë atij të merrte një autorizim për të hapur një zyrë përfaqësimi të Republikës së Kosovës, në Stamboll. Ai dokument, në atë kohë, nga ana zyrtare dukej si diçka e shkruar në rërë. Por, siç do të shohim më vonë, ai dokument do të luante një rol tejet të rëndësishëm

historik, në fatet e dy shteteve shqiptare.

Nuk vonoi shumë dhe z. Tali filloi të prezantohej si përfaqësues i "*Cumhyrriyetit*" (Republikës) së Kosovës në Stamboll. Në konsullatën tonë ai ishte i pranishëm në çdo veprimtari, cilado të ishte ajo, edhe në pritjet diplomatike. Në takimet me shqiptarët e Stambollit, të cilët ishin më të shumtë në numër nga Kosova sesa nga Shqipëria, ai filloi të njihej tashmë si përfaqësues i tyre. Mbante fjalime patriotike, fliste një turqishte të qartë, të kuptueshme por shumë krahinore dhe dialektore si ajo e Gjilanit prej nga vinte. Vishej bukur. Fliste me maturi por ishte emocional dhe nuk "lëshonte kurrë pe" në aspiratën e vet për Pavarësinë e Kosovës.

Kaluan disa vite dhe aty nga nëntori i vitit 1995, baca Enver i mbështetur nga Qeveria e Kosovës në mërgim, edhe nga një patriot i madh nga Kosova, një biznesmen i shquar, z. Hayri Içli Kelmendi, vendosi të përuronte zyrën e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Stamboll. Kjo konsullatë do të kishte selinë në Fatih. Numri i telefonit do të ishte ai privati i shtëpisë së z. Tali. Veprimtaria e saj mbetej të bëhej legale dhe njohja nga qeveria turke dhe akreditimi ishte një pikëpyetje mjaft e madhe për të. Ishin shqiptarët e Stambollit ata që e gjetën udhën të parët drejt legalizimit dhe pranimit të saj, duke e mbështetur me besim në funksionalitetin e saj deri në institucionalizim.

Nevruz Çarkaxhi, Kamil Bitis, Halil Metin, dr. Veton Hoxha, Celalettin Őlmezcan, Jahja Jeshilova, Shefki Osmani, Elita Alo, Kadri Ates, Vilma Lorenc Antoni dhe Nahid Bejtullahu, Sabedin Turker, Yusuf Yusufi dhe Naxhia, Shefki Osmani, Raif e Veli Terziu e shumë të tjerë do të bëheshin njerëzit, të cilët do t'i jepnin jetë asaj zyre nga jashtë saj. Shoqata "Vëllazëria Turko - Shqiptare" u bë nismëtarja dhe promotorja e një akti të tillë. Kështu ata e kthyen në simbol pikërisht bacën Enver si përfaqësues të Kosovës. Lidhjet e Enver beut me qarqe të caktuara turke e jetësuan një nismë të tillë. Në këto përpjekje ndihmonte një djalosh turk me emrin Burhan.

Dhjetor 1995 - hapja e përfaqësisë së Republikës së Kosovës

Në atë fund dhjetori të vitit 1995, në Hotelin Haliç, bash në mes të Stambollit, në një mbrëmje u mblodhën shumë shqiptarë të Turqisë dhe përuruan atë që quhej Përfaqësia e Republikës së Kosovës në Turqi (*Kosova Cumhyrjeti Istanbul*

Temsilcisi).

Hapja e saj nuk ishte veprim i fshehur. Natyrisht që nuk kishte përfaqësi vendesh të njohura të pranishme. Por *nën zë*, me punën dhe vullnetin e tij, Enver Tali kishte arritur të merrte një miratim të heshtur nga organet e duhura turke, të cilat kishin bërë "një sy qorr e një vesh shurdh", por që e kishin bekuar një veprim të tillë. Ky akt e lartësoi z. Tali deri te një përfaqësues i vërtetë i asaj Kosove, e cila druhej se do të përjetonte atë që po ndodhte në Bosnjë prej disa vitesh.

Në lidhje me këtë akt qeveria serbe e kohës reagoi diplomatikisht dhe e kundërshtoi me forcë lejimin e hapjes së një zyre të tillë. Më kujtohet, në atë kohë në Beograd ishte ambasador i Turqisë, Aliev Kelliç, i cili mbase i painstruktuar si duhet nga qeveria e tij, nuk mbajti qëndrim të mirë. Por qeveria e asaj zonje të rëndë, Tansu Çiller dhe ndikimi i një burri të madh të shtetit turk, Presidenti Süleyman Demirel, i mbështetur edhe nga Hysamedin Cindoruk, Kryetar i Asamblesë së Madhe Kombëtare Turke, nuk u tund nga ajo "leje e heshtur" e dhënë Kosovës në dorën e Enver Talit.

Përfaqësia e Kosovës në Stamboll tani ishte realitet, një zyrë tek e cila gjenin zgjidhje të problemeve të tyre shumë e shumë shqiptarë të Kosovës. Aty kam takuar emra të mëdhenj të Kosovës, madje edhe prej atyre, që sot janë në sferat e larta politike dhe që kanë fuqi të madhe vendim-marrëse. Aty kam takuar artistë, poetë, gazetarë të famshëm, udhëtarë, por edhe shumë e shumë prej atyre që e përdornin Stambollin si portë për të udhëtuar drejt vendeve tjera në kushtet e atëhershme të represionit serb.

Në atë mbrëmje të themelimit të zyrës së përfaqësimit të Republikës së Kosovës në Stamboll u mbajtën disa fjalime. Ishte edhe një person që përfaqësonte qeverinë turke, por askush nuk e mori vesh se në çfarë cilësie ishte ai. Mbase këtë e dinte vetëm Enver Tali. Edhe pse u protestua nga qeveria serbe, zyra u hap dhe, për disa vite me radhë, në Fatih të Stambollit vazhdoi të qëndronte në ballinën e një pallati një tabelë e shkruar: *"Kosova Cumhyriyeti Istanbul Temsilcisi"* në turqisht, në shqip dhe në anglisht.

Tani Kosova kishte një përfaqësi të njohur nga shteti shqiptar, e vendosur në Tiranë, në Rrugën "Skënderbej" pranë ambasadave, që drejtohej prej z. Iljaz Rrahmajlit; në Zvicër operonte Qendra e Informacionit të Kosovës (QIK) dhe tani Zyra e Përfaqësuesit të Republikës së Kosovës në Stamboll.

Druaj se pak njerëz e dinë se çfarë roli ka luajtur ajo zyrë në Fatih të Stambollit. Dhjetëra e dhjetëra shqiptarë të Kosovës vinin aty. Shumë prej tyre gjenin ndihmë për gjëra të zakonshme të jetës në rrethanat e jashtëzakonëshme, që i kishin në vendin e tyre. Vinin të ikur, të dëshpëruar. Vinin për shërim, shkollim, për probleme që njerëzve iu dalin në udhëtim, e plot të tjera.

Adresa e parë e tyre ishte: *Enver Tali. Fatih! Stamboll.*

Studentë nga Kosova si Armend Spahia e Armend Agolli, të dy në mjekësi, si dhe Elita Alo me të shoqin, Agronin, nga Prizreni i ishin bërë bacës Enver si fëmijët e tij.

Për disa vite në Stamboll, vendet e takimit me bacën Enver ishin zyra ime në Nişantaşı, zyra e tij në Fatih, selia e Shoqatës "Vëllazëria Shqiptaro - Turke" dhe, në raste të caktuara, në restorantin "Kosova Et Lokanta". Kjo e fundit, afër aeroportit Ataturk, ishte vendi ku gazetari Nihat Islami, në udhëtimet e tij në Lindjen e Mesme e bënte një pushim. Ai me tregimet e tij dhe shakatë me personelin shqiptar të atij restoranti të mrekullueshëm me emrin "Kosova" i bënte drekat e darkat shumë të këndshme. Ndërsa në Prishtinë, pas çlirimit, arritëm të takoheshim te Hotel "Grand", që ai e përmendte me aq përmallim kur ishim në Stamboll.

Enver beu - koleg, atdhetar dhe mik familjar

Marrëdhënia jonë me Enver Talin, kishte shumë përmasa. E para, ne respektonim pa fund thinjat e tij, vuajtjet dhe përkushtimin, sakrificat, besimin e tij tek një Kosovë e lirë. Së dyti, besonim aq shumë në karakterin e tij prej burri të vendosur. Ai ishte një mik i mirë, që të gjendej në çdo rast. Veçanërisht ne e çmonim për bujarinë e tij. Ai ishte gati të ndihmonte këdo që i drejtohej, madje edhe njerëzit e panjohur. Ai ishte një lloj kavaljeri, i cili ishte gati që, për t'u bërë qejfin miqve, të linte pas dore veten.

Donika, ime shoqe, ishte lidhur me të si me babain e saj. E nderonte pa fund dhe ndiente dhimbje për jetën e tij të ndarë nga familja në atë moshë. Një drekë e mirë apo darkë me miq te ne nuk do të kalonte pa një ftesë për Enver beun. Të njëjtën gjë bënte edhe ai.

Në një rast na thirri në telefon dhe na tha se kishte disa miq nga Kosova dhe dëshironte të ishim edhe ne. Ishte vonë, por megjithatë shkuam. U futëm në

dhomën ku ishin miqtë. Ai kishte shtruar darkë me meze dhe me pije alkoolike. Njerëzit ishin në qejf. Donika, si përherë, filloi të merrej me punët e darkës dhe të ndihmonte në gjërat, që duheshin për tryezën. Në punë e sipër doli në dhomën tjetër dhe gjeti mbi tavolinë ilaçet e tij të zemrës. Profesioni i saj i farmacistes i thirri menjëherë dhe u kthye në dhomë me ilaçet në dorë dhe iu drejtua me të madhe:

- Baca Enver, a janë ilaçet tua këto?

- Po, - iu përgjigj ai.

- Po a i ke pirë sonte?

- Jo! - iu përgjigj ai.

- Baca Enver! - iu kthye ajo, krejt kundër natyrës së saj, - miqtë të duan dhe ne të duam shumë, por ti më së pari duhet të duash vetveten. E di se po nuk i more këto ilaçe mund të na bësh të gjithëve të pendohemi, që jemi këtu në këtë darkë? Prandaj, të lutem, më së pari: Merr ilaçet!

Donika, si Nora e Bacës Enver

Ai vetë Donikës i thoshte shpesh: - Të kam Norë! Nora ishte vajza e tij e vetme. Herë pas here në Stamboll vinte zonja Nysrinë, e shoqja e bacë Enverit. Ajo ishte zonjë e fisme, e urtë dhe jashtë mase e duruar. Ndienim se sa shumë kishte vuajtur nga mungesa e tij e gjatë në shtëpi. Vite të tëra burgimi. Por ajo ndiente se puna që bënte bacë Enveri në Stamboll ishte vepër fisnike. Si shumë të tjerë, ndoshta edhe ajo mendonte se ishte "thirrje në shkretëtirë". I vetëm, larg, me aq pak burime, pa mbështetje shtetërore, le që ku kishte shtet, vetëm me një letër autorizuese do të mposhtte Enver Tali makinën vrasëse të Slobodan Milosheviçit!?

Edhe sot që idealet e tij janë materializuar, kur njeriu i kthehet pas asaj kohe, të duket sikur ai ishte utopisti më i madh, edhe më utopist se vetë Robert Owen që e ka shpikur atë teori. Zonja Nysrinë vinte nga Kosova, meqenëse asaj i lejohej udhëtimi jashtë. Ajo vinte në shtëpi, riorganizonte çdo gjë. Ikte për të ardhur përsëri. Mblidheshim për darka e dreka, herë te shtëpia e tyre e herë te e jona. Pastaj mbaj mend që erdhi Kujtimi, i biri, i cili ishte me punë në Londër.

Më pas erdhi Gevara, djali tjetër. Këta të dy i kishin lejuar qasje të plotë në një kartë - krediti bacës Enver. Çfarë djelmoshash! Ishin të dy në emigracion.

Ata çdo muaj bënin bilancin e kartës, që i kishin dhënë të atit, dhe e rimbushnin atë. Me këtë siguri nga ana financiare ai sillej si zotëri në çdo mjedis. Bujaria që e karakterizonte dhe siguria, që i kishin dhënë djemtë nga ana financiare, e bënin shumë më trim. Në biseda me të përherë i thosha: "Baca Enver, ti i ke të gjitha të mirat e kësaj bote. Po ku ta gjetën këtë emër, mor burrë! Këtu e prish fare!"

Dhe qeshnim me të madhe. Në fakt ai vuajtjet i kishte hequr nëpër burgje për shkak të besimit që kishte pasur tek ai që me të cilin ishte emnak. Por më shumë hesht'te sesa fliste për këtë çështje. Atëherë, ne bënim shaka dhe i thoshnim: "Ok, ti për ne je Enver beu".

Fejesa e Norës, vajza e Bacës Enver

Erdhi koha kur një gëzim i madh pushtoi familjen e Enver beut. Vajza e tij, Nora, do të fejohej. E ndienim se gëzimi i tij ishte i dyzuar. Vajza e vetme do të fejohej. Por ai nuk ishte atje në Kosovë dhe zemra i bëhej copë nga kjo. Atëherë ai vendosi ta bënte ndryshe. I thirri vajzën, dhëndrrin dhe miqësinë, që të vinin në Stamboll. Na njoftoi edhe ne. Nuk bëhej fjalë, që ai të bënte fejesën e Norës pa ne. Ata erdhën. Autobusi kishte arritur shumë herët nga Kosova në Top Kapi. Dhe po ashtu herët edhe ata arritën në shtëpi. Na telefonoi dhe në atë mëngjes të asaj dite, shkuam me nxitim për të takuar miqtë, Norën dhe për të pirë kafenë e fejesës së saj.

Hymë brenda. U përshëndetëm. Dukej se Nora kishte bërë zgjedhjen e duhur. Edhe ai djali kishte bërë një gjë të tillë. Dhëndrri ishte piktor, i diplomuar në Akademinë e Arteve të Prishtinës. Ai ishte i shoqëruar edhe me xhaxhain e vet, me piktorin e njohur, Myslim Mulliqi. Familje e njohur piktorësh në Kosovë. Filluam një bisedë shumë interesante. Natyrisht ata tregonin për gjendjen në Kosovë dhe ne rrënqetheshim nga ndodhitë e atjeshme. Në një çast Donika u ngrit të shërbente dhe na solli kafetë. Unë, pa i ditur rregullat e "lojës" së Kosovës në një rast të tillë, e mora kafenë dhe urova:

- Epo, të na trashëgohet çifti! Jetë të lumtur dhe u bëfshi mëhallë!

Baca Enver, hopa kërceu dhe më tha:

- Ndal, bre burrë, çka po thue?

- Po e bana për hajër fejesën, bacë, - i thashë unë.

– Shuj allahile, se këta hala nuk e kanë lypë çikën e ti ua bane për hajër, – m'u kthye ai.

Unë u skuqa, u ndjeva si i zënë në faj, pasi kisha ndërhyrë krejt pa vend dhe kisha bërë një gjest që shkonte krejt kundër zakonit.

– Po, më falni, çfarë e mire iu ka sjellë këtu sot ju, kaq herët, të gjithë së bashku!? – Iu ktheva unë.

Myslymi, që ishte një intelektual qytetar i Prishtinës, më tha:

– Ty të lumtë goja, mor burrë, se na e bane këtë histori më të kollajshme. Ky nipi im, Agroni, dhe vajza e bacës Enver e duan njëri – tjetrin dhe kemi ardhë me marrë dorën e bacës Enver.

Pasoi një qeshje, u bënë urimet, u thjeshtua ceremonia, u lehtësua situata dhe ajo fejesë kaloi me shumë gaz e hare.Vite më vonë e kam takuar Norën dhe të shoqin në Prishtinë. Ishin bërë me fëmijë dhe jetonin të lumtur. Qeshëm për atë ndodhi të asaj kohe. Gjithmonë qeshim kur e kujtojmë.

Në shërbim të Kosovës dhe të Shqipërisë

Një ndër ngjarjet më mbresëlënëse të marrëdhënieve të mia me Enver Talin është edhe ajo e vitit 1997, të cilën do ta rrëfej në një episod tjetër të këtij libri. Është fjala për dymbëdhjetë pikat e Shtabit të Ushtrisë Turke, që e shpëtuan Shqipërinë nga kërcënimet e fqinjit tonë jugor. Ajo natë e marsit të vitit 1997 mbetet në kujtesën time si një moment shumë i rëndësishëm.

Takim në Kosovën e lirë, nëntor 1999

Në vitin 1997 u larguam nga Stambolli. Jeta e solli që të shiheshim përsëri në Kosovë, tashmë të lirë. Ndieja detyrim të madh të takoja njeriun, i cili i kishte kushtuar jetën asaj kauze. Festuam me Enver Talin festën e 28 nëntorit të vitit 1999 në Prishtinë. Ai ishte njeriu, i cili në mënyrën më modeste kishte bërë aq shumë gjëra të mëdha për Kosovën. Ajo zyrë – shtëpi, e thjeshtë, në Stamboll, ishte bërë vatra e atdhetarëve shqiptarë të Kosovës. Ajo ishte vatra, e cila i forcoi marrëdhëniet e Kosovës me njërën nga fuqitë më të mëdha të rajonit të Ballkanit dhe pse jo, të botës, Turqisë…

Të shkruaj për Enver Talin duhet shumë kohë, por nuk mundem pa thënë

që nëse ka një atdhetar idealist në Kosovë, ai është Enver Tali. Natyrisht ai nuk u mori ndonjëherë "poza" triumfante për veprimet e tij, nuk u mburr kurrë. Përkundrazi ai vazhdoi të punonte me zell e dashuri për Kosovën deri në fund të jetës së tij. Në një takim vetëm për vetëm që kam pasur me Presidentin e Kosovës në vitin 2018, i propozova që ta dekoronte atë atdhetar për gjithë atë kontribut, por...ai ishte shumë i zënë dhe kjo nuk ndodhi kurrë.

SA FÉ USHTROJNË SHQIPTARËT?

Takimi i Feve Monoteiste në Stamboll

Në vjeshtën e vitit 1993 në Stamboll u organizua një takim i krerëve të feve monoteiste. Aty do të merrnin pjesë drejtuesit e feve abrahamike, që nga Kreu i Rabinatit të Izraelit, pastaj Bartolomeu I, Kreu i Kishës Ortodokse të Stambollit, Kryemyftiu i Turqisë, ndërsa nga Selia e Shenjtë kishte ardhur Sekretari i Përgjithshëm i Vatikanit. Nga Shqipëria merrnin pjesë personalitetet kryesore të këtyre feve: I pari ishte Hafiz Sabri Koçi, Kryemyftiu i Shqipërisë. Pastaj vinte Imzot Rrok Mirdita, kreu i fesë Katolike shqiptare dhe Anastasios Janullatos, kreu i Kishës Ortodokse shqiptare. Bashkë me ta kishte ardhur edhe kreu i Kryegjyshatës Botërore të Bektashinjve, Dede Reshat Bardhi.

Takimin e përshkoi një frymë e zymtë e natyrës fetare me shumë qetësi dhe përunjësi. Krerët e feve të vendeve të ndryshme takoheshin me njëri-tjetrin, sidomos brenda feve të veta, por edhe në ndërveprim. Fetë e shqiptarëve ishin si të plagosura pas një periudhe të gjatë që kishin kaluar në ateizëm, në shtetin e parë dhe të vetëm në botë, që ishte shpallur i tillë. Hafiz Sabri Koçi, 72-vjeçar, vinte nga jeta e tij e gjatë prej 23 vitesh në burgim për shkak të besimit fetar. Ai ishte teolog, martir i fesë, burrë shumë i ditur, i shtruar, i kulturuar, shumë i urtë dhe i përunjur.

Dede Reshat Bardhi po ashtu kishte kaluar një kalvar vuajtjesh për shkak të besimit dhe e kishte ushtruar fenë tërësisht në mënyrë të fshehtë, por pa e lënë asnjëherë, pavarësisht nga rrjedhojat që pësonte.

Imzot Rrok Mirdita ishte drejtuesi i Dioqezës së Durrësit dhe Tiranës, i konsakruar nga Papa Gjon Pavli II. Ai e kishte filluar shërbimin ndaj Kishës Katolike në moshën 25-vjeçare. Shumë vite ai i kishte kaluar duke shërbyer në Kishën Katolike në Bronx në New York. Ai është nismëtari i ndërtimit të

Katedrales së Shën Palit në Tiranë. Sipas idesë së tij, ajo ka tri këndе, të cilat simbolizojnë bashkëjetesën midis tri feve në Shqipëri, fesë islame, ortodokse dhe katolike.

Kryepeshkopi Anastasios Janullatos, i lindur në vitin 1929, ishte Krypeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë dhe Kreu i Sinodit të Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare. Ai mbante edhe shumë tituj si anëtar i disa akademive. Emri i tij përmendej me shumë skepticizëm si uzurpator i fronit të kreut të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, që dikur e pati themeluar Fan Noli dhe e mbajti gjallë Visarion Xhuvani.

Në atë takim u diskutuan shumë çështje që kishin të bënin me paqen fetare dhe mbarëvajtjen midis feve të ndryshme.

Në këtë rast u hap një diskutim, i cili e vlen të jetë i shënuar në këtë rrëfim. Krerët e feve shqiptare, edhe pse ato janë vetëm tri të tilla, na dilte se "ishin" katër. Kjo bëri që dikush në atë takim të ngrinte problemin e përfaqësimit. Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Shqiptare tha se në Shqipëri ekzistojnë katër fé të ndryshme. Pas shumë diskutimesh u nënshkrua një rezolutë e përbashkët e feve monotesite. Sipas disa drejtuesve aty, shqiptarët duhej të nënshkruanin të katërt. Por në të vërtetë ne kishim tri fé, jo katër, pavarësisht se Dede Reshat Bardhi përfaqësonte një sekt liberal të islamit - pra bektashizmin. Dikujt i interesonte të shtohej një fé te shqiptarët. Kjo ishte një strategji që u binte për shtat atyre që përherë shqiptarët i kanë dashur të përçarë. Ky ishte rast i mirë për t'i konsideruar ata të ndarë në katër fé.

Imzot Rrok Mirdita kërkoi pushim për një konsultim. Ai na mblodhi, Hafiz Sabriun, Dede Reshatin dhe neve të dy të Konsullatës, Orhan beun dhe mua. Ishte e vështirë situata, pasi kishim shumë merak se mos Dede Reshatit do t'i mbetej hatri, po të mos futej bektashizmi si fé më vete. Imzot Rrok Mirdita e shpjegoi shumë bukur dhe me një frymë të vërtetë kombëtare dhe patriotike.

Pastaj Orhan beu u ndal te historia e Kryegjyshatës dhe përse ajo, në vitin 1924, u zhvendos nga Stambolli në Shqipëri. Tek e fundit- tha ai- ndarja fetare midis shqiptarëve u shkon në favor armiqve të Shqipërisë. Dede Reshati menjëherë kërceu dhe tha:

"Ju jeni njerëz të mençëm të atdheut tim. Ju e dini këtë punë më mirë se unë. Unë kurrë nuk pranoj të bëhem pjesë e një veprimi, që e dëmton sadopak vendin tim. Unë jam bektashi, jam besimtar i fesë islame, por para së gjithash

jam shqiptar".

Kështu u shmang përmendja në Rezolutën e Stambollit të Shqipërisë si vend me katër fé. Aty u shënua se Shqipëria ka tri fé monoteiste. "Dikush" ishte nismëtar i asaj teze antishqiptare në konferencë. Pas kësaj ai u largua kokëulur.

SHOFERI ARTUR NË KONSULLATËN TONË

Arturi ishte djalë shkodran, simpatik, i mirë, shpirt njeriu, me një histori të dhimbshme. Ai ishte rritur nga shteti në shtëpinë e fëmijës në Shkodër dhe nuk i njihte prindërit. Kur ishte bërë i zoti i vetes ai kishte dalë në jetë dhe, pa vonuar shumë, ishte martuar. Martesa, deri kur hyri në ambasadën franceze, i kishte shkuar, mirë aq sa mund të shkonte në atë kohë.

Në ambasadën franceze në Tiranë, verë 1990

Në verën e vitit 1990, kur u hapën ambasadat, ai bashkë me të shoqen dhe djalin e tyre dyvjeçar ishin futur në ambasadën franceze. Aty ata prisnin me ankth se çfarë do të ndodhte. A do të lejoheshin të iknin në Francë, apo do të hynte policia dhe t'i merrte përpara e t'i nxirrte me forcë? Kjo ishte një enigmë që shoqërohej nga një ankth i tmerrshëm. Por nuk ishte vetëm kjo. Kushtet nëpër ambasada u përkeqësuan tmerrësisht. Mungonte ushqimi e për fjejte, as që bëhëj fjalë. Sipas një urdhri, që nuk merrej vesh se nga dilte, herë hapeshin dyert e herë mbylleshin. Më e keqja erdhi kur u dha urdhër që të ndërpritej furnizimi me ujë. Ndoshta si në romanin "Kështjella" të Kadaresë, kjo ishte arma më e fortë e regjimit për t'i bërë ata njerëz të dorëzoheshin, duke i dhënë fund aty asaj ëndrre të lirisë, dëshirës së flaktë për të kaluar kufirin dhe për të shkuar me çdo mjet në botën e lirë.

Në kushtet e etjes së padurueshme të djalit të tij, kur ai qante me të madhe për një pikë ujë, Arturi vendosi të dalë nga gardhi i ambasadës franceze dhe të shkojë të marrë ujë. Dhe kështu bëri. Kapërceu rrethimin, doli në rrugën "Skënderbeg" dhe vrapoi drejt rrugës së Kavajës ku do të gjente një shishe me

ujë, për të birin. Në dalje ai e çan rrethimin policor dhe arrin të shkojë e të shuajë etjen për vete, të gjejë një shishe ujë dhe të niset përsëri drejt ambasadës. Për fatin e tij të keq, në kthim, ishin shtuar barrierat e policisë. U ndesh me të parën, e kaloi, por të dytën nuk mundi ta kalojë. Ishte dhënë urdhër i prerë: Asnjë njeri tjetër të mos futet më në ambasada. Arturi mundohej t'i bindte policët se ai kishte qenë brenda, se kishte djalin dhe gruan aty. "Ja ku e kam shishen e ujit! Ata po vdesin", thërriste ai si i çmendur! Po kush mërzitej për "tradhtarët" si Arturi në ato ditë?!

U rrek Arturi i shkretë e u rrek deri në vetmohim. Ishte e pamundur. Mbeti jashtë! Agoi dita tjetër. Vendi ishte aq i rrethuar me police, forca sigurie, grupe speciale sa Arturi kurrë nuk mundi t'i kalonte më ato pengesa. Kaloi edhe një pasdite dhe ra nata. Ai sillej rreth e rreth në zonën jashtë perimetrit të lejuar, por pa mundur t'i afrohej ambasadës. Nuk zgjati shumë dhe u mor vesh se ishte dhënë një urdhër lejimi për ata që kishin hyrë në ambasada që do të transportoheshin pas mesnatës drejt Durrësit, mundësisht vonë, që të mos viheshin re nga sytë e "botës".

Arturi në Tiranë, i biri në Francë

Kështu djali dhe e shoqja e Arturit kaluan me traget për në Itali dhe që andej në Francë, ndërsa ai mbeti i vetëm, pa asnjë njeri në botë. Ishte rritur i vetëm, pa njeri të familjes dhe as të afërm. Kishte krijuar familje dhe ishte bërë me fëmijë. Dhe ja ku u gjend përsëri i vetëm e i dërrmuar. Kishte humbur njeriun më të shtrenjtë, fëmijën e tij dhe natyrisht të dashurën grua, me të cilin kishin filluar atë jetë të re, me aq shumë mundime e privacione, por edhe aq të bukur me frutin e jetës: djalin.

Kaluan muajt e atij viti. As që bëhej fjalë për ndonjë mundësi vajtjeje në Francë te djali dhe gruaja. Gjithçka dukej mjaft e zymtë, e errët dhe e pashpresë. Ngjarjet në Shqipëri rrokulliseshin me shpejtësi të madhe. U formua alternativa e parë demokratike, u bënë zgjedhje, u fituan prapë nga ata që e kishin pushtetin, komunistët, pastaj u bënë përsëri dhe pushteti ndryshoi. Shqipëria u bë demokratike. Të gjitha këto Arturi i shihte vetëm nga një kënd, nga një prizëm - si objekt i madh gjigand, që të shpërbëhet në mijëra forma dhe

ngjyra prej lotit të syrit, ashtu i dukej jeta. Jetonte i vetmuar, i lodhur, me shumë mundime dhe me shumë shpresa se një ditë do të ribashkoheshin me të shoqen dhe djalin, që po rritej larg tij, pa ditur asgjë për të.

Nëpërmjet një shoqate, që u formua në vitin 1992, ai arriti të lidhej me të shoqen dhe me djalin. Edhe pse pa asnjë kacidhe në xhep, ai herë pas here gjente mundësinë për t'i telefonuar të shoqes atje në Francën e largët. Bisedat ishin aq mallëngjyese me djalin saqë ai bëhej keq. Por, ndërkaq, vinte re se bisedat me të shoqen nuk ishin më aq të zjarrta si më parë kur spikaste dashuria dhe malli apo dëshira e madhe që ai të shkonte atje. Këto me kohë filluan të veniteshin dalëngadalë dhe vinte re një farë mungese dëshire të së shoqes për të biseduar me të.

Njeriu i mirë Tanush Çabej

Në atë kohë, vizat ende jepeshin me disa nota që lëshonte Ministria e Punëve të Jashtme, sado që shumë pak merreshin parasysh nga konsujt nëpër ambasada. Arturi rrinte tërë ditën tek dera e Ministrisë dhe i "zinte pritë" shefit të zyrës së personelit, zotit Tanush Çabej. I lutej çdo ditë atij që ta ndihmonte me një notë për vizë franceze. Ky i fundit ishte një nga burrat më të mrekullueshëm që njeriut i takon të njohë në jetë. Gjirokastrit i edukuar, me trup të madh, të plotë dhe të drejtë, skrupuloz, serioz në punë, i dhimbsur e i vuajtur. Ishte sinonimi i çdo gjëje të mirë, që njeriu kërkon te një burrë shqiptar. Tanushi ishte prekur aq shumë nga tregimi i Arturit, e kishte ndihmuar me notë, por pa sukses. Një ditë, kur gjendesha në Tiranë, i kthyer nga Stambolli për ca detyra që do të merrja në Tiranë, z. Çabej më thirri në zyrën e tij dhe midis tjerash më tha:

"Dua të kërkoj një nder. Puna më ka bërë të njoh shumë njerëz. Ndër ta është edhe një djalë i Shtëpisë së Fëmijës së Shkodrës".

Ai më tregoi historinë e Arturit në vija të trasha. "Ai ka kaq kohë, që më lutet për një vizë franceze. Unë ia dhashë notën, por më tej nuk e ndihmoja dot. Franca nuk ia dha vizën, por edhe nëse do t'ia jepnin, ai tani shkon kot atje. Mbase ia vlen se ka djalin, por e shoqja... e ka lënë. Pasi nuk arriti të shkonte për kaq kohë, një ditë ajo i tha: "Tani më mirë mos eja, pasi kam bërë zgjedhje tjetër dhe kot sa vjen". Kjo e ka tërbuar fare. Është i përhumbur i tëri. Asgjë

nuk funksionon në jetën e tij. Kam menduar ta sjell shofer në Stamboll. Do të bisedoj edhe me ministrin. Do t'ia kërkoj si favor për veten time. A nuk është prekëse historia e tij? Prandaj, ty të kërkoj ta kesh amanet. Ta ndihmosh dhe të kujdesesh për të, të lutem! Ndoshta, kjo i shërben atij për t'i zgjidhur gjërat në të ardhmen".

Sigurisht që u pajtova dhe ndjeva jo vetëm dhimbje, por edhe një farë lehtësimi, sepse do të bëja diçka të mirë. Kështu Tanush Çabej, punësoi Arturin, si veprim njerëzor ndaj një njeriu të mirë, pa asnjë interes në këtë botë - thjesht si një akt mirësie.

U ktheva në Stamboll. Pas disa kohësh erdhi Arturi. Me vete solli edhe Lidën, një vajzë po nga shtëpia e Fëmijës në Shkodër. Kësaj radhe Arturi kishte gjetur një vajzë, me të cilin ndanin shumë gjëra të përbashkëta. Kur i kishte propozuar ai i kishte thënë: "Unë jam caktuar shofer në ambasadë. Do të vish me mua e të martohemi?". Dhe natyrisht kjo ishte si një bingo për Lidën! Të dy vinin nga i njëjti vend dhe nga e njëjta shtëpi e fëmijëve. Të dy kishin pësuar nga një dramë të madhe që në lindje, dhe bashkë të dy bashkë filluan një jetë të re.

Stambolli ishte fillesa e jetës së tyre të re. Sado të duket e habitshme, ata në fakt u bënë njerëzit e mirë, që i bënin nder konsullatës me korrektësinë, ndershmërinë dhe përkushtimin në punë. Ndërsa Tanush Çabej bëri një të mirë, që do t'i mbahet mend gjatë. Ishte një rast kur emërimi bëhej jo me njohje dhe as tarafe, por thjesht bazuar në aftësi, humanizëm, mëshirë njerëzore dhe ndershmëri.

HILTON HOTEL - STAMBOLL - ME PRESIDENTIN SHQIPTAR DR. SALI BERISHA DHE ATË IZRAELIT, EZER WEISMAN

Në dimrin e vitit 1995, Presidenti Sali Berisha bëri një vizitë në Turqi për një takim shumëpalësh. Pas takimeve, delegacioni ynë u kthye në Hotelin Hilton. Aty nga ora 19 po e prisja të zbriste nga dhoma në lobin e hotelit, kur pranë meje kaloi një diplomate izraelite e quajtur Ester. Njiheshim mirë me njëri - tjetrin dhe komunikonim shpesh. Ajo m'u afrua dhe më përshëndeti. U ngrita dhe shtrënguam duart. I tregova se presidenti i vendit tim ishte atë natë në atë hotel. Ajo reagoi menjëherë me gëzim dhe më tha:

- Uau! Po edhe presidenti i vendit tim këtu është. Pse nuk i takojmë ata sonte?"

Unë u habita dhe i thashë:

- Po, si t'i takojmë?"

- E di unë, - më tha diplomatja izraelite. - Shëno këtë numër telefoni të brendshëm të hotelit dhe, nëse presidenti juaj bie dakord, unë do të rregulloj çdo gjë, në mënyrë që të dy presidentët të darkojnë së bashku.

I propozova presidentit tim dhe ai pranoi ftesën me kënaqësi. Filloi të më fliste me shumë simpati për Presidentin Ezer Weisman, që ishte presidenti i shtatë i Shtetit të Izraelit, i zgjedhur në vitin 1993 dhe se kishte qenë ministër i mbrojtes i vendit të tij dhe më parë edhe komandant i forcave të armatosura. Që nga telefoni i lobit të hotelit thirra në numrin që më kishte dhënë Esteri, por dilte i zënë. Telefonova shumë herë e nuk po merrja përgjigje. U vura në një pozitë të vështirë. Presidenti Berisha e pa që diçka nuk shkonte, por nuk e bëri veten. Madje më tha:

- Lëre fare, dihet kjo, izraelitët kanë rregulla të forta sigurie.

Kur ishim gati të largoheshim ia behu Esteri. Ajo e takoi me përzemërsi presidentin dhe, pa e zgjatur, kërkoi ndjesë për pështjellimin që ishte krijuar.

- Na falni, - tha ajo. - Një mijë herë na falni, por numrin e telefonit që iu dhashë e bllokoi shefi i sigurimit të Presidentit. Erdha vetë që t'ju marr dhe Presidenti Weisman po ju pret në sallën e restorantit. Le të shkojmë!

Ajo hyri mes nesh dhe, me një lehtësi që tejkalonte çdo etiketë diplomatike, na kapi që të dyve për dore dhe eci me hap të shpejtë nëpër një korridor të gjatë deri kur na çoi te dera e restorantit. Aty i priu presidentit tonë drejt atij izraelit. Weisman-i u ngrit dhe gjithë entuziazëm hapi krahët dhe e përqafoi dr. Berishën. Ishte një takim prej miqsh. Ndërsa presidentët darkuan bashkë në tavolinën kryesore, diplomatja izraelite dhe unë darkuam bashkë në një tavolinë pranë tyre me diplomatët e tjerë izraelitë. Darka mbaroi. Në ndarje e falënderova Esterin, ndërsa presidentët u përqafuan dhe dëgjova Weisman-in tek i tha dr. Berishës:

- Kurrë nuk e harrojmë atë që kanë bërë shqiptarët për ne! Të pres në Izrael!

Ishte një takim spontan, por shumë i vlefshëm për vendin tonë.

TAKIMI ME JOSEPH DIOGUARDIN DHE YASEMIN DOBRA MANÇON

Ardhja e Joseph DioGuardit, President i LQSHA-së, në Stamboll

Në mesin e viteve '90, kur dukej se demokracia në Shqipëri po ecte mirë, gjendja në Kosovë po përkeqësohej çdo ditë e më shumë. Lufta në Bosnjë po bënte kërdinë, ndërsa bota ende rrinte duarkryq. Ajo që u lejua të ndodhte në Bosnjë, sidomos me masakrën e Srebrenicës, e bëri njerëzimin të rrënqethej, por edhe të turpërohej.

Një ndër njerëzit që punonte më shumë për ta parandaluar një tragjedi të ngjashme si ajo edhe në Kosovë, ishte Joseph DioGuardi. Ishte kjo arsyeja përse ne, si Konsullatë e Republikës së Shqipërisë në Stamboll, u angazhuam me çdo mjet për ta pritur atë në Turqi. Ai do të fliste me autoritetin që kishte, si ish-kongresmen amerikan, rreth situatës në Kosovë dhe çfarë mund të bëhej për parandalimin e një tragjedie si ajo e Bosnjës.

Udhëtimin e parë e bëri në marsin e vitit 1994, ku mori pjesë në një Konferencë Ballkanike në Stamboll, e cila u sponsorizua nga Fondacioni i Solidaritetit Ballkanik.

Në atë konferencë, pa asnjë lloj ngurrimi apo kompleksi, DioGuardi dënoi ashpër veprimet e Sllobodan Milosheviçit si dhe qëndrimet e Lordit Owen dhe Carrington, Departamentin e Shtetit Amerikan, Tuxhmanin, Gligorovin, si dhe qeverinë greke. Mund të thuhet se ai ishte zëri më i fuqishëm i asaj konference. Duke marrë shkas nga ajo që po ndodhte në Bosnjë, ai u ndal te keqtrajtimi i shqiptarëve dhe rreziqet që mbarte transferimi i konfliktit prej Bosnjës në Kosovë. Nuk vonoi dhe në shtatorin e vitit 1995, ai e vizitoi përsëri Stambollin, po për të njëjtën arsye.

Ai mori pjesë bashkë me Shirley Cloyes - DioGuardi, Këshilltare e Çështjeve Ballkanike, në një konferencë në Qendrën e Shtypit të Universitetit Marmara në Stamboll, ku erdhën edhe shumë diplomatë, akademikë, studiues të çështjeve ndërkombëtare, si dhe personeli i fakultetit të marrëdhënieve me jashtë i universitetit. Konsullata Shqiptare ishte e pranishme dhe ndihmoi në organizmin e aktivitetit.

Në atë kohë ne nuk shpërfillnim asnjë mundësi që na jepej për të folur dhe vepruar për Kosovën. Vizita e DioGuardit pati shumë efekt në njohjen e disa qëndrimeve ndaj Kosovës, që vinin nga miq dhe dashamirës të shqiptarëve, por edhe të çedimit të institucioneve ndërkombëtare dhe të dërguarve të posaçëm, ndaj të cilëve ai fliste hapur dhe pa rezervë.

Ajo që vura re tek ai, në vitet e bashkëpunimit të afërt me të, ishte kërkesa për arritjen maksimale të synimeve të kombit shqiptar dhe moslënia shteg e interpretimeve rreth të drejtave të shqiptarëve në Ballkan. Konsullata bashkëpunoi me Shoqatën "Vëllezëria Turko - Shqiptare", e cila financoi udhëtimin e Joseph DioGuardit dhe Këshilltares për Çështjet Ballkanike, zonjës Shirley Cloyes - DioGuardi.

Njohja me Yasemin Dobra Mançon, gazetare e "Turkish Daily News"

Gjatë ditëve të atyre konferencave u njoha me një gazetare të së përditëshmes prestigjoze turke në gjuhën angleze "Turkish Daily News", zonjën Yasemin Dobra Manço. Shkëmbyem kartvizitat, nuk vonoi shumë dhe ajo erdhi në zyrën time në Nişantaşi. Prej saj mësova se ishte diplomuar në Universitetin e Columbia-s për historinë, kulturën, gjuhën dhe artin osman.

Yasemin Dobra-Manço, me baba dhe nënë turke, e lindur në Manhattan, ishte kthyer në Turqi për të kryer kërkime për imazhin Perëndimor të Orientit dhe shkëmbimeve historike midis Lindjes dhe Perëndimit.

Gjatë bisedës ajo më tregoi se ishte e bija e Alişan Dobrës, gazetar, shkrimtar dhe biznesmen shumë i njohur, jo vetëm në Stamboll por edhe më gjerë. Ai kishte punuar si reporter politik dhe shkrimtar për Radio Ankaranë dhe Agjencinë Anadolu Axhans dhe si korrepondent politik për gazetën franceze

"Stamboll". Më vonë kishte punuar për gazetat "Vatan" dhe "Tasvir". Në SHBA e vazhdoi jetën e tij të gazetarisë në Kombet e Bashkuara, në New York. Që aty ai u mor me biznes dhe u bë i pari milioner turk në SHBA në fushën e transportit detar. Ai ishte edhe sponsor i Joseph DioGuardit për mbrojtjen e bashkësisë turko – amerikane, kundër shpifjeve greke ndaj tyre në Amerikë.

Si rezultat i përpjekjeve për të tërhequr vëmendjen për rëndësinë dhe nevojat jetësore të Shqipërisë, me Yasemin Dobra Mançon filluam bashkëpunim thuajse të përjavshëm. Shkrimet e saj në *Turkish Daily News* rreth çështjeve shqiptare në Ballkan po kapnin çdo ditë e më shumë audiencën turke e jo vetëm atë. *Turkish Daily News* ishte burimi kryesor i informimit të selive diplomatike në Ankara dhe në Stamboll.

Artikujt e saj mbushnin faqet e gazetës, Shqipëria dhe Kosova ishin të pranishme në to. Në atë kohë u botuan artikuj me rëndësi ndër të cilët veçoj:

"Demokracia Shqiptare zë rrënjë në mes të kundërshtimeve, konflikteve rajonale dhe pasigurisë"

Si dhe artikullin për Kosovën:

"Kosova, kiaveta (kopila) e Ballkanit".

Artikujt patën jehonë shumë të madhe jo vetëm në Turqi, por edhe në qarqet diplomatike. Në shkrimin e parë, ajo tregonte për vështirësitë nëpër të cilat po kalonte procesi i ndërtimit të demokracisë në Shqipëri. Ndërsa në të dytin, për Kosovën, paralajmëronte në një mënyrë gati profetike se pakujdesia e Fuqive të Mëdha ndaj një konflikti që po ngjizej në Kosovë, do të çonte pashmangshmërisht në një konflikt, që do ta destabilizonte Ballkanin. Kjo gjë ndodhi jo më vonë se tre vjet më pas.

Gjatë hulumtimeve të mia rreth shkrimeve të shtypit botëror për ne shqiptarët, kam gjetur një paralele midis këtij artikulli të Yasemin Dobra Manços në shtypin botëror për Kosovën në vitin 1995, me atë të shkruar nga Herman Bernstein në vitin 1934 në New York Times me titull të përafërt: "Shqipëria e vogël - Pengu i Fuqive të Mëdha"

Ajo nuk u mjaftua vetëm më shkrime nga Stambolli, por në mesin e

viteve ’90 bëri një vizitë në Tiranë, ku pa me sytë e saj pasojat, që kishte lënë komunizmi dhe përpjekjet titanike, qoftë dhe kaotike, që populli shqiptar bënte për të dalë nga humnera ku kishte rënë në ato pesëdhjetë vjet të komunizmit. Ajo u takua me shumë personalitete, madje i mori një intervistë edhe Presidentit të Republikës, dr. Sali Berishës. Të njëjtën gjë bëri edhe gjatë një interviste, që ajo i mori atij gjatë një vizite të tij në Stamboll disa kohë më vonë.

Yasemin Dobra Manço në atë kohë mbështetej nga pronari dhe botuesi i gazetës “Ilnur Çevik”, si dhe nga gazetarja shumë e njohur turke, Gűl Demir.

Shkrimet e saj i përcillnim në ministri dhe ndiqeshin me interes në Shqipërinë e asaj kohe. Në fund të misionit ato u përmblodhën në dy dispensa me nga 50 faqe secila dhe iu dorëzuan fondit të arkivës së Ministrisë së Jashtme nën titullin: “Shqipëria dhe çështja shqiptare në Ballkan në faqet e gazetës turke *Turkish Daily News*”.

Në dispensën e dytë shkrova si më poshtë:

> *“Ky është vëllimi i dytë ku përmblidhen artikujt e botuar në gazetën “*Turkish Daily News” *nga Yasemin Dobra Manço të cilët përbëjnë një ndihmë të pazëvendësueshme për informimin e opinionit publik turk si dhe komunitetit diplomatik të akreditуar në Turqi. Njohuritë e thella për faktet, aftësia për të shpjeguar të vërtetën për Shqipërinë dhe shqiptarët në këtë rajon dhe ngjarjet e ndodhura gjatë kësaj kohe, në një mënyrë të thjeshtë dhe të qartë, si dhe mbulimi objektiv i shteteve përreth nga autorja, na japin rastin të shprehim mirënjohjen më të thellë dhe konsideratën më të lartë për zonjën Manço. Përveç kësaj, falënderime të veçanta shkojnë për gazetën “Turkish Daily News”, veçanërisht për zonjën Gűl Demir, e cila ka ndihmuar shumë për një kontribut të tillë.”*

Yasemin Dobra Manço vazhdon edhe sot t’i kushtojë rëndësi punës për zbulimin e historisë antike të popullit ilir dhe asaj se çfarë do të thotë të jesh shqiptar - krenar i ditëve tona, bazuar në sakrificat e panumërta të bëra për një Shqipëri demokratike dhe një Kosovë të pavarur.

VEPRIMTARIA PROMOVUESE KULTURORE ARTISTIKE NË STAMBOLL

Gjatë atyre viteve, 1993 - 1997, një ndër veprimtaritë më të spikatura të konsullatës ishte ajo kulturore e artistike. Rigjallërimi i lidhjeve të vjetra midis bashkësisë shqiptaro - turke, të shkëputura për dhjetëravjeçarë të tërë me atdheun, ishte detyrë parësore e jona. Është e kuptueshme se vizitat e ndërsjella, ritakimi i njerëzve të gjakut të shkëputura për shumë vite, numri i konsiderueshëm i studentëve që vinin nga Shqipëria dhe që po edukoheshin në shkollat turke civile, fetare dhe ushtarake, e ndihmonte shumë atë proces. Edhe shkëmbimi i mallërave luante rolin e vet. Por ishte dhe është edhe një sferë tjetër po aq e rëndësishme dhe jetike e njohjes së popujve dhe njerëzve: veprimtaria kulturore dhe artistike.

Parë nga ky këndvështrim u ndërmorën dhe u organziuan një varg veprimtarishë, njëra pas tjetrës. Ato u realizuan me artistët më të njohur të vendit tonë, të skenës dhe penelit, herë në mënyrë individuale dhe herë kolektive, të cilët ftoheshin që të performonin në Stamboll. Përshtypjet e mbledhura nga disa prej atyre artistëve pjesëmarrës, ndërkohë që po shkruhej ky libër, mendoj se e japin më bukur e më qartë atmosferën e krijuar dhe ndikimin që patën ato veprimtari në jetën e konsullatës, të Bashkësisë Shqiptaro - Turke, të Shoqatës më të vjetër "Vëllezëria Turko - Shqiptare" dhe të vetë turqve, të cilët ushqenin dhe ushqejnë respekt e simpati për ne "arnavutët".

Mjeshtër e koncertit e Teatrit të Operas dhe Baletit, pianistja Lindita Kotorri

"Udhëtova për herë të parë jashtë shtetit më 27 nëntor 1993, në vigjilje të festës tonë kombëtare, falë një ftese që mora nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Stamboll.

E veçanta e atij udhëtimi ishte dashamirësia që gjetëm dhe nderi që na u bë nga diplomatët tanë të konsullatës. Kjo bëri që atë udhëtim ta përjetoja me një emocion e ndjesi të rrallë. Unë do të shoqëroja në piano mexosopranon e njohur Manjola Konjari Lula, në një program shumë mirë të përgatitur, me pjesë nga muzika e zgjedhur qytetare shqiptare dhe ajo operistike botërore. Të performoje përpara asaj audience aq të larmishme, shumë nacionale, me atë shije dhe kërkesë për artin ishte përgjegjësi e madhe. Mendoj se jo vetëm që ia dolëm në atë mbrëmje aq të bukur përfaqësuese për Shqipërinë, por i lamë vend vetes edhe për turne të tjera. Në atë konsullatë vumë re se sa shumë çmohej arti dhe sa shumë vlerësime merrte vendi ynë si rrjedhojë e angazhimit të artistëve nga ana e punonjësve të konsullatës.

Për të plotësuar më shumë këtë kuadër veprimtarishë, që nuk harrohen kurrë, erdhi edhe "Java e Artit dhe Kulturës Shqiptare" në Stamboll, e organizuar po nga Konsullata Shqiptare, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Ishte ky një aktivitet i madh, me qëllim njohjen dhe propagandimin e vlerave të kulturës sonë përpara popullit turk. Në të merrnin pjesë Orkestra e Teatrit të Operas dhe Baletit, e dirigjuar nga maestro Ermir Krantja, trupa e baletit, solistët e operas, soprano Edith Mihali, baritoni Ymer Kaca dhe mexosoprano, Manjola Konjari Lula. Unë pata nderin t'i shoqëroja nën furinë e duartokitjeve të asaj salle madhështore. Ndërkohë, salloni i madh "Atatürk Kültür Merkezi" ishte dekoruar me pikturat e grupit të piktorëve tanë, që plotësonin programin e javës artistike shqiptare.

Në atë turne, edhe pse ishin fillimet e viteve të demokracisë, kur arti dhe kultura jonë sapo i "çelte sytë" nëpër botë, arritëm që të demonstrojmë vlerat dhe kulturën tonë unike, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë."

Profesor Roland Xhoxhi, violinist dhe maestro

"Në festën e 28 nëntorit të vitit 1994, pata nderin dhe kënaqësinë që të isha i ftuar nga Konsullata jonë e Përgjithshme në Stamboll, bashkë me disa artistë nga Opera dhe Akademia jonë e Arteve. Ne do të jepnim shfaqje përpara audiencave turke mjaft të zgjedhura. Në fillim interpretuam përpara trupit diplomatik dhe konsullor të akreditуar aty dhe më pas përpara një numri të shoqatave, organizatave dhe dashamirësve të artit shqiptar.

Në ato ditë dhamë edhe një koncert përpara Shoqatës së Avokatëve të Stambollit. Në të merrnin pjesë personalitetet më të njohura të jurisprudencës së qytetit, avokatë të shquar, pedagogë universitetesh, profesorë, shumë prej të cilëve ishin me prejardhje shqiptare, të hershme dhe të vonë. Ajo ishte një ndër përvojat e mia më të bukura të jetës së deriatëhershme në karrierën time artistike dhe koncertale si vilonist, që i kam kushtuar jetën këtij instrumenti."

Sopranoja e mirënjohur Edit Mihali

"Gjatë tërë jetës i jam gëzuar festave tona të rëndësishme kombëtare të nëntorit: Çlirimi i Tiranës, shpallja e Pavarësisë, çlirimi i atdheut nga pushtimi nazi - fashist… Si artiste e skenës lirike, i kam festuar këto data çdo vit në mënyra të ndryshme, herë në Tiranë dhe herë në Vlorë, por gjithmonë me hare dhe vetëm në vendin tonë. Megjithatë, festa e 28 nëntorit të vitit 1995 do të mbetet më unikja dhe më e paharruara.

E veçanta e atij fund nëntori është se atë vit e festuam në Stamboll. Konsullata jonë organizoi gjënë më të veçantë: "Java e artit dhe kulturës shqiptare".

Ne, artistët e trupës së Teatrit të Operas dhe Baletit, me të gjithë sektorët, orkestrën, solistët dhe baletin, udhëtuam të lumtur drejt atij qyteti të madh. Me ne ishte edhe një grup piktorësh shumë të njohur: Lume Blloshmi, Pashk Përvathi, Suzana Varvarica dhe Enver Rakovica, ky i fundit nga Kosova. Qendra kulturore e atij qyteti, e cila mban emrin e themeluesit të Turqisë moderne "Atatürk", na priti me shumë dashamirësi dhe respekt.

Ne do të dëshmonim forcën e artit shqiptar, në atë qytet të rëndësishëm për historinë tonë kombëtare. Mund të them se u ndjemë artistë të mëdhenj, në një

qytet të madh, në një qendër të madhe kulturore, në një përkujdesje që nuk mund të harrohet kurrë.

Për fat të keq, ai turne, i organizuar në atë formë aq madhështore, ishte i pari dhe mbeti të jetë i fundit. Nisma të tilla, të cilat për t'u realizuar kërkojnë shumë punë, përkushtim, mund, pasion dhe dashamirësi, nuk janë ndërmarrë më. Pas kaq vitesh, kur e shoh se veprimtari të tilla as që i mendon më njeri, vlerësimi për organizatorët e "Javës kulturore shqiptare" në Stamboll, vjen dhe rritet edhe më shumë. Mbetet vetëm të shpreh respektin për njerëzit, që e bënë të mundur atë veprimtari si dhe dëshirën që përfaqësitë tona të kujtohen për artin dhe kulturën shqiptare, e cila mund të ndikojë shumë në promovimin e Shqipërisë sonë të bukur. Ndjehem e nderuar që mora pjesë në atë veprimtari jubilare të festës sonë të madhe kombëtare."

Pashk Përvathi, piktor: Një javë e paharruar në Stamboll

"Ishte 26 nëntor 1995. Herët në mëngjes, një grup prej tre piktorësh, bashkë me trupën e Teatrit të Operas dhe Baletit, morëm rrugën me dy autobusë për në Stambollin e largët. Nën kujdesin e Konsullatës sonë do të zhvillohej "Java e kulturës shqiptare". Për ne ishte emocionuese pjesëmarrja në atë veprimtari. Rrugëtimi me autobus na krijoi mundësinë e një vështrimi panoramik të dy shteteve, Greqisë fqinje dhe Turqisë. Ishte pikërisht koha e "etjes" sonë për të parë sa më shumë nga bota përtej kufirit. Pas dy ditëve udhëtim, në mbrëmje mbërritëm në vendin mikpritës.

Ne do të vendoseshim në Hotelin "Haliç në Beyoğlu", pronë e shqiptarit nga Kosova me shtetësi turke, Hayri Içli Kelmendi. Kryekonsulli ynë bashkë me pronarin e hotelit na pritën dhe na shprehën mirëseardhjen. Më pas na priste një koktej i parapërgatitur, i cili na e hoqi menjëherë lodhjen e atij udhëtimi të gjatë. Në pritje pati edhe bashkëatdhetarë dhe të migruar herët në Turqi, prania e të cilëve krijoi një mjedis shumë vëllazëror.

Të nesërmen të gjithëve na priste Qendra Kulturore "Ataturk". Ajo ishte e vendosur në ballë të sheshit kryesor të qytetit, Taksim. Në katin e parë të asaj ndërtese moderne ndodhej një sallë e madhe ekspozitash, nëpërmjet të së cilës shkohej drejt Sallës së madhe të operas dhe koncerteve. Holli kryesor ishte caktuar për ekspozitën tonë. Aty gjetëm gatishmërinë e menjëhershme të palës pritëse për të na ndihmuar në ekspozimin e pikturave tona. Grupi ynë i krijuesve figurativë përbëhej nga katër

vetë. Kam kënaqësinë që t'i prezantoj në këtë libër:"

Lumturi Blloshmi

"Në atë kohë ajo po bëhej piktore e njohur dhe po e merrte veten nga një e kaluar tmerrësisht tragjike. Ishte bijë e familjes së njohur patriote Blloshmi, por që kishte përjetuar më të keqen e mundshme gjatë regjimit komunist: Pushkatimin e babait, kur ajo ishte vetëm dy - tre muajsh. Kjo kishte sjellë për të një jetë tmerrësisht të vështirë, e cila ishte shoqëruar edhe me një sëmundje meningjiti, që i kishte dëmtuar rëndë të dëgjuarit dhe të folurit. E prapëseprapë ajo e kishte sfiduar kohën dhe ia kishte dalë të ishte një ndër piktoret femra më të mira shqiptare të brezit të vet."

Suzana Varvarica

"Artiste dhe studiuese e njohur e arteve figurative. E diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve, sot Universiteti i Arteve, Suzana njihet si kuratore e dhjetëra ekspozitave të hapura në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative në Tiranë, si dhe në disa galeri arti jashtë Shqipërisë. Ajo ligjëron mbi artin shqiptar dhe të huaj në Universitetin Evropian të Tiranës - UET, si dhe në Universitetin e Tiranës - UT.

Zonja Varvarica është e dhënë pas studimeve dhe ka botuar qindra artikuj studimorë, kritikë dhe vlerësues mbi zhvillimin e arteve pamore në trevat shqipfolëse dhe jashtë tyre. Ajo është autore e mbi 12 monografive, kushtuar krijimtarisë dhe veprave të artistëve shqiptarë të shek. XX dhe udhëhiqet nga motoja: "Arti është ai që len gjurmët e kalimit tonë mbi këtë tokë".

Enver Rakovica

"Grafist shumë i njohur nga Kosova, iu bashkua grupit tonë prej tre piktorëve, për ta bërë ekipin edhe më shqiptar. Enveri po kryente asokohe një specializim pasuniversitar për grafikë në Stamboll në Universitetin "Mimar Sinani". Ishte artist me vlera dhe prania e tij na e lehtësoi shumë punën e organizimit. Ai e njihte mendësinë dhe gjuhën e palës pritëse më mirë se ne, pasi fliste edhe turqisht."

"Pasi i bëmë qejfin Lumes, duke e lënë të zgjidhte vendin e ekspozimit të veprave të saj, secili prej nesh bëri rregullimin e veprave që kishte sjellë me vete. Për këtë rast, unë kisha 10 vepra, peizazhe nga një cikël i atëhershëm me gurë dhe

kodrina. Gjithçka u mbyll mirë që ditën e parë, për të pritur të nesërmen mbrëma, hapjen e ekspozitës dhe më pas shfaqjen e Teatrit të Operas.

Diplomatët e konsullatës sonë kishin bërë punë organizative të shkëlqyer. Por edhe ne artistët bëmë gjithçka për të justifikuar atë kujdes dhe përpjekjet aq fisnike që kishin bërë. Hapja e ekspozitës ishte një prej elementeve të javës së artit që u kurorëzua me sukses të plotë. Më pas ishin interpretimet e shkëlqyera të sopranos Edit Mihali, Ymer Kaca dhe Manjola Konjari të shoqëruar nga Orkestra e Madhe e TOB-së nën drejtimin e dirigjentit Ermir Krantja. Balerinët tanë e elektrizuan sallën me interpretimin e tyre dinjitoz. Të gjitha këto krijuan një atmosferë shqiptare në mes të Stambollit madhështor. Urimet, përgëzimet, fjalët e mira që dëgjuam nga spektatorët, të shoqëruara edhe me kronikat e televizionit turk TGRT atë mbrëmje, na bënë të ndiheshim krenarë dhe të lumtur për atë që kishim arritur.

Ditët e tjera në Stamboll i vazhduam me veprimtaritë e planifikuara më parë nga konsullata, e cila ishte kujdesur që ne të bënim edhe vizita në objektet historike të Stambollit.

Në kthim, nëpër Greqi, përjetuam një episod thuajse provokativo – humoristik, diku pranë Kosturit. Në një kthesë të rrugës, policia rrugore greke bëri shenjë që dy atobusët tanë të hapnin krahun.

Pas disa vështirësive të komunikimit të fillimit me policin në gjuhën greke, na doli në ndihmë gjuha jonë shqipe. Polici grek ishte arvanitas dhe fliste shqipen e vjetër të atyre anëve, por që mjaftoi sa të na jepte, në vend të gjobës, një buzëqeshje vëllazërore. Drejtoresha e Arteve që na shoqëronte, aktorja Marjeta Ljarja, e cila po përpiqej të komunikonte edhe në anglisht me policin grek, u çlirua sapo e dëgjoi atë të na thoshte:

"Shkoni, vetëm bëni kujdes!"

Po udhëtonim nëpër tokat tona shqiptare të mohuara.

Java e Kulturës në Stamboll ishte një veprimtari e bukur. Turqit patën mundësi të shikonin ngjyrat e peizazhit shqiptar dhe bukurinë e interpretimit të artisteve tanë të skenës muzikore."

Përshtypjet e piktorit të shquar Gazmend Leka në fillim i shkurtova në atë mënyrë që emri im në përshkrimin e tij të shmangej. Por kur ia tregova, ai i doli në "mbrojtje" shkrimit të vet me argumentin e të drejtës së autorit dhe anti - censurës. E prapë ndihem i skuqur kur lexuesi i këtij libri ta lexojë këtë

fragment. Kisha dy alternativa: Ose ta hiqja shkrimin e tij, dhe kjo do të ishte fyese për këtë artist të shquar të vendit tonë, ose ta respektoja të drejtën e tij të autorit dhe të mos aplikoja "censurë", të cilën ai ndoshta si askush tjetër e kundërshton. Përshtypjet e piktorit:

Gazmend Leka: "Një rrëfim pa fjalë të tepërta"

"Luaja me telekomandën e televizorit. I ndërroja stacionet njëri pas tjetrit e nuk ndalesha. Ishte si një argëtim, pas një dite të gjatë pune në atelje. Ime shoqe po bënte punët e bekuara të shtëpisë, siç thotë Kazanzaqi. Po shtrohej tryeza të hanim darkë. Aromat e gatimeve kishin mbushur kuzhinën, si të ishin aromat ndjellëse të temjanit. Xhamat e dritareve ishin veshur me avull dhe të krijonin intimitet, që vetëm shtëpia jote mund ta japë. Ime më, pranë meje në divan, kotej duke marrë një sy gjumë. Herë-herë hapte sytë, e tek shihte që unë vazhdoja të bridhja stacioneve, i mbyllte përsëri. Maçoku gërhiste. Më pëlqen shumë shtëpia. Ka një tërheqje të magjishme tek unë, tek shoh gjithë ritualet, që bëhen thjesht e pa bujë.

*Papritur, syri më kapi një imazh të njohur. E ndalova vrapin e dalldisur të stacioneve dhe u ktheva mbrapsht. Ishte një figurë e dashur, që nuk më ishte fshirë nga memoria, edhe pse kishin kaluar rreth 20 vjet. Ishte Mal Berisha. E njoha menjëherë. Intervistuesja po e pyeste dhe ai po përgjigjej urtë, qetë e ëmbël, siç di Mali të flasë. Po intervistohej drejtp*ërdrejt *nga Londra.*

Nëna, kur pa që ndalova së "bredhuri" më pyeti:

- E ke shok?

- E kam mik edhe pse me të, jam takuar vetëm një herë, vite të shkuara.

Ajo vazhdoi ta ndiqte intervistën me kërshëri, ndërkohë që unë nuk po e dëgjoja se çfarë po fliste Mali, pasi u zhyta thellë në kujtimet e mia. Ndalova në atë ditë, kur udhëtoja nga Tirana në Stamboll. Kishim udhëtuar orë e orë të tëra, për të marrë pjesë në një aktivitet me artistë nga shumë vende të botës. Them udhëtuam, pasi isha së bashku me mikun tim, piktorin Ali Oseku. Do të qëndronim një muaj dhe do të pikturonim Stambollin me ftesë të Ministrisë së Kulturës të Turqisë. Rruga ishte shumë e lodhshme. Udhëtonim, ndalonim gjatë në kufij, flinim në sediljet e autobuzit dhe dalëngadalë harruam të hidhnim sytë nga dritaret për të parë vendet që po përshkonim. Kur çelnim sytë, pyesnim me padurim, nëse kishim mbërritur.

Ishim disi të zymtë e të tensionuar, sepse pas, po linim familjet në një Shqipëri, që ende po i merreshin këmbët nga liria. Sa më shumë largoheshim nga vendi ynë, aq më shumë më dukej sikur filli i argjendtë, që mbante bashkuar shpirtin me trupin, po hollohej së tepërmi e po këputej.

Kështu u gjendëm më në fund në Stamboll. Autobusi hyri për t'u parkuar në sheshin e autobusëve, në një hapësirë të ngushtë, ku mbretëronte kaosi. Turma njerëzish që hipnin e zbrisnin nga makinat e mikrobusët, dispeçera me duar përpjetë, që bërtisnin e u jepnin drejtim makinave, shoferë që manovronin në atë ngushti me qetësi e duke bërë shakara me njëri-tjetrin, fërshëllima, herë-herë klithma miqësore, takime me të afërmit, valixhe, çanta e boçe me rroba. Mua m'u duk sikur ishim hedhur në një cep e po humbnim. Më kapi një ankth si rrallë herë. M'u duk sikur i gjithë Stambolli ish i tillë. Pa zbritur mirë, i thashë Aliut, që të gjenim një mjet e të ktheheshim menjëherë në Tiranë. Doja të shpëtoja nga ai kaos. Kisha lënë shtëpinë e dashur dhe isha zhytur në këtë angushti?! Isha jashtë vetes. Aliu më pa me habi dhe i qetë, pa ma vënë fare veshin, më tha se do ta kalonim shumë mirë, por unë nuk e dëgjoja e doja të kthehesha. Harrova se përse kisha shkuar në Stamboll!

Atë moment na u shfaq përpara Mali. Erdhi drejt nesh i qeshur, na përqafoi e na uroi mirëseardhjen. Që atë çast çdo gjë u platit. Zhurmat pushuan, shoferët mbyllnin dyert e autobuzëve, askush nuk fërshëllente e njerëzit takoheshin qetësisht, pa britma. Mali bisedoi pak me Aliun, të cilin e njihte kohë më parë dhe na drejtoi për te makina. Rruga, nga sheshi i autobusëve e deri në shtëpinë e tij, m'u duk si një balsam, si një antidot për çmendurinë time, që m'u largua sikurse ta heqin me dorë një dhimbje. Na shëtiti përreth mureve të rënda të Kostandinopojës së dikurshme dhe e zgjati rrugën, duke ndjekur bregun e detit, që ne të shijonim së largu pak qytet, mbjellë prush me minaretë e xhamive.

Kështu, i qetë pas një traume, mbërritëm në shtëpinë e tij. Te dera na priti plot buzagaz e shoqja, Donika. U futëm brenda dhe pimë si për mirëseardhje një gotë raki. M'u duk sikur ndodhesha në Shqipëri, diku aty, dy rrugica më tej e që kishim shkuar për një vizitë te familja e mikut tonë. Shtëpia e Malit m'u bë atë çast shtëpia ime. Menjëherë e desha shumë atë mjedis familjar. Mali, pas pak, thjesht na drejtoi të bënim një dush për t'u pastruar e çlodhur nga rruga e gjatë. Më pas u ulëm në tryezë. Si tani më tingëllon në vesh intonacioni i zërit të butë e miqësor i tij. Mali ishte simpatik, i dashur, i urtë, i kulturuar e plot sjellje të mirë. Mua më dukej sikur të gjitha cilësitë më të mira të njeriut ishin mbjellë e mbirë te shpirti i tij. E desha

shumë Malin.

Folëm gjatë për Shqipërinë, Stambollin dhe për veprimtarinë e artistëve që do të zhvillohej. Mali, si Konsulli i Përgjithshëm i Shqipërisë, ishte informuar më parë nga Ministria e Kulturës Turke. Folëm e folëm deri sa na u rënduan sytë nga gjumi. Ramë në shtrat. Lëshova një psherëtimë lehtësimi, kur nga errësira erdhi zëri bas i Aliut:

- A të thashë se do kalojmë shumë mirë?

Të nesërmen, Mali na shoqëroi deri në hotel, na njohu me organizatorët e na priti derisa u sistemuam. Për ta, ai ishte zotëria i nderuar Mal Berisha. Për ne ishte thjesht Mali.

Kjo që rrëfej me aq detaje sa më kanë mbetur në mendje, është për çdokënd një ngjarje nga më të thjeshtat, aq sa mund të habiten përse unë e kam të pashlyer në memorie. Vërtet e tillë është, por janë disa fjalë të tjera që kanë humbur, për të shprehur të pashprehurën, esencën e emocionit, të ndjenjës, të dashurisë dhe të mirënjohjes së madhe për tjetrin. Shumë rrallë e takova Malin, por kurrë nuk m'u shqit nga memoria, si një nga njerëzit e mi më të dashur.

Intervista kishte mbaruar. Po jepeshin lajmet, por unë ende po "flisja" me mikun tim dhe ajo darkë në familjen time, më shëmbëlleu me darkën e paharruar në familjen e Malit, në Stamboll."

Piktorja anglo - turke Heather Brown hap ekspozitë në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative, Tiranë

Në morinë e veprimtarive kulturore promovuese për Shqipërinë, jo vetëm me udhëtimet e artistëve tanë drejt Stambollit, por edhe me sjelljen e artistëve të huaj në Shqipëri, në fundverën e vitit 1996, Konsullata organizoi hapjen e ekspozitës së arteve figurative të piktores shumë të njohur anglo - turke, Heather Brown. Me zonjën Brown ishim njohur nëpërmjet ekspozitave të artit figurativ të përmendura në këtë libër. Pas shumë bisedash të tilla ramë dakord, që të organizonim hapjen e një ekspozite personale të saj në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative në Tiranë. Ajo u hap në fund gushtin e vitit 1996 dhe u mbajt e hapur deri në mesin e shtatorit të atij viti.

Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës morën pjesë një numër i madh

artdashësish, piktorë profesionistë dhe amatorë, intelektualë dhe dignitarë të dalluar të vendit tonë.

Ekspozita e Heather Brown-it në Tiranë, e cila ishte e gjashta në karrierën e saj, u pasqyrua edhe në shtypin e kohës, në Tiranë dhe në Stamboll. Gazeta "Turkish Daily News", botoi artikullin me një titull të thjeshtë: "Artistja nga Stambolli hap ekspozitë në Shqipëri." Artikulli shoqërohej me një foto të njërës prej pikturave të saj, vaj në kanavacë, të titulluar "Dremitja e të korrave". Gazeta jepte një pasqyrë të plotë të asaj që kishte ndodhur në Galerinë Kombëtare të Arteve, në Tiranë. Gazeta e konsideronte atë një artiste anglo - turke, që mbart'te të njëjtat karakteristika metafizike e mitologjike. Artisja e lindur në Newcastle, në vitin 1958, dhe e edukuar në Universitetin e Arteve të vendlindjes së vet ka ekspozuar në Turqi, Spanjë, Angli dhe në atë kohë edhe në Shqipëri.

Këtë ngjarje, më mirë sesa me fjalët e mia do ta përshkruante vetë piktorja Heather Brown në një letër që më shkruan:

I dashur Mal,

"Po të shkruaj nga Stambolli rreth asaj që përjetova në Tiranë në vitin 1996. Nuk mund ta besoj që kanë kaluar kaq shumë vite dhe ende i kam ato përshtypje të freskëta. Në atë kohë mendoj se isha artistja e parë anglo - turke, që hapa një ekspozitë retrospektive në Galerinë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë. Ishte një nder që isha e ftuar. Mbaj mend që Konsullata Shqiptare në Stamboll i kreu të gjitha procedurat doganore (të cilat përndryshe do të kishin qenë shumë të shtrenjta dhe të komplikuara). Më pas, kur punimet mbrritën në galeri, personeli i rregulloi ato në mënyrën më profesionale të mundshme. Midis tyre ishte një zonjë e quajtur Suzana Varvarica Kuka dhe dy punonjës të tjerë. Këta të fundit më thanë se nuk kishin udhëtuar kurrë jashtë vendit. Shqipëria, besoj, ende po dilte nga vitet e izolimit të epokës së diktaturës në atë kohë, prandaj kishte aq shumë gjëra, që i habitën shokët e mi turq, si dhe mua.

Sot ne shpesh habitemi se si i kemi bërë punët përpara daljes së telefonave celularë dhe Internetit. Mbaj mend që tre shokët e mi turq shprehnin shqetësim pse celularët e tyre nuk funksiononin në Shqipëri (unë nuk e kisha një të tillë në atë kohë).

Kurrë nuk do ta harroj telefonin statik. Ishte një model i vjetër prej bakeliti, prodhim i vitit 1950, i vendosur mbi një mbajtëse në mes të korridorit që dukej si

një copë e ekspozuar arti modern, një instalacion, dëshmi e një bote të kaluar. Nuk e dëgjova ndonjëherë të cingërrinte.

Ndërtesa e Galerisë ishte një strukturë madhështore dhe unë u ndjeva aq e privilegjuar, që arrita të hapja një ekspozitë aty. Më kujtohet radha e rregullt e njerëzve, që shikonin veprat e mia e më pas prisnin të merrnin kopjen e tyre të katalogut të ekspozitës sime. Ishin vizitorë me interes të mirëfilltë për artin.

Në ditën e hapjes së ekspozitës sime mori pjesë Ambasadori Britanik, Sir Patrick Fairweather, i cili zhvilloi një bisedë shumë interesante me artistët. Aty ishte edhe artisti britanik Mungo McCosh, i cili kishte udhëtuar nga Stambolli për të marrë pjesë në hapjen e ekspozitës. Nga Ambasada Turke mori pjesë Atasheu ushtarak i asaj kohe dhe nipi i gjeneralit turk Gjenerali Ali Karababa.

Kur u kthyem në Stamboll, festuam në Konsullatën e Përgjithshme Shqiptare për atë udhëtim aq të këndshëm dhe me aq shumë përshtypje të bukura nga Shqipëria.

Me dashuri:

Heather Brown

Gusht 1996

SI DOLËN 12 PIKAT E SHTABIT TË USHTRISË TURKE PËR MBROJTJEN E SHQIPËRISË NGA DISINTEGRIMI NË VITIN 1997

Ishte marsi i mbrapshtë i vitit 1997. Gjithçka dukej se po shkonte keq e më keq. Kaosi e kishte pushtuar aq shumë Shqipërinë, saqë situata dukej pa rrugëdalje. Një ndjenjë dëshpërimi më kishte kapluar keq, aq sa më dukej se jo vetëm që nuk po bëja gjë, por ndihesha edhe në një farë faji për këtë. Tek e fundit, përse isha në shërbimin diplomatik të vendit tim?! Secila ditë sillte lajme më të këqija se dita e mëparshme. Më e keqja dukej se ende nuk kishte ardhur. Dhe kjo do të vinte atëherë kur një pretendues dhe lakmues i hershëm i trojeve jugore të Shqipërisë do ta shfrytëzonte situatën e krijuar, të përfitonte prej saj, të merrte përparësinë, të fuste trupat ushtarake dhe ta bënte fakt të kryer marrjen e shumëlakmuar dhe të shumëpritur të të ashtuquajturit "Vorio Epir".

Gjesti më kuptimplotë i dëshirës për ta realizuar këtë ëndërr të vjetër greke ishte zbritja me helikopter e zevendësministrit të Punëve të Jashtme, Kranis Idiotis në Kalanë e Gjirokastrës, prej nga iu bëri thirrje të ashtuquajturve "Grupe të Shpëtimit Kombëtar", që të mblidheshin dhe ta përmbysnin pushtetin e ligjshëm shqiptar dhe të vendosnin administratën greke në vend të tij.

Në sipërfaqe dolën fijet e shtetit grek, që kishin vepruar fshehur apo hapur, figurina të vëna në lëvizje e që shfaqeshin me fytyrë dhe me zë nëpër televizione të ndryshme e që njiheshin si banorë të jugut të Shqipërisë, qofshin ata pjesëtarë të minoritetit grek, apo edhe renegatë, shqiptarë nga gjuha dhe nga gjaku.

Historia e "Vorio Epirit" në librin e amerikanes Edith Pierpont Stickney

Ndërkohë që ndiqja me aq shqetësim situatën në Shqipëri dhe merresha me punët e përditshme të konsullatës, natën isha përqendruar te studimi dhe përkthimi i librit *"Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në Çështjet Evropiane Ndërkombëtare nga viti 1912-1921"*, shkruar nga amerikania dr. Edith Pierpont Stickney, e Universitetit Stanford të Kalifornisë. Ajo kishte mbrojtur doktoraturën në shkencat historike me atë temë. Isha përqendruar veçanërisht në pjesën ku libri fliste për të ashtuquajturin "Protokolli i Korfuzit".

Çfarë ishte "Protokolli i Korfuzit" sipas dr. Edith Pierpont Stickney?

Pas Luftërave Ballkanike, 1912 - 1913, traktatet e paqes që pasuan ia njohën atë rajon Shqipërisë. Kjo bëri që të nxiteshin rebelime të grekërve vendorë, që çuan deri tek "Deklarata e Pavarësisë" së "Epirit të Veriut", e shpallur më 28 shkurt 1914.

Ky dokument antishqiptar u nënshkrua më 17 maj 1914, gjoja si një marrëveshje midis përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Përkohshme të Epirit të Veriut, i cili e njihte atë pjesë të Shqipërisë, si rajon të vetëqeverisur, nën sovranitetin e Principatës së sapothemeluar shqiptare. Marrëveshja do t'u siguronte grekërve të krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës, të cilët formonin të ashtuquajturin "Epiri i Veriut", autonomi politike, kulturore, arsimore e fetare më të gjerë, brenda kufijve të shtetit shqiptar.

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, një organizatë përgjegjëse për sigurimin e paqes dhe qëndrueshmërisë në rajon, më në fund e tha fjalën e vet dhe u nënshkrua Protokolli i Korfuzit. Megjithatë, pikat e protokollit nuk u zbatuan kurrë për shkak të situatës së paqëndrueshme në Shqipëri, e cila e shoqëroi deri në shpërthimin e Luftës së Madhe. Në vitin 1921 ai Protokoll u zhvleftësua nga Konferenca e Ambasadorëve. Edhe pse i ashtuquajturi "Protokolli i Korfuzit" nuk u zbatua kurrë, ai mbeti gjithmonë si një gur i varur në qafën e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë në periudha të ndryshme të historisë së mëvonshme.

Retrospektivë: "Vorio Epiri" "im" në Gjimnazin "Ismail Qemali" Laç, 1967

Gjatë studimeve në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Ismail Qemali" në Laç ne kishim një mësues të quajtur Pashko Camaj. Ai ishte djalë shqiptar i krishterë nga Mali i Zi, i cili kishte kaluar kufirin dhe kishte ardhur në Shqipëri, si shumë djem e vajza shqiptarë, të cilët padrejtësisht quheshin "emigrantë". Mësuesi Pashko ishte emfatik në shprehjen e pikëpamjeve të tij kombëtare. Ai shpjegonte me pathos dhe na tregonte për trimëritë e shqiptarëve të Malit të Zi, për Ulqinin e Tivarin dhe për Plavën e Gucinë. Ishte Pashku që, një ditë, në një zënkë me një kuadër të atëhershëm partiak, të cilin ne e dinim që ishte minoritar nga jugu i Shqipërisë, na e quajti atë Vorio Epiriot.

Ishte hera e parë në jetën time që po e dëgjoja një term të tillë. Më pas, në mësimet e historisë dhe në shumë diskutime të tjera dëgjoja për monarko - fashistët grekë, për pretendimet territoriale greke ndaj Shqipërisë, për "Ligjin e Luftës", për çamët e dëbuar nga grekët, disa prej të cilëve i kishim edhe në qytezën tonë, në Mamurras, si familjet Hodo, Karrameto, Demi etj.

1997 - "Vorio Epiri" i "vështruar" nga Stambolli

Në ata muaj të vështirë të fillimit të vitit 1997 ky togfjalësh kishte marrë jo vetëm përdorim të gjerë, po edhe kuptim më të vrazhdë se më parë. Flitej për ringjallje të pretendimeve territoriale, për grupe të cilat i referoheshin "të drejtës së tyre" për vetvendosje, për shkëputje nga Shqipëria e gjithfarë kërkesash të tjera. Po ashtu, dëgjonim se shumë qarqe të caktuara brenda vendit ishin gati të bënin çdo lëshim për interesa politike të ditës, duke mos menduar për rrjedhojat e mëtejme të veprimeve të tilla.

Pozita ime si Konsull i Shqipërisë në Stamboll ishte shumë e vogël për të marrë përsipër ta ktheja rrotën e historisë në drejtim të kundërt. Krahu im nuk ishte aq i fuqishëm sa ta kthente atë rrjedhë në kahun tjetër. Megjithatë, ishte dëshira e flaktë e shtyrë nga shqetësimi që më nxiste të bëja çfarëdo të ishte e mundur. I ndihmuar nga shumë miq, ia dolëm të ndalonim atë që po të ndodhte, do ta shpërfytyronte përgjithmonë konfiguracionin gjeografik dhe

politik të shtetit shqiptar.

Ndjesia e një të linduri buzë kufirit shqiptaro - shqiptar: Tropojë - Gjakovë

Unë vija nga një zonë e verilindjes së Shqipërisë, aty ku kufiri shtetëror na ndante dhe na detyronte që edhe anëtarë të së njëjtës familje të jetonim veçmas, ndonëse nuk ishin larg njëri – tjetrit vetëm nja pesë kilometra prej vijës ndarëse. Isha mësuar gjatë gjithë fëmijërisë sime të dëgjoja se sa padrejtësira ishin bërë në ato anë. Si u nda kufiri, si u mashtruan njerëzit, si mbeti njëra pjesë e familjes, në njërën anë të kufirit, ndërsa tjetra në anën e përtejme, si u mbyll kufiri, si u hap kufiri, si u mbyll përsëri; si e kalonin atë ilegalisht për të parë njëri - tjetrin ose për të bërë tregti, pasi nuk kishte mundësi tjetër jetese, si vriteshin njerëzit në kufirin shqiptaro – shqiptar etj.

Ndër tregimet, më i dhimbshmi ishte ai i Sokolit, një bir i fisit tonë, i cili humbi jetën në kufi. Ai ishte një djalë i shkathët, i bukur, kërcimtar i pashoq. Kur tregonin për të, asnjëherë nuk harronin të tregonin se si hipte sipër shalës së kalit dhe kërcente mbi të, duke i mahnitur të gjithë me aftësitë e tij. Ai ishte i dashur, i sjellshëm. Prindërit i kishin vdekur, por kishte një vëlla dhe një motër.

Ishte koha e mbretërive, si në Shqipëri ashtu dhe në Jugosllavi. Kosova ishte pjesë e kësaj të dytës. Një natë, Sokoli, bashkë me dy bashkëmoshatarë të tij ishin nisur për në Gjakovë. Të tre e kaluan kufirin, dhe dolën në anën tjetër. Gjatë kohës që ishin atje ra një borë shumë e madhe, karakteristikë për ato anë. Për fatin e keq të tyre, ata u diktuan nga disa serbë të cilët i ndoqën. Ata nxituan dhe shkuan e u futën në një fshat dhe, duke kapërcyer mur pas muri, hynë në një shtëpi, ku gjendej vetëm një plakë. I treguan asaj se ishin në rrezik, ngaqë po i ndiqnin serbët. Ajo i mori dhe i futi në një bodrum thellë, poshtë zavragut të shtëpisë. Atë natë dhe të nesërmen e kaluan aty. Duke mos ditur se sa i madh ishte rreziku po të dilnin, ata ndenjën aty në një të ftohtë shumë të madh, i cili u kthye në një armik edhe më i rrezikshëm se serbët.

Të pasnesërmen ata panë se jeta e tyre do të shuhej nga të ftohtit, etja dhe uria, prandaj vendosën që të zgjidhnin njërën nga të këqijat; të dilnin jashtë sido që të ndodhte, se përndryshe do të vdisnin aty. Kështu Sokoli filloi të

godiste kapakun e tavanit derisa ajo plakë e shkretë, që e kishte harruar fare se i kishte lënë aty, e hapi atë. Ata dolën, siç ishin të rraskapitur dhe, pasi vunë diçka në gojë, morën rrugën drejt kufirit për kthim. Ishin aq të dobësuar dhe të lodhur sa nuk mund ta vazhdonin udhëtimin. Kështu, trokitën në një derë, ku u strehuan atë natë. Të nesërmen i përcollën deri në kufi dhe, në një zonë shumë të lartë malore, arritën te një familje e njohur e tyre. Oh, kur tregohej kjo ngjarje përherë më shkaktonte një ndjenjë dhimbjeje. Pse ajo plakë i mbajti në bodrum? Pse ai kufi duhej të ishte i tillë që njerëzit edhe nëse nuk e humbnin jetën prej plumbit ta humbnin prej të ftohtit?!

Sokolin më në fund e sollën në shtëpi. Ishte thuajse pa ndjenja e i dërrmuar plotësisht, i pagjak, i mërdhirë, i prishur, i pajetë, si një copë akulli e shkëputur nga trupi.

Këto ishin tregimet e ndodhive tragjike, që shkaktonte kufiri tek ne.

Ndërsa tani isha në një sprovë. Duhej bërë diçka dhe duhej bërë pa tjetër. Po flitej për kufij të rinj, kufij që do të vendoseshin edhe më në brendësi të trojeve shqiptare, në anën tjetër sikur pak tokë na ishte marrë…!?

Të marrësh mbi vete barrën më të rëndë të momentit: "Ruajtjen e kufirit të vendit tonë".

Në ato ditë tmerrësisht të hirta dhe të ftohta të atij marsi të vitit 1997 vendosa të merrja nismën për të bërë vetë diçka. Thirra në telefon zotin Enver Tali, me të cilin thuajse pa u vënë re kemi bërë shumë gjëra, të cilat edhe tani pas kaq vitesh mendoj se ia kanë vlejtur dhe i kanë shërbyer çështjes shqiptare, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

– Bacë, bre! – i thashë. – A po e sheh që po na shkon Shqipnia? Unë e ti këto vite përditë kemi mbajtë hallin e Kosovës. Po tash, siç e sheh, po na shkon edhe Shqipnia vetë!?

– Po, qe besa! – U përgjigj baca Enver. Na përherë një shpresë e kena pasë te ju në Shqipni, e tash, mos o Zot ma keq! Nuk po di as unë se çka me ba!?

Zëri i tij ishte i butë, i dridhur, i shqetësuar e gati pa shpresë.

– Po më duket se ai djali i Bashkisë së Madhe të Stambollit, Burhani, që ti dhe unë e kemi shumë mik, – i thashë, – ka lidhje të forta në Ankara. A mendon

se e vlen ta bëjmë një bisedë me të? Ndoshta…! Si thua?

Në fakt, po më dukej se po kapesha si i mbyturi pas shkumës. Burhani ishte vërtet djalë i mrekullueshëm turk, drejtor i një drejtorie në Beledijen e Madhe të Stambollit, por sa ishte hapi i tij në hierarkinë e atij shteti aq të madh, nuk e dija aq mirë. Sidoqoftë, ishte më mirë të përpiqesha që të bëja të pamundurën, sesa të kisha brengën e të qenit viktimë e mosbërjes së ndonjë gjëje. Më erdhi në mendje, në ato çaste thënja e At Gjergj Fishtës:

"Në kjoftë se provon, mundesh me hupë,
Por në kjoftë se nuk provon – je i hupun gjithsesi!"

Pra, duhej edhe guxim. Për mendimin tim është me rëndësi që njeriu të guxojë. Të guxosh nuk është cilësi që duhet keqpërdorur. As që duhet përdorur vetëm kur gjendesh në alternativën, Jetë apo Vdekje!? Guximi duhet edhe kur të ofrohet një mundësi që kërkon angazhim, profesionalizëm, impenjim, forcë karakteri. Njeriu nuk duhet ta lëshojë rastin. Duhet vënë në provë. Edhe nëse dështon, dështo! Dështo një herë, dy, tri. Provoje prapë! Fito! Humb përsëri! Mos u dëshpëro! Lufta është e gjatë, betejat janë të shkurtra. Por mos guxo të bësh gjëra të turpshme për të fituar betejën dhe as mos iu shmang betejës ngaqë të vjen turp të humbasësh! Ngurrimi është armiku i guximit.

Pas ndonja dy orësh baca Enver më mori në telefon dhe më tha:

"A je gati ti të shkojmë sonte bashkë me Burhan beun në Ankara? Ai më premtoi se mund të shkojmë për një takim nesër te një njeri shumë i rëndësishëm i politikës turke".

Kështu e morëm rrugën për në Ankara në mbrëmjen e asaj nate marsi tejet të ftohtë të vitit 1997. Ishte bacë Enveri, Burhan beu, unë dhe shoferi ynë Çeço. Ky i fundit ishte një njeri me zemër të bardhë, por fliste shumë dhe nuk i mbante gjë barku, ndërkohë që misioni ynë nuk ishte aq diskret.

Një bashkëpunim me Ambasadorin Besnik Mustafaj në Paris

Ky udhëtim u ndërmor në konsultim me Besnik Mustafajn. Besniku ishte njeri i matur dhe dashamirës, në atë kohë ambasador i Shqipërisë në Paris, i

cili në anën tjetër fundore të kontinentit mundohej të bënte maksimumin për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej në Shqipërinë e trazuar. Ishte Besnik Mustafaj, poeti, gazetari, shkrimtari, politikani, diplomati dhe politologu. Në pikëpyetje, si për atë edhe për mua, nuk ishte vetëm fati i një njeriu apo i një grupi, as vetëm i imi, dhe as i atij personal, por tërësia territoriale e vendit tonë. Në një nga ato biseda ai më tha:

"Mal, nëse nuk bëhet diçka andej nga Turqia, mos mbaj shpresë se këtej do të vijë ndonjë e mirë. Ajo që munda të bëj këtu është kalimin e një rezolute në Senatin Francez, por ajo nuk ka forcë detyruese për ndonjë gjë. Shpresa mbetet atje ku je ti".

Me një telefon celular unë rrija në kontakt me Besnikun në zyrën e tij në Paris. Si çdo ditë tjetër të asaj periudhe, edhe atë natë ai më mbajti të informuar për çdo gjë që po ndodhte.

Në Bollu, në majën e atij mali, ku bora dhe acari kishin mbuluar gjithçka, ndalova për të marrë edhe një informacion tjetër. Situata përshkallëzohej vetëm për keq.

Në Ambasadën shqiptare në Ankara

Arritëm në Ankara pas mesnatës dhe u vendosëm në një hotel. Në mëngjes vajtëm në ambasadën tonë në Ankara. Ambasador në atë kohë ishte z. Skënder Shkupi, një njeri me shumë kredenciale, intelektual e burrë i urtë, e bashkë me të shoqen, Meritën, të dy ishin midis nismëtarëve të rrëzimit të regjimit të vjetër komunist në Shqipëri. Zgjedhja e tij në atë post ishte bërë qëllimisht pasi ishte një intelektual, që kishte punuar në revistën "Shkenca dhe Jeta", e fliste gjuhën turke në familje, e mbi të gjitha ishte i biri i Ali Shefqet Shkupit, shok shkolle e klase i Qemal Ataturkut, themeluesit të Turqisë moderne. Ata kishin qenë bashkë në të gjitha hallkat e arsimimit të tyre, në shkollën fillore në Selanik, ku ishin edhe fqinj me shtëpi, në të mesmen në Manastir, dhe në Akademinë Ushtarake "Erqani Harbije" në Stamboll. Kjo mjaftonte për të qenë i mirëpritur i tërë salloneve të Ankarasë. Në Ankara ai kishte kontakte me Gjeneralin e Shtabit të Ushtrisë Turke, Ismail Karadağ, i cili e ndiqte situatën me shumë vëmendje. E megjithatë, si shumë shqiptarë në atë kohë, edhe ai kishte

skepticizmin e vet se si gjërat mund të rregulloheshin në atë situatë aq kaotike.

Kështu, kishim rënë dakord më parë të shkonim bashkë, pasi prania e tij ishte një vlerë e shtuar në takimin, që na priste. Ai na u bashkua dhe ne, të tre bashkë, e me Burhan beun katër, shkuam tek Ibrahim beu, krahu i djathtë i Tansu Çillerit, ndërsa kjo e fundit krahu i djathtë i Süleyman Demirelit, Presidentit të Republikës së Turqisë. Kështu, pra, falë njohjes me nivelet më të larta të shtetit turk, që kishte miku ynë, Burhan beu, në orën dhjetë të mëngjesit do të na priste një deputet me emër dhe fuqi shumë të madhe në politikën turke. Ai ishte Ibrahim beu, numri dy në partinë qeverisëse, i gjithëpushtetshëm, krahu i djathtë i ish - kryeministres Tansu Çiller, në atë kohë zv/kryeministre dhe Ministre e Punëve të Jashtme në qeverinë e Erbakanit, politikane me ndikim shumë të madh.

Dy fjalë për Tansu Çiller

Turqia, e konsideruar si fanatike dhe me atë vlerësim që kishte rreth saj Perëndimi, kishte në krye një zonjë të edukuar më së miri, një portret i cili i jepte shumë dritë atij vendi. Tansu Çiller ishte politikane karizmatike, që vinte nga jeta akademike. Ajo shërbeu si Kryeministrja e njëzetedytë e Republikës turke, Ministre e Punëve të Jashtme dhe drejtuese e Partisë së Rrugës së Drejtë.

Tansu Çillerin e kisha takuar një herë në një Konferencë Islamike, kur ajo e drejtoi atë bashkë me të ndjerën Benazir Buto, në atë kohë kryeministre e Pakistanit. Ato të dyja, të mbështjella me elegancë me shamia të bardha plot stil, e drejtuan denjësisht konferencën e radhës. Shqipërinë e përfaqësonte zonja Zana Panariti, ministre e transporteve. Të tria ishin të vetmet zonja në atë sallë. Përfaqësuesja e Shqipërisë, madje, ishte veshur thjesht, por me shumë shije, krejt alla franga, saqë tërhoqi vëmendjen e medias turke.

Ambasadori ynë, z. Skënder Shkupi më thoshte se Tansu Çiller, gjatë një darke të organizuar në Ankara për nder të një delegacioni shqiptar të kryesuar nga kryeministri Aleksandër Meksi, i kishte thënë atij se edhe ajo vetë ishte me prejardhje shqiptare nga Shkupi.

Kodra e vilave të deputetëve në Çankaya, Ankara

Në një kodër në Ankara gjendet një kompleks vilash të bukura, ku banojnë gjithë anëtarët e Mexhlisit të Madh apo parlamentit turk. Ato iu jepen deputetëve në përdorim për aq kohë sa kanë mandatin e popullit. Vilat janë të pajisura shumë mirë dhe gjithë shërbimi sigurohet nga shteti. Në vilën e tij na priti vetë Ibrahim beu. Ai na kishte rezervuar një mëngjes pune me gjithë të mirat e një *kavallti*, siç i thonë turqit. Pasi pimë kafetë e para, hëngrëm atë mëngjes të shijshëm, filluam bisedën. Njëri pas tjetrit i shpjeguam se çfarë situate po kalonte Shqipëria. U përmendën aty lidhjet historike, vezirët, autori shqiptar i Himnit Turk, Mehmet Akif Ersoy, afeksionin midis dy vendeve, shumë gjëra që na lidhnin ndër shekuj… Secili në mënyrën e vet dha më shumë argumente, por ajo që zotëroi ishte:

Shqipëria ishte në një rrezik serioz shpërbërjeje. Pjesa e saj jugore ishte shkelur, sikur të ishte tokë e pa zot. Autoritetet greke në kufirin jugor po merrnin situatën në dorë për të plotësuar ëndrrën e tyre të vjetër: Restaurimin e Protokollit të Korfuzit, pra praktikisht pushtimin e "Vorio Epirit".

Baca Enver tha: "Nëse Yunani (greku) ua merr jugun e Shqipërisë, hapi tjetër i tyre do të ishte pushtimi i Stambollit. Nuk mbrohet Stambolli në Yeni Kapı, porta e parë bizantine e hyrjes në Konstandinopul nga ana greke. Duket si e pabesueshme, por kështu mund të ndodhë nëse nuk ndërhyni shpejt".

Në fjalën time i thashë mikpritësit se vetëm dy ditë më parë zëvendësministri grek i Punëve të Jashtme, njëfarë Kranis Idiotis, është ulur në Kalanë e Gjirokastrës me helikopter, pa marrë leje nga autoritetet shqiptare, duke shkelur në mënyrë flagrante sovranitetin e shtetit shqiptar, dhe iu ka bërë thirrje të ashtuquajturve "Grupe të Shpëtimit Kombëtar" të përbërë nga grekët e jugut dhe disa renegatë shqiptarë, që të shpallin "pavarësinë". Ai iu bëri thirrje të hapur atyre që të mos e lëshonin rastin për të marrë më në fund "Vorio Epirin", aq shumë të lakmuar prej tyre. E nëse nuk ndërhyn menjëherë Turqia për të ndihmuar Shqipërinë në këtë situatë, nesër do të jetë tepër vonë.

Biseda po shkonte mjaft mirë. Në një çast Ibrahim beu doli nga dhoma, ku po mbahej biseda, dhe u kthye pas më shumë se dhjetë minutash. Ai kishte bërë një telefonatë shumë të rëndësishme. Kishim kaluar afro dy orë aty dhe erdhi një çast që na dha të kuptonim se biseda jonë kishte përfunduar. Na përcolli dhe

me dashamirësi na tha: "Besomëni që iu kam dëgjuar me shumë vëmendje. Do të bëhet më e mira. *Merak etme*!"

Pasi na pyeti se ku do të ishim në orën 2 pasdite, i thamë se do të gjendeshim në "Hotel Ankara", në dalje të qytetit, pranë rrugës, që shkonte për Stamboll.

"Mirë, - na tha, - prisni aty derisa të vijë dikush dhe t'ju takojë. Do të jetë një oficer i Shtabit të Përgjithshëm, që do t'ju dorëzojë një letër, të cilën do ta paraqisni sa më parë në Tiranë. Udhë e mbarë!".

U larguam me shpresë në zemër nga ai takim.

Nuk ishim gabuar.

12 Pikat e Shtabit të Ushtrisë Turke, që e shpëtuan Jugun e Shqipërisë

Në orën 2 të asaj dite, në lobin e Hotelit "Ankara", u shfaq një oficer i ri, bardhosh e shumë bukurosh, me gradën kapiten. Duhej të ishte arnavut nga origjina, pasi aq shumë ngjante si shqiptar. Mua më ishte mprehur shqisa dalluese e arnavutëve në Turqi.

Ai shkoi te recepsioni dhe më kërkoi me emër e mbiemër. Sapo e pashë dhe e dëgjova u ngrita menjëherë dhe iu afrova. E përshëndeta dhe më përshëndeti. Më tha se këtu ke një dokument shumë të rëndësishëm të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Turke. Duhej mbajtur me kujdes, të dërgohej në Tiranë dhe të bëhej publik, sa më parë. Ai e la atë letër në dorën time, më përshëndeti ushtarakisht dhe iku.

Menjëherë e hapëm letrën dhe e lexuam. Ishte një mrekulli. Ishte vërtet një mrekulli. Vetëm një vendim i tillë mund ta ndalte dorën grabitqare të grekut, që po zgjatej drejt vendit tonë të lodhur e të çoroditur, që nuk dinte as vetë çfarë po bënte.

Pastaj u ulëm dhe e përkthyem aty për aty, siç ishim në hotel. Ishin 12 pikat e masave që do të merrte qeveria turke në rast ndërhyrjeje ushtarake greke ndaj Shqipërisë. Në të fliste Gjenerali i Shtabit të Ushtrisë Turke, Ismail Karadaği. Aty thuhej se çdo tentativë ushtarake ndaj jugut të Shqipërisë do të ketë si rrjedhojë ndërhyrje në lindje të atij vendi në vijën kufitare ndarëse të lumit Maricaj.

E nisëm menjëherë deklaratën për në Tiranë. Nuk vonoi dhe më erdhi telefonata e parë nga kreu i shtetit me një përshëndetje të ngrohtë për këtë arritje diplomatike të jashtëzakonëshme. E telefonova menjëherë edhe Besnikun dhe i dhashë sihariqin. Mbrojtja e tërësisë territoriale të atdheut, si në atë moment, është një rast që mund t'i jepet tepër rrallë një diplomati. Dhe unë, megjithë dhimbjen që ndieja për situatën fatkeqe, e pata atë fat dhe përjetova gëzimin për atë që u arrit.

Se si rrodhën ngjarjet më tej dihet. Situata në Shqipëri menjëherë u lehtësua. Kjo deklaratë e lëshuar në atë kohë kritike zbuloi edhe faktin se Turqia po e ndiqte me vëmendje shumë të madhe situatën në Shqipëri.

Ndoshta frika jonë nuk do të provohej dhe grekët nuk do të shkonin aq larg sa ta aneksonin jugun e Shqipërisë, për ta kthyer historinë mbrapsht thuajse 75 vjet pas nënshkrimit të atij Protokolli famëkeq të Korfuzit. Në fakt, doli se Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Turke dhe vetë politika turke në nivelet e saj më të larta po e ndiqte situatën me vëmendjen më të madhe, prandaj dhe reagoi menjëherë ndaj shqetësimit tonë.

Përtej asaj që ne bëmë në atë kohë si diplomatë të Shqipërisë, duhet besuar dhe pranuar se ata kishin burimet e tyre të informacionit, të cilat me siguri që ishin shumë të sakta dhe të besueshme, po aq sa edhe fjalët tona në atë takim. Pra, një ndërhyrje e tillë duket se u bë në një moment kritik dhe në kohën e duhur dhe përkonte me vëzhgimet dhe analizat e tyre gjeostrategjike, çka solli si fryt atë deklaratë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Turke, dhe koha e vërtetoi këtë më së miri.

Reagimet e menjëhershme të shtypit turk rreth atij takimi

Shtypi turk menjëherë reagoi duke bërë deklarata të tilla si kjo:

> *"Tre diplomatë shqiptarë të akreditуar në Turqi patën një takim shumë të rëndësishëm me personalitete të larta turke. Ata i paraqitën palës turke shqetësimin e madh për rrezikun që i kanosej vendit të tyre. Disa orë më vonë, diplomatët u njohën me një dokument prej 12 pikash nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Turke lidhur me aksionin, që do të ndërmerrej në Lindje të Greqisë në rast të një agresioni të kësaj të fundit ndaj Shqipërisë. Kjo bëri që planet greke të mbeteshin vetëm në lojën e fjalëve të qeveritarëve dhe në mendjet e sëmura të organizatave Vorio - Epiriote".*

Takimi i 18 shoqatave shqiptaro - turke me Presidentin Turk Süleyman Demirel

Deklarata e Shtabit të Përgjithshëm ngjalli shpresat menjëherë, inkurajoi njerëzit dhe nxiti një takim të 18 kryetarëve të shoqatave shqiptaro - turke, që veprojnë në Stamboll, të takoheshin me Presidentin turk Süleyman Demirel. Presidenti i siguroi shtetasit e tij me origjinë shqiptare se Turqia po e ndiqte me vëmendje të madhe situatën në Shqipëri dhe se askush nuk do të guxonte, qoftë edhe të mendonte, që të merrte një pëllëmbë tokë nga Shqipëria.

Më datën 29 Mars 1997, pas një takimi urgjent me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Turke, Gjeneralin Ismail Haki Karadaği, zv/ kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme e Turqisë, Tansu Çiller, deklaroi përsëri para shtypit dhe medias turke:

> *"Turqia është e vendosur të ruajë integritetin territorial të Shqipërisë dhe nuk mund të qëndrojë pasive ndaj ngjarjeve që kërcënojnë me copëtimin e Shqipërisë. Përkeqësimi i situatës në Shqipëri është i palejueshëm dhe do të ishte turp për Evropën, ndaj nga ana e saj Turqia është e gatshme të bëjë gjithçka për stabilizimin e gjendjes në Shqipëri".*
>
> (Marrë nga e përditshmja turke "Turkish Daily News", 30 Mars 1997).

Në biografinë e Tansu Çillerit, ish kryeministre e Turqisë, është shënuar edhe kjo frazë:

"Si zëvendës-kryeministre, Tansu Çiller deklaroi se, nëse Greqia përpiqet të copëtojë Shqipërinë, ajo do ta shohë ushtrinë turke në Athinë, brenda 24 orësh".

Kështu shpëtoi Shqipëria edhe një herë nga kthetrat greke, e megjithatë dëmi që iu shkaktua vendit tonë ishte shumë i madh. Kjo është historia e lëshimit të 12 pikave të Shtabit të Ushtrisë Turke, që e mbrojti Shqipërinë nga frika e humbjes së një pjese të territorit të saj - Shqipërisë së Jugut, ose të ashtuquajturit: "Vorio Epiri".

NË IBRIK TEPE, TRAKË, ME PROFESOR JOHN FREELY DHE GAZETARIN EMIN SAHATÇIU, NË VENDLINDJEN E THEOFAN STILIAN NOLIT

Ishte ditë vere e vitit 1997 kur prita në Konsullatë dy personalitete, që do të nderonin me vizitën e tyre çdo përfaqësi shqiptare, falë përmasës së tyre intelektuale dhe ndihmesave për ne shqiptarët: profesori amerikano - irlandez, John Freely dhe gazetari turk nga Qipro e Veriut, botues i revistës prestigjioze "Cornucopia", Emin Sahatçi. Kishin ardhur për të bërë së bashku një vizitë, me qëllimin e vendosjes në të ardhmen të një busti të Fan S. Nolit, në fshatin e tij të lindjes, në Ibrik Tepe.

Profesor Freely kishte lindur në vitin 1926 në Brooklyn, në New York. Ai ishte fizikan nga arsimimi dhe praktika e punës që bënte. Kishte shërbyer në Forcat Detare Amerikane në Luftën e Dytë Botërore e më pas, kishte studiuar në Oksford, ndërsa jepte mësime në Universitetin Bosphorus, ose Boğazi University, siç e quanin turqit.

Ai kishte marrë mësime prej Thomas Bullen-it, nxënës i nobelistit Patrik Maynard Blacket, i cili vetë kishte mësuar prej nobelistit tjetër, Ernest Rutherfordit. Më vonë u mor me astronomi dhe histori në Boğaziçi University, (Ish Robert Kolegji) dhe me vazhdimësinë e shkencës perëndimore nga Mesjeta e hershme që prej Kopernikut, Galileut deri tek Isak Njutoni. Që aty ai kishte formësuar kolanën e librave të tij për Stambollin, Athinën, Venecian, Turqinë, Greqinë, Perandorinë Osmane duke botuar plot 40 vepra të tilla.

John Freely, autor i veprës kushtuar Mesia False, Rabinit Sabbatai Zevi, që vdiq në Shqipëri në vitin 1676

Një personalitet i këtyre përmasave, po vinte në konsullatën tonë. E dija se ishte marrë edhe me studimin e jetës së hebrejve, madje edhe me një nga historitë më të habitshme të botës hebraike. Profesori kishte sjellë me vete edhe librin e tij "The Lost Messiah" me një dedikim. Në libër flitej për atë rabin, i cili ishte kthyer në një rrezik për vetë Perandorinë Osmane.

Ai e lidhte fundin e jetës së rabinit Sabbatai Zevi (1626 - 1676) me Shqipërinë dhe pikërisht me Ulqinin dhe më vonë me Beratin ku, sipas tij, aty vdes dhe varroset. Në gjurmë të këtij studimi, profesori kishte udhëtuar edhe në Shqipëri, në Berat, në Ulqin dhe kishte mbledhur fakte për librin e tij kushtuar kësaj figure shumë kontraverse të botës hebraike të shek. XVII.

Rabini Sabbatai Zevi, i lindur në Izmir, ishte hebreu, që habiti botën duke mashtruar sikur ishte Mesia që kishte zbritur nga qielli, për të udhëhequr hebrejtë drejt Tokës së Premtuar.

Historia e tij ishte shumë e habitshme. Një ditë atë e kishte thirrur vetë Sulltan Mehmeti i Katërt dhe e kishte paralajmëruar që duhej të hiqte dorë nga aventurat e tij. Por rabini Sabbatai Zevi, jo vetëm që nuk e pranoi një gjë të tillë, por edhe e kërcënoi atë me gjoja forcën hyjnore që zotëronte, e cila mund ta shfronësonte edhe vetë Sulltanin. Në zemërim e sipër Sulltani thërret xhelatin dhe e urdhëron t'i priste kokën. Rabini proteston dhe Sulltani i kërkon të zgjedhë: Ose do t'i priste kokën aty përpara tij, ose do të shndërrohej në Islam. Hebreu i mençur pranon të dytën, konvertohet në Islam dhe pas kësaj e internojnë në Ulqin.

Që atje ai drejton një lëvizje të quajtur "*Dönme*" ose të "*Shndërruarit*", për shkak se ai dhe pasuesit e tij, edhe pse u shndërruan në myslimanë, në fakt ishin kriptohebrej. Edhe sot ekziston ai sekt hebraik, i cili ende beson se rabini Sabbatai Zevi nuk ka vdekur dhe një ditë do të kthehet. Mendohet se ai është varrosur buzë lumit Osum në Berat, vend të cilin profesor Freely e ka vizituar vetë dhe e ka përshkruar në libër. Ai thotë se, megjithëse Sabbatai vdes si mysliman, në momentin kur e marrin për ta varrosur, poshtë jastëkut të tij gjejnë një libër të shenjtë hebrejsh, Torahun, që do të thotë se ai nuk kishte besuar ndonjëherë në Islam.

Edhe sot e ruaj atë libër si dhuratë të bukur që më bëri Profesor Freely.

Emin Sahatçiu dhe revista e famshme Cornucopia

Mysafiri tjetër, Emin Sahatçiu, ishte turk nga Qipro-ja e Veriut. Ai merrej me botimin e "*Cornucopia-s*" revistë elitare dhe e dashur për shumë njerëz në Stamboll. Titulli i saj, në shqip, ishte intrigues - "*Briri i bollëkut*". Për këtë legjendë antike ka shumë shpjegime, por më i pranuari është ai që ka lidhje me Zeusin foshnjë, i cili duhej të mbrohej që të mos gllabërohej nga babai i tij, Kronosi, nga shërbëtorët hyjnorë që e rrethonin, përfshirë Amaltheian, e cila i jepte qumësht nga gjiri i saj. Mbreti i ardhshëm kishte fuqi të mbinatyrshme aq sa një ditë duke luajtur me kujdestarin e vet theu njërin nga brirët e dhisë.

Kjo i dha atij fuqinë hyjnore për të pasur ushqime me tepricë. Këtë legjendë e ndërton mjeshtërisht në një vepër të tij, piktori i famshëm Peter Paul Rubens, te vepra e tij Cornucopia.

Emin beu merrej me botimin e kësaj reviste, e cila dilte dy herë në vit në gjuhën angleze dhe shërbente për njohjen e Turqisë, duke ravijëzuar elemente të spikatur nga historia, artet, kultura, arti i gatimit, turizmi e udhëtimet. Të takoje këta njerëz aq të ditur ishte nder i madh dhe ndjesi e fortë përgjegjësie.

Profesor Freely dhe dijenitë e tij të pafund për shqiptarët e Perandorisë Osmane

Profesor Freely fliste me kompetencë mbresëlënëse rreth historisë së marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe otomanëve. Ai foli për Köprülü Mehmet Pashain, si i pari i familjes, e më pas për Kara Mustafa Pashën, gjeneralin e famshëm të ushtrisë osmane. Na tregoi se ku i kishte pasur sarajet familja Köprülü, pikërisht aty ku sot është Restoranti shumë i njour "*Gelik*", në rrugën që të çon nga Yeni Kapi në Aeroportin "Ataturk".

Më pas u ndal te numri i madh i shqiptarëve, që kishin shërbyer në Perandorinë Osmane në postet më të mëdha të atij shteti. Profesori fisnik nxori nga çanta një libër shumë të bukur, të botuar nga shtëpia e famshme botuese angleze Penguin Books me titull "*Istanbul - The Imperial City*", (Stambolli një qytet peradorak) duke më lënë një dhuratë të çmuar. Në atë libër profesor

Freely sjell historinë e të gjithë perandorëve të Kostandinopulit dhe sulltanëve të familjes osmane, që nga Gazi Sulltan Osmani deri tek Abdylmexhidi II.

Ndërsa këto rrëfime na zhvendosën në kohë, kishim një rrugë për të bërë; do të shkonim atë ditë në Ibrik Tepe, në vendin ku kishte lindur Fan Noli ynë. Rrugëtimi do të zgjaste tri orë me makinë.

Vizita dhe takimet në vendlindjen e Theofan Stilian Nolit

Arritëm në fshatin Ibrik Tepe për të vlerësuar se si do ta mbante ai mjedis një bust të Nolit. Ishte vendlindja e tij. Ndër sy kishim një fshat me pluhur, me shumë pak asfalt, vetëm në qendër, që dikur ishte quajtur Qyteza dhe ishte i populluar prej shqiptarësh ortodoksë, të ardhur aty nga Kolonja në jug të Shqipërisë. Tani fshati kishte tërë tiparet e një fshati turk. Përtej emocionit tim, nuk kishte asgjë të veçantë. Pyetëm disa fshatarë që gjetëm aty, nëse dinin ndonjë gjë për shqiptarët dhe jetën e tyre. Asnjëri nuk dha ndonjë përgjigje të saktë. Aty kishte myslimanë të zhvendosur kohë pas kohe nga Bullgaria dhe të vendosur ndoshta gjatë luftërave të fundit. Vazhduam të ecnim nëpër fshat, derisa dikush na ftoi të vizitonim disa shtëpi të fshatit, të cilat kishin dyer shumë të vjetra me dekorime të veçanta atipike për zonën.

Na lanë të vizitonim tri shtëpi të asaj natyre. Secila i kishte dyert e brendshme me disa dekorime, që nuk ngjanin me ornamentet myslimane. Ato nuk kishin ikona të pikturuara, por dyert e drunjta ishin të dekoruara me motive, që dëshmonin mjegullt praninë e banorëve të mëparshëm, jomyslimanë të atyre shtëpive. Dr. Freely, Emin beu, atasheu ynë Fisnik Lazimi dhe unë u ngutëm të bënim fotografi, ndërsa nisi një diskutim i gjallë, se si duhet të ketë qenë jeta në atë vend për shqiptarët e asaj kohe, të cilët kishin lënë vendin e tyre dhe qenë vendosur aty. Ishin kohërat e Perandorisë, kur jeta për shqiptarëve ishte e vështirë.

Takim me kryetarin e Bashkisë së Ibrik Tepesë, në Thrakë

Më pas shkuam te Bashkia e Ibrik Tepesë dhe takuam kryebashkiakun, siç i

thonë turqit, Beledyie Başkani. Ishte një burrë i thjeshtë, por jo aq me dijeni rreth historisë. I shpjeguam qëllimin e vizitës sonë, i treguam për një bir të atij fshati, një prift, një poet, shkrimtar dhe përkthyes. Duket se asnjë nga këto nuk i bënë aq përshtypje, deri sa i thamë se ai ka qenë edhe politikan dhe se ka qenë edhe kryeministër i Shqipërisë për një farë kohe, në vitin 1924.

Ky fakt i preku atij nervin e politikanit të vogël provincial. Ndoshta mendoi se një kryeministër nga fshati i tij mund t'i jepte edhe atij ndonjë shenjë trashëgimie për të bërë karrierë në nivele më të larta politike në kasabanë e tij ose më tej. Ai menjëherë kërceu dhe tha:

"O Zot, a prej këtij fshati paska dalë një kryeministër?"

Një bust i madh në fshatin e vogël

Pas këtij momenti diskutuam për mundësinë e vendosjes së një busti të Nolit në fshatin e vogël. Kryebashkiaku ishte dakord me këtë ide, por nuk e dinte se si mund të financohej një projekt i tillë.

Kështu e mbyllëm atë udhëtim me John Freely-n dhe Emin Sahatçiun në Ibrik Tepe dhe u kthyem në Stamboll. Menjëherë e raportova këtë çështje në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Nuk vonoi shumë dhe unë u largova nga misioni në Turqi, përpara se të merrte udhë ky projekt. Nuk munda të bëj gjë në atë kohë, por fara e një nisme të tillë tashmë ishte mbjellë. Vitet kaluan dhe projekti i asaj dite u bë realitet. Busti, vepër e skulptorit Andrea Demçe, u vendos nga autoritetet shqiptare dhe diplomatët tanë pasardhës në Turqi, me pjesëmarrjen e ministrit tonë të kulturës dhe një jetëshkruesi të Nolit, për nder të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë dhe 130-vjetorit të lindjes së Fan Nolit. Merrnin pjesë edhe prefekti i Edirnesë dhe kryetari i bashkisë së Ibrik Tepesë.

Ky bust qëndron krenar në atë qytezë, siç jemi ne krenarë për veprën që na ka lënë Noli trashëgimi deri më sot. Por atë që nuk arrita ta bëja vetë për autorin e "Historisë së Skënderbeut", pra Fan Nolin, munda ta bëja për Skënderbeun vetë në Londër dhe në Munxhufuni, në Itali.

Me profesor John Freely-n në Universitetin "Bogazici" - ish Kolegji Amerikan "Robert"

Profesor Freely më ftoi në Universitet. Përtej privilegjit të ftesës, mbetej kënaqësia e rrallë e bisedës së gjatë me të. Ishte një shkollë më vete. Më tregoi për shumë autorë të huaj, që kishin shkruar për Shqipërinë dhe më bëri një surprizë të bukur; më dhuroi një fotokopje të librit të shkruar nga historiania amerikane Edith Pierpont Stickney e Universitetit Stanford. Më tregoi se ajo ishte bërë Doktore e Shkencave Historike në atë universitet me botimin e librit të saj "*Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare 1912 - 1923"* (1926). Profesori më sugjeroi që ta përktheja atë libër pasi, siç më tha ai:

> *"Shqiptarët do të gjejnë aty një nga variantet më shkencore dhe të paanshme politike rreth asaj periudhe shumë të vështirë dhe të trazuar të historisë së tyre".*

Ishte ky sugjerim i profesorit, që më bëri ta përktheja atë libër, i cili u botua nga Shtëpia Botuese "Koha" në vitin 2000. Ishte më shumë sesa një studim i mirëfilltë shkencor, ku fakti historik dhe ndërtimi i tekstit ishin qëmtuar dhe kujdesur me të njëjtën përgjegjësi nga autorja.

18 vjet më vonë: Takim me Maurine John Freely, e bija e profesor Freely-t

Vite më vonë, në një sallë në Russell Square, në Londër, kur po merrja pjesë në një konferencë për Lindjen e Mesme, vura re se në panelin kryesor ishte një person me mbiemrin, që më kujtonte atë mik të madh të shqiptarëve dhe personalitet të shkencës: John Freely-n. Ishte Maurine John Freely, e bija e profesorit. Ngjante shumë me të atin.

Pas konferencës e ftova për një kafe dhe biseduam. I tregova për të atin, si e kisha njohur, ndërsa ajo ndau me mua si me një mik të babait, merakun për të, që vazhdonte të punonte fort, pavarësisht nga vitet, që kishte mbi vete.

Çfarë miqsh të mirë kemi ne shqiptarët! Na takon të dimë t'i duam dhe t'i mbajmë afër; ata mbesin një pasqyrë e rrallë që na dëshmon përpara botës, por shpesh edhe përpara vetes sonë, për vlerat e rralla që trashëgojmë.

STAMBOLL - NJOFTOHET VDEKJA E NËNË TEREZËS

Në ditën e fundit të gushtit të vitit 1997 dhe në atë të pestën e shtatorit, pra brenda gjashtë ditëve ndodhën dy ngjarje shumë të trishtueshme për mbarë njerëzimin:Vdiqën njëra pas tjetrës Lady Diana dhe Nënë Tereza.

Konsullata jonë si të gjitha misionet diplomatike shqiptare, hapi dyert dhe librin e ngushëllimeve për të gjithë ata që e ndjenin dhe e dinin se Nënë Tereza ishte me origjinë shqiptare.

Po të njëjtën gjë kishte bërë edhe Konsullata e Indisë, pasi dihej nga të gjithë se ajo ishte shtetase e atij vendi.

Shkova për të shprehur ngushëllimet te Konsullata e Përgjithshme e Indisë në Taksim. Si edhe ne, indianët kishin vënë një foto të bukur të Nënë Terezës në fund të një tavoline, me shirit të zi diagonal në cepin e kornizës dhe një pendë e bojë përpara një libri të madh përshtypjesh. Nënë Tereza dukej sikur të vështronte me ata sytë e saj të ëmbël e të zgjuar ,me kokën e mbuluar me shallin e bardhë me shiritat e misionit të saj, bardhë e blu. U përkula përpara saj me nderim. Shkrova me kujdes një dedikim për bijën shqiptare që na kishte zbardhur faqen.

Meqenëse marrëdhëniet me Kryekonsullin indian, z. Harish Dogra, i kisha shumë të mira dhe për faktin se që të dy po nderonim të njëjtën figurë emblematike botërore, ai më ftoi në zyrën e tij dhe zhvilluam një bisedë prej miqsh, që ndajnë të njëjtën konsideratë për të ndjerën. U ndamë me premtimin se ai nuk do të vononte e të vinte për të bërë të njëjtin ritual në Konsullatën Shqiptare. Konsullata Indiane në Stamboll në atë kohë ishte në një ndërtesë midis Hotelit "Divan" dhe Hotelit "Hilton", jo më larg se dy kilometra nga e jona.

Telefonatë nga ish-Presidenti Berisha nga Tirana për pjesëmarrje në homazhet për Nënë Terezën, në Kalkuta

Sapo dola nga Konsullata Indiane dhe po hipja në makinë tingëlloi zilja e celularit. E ngrita menjëherë dhe, në anën tjetër të telefonit, dëgjova zërin e Presidentit të Shqipërisë, i cili me atë tonin e rëndë prej burri, pasi më përshëndeti, më tha: "Si mund të bëj të marr një vizë indiane për Kalkuta? Dua të shkoj të marr pjesë në varrimin e Nënë Terezës, mirëpo nuk kemi asnjë mision diplomatik indian më të afërt se Stambollin".

"Oh, po unë sapo dola nga Kryekonsullata Indiane," - iu përgjigja. "Më duhet të lidhem me Kryekonsullin dhe ju përgjigjem menjëherë. Po kur do të udhëtoni Ju?"

"Nesër pasdite në orën 3 duhet të nisem nga Rinasi për në Kalkuta, via Lufthansa nëpër Frankfurt, sigurisht, nëse mund të siguroj vizën".

"Oh, çfarë situate! Po si të bëjmë për ta pasur pasaportën këtu, edhe nëse këta e japin vizën pa asnjë hezitim?", i thashë.

"As unë nuk e di, - ndjeva tek më tha, - por më duhet të shkoj".

"Mirë, i thashë, lërmëni të merrem unë me këtë punë".

Hipa në makinë dhe fillova të bëj planin. Ishte mbasdite. Pasaporta ishte në Tiranë. Udhëtimi fillonte nga Tirana për Frankfurt dhe më tej për Kalkuta, të nesërmen. Zyra konsullore indiane dhe unë ishim në Stamboll. Po çfarë rregullash konsullore kishin indianët? Më duhej që, më së pari, të sqaroja këtë. Pra më duhej të thërrisja në telefon z. Harish Dogra.

Ashtu bëra. Ai u habit pasi sapo ishim ndarë. I tregova për problemin që kisha. Ai më mirëkuptoi dhe më kërkoi që të kthehesha dhe ta bisedoja çështjen me të në zyrë. U ktheva menjëherë. I shpjegova për shumë gjëra, por theksin e vura te fakti që aplikanti ishte vetë ai që i kishte dorëzuar Nënë Terezës pasaportën dhe medaljen më të lartë që akordon shteti shqiptar. Ndonëse sipas ligjeve të shtetit të tij, rregullat konsullore e ndalonin rreptësisht dhënien e vizës, pa praninë fizike të aplikantit, ai më premtoi se në momentin kur do të vinte pasaporta, viza do të stampohej menjëherë në faqen e saj.

Tani mbetej të koordinoja sjelljen e pasaportës në Stamboll dhe kthimin e saj në Tiranë, në kohën e duhur. Kjo punë bëhej me Elita Alon, vajzën e

mrekullueshme nga Prizreni, e cila menaxhonte zyrën e Albanian Airlines, që fluturonte nga Tirana në Stamboll dhe nga Stambolli në Tiranë.

I tregova si ishte puna dhe më tha se të nesërmen kishte fluturim nga Tirana për Stamboll. Avioni arrinte në orën 13:00 dhe pasi ndërronte udhëtarët, në orën 14:00 me orën vendore të Stambollit, kthehej për Shqipëri. Pra, kishim vetëm një orë kohë dhe, nëse avioni nuk vonohej, ai mund të arrinte në Rinas, në kthim, saktësisht në orën kur avioni tjetër nisej për në Frankfurt. Kjo për shkak të diferencës së orës vendore midis dy vendeve. A do t'ia arrinim që brenda një ore të merrnim pasaportën nga avioni, ta sillnim në qendër të Stambollit, ta stamponim vizën dhe ta kthenim përsëri në aeroport?

Ky dukej mision i pamundshëm.

Mos u dorëzo! E pamundshmja bëhet e mundshme, kur ka vullnet, thashë me vete!

Më duheshin të paktën një kohë prej 1 orë 30 minutash, prej të cilave, sikur çdo gjë të shkonte perfekt, 80 minuta duheshin për trafikun aeroport - qendër - aeroport. Mbeteshin vetëm 10 minuta për parkimin, shkallët, stampimin e vizës, kthimin në makinë…

Pasi i ujdisa të gjitha gjërat me Konsullatën Indiane dhe me Albanian Airlines, telefonova në Tiranë dhe kërkova që pasaporta e mbyllur në një zarf t'i dorëzohej një personi, që i dhashë emrin nga personeli i avionit dhe po ai person, do ta kthente atë në Tiranë.

Sa rrezik kishte ky akt po ta merrje mbi vete? Po a ka gjë të bukur që kryhet pa mundim, stres, rrezik dështimi? Jeta më ka mësuar se nuk ka. Përndryshe nuk bën dot gjë, nuk fiton kurrë. Pra, po merrja rrezikun e anullimit të një udhëtimi aq kuptimplotë!

Të nesërmen u nisa për në aeroport bashkë me Elitën, me merakun se a do të arrija të realizoja diçka, që do të mbetej në kujtesën time tërë jetën. Diçka për Nënë Terezën. Prandaj iu luta edhe vetë Nënë Terezës që të më ndihmonte!

7 shtator 1997 - Aeroporti "Ataturk" i Stambollit

Aeroplani erdhi pa vonesë. Me Elitën u futëm nga dyert e sigurimit të aeroportit. Hipëm në makinën e shërbimeve të brendshme që na priste. Arritëm shumë

shpejt tek avioni. U ngjitëm dhe njeriu i parë që do të takonim ishte stjuardesa. Ajo sapo u shfaq, i tha Elitës: "Kam një porosi për ty". Ishte e qartë që ajo nuk e dinte se brenda në atë zarf kishte një pasaportë të një njeriu shumë të rëndësishëm. E morëm zarfin dhe, ndërsa Elita duhej të kujdesej për ndërrimin e pasagjerëve dhe për "mosikjen" e avionit, unë duhej të shkoja në qendër të Stambollit, të merrja vizën dhe ta sillja pasaportën të vulosur nga Konsulli Indian para se të nisej avioni për Tiranë.

Çfarë aventure! Gjërat shkonin në kohë dhe në hapësirë në një mënyrë që rrezikonin të përplaseshin dhe një mision kaq fisnik që mund të bënte që marrja e vizës të mos kishte asnjë rëndësi, nëse kthimi i pasaportës nuk bëhej në kohën e duhur në Tiranë.

Kështu nxitova atë ditë shtatori drejt qendrës së Stambollit tek sheshi Taksim.

Në Konsullatën e Përgjithshme Indiane në Taksim

Arrita në Konsullatën Indiane brenda 35 minutave. I ngjita shkallët me vrap. Përpara meje ishte një Konsull me turbanin indian mbështjellë rreth kokës. Ia dhashë pasaportën. Shefi i tij, Harishi i kishte dhënë porosi dhe shpjeguar për rëndësinë që kishte ajo vizë.

Indiani me turban e mori pasaportën në dorë dhe po e vështronte sikur të ishte hera e parë që shihte një dokument udhëtimi. Pastaj u ngrit ngadalë, mori disa gjëra nga dollapi, stampa, vula, bojëra, i vuri përpara dhe i rregulloi në tavolinë me një qetësi irrituese.

Unë po e shihja me aq padurim dhe me aq nxitim sa i thashë dy tri herë:

"Të lutem nxito pak, të lutem!"

"Me ngadalë", - ma ktheu indiani, - "me ngadalë, zotëri. Këto punë duhen bërë mirë. Ne kemi oficerë emigracioni të tillë në Indi, që të kthejnë mbrapsht, po qe se viza nuk është lëshuar në rregull. Dëshironi që ta kthejnë ata?"

"Po mirë, bëje në rregull, por bëje më shpejt, të lutem!" - ia ktheva.

"Mos u mërzit do e bëjmë, por do ta bëjmë shumë mirë".

"Ohu, - thashë me vete, - T'i bërtas një herë fort? Por jo, kështu do e prishja fare".

Edhe një herë, rregulloi turbanin, rregulloi ca qime, që i kishin dalë jashtë dhe filloi nga puna.

Hapi faqet e pasaportës një nga një dhe pa se kishte shumë viza. Bëri nja dy pyetje dhe më në fund e vulosi vizën.

"E ke gati", - më tha.

"Vërtet, - i thashë. -Vërtet? Tani mund të hyjë në Indi me këtë vizë, apo jo?".

"Po" - ma ktheu me një pamje shumë indiferente. Mua m'u kujtua Raxh Kapuri, të cilit ai i ngjante aq shumë.

Unë tanimë e kisha kryer pjesën e parë të angazhimit tim. E rrëmbeva pasaportën, e futa në xhep, zbrita shkallët me shpejtësi, hipa në makinë dhe pas 35 minutash isha në aeroprt.

Isha brenda caqeve të pranueshme të vonesës së avionit si dhe minutazhit që i kisha caktuar vetvetes. E mbylla pasaportën në një zarf tjetër. Elita u ngjit në avion, i dha zarfin e mbyllur stjuardesës bashkë me porosinë. Ndërsa unë u ktheva në Stamboll. Pas dy orësh mora një telefonatë nga Tirana:

"Çdo gjë në rregull, faleminderit!".

Të nesërmen pashë në CNN dr. Sali Berishën tek bënte homazhe pranë arkivolit të Nënë Terezës, asaj që i ishte mohuar atdheu deri në vitin 1991. Por kohët kishin ndërruar dhe ajo si kristiane i kishte falur gjithë fajtorët.

U ndjeva i çliruar, sepse kisha bërë edhe unë diçka në shërbim të Asaj, që do të ishte edhe e para shenjtore shqiptare.

DITËT E FUNDIT NË STAMBOLL!

Si çdo punë tjetër në jetën e njeriut, edhe puna e diplomatit, në një vend të caktuar, e ka një fund. Të shumtën e herës diplomatët shkojnë duke qeshur në detyrën e re, por kthehen të mërzitur. Kjo të paktën vlen për ne në Shqipëri. Shërbimi prej afro pesë vjetësh në Stamboll, 1992 - 1997 ishte i mbushur me shumë arritje, suksese, ngjarje, njohje me njerëz të mirë, vështirësi, por edhe halle familjare dhe shqetësime për ato që kishin ndodhur në Shqipëri. E prapëseprapë ishte gjëja më normale që, pasi ke bërë më të mirën për vendin tënd, të kthehesh dhe të presësh se çfarë do të ofrojë "fati" për të ardhmen.

Kështu do të ndodhte edhe me ne.

Po vinte momenti që të largoheshim!

Raporti përfundimtar i punës në Stamboll

Gjatë tërë kohës që shërbeja në Stamboll, mbaja shënime të rregullta për çdo takim me individë të shquar të bashkësisë shqiptaro – turke, për njerëz të shquar të shkencës, artit, muzikës, politikës, biznesit, arsimit. Në të vërtetë, jashtë vemendjes sime nuk kalonin jo vetëm njer*ëzit që kishin bërë emër, figurat e shquara his*torike dhe bashkëkohore, por edhe njerëz të zakonshëm, të thjeshtë. Më printe parimi që pas çdo qenie njerëzore fshihet një histori. Këtë raport përfudnimtar e dorëzova në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe u botua në shtypin e kohës në Tiranë.

Refuzimi i një ftese bujare ofruar nga z. Hayri Içli Kelmendi: Ditët e fundit në Stamboll.

Me Hayri Içli Kelmendin, të cilin e kam përmendur edhe më parë, do të na lidhte jeta edhe më shumë sidomos në vitin 1997. Ngjarjet e atij viti sollën trazira të mëdha në Shqipëri. Pas tyre ra njëfarë qetësie në Tiranë. Në gushtin e atij viti, kur u rivendosën institucionet e dala nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të atij viti, pranova një thirrje telefonike nga Hayri beu. Pasi më përshëndeti më kërkoi të shkoja dhe të pinim një kafe në zyrën e tij.

Nuk e zgjata dhe shkova shpejt. Si përherë ai ishte i sjellshëm, bujar, xhentil, i qeshur dhe shumë energjik. Më qerasi si zakonisht me kafe dhe çokollata. Folëm pak për gjëra të zakonshme. Pastaj, pas një psherëtime të lehtë, më tha:

– Si duken punët me ty, pas këtyre ndryshimeve? Do të vazhdosh edhe më tej apo do të kthehesh në atdhe?

– Jo, - i thashë, - unë do kthehem në atdhe, pasi edhe pa këto ndryshime e kam mbushur kohën për t'u kthyer. Kështu që pres vetëm urdhërin.

– Po mirë, - më tha, - nëse nuk e ke me aq shqetësim, mirë qenka. Është normale, apo jo? Por a mund të pyes, çfarë të pret në Tiranë, a e ke punën të sigurt kur të kthehesh?

Unë bëra një pauzë dhe i thashë me të qeshur:

– Kjo është çështje tjetër. Por unë do të kthehem!

Ai u përtyp pak dhe më tha:

– A dëshiron të rrish në kompaninë time? Punësohu këtu dhe do të të kem pranë. Për shumicën e gjërave kujdesem unë.

– Jo, - i thashë rrëmbyeshëm, këtë nuk e bëj kurrë! Këtë nuk e bëj kurrë, i thashë përsëri, prerazi. Kam përfaqësuar vendin tim me dinjitet dhe nuk mund të pranoj status tjetër në këtë vend.

E pashë që isha pak i prerë, por Hayri beut duket se i pëlqeu vendosmëria ime. Atherë, më tha:

– A do më bësh një nder? Kur të vijë urdhri për t'u kthyer, do të më njoftosh menjëherë.

– Po, i thashë, patjetër që do të njoftoj. Si mund të mos të njoftoj unë ty?!

Ai nxori një kartvizitë, në të cilën kishte të shkruar disa numra telefoni dhe

nënvizoi njërin prej tyre. Ishte një numër me një kod shtetëror +49. Gjermania. Unë e pashë i habitur, por ai më sqaroi menjëherë:

– Ky është numri im celular në roaming. Ju e dini, që unë udhëtoj shumë. Por me këtë numër më gjen kudo që të jem, në gjithë Evropën. Më telefono këtu dhe do të më gjesh 24 orë në shtatë ditë të javës. Mos harro, - më tha, dhe shtoi: - Ju konsujt e Shqipërisë na keni krijuar një traditë jo të mirë këtu në Stamboll. Vini, miqësoheni me ne, gëzojmë bashkë, bëjmë veprimtari, iu presim e përcjellim dhe… kur vjen puna që të ktheheni në atdhe, nuk na thoni as lamtumirë. Kjo duhet ndryshuar. Prandaj nuk do të ikësh si të tjerët. Nuk do ikësh i zemëruar! Mirë? Nuk do ikësh pa një mbrëmje lamtumire. Mirë? Ju keni kaq shumë miq e shokë, vëllezër e motra shqiptarë, diplomatë, konsuj, bashkatdhetarë, miq turq e të huaj… Si do të ikësh ti pa një lamtumirë?

Fillova të përtypesha dhe t'i shpjegoja se kjo do të ishte mirë por… nuk ka buxhet të tillë të planifikuar dhe se pa të nuk mund të bëhet ajo që do të dëshironim. Hayri beu m'u kthye menjëherë:

– Po pse nuk e di unë këtë? Kur të thashë pata parasysh çdo gjë. Do të merrem unë me këtë punë. Ti vetëm më trego kur të vijë urdhri. Me trego datën dhe sa vetë dëshiron të thërrasësh. Nuk ke limit. Sa të dëshironi ju. Vetëm mos ik pa lamtumirë, të lutem! Besa - Besë?

I thashë po, ndonëse u ndjeva si në turp. Por edhe të ikja nga ai qytet ku kisha njohur aq shumë njerëz, pa një lamtumirë nuk bënte. Aty kisha shqiptarë, që më kishin dashur e i kisha dashur me shpirt. Kisha ndarë brengat me ta, si edhe dashurinë dhe gëzimin. Kështu u ndamë atë ditë. Nuk vonoi shumë dhe erdhi urdhri. Tani duhej të bëhesha gati të largohesha nga Stambolli.

Drejt Tiranës...

…Ditët e ndarjes me detyrën për diplomatët janë të vështira. Një zhvendosje ose rivendosje sjell përherë disa trauma, të cilat njerëzit që nuk e kanë përjetuar këtë shërbim, nuk i njohin. Dokumente, dorëzime, paketime, ndarje me njerëzit, lamtumira, ndonjë porosi e pakryer dhe mbi të gjitha… fëmijët, shkollat e tyre etj.

Urdhri për kthimin tim në atdhe erdhi më 31 gusht 1997. Atë natë kishim për darkë në shtëpinë tonë tre artistë nga Tirana, të cilët morën pjesë në një konkurs të muzikës *bel-canto* në Stamboll. Ata ishin shumë të lumtur për këtë pjesëmarrje, të cilën ua kishte mundësuar konsullata. Mbaj mend që njëra prej atyre sopranove quhej Lindita Hisku nga Sukthi i Durrësit, tjetra ishte Oriana Kurteshi dhe një djalosh simpatik lezhjan, i quajtur Izet Salihi. Artistët ishin shumë të lumtur dhe ne po bënim shumë humor, këndonim dhe kthenim nga një gotë.

Në mesnatë, bëra zakonin e përhershëm: Shkova tek zyra e cila ishte një kat më poshtë dhe kontrollova faksin nëse kishte ndonjë mesazh apo njoftim. Po. Kishte. Ishte urdhri i kthimit tim në atdhe. U ktheva në apartamentin tim dhe me letër në dorë iu drejtova artistëve:

– Po ju paskeni sjellë sihariq! Do kthehemi bashkë, atëherë. - Qesha me të madhe, ndërsa ata kur e morën vesh u brengosën thellë.

Të nesërmen fillova përgatitjet për largimin dhe, natyrisht, më së pari e plotësova amanetin. Thirra në telefon Hayri beun. Pas dy tri zileve të telefonit, zëri i tij erdhi i qartë, i plotë dhe i qetë, por me një ton, sikur të dinte çdo gjë që kishte ndodhur.

– Hë, - më tha, a erdhi ai urdhri?

– Po, Hayri bej, - i thashë.

– Epo, me hajër, - më tha. - Të kam thënë, nëse dëshiron të rrish, je i mirëpritur. Përndryshe, të lutem, shkruaji këtë numër telefoni të një zotërie të quajtur Selxhuk bej.

Ai më dha numrin e telefonit, emrin e Hotelit "Grand Haliç", pronar i të cilit ishte ai vetë dhe më këshilloi t'i jepja atij numrin e njerëzve, që do të priteshin në recepsion, datën dhe orën kur dëshiroja unë.

– Për të tjerat, - më tha, - përgjigjet Selxhuk bej. Detyra jote është kjo që të thashë.

Oferta e Hayri beut ishte aq bujare dhe aq fisnike sa ishte e vështirë ta refuzoja.

Meqenëse më 21 shtator 1997 duhej të largohesha, vendosa që mbrëmjen e lamtumirës ta bëja një natë para largimit. Telefonova Selxhuk beun. Ai ishte në dijeni të çdo gjëje. Më ftoi për një çaj dhe shkova. Për çdo gjë ramë dakord. Ishte ai që më propozoi menunë, pijet, shërbimin, lulet…

Hayri beu kishte atë kohë në menexhim 28 hotele, të cilët gjendeshin që

nga Beyogly në Stamboll deri në Antalia. Unë kisha pasur rastin edhe më parë të shijoja bujarinë e tij në hotelin "Grand Haliç", i cili ishte një hotel me katër yje, shumë i lezetshëm.

Bashkë me vitet e punës aty, kisha lënë një dëshirë të madhe për t'u kthyer dhe takuar ata njerëz, me të cilët tani më priste lamtumira. Dhe që të ndodhte kjo, Hayri beu kishte menduar deri në detaje.

Lulet e lamtumirës

Atë natë të 20 shtatorit 1997, në hotelin "Grand Haliç" erdhën shumë mysafirë, diplomatë, konsuj, miq, bashkatdhetarë, intelektualë, gazetarë… Salla ishte e dekoruar me shumë lule. Në ballë qëndronte ajo e Ten Tour - it. Pastaj "Turkler Naklyat Firmasi", "Ipek Tur", shoqatat shqiptare, individë. Ishte një dekorim, që e kisha parë edhe në pritjen e mirëseardhjes dhe po e shihja tani në atë të lamtumirës.

Mbrëmja ishte emocionale, e bukur. U takova me shumë miq atë natë për t'iu thënë lamtumirë! Shumë prej tyre nuk i kam takuar më. Me shumë prej tyre i ruaj lidhjet edhe sot nëpërmjet të rrjeteve sociale, telefonave, e-maileve.

Fjalimin kryesor e mbajti kryetari i shoqatës "Vëllazëria Shqiptaro - Turke", Halil Metin, pastaj sekretari Celalettin Őlmezcan. Më pas foli një intelektual i shquar shqiptaro - turk, nga familja e mbretit Zog, Ergün Zoga, shkrimtar dhe publicist shumë i njohur. Në mbrëmje merrnin pjesë shumë konsuj, ndër të cilët nuk harrohet arbëreshi, diplomat i Konsullatës Amerikane në Stamboll, Michael Garrote dhe anglezja e natyralizuar si turke Jacky - Sema Pezakoglu. Ishte një mbrëmje e paharrueshme e mbushur me fjalë të ëmbla, mallëngjim për ndarjen, dhurata të vogla, por shumë simbolike dhe kuptimplote.

Ajo mbrëmje nuk ishte vetëm një lamtumirë, por ishte edhe një provë e miqësisë, dashurisë, afinitetit që njeriu duhet të krijojë, që diplomati duhet të ndërtojë me miqtë e Konsullatës ose Ambasadës, por natyrisht duke përdorur tërë aftësinë dhe mirësinë që duhet ta karakterizojë.

Të ndaheshe nga shqiptarët e Stambollit

Ndarja nga vëllezërit shqiptarë të Stambollit ishte vërtet "e vështirë". Aty ishin atë natë baca Enver Tali, Nevruz Çarkaxhiu, doktor Veton Hoxha me zonjën e tij Vjollca, Jusuf Jusufi me Naxhen e dashur, Njazi Saracoǧlu, dr. Armend Spahia dhe dr. Armend Agolli, Elita e Agron Alo, Flutura dhe Julian Hivzi, mësuesja veterane Zana Baroni - Harxhi e doktor Zefir Harxhit, vëllezërit Raif e Veli Terziu, vëllezërit Sabeddin e Kadri Turker, Ingj. Nahit Bejtullahu dhe Vilma, bijë e familjes së Nënë Terezës. Aty ishte gazetarja Yasemin Dobra Manço, me të shoqin Hilmiun, i biri i Arnavut Ahmetit siç e thërrsinin turqit, gazetarja Ilana Navaro. Po si të ndahesha nga anëtarët dhe drejtuesit e shoqatave shqiptaro - turke, ishin plot 18 të tilla, të cilat i kisha ndihmuar që të themeloheshin dhe të ushtronin veprimtarinë e tyre!

TELEFONATA E FUNDIT NË STAMBOLL DHE NJË LEGJENDË TIPIKE SHQIPTARE

Në mëngjesin e 21 shtatorit 1997, kur sapo bëhesha gati t'i dorëzoja çelësat e zyrës, kolegut tim Ilir Tufa, ra zilja e telefonit. Në fillim pata mëdyshjen, nëse duhej ta merrja apo jo, pasi unë që nga ai çast nuk isha më një përfaqësues i shtetit, por thjesht një njeri që po kthehesha në atdhe, pa e ditur mirë se çfarë më priste. Instinktivisht e kapa telefonin, sikur ta dija se dikush donte të më jepte një lamturmirë sa të gëzueshme aq edhe emocionuese: Ishte një zonjë e familjes shqiptare, Iliazi, nga Selçuku i Izmirit. Ajo më njoftoi se Roland Evans do të vinte në Turqi dhe në planet e vizitës së tij ishte edhe një takim me mua, në Konsullatën Shqiptare në Stamboll.

Ishim "njohur" si në një legjendë tipike shqiptare

Në morinë e punëve të konsullatës, më kishte dalë edhe një "punë e re". Një ditë mora një letër bashkë me një artikull të botuar në gazetën ILLYRIA të New York - ut, të botuar nga kryeredaktori i saj, zoti Vehbi Bajrami. Bashkë me mirësjelljen tipike që e karakterizon atë burrë, ai më lutej të interesohesha për të gjetur, nëse ishte e mundshme, një familje shqiptare, e cila ishte vendosur në Turqi, diku nga viti 1930. Të dhënat për familjen ishin mjaft të pakta. Historia e asaj familje ishte e tillë:

Omer Iliazi ishte një djalosh shqiptar, i cili kishte vajtur në Amerikë pas Luftës së Parë Botërore. Atje ai kishte ndërruar emrin dhe ishte bërë George Ogio Evans dhe ishte martuar me Rose Le June, një franko - kanadeze në Luiziana. Bashkë kishin lindur dy djem, Rolandin dhe Floydin.

Ai kishte punuar si kuzhinier. Përpjekja për të bërë një jetë sa më të mirë me punë të ndershme nuk i kishte dhënë shumë mundësira të merrej me edukimin e fëmijëve të vet me ndjenjat e identitetit shqiptar. Vitet dhe dhjetëvjeçarët kishin kaluar dhe tani, në periudhën kur dy djemtë e tij po plakeshin, ishin vënë në kërkim të origjinës së tyre shqiptare dhe lidhjeve me njerëzit e mbetur në atdheun e të atit.

Ata kishin rënë në adresën e gazetës ILLYRIA dhe kishin filluar të interesoheshin intensivisht për të gjetur lidhjet e veta, të cilat mund t'i kishin në Shqipëri ose në Turqi. Midis shumë letrave, që ata nuk mundeshin t'i lexonin, pasi ishin në shqip dhe fotografive që babai i tyre kishte shkëmbyer me vëllezërit, gjendej edhe një letër e shkruar nga Nevruzi, më 16 mars 1931. Ndër të tjera ai i shkruante vëllait:

"Me këtë rast pra vij i malluarë dhe ju puth me ngashërime, të cilat vijnë prej një periudhe të largët. Janë gati 17 vjet, që nuk kemi pasur okazion të çmallohemi. Siç dihet neve, vëllezër të lerë nga një skëth nuk mbahemi mënt dhe nuk na kujtohet as fizionomi e njëri tjetrit; gjë e cila rëndon më shumë në trupin tim, që në atë kohë për fat të keq jam ndodhur fare në moshë të vogël, që nuk ua kam në hatër pamjen… Hesati po bën 7 vjet, që ka ikur e ndodhet në Turqi. Gjithashtu edhe mëma po bën gati një vjet që edhe ajo ka vajtur tek Hesati. Këtu në Shqipëri kam mbetur unë si ushtar, në të cilën po bëj gati 19 muaj nën armë këtu në Tiranë, të cilën e quaj një dhurim nga Zoti qëkurse unë arrita në këtë ditë e t'shërbej Atdheut të shtrenjtë Mëmës SHQIPE dhe MBRETIT tonë të dashur. Të cilën dhembshuri ma jep dhe forcon më shumë kur unë mendohem dhe kujtoj kohërat dhe SHEKUJT e kaluem, kur MËMA SHQIPE gjindesh nën prangat e të huajve dhe Prindërit tanë shërbenin nëpër botë si në JEMEN etj."

Këto fjalë dhe të tjera në vijim të letrës ishin prekëse. Ishin tre vëllezër, Omari i bërë George, në Amerikë, Hesati në Turqi ndërsa ushtari i mbretit, Nevruzi, në Tiranë.

Më 23 janar 1934 Nevruzi, me sa duket kishte shkuar në Izmir të Turqisë dhe i shkruan vëllait, Omerit, një letër në Amerikë në të cilën i thotë:

"Shumë kohë nuk jemi marrë vesh, i dashur vëlla. Jemi bërë shumë merak për shëndetin tuaj dhe të lutemi shumë posa të marrësh këtë letër na lajmëro një orë e më parë. Duam të na shkruash gjatë e gjerë si je, si shkon, si është puna atje?"…

Nga e njëjta adresë, pak më vonë, niset një letër e shkruar me dorë nga nëna e vëllezërve Iliazi, Shefzija. Ajo në atë kohë e dinte se i biri në Amerikë ishte martuar dhe kishte një fëmijë: Ronaldin. Ajo i lutej Zotit, që t'i falte të birit edhe fëmijë të tjerë dhe e përfundon letrën me fjalët:

"Të kesh uratën e Zotit, bir, mos na harro!"

Kjo letër e fundit dhe adresa dërguese më bëri të vihesha në kërkim të njerëzve të afërm të Iliazëve në Turqi.

Thirra në telefon një djalë nga Peja, shtetas turk, zotin Menan Gashi - Aksoy. I shpjegova si ishte çështja dhe ai më premtoi se do të interesohej nëpërmjet një mikut të vet turk, që jetonte në Izmir, Muhamer Izmit. Ky i fundit vajti te vendi me adresën e vitit 1934, që i dhashë. Shndërrimet e jashtëzakonshme të Turqisë moderne e kishin fshirë nga faqja e dheut atë vendbanim dhe mbi të ishte ndërtuar një kompleks i ri, shumë i madh. Por, ajo Turqia që ne nganjëherë e themi me ironi, "dava turke", nuk është vërtet e tillë. Administrata turke e asaj kohe punonte një milion herë më mirë se e jona sot në kohën e digjitalizmit google të adresave. Neve sot na duhet të postojmë një letër me adresë dërguese, pa numër shtëpie, nganjëherë as emër rruge dhe na duhet të shkruajmë se jemi diku pranë një objekti të njohur. Kjo ndodh edhe në kryeqytet. Më shumë se "dava turke" kjo e jona është "arnavut meselesi", siç na thonë neve turqit.

Por le të kthehemi te historia në fjalë. Muhamer Izmitit i thotë administratori i kompleksit të ri, të ndërtuar në atë bllok të madh banesash në Izmir, se të gjitha të dhënat e banorëve të zhvendosur nga një vend në tjetrin, për çfarëdo lloj arsyeje, mbarten nga gjendja e vjetër civile tek ajo e reja, duke i ruajtur ato me kujdesin më të madh. Kështu që ai djalë turk shkon në gjendjen civile dhe gjen që familja e Iliazajve kishte ikur nga shtëpia e vjetër në një banesë tjetër, jo më në Izmir, por në Selçuk, pranë qytetit të lashtë të Efesit. Në rregjestrin e emrave dhe adresave ai gjeti edhe numrin e telefonit të familjes dhe e përcolli tek unë, në Stamboll.

Sapo mora të dhënat, puna e parë që bëra thirra në atë numër telefoni, që më kishte dhënë Muhameri. Pas tri zilesh, telefonin e mori dikush dhe u përgjigj:

Efendem!

Unë menjëherë i fola në turqisht.

Ben Arnavutluk Cumhuriyeti Istanbul Başkonsolosu!

Në mënyrën më të papritur, zëri i një gruaje në anën tjetër të linjës m'u kthye në gjuhën shqipe.

"Po qëkurse qenkërke Başkonsolosluku i Cumhuriyetit të Shqipërisë zotrote, përse nuk e flet gjuhën e sat'ëme..!?

Unë mbeta si në faj dhe i thashë se nuk e pandehja, që dikush do të më fliste shqip, por tani që po komunikonim në gjuhën tonë, do t'ia tregoja përse e thirra në telefon.

Kështu i tregova për vëllezërit Evans në Luisiana të Shteteve të Bashkuara. Doli që ata ishin pikërisht njerëzit që Rolandi dhe Floydi i kërkonin mikut tim Vehbi Bajrami. Sapo mbarova bisedën, u ula dhe i shkrova me shumë gëzim z. Bajrami:

"Kërkesa dhe shkrimi juaj në "ILLYRIA" më nxiti që të përpiqem për zgjidhjen e enigmës ose bashkimin si në legjendë të këtyre njerëzve që s'janë veçse një hap larg nga gjaku me njëri-tjetrin, por të ndarë prej dhjetëra vitesh, duke patur në mes oqeane e kontinente… Ky akt që kreva, duke i gjetur të afërmit e Evansëve, ka simbolikën e bashkimit, kthimit te vatra, mos-harresën.

Jemi në dy skaje të ndryshme të botës, mjaft larg, por na bashkon diçka tejet e rëndësishme, përveç gjakut. Kemi thuajse të njëjtin mision: Të gjejmë sa më shumë lidhje të përbashkëta me vëllezërit tanë, kudo që janë. Sa e sa ndarje kam parë e përjetuar këtu! Janë me mijëra, e pse jo, dhe miliona shqiptarë, që kanë lënë vatrat e tyre, pra edhe mijëra e miliona ndarje. Secila ndarje ka dramën e vet, dhimbjen e vet, historinë e vet. Por jo të gjitha kanë edhe bashkimin e vet.

Një adresë e thjeshtë e viteve '30 ishte ajo që më dha mundësinë të kapja fillin e ekzistencës së familjes së Hesatit dhe Nevruzit. Ata tashmë nuk jetojnë, por kanë lënë fëmijët e tyre, njëri gjashtë e tjetri katër. Edhe ata dëshironin t'i gjenin të afërmit e tyre, Evansët. Në të vërtetë biseda me një anëtar të asaj familje, në një shqipe të ruajtur në dialektin toskërisht, ishte një befasi e rrallë".

Ajo telefonatë e atij mëngjesi pra, e fundit në atë detyrë, vinte nga e njejta zonjë nga Selçuku, e cila dëshironte të më takonte bashkë me Roland Evans në Stamboll.

"Oh", psherëtiva, "kjo do të ishte një dëshirë shumë e madhe edhe për mua, por kjo është Legjenda Shqiptare e Ndarjes. Unë po kthehem në Shqipëri pasi detyra ime këtu ka mbaruar."

E mbyllëm bisedën me mall.

U ndamë dhe kurrë nuk u pamë!

Zbrita shkallët dhe u nisa për në Ferikőy për t'i lënë lamtumirën edhe varrit të Sami Frashërit.

Edhe një homazh te varri i Sami Frashërit në Ferikőy - Stamboll

Varrin e Sami Frashërit në Ferikőy e kishim vizituar bashkë me Orhan beun (Kryekonsulli i mëparshëm) dhe personelin e konsullatës dhe dërgonim lule me rastin e datëlindjes së tij më 1 qershor, pothuajse çdo vit. Vajtja te varri i Samiut dhe te varri i të birit, Ali Sami Yen ishte kthyer në një lloj rituali dhe madje detyrimi për ne. Samiu ynë, të cilin turqit e thërrasin Shemsedin Sami, konsiderohet si themeluesi i Enciklopedisë Turke, filozof i madh dhe intelektual i jashtëzakonshëm. Për ne ai është rilindasi, që përvijoi doktrinën e të ardhmes së Shqipërisë, jo vetëm pa sundimin otoman, por edhe si shtet modern, i ngjashëm me Zvicrën. Eshtrat e tij, ndryshe nga vëllezërit tjerë, turqit nuk i lejuan kurrë që të silleshin në Shqipëri.

Në largimin përfundimtar nga Stambolli, bëmë një shmangie të rrugës, nga konsullata në rrugën Hüsref Gerede Caddesi, Ekmek Fabrikasi Sokak të Nişantaşisë dhe morëm rrugën për te varrezat në Ferykőy, atje ku gjendej varri i Samiut dhe të birit, Aliut. Vendosëm nga një lule mbi varret e tyre, i nderuam dhe iu lamë lamtumirën, ndoshta për të mos i parë më kurrë. Menjëherë dolëm në Çevreyőly (autobandi unazë i Stambollit) dhe u drejtuam drejt Trakës. Pas kishim lënë një fill të gjatë kujtimesh, që do të na lidhte gjithë jetën me atë vend. Ishte 21 shtator 1997.

Tekirdag - kolegji privat i Raif Terziut

Në kthim do të kalonim një natë në Tekirdag, aty ku na priste njëri nga atdhetarët më të mëdhenj shqiptarë që kam njohur. Ai më vonë u bë edhe Konsull i Nderit i Shqipërisë për zonën e Trakës. Ishte zoti Raif Terziu, shqiptar nga Ternovci i Preshevës, nga një familje shumë e madhe dhe e pasur. Familja

Terziu ishte pronare e Kolegjit Privat të Tekirdagut (Özel Tekirdağ Bil Temel Lisesi), në të cilin kishin ardhur të punonin katër mësues nga Shqipëria, Zana Harxhi, Flutura Ivziu, Shkëlqimi dhe Arturi. Ata jepnin gjuhën angleze bashkë me mësues nga Britania e Madhe.

Raif beu më "detyroi" ta lija djalin e vogël, Kreshnikun 12-vjeçar, në atë shkollë të paktën për një vit shkollor. Ai do të merrte përsipër të gjitha shpenzimet. Në mëngjesin e 22 shtatorit, bashkë me Kreshnikun shkuam te Kolegji. Shkolla i dha uniformën dhe ai u fut në klasë. Në moment u shndërrua në sytë tanë. Na u duk se ishte tjetër fëmijë. E puthëm, i lamë çfarë kishim mundësi dhe u ndamë.

Përmallim diplomatësh në ardhje dhe në ikje

Kur erdhëm në Stamboll, ishim katër vetë. Tani djali i madh, Erioni 17 vjeç, kishte shkuar në Amerikë, ndërsa i vogli, Kreshniku, mbeti në Tekirdag! Ne me një makinë "Audi", që e kisha blerë nga një gjerman, të cilën e kishte reklamuar në gazetë, për 500 dollarë, u nisëm për në Shqipëri. Në makinë kisha po atë televizor, që e kisha sjellë me vete nga Shqipëria në Stamboll, dhuratë e një miku kosovar nga Zvicra, rroba, suvenire, shumë albume dhe libra dhe një seri kasetash me muzikë të ndryshme. Ndër to edhe atë të një këngëtarje shumë të njohur turke që edhe ajo thuhej se kishte origjinë shqiptare, Nilüfer.

Një ndër këngët e saj më të pëlqyera për ne ishte një këngë e përkthyer nga frëngjishtja e quajtur "Prej së largu". Ishte një këngë, që na solli aq përmallim sa përherë e kujtojmë me dhimbje. Teksti i asaj kënge i shkonte thuajse fjalë për fjalë ndarjes dhe largimit tonë nga fëmijët. E dëgjuam në kabinën e makinës dhe nuk e fshehëm dot përlotjen. Ata tani do të ishin larg prej nesh. Afro pesë vjet më parë kishim shkuar të katër bashkë me ta, të vegjël si dy zogj, ndërsa tani… dallëndyshet fluturuan. Ishte një ditë sa emocionale, e dhimbshme, aq edhe krejt e natyrshme… Pas dy orësh udhëtim me makinë kaluam kufirin Turqi - Greqi, në Ipsalla. Një ditë e gjatë udhëtimi dhe natën vonë mbërritëm në Tiranë.

Që prej asaj kohe rrallë jemi mbledhur të gjithë bashkë. Kjo është jeta e diplomatit, me të mirat dhe vështirësitë e veta.

Lamtumirë, Stamboll!

KREU I DYTË

NË AMERIKËN MIKE PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS

1998 – 2000

Kryetemë:

Senatori Robert Dole u ngrit dhe duke mbajtur lapsin në dorën protezë, e përshkroi udhëtimin e tij një javor në Shkup. Ai foli për dëshmitë e shumta të barbarive serbe kundër shqiptarëve që kishte mbledhur atje, për shpërnguljen masive të popullsisë, vrasjet dhe torturat, jashtë syve të vëzhguesve të OSBE - së, ose siç quheshin në atë kohë, verifikatorëve. Ai u ndal te Milosheviçi dhe krimet e tij.

> *"Krimineli Milosheviç, - tha ai, - "duhet goditur ashpër, pa mëshirë dhe kështu do të mbrohej një popull, i cili po shkon drejt shfarosjes. Ai kupton vetëm një gjuhë; atë të tankeve dhe bombave".*

ME FORCAT E MIA DREJT AMERIKËS MIKE

Pas rreth dhjetë muaj qëndrimi pa punë nëpër Tiranë, më 4 korrik 1998, Ditën e Pavarësisë së ShBA-së, u ulëm bashkë me familjen time në Aeroportin "John F. Kennedy" në New York.

Tani nuk mbetej gjë tjetër veçse të vazhdoja jetën dhe punën në mënyrën time, por pa e harruar asnjëherë misionin që i kisha vënë vetes. Pas disa ditësh u takova me të nderuarin Joseph DioGuardi, me të cilin na lidhte një miqësi shumë e fortë.

Me Ligën Qytetare Shqiptaro - Amerikane në mbrojtje të çështjes së Kosovës

Në historinë bashkëkohore të shqiptarëve, njëri ndër njerëzit që ka kontribuar më shumë në çështjen tonë kombëtare është amerikani me origjinë arbëreshe, Joseph DioGuardi. Veprimtaria e tij në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare është shumë e njohur. Vlen të përmendet më së pari se ai ka shërbyer si anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve, nga Partia Republikane, nga viti 1985 deri në vitin 1989. Pasi u largua nga Kongresi dhe ishte njohur me situatën e shqiptarëve në Ballkan, përfshirë diktaturën komuniste në Shqipëri dhe përndjekjen e vazhdueshme ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, ai ndërmori veprime historike për të cilat ne shqiptarët duhet t'i jemi përherë mirënjohës: Ngritjen e çështjes së Kosovës në SHBA dhe në botë, si dhe ndihmesën ndaj proceseve demokratike në Shqipëri.

Ai bëri miq, të cilët ndikuan në mënyrë të jashtëzakonëshme në zhvillimet

demokratike në Shqipëri dhe në njohjen e çështjes së Kosovës, veçanërisht në Washington. Në të njëjtën kohë arriti që, në qarqet e rëndësishme lobiste në SHBA të bëjë të njohur një histori fisnike të fshehur për pesëdhjetë vjet: atë të mbrojtjes së hebrejve nga shqiptarët gjatë periudhës së Holokaustit.

Me krijimin e Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane, ai doli si lobist shumë i fuqishëm dhe efektiv, njësoj siç ishte "Vatra" më parë, e cila i doli zot Shqipërisë me parullën noliane:

"Mbahu nëno, mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë!"

Kjo ishte (dhe mbeti edhe më tej) motoja, që i nxiti shqiptarët e Amerikës ta ndihmonin atë me të gjitha forcat dhe mundësitë e tyre, më së shumti financiare, por edhe me njohjet e tyre në zonat zgjedhore, ku jetonin. Në nëntor të vitit 1989, DioGuardi shfaqet në Qendrën Ndërkombëtare të Shtypit në Beograd dhe dërgon në zyrën e Milosheviçit një letër të nënshkruar prej Senatorit Robert Dole dhe 12 senatorëve të tjerë amerikanë, për lirinë e Kosovës.

Që andej ai udhëtoi për herë të parë në Kosovë dhe aty mbajti fjalimin e tij historik përpara Hotelit "Grand" kundër Sllobodan Milosheviçit. Më pas e vizitoi Jugosllavinë edhe dy herë të tjera, deri sa iu ndalua hyrja nga regjimi i diktatorit serb. Po ashtu, udhëtoi në Shqipëri, bashkë me Kongresmenin Tom Lantosh, më 30 Maj 1990, ku panë me sytë e tyre "fosilet" që po linte pas komunizmi, i cili ishte në grahmat e fundit.

Bashkëpunimi me DioGuardin për çështjen e Kosovës

Vetëm pak kohë pas ardhjes së DioGuardit në Stamboll, në vitin 1995 udhëtova për Amerikë dhe vizitova Ligën Qytetare Shqiptaro - Amerikane, në Ossining, New York. Por lidhjen më të madhe me Join, siç e thërrasim ne, e pata në vitin 1998. Në atë kohë u vendosa përkohësisht në New Jersey. Menjëherë i ofrova shërbimin tim ndaj çështjes së Kosovës, LQSHA-së të drejtuar prej tij. Punuam rreth dy vjet pa pushim. Nga zyra e tij e thjeshtë amerikane në Ossining kemi bërë shumë gjëra të rëndësishme për Kosovën.

Pak histori rreth qytezës së vogël amerikane Ossining në New York

Ossining-u është një qytezë me histori të re, e banuar ndoshta nga jo më shumë se njëzet mijë banorë. Ajo dikur banohej prej vendasve indianë, të njohur si Sint Sinck, të cilëve iu mor toka në vitin 1685. Pas shumë vitesh të luftërave dhe përpjekjeve ajo zonë, e cila shtrihet paralel me Lumin Hudson, ishte konfiskuar plotësisht në vitin 1779. Qyteza gjendet në anën lindore të lumit, rreth njëzet kilometra në veri të Urës Tapenzi, që lidh shtetin e New Yorkut me atë të New Jersey-it. Në qendër të qytezës shtrihen disa objekte si Kisha e Kalvarit Baptist, ish-fabrika e Benjamin Breandith-it e shekullit të nëntëmbëdhjetë etj.

Ajo qytezë do të ishte krejt e thjeshtë dhe ndoshta pa ndonjë rëndësi për ne shqiptarët, nëse aty nuk do t'i kishte zyrat Lidhja Qytetare Shqiptaro – Amerikane, e themeluar dhe e drejtuar prej Joseph DioGuardit. Në atë zyrë të vogël periferike të New Yorkut janë shkruar shumë dokumente, të cilat kanë pasur rëndësi shumë të madhe historike dhe ndikim të madh në fatin e demokracisë në Shqipëri e në Kosovë. Aty shkruheshin Rezoluta Kongresi, fjalime me vlerë, organizoheshin takime me kongresmenë e senatorë, politikanë e studiues, analistë politikë dhe miq të popullit shqiptar.

Kur shkova aty, në verën e vitit 1998, gjendja në Kosovë po arrinte pikën kritike. Bashkësia ndërkombëtare ishte në një gjendje të paqartë se çfarë do të bënte me këtë çështje, e cila po merrte përmasat e një tragjedie mu në zemër të Evropës, e që po kthehej në një turp për njerëzimin modern. Nga ajo zyrë bëheshin telefonata, niseshin letra e mesazhe drejt administratës amerikane të Presidentit Clinton, Kongresit dhe Senatit Amerikan, si dhe kancelarive evropiane. Që aty i bëhej thirrje ndërgjegjes së njerëzimit për ta ndërprerë një proces shfarosjeje dhe genocidi ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

DioGuardi dhe këshilltarja e tij, publicistja e njohur Shirley Cloyes, nuk pushonin as edhe një minutë së përpjekuri për Çështjen e Kosovës. Në mbështetje të tyre ishin vënë një numër i madh shqiptaro - amerikanësh, të cilët nuk kursenin gjë për ta ndihmuar atë, në çdo mënyrë, e veçanërisht me financa. Liga funksiononte si institucion i përsosur me fondet që mblidhnin nga shqiptarët dhe Joi, po ashtu, nuk pushonte duke udhëtuar nga New York-u në

Washington D.C, sa në Kongres e në Senat e sa në Turqi e në Evropë. Ai ishte në ato kohëra aktivisti dhe lobisti më i fuqishëm, që i dha zë çështjes sonë kombëtare. Shumë shqiptarë në atë periudhë mblidhnin fonde vetëm e vetëm që "makina" e DioGuardit të funksiononte. Takimet me vendim-marrësit ishin shumë të rëndësishme, sepse, siç thoshin amerikanët, "Ne po e krijonim dosjen tonë të Kosovës", ndërsa ata vetë kishin nevojë të "edukoheshin", pra të mësonin rreth çështjes sonë.

Natyrisht që Liga nuk ishte e vetmja. Në anën tjetër Federata Pan-Shqiptare "Vatra", bënte edhe ajo të njëjtën gjë, si edhe plot shoqata të tjera shqiptaro - amerikane, shpeshherë të sapokrijuara dhe vetëm për atë periudhë. Liga organizonte shpesh udhëtime për Washington D.C. dhe ajo që e bënte edhe më interesante ishte se jetonte me ndihmesa të vogla të njerëzve të thjeshtë, të cilët, në shumë raste, për shkak të punëve të vështira që bënin, kontribuonin me çeqe, por nuk merrnin dot pjesë nëpër tubime, demonstrata dhe protesta.

Protestat ishin bërë të zakonshme dhe shpesh Capitol Hill mbushej me flamuj shqiptarë dhe amerikanë, me të cilët demonstronin për orë të tëra, duke ftuar edhe anëtarë të Kongresit e Senatit, sidomos miq të DioGuardit, por edhe të shqiptarëve të tjerë. Ata dilnin nga seancat e tyre të punës dhe flisnin në favor të kauzës sonë. Pra, çdo shqiptar jepte ndihmesën e tij në një mënyrë ose një tjetër.

Ndihmesa ime e asaj kohe nuk mund të ishte financiare, për shkak të vështirësive të fillimit të jetës në Amerikë, por me ndihmën e djalit tim, Erionit, arrija të përballoja shpenzimet e udhëtimit deri në Ossining dhe e bëja "donacion" kohën time pesë ditë në javë, që i kushtoja asaj çështjeje. Kjo lloj ndihmese ishte e domosdoshme dhe mjaft e vlefshme. Zyra ishte 65 milje larg në vajtje dhe po aq në kthim, ndërkohë që duheshin kaluar disa ura dhe terminale me pagesë me një "Kadillak" të vogël që ma kishte dhuruar DioGuardi.

Asgjë tjetër nuk ishte më e rëndësishme se Kosova në atë kohë.

Puna e pashembullt e Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane

Ajo që pashë në atë kohë në punën që bënin këta njerëz për çështjen shqiptare është e pashembullt dhe e vështirë ta përshkruaj. Natë dhe ditë, pa pushim, në

zyrë, në makinë, në restorant, në kafe, në ecje, ata ishin në kontakt me njerëz të rëndësishëm. Takuam shumë personalitete të shtetit amerikan të asaj kohe. Lidhjet e tyre shkonin shumë lart. Ndër ta mbaj mend takimet me senatorin Robert Dole, mik i madh i shqiptarëve, republikanin Henry Hyde, Kryetar i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë i Kongresit Amerikan, kongresmenin Benjamin Gilman, i cili e mori më vonë po të njëjtën detyrë, Kongresmenin hebreo - amerikan Tom Lantosh, senatorin Porter, senatorin Nickles-D'Amato dhe i fundit, por jo më i parëndësishmi për kohën e vet, senatorin John McCain.

DARKË ME KONGRESMENIN BENJAMIN GILMAN PËR KOSOVËN

Ishin pikërisht ato ditë kur çështja e Kosovës kishte arritur në pikën e vlimit. Takimet me kongresmenët dhe senatorët amerikanë qenë shtuar shumë. Një ndër takimet më të rëndësishme të asaj kohe ishte ai me Kongresmenin Benjamin Gilman. Ai ishte burrë i qetë, në një farë moshe (i lindur në vitin 1922). Ka shërbyer plot 30 vjet në Kongresin Amerikan, si republikan. Ai kishte miqësi të afërt me Joseph DioGuardin, miqësi që ishte forcuar shumë pas zbulimit nga ana e Joit, e historisë së hebrejve në Shqipëri.

Ben Gilman-i ishte hebre dhe e kuptonte më mirë se shumëkush atë që kishte bërë populli shqiptar.

Në atë mbrëmje të shkurtit 1999 gjatë darkës, bashkëshortja e kongresmenit, Xhorxhia, e cila ishte me origjinë greke, na tha: "Ju mos u merakosni, sepse Beni do të bëjë gjithçka për ju shqiptarët. Mos u shqetësoni, sepse ju ndihmoj edhe unë".

Nga fjalët e saj kuptohej se çështja e Kosovës kishte marrë përmasa shumë të mëdha, dhe kishte bërë që të reflektonin edhe njerëz që nuk kishin ndonjë afinitet me çështjen shqiptare.

NË KËSHILLIN E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË TË KONGRESIT AMERIKAN, NË CAPITOL HILL

Një ditë marsi të vitit 1999, një grup aktivistësh të Ligës, u nisëm për në Washington D.C, me shpresën dhe besimin se do të bënim aq sa të mundnim për të ndihmuar Kosovën që të gjente mbështetjen e duhur e të fitonte lirinë që meritonte.

Hymë në ndërtesën e Kongresit Amerikan. Në tribunën e sallës së Komisionit të Jashtëm erdhën dhe zunë vendet anëtarët e tij, të cilët do të dëgjonin mendimet *pro* dhe *kundër* të dy paneleve, me nga tre anëtarë. Atë e drejtonin kongresmenët Henry Hide dhe Tom Lantosh.

Zhvillimi i kësaj seance dëgjimore doli të ishte vendimtare për fatin e Kosovës, pasi administrata mbështetej shumë në opinionin e saj. Kongresmeni Tom Lantosh, i cili hapi seancën, shpalosi një panoramë të shkurtër, por të qartë e të plotë, mbi situatën në Kosovë dhe më pas, vazhdoi me debatin.

Me Senatorin Robert Dole, Ambasadoren Jeane Kirkpatrick dhe ish Sekretarin e Shtetit, Henry Kissinger

Paneli i parë dhe kryesor përbëhej nga senatori Robert Dole, mik i madh i shqiptarëve, ambasadorja Jene Fitzpatrick dhe ish Sekretari i Shtetit dhe diplomati më me përvojë në politikën e jashtme amerikane, Henry Kissinger.

Senatori Robert Dole në Shkup, për Kosovën

Senatori Robert Dole u ngrit dhe, duke mbajtur lapsin në dorën e tij protezë, përshkroi udhëtimin e tij njëjavor në Shkup. Ai foli për dëshmitë e shumta të barbarizmave serbe kundër shqiptarëve, që kishte mbledhur atje, për shpërnguljen masive të popullsisë, vrasjet dhe torturat jashtë syve të vëzhguesve të OSBE-së, ose siç quheshin në atë kohë, verifikatorëve. Ai u ndal te Milosheviçi dhe krimet e tij. U shpreh i pakënaqur me veprimet e H. Sh., të cilin kishte kërkuar ta takonte në Shkup, në pamundësi për të hyrë në Kosovë, por që i ishte thënë se ai ishte në front, në Drenicë. "Për habinë time", - tha ai, "pashë në televizion se ai ishte duke mbajtur një konferencë në hollin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë". Toni i tij ishte tmerrësisht kritik. Megjithatë e mbylli diskutimin, me thirrjen për ndërhyrje të ashpër ushtarake kundër Serbisë.

"Krimineli Milosheviç", - tha ai, - "duhet goditur ashpër, pa mëshirë dhe kështu do të mbrohej një popull, i cili po shkonte drejt shfarosjes. Ai kupton vetëm një gjuhë: Atë të tankeve dhe bombave".

Ambasadorja Jeane Kirkpatrick për Kosovën

Pas tij e mori fjalën Ambasadorja Jeane Kirkpatrick. Ajo mbajti të njëjtën linjë. Foli gjatë, qartë, kthjellët, e me shumë argumente për historinë e terrorit serb ndaj shqiptarëve dhe, se ata duhej të mbroheshin me çdo mjet dhe këtë mund ta bënte vetëm Amerika, bazuar në vlerat e saj demokratike, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të kombeve të vegjël.

Henry Kissinger për Jugosllavinë

Pas tyre do të fliste njeriu më me autoritet në fushën e diplomacisë, jo vetëm në SHBA, por edhe në të gjithë botën. Ai u ndal te ruajtja e sovranitetit të një shteti, përmendi rastet kur ndërhyhet ushtarakisht dhe pse nuk mund të

ndërhyhej ndaj Serbisë dhe pse çështja mund dhe duhej zgjidhur vetëm me mjete diplomatike.

Ky ishte zëri ndryshe, por ishte zë shumë i fuqishëm, shumë i fortë dhe gati tronditës për të gjithë ne që ishim aty.

LQSHA dhe NAAC kundër përfaqësuesve të Institutit "CATE"

Pas kësaj fjalën e morën me radhë, Shirley Cloyes - DioGuardi, këshilltare për çështjet e Ballkanit pranë LQSHA, Ilir Zherka, President i NACC, (Këshilli Kombëtar Shqiptaro - Amerikan) dhe më pas edhe një përfaqësues i Institutit Cate, organizatë joqeveritare shumë e afërt me serbët.

Argumentet e dy të parëve ishin tërësisht në një linjë me ato të Senatorit Robert Dole dhe Ambasadores Kirkpatrick, ndërsa ato të përfaqësuesit të Institutit Cate përkonin me ato të Henry Kissinger-it.

Agim Aliçkaj me librin në dorë, "Shpëtimi në Shqipëri"

Pas këtyre fjalimeve u bë një pushim i shkurtër. Bashkë me Agim Aliçkajn, aktivist i paepur i çështjes së Kosovës, iu afruam Henry Kissinger-it. Kishim me vete disa kopje të librit "Shpëtimi në Shqipëri" (Rescue in Albania), të cilat i shpërndanim kudo që mundeshim, sapo shihnim ndonjë hebre. Besonim shumë tek ai libër dhe historia që tregohej në të për mbrojtjen e hebrejve nga shqiptarët gjatë gjithë historisë, por veçanërisht gjatë kohës së Hollokaustit.

Kështu në ato çaste sapo mbaroi seanca, Agim Aliçkaj iu afrua Henry Kissinger-it dhe u ul në gjunjë përpara tij. Ai ishte ulur në karrigen e tretë majtas të tavolinës së treshes kryesore. Agimi kishte në dorë një kopje të librit, ia tregoi dhe i tha:

"Zoti Kissinger, të lutem, merre këtë libër! Të lutem, merre dhe lexoje! Ju njiheni si poliglot, diplomat, filozof, historian e lexues dhe shkrimtari më i madh i politikës globale. Lexojeni dhe do të mësoni sesi një popull, që sot është për vete në prag të shfarosjes, i ka mbrojtur hebrejtë në kohët e tyre më të

vështira, ani pse për vete ishte i pushtuar nga nazistët gjermanë".

Agim Aliçkaj insistonte që Kissingeri ta lexonte atë libër dhe të mësonte se ishte po ai popull që po masakrohej sot nën Serbinë, ai populli që dikur ishte i vetmi, që mbrojti njerëzit e tij - hebrejtë.

Kissingeri e mori librin në dorë, e shfletoi për një grimëherë, dhe i tha:

"Të siguroj që do ta lexoj me vëmendje".

KONFERENCA E RAMBUJESË DHE KONTRIBUTI I JOSEPH DIOGUARDIT

Në fillim të vitit 1999 ndodhën ngjarje shumë të rëndësishme për Kosovën. Ndër to veçohen masakra e Reçakut dhe Konferenca e Rambujesë. Bashkësia ndërkombëtare u angazhua seriozisht për ta penguar një gjakderdhje të re në Ballkan. Në fakt, përvoja e Dayton – it, si marrëveshje paqeje për Bosnjën, kishte lënë shije shumë të keqe për shkak të defekteve të jashtëzakonshme që ajo mbarte. Për më tepër, shqiptarët as që ishin konsideruar në atë rast, ku vetëm Milosheviçi, Izetbegoviçi dhe Tuxhmani ishin palë, të ndërmjetësuara nga amerikanët.

Ajo marrëveshje qe nënshkruar edhe nga Presidenti Amerikan Bill Clinton, Kryeministri Spanjoll, Filipe Gonzales, Presidenti i Francës Zhak Shirak, Kryeministri britanik John Major, Kancelari gjerman Helmut Kol dhe kryeministri rus Viktor Çernomyrdin. Ajo marëveshje solli paqe, por asnjëherë stabilitet në Bosnjë e Hercegovinë. Por çfarë dukej se do të sillte konferenca tjetër ndërkombëtare, e cila kishte si qëllim po të njëjtën gjë - të sillte paqe në Ballkan e veçanërisht në Kosovën që ishte në prag të një shpërthimi të tmerrshëm?

Marrëveshja e Rambujesë - më e keqja e nënshkruar nga shqiptarët dhe e kundërshtuar nga DioGuardi

Drafti i Marrëveshjes së Rambujesë, i cili u negociua midis shqiptarëve dhe serbëve me ndihmën e amerikanëve dhe veçanërisht dy diplomatëve, Richard Hollbrook dhe Christopher Hill, me gjithë dashamirësinë e tyre, nuk ishte gjë

tjetër veçse më pak sesa një lëshim shumë i madh i bashkësisë ndërkombëtare ndaj Milosheviçit.

Dokumenti final linte në fuqi administrimin serb mbi Kosovë, me autonomi diçka si ajo që kishte pasur, pak më e zgjeruar se në kohën e Jugosllavisë titiste, që ishte marrë brutalisht nga Milosheviçi në vitin 1989. Joseph DioGuardi, si edhe politikanët më atdhetarë shqiptarë, që në atë kohë ishin në opozitë, e kundërshtuan me forcë këtë marrëveshje. Ai doli në ballë të përpjekjeve për ta redaktuar projektin dhe e kundërshtoi atë me forcën më të madhe. Si politikan profesionist amerikan, ai e kuptonte më mirë se çdokush tjetër se për Amerikën dhe Fuqitë e Mëdha, stabiliteti ishte më i rëndësishëm sesa realizimi i të drejtave të shqiptarëve. Kjo është arsyeja përse diplomatë si Hill dhe të tjerë iu imponuan shqiptarëve, të cilët nuk kishin ndonjë mbështetje tjetër, përveç asaj amerikane, dhe sado e pamjaftueshme që ishte ajo në atë moment, sigurisht që nuk mund ta refuzonin. Në një takim të shumë aktivistëve të LQSHA-së, Joseph DioGuardi deklaroi:

> *"Marrëveshja e Rambujesë është e para marrëveshje në historinë e shqiptarëve, nëpërmjet së cilës kanë nënshkruar me dorën e tyre të drejtën serbe mbi Kosovën dhe për rrjedhojë skllavërimin e mëtejshëm nën sovranitetin serb mbi Kosovën".*

Me atë rast Liga vendosi që Joi dhe Shirley të udhëtonin urgjent për në Paris. I përcolla atë natë në Aeroportin "Liberty" në Newark të New Jersey-it. Ai ngiste një makinë "Kadillak" të thjeshtë. Në vend të parë ishte ulur Shirley. Vendimi për të udhëtuar ishte marrë menjëherë. Me shpejtësi ata u bënë gati, morën dosjet, hipëm në veturë dhe DioGuardi e mori vetë timonin. Në anën e djathtë ai kishte një telefon satelitor që komunikonte pa ndërprerje me miqtë e tij në Washington, New York dhe Evropë. Nga ngutja dhe shpërqëndrimi në telefon bëri një dalje të gabuar nga autobandi Turnpike South për në autobandën 78 West, drejt perëndimit. Ishte dalje në drejtim krejt të kundërt me aeroportin, e cila iu shkaktoi humbje kohe prej më shumë se gjysmë ore deri sa gjeti një dalje tjetër për kthim mbrapsht. Paguam dy herë terminalet dhe u kthyem në drejtimin e duhur. Klithmat e Joit ndiheshin deri në qiell:

"Si ka mundësi, tre njerëz intelegjentë humbasin rrugën?!" …

Arritëm në terminal në momentin e fundit. Të nesërmen ata u shfaqën

përpara Kështjellës së Rambujesë. Në atë kohë shumëkush e ka kundërshtuar qëndrimin e DioGuardit, por nëse lexohet edhe sot me pak vëmendje dokumenti përfundimtar i Marrëveshjes së Rambujesë, ai e lë Kosovën në statusin e autonomisë. DioGuardi ishte kundër. Ajo që ndodhi më pas është ajo që anglezët e quajnë "*by default*".

Ndodhi mrekullia që kryeministri serb, Milutinoviç nuk e nënshkroi marrëveshjen, por ua hodhi në fytyrë ndërkombëtarëve në çastin kur po linte kështjellën. Mungesa e një marrëveshjeje solli ndërhyrjen ushtarake të NATO-s të udhëhequra nga SHBA-ja. Konsideroj se roli i Joseph DioGuardit ka qenë dhe mbetet historik edhe në këtë moment të rëndësishëm për Kosovën. Nëse serbët e nënshkruanin marrëveshjen, Kosova mbetej me statusin e një autonomie nën pushtetin serb. Aty flitej për një autonomi me të drejtë referendumi pas tre vjetësh, por a do të arrihej dot kjo?

A ishin serbët tradhtarë të çështjes së tyre në Rambuje? A ishin serbët tradhtarë, që nuk e pranuan atë zgjidhje me konseguenca minimale për ta, dhe asnjë përfitim për shqiptarët, kjo përbën një pikëpyetje të madhe. A ishin ata agjentë të shitur, apo naivë, këtë ende nuk e ka vlerësuar historia. E vërteta është që situata nuk mbante më, serbët nuk nënshkruan, shqiptarët pranuan një dokument, ndoshta me premtime të strukturave të fshehta, që do t'i bëjë të skuqen gjithë jetën.

Prapëseprapë, kokëfortësia serbe dhe "toleranca" shqiptare i shkuan për shtat zgjidhjes së çështjes së Kosovës, pra fillimit të luftës. Joseph DioGuardi ishte në anën e së drejtës, por a ishte edhe në anën e historisë? Kjo çështje han diskutim.

Joseph DioGuardi, "maksimalist" i ndershëm i çështjes shqiptare

Joseph DioGuardi është personi, i cili vepron me atë që bota e quan kërkesë maksimaliste shqiptare, por në të vërtetë ajo është kërkesa më e natyrshme: Bashkimi i kombit shqiptar në trojet e veta etnike në Ballkan. I vetmi aktivist i çështjes kombëtare, i cili nuk ka çeduar kurrë e që nuk ka bërë lëshime, ka qenë dhe mbetet Joseph DioGuardi. Thuajse çdo politikan shqiptar i është trembur stigmës "*Shqipëria e Madhe*" e sajuar nga qarqet antishqiptare, veçanërisht ato

sllave, e bashkë me ta, nganjëherë, edhe përfaqësues të aleatëve perëndimorë që e kanë me pikatore dashurinë për kombin shqiptar. Fjala e parë që çdo diplomat dhe politikan perëndimor të thotë është:

"A synoni ju shqiptarët të bashkoheni në një shtet të vetëm?", sikur ky është fundi i botës. Kjo në përgjithësi i ka kompleksuar politikanët shqiptarë, por jo Joseph DioGuardin.

Kontributi i LQSHA-së nëpërmjet librit historik "Shpëtimi në Shqipëri" dhe ndikimi që pati ai tek Lobi Hebraik në SHBA

Në tetor të vitit 1997 Liga Qytetare inicioi botimin e librit "Shpëtimi në Shqipëri" (Rescue in Albania) me parathënien e dy kongresmenëve hebrej më të fuqishëm, Tom Lantosh dhe Benjamin Gilman. Roli i këtij libri ka qenë i jashtëzakonshëm dhe kontributi i DioGuardit në këtë drejtim është i pazëvendësueshëm. Librin e shkroi filantropisti hebre, Harvey Sarver. Liga shpërndau në gjuhën angleze plot 10 mijë ekzemplarë të këtij libri, i cili pati një efekt në ndërgjegjësimin e njerëzve më eminentë të SHBA-së, në njohjen e popullit shqiptar dhe qëndrimin e tij human të veçantë në një botë, ku mbretëronte krimi ndaj hebrejve prej nazistëve në të gjithë Evropën. Si anëtar aktiv i Ligës Qytetare, si edhe shumë të tjerë, kam shpërndarë qindra kopje të këtij libri te hebrejtë e Amerikës anembanë dhe, më vonë, edhe tek ata të Anglisë.

Dua të kujtoj se në kohën e këtyre ngjarjeve që po u referohem, në drejtim të shtetit amerikan gjendeshin personalitete të tilla me origjinë hebreje si Samuel Richard, "Sandy" Berger, Këshilltari i Çështjeve të Sigurisë Kombëtare i Presidentit Clinton, Sekretari i Mbrojtjes William Cohen, Sekretarja e Shtetit Madeleine Albright, zv/Sekretari i Shtetit, James Rubin, Gjenerali i Shtabit të Ushtrisë, Wesley Clark si dhe kongresmenët më aktivë Tom Lantosh, Benjamin Gilman dhe senatori Chuck Shumer.

Roli i këtij libri është i jashtëzakonshëm, sepse ndihmoi që çështja e shfarosjes së shqiptarëve në Kosovë, të vihej në vijë paralele me atë të Holokaustit kundër hebrejve.

DioGuardi më dha mundësinë ta përktheja librin në shqip, të cilën e shpërndamë në rreth dy mijë kopje edhe te shqiptarët, të cilët nuk e kishin idenë rreth kësaj historie kaq të mrekullueshme e fisnike, që kishin treguar në atë kohë ndaj hebrejve.

Puna ishte që asnjë hebre, i cili i di mirë vuajtjet e racës së tij, të mos mbetej pa mësuar se cilët ishin ata, që në ditët e tyre më të errëta, i mbrojtën edhe përkundër rrezikut që merrnin mbi vete.

Henry Kissinger në CNN International natën e 24 marsit 1999

Efekti i librit që iu dorëzua Henry Kissinger-it mund të ketë qenë i jashtëzakonshëm. Vetëm disa ditë më vonë, nga Mbledhja e Komisionit të Jashtëm të Kongresit Amerikan në Capitol Hill rreth çështjes së Kosovës, filluan bombardimet kundër caqeve ushtarake të Serbisë. E gjithë media botërore filloi menjëherë transmetimet e drejtpërdrejta nga baza ajrore italiane e NATO-s, Aviano, prej nga ngriheshin avionët, që bombardonin objektivat ushtarake serbe.

Natyrisht që *CNN International* ishte si përherë i pari që e njoftoi këtë. Ata ndërprenë çdo lajm dhe e vonë kryelajmin në ekran.

Ishte lajmi i fundit:

I pari njeri, që i bekoi ato bombardime, ishte Henry Kissinger. Ai i tha CNN-it:

"Duhet shpëtuar populli shqiptar i Kosovës nga shfarosja, por edhe nderi i SHBA-së. Tani nuk ka kthim pas", deklaroi Henry Kissinger, atë natë.

ERË LUFTE QË ERDHI DERI NË OSSINING - NEW YORK - USA

Mëngjesi i parë pas fillimit të bombardimeve të forcave ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë më gjeti në Ossining. Atë ditë, si edhe në ditët e mëparshme, isha ulur në tryezën e punës pranë asaj të DioGuardit.

Fillimi i bombardimeve kundër caqeve ushtarake serbe në ish-Jugosllavi kërkonte publicitet edhe brenda Amerikës, për ta mbajtur lart mbështetjen e opinionit publik ndaj administratës së Presidentit Clinton. Një nga zërat më të fuqishëm të asaj kohe në mediat amerikane u bë vetë DioGuardi me Shirley Cloyes.

Ata u shfaqën në atë kohë në rreth 50 kanale televizive e radiofonike përfshirë edhe CNN International, Fox-TV, BBC-TV, NBC, MSNBC, WPIX, dhe CNBC. Kjo vazhdoi gjatë gjithë kohës së luftës dhe disa kohë më pas.

Në atë kohë, i ngarkuar nga Joseph Dioguardi, pata rastin dhe nderin të paraqisja pikëpamjen shqiptare rreth asaj që po ndodhte në Kosovë nëpërmjet të televizionit CN8 Comcast Network, i cili transmetonte për pjesën lindore të SHBA-së. Po në atë kohë u angazhova në bazën ushtarake në Fort Dix ku rreth 6 mijë e 500 shqiptarë të Kosovës u katapultuan përmes ajrit nga Kampi i Bllacës dhe Stankovacit të Maqedonisë, për t'i mbrojtur nga lufta. DioGuardi bëri një vizitë historike në atë bazë. Takimi u bë në kishën e bazës ushtarake. Masa e kosovarëve të pranishëm, të cilët e dinin mirë ndihmesën e këtij njeriu shpërthente herë pas here në thirrje "USA - DioGuardi". Ai ishte një nga takimet më emocionale. Aty kishte njerëz, të cilët dikur e kishin pritur kongresmenin përpara Hotel "Grandit" në Prishtinë teksa sulmonte Milosheviçin, në vitin 1991, dhe tani në mes të Amerikës.

11 Emisione televizive në CN8 Comcast Television

Ishte pikërisht data e 25 mars 1999, një ditë pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s kundër objektivave ushtarake të Sllobodan Milosheviçit, kur mora një telefonatë nga gazetarja e televizionit CN8 Comcast të shtetit të New Jersey-t, Liza Espagnola. Ishte menaxherja e personelit të gazetares së njohur amerikane Lyn Doyle. Ajo kërkonte të fliste me Joseph DioGuardin. Unë e mora në shënim numrin e saj të telefonit dhe i premtova se do ta njoftoja Join për kërkesën që kishte ai televizion, në mënyrë që të paraqitej aty për të shprehur, siç thoshte ajo - këndvështrimin shqiptar të konfliktit në ish-Jugosllavi. Menjëherë e njoftova Join dhe ai me atë furinë e veprimtarisë që e karakterizonte më tha:

"Shko ti! Duhet të shkosh ti! Na duhen njerëz që flasin, na duhen aktivistë, është kohë e vështirë, kohë lufte dhe secili le të bëjë të tijën! Shko ti, dhe na përfaqëso me dinjitet!"

E telefonova qendrën televizive CN8 Comcast dhe iu thashë se, në cilësinë e këshilltarit të Ligës, isha autorizuar të paraqitesha në atë debat televiziv. I dërgova rezymenë time dhe telefonata e tyre nuk vonoi. Me kërkuan të paraqitesha në qendrën televizive në qytetin Union, të shtetit të New Jersey-it, atë të enjte të 25 marsit 1999, në orën 20.00. Ishte hera e parë në jetën time që do të futesha në një debat televiziv, qoftë edhe në gjuhën shqipe.

Në studion televizive CN8 Comcast me gazetaren veterane Lyn Doyle

Kanali televiz CN8 Comcast transmeton për 110 milionë amerikanë që jetojnë në *East Coast* (Bregdeti Lindor). Emisioni titullohej *It's Your Call with Lynn Doyle* dhe organizohej me të ftuar ekspertë, analistë, politikanë e profesorë, të cilët flisnin për tema të rëndësishme të ditës. Emisioni kishte përherë një prelud me kronikë për ngjarjen e ditës dhe më pas të ftuarit jepnin opinionin e tyre. Fill më pas shpërthenin telefonatat *për* dhe *kundër* rreth temave që flisnin të ftuarit në studio. Ky emision ka fituar çmimin Emmy në Boston dhe New England shtatë herë rresht. Kështu filloi për mua emisioni *"It is your Call me*

Lyn Doyle".

Atë mbrëmje përballë kisha një profesor të Universitetit Rutger të New Jersey-it, i cili mbrojti me fanatizëm tezën e mosndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara në konfliktin në Jugosllavi. Preludi i përgatitur nga televizioni tregonte ngritjen e avionëve nga baza ajrore e NATO-s në Aviano të Italisë dhe shpërthimet në bazat ushtarake serbe. Atë natë ishte planifikuar që emisioni të zgjaste një orë, por ndërhyrja e vazhdueshme e teleshikuesve dhe debati me argumente dhe kundërargumente bëri që të zgjaste një orë e gjysmë.

Me profesorin e Universitetit Princeton, Wolfgang F. Danspeckgruber

Të nesërmen studioja kërkoi që të vazhdonim këtë emision çdo të enjte, deri sa lufta të mbaronte. Dhe kështu në javën e dytë, u gjenda përpara një profesori të Universitetit Princeton. Ai ishte Wolfgang F. Danspeckgruber, drejtori themelues i Institutit Lihtenshtein për Vetëvendosje, në atë universitet. Ai jepte mësime për çështjet e teorisë së shtetit, të sigurisë ndërkombëtare, vetëvendosjes së popujve dhe diplomacisë si dhe për krizat diplomatike, në shkollën e Çështjeve Ndërkombëtare dhe Publike "Woodrow Wilson". Në fakt profili i tij shumë i lartë akademik i shkonte shumë mirë edhe argumentit për drejtësinë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, kundër Jugosllavisë.

Debati i dytë, ashtu si edhe i pari, shkoi mirë dhe zgjati bashkë me reklamat dhe ilustrimet nga Kosova një orë e gjysmë. Telefonat nuk pushonin dhe ndihej në masë shqetësimi i qytetarëve amerikanë për përfshirjen e Amerikës në këtë konflikt jashtë territorit të tyre. Pas emisionit, pimë kafe me profesorin, i cili të befasonte me gjerësinë e dijenive të tij gati të pafundme.

Debat me serbo - amerikanen Edita Kruniç, Presidente e "Unionit të Serbëve të Amerikës"

Në emisionin e tretë u gjenda përpara një të papritur. Kur hyra në hollin e studios, aty ku përherë na ofronin kafe dhe biskota, vura re një burrë me flokë

shumë të gjata, të lidhura bisht kali dhe një zonjë të veshur me shije dhe e shëndetshme. Të dy ishin njerëz shumë të zymtë. Gazetarja Doyle nuk jepte ndonjë lloj orientimi mbi atë që do të flisnim, çfarë do të thotë se, ne mund të shpreheshim pa censurë.

Zonja përballë meje do të ishte Edita Kruniç, serbo - amerikane e lindur në Amerikë. Ndërsa burri, me flokët bisht kali ishte bashkëshorti, i cili, siç mësova më vonë, kishte ardhur pak kohë më parë nga Serbia dhe ishte gjithë mllef për atë, që po ndodhte përtej detit. Pas siglës së emisionit dhe preludit, pashë se në ekran u shkrua:

"Edita Kruniç, Presidente e Unionit të Serbëve të Amerikës."

Në atë kohë në Amerikë shpërthyen si kërpudhat pas shiut lloj-lloj shoqatash e fondacionesh në mbrojtje të "kauzës serbe" të kombit të "sakrifikuar" dhe të "viktimizuar" ndër shekuj. Menjëherë kuptova se kisha të bëja me një drejtuese të një "krijese" të tillë. Debati u përqendrua, sipas saj, te persekutimi shekullor që serbët na paskëshin përjetuar në Kosovë prej shqiptarëve, në "djepin e Serbisë", dhe në atë që mbrojta unë për të kundërtën dhe drejtësinë e ndërhyrjes së forcave të NATO-s. Pas emisionit të parë morëm përgëzime nga drejtuesja dhe u shpërndamë.

Kur arrita në shtëpi mora mjaft telefonata nga shumë shqiptaro - amerikanë, që e kishin ndjekur emisionin.

Tani kundërshtarë ishim Edita Kruniç dhe unë. Në një prej emisioneve doli në telefon një vajzë, e cila pretendonte se fliste nga Beogradi, por në të vërtetë dukej hapur nga aksenti i anglishtes së saj se ishte nga jugu i New Jersey-it. Ajo tha duke qarë:

"E kuptoni se çfarë do të thotë për një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçare si unë, të mos guxojë të dalë mbrëmjeve nëpër rrugët e Beogradit që prej dy javësh, nga frika e bombardimeve të NATO-s?!"

Lyn Doyle e hapi debatin: Edita Kruniç e qau me lot "vuajtjen" e asaj vajze serbe për atë që po i ndodhte. Dhe pas kësaj gazetarja m'u drejtua mua:

"Po ju, çfarë komenti keni?"

I thashë se më vjen keq për vuajtjen e asaj vajze, por kur e di që me mijëra vajza shqiptare, moshatare të saj të Kosovës, flenë jashtë në borën dhe akullin e atyre ditëve nëpër male e pyje, të pangrëna dhe nën frikën e dhunës që ushtron një polici dhe ushtri, ku ndoshta edhe babai i asaj vajze është i mobilizuar,

ngushëllohem për të. Madje, shtova, nga e folura më jep të kuptoj se ajo nuk flet nga Beogradi tani, kur atje është ora rreth tre e mëngjesit".

Shpesh në linjë filluan të futeshin edhe shqiptaro - amerikanët. Një ndër to ishte Nurie Rugova, motra e fotografit të njohur, Fadil Berisha, e lindur në Kosovë, e cila me argumente dhe fakte mbështeti atë që mbroja edhe unë në atë studio. Ky debat zgjati dhjetë javë deri sa mbaroi lufta. Një emision u organizua në shtatorin e po atij viti, kuptohet pasi lufta kishte mbaruar. Kësaj radhe tema ishte për largimin e serbëve nga Kosova.

Këto njëmbëdhjetë emisione i kontribuan medias amerikane, e cila ishte angazhuar në mbajtjen lart të frymës pozitive të opinionit vendas për drejtësinë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër kriminelit Milosheviç dhe në mbrojtje të popullit shqiptar të Kosovës. Argumenti që jepnim ne shqiptarët në Amerikë ishte ndihmesë e madhe për mbajtjen lart të mbështetjes popullore demokratike ndaj aksionit ushtarak të drejtuar nga SHBA-të.

Mars - qershor, shtator 1999

KUJTIME NGA BAZA USHTARAKE AMERIKANE FORT DIX ME MISIONET HUMANITARE AMERIKANE

Sikurse e kam përmendur edhe më lart, më 24 mars 1999 forcat ajrore të NATO-s filluan bombardimet mbi caqet ushtarake të Sllobodan Milosheviçit. Paralel me debatet në emisionet në Televizionin CN8 Comcast, u përfshiva edhe në grupin e punonjësve humanitarë amerikanë dhe të emigracionit. Aty m'u dha rasti të gjendesha në pritjen e grupit të parë të shqiptarëve të Kosovës, që zbritën në aeroportin ushtarak Fort Dix, në jug të shtetit të New Jersey-it. Ishin ditët e para të majit të vitit 1999 kur u mblodhëm në atë bazë. Shumica ishin amerikanë, ushtarakë, punonjës të Agjensisë së Imigracionit, agjensi ndihmash humanitare, shërbime të tjera, si dhe disa shqiptaro - amerikanë me qëndrim të ligjshëm në SHBA. Unë përfaqësoja Ligën Qytetare Shqiptaro - Amerikane.

Aeroplani i parë ushtarak, që mbrriti plot e përplot me shqiptarë të Kosovës, u ul rëndë - rëndë dhe mua më dukej sikur ai sillte me vete gjithë peshën e atij dheu, që banohet prej shqiptarësh. Vërtet ai ishte shumë i madh, dhe me ngjyrë kaki - ushtarake, ndërsa ngarkesa që kishte me vete dhe padurimi ynë për t'i parë, takuar e ndihmuar bashkëkombasit tanë në atë bazë, e bënte atë të dukej shumë më i rëndë se pesha e tij e vërtetë fizike. Aty prisnin mbi 100 kamera të qendrave më të mëdha televizive të botës.

Nuk vonoi dhe nga dera e avionit zbritën udhëtarët e parë. Ideja që na shkonte ndër mend ishte: Vallë a do të mund të zbresin nga shkallët? A janë ata aq të qëndrueshëm sa të arrijnë deri te qilimi i kuq i shtruar nga autoritetet shtetërore të New Jersey-it, të cilët kishin vënë gjithçka në dispozicion të tyre?

Ata po zbrisnin dhe unë ndieja se si çdo shkallë e mëposhtme që ata shkelnin ishte një gong i ri, që pakësonte numrin e banorëve shqiptarë të Kosovës. Një, dy, tre, katër, dhjetë, njëqind, katërqind e pesëdhjetë vetë i shkelën ato shkallë

me hapin e tyrë të rëndë, të lodhur e të dërrmuar… Katërqind e pesëdhjetë shqiptarë më pak në dheun e tyre, vetëm në këtë aeroplan… Po edhe sa mijëra të tjerë kishin ikur në drejtime të tjera nëpër gjithë botën, deri në Australi dhe në Zelandën e Re?

Autobusët e kompanisë më të madhe amerikane të transportit tokësor të udhëtarëve "Academy" ishin rreshtuar fare pranë pistës. Ndoshta ishte hera e parë, që ata lejoheshin të hynin në atë bazë ushtarake. "Mysafirët" siç i quajtën amerikanët, hipën në autobusë, të cilët kishin ulur krikët e shasisë deri në një nivel me tokën për t'ua lehtësuar atyre sadopak mundimin fizik të të ngjiturit në shkallë. Karvani i autobusëve i transportoi të porsaardhurit, fytyrat e të cilëve ngjanin më shumë me portrete filmash plot legjenda e personazhe, se sa me njerëz realë. Dikush e kishte quajtur udhëtimin e tyre "biblik". Dhe i tillë ishte. As në Bibël, dhuna nuk i ka stërpikur njerëzit kaq larg.

Në sallën e madhe të gjimnastikës së bazës ushtarake ishin instaluar shërbime të ndryshme si ato sanitare, shëndetësore, ushqimore, pije freskuese pa fund, kafe, çaj, fruta të çdo lloji, sanduiç të shumëllojeve, infermerë, mjekë, punonjës socialë, Kryqi i Kuq, vullnetarë, punonjës emigracioni, përkthyes të gjuhës shqipe, civilë, ushtarakë, agjentë të FBI-së e shumë e shumë të tjerë, të njohur dhe të panjohur. Secili mbante një kartë identiteti në qafë dhe çdokush në mënyrën më njerëzore përkujdesej për diçka. Ndër ta, një të tillë e mbaja edhe unë dhe im bir, Erioni. E gjitha kjo e përkushtuar për ata njerëz.

Salla u mbush. Njerëzit zunë vende nëpër shkallët e sallës. Ishin tejet të lodhur, të nxirë nga dielli, të drobitur nga rruga e gjatë dhe kushtet e tmerrshme në të cilat kishin kaluar ditët dhe javët e tyre të deriatyshme. Disa prej atyre, të cilët nuk rezistonin më, i shtruan në fushën e sportit nëpër barrela ushtarake dhe filluan t'u bënin serume. Nga altoparlanti dëgjoheshin thirrje të pandëprera të punonjësve socialë:

"Ju lutemi shumë, merrni sa më shumë lëngje, pini lëngje sepse trupat tuaj janë dehidruar".

"E gjithë Amerika" në Fort Dix për kosovarët

Atë përkujdesje aq njerëzore që pashë aty, as që do të kisha arritur ta mendoja. Merrej me mend se çfarë kontrasti i jashtëzakonshëm ishte për ata njerëz ky kalim sublimues nga ajo gjendje që kishin lënë pas, me këtë që kishin gjetur këtu. Filluan procedurat e para. Tani secili kishte zënë vend.

Në sallë u shfaqën Zonja e Parë e Amerikës, Hillari Clinton, Guvernatorja e Shtetit të New Jersey-t, zonja Christine Todd Whitman, Sekretarja e Shtetit për Shëndetësinë dhe Punën Sociale, senatorë, kongresmenë, si dhe autoritete vendore të kantonit të Fort Dix-it.

Salla shpërtheu në duartrokitje. Ato dukeshin si të buta, pak të shurdhëta, si një daulle pak e shfryrë, si një dajre e panxehur; në to më dukej se dëgjoja diçka që nuk dëgjohet, më dukej se ndieja atë që nuk ndiehet; rrahjet e atyre duartrokitjeve kishin pak zë, por tingëllonin shumë. Dukej sikur ishin të akorduara në frekuenca të tilla, që nuk dëgjohen afër. Dukej që secili donte ta bënte zhurmën e tij jo për vete, jo për atë që shihej, jo për atë që ndihej aty. Dukej se ata donin që ato duartrokitje të dërgoheshin përtej atyre mureve, përtej atij pylli rrethues, tutje, tutje diku ku ato të dëgjoheshin jo më për ata vetë, por për ata që kishin lënë pas; duhej të tërhiqnin vëmendjen për ata që ishin në male, të mbetur rrugëve, pa ushqim e veshmbathje; për ata që ishin në mëshirë… të kujt?

Në rastin më të mirë, në mëshirën e askujt! Sa mirë do të ishte që ata që ishin atje, larg nëpër pyje, të ishin të paktën në mëshirën e askujt. Dhe ai gëzim i venitur i atyre njerëzve që nuk dinin as të gëzoheshin dhe as të hidhëroheshin më, ishte tashmë i hedhur në atë sallë si vello, ngjyrën e së cilës askush nuk di ta përcaktojë, e bardhë, e zezë, blu apo… ndoshta më së miri mund të quhet flu, e paqartë, e pandritshme, e shlyer.

Mbaroi edhe ceremonia. U tha se ju jeni njerëzit më të fortë në botë, se keni përkrah Amerikën, që kurrë nuk do t'u lërë në baltë, se do të bëhet çdo gjë për ju dhe bashkëkombasit tuaj e shumë e shumë gjëra të tjera… Tani do të fillonte procedura e parë elementare, marrja e identitetit të të porsaardhurve, shumica e të cilëve nuk kishin asnjë lloj dokumenti, për shkaqe të ndryshme, ndër të cilat kryesorja ishte se ato ua kishin grisur autoritetet policore serbe për

t'i dëbuar, ose në ikje e sipër, as që u kishte vajtur mendja te një gjë e tillë.

Të shohësh jo një shfaqje të tragjedisë, por vetë tragjedinë e luajtur nga tragjikët

Në rastet kur mungonte çdo dëshmi identiteti, atëherë çështja kalonte nëpër një seancë marrjesh në pyetje. Ishte procedurë e thjeshtë, por më e vlefshmja për të kuptuar gjithë atë që kishte ngjarë në Kosovë. Këtu njeriu mësonte shumë për thellësinë e tragjedisë dhe vuajtjes njerëzore. Këtu mësohej se si fëmija kishte parë prindërit tek i vriteshin, se si prindi e kishte parë fëmijën po ashtu, se njeriu nuk mund ta ndihmonte njeriun e vet në momentet më të vështira të jetës, sepse as këtë nuk ia lejonin...!

Këtu dukej se sa e çmuar është jeta kur e jeton në një vend të sigurtë, ashtu sikundër mësoje se sa e pavlefshme bëhet ajo në momente të caktuara. Këtu mësoje se si njeriu është gati t'i japë fund jetës në çdo moment, ndërkohë që lufton për ta mbrojtur atë me këmbë e me dhëmbë. Këtu njeriu sheh jo figura të krijuara skenike, që interpretojnë tragjedinë njerëzore, por vetë tragjedinë, që dikush mundohet ta rikrijojë duke sjellë te njerëzit mesazhe të forta nëpërmjet emocionesh shokuese. Jo, në këtë vend nuk ke nevojë për aq shumë mundim aktorësh. Këtu secili është lojtari origjinal i një tragjedie njerëzore të shkaktuar mbi të thjesht për fajin se rasti ka bërë që ai të lindë i një feje, besimi dhe kombi të caktuar!

Në intervistat për gjetjen e identitetit, kalonin njëri pas tjetrit burra, gra, të rinj, të moshuar.

Tjetri, kush është tjetri në radhë? - thërrisnin oficerët e imigracionit. Nga ajo datë deri më 10 qershor 1999, baza ushtarake e shtetit të New Jersey-it, Fort Dix, priti 6 mijë e 500 shqiptarë të Kosovës.

Fort Dix, New Jersey - ShBA, pranverë 1999

PËRQAFIMI I VOGËLUSHES SHEHRIJE

Gjatë intervistave me "mysafirët" kosovarë në Fort Dix mësova dhjetëra dhe ndoshta edhe më shumë ngjarje, që iu kishin ndodhur vëllezërve e motrave tanë nga Kosova, në ato ditë të tmerrshme të aksionit policor dhe ushtarak serb, kundër popullsisë civile. Një ndër to ishte edhe ajo që i kishte ndodhur Shehrijes së vogël.

Ajo ishte një 13-vjeçare, me fytyrë engjëlli të rreshkur, me sy zhbirues të frikësuar, me një qeshje të shtrënguar, me flokë të shpupurisur e të pakrehur, si shenjë e një pakujdesie të gjatë. Erdhi ngadalë, e ndrojtur dhe u ul në karrigen e të intervistuarës, përpara oficerit të imigracionit. Në fillim më ngjau me atë foton e afganes së tmerruar të popullarizuar si fotoja e shekullit e National Geographic Magazine.

- Si ndihesh? - e pyeti oficeri.

- Mirë, - iu përgjigj ajo, ndërsa mua m'u duk se në atë fjalë nuk ishte fare zanorja "i".

- Eh, si të them mirë?! - tha ajo.

- Ke nevojë të pish diçka? - i tha oficeri me mirësjellje.

- Jo, falemnderit! - i tha vajza, - Sapo piva diçka.

- A je në gjendje të flasësh? - shtoi ai.

- Po, - tha ajo, por mua m'u duk se edhe te kjo fjalë mungonte zanorja "o".

- Mund të fillojmë? - pyeti ai përsëri.

- Po, - përsëriti edhe ajo, por në moment u ngashërye deri në atë masë sa m'u afrua e u ngjesh pas meje.

Përqafimi

Shehrija m'i vuri duart rreth qafës, më pushtoi dhe me lotë e dënesë nuk po më ndahej. Gjendja e saj me preku sa nuk po i mbaja dot lotët. Po ndieja se dhe unë kisha aq shumë nevojë të shkarkoja diçka nga shpirti im. U mundova ta qetësoja sadopak, megjithëse në atë çast kisha aq shumë nevojë edhe për veten, por më parë sigurisht duhej të merresha me të. Kaluan disa minuta. Ajo u përmend dhe fshiu lotët me një pecetë letre, që gjendej në tavolinën e punës së oficerit. Pas pak filluam.

- Emri?

- Shehrije.

- Mbiemri?

- Bajrami.

- Emri i nënës? - Një ofshamë e thellë, e pjekur, diçka që sillte një vuajtje të hershme të kësaj fëmije doli me fjalët:

- Nëna ime quhej….

- Emri i Babait?

Një psherëtimë tjetër e thellë nga shpirti i saj doli bashkë me fjalët:

- Babai im quhej…

- Përse thua quheshin? - pyeti oficeri.

- Sepse ata nuk jetojnë më.

- Asnjëri?

- Jo, asnjëri.

- Si ndodhi?

- Nëna më vdiq që kur isha e vogël. Nuk e mbaj mend fare. Më rriti një nënë tjetër, gruaja e dytë e babait tim. Më ka dashur si fëmijën e vet dhe ndoshta nuk më la ta ndieja aq shumë mungesën e nënës sime. Babai erdhi në Amerikë kur unë isha e vogël. Punoi në një shtet, që quhet Ohio. Atje bëri ca para dhe mori edhe shtetësinë amerikane. Pas disa vitesh ai u kthye në vendlindje. Aty ngriti një biznes të vogël dhe ndërtoi një shtëpi të bukur. Me njerkën time bëri katër fëmijë, dy djem e dy vajza. Të gjithë si drita. Babi nuk merrej me politikë, por e shihja se ndihmonte shkollën private, që bëhej në shtëpinë e njërit prej fqinjëve tanë, pasi shkollat publike u mbyllën prej serbëve. Aty dërgonte para,

veshje, lojëra, fletore, libra, lapsa dhe mjete të tjera. Policia na përzinte shpesh nga shtëpia – "shkollë" dhe na i rrihte mësuesit para syve tanë. Babai i strehonte te ne nxënësit dhe mësuesit.

Aty nga vjeshta e vitit të kaluar u tha se do të vinin disa verifikatorë, të cilët do të vendoseshin nëpër të gjithë qytetet e Kosovës dhe do të raportonin situatën. Ata duhej të qëndronin diku, dhe babai im shkoi dhe iu tha:

"Merreni shtëpinë time! Është e mirë dhe mund ta përdorni sa kohë që jeni këtu. Mjafton që të raportoni atë që po ndodh me ne".

Babai kishte jetuar në Amerikë dhe shumë gjëra i kuptonte ndoshta më mirë se shumëkush. Verifikatorët erdhën dhe u vendosën te ne. Ata mbanin disa shenja të OSBE-së në rroba dhe në makina. Ne i deshëm shumë. Babai bënte gjithçka që ata të ndiheshin mirë, madje nuk iu merrte as qira dhe iu shërbente për shumë gjëra, që ata kishin nevojë. Qëndruan te ne deri para bombardimeve, më duket dy ditë përpara. Erdhi një urdhër dhe ata ikën. Ne u ndjemë krejt të vetmuar. Ata nuk kishin armë, por neve na dukej sikur na mbronin. Ata nuk ishin për të luftuar aty, por e ndjenim se dikush të paktën do ta shihte dhe dëshmonte atë që po ndodhte me ne. Me praninë e tyre na dukej sikur ishim pak më të sigurtë, por kur ata ikën, ne mbetëm në mëshirën e fatit.

Nuk zgjati shumë dhe filluan bombardimet. Bashkë me to edhe dëbimi, vrasjet e shfarosja. A e dini se nga ia nisën? Nga ata që kishin strehuar verifikatorët. Ne ishim pikërisht prej atyre. Me të kërcitur bomba e parë e NATO-s mbi caqet ushtarake serbe, në mëngjesin e ditës tjetër, mbërritën serbët te ne. Ishte një togë njerëzish. O zot sa të ashpër, të egër, të armatosur, të dehur… Ata bërtisnin, klithnin e shanin. Në shtëpi ishim të gjithë. Babai, njerka, vëllezërit, unë dhe motrat. Na nxorrën në oborr të shtëpisë. Na rreshtuan te muri. Pastaj e ndanë babain prej nesh. I thanë të lëvizte pesë hapa anash. Në fillim ai hezitoi, por pastaj lëvizi. Me sa duket e ndjeu se po të rrinte pranë nesh, do të ndante me ne vetëm vdekjen, e jo mbijetesën. Eci përpara dhe u kthye nga ne. Na pa njëherë të gjithëve dhe na tha në anglisht, siç na thoshte çdo ditë sa herë e përqafonim:

"I Love you all. I love you".

Në atë çast një breshëri automatiku u zbraz mbi trupin e tij. Ndoshta ishte me sy tek unë dhe në gojë kishte fjalën "lo…ve".

"Love" për herë të tretë kur iu këput zëri dhe ra për tokë. Vrapova drejt tij.

I rashë përsipër duke bërtitur: Jooooooo, Joooooo, Jo! Një ganxhë më ngriti përpjetë me atë forcë që m'u duk vetja si një pendë në ajër. I ndjeva këmbët, që nuk po më preknin më në tokë. E kisha humbur peshën në duart e një bishe, që sakaq më flakëroi diku në cep të oborrit. Një breshëri tjetër u zbraz dhe një krratje bishe më shumë se fjalë e dalë nga goja e një njeriu, u dëgjua:

"Berzhi, Berzhi".

Oborri i shtëpisë kishte dy porta. Të dyja të hapura. Unë dëgjoja automatikë që zbrazeshin. Babai kishte mbetur i shtrirë përtokë, ndërsa të tjerët po largoheshin në panik. Unë dhe njerka me dy motrat morëm të njëjtin drejtim, kurse vëllezërit një drejtim tjetër. Nuk e di se nga shkuan. Ja dolëm të dalim në Maqedoni. U paraqitëm tek Konsullata - çadër e Amerikës dhe ja ku jemi!

Ishim dy vetë, oficeri i imigracionit dhe unë, që kishim mbetur të shtangur. Çfarë force kishte ai fëmijë për të treguar atë që kishte parë me babain e saj, kur ne nuk kishim forcën e duhur për ta dëgjuar atë? Vërtet forcohet aq shumë njeriu?

Ditën tjetër, Shehrija më pa pranë qendrës së Kryqit të Kuq. Erdhi me vrap, si manare, dhe më përqafoi.

Ndjeva dhembjen dhe dashurinë që ndjen çdo prind, por kur u shkëput, që të më jepte dorën, ajo po qante me dënesë. U mundova ta qetësoja, i ofrova dhe diçka që ta pinte dhe më pas u largua. Ky ritual më shoqëroi disa ditë deri sa një ditë, motra e saj më tha:

I ngjaja babait të Shehrijes

- A e di ti se përse qan Sherija sa herë që të sheh ty?

Në të vërtetë unë diçka duhej të kisha marrë me mend, por megjithatë, asaj i thashë:

- Ma thuaj ti, të lutem!

- Sepse ti ngjan krejtësisht me babain tonë, - u përgjigj vogëlushja.

Ishte përgjigje e asaj vajze shkaku që më bëri të shkoja te shtëpia e saj, në Drenas, në rastin më të parë kur shkela në Kosovën e lirë.

Në Drenas të Kosovës përpara shtëpisë së Shehrijes së Bajraktarëve

Lufta tashmë ka mbaruar dhe Kosova është çliruar. Kam mbërritur aty dhe jam ndalur përpara një shtëpie në Drenas. Janë rrënojat e asaj, që dikur duhet të ketë qenë një shtëpi shumë e bukur, tipike e një shqiptari të Kosovës. Hyrja në oborr bëhet nëpërmjet të një porte me dy dyer të mëdhaja, aq sa të futesh edhe me qerre ose me makinë. Ballkonet janë të rënduara me ornamente, një modë e përhapur shumë në Kosovë.

Ishte krejt e braktisur.

Erdha të shihja vendin ku kishte rënë babai i Shehrijes, që unë i ngjaja aq shumë, i pushkatuar në sytë e fëmijëve të vet, në atë oborr. Tani Shehrija, e cila mbarte tërë peshën e kësaj tragjedie që pësoi Kosova, po ndërtonte jetën e saj në Tokën e Re, në vendin që u bë shpëtimtar për të dhe vendlindjen e saj. Ishte historia që ajo i rrëfeu oficerit të imigracionit amerikan në praninë time, që më solli mua te dera e kësaj shtëpie, në Drenas të Kosovës.

30 nëntor 1999

ME FEDERATËN PAN-SHQIPTARE TË AMERIKËS "VATRA"

Gjatë kohës së qëndrimit në New York, bashkëpunimi me "Vatrën" ishte po aq i rëndësishëm sa ai me Ligën Qytetare. Veprimtaritë e saj në dobi të çështjes së Kosovës përbëjnë një kapitull të artë. Nën drejtimin e ingj. Agim Karagjozit, zotëri Agim Rexhës dhe dr. Gjon Buçës, "Vatra" u bë vërtetë një vatër e përpjekjeve atdhetare. Përveç kësaj, në traditën e vet të ndriçimit të historisë së vetë organizatës, herë pas here "Vatra" përkujton momentet e rëndësishme të veprimtarisë së vet, që nga themelimi. Një ndër to ishte përkujtimi i 90-vjetorit të daljes së numrit të parë të gazetës "Dielli". Për këtë Kryetari i saj, ingj. Agim Karagjozi më kërkoi të mbaja një kumtesë, të cilën e prezantova përpara një audience të nderuar atdhetare me titull:

Roli i "Vatrës" dhe i "Diellit" në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, e përshkruar nga katër autorë të huaj

"Vatra" dhe "Dielli" kanë luajtur një rol të tillë në historinë e Shqipërisë saqë vështirë se mund ta krahasohen me ndonjë tjetër. Të dyja përbëjnë atë pjesë të shpirtit dhe mendjes shqiptare, e cila u largua nga atdheu, duke e lënë atë në kushte e rrethana që dihen, por pa e harruar kurrë.

Është folur dhe shkruar shumë lidhur me qëndrimin e "Vatrës" dhe organit të saj "Dielli". Por unë do të ndalem shkurt në trajtimin që i kanë bërë kësaj çështjeje katër autorë të huaj, të cilët kanë vepruar në emër të Vatrës ose kanë botuar libra shembullorë për Historinë e Shqipërisë. Në të gjithë këto libra është trajtuar roli i "Vatrës" dhe i "Diellit", duke iu referuar shtypit të kohës dhe

dokumenteve historike.

Edwin Jacques, autor amerikan, me librin e tij "Shqiptarët, një histori etnike prej kohëve para-historike deri në kohët moderne", botuar në SHBA në tetor 1995 nga Shtëpia Botuese McFarland & Co.

Ky autor jep një përshkrim historik të gjenezës shqiptare dhe zhvillimin e kombit tonë deri në ditët e sotme. Ai është ndalur te roli që luajtën shqiptarët e Amerikës në demaskimin e intrigave të fuqive evropiane dhe në formimin e shtetit shqiptar, e veçanërisht në rolin që luajtën ata në Konferencen e Paqes në Paris. Libri i Edwin Jacques ka sjellë citime të shumta nga arkivat në Washington D.C., por unë do të ndalem te disa prej tyre:

"Shqiptaro - amerikanët e Bostonit u mblodhën në një tubim historik më 4 nëntor 1915 për t'i dërguar peticion Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të krijuar një fond ndihmash ushqimore në ndihmë të popullatës shqiptare, e cila po vdiste nga uria, si rezultat i bllokadës italiane në bregun e detit shqiptar, pas Traktatit të Fshehtë të Londrës, i cili i jepte Italisë Vlorën. Në ato ditë të vështira të mbijetesës së popullit shqiptar, ishte Peshkopi Fan Noli, i cili lëshoi thirrjen e famshme:

"*Jepni për Nënën*"!

Ai nxiti djemtë besnikë të shqipes që të kontribuonin me 150 mijë dollarë në ndihmë të Shqipërisë, çka ishte një shumë kuptimplotë, po të kemi parasysh situatën e atëhershme dhe vlerën e monedhës.

Ndër ndihmesat më të mëdha historike të "Vatrës" mbeten marrëdhëniet e krerëve të saj me Presidentin Amerikan, Wodrow Wilson. Më 4 korrik 1918 Peshkopi Noli, i cili përfaqësonte Federatën Pan - Shqiptare "Vatra", bashkë me përfaqësues të tjerë kombesh të vogla, e shoqëruan Presidentin Wilson në jahtin presidencial "Mayflower" për te varreza e George Washingtonit në malin Vermont. Në këtë datë të shënuar, presidenti Wilson deklaroi katërmbëdhjetë parimet e vetqeverisjes së kombeve të vogla. Më pas Fan Noli u takua me Presidentin në "Mayflower" për të folur në emër të pavarësisë së Shqipërisë. Në atë takim presidenti Wilson i tha Fan Nolit:

> "*Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe atë zë do ta përdor në emër të Shqipërisë*".

Presidenti ishte prekur thellë nga telegramet dhe letrat, që kishte marrë nga shqiptarët për pavarësinë dhe ruajtjen e territorit të Shqipërisë.

Konferenca e Paqes e njohu Shqipërinë si komb me vetëqeverisje të ligjshme brenda kufijve të vendosur më 1913 dhe i urdhëroi ushtritë e vendeve fqinjë të largoheshin menjëherë prej territorit të saj. Fan Noli, si përfaqësuesi i "Vatrës" deklaroi:

> "*Presidenti Wilson bëri më shumë se askush tjetër për pavarësinë e Shqipërisë. Ai refuzoi kategorikisht të nënshkruante marrëveshjen deri në momentin kur u sigurua për të drejtën vetëqeverisëse të shqiptarëve*".

Është e lehtë të kuptohet se sa cinik ka qenë sistemi komunist në Shqipëri kur deklaronte se i vetmi regjim që mbrojti të drejtat e kombeve të vegjël ishte ai sovjetik, i udhëhequr nga Lenini.

Dr. Harris Silajxhiç në librin "*Shqipëria dhe shqiptarët në Arkivat e Washingtonit*", me të cilin ka marrë gradën Doktor i Shkencave Historike, ka dhënë një pasqyrë të shkëlqyer të luftës dhe përpjekjeve që intelektualët shqiptarë dhe vatranët në SHBA, kanë bërë për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe për formimin e shtetit shqiptar. Dr. Silajxhiç mund të themi se ka arritur të na japë me dashamirësi orientimin perëndimor e veçanërisht orientimin proamerikan të shqiptarëve, çka është nder për ne dhe goditje për pseudo-historianët, të cilët kërkojnë ta identifikojnë kombin shqiptar me një komb të prapambetur e të paorientuar.

Në këtë libër autori ka arritur të nënvizojë aftësinë e vatranëve për ta rreshtuar vendin e tyre në krah të palës fituese, si dhe afrimin e miqve, të cilët e duan Shqipërinë. Dhe këta miq janë gjetur e gjenden gjithnjë në SHBA.

Në librin e tij dr. Silajxhiç i ka kushtuar vëmendje shumë të madhe ndikimit të "Vatrës" mbi delegacionin amerikan në Konferencën e Paqes dhe rrjedhimisht qëndrimit amerikan mbi këtë çështje. Për këtë ai i është referuar gazetës "Dielli" dhe shumë burimeve të tjera të botuara. Megjithëse vatranët nuk arritën t'ia mbushnin mendjen presidentit Wilson, që ta merrte Shqipërinë nën një protektorat amerikan, përsëri roli i "Vatrës" në mbrojtjen e kufijve të përcaktuar më 1913 nga një copëtim i mëtejshëm, mbetet historik.

Vatranët e drejtuan luftën e tyre në këto drejtime kryesore, thotë dr. Silajxhiç:

- Në bindjen e delegacionit amerikan mbi drejtësinë e kërkesave shqiptare;
- Në diskretitimin e propagandës armiqësore anti-shqiptare, e sidomos asaj greke, sipas së cilës, të tërë ortodoksët e jugut të Shqipërisë janë grekë;
- Në gjallërimin e jetës politike në atdhe.

Detyra bazë e emigrantëve shqiptarë në Amerikë të grumbulluar rreth "Vatrës" ishte që të demonstronin se shqiptarët e besimit ortodoks, që jetonin në Shqipërinë e Jugut ose ata që kishin ardhur në Amerikë nga ajo zonë, nuk ishin grekë. Shqiptarët e Amerikës, të shqetësuar nga deklaratat e Venizellosit dhe Politisit, u dërgojnë nëpërmjet Mehmet Konicës telegram udhëheqësve të katër Fuqive të Mëdha, në të cilën tregojnë vendosmërinë e tyre në favor të çështjes shqiptare. Në mbledhje morën pjesë 124 priftërinj, ndër ta edhe rumunë me origjinë nga Korça, çka ishte një përgjigje e drejtpërdrejtë kundër presionit të Patriarkanës Greke ndaj popullsisë ortodokse shqiptare në Shqipërinë e Jugut.

Këtu vlen të përmendet edhe një telegram i dr. Mihal Turtullit në emër të Federatës Pan-Shqiptare "Vatra", dërguar presidentit Wilson, ku i jep fakte rreth fallsitetit të thënieve greke mbi numrin e grekëve në jug të Shqipërisë. Në qerthullin e intrigave anti-shqiptare të grekëve dhe qarqeve tjera, "Vatra" luajti një rol të pazëvendësueshëm në sqarimin e identitetit të kombit shqiptar, përkatësisht të banorëve shqiptarë të zonave që synohej të copëtoheshin.

Në një letër drejtuar presidentit Wilson, vatranët e krishterë shkruanin:

"Ne të poshtëshënuarit, të krishterë ortodoksë, të lindur në këtë pjesë të Shqipërisë, të cilin disa e quajnë Epir të Veriut, protestojmë energjikisht kundër deklaratave të z. Karapanos. Situata në të cilën gjenden banorët e besimit kristian nuk dallon aspak nga situata, në të cilën gjendet pjesa tjetër e bashkatdhetarëve tanë. Të krishterë dhe myslimanë, jemi bij të të njëjtit atdhe, që flasim të njëjtën gjuhë, që kemi të njëjtat ndjenja dhe interesa dhe që gjithmonë kemi punuar së bashku për të njëjtën çështje: Ruajtjen e tërësinë tokësore dhe pavarësinë e Shqipërisë. Ne, jo vetëm që nuk kemi pranuar pushtimin e Shqipërisë nga trupat greke, por sapo

kujtojmë genocidin e tyre të pashembullt mbi shqiptarët, kryer gjatë vitit 1914, na dridhet zemra nga tmerri".

Vatranët kanë meritë të madhe sepse i ofruan për herë të parë delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris të drejtën për të dëshmuar në Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë në Senatin Amerikan. Prezantimin para Senatit e ka bërë njëri ndër anëtarët aktivë të Federatës Pan-Shqiptare "Vatra", Konstandin Çekrezi (anëtar i Kolegjiumit të Universitetit Kolumbia), i cili, pasi paraqiti shkurtimisht Historinë e Shqipërisë, iu kërkoi senatorëve që të përqendroheshin veçanërisht në Shqipërinë e Jugut. Ai e akuzoi Unionin Pan-Epirot për falsifikim të nënshkrimeve në memorandumin, që kjo organizatë i kishte dërguar Konferencës. Ai akuzoi pjesëmarrësit në Konferencë se çështjen e Shqipërisë po e përdornin si objekt kompensimi për çështjet e tyre.

Ishte edhe Kristo Dako, që po ashtu e akuzoi Greqinë për gjithçka që kishte bërë, duke dëshmuar për masakrat e kryera ndaj shqiptarëve dhe kërkoi komision hetimi në vend, i cili të vendoste për fatin e Shqipërisë.

Merita e "Vatrës" qëndron te fakti se ajo arriti të bënte që SHBA ta bllokonte vënien në jetë të Traktatit të Fshehtë të Londrës. Pra, vatranët arritën ta bindin Presidentin Wilson për drejtësinë e kauzës së tyre.

Idetë e "Vatrës" për orientimin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve janë shprehur më së miri nëpërmjet kryetarit të atëhershëm të saj, Fan Noli, i cili kërkonte një komision amerikan, si i vetmi i paanshëm, për t'i ndihmuar shqiptarët për krijimin dhe vënien në efiçiencë të një shteti, ku çdo shqiptar besnik të ndjehej i kënaqur. Noli ishte i sigurtë se shumë shqiptarë, që ishin detyruar të emigronin në Amerikë, kishin dëshirë të ktheheshin në atdhe dhe të jepnin ndihmesën në zhvillimin e tij dhe, *"me futjen e koncepteve amerikane të lirisë, ekonomisë dhe zhvillimit politik"*, ta fusnin Shqipërinë në rrugën e rilindjes ekonomike dhe kulturore. Institucionet arsimore amerikane, sipas mendimit të Nolit, do të ishin…

"…*shpëtim për Shqipërinë, duke patur parasysh se kultura anglo-saksone i përshtatet më mirë shpirtit puritan të racës shqiptare*".

Shihet qartë, pra, se çfarë orientimi donte t'i jepte "Vatra" zhvillimit

të ardhshëm politik e ekonomik. Shqiptarët e Amerikës nën drejtimin e saj arritën që të kenë ndikim të jashtëzakonëshëm te përfaqësuesit amerikanë në Konferencë. Ata luftuan për ta patur Amerikën mandatore. Kërkesën, sipas dr. Silajxhiç, për një Madat Amerikan mbi Shqipërinë e paraqiti një amerikan që vepronte në emër të "Vatrës" e që do e shtjellojmë më poshtë.

Dr. Charles Telford Erickson ishte amerikani, mik i shquar i "Vatrës". Ai lindi në vitin 1867 në Galensburg të Illinois-it nga prindër emigrantë suedezë.

Pas diplomimit në Universitetin e Bostonit dhe pas një viti të kaluar në Burma, Erickson për disa vjet shërbeu si pastor në kishat e Ohio-s. Më vonë kaloi tre vjet në Yale University, ku mori diplomë masteri, në vitin 1902. Më pas shërbeu si pastor në Connecticut, derisa u emërua drejtor i një misioni të "American Board of Foreign Missions" në Shqipëri, në vitin 1908. Ai shërbeu në Korçë, Tiranë dhe Elbasan deri në dhjetor të vitit 1912.

Në vitin 1919, i përkrahur edhe nga Noli, Konica dhe delegacionet shqiptare të Shqipërisë e diasporës, Erickson, hartoi memorandumin e veçantë, duke kërkuar nga presidenti Wilson dhe SHBA-ja që ta vendosnin Shqipërinë nën protektoratin amerikan. Më pas, ai punoi si komisioner special për Shqipërinë në Shtetet e Bashkuara në vitet 1920-1921. Në periudhën 1922-1923, gjendet sërish në Shqipëri, kësaj radhe si asistent në personelin e Legatës Amerikane në Tiranë.

I mbështetur nga qeveria shqiptare, në atë kohë me kryeministër Ahmet Zogun, kontribuoi për të ngritur kolegjin bujqësor të Kavajës, për djemtë dhe një shkollë për vajzat.

"Vatra" e kontaktoi Erickson-in në Romë ndërkohë që drejtonte Kryqin e Kuq Ndërkombëtar për Jugun e Italisë dhe i kërkoi atij që t'i bashkohej delegacionit të tyre të sapoformuar në Konferencën e Paqes në Paris.

Ata e zgjodhën atë, pasi ndienin urgjencën për të pasur disa zëdhënës të çështjes kombëtare me profil të lartë, të cilët do të dinin çfarë të kërkonin dhe si ta kërkonin tek Woodrow Wilson-i. Erickson-i jo vetëm që e pranoi kërkesën për t'u bërë i pari amerikan i lindur në Amerikë, që përfaqësonte kombin shqiptar, por ai mezi e priti rastin për t'i shërbyer përsëri kombit tonë. "Vatra", siguroi fondin e nevojshëm financiar dhe i ofroi Erickson-it një pozicion si delegat nderi, për t'i përfaqësuar në konferencë. Në fakt, ky ishte një veprim

shumë i zgjuar i "Vatrës" në mbrojtje të çështjes shqiptare në Paris.

Erickson-i u nis për në Konferencën e Paqes në Paris. Me të arritur atje, atij iu desh të kalonte pak kohë për ta pikasur se ku gjendeshin anëtarët e delegacionit amerikan, të cilëve ai do t'u paraqiste pozicionin e delegacionit shqiptar.

Që prej 15 shkurtit të vitit 1919, delegacioni amerikan, i cili dukej se i njihte veprimtaritë e Erickson-it, u informua se përfaqësuesit e qeverisë së përkohshme të Shqipërisë në Paris ishin, Turhan Pasha, kryetar, Mehmet Konica, ministër i Punëve të Jashtme dhe Charles Telford Erickson-i, delegat nderi. Në këtë mënyrë Erickson-i iu fut një pune titanike për ta informuar Presidentin Wilson mbi të drejtën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.

Erickson në shënimet e tij shkruan:

…"Me të arritur në Paris, hapi tjetër që duhej të bëja ishte të gjeja ku ishte delegacioni amerikan. Çfarë kishte ndodhur me Katërmbëdhjetë Pikat e Presidentit Wilson, të cilat ishin tërësisht në kundërshtim me Traktatin e fshehtë të Londrës? Ku qëndronin ata në lidhje me kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut? Kështu unë u paraqita para zyrës së delegacionit në hotel "Crillon". Ishte gjenerali Blis që më priti. Ai ishte babaxhan dhe zemërbardhë, por shihej qartë se dinte shumë pak ose aspak rreth çështjeve që kisha unë ndër mend. Ai më paraqiti tek kreu i divizionit të Ballkanit, dr. W.L Westerman dhe z. Clive Day."

"…Tani problemi ishte si të arrinim deri tek Presidenti Wilson!? Vendosa të ndërmerrja një veprim të fortë, duke shkruar një deklaratë të shkurtër rreth situatës sonë, të cilën ia drejtova jo vetë Presidentit, por zonjës Wilson, me të cilën njihesha prej kohës kur të dy punonim për Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, bashkë me një letër shoqëruese ku i shpjegova qëllimin tim."

"Disa ditë më vonë na erdhi një mesazh prej sekretarit të Presidentit. Ishte një deklaratë e lëshuar nga Presidenti dhe botuar në Paris Press. *Ajo fillimisht paraqiste shqetësimet për pretendimet e Italisë ndaj Fiumes dhe i hidhte poshtë si të bazuara thjesht në interesa dhe jo në parime."*

"Nuk janë në pikëpyetje "interesat" thuhej aty, por të drejtat e popujve, sundimtarët e të cilëve kurrë nuk i kanë llogaritur të drejtat e tyre si të vlefshme. Duke u zgjeruar më tej në këtë deklaratë ai e mbyllte atë me këto fjalë:

Unë refuzoj të pranoj se, meqë qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka qenë palë

në këtë traktat, (traktati i Fshehtë i Londrës, shënim i MB) të ketë qenë në fakt edhe tërësisht e panjohur me ato që janë vendosur aty. Rrethanat e reja e kanë transformuar atë në një copë letër pa vlerë."

Kur e lexuam këtë deklaratë befasuese, pyetëm veten nëse ishte letra ime e cila i kishte dhënë Presidentit njohjen e parë të ekzistencës së atij traktati të fshehtë me Italinë. Sidoqoftë, ne kishim tashmë Yllin tonë Polar dhe nuk humbëm kohë që ta ndiqnim atë. Mëngjesin tjetër Presidentin e priste në tavolinë teksti i letrës së mëposhtme:

Shkëlqësisë së tij Woodrow Wilson,
President i Shteteve të Bashkuara
Paris, 24 prill 1919
Zotëri,

A do të na lejoje ne, përfaqësuesve të një kombi të vogël, që gjithmonë i ka vlerësuar nderin, drejtësinë dhe guximin si virtytet më të larta, që t'u shprehim Juve mirënjohjen më të thellë për ndjesitë tuaja fisnike, të cilave ju i keni dhënë shprehje të tilla kaq të fuqishme? Në to ne shohim shpalljen e lirisë, njësoj si raca me ngjyrë e vendit Tuaj i sheh të vetat në Shpalljen e paraardhësit Tuaj të nderuar, Abraham Linkolnit.

Duke ditur ndoshta më mirë se ju, se sa të thella janë rrënjët e imperializmit në Evropë, se sa i paepur është egoizmi, ne frikësoheshim pa masë se mos ju dhe kolegët tuaj do të detyroheshit, përkundër tërë asaj që mund të bënit, të dorëzoheshit ose më në fund të bënit kompromis në dëm të parimeve për të cilat Amerika i hyri kësaj lufte. Kështu Shqipëria do të bëhej edhe një herë mish për top, siç është bërë kaq shpesh në të kaluarën. Deklarata juaj, e botuar këtë mëngjes, zhduk edhe gjurmën e fundit të asaj frike.

Tani ne e dimë se çështja jonë humb vetëm nëse humbet çështja juaj, sepse të dyja janë një, dhe ajo do të ndodhë vetëm nëse vetë Zoti dështon, që do të thotë, KURRË!

Z. President, Ju treguat këtë mëngjes se jeni udhëheqësi i denjë i një populli të madh e fisnik, të cilin e përfaqësoni kaq denjësisht. Në deklaratën tuaj populli amerikan do të gjejë një mesazh edhe për vete, një thirrje të një detyre të lartë e të shenjtë dhe, nëse nevojitet, vetë guximin që do të përligjë të drejtën morale të Amerikës për të udhëhequr në këtë orë të rëndë e kritike për botën.

Pranoni, z .President, mirënjohjen tonë më të thellë dhe respektin më të

madh si,

Shërbëtorët Tuaj më të bindur dhe plot nderim,
Mehmet Konica
Mihal Turtulli
Charles Telford Erickson

"Ditën tjetër ne u gëzuam aq shumë", thotë Erickson-i, "sa nuk mund ta shprehin fjalët, kur morën letrën e mëposhtme nga vetë Presidenti Wilson:"

Të dashur zotërinj,

E kam vështirë që në mes të një ditë kaq të ngarkuar me punë t'ju tregoj si duhet se sa shumë jam gëzuar kur mora letrën tuaj të datës njëzet e katër prill dhe se sa thellësisht i interesuar jam unë të shoh parimet e paqes së vërtetë të zbatuara me besnikërinë më të madhe.

Me nxitimin më të pashmangshëm
Sinqerisht i Juaji
Woodrou Wilson

Më pas Erickson-i e vijon korrespendencën në emër të delegacionit shqiptar si më poshtë:

Shkëlqësisë së tij, Woodrow Wilson
President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Zotëri,

Delegacioni shqiptar iu është shumë mirënjohës për letrën tuaj aq të bukur të datës 25 prill dhe për sigurimet që Ju përsëri dhatë rreth qëllimeve tuaja për të vazhduar me vendosmërinë më të madhe përpjekjet për arritjen e një paqeje të përhershme. Duke njohur sinqeritetin tuaj rreth këtij qëllimi dhe qartësinë me të cilën ju i shihni kushtet qenësore për arritjen e një paqeje të tillë, ne guxojmë të sjellim në vëmendjen tuaj edhe një herë çështjen e Vlorës. Në Memorandumin e botuar në gazetat e mëngjesit të datës 30 prill ju deklaroni:

Në emër të këtij kombi të vogël, i cili ka qëndruar kaq shumë përkundër padrejtësive shekullore që i janë bërë, duke mos patur miq apo mbrojtës midis kombeve të tjera, ne, përfaqësuesit e tij, ju përgjërohemi juve që të përdorni

personalitetin Tuaj të fuqishëm, jo vetëm për ta mbrojtur atë nga poshtërimi dhe shkatërrimi i mëtejshëm, por ta ndihmoni atë në fillimin e realizmit të ëndrrës së tij për një të ardhme fisnike.

Ne jemi, Shkëlqësia Juaj,

Shërbëtorët Tuaj të bindur dhe plot nderim

Nënshkruar:

Mehmet Konica
Mihal Turtulli
Charles Telford Erickson.

Erickson-i shërbeu edhe si delegat i "Vatrës" në Konferencën e Kombeve të Bashkuara, e cila u mbajt në San Francisco, California, në vitin 1945. Ai asnjëherë nuk e harroi Shqipërinë, por vazhdoi të ishte një nga miqtë e saj derisa sa vdiq në vitin 1966, pak pa i mbushur 100 vjet. Ai ka lënë një seri prej pesë librash për Shqipërinë, të pobotuara, nën titullin "Shqiptarët - Enigma e Ballkanit".

Edith Pierpont Stickney, edhe kjo autore amerikane, e cila ka doktoruar në shkencat historike me librin: *"Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare nga viti 1912 deri më 1923",* botuar më 1925. Autorja e ka hulumtuar materialin e jashtëzakonshëm të Bibliotekës së Hooverit në SHBA (Koleksioni më i madh në botë rreth Shqipërisë për periudhën në fjalë) dhe ka sjellë te ne një studim, i cili duhet çmuar për shumë të vërteta, që janë thënë aty.

Në morinë e fakteve të trajtuara nga Stickney, desha të ndalem te përshkrimi, që ajo i ka bërë rolit që luajti "Vatra" jonë, si kundërshtare e denjë dhe bindëse, ndaj propagandës greke në Konferencën e Paqes. Rreth 31 organizata Pan-epirote nga SHBA-ja, Anglia, Australia e gjetkë kishin ndërmarrë një fushatë të ethshme shpifjesh e mashtrimesh mbi gjoja të drejtën historike dhe të ligjshme, që sipas tyre, gëzonin grekët mbi Epirin e Veriut, ose mbi Shqipërinë e Jugut. Autorja thotë se në përbërje të këtyre organizatave bënin pjesë gjithëfarë pseudo-

historianësh, pseudo-gazetarësh, falsifikatorësh, pamfletistësh, karikaturistësh, fotografësh, që mbushnin çdo rrugë kryesore të Parisit me fletushka, të cilat shprehnin "padrejtësinë e madhe", që iu ishte bërë grekëve të Epirit të Veriut. Kësaj lukunie greke i bënte ballë me dinjitet Federata Pan-Shqiptare "Vatra" dhe organi i saj "Dielli". Ndërsa nga Anglia një grup intelektualësh të shquar anglezë, të drejtuar nga e njohura Edith Durham dhe Aubrey Herbert, punonin pareshtur sa me Foreign Office-n anglez, aq edhe me mjetet e atëhershme propagandistike, për të bindur opinionin publik mbi drejtësinë e kërkesave të shqiptarëve.

Stickney nënvizon faktin se Federata Pan-Shqiptare "Vatra" e Amerikës, që nga formimi i saj më 1909 e deri më 1919 kishte arritur të ndërtonte 72 degë ane mbanë SHBA-së dhe Kanadasë, si dhe të botonte gazetën e saj "Dielli" dhe një revistë mujore të quajtur "Adriatic Review".

Kjo shoqëri dërgoi një delegat në Paris më 1919, Rev. C. Telford Erickson, ish-misionar amerikan në Lindjen e Afërt. E dyta për nga rëndësia, thotë Stikney, ishte Shoqëria Anglo - Shqiptare, e cila kishte si qëllim njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo Shoqëri luftonte në dy fronte: atë të botimeve dhe të komunikimit me shtypin dhe Dhomën e Komunave. Nga më të shquarit prej tyre ishin i nderuari Aubrey Herbert, si president, dhe Edith Durham, të dy miq të flaktë të Shqipërisë. Përkrah përfaqësuesit të Federatës Pan-Shqiptare "Vatra" ishin edhe delegacione të tjera të përbëra prej delegatësh nga kolonitë në Stamboll, Rumani dhe nga zona e Korçës.

Rëndësinë e veprimtarisë së "Vatrës" në dobi të çështjes shqiptare e ka shprehur më mirë se kushdo një ndër armiqtë më të mëdhenj të Shqipërisë, Kryeministri i atëhershëm grek Venizellos, kur deklaronte:

"Ishte "Vatra" ajo që ma hoqi nga dora "Vorio Epirin".

"Vatra" është nga ato organizata shqiptare, që ka vulosur në historinë e Shqipërisë një emër të artë, sepse korifejtë e kulturës sonë kombëtare, Noli e Konica, e sa e sa bij të tjerë të "Vatrës" kanë vënë çdo gjë në shërbim të atdheut. Në këtë pamje le ta kujtojmë historinë e "Vatrës", që ajo të përsëritet te brezat e rinj qofshin të lindur, qofshin të ardhur rishtaz në Amerikë. Le të luftojmë që, në vend të Stefanopollusve, që kështillojnë Presidentin e Amerikës se si t'u

lëshojë dorë të lirë grekëve në jug të Shqipërisë, të kemi një Erickson, i cili deklaronte në Kongresin Amerikan në vitin 1919 si më poshtë:

> *"Te shqiptarët gjen virtyte, të cilat do të ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Propaganda sistematike i ka paraqitur si armiq të qytetërimit dhe plaçkitës, por kjo është vetëm gënjeshtër. Unë kam jetuar disa vite në mes të shqiptarëve dhe për këtë ndjehem i detyruar të them të vërtetën. Ata janë inteligjentë, fisnikë, punëtorë, e duan jetën familjare, seriozë, mikpritës, besnikë deri në vdekje. Për të tillë popull e kam njohur popullin shqiptar dhe jam krenar që po e përfaqësoj sot këtu".*

Pikërisht në këtë traditë të "Vatrës" u zhvillua lufta e vatranëve edhe për çlirimin e Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve të popullit amerikan në Kongres, Senat e administratë.

Historia e "Vatrës" dhe e "Diellit" bëjnë pjesë në fondin e artë të përpjekjeve shqiptare në shekullin e fundit të Mijëvjeçarit të Dytë.

Southern Gate Hotel, New York, 30 tetor 1999

ME ARBËR XHAFERRIN NË OSSENING, NEW YORK DHE NË TETOVË

Një ditë, ndërsa po punoja në zyrën e Joit në Ossening, aty erdhi Arbër Xhaferri, politikani i njohur shqiptar nga Tetova. Ishte hera e parë që e takoja atë burrë, i cili, sa më shumë kohë do të kalonte, aq më shumë e me të drejtë do të cilësohej si strateg dhe politolog i veçantë shqiptar. Biseduam gjatë për situatën në Maqedoni dhe në Kosovë, por po me aq shqetësim foli ai edhe për situatën në Shqipëri. Pastaj më tha:

"Ti ke rol shumë të rëndësishëm për të luajtur në këtë organizatë. Ti duhet të kuptosh që kontributi yt këtu është shumë i rëndësishëm. Prandaj, ndihmo me çdo mjet".

Ai qëndroi disa ditë dhe Liga i bëri shumë nderime.

Do ta takoja përsëri natën e 27 nëntorit të vitit 1999 në Tetovë. Grupi ynë i Ligës, i përbërë prej 18 vetësh, zbriti në aeroportin e Shkupit, më pas na organizuan një pritje në Tetovë. Në mesnatë kaluam nga Tetova, nëpër pikën kufitare të Gllboçicës, dhe dolëm në Ferizajn e djegur e bërë zhar nga lufta.

Në orët e para pas mesnate shkela për herë të parë në Hotelin "Grand", i shumëpërmendur ndër vite. Fjetëm vetëm dy-tri orë, u zgjuam në Prishtinën ende të rrënuar nga lufta dhe udhëtuam për në Prizren. Ishte 28 nëntor 1999 dhe ne do të festonim përpara Shtëpisë së Lidhjes së Prizrenit. Liga Qytetare, Joseph DioGuardi dhe Shirley Cloyes si dhe 16 anëtarë të tjerë të atij grupi kishim shumë të drejtë të festonim dhe t'u gëzoheshim fryteve të një pune shumëvjeçare të palodhur.

Ky ishte shpërblimi më i mirë.

NJË DITË ME SENATORIN JOHN MCCAIN PËR NJOHJEN E KOSOVËS SË PAVARUR, NË MANHATTAN

Me Ligën Qytetare Shqiparo - Amerikane duke pritur Senatorin John McCain

Në fillim të vitit 2000, Kosova ishte vënë nën administrimin e UNMIK-ut, ndërsa shqiptarët luftonin me çdo mjet që të arrinin shpalljen e pavarësisë së Republikës dhe njohjen e saj nga ana e Shteteve të Bashkuara. Për këtë veprimtari ishte përfshirë edhe Liga Qytetare Shqiptaro - Amerikane. Bashkë me veprimtarë të dalluar të Ligës si Agim Aliçkaj, Zef Bala, Vincent dhe Peter Saljani, David Balaj, Hafiz Shala, Arslan Cekaj dhe një grup tjetër veprimtarësh dolëm në krye të një turme disamijëshe.

Përpara Hotel "Regent" kishim ngritur një podium dhe ishte vendosur një mikrofon prej nga mbaheshin fjalime dhe manifestohej me flamuj kombëtarë dhe me parulla për njohjen e pavarësisë. Pas rreth një ore, në rrugën 42, përpara Stacionit Qendror të Trenit u shfaq autobusi me parullën e fushatës së senatorit në ballë: "Straight Talk".

Senatori John McCain me Straight Talk (Të flasim pa doreza)

Senatori McCain, flokëbardhë i tëri, ekspresiv, me ecje të drejtë e krenare, doli nga autobusi dhe iu drejtua miniskenës që kishim ngritur. Ai hipi në podium dhe priti sa ta paraqiste DioGuardi, i cili tha ndër të tjera:

"Këtu është sot me ne një hero, një burrë që e njeh më mirë se kushdo sigurinë

tonë kombëtare, pasi i ka kushtuar jetën shërbimit nën armë dhe po ashtu në Kongresin Amerikan".

Pastaj fjalën e mori senatori, ndërsa turma thërriste: "McCain President, McCain President". Ai foli për shqiptarët, foli për mbrojtjen që u kanë bërë hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe premtoi që, nëse bëhej President i Amerikës, ai do ta kishte çdo ditë në vëmendje çështjen e Kosovës deri në pavarësimin dhe njohjen e saj. Këtu ai e mbylli fjalimin dhe la pas një masë njerëzish të ngazëllyer nga premtimet e këtij burri të madh të kombit amerikan.

Pas kësaj, ai iu drejtua sallës tremijëvendëshe të Hotelit "Regent", ku do të mbante takimin zgjedhor të radhës. Ndërsa DioGuardi na e bëri me shenjë:

"Le të shkojmë edhe ne."

Dreka me McCain dhe çeku 250 dollarësh

Zbrita nga tribuna dhe iu drejtova shkallareve të hotelit. Kur arrita në katin e parë, aty prisnin stjuartë, të cilët të orientonin drejt sallës ku bëhej takimi i senatorit me kontribuesit e vet. Eca nëpër një korridor të gjatë dhe përpara meje u shfaq një tavolinë, në të cilin ishin ndoshta pesëmbëdhjetë djem e vajza të reja, të cilët mblidhnin fonde per kandidatin. Në ballë të tavolinës shkruhej:

"McCain President! Kontribuoni për Presidentin tonë! Pranojmë çeqe, urdhër pagesa, karta krediti, por jo para në dorë! Minimumi i pranueshëm 250 dollarë, maksimumi 2.000 dollarë".

Kur pashë se hyrja aty bëhej me para, nxora nga xhepi një çek, vura shumën minimale, e nënshkrova dhe e dorëzova në tryezë. Eca drejt sallës, vajta dhe u ula ku gjeta një karrige dhe po dëgjoja senatorin ndërsa fliste. Në krahun e djathtë ai kishte bashkëshorten Cindy McCain, dikur Miss Arizona, ndërsa në të majtë kishte të bijën, me gruan e parë, po ashtu Cindy McCain. Ai e filloi fjalimin me një kompliment për të dyja dhe u betua se të dyja paguajnë taksa për çdo dollar që fitojnë. Për amerikanët të paguash ose jo taksa është jo vetëm detyrim ligjor, por edhe çështje nderi.

Një kartolinë nga Senatori McCain

Dola nga ai takim, kalova nga banka, depozitova diçka që çeku i lëshuar të ishte i mbuluar dhe shkova në shtëpi. Nuk kaloi as një javë dhe në adresën time të shtëpisë erdhi një zarf nga zyra e senatorit me emblemën "Straight Talk". E hapa dhe e lexova. Ishte një kartolinë falënderimi për donacionin. Brenda kishte një foto shumë të bukur të senatorit me bashkëshorten Cindy-in dhe një mbishkrim:

"I dashur Mal, shumë falemnderit për mbështetjen tuaj, John & Cindy".

E lashë letrën mbi tavolinë dhe dola nga shtëpia.

Habia e babait tim

Në mbrëmje, babai im, i cili pak ditë më parë kishte ardhur nga Shqipëria për vizitë, më pyeti për ato që kisha bërë atë ditë, dhe më pas shtoi:

– More, pashë një letër që të ka ardhur prej një senatori, të cilin e shoh çdo ditë në televizor dhe, mesa po kuptoj unë, ai dëshiron të bëhet President i Shteteve të Bashkuara. A është ky që të ka shkruar ty, apo e kam unë gabim?

– Po, - i thashë, - është pikërisht ky që më ka shkruar, senatori John McCain.

E pashë që u habit shumë. Më pa me dyshim, por ndjeva edhe një farë simpatie në sytë e tij.

– Po, ky njeri kaq i madh të paska shkruar ty, personalisht ty?!

– Po, - i thashë, - ky, bash ky është!

– Ky që dëshiron të bëhet President i Amerikës?

– Po, - i thashë.

– Ai mbeti i habitur.

E pashë se sa mosbesues ishte, por lexoja në sytë e tij edhe dëshirën që unë t'i thoja: "Po, ky është!"

Ashtu bëra. Po, ky që po përpiqet të bëhet President i SHBA-të më ka

shkruar vetë, personalisht me bashkëshorten. Ja emrat e tyre dhe nënshkrimi me bojë blu.

– Po mirë, më tha ai, nëse bëhet ky President, ti…?

– Unë në Washington DC, i dashur babë. Me punu për Amerikën, besoj në shërbimin diplomatik. Mbase një ditë vij në Ambasadën Amerikane në Tiranë.

Skepticizmi i tij ishte po aq i qartë sa edhe vetë shakaja ime.

– Eh mor babë, unë e di se ti gjithmonë më ke nënvlerësuar, por mos u habit, një ditë…! Thjesht lutu që McCain të bëhet President!

Pasi më kërkoi që të mos bëja humor, i tregova të vërtetën. I thashë se kisha bërë një donacion për senatorin dhe kjo letër ishte jo vetëm një falënderim për atë shumë të vogël, (që në fakt për ne ishte shumë e madhe), por edhe një kërkesë. Në faqen e pasme letra kishte edhe një formular për një donacion tjetër në të cilën thuhej:

"Vetëm falë mbështetjes suaj ne do të jemi të suksesshëm në fushatën tonë".

Lexova habi në sytë e tij për një çast, por pastaj ajo u kthye në një farë simpatie teksa u shpreh:

– Domethënë këta mbledhin para nga populli që të bëhen Presidentë?

– Po, - i thashë.

– Epo, prandaj këta bëjnë çfarë iu kërkon populli kur zgjidhen, sepse zgjidhen me dëshirën dhe të hollat e popullit dhe nuk është populli që detyrohet të bëjë vetëm çfarë dëshirojnë këta, kur hipin në karrige.

Babai im, edhe pse i vjetër dhe pa njohje për gjuhën angleze, e kishte kuptuar shumë mirë thelbin e zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Hero i madh, edhe pse jo president

John McCain nuk mundi të zgjidhet President i Amerikës, por një takim me të mbetej në kujtesën e njeriut, ndërsa Amerika e nderoi atë përherë si heroin e vet, të burgosurin peng të Luftës në Vietnam që u bë kongresmen, senator, kandidat për President dhe më e rëndësishmja për ne: Një mik shumë i çmuar i shqiptarëve. Ai përherë e ka mbështetur Kosovën, madje në vitin 2009 zonja e tij Cindy e vizitoi atë, duke ngjallur diskutime të shumta në Serbi.

TAKIM ME GJENERALIN WESLEY CLARK

Në maj të vitit 2001, Gjenerali amerikan Wesley Clark, komandanti i forcave ushtarake të NATO-s botoi librin e tij "Të bësh Luftë Moderne". Vetëm disa javë më vonë, në korrik, Liga Qytetare Shqiptaro - Amerikane organizoi një veprimtari me autorin. Pjesëmarrësit morën libra me autograf prej Gjeneralit, ndërsa Presidenti i Ligës, DioGuardi, i dha atij Mirënjohjen e Parë të Paqës në Ballkan, dekoratë e Ligës për personalitete të larta.

Në atë takim, Gjenerali Clark tregoi përvojën e tij në drejtimin e forcave të NATO-s në zhvillimin e Luftës Moderne drejt një fitoreje të suksesshme në Kosovë, në vitin 1999.

Ai tha se tanimë është bërë e qartë se mësimet që nxorëm nga lufta në Kosovë janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në luftën kundër terrorizmit dhe vendeve që e sponsorizojnë atë. Rasti i Kosovës na mësoi sesi të zhvillohet një luftë ajrore kundër forcave jokonvencionale në një terren të ashpër dhe si të bashkërendohen frocat ushtarake të Amerikës me ato të kombeve të tjera. Aq më shumë tha ai, ajo luftë na mësoi si të përballemi me armikun, që gjithnjë e më shumë kërcënon botën e sotme dhe vetë Amerikën. Gazeta "Los Angelis Times" ka shkruar për këtë libër:

> *"Mësimet e këtij libri janë shumë të rëndësishme tani … Ne duhet të mendojmë saktësisht se cilët hapa do ta zvogëlojnë, në vend që ta rritin kërcënimin terrorist. Po ashtu ne kemi nevojë për komandantë të zotë, inovativë, të gatshëm, të improvizojnë në momentet e duhura për të përmbushur çdo detyrë në rastet më të vështira. Po ashtu koha kërkon udhëheqje politike të aftë dhe komandantë të zotë që kanë këndvështrim më fleksibël në Pentagon. Ky ishte Gjenerali Clark, i cili kreu me nder edhe një shërbim tjetër ndaj njerëzimit, me fitoren e kësaj lufte në një moment*

vendimtar për historinë Amerikane"…

Ajo ishte një mbrëmje e paharrueshme. Takimi me një njeri që kishte komanduar bombardimet e 78 ditëve kundër objektivave ushtarake të Serbisë, të bënte të ndiheshe sikur ishe përpara një fetishi, por që ai e thjeshtonte atë ndjenjë deri në nivelin njerëzor të komunikimit. Atë takim e fiksoi me aparatin e tij, si shumë e shumë ngjarje të tjera të tilla, gazetari i mirënjohur i bashkësisë shqiptare në New York, Beqir Sina.

KREU I TRETË

KTHIM NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

2009 – 2012

Kryetemë:

"Ta dijsh dhe të jesh i sigurtë se fatbardhësia dhe lumtunija jote gjindet në Shqipni, e cila t'ep nder e të fal emnin Shqiptar; Ruaje mirë karakterin kombëtar dhe kryenaltësinë shqiptare; bindju ligjeve dhe urdhnave të vendit, kudo që të jesh; Çdo shqiptar asht vllau i yt: nderoje kurdoherë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë. Mos e përbuz gjuhën e nanës s'ate tue folë në gjuhë të huej, kur nuk asht nevoja. Ndero flamurin e Atdheut t'and: kush nuk e nderon Shenjin e kombësisë, shnderon vehten e vet".

(Këshillat e shkruara në pasaportën Mbretërore të Shqiptarëve)

2009 - 2012 NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME - TIRANË

Koha po ecte me shpejtësi dhe vitet e para në Amerikë kaluan si pa u ndjerë, falë edhe atij intensitetit aq të madh që impononin ngjarjet në Kosovë. Qëkur kisha shkuar në Amerikë, kisha aplikuar pranë Kombeve të Bashkuara për ndonjë vend pune, i cili t'i shkonte profilit dhe përvojës sime të mëparshme.

Në vjeshtën e vitit 2000 mora përgjigje nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në NewYork. Më ofrohej një punë si anëtar i personelit ndërkombëtar në Kosovë. Kontrata shoqërohej me një paketë, e cila tejkalonte dhjetë herë çdo punë që ofronte shteti shqiptar në shërbimin diplomatik, përfshirë edhe atë të ambasadorit. Nga tetori i vitit 2000 deri në qershorin e vitit 2009 punova në atë që njihet si Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK. Përshtypjet rreth asaj periudhe janë objekt i një libri tjetër. Kjo shpjegon hendekun kohor, që vihet re në këtë periudhë të përshkruar në libër.

Pas 12 vjetësh largim nga puna në Ministrinë e Punëve të Jashtme, më 23 Tetor 2009, u ktheva përsëri po aty. Fillimisht u emërova Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Konsullore dhe, më pas, i Drejtorisë Rajonale. Në atë drejtori, çështjet më të rëndësishme ishin përpjekjet për njohjen e Republikës së Kosovës nga vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara. Disa nga ngjarjet më të rëndësishme të ndodhura gjatë asaj periudhe janë të regjistruara në shkrimet në vijim.

LOBIM PËR NJOHJEN E KOSOVËS NË LINDJEN E MESME

Në nëntorin e vitit 2009, Ministria e Punëve të Jashtme organizoi një ekip prej tre vetësh për të bërë një udhëtim për njohjen e Republikës së Kosovës në disa vende të Lindjes së Mesme. Në përbërje të atij ekipi ishim zevendës-Ministrja e Punëve të Jashtme e kohës, zonja Edith Harxhi, diplomatja Vera Cara dhe unë. Në atë udhëtim shkuam në Damask të Sirisë, në Bejrut të Libanit dhe në Kajro të Egjyptit. Ndërsa në dy të parat mora pjesë, në të tretin, udhëtimi im u ndërpre pasi do të isha pjesë e një delgacionini që do të zhvillonte vizitë në Prishtinë, Kosovë. Më poshtë janë përshtypjet e udhëtimit në Damask dhe Bejrut, dy qytete sot të rrënuara nga luftërat dhe sektarizmi.

NË DAMASK - SIRI

Avioni u ul lehtë në aeroportin e Damaskut. Te dera e avionit na priti një djalë simpatik, me një buzëqeshje të lehtë dhe mjaft i kujdesshëm. Ishte Konsulli i Nderit i Republikës së Shqipërisë në Damask. Ai na priu të kalonim nëpër sallonin e VIP - ave. Më pas na dërgoi drejt e në hotel. Pasi i lamë sendet që kishim me vete, zbritëm në lobin e hotelit dhe pritëm të vinte dhe të na merrte për darkë zv/Ministri i Punëve të Jashtme të Sirisë, zoti Al Mura. Në fakt vetëm mbemri i tij dhe mjedisi ku ishim të bënte të mendoje se gjendeshim në një vend arab. Gjithçka tjetër kishte pamje krejt perëndimore.

Darkë me zv/Ministrin Sirian Al Mura

Në darkë shkuam të tre, zv/ministrja Harxhi, zonjushë Vera Cara dhe unë. Al Mura ishte intelektual i vërtetë. Fliste një anglishte të pastër dhe një frëngjishte edhe më të këndshme. Ishte i mirëinformuar për shumë gjëra që lidheshin me politikën e ditës. Na shpjegoi shumë histori interesante për Lindjen e Mesme, kulturën arabe, historinë e asirianëve, babilonasve dhe tërë krenarinë e asaj bote paraardhëse të atij populli. Ai na dha të kuptonim se nuk donte të prekte temën e bisedës zyrtare, për të cilën kishim shkuar. Këtë dëshironte ta linte për të nesërmen, pasi do të ishte tema kryesore për të cilën kishim vajtur. Ne mësuam shumë atë natë për konfliktin në Lindjen e Mesme.

Gjithçka që thuhej aty lidhej me Izraelin, Palestinën, hasbullahët, refugjatët… Atë natë mësova se dy milionë palestinezë kishin gjetur strehë në Siri. Aty ata lindnin, rriteshin, shtoheshin, vdisnin në zona të mbyllura që prej luftës Izrael - Palestinë. Këtu, sipas tij, manifestoheshin tërë dobësitë njerëzore. Në një zonë

të mbyllur, të rrethuar, shfaqeshin tërë ligësitë: lakmia, egoja, interesat, lufta për ekzistencë, konkurrenca, hafijelliku, rënia morale… Aty ndërroheshin brezat njëri pas tjetrit dhe asgjë nuk ndryshonte për mirë.

Kështu kaloi ajo natë për të vazhduar bisedën zyrtare të nesërmen, në zyrën e tij, në Ministrinë e Punëve të Jashtme Siriane. Ajo ishte një ndërtesë e bardhë, e mermertë, e rrethuar nga bandiera të trasha prej hekur betoni të pakalueshme, edhe nëse tentohej të hyhej me forcën e mjeteve të motorizuara. Ndërtesa dukej se nuk kishte dritare të mëdha nga fasada kryesore, por një lloj harku dekorativ me pjesëza të varuara interesante dhe tipike arabe. Hymë në hollin kryesor të ndërtesës. Si kudo edhe aty kishte një "dezhurn", i cili na drejtoi tek zyra e zv/Ministrit Al Mura. Tani çdo gjë ishte zyrtare.

Takimi zyrtar me Al Mura-n në MPJ–në siriane për Kosovën

Pas fjalëve hyrëse të takimit dhe mirësjelljes së ndërsjellë i paraqitëm kërkesën tonë për njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe arsyet përse Siria duhej ta bënte këtë. Përmendëm shumë faktorë, duke filluar që nga miqësia tradicionale midis popullit shqiptar dhe popujve arabë të atij rajoni, praninë e hershme shqiptare ndër shekuj dhe ndihmesa e tyre në botën arabe. Përmendëm emrin e shkrimtarit më të madh sirian, Abdyl Latif Arnaut, me origjinë shqiptare, i cili është nderi i letërsisë bashkëkohore të vendit të tij. Ai na dëgjoi me vëmendje por çfarëdo lloj përpjekje e jona për të dhënë edhe një argument më shumë në këtë drejtim, ndeshte në të njëjtën përgjigje të Al Murra-s:

"*Kosova is an American Baby*.

Kosova është fëmija i amerikanëve."

"A duhet që ne të përkundim një fëmijë të amerikanëve?! Ajo është pjellë e Amerikës. Ajo e shkatërroi Jugosllavinë, vendin më të zhvilluar të Evropës, themeluesen e Organizatës së të Pa-angazhuarve. Ne kurrë nuk do ta njohim atë vend si vend të pavarur"!

Ky ishte Al Mura, i cili fliste në emër të Presidentit sirian Bashar Al Asad.

Një zemërim i madh na shoqëroi, sado që e prisnim se nuk do kishim një përgjigje pozitive. U larguam zemërthyer. Al Mura ishte njeri me kulturë, por tërë atë kulturë e përdorte krejtësisht në shërbim të bosit dhe politikës së tij

anti-amerikane dhe për rrjedhojë anti-kosovare.

Damasku - qytet me bukuri të rralla

Më pas dolëm dhe shëtitëm në pjesën e vjetër të qytetit. Ecëm drejt xhamisë dhe e vizituam atë me kurreshtje të rrallë. Xhamia Umayyad, e njohur si Xhamia e Madhe e Damaskut, e vendosur në pjesën e vjetër të qytetit, është një prej xhamive më të mëdha dhe më të vjetra të botës. Ajo vlerësohet të jetë një vend i shenjtë, i katërti më i madhi i fesë islame. Pas pushtimit të Damaskut në vitin 634 kjo xhami u ndërtua mbi trojet dhe pjesët e mbetura të pashembura të një bazilike të krishterë të kushtuar Gjonit Baptist (Jahjasë). Xhamia ka një vend të shenjtë, i cili mendohet se mban brenda vetes kokën e Gjonit, i nderuar si profet edhe prej myslimanëve edhe prej të krishterëve. Aty besohet të jetë vendi ku Isaja (Jezusi) do të kthehet dikur.

Aty gjendet edhe varri i Salajdinit, në një kopsht të vogël pas murit verior të xhamisë. Kaq interesante është kjo xhami sa vërtet të bën të reflektosh. Çfarë qetësie shpirtërore gjen njeriu në atë vend? Çfarë kombinimi i personazheve të feve monoteiste dhe çfarë filozofie paqësore! Por, edhe sa keq e interpretuar ajo filozofi!? Sa fatkeqësi i ka sjellë njerëzimit, veçanërisht në atë zonë! Jo vetëm midis dy feve të ndryshme, jo vetëm midis atyre që besojnë Isanë dhe të tjerët Jezusin, por edhe brenda vetë atyre që kanë të njëjtin profet, por që e besojnë në mënyra të ndryshme, ose që thjesht i luten në forma të ndryshme, ka sjellë ato fatkeqësi, të cilat i dëshmojmë ne edhe sot pas mëse 16 shekujsh.

Më pas kaluam një drekë në një nga vendet më interesante në botë, të quajtur Restoranti "Naranj". Jo vetëm që ushqimi ishte nga më të shijshmit që njeriu mund të provojë, por mjedisi oriental ishte tepër interesant. Përkrah menusë, ushqimit dhe pijes, lokali ofronte takëmet e nargjilesë, me ata gypa të bukur në vazo qelqi të mbushura me ujë dhe me pipa, të cilët në fund kishin secili një seri rezervash për t'u përdorur nga klientë të ndryshëm. Në menu kishte lloj - lloj gjethesh, që nga duhani dhe deri te gjethe të tjera aromatike. Secili vinte pipin e vet, e ndizte gjethin dhe tymoste nëpërmjet filtrit të ujit. Pas disa minutash vihej re se restorantin e mbulonte një re tymi, e cila, për habinë time, davaritej herë pas herë në një interval kohor prej dhjetë minutash.

Nuk pashë të kishte ndonjë aspirator as dritare të hapur. Por në një moment kur ndjeva që u freskua ajri, ngrita kokën lart. Aty pashë një gjë që nuk do të më hiqet nga mendja. Mbulesa e restorantit, e cila ishte sa dy kate ndërtese e lartë, ishte një *serë* prej xhami me panele në formën e një fizarmonike, e cila hapej dhe mbyllej me aq ngadalësi dhe lehtësi, mbi shina të lubrifikuara, në atë mënyrë sa nuk vihej re fare. Kjo ishte një ndër përvojat më të bukura në Lindjen e Mesme.

Pas drekës, Profesor Mufaku na ftoi për një kafe në ndërtesën e Lidhjes së Shkrimtarëve të Sirisë. Aty takuam një nga shkrimtarët sirianë të kohës. Ai ishte shumë i këndshëm dhe na foli për letërsinë siriane e sidomos për emrat e famshëm të letërsisë së Lindjes së Mesme si Firdeusi, Xhelaledin Rumi – Mevlana dhe Sadi Shirazi.

Emri i Sadi Shirazit më ktheu tek kujtimet e shkollës së mesme. Ishim në aksion në Lukovë, në vitin 1970. Në sallën e kulturës së fshatit, organizoheshin mbrëmje vallzimi me rininë vendase të atij fshati aq të bukur. Lukovitët ishin shumë të kulturuar. Ditën punonin nëpër punët e tyre në bujqësi ndërsa në mbrëmje visheshin shumë bukur, të gatshëm për ballo. Në një prej atyre mbrëmjeve, njëri prej lukovitëve hodhi një pyetje në sallë:

– Kush e gjen emrin e shkrimtarit me emrin më të gjatë në botë, do të zgjedhë për të vallzuar muzikën dhe damën më të mirë të mbrëmjes!

Unë e dija një emër të tillë shumë të gjatë, por nuk besoja se kishte një kufi për këtë, ndaj e mora për shaka. Ia thashë emrin që dija mësuesit tim të letërsisë, por shpreha edhe dyshimin se do të bëja fiasko. Mësuesi më tha:

Po ti thuaje, pastaj prit rezultatin! Nuk është faj të mos fitosh! Faj është të mos përpiqesh për të fituar!

Ashtu bëra dhe u ngrita dhe e thashë:

Për mua emri me i gjatë i një shkrimtari është:

Abu Muhammet Muslih al Din bin Abdullah Sadi Shirazi.

Duhej të ishte diçka e tillë, sado i çuditshëm. E kisha fiksuar atë emër kur lexoja librin e tij "Gjylystani dhe Bostani" të përkthyer nga Vexhi Buharaja.

E fitova garën, zgjodha muzikën, por nuk dita të zgjedh damën!?

Në vijim të bisedës në Damask, shkrimtari sirian, në shenjë mirësjelljeje më dhuroi një antologji me poezi në gjuhën arabe të përkthyer në anglisht pas çdo faqjeje. Ndër to veçova për ta përkthyer poezinë e Mevlanës: Dashuria, të cilën më vonë e botova në shqip me titull:

Prej dashurisë:

Dashuria bën të zbutet krejt zemërimi,
Ajo e bën bronxin të shndrisë si florini.
Prej dashurisë edhe bërsitë kthehen në musht,
Ndërsa dhimbja ikën pa asnjë eh, a oh, a kusht.
Dashuria i bën gjëmbat të duken lule, gjithëherë,
Dhe uthullën e thartë e kthen në të shijshmen verë.
Dashuria, Kryqin e mundimshëm e bën si një fron,
Dhe barrën e rëndë të dhimbjes e hedh tej, në hon.
Dashurisë, burgu mizor i duket si kopësht me lule të hijshme,
E kopshtin vetë e bën furrën e bukës më të shijshme.
Është dashuria që furrën e zjarrtë e mbush me dritë,
Dashuria edhe vetë djallit ia verbon të dy sytë.
Dashuria gurin e zbut dhe e bën të lëmuar si dylli,
Pa dashuri, dylli i butë nguroset si dru pylli.
Nuk ka si dashuria që pikëllimin ta kthejë në lumturi,
Dhe që pasonjësin kokëulur ta bëjë të duket si zotni.
Dashuria pickimin e bën ta ndjesh si përkedheli,
Ajo edhe luanin e tërbuar e bën të sillet si një mi.
Sëmundja bëhet shëndet kur dashuron,
Bekim bëhet nëma sado që dikush mallkon.
Prej dashurisë gjembaçi bëhet gjilpërë shëruese,
Një shtëpi me dashuri është si një llampë ndriçuese.
Dashuria të vdekurin e ngjall e shëron,
Ajo edhe mbretin kokëlartë kur e zë, e skllavëron.

Me profesor Muhamet Mufak Arnaut, shkrimtarin më të madh të Sirisë, Abdyl Latif Arnaut dhe arnautët tjerë të Damaskut

Në mbrëmjen e asaj dite na mblodhi profesori i nderuar me origjinë nga

Kosova, Muhamet Mufak Arnauti. Ai jetonte sa në Jordani, sa në Damask dhe jepte leksione në universitete të ndryshme. Aty kishte apartamentin e tij dhe kishte ftuar një numër të madh sirianësh me origjinë shqiptare. Me këtë burrë të madh të shqiptarisë në Lindjen e Mesme disa vite më parë më kishte prezantuar gazetari i njohur nga Kosova Nihat Islami. Ky i fundit ishte legjendë e gazetarisë kosovare dhe vazhdon të jetë edhe sot. Ai kishte raportuar nga Lindja e Mesme për gazetën "Rilindja" në Prishtinë për më se dhjetë vjet. Pena e tij kishte regjistruar intervista me udhëheqësit më të njohur të Lindjes së Mesme, Anvar Sadatin dhe Mubarakun e Egjyptit, Arafatin e Palestinës, Shimon Perezin e Izraelit, Sadam Hysenin e Irakut, Mbretin Hysejn të Jardanisë, Hafez Al Asadin, babain e Bashar Al Asadit të Sirisë. Mbi të gjitha, vështirë se kishte ndonjë shqiptar të shquar të atyre anëve, që nuk e njihte Nihat Islamin.

Në Damask gjendej një bashkësi e tërë shqiptaro - arabe, nga më të habitshmet në botë, me njerëz të cilët mbanin të njëjtin mbiemër: Arnaut. Mbrëmja ishte e bukur, e përmallshme. Na u duk sikur po takonim njerëzit tanë të një gjaku, me të cilët nuk ishim ndarë ndonjëherë.

Atë natë në atë pritje me shqiptarët, ishte edhe Abdyl Latif Arnauti me zonjën e tij. Ai ishte shkrimtar shumë i njohur në gjuhën arabe, me prirje të majta, i përkëdhelur i regjimit të Asadit. E vizitonte Shqipërinë në kohën e diktaturës dhe çuditërisht ishte i vetmi shkrimtar shqiptar jashtë vendit, që përmendej me vlerësime. Atë natë na tregoi sesi për një libër kishte marrë 180 mijë dollarë amerikanë, me të cilat kishte blerë katër apartamente. Regjimi i Asadit i paguante shkrimtarët që i donte me vlera shumë të mëdha. Por Siria ishte vend diktatorial, e ngulfatur në duart e një familjeje, babë e bir, të cilët e kishin ndërtuar atë pushtet thjesht dhe vetëm për interesat e veta. Ata kishin gjetur si mjet mbijetese politike për vete mbështetjen ruse, së cilës i bindeshin me servilizëm.

Aty takuam edhe një burrë të mençur, të cilin e kisha pritur shumë herë në Stamboll. Ishte Qamil Gavoçi - Arnavuti. Ai kalonte përherë nga Stambolli për të udhëtuar për në Shqipëri, pasi kishte lindur në Shkodër dhe ishte larguar i vogël në kohën e Mbretërisë Shqiptare. Kur shërbeja në Stamboll e ndihmova të pajisej me pasaportë shqiptare për ta zëvendësuar atë që kishte që nga koha e Mbretërisë Shqiptare. Ai më tregoi asokohe pasaportën e Mbretërisë, të cilën e ruante me fanatizëm të pashoq dhe që unë e shihja për herë të parë. Ishte vërtet

një relike e çmuar. Pasaporta ishte e mbështjellë me kopertinë të fortë prej bezje dhe e bënte atë të rronte gjatë. Brenda kishte gjeneralitetet dhe në faqen e parë të brendshme, shkruhej:

> *"Ta dijsh dhe të jesh i sigurtë se fatbardhësia dhe lumtunija jote gjindet në Shqipni, e cila t'ep nder e të falë emnin Shqiptar; Ruaje mirë karakterin kombtar dhe kryenaltësinë shqiptare; bindju ligjeve dhe urdhnave të vendit, kudo që të jesh; Çdo shqiptar asht vllau i yt: nderoje kurdoherë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë. Mos e përbuz gjuhën e nanës s'ate tue folë në gjuhë të huej, kur nuk asht nevoja. Ndero flamurin e Atdheut t'and: kush nuk e nderon Shenjin e kombësisë, shnderon vehten e vet. Dashnija për atdhe ndihet ma shumë në mërgim prandaj këtë dashuni rueje edhe kur të kthehesh në vendin tand".*

Kaq të ëmbla m'u dukën ato fjalë, atë natë kur u recituan në atë sallë, sa më erdhi të qaja. Pastaj një djalë, na tregoi se punonte në Telekomin sirian. Ai po ashtu ishte me origjinë shqiptare dhe mbante mbiemrin Arnauti. Kur e pyeta se si është e mundur që të gjithë keni një mbiemër ai m'u përgjigj:

> *"Këtu në Siri ne jemi njerëzit më të dashur dhe më të respektuar. Për ne mbajtja e këtij mbiemri është nder i madh. Sirianët, kur marrin vesh se jemi shqiptarë, na shohin me sy tjetër, prandaj e mbajmë të njëjtin mbiemër. Unë punoj në Telekomin sirian dhe kam tërë listat e abonentëve të telefonisë. Vetëm në Damask ka pesëmijë vetë me mbiemrin Arnavut."*

Natyrisht që një konstatim i tillë do të shkaktonte po atë ndjenjë dhimbjeje, përhumbjeje dhe krenarie, siç të shkaktonin arbëreshët e Italisë, shqiptarët e Turqisë apo arvanitasit e Greqisë.

Të nesërmen udhëtuam për në Liban.

Damask, 20 nëntor 2009

NË BEJRUT - LIBAN

Kufirin midis Sirisë dhe Libanit e kaluam pothuajse siç mund ta kenë kaluar udhëtarët e huaj dikur kufirin midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Kishim udhëtuar nëpër një autostradë siriane, që përshkonte një zonë thuajse të shkretë. Në të dy anët e autobandit shfaqeshin vetëm dy portrete të mëdha. Herë Hafizi - Al Asad, babai, e herë Bashari Al Asad, i biri. Për një sy të mësuar si yni, i cili kishte parë portretin e diktatorit gjithandej kjo ishte përqasje tipike e diktaturës. Iu afruam kufirit në pikën e takimit Arida, pritëm rreth një orë sa u verifikuan tërë dokumentet, me siguri edhe qëllimin e vizitës sonë në Siri, dhe kështu u lejuam të kalonim.

Në anën libaneze të kufirit na priste një pengesë mbrojtëse, e cila gjarpëronte gati 300 metra, e ndërtuar me blloqe të larta betoni dhe shenja të zeza dhe të verdha. Më në fund iu qasëm pikës së hyrjes dhe përpara nesh u shfaq një djalë i gjatë, me mjekër të zezë të shkurtër, trupmadh, me konstrukt sportisti, i qeshur, tej mase i dashur. Ai na uroi mirëseardhjen, na puthi disa herë siç bëjnë arabët, dhe na ftoi në sallën e pritjes së postës kufitare. Ishte Mark Gorayev, Konsulli i Nderit i ardhshëm i Shqipërisë, i cili kishte marrë përsipër të lobonte bashkë me ne për njohjen e Kosovës, si shtet i pavarur, nga ana e shtetit të Libanit. Me të kishte ardhur edhe Ambasadori ynë, z. Nuri Domi, me rezidencë në Kajro.

A isha takuar unë me Presidentin Obama?!

Marku ishte sa karizmatik, aq edhe i dashur, shprehte çdo gjë me aq emfazë sa na bëri të ndjeheshim të afërt me të që në çastin e parë. Ai kishte me vete edhe disa bashkëpunëtorë të tij, të cilëve iu drejtua ai u tha me zë të lartë:

– E shikoni këtë zotëri, duke bërë me shenjë drejt meje, ky ka takuar Presidentin Obama vetëm pak kohë më parë. E besoni, sapo e ka takuar Presidentin Obama!?

Unë u ndjeva si në faj, pasi kjo nuk ishte e vërtetë, dhe për pak sapo nuk hapa gojën të thosha: "Jo, kjo nuk është e vërtetë. Unë nuk e kam takuar ndonjëherë". Megjithatë bëra një gjest, për të dhënë të kuptohej se kjo nuk kishte asnjë rëndësi. Por ai vazhdoi:

– Kushedi sa interesant do të ketë qenë takimi me Obamën, kur ju e morët statusin e vendit anëtar i NATO–s, në sheshin Shën Mark, në Zagreb. Sheshi Shën Mark, hahaha, edhe unë jam Mark, por nuk jam shenjt.

Dhe shpërtheu në një qeshje të fortë.

– Uaua! Çfarë privilegji për ty që e ke takuar, çfarë privilegji për ne, që të takojmë ty!!!

Unë pashë nga zonja Harxhi, të cilën e shoqëroja, për t'i thënë se duhej ta sqaroja që kjo nuk ishte e vërtetë dhe do të dilja bllof. Por ajo bëri një gjest, sikur donte të thoshte: "Mos ia prish qejfin, le të mendojë ashtu, pastaj e sqaron këtë keqkuptim".

Kështu u prezantuam në atë pikë kufitare midis Libanit dhe Sirisë. Unë isha "Njeriu i Obamës", që kisha marrë pjesë në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, në sheshin Shën Mark në Zagreb dhe këtë sipas Markut nuk e luante as topi.

Një udhëtim aventuresk pa dëshira për aventura

Rruga prej 160 kilometrash nga kufiri siriano - libanez deri në Bejrut kalonte nëpër zona malore, fushore, shkretëtira dhe pyje. Ndoshta vështirë se mund të ketë një natyrë më të larmishme se ajo në botë, ku alternohen të gjitha format gjeografike të natyrës. Na shoqëronin dy makina me nga katër vetë të armatosur. E jona, një "Chevrolet" e blinduar, qëndronte në mes. Secili prej atyre që ishin në makinat e tjera kishte një kallashnikov ose pistoletë në dorë të gatshëm për "luftë". Shpura ecte me shpejtësi marramendëse.

Ishim të terrorizuar nga shpejtësia dhe mënyra si po shoqëroheshim, me njerëz të armatosur. Në të gjitha dritaret e makinës së parë dhe asaj të tretë

ndrinin tytat e armëve të nxjerra jashtë, që iu kërkonin makinave të hapnin rrugën në parakalim, nën kërcënimin e tyre. Ishte vërtet përvojë e paprovuar, tejet e rrezikshme, aspak joshëse dhe shumë aventureske. Kështu hymë në Bejrut, në fakt "të rënë nga pesha" prej frikës, që na kallte ai lloj udhëtimi.

Arritëm në Bejrut me zemër të ngrirë, por të paktën shëndoshë e mirë. Me të arritur aty, shoqëruesi na drejtoi te Ministria e Punëve të Jashtme e Libanit.

Takim bosh me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme libaneze, William Habibi

Takimin e parë e patëm me Sekretarin e Përgjithshëm William Habibi. Gjetëm aty një burokrat të ftohtë-akull, pa ndonjë emocion, pa portret të qartë, aspak diplomat, shumë fjalëshkurtër, i prerë dhe fytyrëgur. Edhe prej atij dëgjuam të njëjtën gjë, që kishim dëgjuar nga zëvendësministri sirian, Al Mura. Na e tha shkurt e prerë: Libani nuk do ta njohë kurrë Kosovën. Biseda ishte krejt e pafrytshme. Morëm një përgjigje krejt të thatë dhe të pashpresë. Dhe dolëm. Pas lamë një njeri, i cili nuk kishte ndonjë gjë që të bënte ta mbaje mend për mirë.

Në vendin e Pashko Vasë Shkodranit - dikur Guvernatori i Libanit

Natyrisht që çdo bisedë fillesën do ta kishte te lidhjet historike dhe sidomos fakti që një ndër themeluesit e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Pashko Vasa ose Vaso Pashë Shkodrani, kishte shërbyer si Governator i Libanit, që nga 9 Maj 1882 deri sa ndërroi jetë në vitin 1892. Ai ishte Guvernator i Përgjithshëm (Mutesarif) i Libanit, post i cili ishte rezervuar nga një traktat ndërkombëtar për një katolik me shtetësi otomane, pas trazirave civile dhe pushtimit francez të vitit 1860.

Në atë post ai ishte i gatshëm që të pranonte autoritetin francez, por më pas ai iu kundërvu edhe atyre si edhe klerikëve maronitë. Ai e mbajti atë zyrë gati dhjetë vjet. Pashko Vasa është autori i poemës më të rëndësishme të Rilindjes tonë Kombëtare, "O moj Shqypni, e Mjera Shqypni".

Nabih Berri - Kryeparlamentari libanez

Prej andej shkuam te kryetari i Parlamentit, Nabih Berri. Ai ishte libanez, i lindur në Sierra Leone dhe drejtonte Lëvizjen Amal. Mark Gorayev, një i krishterë ortodoks ishte mik i ngushtë me të. Pas takimit me të kaluam nëpër shumë pengesa gjarpëruese të qytetit për t'u paraqitur më pas në zyrën e një gjenerali, i cili ishte shef i sigurimit të Libanit. Takimi me të ishte vërtet shumë interesant, por nuk mund të dilte ndonjë gjë nga ajo zyrë për atë qëllim që kishim shkuar ne.

Para përmendores së Refik Haririt, ish Kryeministri Libanez i masakruar në qendër të Bejrutit

Gjatë rrugës bëmë një vizitë te vendi i përmendores ku Refik Hariri bashkë me gjashtë shoqëruesit e tij ishin bërë copë nga një shpërthim i tmerrshëm. Ishte biznesman i madh dhe kryeministër i Libanit prej vitit 1992 deri në vitin 1998 dhe përsëri nga viti 2000 deri kur dha dorëheqjen në vitin 2004. Ai kishte ndërtuar Bejrutin pas një lufte civile prej gati dy dhjetëvjeçarësh në atë mënyrë që vërtet të linte pa frymë kur e shihje. Por, më në fund, ai e pagoi me kokë mu në mes të qytetit. Ai u vra me datën 14 shkurt 2005. Për vrasjen e tij dhe të 22 vetëve të tjerë, që u gjetën aty pranë Hotelit "St. Georges", u përdorën 1 mijë e 800 kg dinamit. I vrarë mbeti edhe Ministri i Financave i asaj kohe, Bassel Fleihan. Varrimi ishte bërë pranë xhamisë Mohamed Al-Amin.

Ajo ditë në Bejrut më bëri të mendoja se sa të lumtur jemi ne shqiptarët. Bejruti ishte qytet shumë i bukur. Hariri e kishte ndërtuar atë pas luftës civile. Nga një largësi e përafërt, si ajo që tek ne ndan Xhaminë e Ethem Beut me Kishën Katolike të Shën Palit dhe atë Orthodokse të Rrugës së Kavajës në Tiranë, gjendeshin edhe në Bejrut tre objekte të tilla kulti madje edhe një sinagogë. Kur e ktheje kokën nga njëra anë të dilte një prej këtyre objekteve, më pas tjetra dhe tjetra më pas. Bashkëekzistenca e tyre ishte aq e vështirë sa kishte sjellë gjakderdhje pas gjakderdhjesh.

Sa vetë kishin rënë "*shehit*" pikërisht për bashkekzistencën midis tyre, ose

më mirë për ekzistencën e tyre. Dëshmia më e tmerrshme e kësaj ishte pamja e përmendores së Refik Haririt. Ndërsa në vendin tonë, për fat të mirë, nuk kemi qoftë edhe një dëshmor të rënë në një luftë të tillë të pakuptimtë. Madje te ne ekziston një paqe e tillë, si ajo që i bëri shqiptarët të mbronin hebrejtë, në një kohë kur gjithë Evropa i përndoqi, i zhduku dhe i eleminoi edhe fizikisht.

Një krahasim me paqen fetare në Shqipëri

Ndërsa shihja ato pamje të Bejrutit mendoja se isha me fat, që kisha lindur në vendin tim. Kur isha fëmijë, njerëzit i faleshin një vendi, që quhej Vorri i Mirë, ose Tyrbja e Elez Kurtit në grykën e Malit të Shkëlzenit. Por askush nuk e dinte përse i falej. Flitej se ishin dëshmorë të Luftës së Qerbelasë, por ajo luftë nuk ishte bërë kurrë në Shqipëri. Në Krujë gjendet varri i Sari Salltikut, por edhe ky nuk dihej mirë pse adhurohej. Ndërsa në Malin e Laçit gjendej një vend i quajtur Kisha e Shën Ndout i shqipëruar nga Shën Antoni i Padovës. Sesi ka arritur ky shenjt të jetë aq shumë i adhuruar te shqiptarët e të gjitha feve është ende një mister. Ajo që dihet është se Antoni i Padovës (1195-1231) ishte frat françeskan, teolog dhe predikues. Ai u bë i pari mësues i teologjisë në Urdhrin Françeskan, që mori titullin "Doktor i Kishës". Atij i atribuohen shumë mrekullira dhe njihet si "Shenjti i gjërave të humbura".

Antoni i Padovës, ose Shën Ndou ynë, ka lindur si Fernando de Boullion (Ferdinand Bulhon) në Lisbonë, Portugali, më 15 gusht 1195 në një familje të pasur. I ati, Martin de Boullion, ishte pasardhës i Godfrey de Bouillon-it, komandant i Kryqëzatës së Parë, ndërsa e ëma, Theresa Tavejra, ishte pasardhëse e Frilës I, mbreti i katërt i Asturias.

Historia e tij është tejet interesante dhe pelegrinazhi i tij po ashtu. Por në fund ai mbeti Shën Ndou i Padovës, i biri i një pasaniku të madh dhe mësues i fretërve, i njohur si shenjti padron i analfabetëve dhe i të varfërve, gjetësi i gjërave të humbura dhe shenjti i kërkesave të vogla.

E marta u bë dita e Shën Ndout, sepse funerali i tij u bë këtë ditë të javës. Festa e tij u bë data 13 qershor. Ka një histori, sipas së cilës, atij iu faneps (shfaq) Jezusi në vitin 1231 si fantazmë. Një imazh tjetër i tij është ai me zambak në dorë në një statujë në një kishë në Austri. Thuhet se dikush e vuri zambakun

në dorën e statujës së Shën Ndout në Austri dhe ai, në vend që të thahej, çeli lule të tjera. Zambaku u kthye që atëherë në simbol të pastërtisë dhe pafajësisë. Vdiq në vitin 1231. Ky është Shën Ndou.

Në fakt, ky shenjt më erdhi në mendje atë ditë ndërsa soditja ato qendra fetare të Bejrutit. M'u kujtuan vitet e largëta të ateizmit, kur mijëra shqiptarë, katolikë, ortodoksë po aq sa myslimanë dhe bektashinj, merrnin rrugën 13 javë përpara të martës së 13 qershorit për ta gdhirë atë natë tek ai shkëmb i Shën Ndout. Aty nuk kishte mbetur më kishë, pasi ishte shndërruar në repart ushtarak. Njerëzit sfidonin kohën, shtetin, dhunën, represionin politik… gjithçka! Dhe shkonin atje. Të gjithë, me mijëra e pa dallim, nevojtarë, të sëmurë, besimtarë… të gjithë në paqe me njëri-tjetrin rendnin drejt atij vendi të shenjtë.

Në ato çaste m'u kujtua ajo ditë kur Nuncio Apostolik i Vatikanit, indiani Ivan Dias, erdhi për të *bekuar* Kishën e Shën Ndout. Isha njeriu më i lumtur që gjendesha në krah të tij, për të marrë pjesë në atë ceremonial. Unë, bir i dy prindërve: babai - mysliman jopraktikues, dhe nëna - bektashie besimtare e bindur, isha në krah të Nuncios Apostolik të Vatikanit. Ai ishte vendosur në Shqipëri në datën 28 tetor 1991 dhe punoi shumë për rikthimin e besimit të krishterë pas shumë viteve ndalimi ateist te shqiptarët. Atë ditë unë isha në krah të tij, në meshën e parë të mbajtur në një vend, që ende ishte thjesht një ish - kishë, por që më vonë u rikthye në origjinën e vet të vendit të shenjtë dhe pelegrinazhit gjithëvjetor.

Por le të shkëputem nga kujtimet, që heqin paralele midis Bejrutit dhe Tiranës, dhe vazhdojmë:

Takimi me Kryeministrin Saad Hariri, i biri i Refik Haririt

Prej atij vendi të mbushur me varre për shkak të sektarizmit fetar, shkuam në zyrën e Kryeministrit. Ishte djalë i shkurtër, nën të dyzetat. Kishte vetëm disa ditë në zyrë. Jetonte me sindromin e vrasjes së të atit, Refikut. Ai vetë kishte qenë djali çapkën i një të pasuri tajkun, që lodronte mbi të mirat e kësaj bote, pa i munguar gjë. Papritmas ishte kthyer në djalin e një të vrari në mes të qytetit, bashkë me një turmë njerëzish të tjerë dhe… tani, për fatin e tij, ai do të ishte njeriu që duhej ta çonte përpara vendin e lënë zbrazët nga i ati.

U futëm në zyrën e tij dhe pritëm rreth dhjetë minuta, aq sa Marku, i cili ishte mik e shok fëmijërie, e instruktoi që të mos na e thoshte hapur, jo-diplomatikisht e pa doreza, se vendi i tij nuk kishte ndërmend të njihte Kosovën. Ai doli nga zyra dhe erdhi në hollin e pritjes ku po qëndronim ne. Marku na prezantoi të gjithëve, zonjën Harxhi, Ambasadorin, z. Nuri Domi, diplomaten Vera Cara dhe mua. Kur më prezantoi, Marku nuk harroi të përmendte faktin se unë isha "takuar me Presidentin Obama"(!?).

Tashmë kisha gjetur kohë për ta verifikuar keqkuptimin e Markut me këtë "gjetje" të tij. Kontrollova nëpërmjet iPodit tim në Google dhe gjeta diçka që mund të ngatërrohej lehtë: Momenti kur Presidenti Obama i dorëzoi Kartën e anëtarësimit Shqipërisë dhe Kroacisë, në Sheshin Shën Mark, në Zagreb, aty gjendej edhe Presidenti i asaj kohe i Kroacisë, Stipe Mesiç. Ai në fakt kishte një pamje ca të ngjashme me mua. Ky duhej të ishte edhe keqkuptimi i Markut për "takimin tim" me Obamën.

Kryeministri ishte si i lodhur, pak i mërzitur, jo aq i përqendruar. Kërkoi ndjesë, duke thënë se kishte vetëm disa ditë në detyrë, dhe se ende nuk i kishte mësuar mirë dyert e zyrave. Ishte ulur në kolltukun e të atit, i cili kishte qenë udhëheqës i përmasave të mëdha. Ai njihej në Amerikë, veç tjerash, për marrëdhëniet me Presidentin Bush dhe kishte rol të madh në proceset që zhvilloheshin në Lindjen e Mesme. Pas prezantimit që na bëri Marku, m'u drejtua:

"Nuk e di nëse keni ndonjë lidhje me Kryeministrin e Shqipërisë, por mbiemri juaj më kujton miqësinë që babai im i ndjerë kishte me udhëheqësin tuaj".

Pasi folëm rreth vizitës dhe pritjet nga vendi i tij, ai na tha se do ta shihte me shumë kujdes dhe përparësi por, në vendin e tij, kishte shumë faktorë që ndikonin për të ardhur deri te njohja. Pastaj folëm për vendin e tij, një farë stabiliteti që gëzonte në atë periudhë, dhe nuk ngurrova t'i thosha se sa shumë më pëlqeu ai vend dhe çfarë larmie të jashtëzakonëshme kishte natyra aty.

Libani, vendi i favorizuar apo i mallkuar, sipas Saad Haririt!?

Hariri filloi të na fliste për legjendën e krijimit të vendit të vet.

– Kur Zoti e krijoi Libanin, - tha ai, - i dha male, pyje, fusha, dete, lumenj, ara, rrëpira, livadhe, ujëra, male të larta, shkretëtira; çdo gjë të bukur që ka natyra, çdo gjë. Pastaj i dha një popull të mirë, të dashur, bujar, punëtor, besimtar… të zgjuar. Të tjerët u bënë shumë xhelozë për të dhe i thanë Zotit:

– Përse i dhe kaq shumë këtij vendi dhe neve na i hodhe me kaq kursim?

– Zoti iu përgjigji: Po po, ia dhashë të tëra, ia dhashë. Por mos harroni, i dhashë edhe diçka tjetër: Fqinjët.

Aluzioni ishte shumë i qartë. Në të gjitha qarqet thuhej se vrasësit e babait të tij ishin sirianët. Dolëm prej zyrës së tij dhe Marku na dërgoi për takim në Tripoli.

Në Tripoli me Ministrin Mohamad Chatah

Në Tripoli takuam Kryetarin e Partisë së Haririt, z. Mohamad Chatah. Ai ishte burrë me plot kuptimin e fjalës, inteligjent, i ditur, i pashëm, i aftë të komunikonte në frëngjisht dhe anglisht. Mendjendritur dhe, mbi të gjitha, ai shpalosi një virtyt, që do t'ia uroja çdo njeriu dhe sidomos çdo politikani: Ai fliste me kompetencë të madhe për sektorin e tij dhe na tregoi për diasporën libaneze. Na tregoi se sa milionerë libanezë kishte nëpër botë dhe se pasaniku më i madh në botë ishte libanezi, që kishte Telekomin Meksikan. Ndërsa në parlamentin e Brazilit kishte 50 anëtarë me prejardhje libaneze.

Zoti Chatah ishte kritik i njohur i regjimit sirian, prej të cilit në fakt e gjeti edhe vdekjen në mes të Bejrutit, në fund të vitit 2013, nëpërmjet një shpërthimi të makinës së tij. Në atë kohë kur e takuam atë, ai ishte Ministër i Financave dhe mik i ngushtë i Kryeministrit Saad Hariri. Ai na priti me shumë respekt dhe na tregoi një histori nga më fisniket, që kisha dëgjuar:

Pas vrasjes së Refik Haririt Libani kaloi situata shumë të vështira. Partia e zgjodhi zotin Chatah kryetar dhe në zgjedhjet e vitit 2010 partia e tij fitoi, ndërsa ai u mandatua për kryeministër. Por, sapo e mori atë mandat, ia dorëzoi djalit të Haririt, Saad Haririt, që në atë kohë ishte 39-vjeçar, duke i thënë:

"Ishte babai yt ai që na formoi ne të gjithëve dhe ne i detyrohemi atij. Kjo është më e pakta që mund të bëja për të".

U larguam nga Bejruti me fjalët e Saad Haririt:
Zoti i kishte dhënë gjithçka të mirë atij vendi, por edhe… fqinjët.
Jo vetëm Libanit…

Bejrut, 23 nëntor 2009

NË HAGË PËR TË PRITUR VENDIMIN E GJND PËR KOSOVËN

BBC lajmëron arrestimin e Ramush Haradinaj

Atë ditë të 21 korrikut të vitit 2010 po udhëtoja nga qendra e Tiranës drejt Aeroportit të Rinasit. Do të përfaqësoja Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë në momentin e shpalljes së gjykimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për drejtësinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, sipas të drejtës ndërkombëtare. E kisha fiksuar radion e makinës në programin botëror të BBC-së. Papritmas dëgjova - ndërprerjen e lajmeve - dhe njoftimin:

> "*Lideri i guerrilasve shqiptar të Kosovës, Ramush Haradinaj sapo është arrestuar dhe është duke u dërguar në Burgun e Scheveningen-it në Hagë, Holandë. Atje ai do të ballafaqohet me akuza të reja për krime të rënda të kryera gjatë luftës në Kosovë".*

U shokova. Po pse, a përsëri ky, thashë me vete? Si është e mundur? Pse pikërisht sot? Nesër jepet opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) për ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, dhe ja ku përsëri dikush godet kaq fort?! Vendosa t'i telefonoja kryeministrit Berisha. Ai u përgjigj menjëherë. E pyeta nëse ishte informuar për ngjarjen. Ende nuk dinte gjë. I tregova se isha udhës për në Hagë, për të ndjekur seancën e nesërme të Gjykatës, ku pritej të jepej opinioni mbi ligjshmërinë ose jo, të së drejtës së shqiptarëve të Kosovës për shtet të pavarur. Më uroi rrugë të mbarë. Ndjeva shqetësimin në zërin e tij dhe, pak para se të mbyllnim telefonat, më tha:

"Dëgjo, sa ditë do të qëndrosh në Hagë?

"Tri ditë", - i thashë.

"Shkoni bashkë më ambasadorin tonë atje dhe takojeni Ramush Haradinajn. Bëji të fala nga unë dhe siguroje për mbështetjen tonë. Rrugë e mbarë! Për më tepër mbaje telefonin hapur që të komunikojmë".

Ankthit dhe pritjes së ethshme për dhënien e opinionit përfundimtar për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë iu shtua edhe ky fakt. Përse tani? Përse sot? Përse duhej? Apo që të kompromentohej çdo gjë shqiptare e Kosovës? Tek e fundit a nuk prisnin dot edhe dy ditë apo tri dhe pastaj ta arrestonin!?!

Kush thotë se ka drejtësi pa politikë!?

Ramushi nuk ishte nga ata burra që fshihej. Ai u dorëzua herën e parë në mënyrën më burrërore. Vetëm një burrë, një shqiptar nga Dukagjini, mund ta bënte atë që bëri ai. Në rastin e arrestit të parë, kur ai ishte Kryeministër, mblodhi kabinetin e tij dhe iu caktoi detyrat si çdo ditë tjetër. Askush nuk dalloi dot qoftë edhe një drithërimë në zërin e tij. Komunikoi, bisedoi, bëri edhe shaka. Mbledhja mbaroi. Dhe papritmas tha:

"Oh më falni se kam edhe diçka për t'iu kumtuar sot: Që prej këtij momenti unë nuk jam më Kryeministri Juaj. Sapo të dalim nga kjo sallë, unë iu dorëzohem organeve të drejtësisë ndërkombëtare dhe udhëtoj për në Hagë, i akuzuar për krime lufte".

Gjithkush që ishte në atë sallë mbeti i shokuar. Gjyqi ndaj tij zgjati shumë, por në fund doli i pafajshëm. U kthye në atdhe. Natyrisht që postin e Kryeministrit nuk mund ta merrte përsëri në atë kohë, por në politikë ishte shumë aktiv. Dhe ja sot, përsëri atje**...**

Në Hagë

Arrita në Hagë në mbrëmje. Aty më priti ambasadori ynë z. Gazmend Barbullushi, një mik imi i vjetër dhe koleg shumë i mirë. Atë natë darkuam bashkë me delegacionin e Kosovës të drejtuar nga Ministri i Jashtëm z. Skënder Hyseni. Gjatë darkës shkëmbyem shumë biseda, tregime, shqetësime.

Ministri i Jashtëm i Kosovës Skënder Hyseni vis-à-vis Vuk Jeremiç

Ambasadori i Kosovës në Hagë na tregoi për ndodhinë e asaj dite me delegacionin serb. Kishte koinciduar që pala kosovare ishte vendosur në një hotel në qendër të Hagës dhe kishte arritur më përpara se ajo serbe. Kështu që ata jo vetëm ishin vendosur në hotel atë ditë, por edhe kishin zbritur te lobi për të pirë kafe. Kur pas pak vjen delegacioni serb i drejtuar nga Vuk Jeremiç, Ministër i Jashtëm i Serbisë. Ata u futen te lobi dhe, ndërsa personeli i ambasadës serbe po merrej me sjelljen e bagazheve dhe check–in, Jeremiçi vuri re se në hollin e hotelit ishte Skënder Hyseni dhe pala kosovare. Ai menjëherë iu drejtua ambasadorit të vet:

- Edhe këta në këtë hotel janë vendosur?

- Nuk e di, - iu përgjigj ambasadori i tij. - Nuk e kam idenë për këtë.

- Si nuk e ke idenë? Më çfarë merresh ti? Në një hotel me këta do të rrimë ne, me armiqtë e Serbisë do të rrimë ne në një hotel?, - iu hakërrye ai ambasadorit të vet.

- As që më ka vajtur mendja se mund të ishin këtu, - iu përgjigj ambasadori.

- Atëherë, m'u zhduk që këtej dhe nuk dua të shoh më me sy! Je i shkarkuar nga ky moment! Ju të tjerët merrni valixhet dhe le të ikim menjëherë nga ky hotel!

Kështu delegacioni serb u largua menjëherë dhe u vendosën në një hotel tjetër në Hagë.

Kjo ngjarje dukej si ugur i mirë për ne shqiptarët. Në fakt, Gjykata e kishte mbajtur aq mirë sekretin e opinionit të vet, saqë askush nuk mund të thoshte me siguri se cili do të ishte vendimi. Thjesht mund të hamendësonim. Kështu kaloi ajo mbrëmje me ethet e pritjes të së nesërmes për një ngjarje të madhe që do të kishte ndikim në të ardhmen e mëtejshme të kombit shqiptar.

Ethet e Ambasadorit Barbullushi

Ambasadori Barbullushi kishte bërë një punë të shkëlqyer gjatë takimeve me

anëtarë të ndryshëm të GJND-së. Natyrisht, askush nuk priste që me punën e një ambasadori do të ndryshonte mendja e atyre njerëzve të veshur me togat e drejtësisë ndërkombëtare, por përsëri të paktën ambasadori e dinte se nga i anon peshorja secilit nga anëtarët. Aty kishte gjykatës që ishin tërësisht kundër dhe frika se ata mund të përbënin shumicën ishte shumë e madhe. Ai merak i tij tanimë ishte kthyer në një ankth për ne të tjerët. Sidoqoftë tani duhej të prisnim orën 15:00 të datës 22 korrik 2010 dhe të dëgjonim vendimin.

Në orët e para të paradites bëmë një shëtitje para selisë së gjykatës. Ajo është një ndërtesë shumë e bukur, ndoshta më e bukura e Hagës, e njohur në gjuhën hollandeze si *Vredespaleis ose:*

Pallati i Paqes

Kjo Gjykatë është hapur më 28 gusht 1913. Ajo fillimisht u mendua si një ndërtesë simbolike për Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, e vendosur në Konferencën e Hagës të vitit 1899. Në atë kohë Andrea Dickson White, i cili punoi më së shumti për ndërtimin e kësaj gjykate, siguroi një fond prej një milion e gjysmë dollarë, të cilat në vitin 1903 i dha industrialisti i hekurit, skocezi Andrew Carnegie, për të ndërtuar atë që do të quhej Pallati i Paqes. Andrew Carnegie ishte një skocezo - amerikan, i lindur në vitin 1835. Ai ishte një nga filantropët më të famshëm të botës dhe njeriu që i dhuroi qytetit të New York-ut atë që sot quhet Cornegie Hall, një nga qendrat më të bukura muzikore në botë, pa përmendur sa e sa vepra të tjera, që ka dhuruar gjatë jetës së tij.

Pallati i Paqes është ndërtuar në stilin e rilindjes së vonë. Ndërtesa është vërtet një vepër arti dhe të tilla janë edhe dhuratat që e dekorojnë atë. Në të gjenden vlera të mëdha artistike, siç janë vazo 3.2 ton të dhuruara nga Rusia, dyer të dhuruara nga Belgjika, mermer nga Italia, një shatërvan nga Danimarka, qilima muralë nga Japonia, orë për Sahatin e Kullës nga Zvicra, qilima persianë nga Irani, dru dekorativë prej Indonezisë dhe Shteteve të Bashkuara etj. Brenda tij gjenden buste, portrete të kampionëve të paqes nga e gjithë bota dhe nga të gjitha fushat, si Nelson Mandela, Jawaharlal Nehru, Mahatma Ghandi, Andrew Cornegie, William Kremer, Ruy Barbosa etj.

Sot, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, është organi juridik më i rëndësishëm i Kombeve të Bashkuara. Ajo u themelua në qershor të vitit 1945, bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe filloi punën në prill 1946. Themeluesit e saj deshën që ajo të ishte:

> *"Tempull i paqes ku dyert janë të hapura, ndryshe nga ato të Tempullit Janus, në kohët e paqes dhe të mbyllura në rastet e luftës (…) si dëshmi e vlefshme e popujve që pas shumë shekujsh të gjatë më në fund të kenë një gjykatë ku gjejnë zgjidhje paqësore kundërshtitë, që ekzistojnë midis popujve".*

Me pak fjalë, ky ishte pallati në të cilin do të futeshim atë ditë për të dëgjuar vendimin mbi opinionin e asaj gjykate të përbërë prej trembëdhjetë anëtarësh. Ne u futëm aty së bashku dhe u drejtuam nga stuartët e gjykatës. Zumë vendet në anën e djathtë të sallës. Pak pas nesh erdhi delegacioni serb. Jeremiçi hyri me kokën lart, parakaloi (përsëri gabim) para delegacionit tonë dhe me shpejtësi shkoi e u vendos në anën tjetër të sallës, atë të majtën. Këto veprime më kujtonin plotësisht veprimet diplomatike të kohës së luftës së ftohtë, kur thjesht gjetja rastësore në një mjedis me armikun mund të shkaktonte masa ndëshkuese ndaj atij, që nuk kishte bërë kujdesin e duhur.

Vendimi pro Kosovës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Seancën e hapi Hisashi Owada - gjykatës japonez, president i GJND në atë kohë. Ai filloi ta lexonte vendimin dhe ne po dëgjonim gjithë me veshët katër. Gjatë kohës kur ai po lexonte, zëvendësi i tij, një gjykatës trupmadh sllovak, me emër Peter Tomka, vendoste kontakt me sy me ambasadorin tonë dhe dukej sikur i thoshte: "Ja, e arritët atë që deshët. Unë vetë nuk desha, por ju e arritët këtë".

Më vonë ambasadori na tregoi se Peter Tomka kishte qenë kategorikisht kundër, por natyrisht, kur shumica në atë gjykatë voton "për" ose "kundër" diçkaje, pala tjetër i bindet plotësisht. Në të vërtetë ashtu ndodhi, nëntë gjykatës votuan "për" dhe katër që ishin *"*kundër*"*, përfshirë edhe gjykatësin sllovak, duhej të bënin të njëjtën gjë.

Leximi i materialit zgjati aq kohë sa nuk e mbaj mend, sepse ajo fjala magjike se Shpallja e Pavarësisë ishte akt ligjor i justifikueshëm nga e Drejta Ndërkombëtare, na bëri të ngriheshim në këmbë dhe të brohorisnim me të madhe prej gëzimit. Midis atyre gjërave, që përjetova në atë ditë më mbeti në mendje edhe largimi kokulur i Vuk Jeremiçit dhe anëtarëve të delegacionit të tij. Pastaj edhe ne u larguam të lumtur sa më s'ka për të festuar bashkë me delegacionin kosovar.

Në burgun e Scheveningen te Ramush Haradinaj

Ditën tjetër bashkë me ambasadorin vajtëm të shihnim heroin e Kosovës, Ramush Haradinaj, në burgun e Hagës, Scheveningen. Pas procedurave të gjata dhe shpjegimeve për natyrën e takimit, një seri dyersh të hekurta u hapën njëra pas tjetrës. Dhe ja, më në fund, në kafenenë e burgut, u ulëm pranë një tavoline në një kompartment, ose një dhomëz të ndarë prej të tjerave me perde, prej nga shiheshim shumë mirë për çdo veprim që mund të bënim, nga një treshe policësh, të cilët ishin ulur në një si podium.

Pas pak, aty u shfaq Ramushi. I fortë, i qeshur, i vendosur, ai na shtrëngoi duart, na përshëndeti dhe na ftoi të uleshim. Patëm një bisedë interesante dhe unë më së pari e urova për opinionin e Gjykatës së Hagës për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pastaj biseda u përqendrua tek arresti i tij dhe te pafajsia, e cila do ta kthente përsëri si hero në Prishtinë. I përcolla mesazhin e kryeministrit Berisha dhe porosinë, që më kishte dhënë gjatë ditëve atje, dhe më pas vijuam bisedën. Në një moment e pyeta:

– A keni parë këtu ndonjë prej këtyre serbëve si Radovanin (Karaxhiç) apo ndonjë prej serbëve tjerë kriminelë?

– Po, – më tha, – i kam parë më herët, kur isha radhën tjetër, por edhe unë u shmangem edhe ata më shmangen mua. Milosheviçin e shihja, por sa herë e shihja, më kapte një ankth dhe një dëshirë ta shqyeja dhe duket se ai e ndiente, sepse përherë fshihej pas rojeve dhe largohej. Radovanin nuk e kam parë.

Ai vazhdoi me emrat dhe përmendi Vojsllav Sheshelin. Sikur të ishte me porosi, ky i fundit kaloi aty pranë, u ndal dhe na hodhi një vështrim të habitshëm.

- Kakoste bre gospodin Ramushe? - iu drejtua ai.

- Dobra, dobre, - u përgjigj Ramushi, - ti si bila ona?

Ata biseduan serbisht rreth një minutë në këmbë, dhe kur u ul Ramushi na tregoi për ato fjalë që shkëmbyen në atë bisedë të shkurtër. Shesheli i kishte thënë:

"Mos u mërzit, Ramush! Kësaj radhe të sollën këtu se deshën t'ia bënin më të lehtë atë, që i bënë Tadiçit dje".

Ishte fjala për Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare.

Në sytë e atij krimineli lexova tërë urrejtjen e tij jo vetëm ndaj bashkëbiseduesit, por edhe tërë atyre që kishin kontribuar për ta futur atë aty. Mbase edhe ndaj presidentit të vendit të vet - Boris Tadiçit.

U ndamë me Ramushin me premtimin se asgjë nuk do të kursehej për lirimin e tij.

Udhëtimin për në atdhe e bëra me një gëzim të pashoq. Më dukej se po sillja një lajm të madh me vete, edhe pse lajmi ishte shpërndarë në eter në kohë reale dhe shumë para kthimit tim.

Holandë, Hagë, 22-23 korrik 2010

ME ORGANIZATËN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIKE TË DETIT TË ZI (BSEC), NË MOSKË

Ishte mesi i dhjetorit të vitit 2011. Rusia do t'i dorëzonte Serbisë presidencën e radhës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi (BSEC). Ky ishte moment i rëndësishëm në vijueshmërinë e veprimtarisë së njërës prej organizatave më të rëndësishme rajonale, BSEC-ut, e themeluar në verën e vitit 1992.

Pak histori

Shqipëria ishte anëtare e saj themeluese, edhe pse nuk lagej nga ujëra të Detit të Zi, madje qoftë edhe një përrua i ujërave shqiptare nuk derdhej në atë det. Ishte mesa duket dëshira e madhe e Presidentit të asaj kohe, Turgut Őzal, që ta ndihmonte Shqipërinë të anëtarësohej në një prej organizatave rajonale, si hap i rëndësishëm drejt hapjes së vendit, pas një vetizolimi prej shumë dekadash.

Më 25 qershor 1992 krerët e shteteve dhe qeverive të njëmbëdhjetë vendeve: Armeni, Shqipëri, Azerbajzhan, Bullgari, Gjeorgji, Greqi, Moldavi, Rumani, Rusi, Turqi dhe Ukrainë, nënshkruan në Stamboll Deklaratën e Bosforit, duke sjellë në jetë BSEC-un.

Gjatë viteve të shërbimit diplomatik, si konsull në Stamboll, më ishte dhënë rasti të merrja pjesë në shumë takime madje edhe mjaft të rëndësishme, samite ku merrnin pjesë presidentë, kryeministra dhe ministra të jashtëm. Zyrat e organizatës ishin vendosur në një vend jashtëzakonshit të bukur. Qeveria turke ishte treguar shumë bujare, duke vënë në dispozicion një nga pallatet ministrore

të sulltanëve, në Müşir Fuad Paşa Yalısı, Eski Tersane, në Stamboll.

Sa herë shkoja aty, mësoja diçka nga historia e këtij pashai, i lindur në vitin 1835, që kishte jetuar shumë gjatë deri në vitin 1931. Ai ishte i biri i një ushtari dhe burrë-shtetasi otoman me gjak circasian. Ai u bë kolonel i ushtrisë egjiptiane nën komandën e themeluesit të Egjiptit modern, shqiptarit Muhamet Ali Pashë Kavalla. Në vitin 1869 vajti në Stamboll. Në vitin 1877 - 1878 ishte në frontin e Danubit në Luftën Ruso - Turke. Më pas u bë i njohur si Heroi i Betejës së Helenës së 26 Qershorit 1877 ndërsa drejtonte trupat otomane dhe mori titullin "Deli", që në turqisht do të thotë i "dalldisur". Këtë nofkë e mori për shkak të guximit të tij prej të çmenduri.

Duke pasur parasysh këtë figurë, të cilin Turqia moderne e nderonte duke i vënë emrin e tij një objekti të tillë, përherë më shtynte kurreshtja të dija se çfarë do të mendonte ai, nëse do të shihte që ajo administratë përbëhej prej rusësh, të cilët i kishte mundur, pastaj prej grekësh, ukrainasish, gjeorgjianësh dhe armenësh, shqiptarësh dhe azerësh, e kështu me radhë. Të tërë, njëherë e një kohë, ishin subjekte të shtetit që ai e kishte mbrojtur me mjaft guxim ndërsa tani ishin pajtuar të bashkëpunonin në të njejtën organizatë.

Në dhjetorin e vitit 2011 ishim pra në Hotelin "President", në Moskë, në mbledhjen e dorëzimit të presidencës së radhës së Federatës Ruse tek anëtari tjetër i radhës, Serbia.

Kosova e ftuar nga presidenca shqiptare e BSEC në Tiranë dhe një incident me delegacionin rus

Në një takim të radhës së Asamblesë Parlamentare të BSEC-ut, në Tiranë, ndodhi një incident. Atë kohë Shqipëria mbante Presidencën e Parlamenteve dhe e kishte thirrur mbledhjen në Tiranë. Sipas statutit të kësaj asambleje, kryesuesi i radhës ruante të drejtën të ftonte kë të donte madje edhe Kryetarë Parlamentesh të vendeve, që nuk ishin anëtarë të BSEC-ut. Me këtë të drejtë, Kryetarja e Parlamentit të Shqipërisë kishte ftuar Kryetarin e Parlamentit të Kosovës, vend jo anëtar, dhe as i njohur nga shumë prej vendeve anëtare të BSEC-ut. Kjo bëri që para mbledhjes, delegacione të caktuara, sidomos ai rus, të paralajmëronin se nuk do të ndiqnin seancën parlamentare në Tiranë, nëse

në sallë do të ishte Kryetari i Parlamentit të Kosovës. Ky fakt u paralajmërua nga Ministria e Punëve të Jashtme Ruse dhe u pa qartë se do të merrte trajtë të fortë politike dhe se mund të bëhej një arsye për të justifikuar mos zhvillimin e mbledhjes. Këtyre paralajmërimeve, Ministria jonë e Punëve të Jashtme iu përgjigj me indiferencë. Delegacionet u mblodhën për të përshtatur programin në një mbasdite të bukur në Hotel Tirana International.

Sado që dukej situatë mjaft e tensionuar, kryetarja jonë erdhi shumë e lirshme, gati e shkujdesur, elegante, i takoi të gjithë dhe nuk shfaqi asnjë shenjë brengosjeje. Me të filluar, i përshëndeti, nxori përpara programin dhe kërkoi menjëherë miratimin e tij. Në këtë kohë kryetari i delegacionit rus ndërhyri për të kërkuar fjalën. Kryetarja jonë e kundërshtoi dhe i tha se do të jepej fjala pas përshtatjes së programit. Rusi kundërshtoi dhe iu dha fjala. Ai deklaroi se donte të dinte për pjesëmarrjen e Kryetarit të Parlamentit të Kosovës dhe nëse kjo do të ndodhte, atëherë kjo duhej hedhur në votë.

Kryetarja, plotësisht në të drejtën e saj, i tha se kjo do të diskutohej te pjesa "çështje të tjera" pra, në fund, dhe vetëm pas përshtatjes së programit. Rusi këmbënguli dhe u mbështet fort nga Moldavia dhe Rumania. Çështja dukej se po merrte përmasa të padëshirueshme. Kryetarja këmbënguli. Delegati turk ndërhyri dhe kërkoi kompromis, i cili do të hidhej në votë. Votimi u bë dhe rezultoi një votë "për", Shqipëria, një abstenim nga Turqia dhe të tjerat "kundër".

Kështu, Asambleja Parlamentare e radhës e Organizatës Ekonomike të Detit të Zi u anulua. Kjo bëri që as stafeta të mos dorëzohej zyrtarisht dhe takimi tjetër, që duhej mbajtur në Armeni, të vihej në dyshim. Në të vërtetë kjo shkaktoi një farë situate të pakëndshme por… në fund të fundit për ne shqiptarët më e rëndësishme se çdo gjë ishte Kosova dhe jo një mbledhje, sado shumë të përfryhej.

Përgjigje me të njëjtën monedhë ndaj rusëve dhe grekëve në Moskë

Atmosfera e kësaj mbledhjeje do të ndihej edhe më 14, 15, 16 dhjetor 2011, në Moskë. Aty do të kishte një takim në nivel drejtorësh dhe specialistësh për tri

ditë, pastaj Rusia ia dorëzonte presidencën e Organizatës Ekonomike të Detit të Zi, Serbisë.

U bënë shumë diskutime, mjaft debate. Mbledhjet i drejtonte rusi Çevçenko bashkë me Sekretarin e BSEC-ut, grekun Leonidas. Në përgjithësi ndihej fryma sllave ortodokse, greke. Natyrisht që ajo organizatë, përveç parave që u harxhonte shteteve, disa nëpunësve që paguheshin, udhëtimet që kryheshin, nuk bënte ndonjë gjë të madhe, por edhe aq sa ishte, mbronte interesa të caktuara. Shqipëria në fakt, ashtu siç ishte e largët me ujërat e atij deti, ndihej e largët edhe në punët e asaj organizate. Ose më mirë, nuk kishte pasur ndonjë përfitim apo dëm. Megjithatë, vlerësohej se ishte më mirë të ish aty sesa të mos merrte pjesë. Dhe ne ishim aty.

Ndërkohë që zhvillohej mbledhja, ne, delegacioni shqiptar, ku bënte pjesë z. Agim Pasholli dhe zonjushe Almona Bajramaj, kishim rënë në gjurmë të një veprimi tërësisht në shkelje të statutit të BSEC-ut. Një akt i tillë nuk duhej lënë të kalonte kur mendonim se si rusët e kishin prishur mbledhjen e Tiranës. Sado që Shqipëria ishte tërësisht konstruktive dhe as që kishte kurrfarë qëllimi të ndërmerrte ndonjë hap që shkonte kundër kësaj, gjithsesi në situatën që ishim nuk do të mund të rrija pa e ngritur atë problem dhe isha plotësisht i bindur se do të bëja një lëvizje shah-mat.

Në ditën e tretë, përpara se të bëhej gati rezoluta, të cilën do ta lexonte Lavrovi, Ministri i Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, e mora fjalën në emër të delegacionit tonë:

Karvani me "ndihma humanitare" ruse për rojet e urës në Mitrovicën e Veriut – Kosovë

Pasi përshëndeta dhe urova për suksesin e takimit, u ndala te një ngjarje e cila "rastësisht" kishte ardhur në vëmendjen e delegacionit shqiptar.

"Fjala është…", - shqiptova ngadalë e qartë, duke u munduar ta fshihja emocionin, - "fjala është për një karvan, një dërgesë mallrash "humanitare", ndihmash gjoja humanitare të nisura nga Rusia me destinacion fundor Mitrovicën e Veriut, në Kosovë. Janë jo pak, por 18 maune të ngarkuara me mallra, që askush nuk ua di inventarin. Siç dihet atje ka grupe rebelësh, të cilët

kundërshtojnë me armë autoritetet vendase dhe ato ndërkombëtare. Rrugët janë bllokuar. Ka ushtarë të KFOR–it të goditur, të plagosur madje edhe një jetë të humbur. Më e keqja e kësaj është se ky karvan "ndihmash" shkon në Mitrovicë nën ombrellën e Sekretariatit të BSEC-ut, i autorizuar prej tij, në mënyrë të njëanshme, pa dijeninë e vendeve anëtare dhe administratave të tyre në Stamboll. Për më tepër, ndihmë humanitare, sipas marrëveshjes dhe protokollit mes vendeve të BSEC-ut, të nënshkruara midis tyre, përfitojnë vetëm vendet anëtare të kësaj organizate, nga vendet e tjera anëtare në rast fatkeqësish dhe miratohen brenda sekretariatit, kur kërkesa për një ndihmë të tillë paraqitet nga qeveria e vendit anëtar. Ky protokoll pasqyron edhe nivelin më të lartë të solidaritetit midis vendeve në raste emergjencash dhe fatkeqësish natyrore. Kjo ndihmë duhet të përmbajë ndihmesën e të gjitha vendeve, sipas mundësisë për të ndihmuar vendin, që e kërkon atë. Ndihma nuk iu jepet vendeve jo-anëtare të BSEC-ut dhe as vendeve anëtare të BSEC-ut, që nuk e kanë nënshkruar dhe ratifikuar protokollin në parlamentin përkatës. Asnjë vend nuk mund t'i tranzitojë këto ndihma, nëse nuk është anëtar dhe nënshkrues i protokollit. Në këtë rast, karvani ka kaluar nëpër Serbi, e cila nuk e ka nënshkruar protokollin, është dërguar në Kosovë, vend i cili nuk njihet nga një numër shtetesh rreth kësaj tryeze, i është kërkuar korridor Hungarisë që nuk është anëtar i BSEC-ut, dhe shkresa shoqëruese e karvanit është bërë vetëm në një kopje, me dijeninë vetëm të një vendi, pikërisht Rusisë. Ky veprim përbën shkelje flagrante të normave dhe rregullave të bashkëpunimit të vendeve të kësaj organizate".

Unë isha i ulur në skajin e fillimit të tavolinës në krahun e djathtë të presidiumit dhe, fill pas meje në të majtë, ishte Leonidas, greku plak i sekretariatit, një dhelpër që kishte ca sy të vegjël e të picërruar. Kur fillova fjalën, dukej se ai po luante me telefonin e tij celular, sepse pashë që nuk më dha ndonjë rëndësi, por me kalimin e sekondave dhe minutave të fjalës sime, vura re që ai u përqendrua, filloi të më shihte me vëmendje dhe pastaj po shihte drejt rusit, të cilin e kishte në krah dhe, akoma pa mbaruar së foluri unë, ai përplasi në tavolinë telefonin celular me shumë forcë dhe befas klithi:

- Jo, kjo nuk është e drejtë. Si ka mundësi?

- Zotëri, ky autorizim është nënshkruar prej jush, - i thashë qetë dhe e tregova dokumentin në sytë e të gjithëve. Nëse anëtarët e nderuar të delegacioneve dëshirojnë që unë t'ua shpërndaj, do ta bëja me kënaqësi.

- Jo, - klithi Leonidas përsëri. - Si ka mundësi?

Vura re se shqetësimi i tij ishte se kush e dekonspiroi këtë lëvizje. Kryetari i seancës, rusi Çevçenko, kërkoi ndërprerje të seancës dhe më ftoi në një bisedë private, siç i thonë *off record*. Me mirësjellje u ndava dhe biseduam. Propozimi i tij ishte:

- Po sikur ta mbyllim këtu këtë çështje?".

- Jo, - i thashë, nuk do të mbyllet këtu. Ne vërtet jemi vend i vogël dhe larg zonës së Detit të Zi, por në këtë organizatë gëzojmë të drejta të barabarta. Prandaj jemi anëtarë. Nuk mund të ketë dy standarde dhe dy statute. Njëherë e shkelim, sikurse bëtë ju në Tiranë, tjetrin e shkelim, siç keni bërë ju në Mitrovicë. Unë kërkoj debat për këtë.

Pas kësaj pasoi një pauzë prej disa minutash dhe u mblodhëm rreth tryezës. Personi më i pezmatuar ishte njeriu symizë, greku Leonidas.

Fjalën e mori e para delegatja turke, e cila u ndal në detajet e autorizimit, të cilin ia dorëzova unë. Ajo e konsideroi këtë shkelje të rëndë dhe e quajti thyerje të çdo rregulli dhe norme, madje ndërhyrje në punët e tjerëve në emër të organizatës. Pas saj, çuditërisht pasoi reagimi i rumunit, me shumë forcë dhe shumë argumente dhe më pas ai i bullgarit.

Pas rreth një gjysmë ore debat, Leonidas pranoi pa asnjë pikë turpi se "kishte qenë nën presion të madh", dhe bëri me shenjë nga ai, që kishte në krahun e majtë. Ishte rusi. Në lidhje me këtë delegacioni turk mbajti qëndrim të prerë dhe u mbështet edhe nga vendet e tjera.

Një akt i tillë, në dukje i thjeshtë, në përmbajtje ishte shkurtim dore i një veprimtarie ilegale të një fuqie të madhe ndaj Kosovës. Po ashtu iu pre "ndihma" grupeve rebele kriminale të Mitrovicës, ose të ashtuquajturve Rojet e Urës.

Ministrit rus, Sergej Lavrov, nuk i punon mikrofoni brenda në Moskë

Pasi u miratuan rezolutat, të nesërmen në sallën e madhe të atij hoteli, tërësisht *alla komunizëm*, u mbajt mbledhja e Ministrave të Jashtëm. Pak para fillimit zumë vendet. Delegacioni ynë përfaqësohej nga zv/Ministri i Punëve të Jashtme, z

Selim Belortaja. Pas tij ishte një ndër ministrat më të fuqishëm të Jashtëm të botës, Sergei Lavrov. Ai erdhi ashtu siç është, çehresëz, nursëz, siç thonë turqit, me një natyrë vetbesuese deri në maksimum. BSEC-u ishte një gjë fare e vogël për atë që mbante pezull një pjesë të rruzullit tokësor, në konflikt. Gati përballë me të ishte Vuk Jeremiç, Ministër i Jashtëm i Serbisë, me të cilin hynë bashkë në sallë, tërë gaz e hare ndaj njëri-tjetrit. Ai e mori mikrofonin që ta hapte seancën si mikpritës.

Për habinë e të gjithëve mikrofoni nuk punonte. Me erdhi të qeshja me vete. Këto gjëra ndodhin nëpër dasma, kur ata që duan të flasin dalin dhe bëjnë një provë teknike, një - dy - tre, u duk sikur erdhi zëri. Filloi me "Të dashur miq…", u ndërpre përsëri dhe për pesëmbëdhjetë minuta ai mbeti i heshtur përpara nesh, që e shihnim se si nervozizmi i tij po vinte në rritje.

Në të vërtetë unë prisja që ai ta braktiste sallën. Por jo ishte në shtëpinë e vet, shtëpi e cila ishte aq difektoze dhe që ato ishin të tilla, saqë kishin difektuar edhe një pjesë të madhe të botës. Në atë moment m'u kujtuan shakatë e Ronald Reganit me makinat sovjetike, të cilat për t'i blerë duhej të prisje në radhë njëzet vjet.

Moskë, 14 - 16 dhjetor 2011

Epilog

Sapo u ktheva nga Moska, i raportova Ministrit të Punëve të Jashtme rreth takimit në Moskë. Po atë ditë më njoftoi se mua do më afrohej një post i ri, *Charge D'Affaires* i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës. Pas kësaj, për mua fillonte një fazë e re në shërbimin diplomatik, e cila do të pasqyrohet në faqet vijuese të këtij libri.

Tiranë, 21 dhjetor 2011

KREU I KATËRT

NË LONDËR – I NGARKUAR ME PUNË ADINTERIM

2012 – 2013

100 VJET PAVARËSI, 28 NËNTOR 2012

Prej sot, këtu në Bayswater ne do të kemi simbolin tonë kombëtar, Bustin e Skënderbeut, vepër e skulptorit Kreshnik Xhiku.

Jam krenar që, në këtë ditë historike të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, përfaqësoj vendin tonë të dashur, Shqipërinë; t'ju përfaqësoj juve, që jeni komuniteti më i ri dhe më me perspektivë në këtë vend, ju që i jepni nder këtij vendi dhe vendit prej nga keni ardhur nga çdo truall etnik shqiptar i Ballkanit.

Prej sot, ky vend do të jetë vendi juaj, tempulli juaj i nderit kombëtar, do të jetë faltorja juaj. Duajeni, respektojeni, kthehuni herë pas here, frymëzohuni dhe reflektoni për identitetin tuaj!

Bëhuni britanikët më të mirë të këtij vendi, por jeni edhe shqiptarët më atdhetarë në botë!

Dhe do të jeni njerëzit më fisnikë të këtij rruzulli!

Dhe do të jeni njerëzit më të mirë të këtij vendi mik e të bekuar!

Rrofshi ju! Rroftë emri dhe vepra e Skënderbeut!

Rroftë Shqipëria! Rroftë Britania e Madhe!"...

Bacë u kry.

Bayswater, London, 28 nëntor 2012

DREJT LONDRËS

Paraditen e 21 dhjetorit të vitit 2011, Ministri i Punëve të Jashtme më thirri në zyrë, për të më komunikuar një detyrë të re. Pasi më pyeti për të rejat e fundit dhe iu përgjigja për çdo gjë që kishte ndodhur ato ditë, ai më tha:

- Epo, mirë! Por unë kam një lajm për ty. A dëshiron të shkosh jashtë shtetit?

- Po unë sapo jam kthyer nga Moska, - i thashë ministrit.

- Atë e di, por unë po të ofroj të na përfaqësosh diku jashtë vendit, - m'u kthye ai.

E dëgjova me vëmendje ministrin.

Fjala ishte të shkoja si *Charge d'Affaires*, në Londër.

Pas tri ditësh e pranova propozimin.

Pasditen e 16 shkurtit 2012 u nisa për Londër.

Dëshiroja ta filloja punën, të nesërmen, në ditën e 4-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Charge d'affaires i Republikës së Shqipërisë në oborrin e Shën Xhejmsit, në Londër

Dita e mbërritjes në Londër nuk mund të ishte më e zgjedhur sesa ajo:

"4-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës."

E kisha festuar ditën e shpalljes së saj në Prishtinë dhe tani do të festoja me kolegët kosovarë në Londër. Arritëm vonë në mbrëmje. Të nesërmen më 17 shkurt 2012, në orën 12, morëm pjesë në pritjen e organizuar në Hotel "Corinthia", në Whitehall. Ky hotel ishte zgjedhur me qëllim, pasi pikërisht aty mendohet se u mblodh Konferenca e Ambasadorëve, e cila vendosi njohjen e shtetit të pavarur shqiptar, por me koston e lënies përtej kufijve të tij të

territoreve të tëra, midis tyre edhe ato të Kosovës. Dhe ja tani pas 100 vjetësh, ajo pjesë e lënë jashtë kufirit politik të shtetit të shqiptarëve, do të festonte përvjetorin e vet. Edhe pse aq i padrejtë sa ishte ai vendim, prapëseprapë realiteti i ri ishte ky:

Kosova e Pavarur.

Shkuam te Hoteli "Corinthia". Ambasador i Kosovës ishte profesor Muhamet Hamiti dhe zëvendës i tij, studiuesi i mirënjohur dhe drejtor e themelues i Institutit të Studimeve Shqiptare në Londër, Bejtullah Destani. Midis shumë miqve të shqiptarëve në atë pritje gjendej pothuajse e tërë anëtarësia e Shoqatës Anglo - Shqiptare. Është kjo arsyeja përse udhëtimin tim në Londër dua ta filloj dhe ta mbaroj pikërisht me këtë Shoqatë, e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në momente të caktuara të historisë së kombit tonë.

NJOHJA ME SHOQATËN ANGLO - SHQIPTARE (AAA) NË LONDËR

Pak histori

Shoqata Anglo - Shqiptare (AAA) është formuar në vitin 1912 me nismën e Kolonelit Aubrey Herbert, diplomat i shquar, studiues dhe anëtar i Parlamentit britanik. Edith Durham ishte ndër aktivistet e para pjesëmarrëse dhe sekretare e Shoqatës. Ajo njihej si korrespondente e huaj, shkrimtare, udhëtare dhe antropologe e Ballkanit. Qëllimi i shoqatës ishte të ndihmonte pavarësimin e Shqipërisë, pasi ajo u themelua pak përpara asaj date të shënuar historike për kombin tonë. Pas Luftës së Parë Botërore, shoqata ndiqte nga afër ngjarjet në Ballkan dhe përbënte një kanal të rëndësishëm lajmesh nga Shqipëria, që ia paraqiste qeverisë britanike dhe publikut të gjerë ndërkombëtar. Pas Luftës së Dytë Botërore ajo merrej më shumë me fatin e të arratisurve nga Shqipëria, për shkak të përndjekjes së regjimit komunist ndaj tyre. Me rënien e komunizmit, në vitin 1991 ajo u riformua dhe mori tiparet e një shoqate, që promovon historinë, kulturën dhe traditën e popullit shqiptar.

Shoqata tani boton edhe një buletin informativ, i cili del tri herë në vit dhe përmban artikuj të rëndësishëm për Shqipërinë dhe shqiptarët në përgjithësi nëpër Ballkan. Shoqata drejtohet nga një prej figurave më të ndritura të kombit anglez sot, filozofit, studiuesit dhe historianit Sir Noel Malcolm, President Nderi, ndërsa kryetar është ish- Ambasadori i Britanisë së Madhe në Tiranë, z. Stefan Nash. Editori i buletinit është Adam Yemey dhe një ndër anëtaret më të shquara është zonja Patricia Nugee, koleksionistja më e madhe e librave të Skënderbeut në botë. Në shoqatë ka shumë emra për t'u përmendur. Vlen të veçohet John Hodgson, përkthyesi i veprës së Ismail Kadaresë në gjuhën angleze. Me kohë

aty kanë mituar edhe anëtarë të tillë si Anthony Quayle, një ndër interpretuesit më të mëdhenj të tragjedive të Shekspirit, ish-anëtar i SOE-s, i cili shërbeu në Shqipëri gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Alexandër Duma, i biri i diplomatit të Mbretërisë Shqiptare, Dervish Duma, i cili nuk ua dorëzoi çelësat e Legatës italianëve në vitin 1939, ka ndjekur traditën e të atit, duke u bërë një ndër mbështetësit më të mëdhenj të kësaj shoqate, me histori aq të vyer.

Shoqata dhe ambasada

Pak ditë pasi u njoha me drejtuesit e Shoqatës Anglo - Shqiptare, në një bisedë me diplomatin dhe studiuesin e shquar, Bejtulla Destanin, vendosa që salla e madhe e ambasadës të vihej në dispozicion të anëtarëve të saj. Kjo do t'i jepte asaj një autoritet tjetër dhe ata do të ndjenin edhe ngrohtësinë e shtetit shqiptar, i cili iu kishte munguar për një kohë shumë të gjatë. Madje, me portretet e dy njerëzve aq të dashur, varur në muret e ambasadës, vetvetiu salla mori emrin *"Edith & Herbert"*. Prej asaj kohe, në ambasadë zhvillohen veprimtari të shoqatës, që nga ekzpozitat e librave për Skënderbeun deri te promovimi i librave historikë për Shqipërinë, diskutime filmash dhe festa jubilare etj.

Dekorimi i drejtuesve dhe disa anëtarëve të AAA-së

Momenti më i rëndësishëm i marrëdhënieve të Ambasadës me AAA–në ishte ai kur Presidenti i Republikës, Sh.T. Z. Bujar Nishani, më 9 dhjetor 2014 nderoi personalitete të shquara britanike për kontributin e veçantë e të çmuar në forcimin e miqësisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, si dhe për promovimin e vlerave historike e kulturore dhe të çështjes shqiptare. Në një ceremoni të veçantë të zhvilluar në Ambasadë, kreu i Shtetit Shqiptar vlerësoi Fort të Nderuarin Lordin Alan Watson të Richmondit dhe Fort të Nderuarin, Lordin Michael Bates me Dekoratën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"; Sir Noel Malcolm me Dekoratën "Nderi i Kombit", z. Alexander Duma dhe z. David Lloyd me Dekoratën "Nënë Tereza" ndërsa Kryetarin e Shoqatës, z. Stephan Nash me dekoratën "Për Merita të Veçanta Civile".

LONDON SCHOOL OF ECONOMICS, TAKIM ME NOBELISTIN E PAQES DALAI LAMA

Në jetën e një diplomati, veçanërisht kur ai është i emëruar në një vend të madh siç është Britania e Madhe, çdo takim, aktivitet, prezantim, leksion i paraqitur nga njerëz të rëndësishëm të kësaj bote, duhet vlerësuar me seriozitetin më të madh. I tillë ishte edhe takimi në *London School of Economics* në Londër, me Nobelistin e Paqes, Dalai Lama.

Kush është Dalai Lama?

Dalai Lama është udhëheqësi shpirtëror i budizmit tibetian, i cili është bërë nobelist pas përpjekjeve të veta për çlirimin e Tibetit dhe ngritjen e problemeve të mbrojtjes globale të mjedisit.

Atë ditë vajta në sallën e LSE-së me dëshirën e madhe për të parë një ndër njerëzit më interesantë të botës. Kisha vërtet kureshtje të veçantë, pasi do të takoja njeriun që, më së shumti, e ka predikuar tolerancën ndërfetare dhe etnike për arritjen e qëllimit të tij - çlirimin e Tibetit, të cilit ai i takon.

Dalai Lama është i katërmbëdhjeti pinjoll trashëgimtar i kultit budist të priftërinjve tibetianë të shkollës guliste. I lindur në vitin 1935 me emrin Lhamo Dhondup, si udhëheqës shpirtëror, ai do të mbante një bisedë mbi tolerancën në një shoqëri të drejtë dhe të ndershme. Vite më vonë, kur ndoqa filmin "Shtatë vite në Tibet", luajtur nga Brad Pitt, mësova shumë më tepër rreth jetës së tij, që kur ishte fëmijë dhe më pas.

Filozofia e Dalai Lamës

Ai e filloi bisedën, duke iu drejtuar audiencës me fjalët:

"Vëllezër dhe motra, unë gjithmonë e kam konsideruar veten si njëri prej jush, pikërisht sikurse jeni të gjithë ju. Shtatë miliardë njerëz sot jetojmë mbi këtë tokë dhe të gjithë jemi njësoj fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht. Disa kanë flokë me ngjyrë të ndryshme, hundë më të madhe ose më të vogël, por këto janë të parëndësishme. Ajo që na bashkon të gjithëve ne është se dëshirojmë të jemi të lumtur dhe askush nuk dëshiron të jetë i pikëlluar. Çdokush prej nesh nuk dëshiron të zgjohet në mëngjes e të thotë: Sot dua të ballafaqohem me një problem. Në fakt, gjithkush ka dëshirë të gëzojë jetë të lumtur".

Më pas ai foli për problemet që njeriu ia shkakton vetvetes thjesht, sepse nganjëherë nuk shohin larg dhe janë mendjeshkurtër. Ai e ilustroi këtë me një shembull, ku përfshinte krizën globale të ekonomisë, ndryshimet klimaterike dhe hendekun e madh që është shkaktuar midis të varfërve dhe të pasurve. "Kjo vjen, – tha ai, – "pasi ne nuk vëmë në lëvizje mençurinë tonë të mrekullueshme njerëzore, por në vend të saj kërkojmë kënaqësinë e menjëhershme personale".

Në çdo fjalë të tij ndjeja mençurinë njerëzore. Ai fliste shumë thjesht, por brendia e frazës së tij ishte shumë e madhe. Ai ishte njeriu, që ka si devizë:

> *"Të jesh dashamirës sa herë të jepet mundësia, dhe kjo është përherë e mundshme; feja ime është shumë e thjeshtë: feja ime është mirësia. Lumturia nuk është diçka e dhënë si dhuratë; ajo rrjedh nga veprimet tona".*

E ndiqja me vëmendje nobelistin dhe më dukej se nuk kisha të ngopur me fjalët që ai thoshte. Pas çdo fjalie të mençur ai qeshte me zë dhe bënte grimasa, që e bënin edhe audiencën të qeshte. Dukej sikur kërkonte një farë miratimi, si pa dashje, për ato që thoshte dhe atë miratim e merrte nga salla pa ndonjë hezitim prej reagimit të saj.

Pasi mbaroi ligjërata e Dalai Lamës, moderatori, i cili foli në emër të Frederick Bonnart Braunthal Trust, Matrix Chambers dhe atë të Sigrid Rausing Trust, i dhuroi atij një kapele bejsbolli, një simbol, që iu dhurohej udhëheqësve botërorë, të cilët mbanin ligjërata në LSE.

Toleranca fetare e Dalai Lamës dhe ajo e shqiptarëve

Në dalje e takova Dalai Lamën. Në atë bisedë që zgjati pak minuta munda t'i flisja atij për tolerancën fetare që manifeston populli ynë.

20 qershor 2012

EDHE NOBELISTËT KANË TË METAT E TYRE

Takim me Aung San Suu Kyi - Nobelistja e Burmës në Westminster Hall

Prej disa kohësh, media e vendeve demokratike dhe veçanërisht ajo britanike, ka filluar të jetë shumë kritike ndaj Presidentes së Burmës, Aung San Suu Kyi. Ajo është mbajtëse e çmimit "Nobel për Paqe", të cilin e kishte pranuar në vitin 1990 për veprimtarinë e saj të palodhur kundër juntës ushtarake, e cila nuk e dorëzoi pushtetin, edhe pse kjo nobeliste i kishte fituar zgjedhjet e përgjithshme me 59 për qind të votave. Bota demokratike reagoi menjëherë dhe e vlerësoi atë shumë lart.

Por, ndryshe nga çfarë mendohet për këtë laurate, këto kohë kemi parë sesi rreth 750 mijë myslimanë të quajtur Rohingya nga ai vend i rrënuar, të dëbohen drejt Bangladeshit vetëm për shkak të besimit të tyre fetar. Edhe pse nobeliste e paqes, ajo nuk ndërmerr ndonjë veprim për ndërprerjen e këtij eksodi të çmendur dhe të pakuptimtë, duke e kompromentuar këtë çmim kaq të lartë.

Tek e shoh në televizion sesi ajo masë e madhe myslimanësh dëbohen pa mëshirë nga vendi i tyre në një vend tjetër thjesht për shkak të besimit, më lëkundet simpatia dhe respekti që pata krijuar për nobelisten e paqes së këtij vendi, Aung San Suu Kyi, atë ditë kur e takova në Hollin e Madh të Parlamentit Britanik. Në fakt, kjo më bën të mos besoj më as në shprehjen e saj:

"Paqja si qëllim është një ideal, i cili nuk duhet të kundërshtohet prej asnjë qeverie apo shteti qofshin ato edhe më luftaraket"…

… sado që i kisha besuar plotësisht thënies së saj:

"I vetmi burg është frika dhe e vetmja liri e vërtetë është liria nga frika".

Mëngjes i hershëm në Parlamentin britanik

Atë mëngjes të 21 qershorit 2012 u zgjova shumë më herët se zakonisht. Kisha marrë ftesë për një mëngjes të shtruar që në orën 7.00 me të gjitha të mirat, që mund të vihen në tavolinë në atë orë të hershme të ditës. Ishte diçka e jashtëzakonshme për dy arsye: e para, mëngjesi shtrohej në hollin kryesor të Parlamentit britanik, që përbënte një rast krejt të veçantë, pasi ai në fakt ngjante më shumë me një holl kishe të vjetër, sesa vend për ngrënie dhe, e dyta, se ishte hera e parë që britanikët nderonin në atë sallë një udhëheqëse të huaj të një vendi aq të vogël sa ishte vendi i kësaj zonje - Burma.

Holli i Parlamentit britanik, i njohur si Westminster Hall, është pjesa më e vjetër e Pallatit ku veprojnë Dhoma e Komunave dhe ajo e Lordëve, i ndërtuar në vitin 1097. Ai ka pësuar një zjarr në vitin 1834, i cili e kishte rrënuar pallatin origjinal. Në rrjedhë të historisë ai vend është përdorur për ceremoni shtetërore, ngjarje të rëndësishme dhe veprimtari me peshë kombëtare. Deri atëherë ndoshta ngjarja më e madhe e festuar aty ishte jubileu i gjashtëdhjetë i kurorëzimit të Mbretëreshës Elizabeth II apo, siç quhet, Jubileu i Diamantit.

Gjatë 900 vjetëve të ekzistencës së kësaj ndërtese madhështore, një gjë e tillë kishte ndodhur vetëm për disa nga burrështetasit më të mëdhenj të botës, siç janë Çarls de Gol, Nelson Mandela, Papa Benedikti XVI dhe Barack Obama. Aung San Suu Kyi do të ishte e para grua dhe i pari individ, që nuk ishte në krye të një shteti, kur do t'i bëhej një nderim i tillë, kaq i madh.

Në sallë ishin të ftuar dhe merrnin pjesë anëtarë të Familjes mbretërore, anëtarë të kabinetit qeveritar të Kryeministrit David Cameron, tërë ambasadorët dhe komisionerët e lartë nga e gjithë bota.

Kryetari i Parlamentit britanik, John Bercow, mbajti një fjalim mbresëlënës sa vërtet na bëri të besonim se ajo grua trupvogël, e përunjur, e natyrës gandiste, me imtësinë e saj, kishte sfiduar edhe forcat ushtarake dhe policore të një vendi prej nga ku, kurrë nuk kisha dëgjuar një lajm të mirë. Ai tha pak a shumë se

kjo ngjarje përbënte largim nga tradita angleze, por kjo nuk është bërë në mënyrë të paqëllimshme. Guximi i të ftuarës sonë është legjendar. Ajo iu ka bërë ballë me dinjitet të lartë vuajtjeve të paimagjinueshme, që i ka shkaktuar ndarja nga familja dhe njerëzit e saj, diçka që për ne është e vështirë, qoftë edhe ta mendojmë. Lidhjet e saj me Mbretërinë e Bashkuar janë intime për shkak të studimeve në Oxford. Ajo është simboli i rezistencës ndaj një regjimi, që do të ishte përjashtimor për nga barbaria edhe në një botë parahumane. Përdorimi i dhunës seksuale si armë lufte, ekzekutimet pa gjyq, zhvendosja e detyruar e popullsisë, puna e detyrueshme, rekrutimi i fëmijëve në ushtri, shkatërrimet e pasurive dhe ndihmave, përdorimi i minave, torturimi i kundërshtarëve në mënyra të patregueshme, shkatërrimi i fshatrave janë vetëm disa nga dukuritë e tmerrshme, që vijnë si lajme nga vendi i saj.

Prandaj kjo zonjë e nderuar gjendej atje, për rezistencën, që u ka bërë pikërisht veprimeve të tilla anti-njerëzore. Aung San Suu Kyi ishte një grua, që kishte sfiduar diktaturën me kaq shumë privacione të jetës së vet për dhjetëravjeçarë të tërë.

Burma - Erickson - Shqipëria

Ndërsa John Bercow po lexonte fjalimin, mua mendja më rrinte te njeriu, për atë për të cilin në atë kohë punoja për t'i nxjerrë në pah jetën dhe vuajtjet që kishte hequr në Burma, e më vonë edhe në Shqipëri. Ishte Charles Telford Erickson, jetën dhe veprën e të cilit po e studioja dhe po e përktheja për 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Në ato kërkime rreth tij kisha gjetur se në jetën e tij kishte një moment të lidhur pikërisht me vendin e Aung San Suu Kyi. Ai kishte qenë misionar i Kishës Protestante në Burmë në vitin 1887 - 1888. Pasi u vendos atje, e shoqja, Kerry, nuk mund ta duronte jetën e mjerueshme që ata bënin në Burmë. Ajo u prek edhe nga një sëmundje, e cila duhej kuruar seriozisht. Prandaj ata u detyruan të ktheheshin në Boston. Por, dhjetë vjet më vonë, atyre iu afrua një pozicion si pastor në një vend të 'çuditshëm', të quajtur Shqipëri, pjesë e Perandorisë Osmane, ku prej kohësh ungjillorët kishin hapur misionet e tyre, në Stamboll e Izmir, në drejtim të vendeve të "Rumelisë", në Azinë e Vogël, Siri etj.

Kerry, edhe kësaj here, nuk ndjehej sikur ia vlente të shkonin me mision në një vend të panjohur dhe të përsërisnin kalvarin e vuajtjeve, që kishin kaluar në Burmë. I shoqi, Telford, e bindi se nuk do të ishin aq keq sa në Burmë, pasi Shqipëria "*ishte vend evropian*" dhe aty gjërat do të ishin krejt ndryshe. Kështu ata, në vitin 1908, udhëtuan për në Shqipëri, u vendosën në fillim në Korçë, pas dy javësh në Tiranë dhe, më vonë, në Elbasan. Në fakt jeta e tyre në Shqipëri, represioni turk, pushtimi serb i vendit, kaosi dhe varfëria nuk ishin aspak më të mira, se ato që ata kishin parë dhe provuar në Burmë.

Aung San Suu Kyi ishte ballafaquar me represionin e vendit të saj në Burmë. Heroi im, Charles Telford Erickson, vuajti edhe më shumë se ajo, jo për vendin e tij, Amerikën e pasur e të lirë, por për Shqipërinë. Por atij, në vend të Çmimit "Nobel", iu mohua edhe emri deri në vitin 2012.

Aung San Suu Kyi ka marrë Çmimin "Nobel për Paqe", të cilin e mban edhe sot, pavarësisht nga fakti, që nuk mbron njerëz të pafajshëm në pozitat e zhdukjes fizike, ndërsa heroit të librit tim iu ndalua t'i përmendej emri nga diktatori Hoxha. U deshën vite punë, që vepra e tij të dilte në dritë dhe Shkollës Bujqësore të Kavajës, të cilën ai e themeloi në vitin 1925, t'i vendosej emri i Tij.

Londër, 21 qershor 2012

NË GJURMËT E FAMILJES ANGLEZE HERBERT - MIKE E SHQIPTARËVE

Në muret e sallës së madhe të Ambasadës Shqiptare në Londër, të cilën e emëruam "*Herbert & Durham*" varen portretet e këtyre dy anglezëve, që i kushtuan vendit tonë një pjesë të mirë të jetës së tyre. Përveç respektit ndaj këtyre dy figurave, ajo që e tërheq një përfaqësues diplomatik të Shqipërisë është njohja, vizita dhe shprehja e nderimit në vendet ku ata kanë jetuar, ku kanë vepruar dhe kanë lënë trashëgiminë e tyre. Ishte kjo arsyeja përse, gjatë viteve të shërbimit tim në Londër, vizitova shumë prej vendeve ku kanë jetuar njerëz, të cilët e kanë dashur Shqipërinë. Një prej tyre është vendi i lindjes dhe vendi i vdekjes i Kolonel Aubrey Herbert, diplomat, politikan dhe ish-anëtar i Parlamentit Britanik.

Kolonel Aubrey Herbert, miku më i madh i shqiptarëve

Ai njihet me emrin Aubrey Nigel Henry Molyneux Herbert dhe ka lindur më 3 prill 1880. Ishte djali i dytë i Henry Herbert, Early i Katërt Carnarvon dhe vëlla nga babai me George Herbert, Earli i Pestë Carnarvon (1866-1923). Ky i fundit është zbuluesi i Varrit të Tutankhamun-it, njërit prej faraonëve më të famshëm të Egjiptit. Aubrey pati lindur në një familje aristokrate. Pasi studioi në Eton dhe Oxford u emërua atashe në Tokio dhe në Konstandinopol. Ai udhëtoi shumë. Në Selanik u njoh me një shqiptar, të quajtur Kiazim Kokeli, prej të cilit mësoi dhe u dha shumë pas Shqipërisë.

Në vitin 1911 u zgjodh në Parlamentin britanik. Iu kushtua çështjes shqiptare dhe në vitet 1912 - 1913 udhëtoi nëpër Ballkan. Në momentin më

kritik të formimit të shtetit shqiptar, më 17 dhjetor 1912, ai themeloi "Komitetin Shqiptar në Londër", me qëllim që ta ndihmonte delegacionin tonë në bisedimet me Fuqitë e Mëdha dhe të tërhiqte vëmendjen rreth situatës së tmerrshme në të cilën gjendej Shqipëria. Ky Komitet u shndërrua në "Shoqërinë Anglo - Shqiptare" më 12 mars 1918 me Aubrey Herbertin, President, dhe më vonë në atë që njihet edhe sot me emrin "Shoqata Anglo - Shqiptare."

Në vitin 1913 ai takoi Edith Durham-in dhe, së bashku, u morën me shumë veprimtari në të mirë të shqiptarëve. Më pas, u miqësua me Isa Boletinin dhe, në njëfarë mënyre, Herbert-i u shpall hero i Shqipërisë. Emri i tij u përmend më së shumti si njeriu që do të merrte kurorën mbretërore shqiptare. Në Luftën e Parë Botërore ai ishte kolonel i Gardës Irlandeze dhe, në pjesën e fundit të qëndrimit në Ballkan, i kaloi tre muaj, qershor - korrik 1918, në Vlorë. Herbert-i ka meritën e madhe për ndihmesën që i dha delegacionit shqiptar si këshilltar në Konferencën e Paqes në Paris. Më pas, në vitin 1920, nëpërmjet miqve të tij të shquar anglezë, Lordit Robert Cecil, Balfour dhe historianit Fisher,M ndihmoi në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, si vendi nr. 42 i kësaj organizate. Ai e përjetësoi veprën e vet në librin *Ben Kendim* ndërsa stërmbesa e tij, Margaret Fitsherbert, e botoi biografinë e tij me titullin: *"Njeriu me pallto të gjelbër"*.

Vizitë në vendlindjen e Aubrey Herbert-it - Highclere Castle

Për të nderuar emrin dhe veprën e këtij njeriu, i cili luajti rol të rëndësishëm në historinë moderne të Shqipërisë, në fillim shkuam aty ku ai kishte lindur, në Highclere Castle. Ajo është shtëpi fshati e përdorur prej aristokratëve, të cilët kishin shtëpi në fshat dhe në qytet. Ajo është ndërtuar sipas stilit Jakobethan. Ky është një stil kombëtar arkitekturor i përzier i Rilindjes së ringjallur, që u bë shumë popullor nga fundi i viteve 1820, rrjedhojë e frymëzimit nga Rilindja Evropiane (1550 - 1625) dhe që mbart edhe elemente të ndërtimeve nga koha e Mbretëreshës Elizabeth dhe të Jakobinit të periudhës anglo-skoceze në kohën e mbretërimit të Xhejmsit VI të Skocisë, i cili trashëgoi kurorën e Anglisë në vitin 1603 si Xhejmsi i Parë. Jakobitinët vijnë pas Elizabetës dhe e përcjellin kurorën te Mbretëresha Karolinë. Kjo kështjellë mori formën e sotme për hir të arkitektit Carls Barry në shekullin e 19-të dhe ka qenë përherë shtëpia e Lordit

Carnarvon, degë e familjes Anglo - Wellse të Herbertëve.

Vizita te Highclere Castle kishte rëndësi shumë të veçantë për ne. Aty Kontesha Elizabeth Herbert kishte lindur të birin, Aubrey Herbert. Po aty kishte kaluar jetë edhe e shoqja e Herbertit, Mary. Pra, aty kishin jetuar breza anglezësh që, në një mënyrë ose në një tjetër, kishin lidhje me Shqipërinë.

Kontesha Elizabeth Dowager Herbert, nëna e Aubrey Herbert (1856 - 1929)

Elizabeth Catherine (Elsie) Herbert, mbiemri i vajzërisë Howard, ishte Kontesha e Katërt Carnarvon, lindur në Cumberland në vitin 1856. Titulli "Konteshë" ishte nivel shumë i lartë aristokratik. Ajo u martua me Earlin e Katërt Carnarvon, babain e Aubrey Herbertit, në vitin 1878. Më vonë ata e lanë Kështjellën Highclere dhe u vendosën në një shtëpi madhështore në Pixton Park, aty ku Aubrey do të ndërronte jetë më 23 shtator të vitit 1923, duke i thënë nënës së tij fjalët e fundit:

"Po të lë amanet Shqipërinë"…

Themeluese e Komitetit të Ndihmave Britaniko - Shqiptare kundër malarjes

Kontesha Carnarvon iu kushtua me gjithë shpirt ndihmave për vendin tonë, duke themeluar "Komitetin e Ndihmave Britaniko - Shqiptare". Me këtë përkushtim ajo ndërmori veprimtari ndihmuese për Shqipërinë me shpenzimet e veta. Në mënyrë të veçantë u përqendrua në luftën kundër malarjes. Në dimrin e vitit 1923 vizitoi Shqipërinë dhe themeloi në Vlorë një mision shëndetësor kundër malarjes, duke ngritur aty dhe një klinikë mjekësore. Në vitin 1927 udhëtoi për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku i vëllai i saj, Sir Esme Howard (1863 - 1939) mbante detyrën e Ambasadorit Britanik. Aty siguroi mbështetjen financiare të "Fondacionit Rockefeller" për organizatën e saj të ndihmave dhe luftën kundër malarjes në Shqipëri. Një vend të veçantë i kushtoi

ndihmës për shqiptarët e dëbuar nga Kosova. Në Kavajë ajo themeloi një fshat të quajtur nga vendasit Stan, i cili mori emrin "Fshati Herbert", për nder të të birit. Fshati e mbajti atë emër deri në vitin 1939. Veç kësaj ajo financoi hapjen e Bibliotekës së Parë Publike në Shqipëri, "Librarinë Herbert", e cila më vonë u njoh me emrin "Instituti Herbert". Fondi i librave të kësaj biblioteke u bë bërthama e Bibliotekës sonë Kombëtare të ardhshme, në Tiranë. Biblioteka u ndërtua në tetorin e vitit 1927 në një tokë të blerë në Rrugën e Shën Gjergjit dhe u përurua pas vdekjes së saj më 12 maj 1929. Gjatë viteve të komunizmit biblioteka u shndërrua në Kinemanë "Ali Demi". Më 14 shkurt 1929 gazeta "Laboremus" njoftonte për vdekjen e saj në faqen e parë me titullin:

Ndërroi jetë "Nëna e Popullit Shqiptar"

"Nëna e Popullit Shqiptar", Kontesha Carnarvon, - thoshte gazeta "Laboremus", - u nda nga jeta më 2 shkurt 1929. Kjo ka qenë humbje shumë e madhe për tërë popullin tonë. I biri, Koloneli Aubrey Herbert, para se të vdiste, i pat lënë amanet nënës ta donte dhe ta ndihmonte Shqipërinë, siç kishte bërë edhe ai vetë. Pas kësaj ajo i kushtoi Shqipërisë dashurinë, që i kishte lënë i biri".

Kontesha Elizabeth Carnarvon ishte zonjë aristokrate dhe një prej anglezeve më të dashura për Shqipërinë. Për të pasur një ide se nga çfarë klase e lartë angleze vinte ajo, mjafton të kërkohet në internet për Highclere Castle, ku është përjetësuar emri i saj dhe i asaj familjeje të madhe. Emri i saj është i skalitur me shkronja të arta në listën e zonjave angleze, si: Mary Herbert, Miss Edith Durham, Margaret Hasluck, Ruth Pennington, Mary Adelaide Walker, Theodora Benson, Agnes Ethel Conway, Georgina Muir Mackenzie, Adelina Irby etj. Po aq ajo kujtohet prej shqiptarëve edhe sot, si "Zonja e Inglizit". Ndërroi jetë në Portofino, Itali. Veprën dhe punën e saj e vazhdoi, edhe për disa kohë, e reja e saj, zonja e Aubrey Herbert-it, Mary Herbert.

Zbuluesi i Faraonit Tutankhamun, Earl i 5-të Carnarvon - vëllai i Aubrey Herbert

Vëllai nga babai i Aubrey Herbertit, Lordi George Herbert Carnarvon, bashkë me Howard Carter-in, zbuluan shumë gjëra me vlera të antikitetit egjiptian. Ata, pas 16 vjetësh kërkime të pareshtura, u bënë të famshëm kur zbuluan Varrin e Faraonit të egjiptianit Tutankhamun, në vitin 1922. Ai krijoi njërin prej koleksioneve më të jashtëzakonshme me vepra të spikatura arti egjiptian, në botë. Pas vdekjes së tij, në vitin 1923, e cila, sipas një legjende, erdhi për shkak të mallkimit të faraonit, ai koleksion u shit nga e veja e tij në Muzeun Metropolitan të Artit në New York, për të përballuar shpenzimet e funeralit të tij. Howard Carter i kishte kataloguar reliket e sjella nga Egjipti dhe kishte thënë se aty gjendeshin disa artikuj të parëndësishëm. Ata kishin mbetur nëpër disa rafte deri sa u rizbuluan nga familja në vitin 1987. Muzeu britanik dhe ai i Newbury-it i kanë huazuar këto sende të çmuara. Kështu koleksioni i familjes Carnarvon në Hicklere Castle, me vepra antike egjiptiane, të jetë plot e përplot me to.

Salla e antikiteteve e kësaj shtëpie është e mbushur me aq shumë sende sa vizitorët të mund të vëzhgojnë stoli, relike, figurina dhe vepra arti, si dhe arkivolin e një gruaje fisnike egjiptiane, e cila ka jetuar rreth 3.500 vjet më parë. Kështjellën dhe atë koleksion e vizitojnë me qindra e mijëra njerëz çdo vit.

Kur e vizituam ne, Lady Carnarvon ishte Fiona - Kontesha e Tetë Carnarvon, që vazhdonte trashëgiminë aristokratike të Earl-ve, e shoqja e George Reginald Oliver Molyneux Herbert-it, Earli i 8-të Carnarvon (i lindur më 10 nëntor 1956). Për të ditur më shumë duhet thënë se Earli është pozitë fisnike, që gjendet mbi atë të të Viskontit dhe poshtë asaj të Markezit. Gruaja e Earlit është Kontesha e radhës dhe i drejtohen me titullin "Lady Carnarvon". Kur e vizituam kështjellën, ajo kishte shkruar librin: "Lady Almina, Downton Abbey i vërtetë: Humbja e trashëgimisë së Kështjellës Highclere".

Pixton Park - Shtëpia, ku ndërroi jetë Aubrey Herbert

Pixton Park, është shtëpi fshati në Dulverton, në Somerset të Anglisë. Ajo shtëpi është e lidhur me të paktën dy familje të rëndësishme historike për Anglinë dhe, po ashtu, më tre persona shumë të rëndësishëm për Shqipërinë. E para

është familja Akland, një prej më të pasurave mbi tokën e Westcountry-it dhe familjen Herbert, politikanë dhe diplomatë të shquar anglezë.

Njëjtë si Hicklere Castle, edhe shtëpia Pixton Park, për ne diplomatët shqiptarë kishte rëndësi shumë të madhe, pasi aty kishte ndërruar jetë, miku i madh i popullit tonë, Koloneli Aubrey Herbert, si dhe kishte jetuar e ëma, Elizabeth, njëherë e njëkohë Kontesha Carnarvon dhe e shoqja Mary.

Me Bejtullah Destanin - vizitë te Mery Melotte, mbesa e Aubrey Herbert-it

Më 12 gusht 2012, bashkë me diplomatin, studiuesin dhe historianin e shquar nga Kosova, z. Bejtullah Destani, shkuam të vizitojmë mbesën e Aubrey Herbertit, zonjën Melotte, në Somerset. Ajo na priti me shumë gëzim. Folëm për Aubrey Herbert-in, gjyshin e saj. Na shtroi drekë në shtëpinë e saj, të thjeshtë dhe të shijshme me shumë të gjelbërta. Pastaj shkuam në Bibliotekën e Somersetit, një bibliotekë vendore, që në Shqipëri do ta kishte zili çdo qytet. U ulëm dhe nxorëm një seri dokumentesh që ajo na i kishte bërë gati. Ato ishin shumë të rëndësishme për historinë e vendit tonë. Një prej tyre vërtetonte plotësisht atë që Charles Telford Erickson e kishte përshkruar në doreshkrimet e tij të lëna në Universitetin Yale, në Hartford, Kenektikat, SHBA, ku thotë se në emër të qeverisë shqiptare, në gushtin e vitit 1923, ai bashkë me Mehmet Konicën, në atë kohë Ministri Shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar, i kishin ofruar kurorën e Mbretërisë së Shqipërisë, Kolenelit Aubrey Herbert.

Ishte koha kur punoja për të përmbyllur librin "Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë" dhe ato që gjetëm në atë bibliotekë ishte sikur të gjeje një copë floriri në një vend të largët. Ja çfarë përmbante dokumenti, të cilin e kishte shkruar dhe nënshkruar me dorën e vet në një letër me bojë kopjativi, Charles Telford Erickson:

Mehmet Konica dhe Erickson i ofrojnë Kurorën Mbretërore shqiptare Kolonelit Aubrey Herbert

Charles Telford Erickson e përshkruan me ngjyra dramatike dhe fund tragjik njeriun, i cili i kishte kushtuar një pjesë të mirë të jetës së vet, Shqipërisë, anglezi Aubrey Herbert.

Këtu është një përshkrim i atij diskutimi:

"Në një ndër mbrëmjet, ku mblidheshin njerëzit e shqetësuar të asaj kohe për të ardhmen e Shqipërisë, gjatë diskutimeve u përfshimë në një diskutim, i cili kishte të bënte pikërisht me formën e qeverisjes në Shqipëri. A do të kthehej ajo në monarki? Kush do të ishte monarku?"

"Kjo qeveri e përkohshme, nuk e përligj veprimtarinë e saj. Skema e vetëqeverisjes duket se nuk funksionon. Të gjithë diskutuan mbi të mirat dhe të këqijat e një republike sipas modeleve zvicerane dhe amerikane, me përparësitë që do të kishte, nisur nga fakti se njerëzit ishin mësuar që prej kohëve të lashta të zgjidhnin prijësit e vet, parinë, bajraktarët, pleqtë e fshatrave dhe të komunave, të cilët vepronin si trupa qeveritare. Pastaj iu shkrepi ideja e mbretërisë dhe i bëri të zbraznin tërë mendimet që kishin."

- A duhej të ishte Monarki Kushtetuese? Sigurisht.

- A duhej të ishte "Ai" një i huaj?

Kjo shkaktoi menjëherë reagimin e të gjithëve, duke kujtuar fatin e Princ Widi - t. Disa thanë se atij nuk iu dha asnjëherë një mundësi dhe kombi e kishte detyrë nderi që t'i jepte atij rast tjetër nëse një mbret do ta sundonte këtë vend ndonjëherë. Ahmet Zogu iu bashkua bisedës po aq energjikisht sa edhe të tjerët dhe unë jam i sigurt se ideja e tij për t'u bërë ndonjëherë mbret i Shqipërisë, as që i kishte shkuar ndër mend deri në atë kohë. Dhe më pas, krejt aty për aty, ndërhyra:

- Pse të mos të zgjidhni një mbret britanik?". Kjo filloi të nxiste fantazinë e bisedës.

- Përse propozoni një britanik? - tha dikush.

Për të mbrojtur propozimin tim, u përgjigja duke i përmbledhur mendimet dhe duke vijuar bisedën, pasi në të vërtetë nuk kisha menduar për këtë gjë ndonjëherë më parë. Një mbret britanik mund të jetë pengesë ndaj veprimtarisë italiane, prej së cilës të gjithë duhet të frikësohemi. Ai do të ishte në gjendje të siguronte kreditë e domosdoshme me të cilat të fillonte dhe të zhvillohej industria e vendit, e cila ka mbetur krejt në vend. Britania e Madhe nuk do të

kishte interesa egoiste, siç është kolonizimi, diçka që e dimë se e ka Italia apo lakmi për futjen e vendit brenda suazave të perandorisë, gjë e cila e dimë se është në mendjen e Italisë. Ideja u kap menjëherë.

- Nuk besoj se mund të marrim Princin e Wells-it ose ndonjë tjetër prej bijve të Xhorxhit, por midis aristokracisë së tyre, dikë që të jetë më i përshtatshëm".

A keni dikë në mendje?"

Për të mos u treguar tërësisht jashtë loje u përgjigja:

- Po, kam".

- Kush është ai?-më pyetën menjëherë.

- Kolonel Aubrey Herbert, iu thashë.

- A mendoni se ai do ta konsiderojë këtë?

Iu përgjigja se mendoja që ai do ta konsideronte atë shumë seriozisht përpara se ta hidhte poshtë. Kjo ndodhi pikërisht kur unë sapo e kisha marrë kontratën time për Kolegjin Shqiptaro-Amerikan të Bujqësisë, i dekretuar si ligj prej parlamentit dhe nënshkruar e vulosur prej Kryetarit të Kuvendit dhe Regjentëve. Ato ditë po planifikoja të ikja për në Shtetet e Bashkuara për të filluar fushatën në emër të tyre.

Kështu ata më thanë:

- Mirë atëherë, shko nëpërmjet Londrës dhe paraqitja ofertën dhe shihe se çfarë do të thotë. Por ta hamendësojmë se e pranon, çfarë do të bëjmë pastaj?

Kësaj Ahmet Zogu iu përgjigj:

- Do të kujdesem unë për këtë. Si drejtues i ushtrisë, do t'i dërgoj trupat e mia nga Mati në Durrës për manovra sapo ai të arrijë. Ne do ta marrim nga anija e tij, ta sjellim këtu me nxitim, ku çdo gjë do të jetë gati dhe ai do të kurorëzohet si Mbret i Shqipërisë përpara se bota ta marrë vesh se mbreti po e merrte atë detyrë.

- Por a do të rrinin duarkryq përkrahësit e Princ Vidit pa bërë trazira, pasi ata ishin në numër të madh nëpër tërë vendin, përfshirë edhe Aqif Pashën e Elbasanit?

- Unë do të kujdesem për këtë, ishte përgjigjja e tij e menjëhershme.

Kështu u vendos aty për aty sikundër e tregova.

Për ta plotësuar këtë histori: Shkova në Londër, në Westminster, aty ku

parlamenti ishte në seancë punimesh dhe ku kandidati ynë për nbret ishte anëtar i tij. I dërgova letrën dhe e prita tek lobi. Pas disa minutash ai erdhi, më pa, qeshi me gjithë shpirt, sepse ishte mik i vjetër dhe shumë i dashur i imi dhe lëshoi një si pasthirrmë:

"Tungjatjeta, Erik, çfarë të paska sjellë në Londër?!"

Me tërë frymën i thashë se kisha ardhur për t'i paraqitur një ofertë për mbretërimin e Shqipërisë.

"Çfarë është kjo që më thua?"…

Unë ia përsërita deklaratën time, duke i shtuar se isha autorizuar prej Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë për t'i ofruar atij kurorën.

"O Zot i madh, më duhet të pi diçka! Eja me mua!"

Kështu, ai më mori te bari i katit të nëndheshëm, ku e diskutuam çështjen qetësisht për një orë ose më shumë, me whisky-n dhe pijet e buta përpara nesh. I tregova për tërë çfarë kishte ndodhur dhe besimin tim të thellë se ai ishte ndoshta njeriu i vetëm, që mund ta shpëtonte Shqipërinë nga një fiasko tjetër dhe nga rënia e saj përfundimtare në duart e Italisë. Ai ishte thellësisht i emocionuar. Zakonisht ai i merrte edhe gjërat më serioze në mënyrë thuajse gazmore. Përshtypjet e tij nga përvojat e tri luftërave: Francë, Galillopus dhe "Mesopot" mbushnin vëllime nga më magjepsëset të shkruara për Luftën Botërore. Këtë herë nuk kishte fshehje emocionesh. Pasi ia paraqita këtë çështje nga Shqipëria, ai qëndroi për disa minuta në heshtje, u përpi gati si i shushatur dhe i pazoti për t'u përgjigjur. Pastaj ngriti kokën dhe më pa, gati si gjuetar, drejt e në sy, dhe m'u përgjigj:

"Mirë atëherë, nuk dua të them jo. Le të shkojmë në shtëpi dhe të shohim çfarë do të thotë bashkëshortja ime".

Ditën tjetër, bashkë me Mehmet Konicën, ministrin shqiptar në Britaninë e Madhe, shkuam në shtëpinë e tij në fshat, në Pixton Park. Atje, për dy ditë të tëra, u diskutua kjo çështje me tërë të mirat e të këqijat e veta, pa ndërprerë, nga fillimi në fund, parë nga çdo aspekt i mundshëm.

Kjo nuk duhej të ishte çështje që mund të trajtohej pa kujdes. Nuk ishte punë ambicieje, as një aventurë gazmore për mbretërim. Pastaj, mbrëmjen e ditës së tretë, ai më thirri veçmas në studion e tij, për të më kumtuar vendimin përfundimtar. Ai më drejtoj tek një karrige, por unë i kërkova leje të qëndroja në këmbë. Isha aq i shtrënguar dhe i tensionuar, sa nuk mund qëndroja ulur.

"Mirë atëherë, unë kam vendosur ta pranoj ofertën", tha ai, por kur vrapova që t'i merrja dorën, më ndaloi me një lëvizje dhe shtoi:

"Ekziston një pengesë e madhe në këtë rrugë, Erik. Unë nuk jam mirë me shëndet. Më duhet të bëj një operacion shumë të rëndë, për të cilin kirurgu e parashikon shpëtimin pesëdhjetë me pesëdhjetë për qind. E kam shtyrë tepër gjatë, por do ta bëj pa vonesë. Nuk di askush në botë për këtë, përveç gruas dhe familjes sime, kështu të lutem, mbaje për vete, derisa të jetë mbyllur kjo çështje. Unë shpresoj për më të mirën dhe, nëse mund t'ia hedh, do t'i jap Shqipërisë gjithçka në fuqinë time për ta ndërtuar si shtet të fuqishëm që mban vetveten".

Ai më tha edhe shumë gjëra të tjera, por kjo mjafton për ta treguar këtë histori. Mora rrugën për në Shtetet e Bashkuara dhe, disa ditë pasi arrita atje, mora një kabllogram, i cili i lëshoi tërë shpresat tona për tokë.

"Mbreti" ynë kishte vdekur në operacion përpara se t'i vinte koha që ndonjëherë të bënte betimin.

Ky mbret do të ishte Aubrey Herbert".

Në shtëpinë ku ndërroi jetë Koloneli Aubrey Herbert në Pixton Park

Pas asaj dreke të këndshme dhe "hulumtimit" të dokumenteve në arkivin e Bibliotekës së Somersetit, të cilat i fotografova me shumë kujdes, shkuam drejt e në shtëpinë e Herbertëve. Pronari i shtëpisë ishte financier londinez në pension, Timothy F. Bell, me të shoqen, Beatriçen. Ai na priti me kënaqësi dhe na lejoi madje edhe të futeshim brenda shtëpisë. I shpjeguam arsyen pse kishim shkuar dhe na lejoi të bënim fotografi. Në hollin e katit përdhes gjendeshin disa karrige të mëdha të thurura prej kashte. U ula aty. Ndoshta ishte moment emocional nga ato që njeriu rrallëherë i përjeton. Vura duart mbi tavolinë dhe në imagjinatën time krijova atë skenë kur një anglez, Aubrey Herbert, një amerikan, Charles Telford Erickson dhe një atdhetar shqiptar, diplomati Mehmet Konica, të tre njerëz të dashuruar me Shqipërinë e vobektë, ishin ulur rreth asaj tryeze dhe bisedonin për të ardhmen e vendit tonë, për një Mbret Anglez. Ishte nga momentet me më shumë efekt në jetën e njeriut, ku simpatia, respekti dhe adhurimi për ata njerëz mund të impononte dashuri edhe dhimbje

shpirtërore, njëkohësisht.

Ishte ditë e rrallë e jetës. Asnjë muze në botë nuk mund ta japë atë efekt në shpirt.

Kolonel Edward Melotte hyn në Kosovë më 12 qershor 1999

Historia përsëritet dhe tradita nuk harrohet nga njerëzit në përgjithësi, por nga ata fisnikë edhe më në veçanti. Stërnipi i Kolonel Aubrey Herbert, Koloneli Edward Melotte, ishte ushtarak, i cili ndiqte traditën e familjes së vet angleze, me lidhje të forta me ushtrinë. Atdhetarë të njohur, ata në çdo kohë i kishin bërë shërbime vendit të tyre. Por shërbimi i këtij stërnipi të Aubrey Herbertit, për ne shqiptarët kishte rëndësi shumë më të madhe: Ai ishte koloneli që i priu kolonës ushtarake britanike, nën flamurin e NATO-s, më 12 qershor 1999, kur këto trupa hynë triumfalisht në Kosovë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Vërmicë - Qafë Morinë. Koloneli Melotte, sapo kaloi kufirin në tankun e tij, hapi kapakun e tankistit, dhe thërriti me të madhe:

- Hapuni! Unë jam Kolonel Melotte dhe kam në trup gjak të gjyshit tim, Abrey Herbert, mikut më të madh të popullit shqiptar!

Djali i Merit, dhe stërnipi i Herbert-it, më vonë shërbeu në shumë misione ushtarake britanike dhe, më e rëndësishmja për ne, ai shërbeu si atashe ushtarak britanik në Tiranë, në vitet 2016 - 2019. Madje, edhe djalit të vet i ka vënë emrin Aubrey, në kujtim të stërgjyshit të tij.

Miqtë e mëdhenj nuk reshtën kurrë të gjenden pranë nesh, shqiptarëve.

Herbert-ët qenë ndër më të rëndësishmit midis tyre.

Nderim të përjetshëm!

12 gusht 2012

WESTMINSTER ABBEY UNDERCROFT - SHËNOHET DITA E SHËN NËNË TEREZËS

Në ditën e Nënë Terezës, Lordi Alan Watson, një nga burrat më autoritarë të Dhomës së Lordëve Anglezë, dëshiroi të organizonte një veprimtari në bodrumin e Abacisë Westminster. Bëmë shumë përgatitje. Nga Tirana ftuam Presidenten e Fondacionit "Nënë Tereza", zonjën Liri Berisha. Sponsor i aktivitetit të Lordit Watson u bë British Petroleum, nëpërmjet të Drejtorit Ekzekutiv për Evropën, z. Peter Mather, ndërsa dekani i Abacisë, fort i nderuari, John Hall, na vuri në dispozicion gjithçka që duhej për ta realizuar me sukses atë veprimtari. Atë mbrëmje nderimi për Shenjtoren Nënë Tereza më erdhën në mendje shumë kujtime që lidheshin me emrin e Saj.

1985 - Krujë: Dëgjova për herë të parë për Nënë Terezën

Për Nënë Terezën dëgjova për herë të parë, pak vite përpara se të rrëzohej komunizmi. I pari që më tregoi për të ishte historiani i njohur krutan, Haxhi Goci, mësues iluminist, ligjërues i mrekullueshëm dhe njohës i shkëlqyer i historisë. Me profesor "Xhiun" siç e thërrisnim, më lidhte një miqësi e jashtëzakonshme. Ai ishte njeri i ditur, bujar dhe shumë i dashur.

Njëherë, në Krujë, pasi mbaruam një mbledhje më ftoi për drekë në shtëpinë e tij. E shoqja, Nadirja, zonjë dhe amvisë e pashoqe, na priti me tërë bujarinë që e karakterizon një familje krutane. Ata të dy, zonja dhe i zoti i shtëpisë, kishin komunikim mjaft të këndshëm me njëri-tjetrin. Në një dialog me shumë humor, profesori iu drejtua së shoqes:

"Hajde Nadire, na shtro tavolinën se ti i bon gjonat ma mirë se asnjë, madje ia kalon edhe Nënë Terezës!"

"Qyqja Xhio, amon mos e përmend atë grue se do na marrësh m'qafë kalamojat. Amon mos e përmend at'gru t'Zotit!", - ia ktheu ajo.

"Nadire t'kam thanë, Nënë Tereza asht shqiptare edhe ka për të ardhë dita që kanë me e njoftë edhe shqiptarët, se atë e njeh edhe e respekton e gjithë bota. U bomë ne!"- ia ktheu profesori asaj.

Ishte hera e parë që e dëgjoja një emër të tillë dhe në fakt nuk po kuptoja se për kë bëhej fjalë.

Dreka u shtrua, Xhiu siç e kishte zakon filloi të thoshte:

"Vrej, mos thuaj se nuk t'i kom vu gjithë k'to asortimente përpara! Se kshtu bon kjo Nënë Tereza ime!

Profesori filloi të numëronte të gjitha gjërat që kishim përpara në tavolinë dhe ne që të dy qeshnim e qeshnim! Dreka ishte shumë e shijshme falë bujarisë së atyre njerëzve të mrekullueshëm. Por Xhiu çdo gjë e lidhte shumë bukur me situatën dhe më tha:

"Dije se ne kot nuk e kemi marrë certifikatën e popullit që ushqehet ma mirë në botë. E kemi meritue. Bota janë duke vdekë për bukë!"

Pastaj ia dha një të qeshure cinike.

E pashë me adhurim të jashtëzakonshëm atë mënyrë komunikimi të atyre dy njerëzve. Me të mbaruar drekën profesori më tha:

"Due më të thanë diçka që ndoshta nuk e di. Është një grue e vogël shqiptare po shumë e famshme, Gonxhe Bojaxhiu e ka pasë emrin. Unë i thërras Nadires, Nënë Tereza se është edhe kjo bamirëse" e përfundoi frazën duke qeshur me të madhe.

Pastaj më shpjegoi shumë gjëra për të dhe vijoi:

"Po këta nuk e duan", dhe bëri me dorë nga komiteti, "se është katolike edhe se e duan shumë amerikanët. Ajo ka marrë çmimin "Nobel për Paqë" dhe dekoratat më të larta të shtetit amerikan. Edhe Presidenti Regan e dekoroi, po nuk tha se është shqiptare, po se ka lindë në Jugosllavi. Kaq keq e kanë ngatërru këta që e mohojnë sa edhe Presidenti i Amerikës, në fjalën e tij gaboi keqas kur tha se ajo është nga Jugosllavia, kur kësaj të fundit i duheshin edhe tetë vite që të vinte në jetë, që nga koha kur kish lindur ajo. Në të vërtetë, vazhdoi profesori, ajo ka lindur në Shkup, në një familje shqiptare me babë e me nanë nga Prizreni. Ndoshta do të vijë dita ta njohim edhe ne bijën tonë ashtu siç e njeh tërë bota!"…

Kjo ishte hera e parë që dëgjoja për Nënë Terezën.

1986 - Tiranë: Rrëfime për Nënë Terezën nga artisti Fatos Zajmi

Njohja ime me Nënë Terezën u shtua edhe kur Fatos Zajmi, valltar i famshëm i Ansamblit të Shtetit në Tiranë, më tregoi një histori për nënën dhe motrën e Nënë Terezës. Familja Zajmi ishte nga Kosova. Unë nuk i dija rrethanat dhe lidhjet e asaj familjeje me njerëzit e Nënë Terezës në Shqipëri, por di që, kur Fatosi vinte te shtëpia ime në Mamurras, më fliste për to, si murgesha apo njerëz të veçuar, të vetmuar dhe përçmuar, që kishin jetuar në shtëpinë e Avni Zajmit. Shtëpia ishte pranë Kishës Katolike në Tiranë. Aty qëndruan nëna e Shën Terezës, Drandja dhe motra e saj Agia. Vëllai, Lazri, kishte ikur në Itali. Më vonë, ato ndërruan vend dhe vdiqën në vetmi dhe mjerim njëra pas tjetrës në vitin 1972, Drandja dhe më pas Agia më 1973. Fatosi tregonte sesi ato dy zonja e bënin jetesën me thonjtë e tyre, duke bërë punë dore. Natyrisht me një vëlla si Lazri, ish-oficer i ushtrisë shqiptare të kohës së mbretërisë, me vajzën dhe motrën Gonxhen në urdhrin e saj katolik në Kalkuta, nuk kishte asnjë mundësi të trajtoheshin ndryshe.

1992 - Tiranë: Meshë në Kishën Katolike te rruga e Kavajës, me praninë e vetë Nënë Terezës

Vitet kaluan dhe në vitin 1992, pata rastin ta shoh me sytë e mi Nënë Terezën, në Kishën Katolike, te Rruga e Kavajës. Aty në prani të Presidentit të Republikës, dr. Sali Berisha, ajo mbajti një meshë. Ashtu e butë, e vogël, e urtë, iu drejtua asaj grigje me aq dashuri dhe sikur asgjë e keqe nuk kishte ndodhur në jetën e saj. Deviza e saj, se prej gjaku jam shqiptare, me shtetësi indiane, prej feje katolike, i takoj botës, prej zemre i takoj krejtësisht zemrës së Krishtit, u pa edhe atë natë në atë proçesion fetar.

5 shtator 1997 - Stamboll: Homazhe për Nënë Terezën

Më 5 shtator 1997 ndërroi jetë Nënë Tereza. Në atë kohë shërbeja si Konsull i

Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Stamboll. Konsullata jonë, organizoi homazhe në nderim të Nënë Terezës. duke hapur Librin e Ngushëllimeve. Ato ditë pritëm e përcollëm shumë miq të Shqipërisë nga shumë konsullata. Po ashtu shkëmbyem ngushëllimet e ndërsjella me njëri-tjetrin dhe me Kryekonsullin e Indisë së asaj kohe në Stamboll, z Harish Dogra.

1999 – New Jersey SHBA: Telefonatë rastësore që më gëzoi me Nënë Terezën

Isha në apartamentin tim në New Jersey të SHBA-vë, atë ditë janari të vitit 1999. Më duhej të komunikoja me një kompani telefonash për të kërkuar sesi mund të lidhja një shërbim tjetër online. Në anën tjetër të linjës u përgjigj një zë gruaje. Ajo ishte shumë e sjellshme dhe më sqaroi për çdo gjë që e pyeta. Kur mbaruam, ajo, duke më kërkuar ndjesë, më pyeti se nga isha unë? Mendova se e kishte kuptuar nga theksi që nuk isha amerikan.

"Nga Shqipëria", iu përgjigja.

Ajo reagoi menjëherë dhe më tha:

"O Zot i Madh! Të jem kaq me fat unë sot?"

"Po përse", i thashë, "çfarë të bëri të ndjehesh kaq me fat?"

"E parandjeva se ju jeni nga ai vend, nga mbiemri, prandaj të pyeta. Tani që u binda, e ndiej se unë jam me shumë fat."

Po si ka mundësi? e pyeta."

"Sepse, ju keni gjak në damarët tuaj nga gjaku i idhullit më të madh të jetës sime: Nënë Terezës."

Kthim në Westminster Abbey, Londër

Me zonjën Liri Berisha dhe shumë miq të ambasadës, më së shumti britanikë por edhe shqiptarë, e mbyllëm atë mbrëmje në bodrumin e Katedrales. Lordi Watson mbajti një fjalim, që do të mbahet mend gjatë për Nënë Terezën, si dhe për popullin shqiptar. Po ashtu z. Peter Mather, drejtori ekzekutiv i kompanisë "British Petroleum" ishte i pranishëm dhe sponsor kryesor i kësaj veprimtarie.

Londër, nëntor 2012

HISTORIA E VENDOSJES SË BUSTIT TË SKËNDERBEUT NË LONDËR

Objektivi më i rëndësishëm, që i kisha vënë vetes për detyrë, në vitin e përvjetorit të njëqindtë të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ishte vendosja në Londër e një busti të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeg. Ishte kjo një ëndërr e kahershme e shqiptarëve në ishullin britanik.

Biseda me Kryeministrin dhe Ministrin e Kulturës për vendosjen e bustit në Londër

Para se të merresha me procedurat e vendosjes së bustit në Londër, e bisedova çështjen me Kryeministrin Shqiptar, dr. Sali Berisha. I thashë se i kisha vënë objektiv vetes që të vendosnim bustin e Skënderbeut në Londër, gjë të cilën e mirëpriti dhe u angazhua ta mbështeste me çdo mundësi që kishte shteti shqiptar. Nuk vonoi shumë dhe Londrën e vizitoi në një Forum Ekonomiko - Kulturor të organizuar nga International Business and Diplomatic Exhange (IBDE) ministri i atëhershëm i kulturës. Biseda për vendosjen e bustit të Skënderbeut ishte ajo që na mori më shumë kohë gjatë një dite kur pinim kafe ngjitur me Katedralen e Shën Palit. Kuptohet që Ministri i Kulturës ishte plotësisht i interesuar, sado që vura re nota skepticizmi për shkak të vështirësisë së madhe, që paraqiste një sipërmarrje e tillë në çdo aspekt. Por edhe ai ishte shumë pozitiv dhe më premtoi ndihmën e tij për realizimin e një projekti të tillë.

Retrospektivë - Përpjekjet e mëparshme për vendosjen e bustit të Skënderbeut në Londër

Në morinë e gjërave, që mora në dorëzim në zyrën e Ambasadorit shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar, ishte edhe një dosje ku pasqyroheshin përpjekjet e bëra deri atëherë për vendosjen e një përmendoreje të Skënderbeut. Ishte një letërkëmbim midis Ambasadorit shqiptar, paraardhësi im i viteve '90, zotit Pavli Qesku, me një atdhetar shqiptar, i cili i kishte kushtuar aq shumë punë, mundime dhe përpjekje një misioni të tillë. Fjala është për z. Astrit Leka, i cili ka arritur të vendosë bustin e Skënderbeut në Gjenevë. Ai kishte shkëmbyer letra edhe me zyrën e Kryeministrit Tony Blair, por pa arritur që t'i bindte autoritetet londineze, që një bust të tillë ta vendosnin në atë qytet të mrekullueshëm.

Westminster Council - Londër

Një ditë prilli të vitit 2012, bashkë me sekretaren e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, dr. Xhoana Papakostandini, u ngjitëm me ashensor në katin e 14-të, të zyrave të Këshillit Bashkiak të Westminster-it, që është bashkia qendrore e Londrës. Ky organ i pushtetit vendor administron qendrën e qytetit, ku janë të vendosura institucionet kryesore të vendit - mbretëria, parlamenti, qeveria dhe të gjitha ambasadat e huaja.

Sekretari i Kryebashkiakes së Qytetit, zonjës Susan Burbridge, na priti me shumë ngrohtësi dhe mirësjellje. Ai madje na bëri një kalim pamor rretherreth atij kati të lartë aq sa pamë e soditëm shumë prej mrekullive të këtij qyteti magjik. Me shpjegimet e tij na kënaqi shumë, sadoqë ne mezi prisnim ta takonim kryetaren e nderuar. Që andej, në të gjitha anët e atij salloni të gjerë, shiheshin pjesë të ndryshme fantastike të Londrës. Pamja e parë ishte ajo e Pallatit Mbretëror Buckingham, Kulla e Orës së Madhe, e njohur me emrin Big Ben, Parlamenti Britanik, Abacia Westminster, Foreign Office, më tej Lumi Tames dhe "Syri i Londrës". Më larg, po në atë drejtim shfaqeshin ndërtesat prej xhami të Distriktit Financiar dhe ajo më e famshmja, që njihet me emrin

Fisheku. Në drejtim të Viktorias dukeshin një seri ndërtesash viktoriane dhe gjeorgjiane, të bardha me kolona para dyerve.

Takim me zonjën Susie Burbridge - Lord Mayer e Westminster - Londër

Ora e takimit me zonjën Burbridge kishte kaluar, ndërsa ajo nuk dukej, gjë që nuk ndodhte kurrë me anglezët, sidomos kur shkon në zyrën e tyre. Pas mëse pesëmbëdhjetë minutash vonesë, ky merak i yni u shua sapo u shfaq në derë një zonjë flokëthinjur, me syze, shumë e mbajtur dhe e bukur, ndonëse dukej se mbi të rëndonin më shumë se 60 vite. Rreth qafës mbante gjerdanin e artë të Kryetares së Bashkisë së Westminister-it, një nga emrat më të njohur në botë. Ajo na buzëqeshi aq ëmbël, sa në çast m'u duk sikur këtë person nuk po e shihja për herë të parë, dhe na ftoi të futeshim në zyrën e saj. U ulëm sipas protokollit dhe rregullave të tyre. Ajo pasi më tregoi se sa e bukur ishte puna e Lord Mayer-it, po ashtu më tregoi edhe si zgjidhej ky post, i cili kishte në themel besimin e dhënë nga Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II. Susie na tregoi për këshillin, këshilltarët, se si ata zgjidheshin dhe e zëvendësonin njëri-tjetrin çdo vit, çfarë përgjegjësish mbartnin etj., etj. Në disa minuta mësova shumë gjëra për funksionimin e pushtetit vendor në Britani. Megjithëse këto shpjegime ishin shumë interesante dhe ishte shumë mirë për mua që t'i dija, çështja për të cilën unë isha aty kishte krejt objekt tjetër. Krijova përshtypjen se Susie po e largonte vëmendjen time nga ajo, për të cilën isha aty, mbase edhe me qëllim.

E shprehur bukur, siç ishte, e gjallë, që fliste një gjuhë të bukur, me një fjalor të zgjedhur, shoqëruar me gjeste shumë delikate, aristokrate, ajo na mbajti gati 15 minuta me rrëfime të tilla. Kur më dha mundësinë të flisja, e falënderova për kohën që më vuri në dispozicion, e falënderova për shpjegimet e çmueshme për njohjen e atij qyteti dhe të pushtetit vendor si ky në Westminster, pastaj dola menjëherë në "temë".

"Sivjet vendi im feston 100-vjetorin e pavarësisë së shtetit të vet", i thashë asaj. "Janë duke u bërë përgatitje të mëdha për këtë festë, jo vetëm në Shqipëri, por në tërë botën ku ka shqiptarë. Në Britaninë e Madhe kemi një numër mjaft të madh shqiptarësh, por në këtë vend ka shumë pak ose asnjë gjurmë të pranisë

së jetës shqiptare. Njerëz të shquar të këtij vendi e kanë vizituar Shqipërinë që në fillimet e shekullit të 19-të, madje edhe më parë. Vendi juaj ka luajtur një rol të caktuar në historinë e vendit tim. Është koha të kemi një përmendore këtu. Ai do të jetë busti i Skënderbeut, heroit kombëtar shqiptar, "Atletit të Krishtit", luftëtarit të paepur të rezistencës ndaj hordhive osmane".

Kështu vazhdova t'i shpjegoja për disa minuta me radhë dhe vura re se, ndërsa po flisja, vëmendja e Susie Burbridge po shtohej deri sa ajo filloi të buzëqeshte me një lloj kureshtjeje dhe simpatie. Me sa duket, shpjegimi im, përpjekja për ta bërë atë paraqitje sa më mbresëlënëse e mundësisht bindëse për të, pasioni me të cilin po këmbëngulja nëpërmjet çdo fjale për të marrë një premtim prej saj, e "stepi" atë dhe, në një moment, më ndërpreu e më tha:

- A është i vendosur diku tjetër ky Skënderbeu juaj përveçse në Shqipëri?

Po, - i thashë, dhe i tregova se përmendore madhështore të Skënderbeut ka në Romë, Gjenevë, Detroit, Shkup, Prishtinë, si dhe shumë zona arbëreshe në anë të ndryshme të Italisë, si në Horën e Arbëreshëve (*Piana degli Albanesi*) etj.

- Po në Londër, - pyeti ajo, - a dini ju se ku mund të vendoset dhe… në fakt a e dini se sa e vështirë është vendosja e tij?

- Po, - i thashë, - e dimë, në Warwick Square, afër Ambasadës Shqiptare në Pimlico - Viktoria. Aty është një vend i shkëlqyeshëm. Do të ishim të lumtur ta vendosnim aty.

- Oh, - psherëtiu ajo. Edhe nëse do të kisha dëshirën e tërë botës për këtë, aty nuk mund ta vendosim, pasi është në një plan rishikimi urbanistik dhe do të merrte vite deri sa të miratohej. E keqja është se unë për një muaj dorëzoj detyrën dhe kaloj si këshilltare e thjeshtë. Por do të jem në këshill dhe do të ndihmoj me tërë forcat e mia, sado që tani për tani nuk kam ndonjë gjë në mendje. Unë do të jem mbështetëse e fortë e juaja. 100 vjet shtet shqiptar! A nuk është diçka e bukur?! Dhe një përmendore në Londër, në këtë kohë duket si dhuratë shumë e mirë. Pas tërë këtyre që më tregove, ia vlen t'iu ndihmoj.

Ajo përsëri na dhuroi një buzëqeshje, sa njerëzore aq edhe fisnike, dhe na dha të kuptonim se këtu mbyllej ajo bisedë. Mendova se tërë ato shpjegime për Skënderbeun, pastaj historia jonë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Edward Grey, Bajroni, Hobhuase, Edward Lear e sa e sa udhëtarë të tjerë të

përmendur bënë punën e vet… Kështu, u larguam nga ajo ndërtesë, me shumë fjalë, por jo me aq shumë shpresa.

Takim me David Lloyd-in, mikun e David Smail-it dhe Julio Emer-it

Disa ditë më vonë shkova te një mik i shquar i Shqipërisë, zoti David Lloyd. Ai ishte i njohur i Kryeministrit Berisha dhe ky i fundit më kishte këshilluar ta takoja. Ishte njeri i dashur, por shumë ironik, këpuste ndonjë thënie të fortë angleze, pastaj qeshte e qeshte vetë. Më nxori një gotë me whisky përpara dhe më pyeti për punën dhe çfarë kisha ndërmend të bëja për 100-vjetorin e Pavarësisë. Pasi i tregova për shumë projekte që kisha në kokë, i fola edhe për dëshirën për të vendosur një bust të Skënderbeut në Londër dhe, si rrëshqitazi, i tregova edhe për hapin e parë, që kisha bërë, d.m.th. për takimin me Susie Burbridge.

- Hahaha, - shpërtheu ai në të qeshura. - Susie? Susie Burbridge!?

- Po, - i thashë, - Susie, Lord Majoresha e Westminster-it.

Pastaj më pyeti çfarë kishim biseduar dhe pasi i shpjegova në përgjithësi ai qeshi dhe, papritmas, mori telefonin, formoi ca numra dhe, në anën tjetër të linjës, u dëgjua një zë i ëmbël gruaje.

- Po, i dashur David, më thuaj, - u përgjigj ajo.

- Susie, ku gjendesh ti? - e pyeti Davidi.

- Në shtëpi, - u duk se tha zonja.

- Eja tek unë sa më parë, të lutem!

- Mirë, - tha ajo.

Pas rreth 15 minutash, në derë u shfaq Susie Burbridge. Ajo për një moment shtangu.

- Uau, po ju këtu? Çfarë surprize! David, a është koincidencë, apo e keni sajuar ju këtë takim?

- Është edhe koincidencë, por edhe desha ta takonit mikun tonë nga Shqipëria, në shtëpinë time dhe të vazhdoni bisedën për Skënderbeun.

- Oh, Zot i Madh, Skënderbeu! Ai i ka shpëtuar shqiptarët dhe Evropën nga Turqit.

Pas kësaj që tha shumë seriozisht, shpërtheu në të qeshur dhe vazhdoi:

- Ndërsa mua më shpëtoi nga një vend parkimi për makinën e Ambasadës(!)

- Çfarë parkimi, Susi, a e di për çfarë po flasim? - ia ktheu Davidi.

- Po, David, kur më erdhi në zyrë zotëria, gati sa nuk desha ta takoja. Jam mësuar që tërë shefat e misioneve diplomatike në Westminster, vijnë dhe kërkojnë vende parkimi për makinat e personelit të tyre. Thashë se të njëjtën gjë do të bënte edhe ky. Kur e pashë që nuk më kërkonte vend parkimi, u lehtësova, mora një leksion historie, madje kam kërkuar dhe lexuar edhe shumë gjëra të tjera në internet dhe kam mësuar për Skënderbeun.

- Epo na duhet ta ndihmojmë ta vendosim atë bust këtu në Londër, si thua? - ia ktheu Davidi. Unë kam një vend në mendje. Këtu në Bayswater, në kufi me Notting Hill, është një vend shumë i mirë për atë përmendore. Është Lady Samuel Square. E di çfarë? Marko, iu drejtua ai një njeriu që e kishte në shtëpi, merr Susin dhe Malin dhe shkoni e shikojeni. Pastaj ejani prapë këtu.

Te sheshi Lady Samuel Square - Bayswater

Bashkë me zonjën Burbridge dhe zotin Marko Maciolini, u nisëm dhe shkuam tek ai shesh. Ishte mjaft i përshtatshëm për ta vendosur bustin. Një shesh i gjelbëruar mjaft mirë, me shumë bimë dekorative, në një kryqëzim rrugësh me shumë lëvizje, me një mur prapa në sfond të mbuluar me bimë kacavjerrëse.

Sheshi gjendej në adresën *113 Inverness Terrace, London W2 6JH*. Ai ishte vend shumë i pranueshëm dhe i bukur. Kisha pyetur se si ishin vendosur përmendore njerëzish të huaj nëpër Londër dhe sa kishin kushtuar? Çmimi për vendosjen e tyre ishte marramendës. Për shembull, shtatorja e Nelson Mandelës, e vendosur përpara Abacisë së Westminister-it dhe Parlamentit në qendër të Londrës, kishte kushtuar 5 milion sterlina vetëm për ta lejuar vendosjen e tij aty. Kostoja e bustit ishte llogari tjetër dhe po kaq, në mos më shumë, kishte kushtuar vendosja aty afër e shtatores së Mahatma Ghandit, themeluesit të shtetit modern të pavarur të Indisë.

Kështu u kthyem përsëri te shtëpia e Davidit. Rrokullisëm nga një gotë whisky dhe biseduam për mundësinë e marrjes së atij vendi për truall të bustit

së Skënderbeut. Lord Majorja Burbridge na premtoi se do të shihte mundësinë e dhënies së atij vendi pasi të sigurohej mbi pronësinë e tij, lobimin që do të bënte me anëtarët e Këshillit Bashkiak e sidomos me këshilltarin Robert Davis, pasardhës i saj, si dhe më pas hapat, që do të merreshin për ta përfunduar atë projekt në kohën e duhur, do me thënë me datën 28 nëntor 2012. Një ndër gjërat që duheshin bërë ishte të merrnin miratimin me nënshkrime të më shumë se dy mijë banorëve, që jetonin në atë zonë dhe e shihnin bustin çdo ditë dhe që nuk kishin kundërshtim për vendosjen e tij.

Patricia Nugge - Koleksionistja e njohur e librave për Skënderbeun

Në Londër jeton një zonjë angleze e quajtur Patricia Nugee, koleksioniste e njohur e librave për Skënderbeun. Ajo njihet si një nga koleksionistet që ka më shumë libra për Skënderbeun, të cilat i ka grumbulluar që kur ishte punonjëse e re e një biblioteke në Londër. Patricia ishte frymëzuar gjatë vizitës, që kishte bërë në Shqipëri në vitet '70 të shekullit të kaluar dhe i kishte kushtuar shumë kohë mbledhjes, ruajtjes dhe ekspozimit të këtyre librave jo vetëm në Londër, por edhe në shumë vende të botës, Barcelonë, Madrid, Romë, si dhe në Tiranë, Prishtinë etj. Patricia dëshironte që busti të vendosej në sheshin Warwick. Por aty ishte e pamundur për një mijë e një arsye.

Ndërkohë, në Shoqatën Anglo - Shqiptare bëheshin po ashtu përpjekje për të ndihmuar në vendosjen e bustit. Presidenti i Nderit, profesor Noel Malcolm, kryetari i shoqatës, ish-Ambasadori Britanik në Tiranë, Stephen Nash, përkthyesi i Ismail Kadaresë, John Hodgson, studiuesi dhe diplomati i Republikës së Kosovës, Bejtullah Destani, Konsullja e Nderit e Republikës së Shqipërisë në Oxford, zonja Bryony Bethel, të gjithë bënin përpjekjet e tyre. Kjo u bë temë e preferuar bisede me të gjithë dhe në çdo moment. Tani ajo ide dashamirëse e të gjithë këtyre po merrte formën e vet. Shumica prej tyre e mbështetën idenë e vendosjes së bustit në Bayswater.

Në kërkim të modelimit të bustit të Skënderbeut

Pasi mora miratimin dhe një premtim për financimin e bustit nga Tirana (premtim, i cili u përmbush vetëm pjesërisht) dhe pasi kisha gjetur edhe truallin ku do të vendosej, fillova të mendoja për veprën, të cilën as që e dija se ku do ta gjeja. Në fillim më erdhi ideja që të vendosnim një kopje të veprës së Odise Paskalit. Kjo ide ra menjëherë, sapo njerëzit që e kishin të drejtën e autorit na paraqitën një çmim, i cili ishte përtej çdo mundësie financiare.

Atëherë vendosa të thërrisja dhe ta pyesja artisten e njohur Suzana Varvarica - Kuka, njohëse dhe kritike e shkëlqyer e artit figurativ, e cila punonte në Galerinë tonë Kombëtare të Arteve. Pasi i shpjegova situatën, ajo më rekomandoi të kontaktoja skulptorin e njohur Kreshnik Xhiku, të cilin sipas të dhënave të saj, e gjeta në Washington D.C, në SHBA. Pasi i shpjegova Kreshnikut për nismën tonë, ai më premtoi se do ta bënte me shumë kënaqësi. Tani edhe një problem u zgjidh: Vepra. Por mbetej financimi si problemi kryesor dhe projekti i vend-vendosjes.

Ndihmesa e Studios Oliver & Hasani

Për dokumentacionin e projektit të vendosjes së bustit, një studio ligjore londineze kërkonte pesë mijë sterlina. Ku do të gjendeshin!? E dija që kishte djem e vajza shqiptare arkitektë në Londër. Dhe ja ku u gjet! Së pari, u angazhua studio ligjore Oliver & Hasani, e drejtuar nga një djalë shkodran i quajtur Naim Hasani. Ai mori përsipër tërë anën dokumentare dhe ligjore për t'i paraqitur në Bashkinë e Westminister-it. Pa pagesë! Dhuratë e bukur për 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë!

Si do të emërtohej ajo përmendore?

Ndërsa merresha me bustin dhe aksesorë të tjerë, duhej menduar edhe për emërtimin e tij. Në dukje kjo ishte gjëja më e thjeshtë, por në fakt kjo kishte

rëndësi të posaçme. Teksti duhej të gdhendej në piedestal. E mendova gjatë e gjatë. Ta identifikonim me Krishterimin, siç kishin bërë Papët e Romës kur e quajtën "Atlet i Krishtit", patëm frikë se mos nxisnim reagimin e ndonjë fanatiku islamik, të cilët gjenden me shumicë në Londrën kozmopolite. Por, edhe pa një emërtim shumë përfaqësues të kohës kur jetoi ai, nuk do të kuptohej nga vizitorët dhe kalimtarët. Pasi u konsultova me shumë miq të ditur, madje edhe akademikë, mendja më shkoi te miku im Visar Zhiti. I shkrova Visarit një e-mail dhe iu luta të më ndihmonte për emërtimin. Pasi e diskutuam gjatë me telefon dhe me postë elektronike, arritëm në një mendim të përbashkët. Le të ishte diçka që, me pak fjalë, do të thoshte shumë, menduam të dy. Dhe vendosëm këtë diçiturë:

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu
1405 -1468
Heroi i Paepur Kombëtar Shqiptar
Mbrojtës i Qytetërimit Perëndimor.

Na u duk se ishte ide shumë e mirë. Tani duhej përkthyer në anglisht në një formë sa më shprehëse, koncize, të pranueshme dhe mbresëlënëse. Dhe ja ku doli edhe diçitura:

George Kastrioti - Scanderbeg
1405 - 1468
Invincible Albanian National Hero
Defender of Western Civilization

Më bukur se kaq nuk ka ku të shkojë, thashë me vete. Më kuptimplotë se kaq nuk mund të ishte. Duke ditur se shenjti mbrojtës i anglezëve ishte *George* dhe mbretërit e atij vendi shumica "*George*" ishin, por edhe pse në literaturën perëndimore, emri i parë i heroit tonë Gjergj është George, vendosëm ta shkruajmë atë si në anglisht.

Piedestali - Përparimi dhe Kristalja nga Grupi "4mgroup" dhe Isuf Margjeka

Kriteret e vendosjes së një përmendoreje në Londër janë tej mase rigoroze: Përmasat, baraslargësia me objektet e tjera, shikueshmëria nga vizitorët, profili dhe drejtimi i vështrimit të bustit, mjedisi rrethues, lulet dhe gjelbërimi, lartësia mbi tokë, largësia e bustit të heroit tonë nga fasada duheshin respektuar një më një. Për këtë u angazhua Grupi "4mgroup" i themeluar nga arkitekti shumë i njohur nga Prishtina, Ing. Përparim Rama, si dhe e shoqja, zonja Kristale Rama - Ivezaj, shqiptaro - amerikane e lindur në Detroit me prindër shqiptarë nga Mali i Zi, botuese gazete dhe intelektuale e shquar. Ata dhe Besiana (nga Tropoja) morën përsipër tërë punën përgatitore dokumentare për vendosjen e piedestalit dhe më pas të vetë bustit.

Tani mbetej të përgatitej terreni dhe të ndërtohej piedestali. Pasi e diskutova me shumë të njohur e gjeta edhe atë. Ishte Isuf Margjeka, djalë i mrekullueshëm, edhe ky tropojan.

"E bëj unë", më tha! "E kam për nder."

Dhe kështu bëri. E ndërtoi piedestalin dhe e bëri gati për ditën e përurimit.

Tani mbetej pjesa finale.

Odiseja e modelimit, derdhjes dhe transportit të bustit deri në Londër

Dita e përurimit të bustit ishte caktuar: 28 nëntor 2012, në orën 12.00, edhe pse busti ende nuk ishte bërë. Deri më 5 nëntor kishim vetëm premtime, por jo bust, as fond të lëvruar, as para për të paguar për lejen nga Këshilli Bashkiak i Westminster-it. Problemi ishte se nuk kishim fond as për skulptorin, që të modelonte veprën dhe, më keq akoma, as për shkritoren, që do ta derdhte në bronz, dhe as për transportin nga Tirana në Londër. Me një përpjekje të jashtëzakonshme arrita të siguroja premtimin për fondin, që do t'i jepej bashkisë, po ashtu edhe autorit. Por, ndërsa me bashkinë isha në negociata që fondi të transferohej menjëherë pas vendosjes së bustit, autori, Kreshnik Xhiku,

nuk gjente shkritore në Tiranë, e cila të mund ta derdhte bustin në gizë a në bronz, pa i dhënë paratë në dorë. Tri të tilla punonin në Tiranë, por asnjëra nuk pranonte. Më pas do të ndiqej ecuria e derdhjes së bustit dhe lustrimit të tij, që kërkonte edhe kjo kohën e vet.

Financimi dhe pronësia mbi bustin e Skënderbeut në Londër

Mesditën e 5 nëntorit 2012, skulptori, Kreshnik Xhiku, më thirri në telefon nga Tirana dhe më tha që, nëse busti nuk futej në proces në shkritore po atë ditë, nuk arrihej të bëhej gati për t'u vendosur në Londër më 28 nëntor. Problemi ishte shumë serioz. Unë, ndonëse njihesha mirë me drejtuesin e Ministrisë së Kulturës së asaj kohe, i cili më kishte thënë që: "*veç arrije ta vendosësh bustin, se për çdo gjë jemi gati të të mbështesim*", nuk e gjeja të realizuar këtë premtim. Atëherë, çfarë duhej të bëja? Të dorëzohesha? Jo! Kjo nuk mund të ndodhte!

Në pamundësi për ta zgjidhur këtë çështje me shtetin, i kërkova një mikut tim në Tirane (AP) një hua prej tetë mijë eurosh, me të drejtë kthimi në një afat pak të gjatë dhe me shpresë se Ministria e Kulturës do ta konsideronte premtimin e dhënë. Kështu edhe kjo çështje u zgjidh. Skulptori i mori po atë ditë paratë dhe bëri pagesën në shkritore. Disa kohë më vonë e ktheva huanë cent për cent, nga buxheti im modest personal. As qeveria shqiptare e asaj kohe dhe aq më pak pasardhësja e saj nuk e pagoi kurrë atë faturë. Në këtë aspekt, ai bust edhe sot e kësaj dite qëndron krenar në Londër, por është pronë e familjes sime (Berisha), dhe do t'u trashëgohet me testament pasardhësve të mi.

Askush nuk ka të drejtë ta marrë pronësinë deri sa të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 697, datë 16.8.2013 për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Mbulimin e Shpenzimeve për Realizimin në Bronz të Bustit.

Sipas një informacioni që mora më vonë, ai bust nuk gjendet në inventarin e veprave të artit të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë. Por, dosja e të tërë dokumentacionit gjendet në arkivin e Ambasadës Shqiptare në Londër.

Arritja e bustit në Londër, 27 nëntor 2012. Skënderbeu "bujtës" te Isufi

Me vullnet dhe përkushtim çdo gjë arrihet. Kështu, në mbrëmjen e datës 27 nëntor 2012, busti arriti në Aeroportin Gatewick në Londër. Procedura e zhdoganimit dhe futjes së kësaj vepre arti ishte një praktikë tjetër plot me burokracira. Edhe për atë i kishim marrë të tëra masat, që mos të kishte pengesa. Aty nga ora njëmbëdhjetë e natës, çdo gjë u rregullua. Busti tanimë ishte në tokën angleze. Isuf Margjeka, i cili kishte bërë piedestalin, shkoi në aeroport për ta transportuar. Ai më bëri telefonatën e sihariqit se Skënderbeu më në fund kishte arritur në Londër.

- Skënderbeu erdhi dhe unë tani sapo e vura në makinën time, - më njoftoi ai në telefon. - Por më thuaj çfarë duhet të bëj tani? Ku duhet ta mbaj sonte? - më tha ai, si në të qeshur.

- Oh, Isuf, po merre mysafir në shtëpi! A ka nder më të madh se ta kesh pasur Skënderbeun bujtës në shtëpinë tënde, qoftë edhe një natë?

- Ke të drejtë, - më tha.

Dhe kështu bëri. Me makinushën e tij, ai e mori atë natë në shtëpinë e vet. Ndoshta u bë i pari shqiptar, që një natë e kishte pasur mysafir Heroin tonë Kombëtar. Ai edhe sot e kësaj dite, e kujton si ndër gjërat më të rëndësishme që i kanë ndodhur në jetën e tij.

Vendosja dhe përurimi i bustit - 28 nëntor 2012

Më 28 nëntor 2012, në orën 8 të mëngjesit busti u lëshua në zhlepin e vet të piedestalit dhe u mbështoll me Flamurin Kombëtar Shqiptar. Qysh në atë orë, qindra shqiptarë filluan të festojnë, të kërcejnë e të këndojnë. Në një moment, Policia Metropolitane e Londrës erdhi dhe më kërkoi t'u shpjegoja se çfarë po ndodhte, pasi kishte pengesë të trafikut. Pasi ua shpjegova më thanë:

"Ne do të devijojmë trafikun deri sa ju të mbaroni. Vazhdoni për aq kohë sa dëshironi ju! Gëzuar!".

Në orën 12:00 velloja e kuqe me Flamur Kombëtar Shqiptar u hoq dhe ai

u shfaq krenar në sheshin Lady Samuel, në mes të Londrës.

Unë kisha shkuar që herët bashkë me punonjësit e ambasadës si dhe zonjën time, Donika. Kur busti u lëshua mbi piedestalin e vet ndjeva një gëzim të jashtëzakonshëm. Kishim arritur diçka të madhe. Ai bust m'u duk se pasqyronte në fytyrën e tij epike, tërë karakterin e popullit tim. Ai kishte gjithçka burrërore në pamje dhe njerëzore në thjeshtësinë e tij.

Skulptori e kishte trajtuar me kujdes dhe me qëllim për ta bërë atë sa më tokësor dhe sa më njerëzor, por duke ruajtur dhe vënë në pah edhe forcën e tij burrërore.

Kryelartë, krenar, me sy të thellë që vështrojnë larg, me tipare të theksuara prej burri, me ashpërsinë e luftëtarit të paepur, me një mjekër të shkurtër me shtëllunga të vogla, aspak të ekzagjeruara, me qafë të gjatë mbi një trup solid, të fortë e burrëror, ai qëndroi sfidues në atë shesh. Ai është i pari dhe i vetmi monument shqiptar deri më sot në Britaninë e Madhe. Por është edhe një ndër përmendoret më të denja dhe përfaqësuese të një figure a heroi kombëtar të ndonjë populli evropian në atë qytet - Galeri Arti në Natyrë.

Fjalimi para bustit më 28 nëntor 2012

Në ceremoninë e përurimit fola me pasion dhe emocion si kurrë ndonjëherë. Në fakt isha gati si kufomë e pakallur prej dy operacioneve shumë të rënda, që kisha kryer gjatë nëntorit, pikërisht në atë kohë kur po merresha edhe me bustin. Ishte dëshira për ta vënë atë bust në përvjetorin e Pavarësisë në atë vend, për ata njerëz që kishin ardhur për inaugurimin që tejkalonte çdo gjë. Sipas shënimeve të mia, ndër të tjera, thashë:

100 Vjet Pavarësi, 28 Nëntor 2012

Prej sot, këtu në Bayswater ne do të kemi simbolin tonë kombëtar, Bustin e Skënderbeut, vepër e skulptorit Kreshnik Xhiku.

Jam krenar që, në këtë ditë historike të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, përfaqësoj vendin tonë të dashur, Shqipërinë; t'ju përfaqësoj juve, që jeni

komuniteti më i ri dhe më me perspektivë në këtë vend, ju që i jepni nder këtij vendi dhe vendit prej nga keni ardhur nga çdo truall etnik shqiptar i Ballkanit. Prej sot, ky vend do të jetë vendi juaj, tempulli juaj i nderit kombëtar, do të jetë faltorja juaj. Duajeni, respektojeni, kthehuni herë pas here, frymëzohuni dhe reflektoni për identitetin tuaj!

Bëhuni britanikët më të mirë të këtij vendi, por jeni edhe shqiptarët më atdhetarë në botë!

Dhe do të jeni njerëzit më fisnikë të këtij rruzulli!

Dhe do të jeni njerëzit më të mirë të këtij vendi mik e të bekuar!

Rrofshi ju! Rroftë emri dhe vepra e Skënderbeut!

Rroftë Shqipëria! Rroftë Britania e Madhe!"…

Bacë u kry.

Bayswater, London, 28 nëntor 2012

ODISEJA E LIBRIT "CHARLES TELFORD ERICKSON, AMERIKANI QË I KUSHTOI JETËN SHQIPËRISË"

Çdo rrugë e gjatë fillon me hapin e parë. Përgatitja e biografisë dhe përkthimi e botimi i veprës së Charles Telford Erickson-it për mua ka qenë një rrugë e gjatë dhe jo pak e mundimshme, por edhe shumë e bukur dhe tunduese në vetvete. Hapi i parë i kësaj rruge të gjatë nisi kur mbajta një kumtesë për 90-vjetorin e botimit të gazetës "Dielli" në New York. Në hulumtimet për "Diellin" dhe "Vatrën" ndesha në emrin e Charles Telford Erickson-it. Aty lexova vlerësimet që këtij burri të madh ia bënte një politikan i shquar i Ballkanit, ish-Presidenti i Bosnje - Hercegovinës, dr. Harry Silajxhiç. Ai ishte bërë doktor i shkencave historike me një punim shkencor me titull: *"Çështja shqiptare në arkivat amerikane"*. Në një mori dokumentesh dhe emrash të përmendur aty gjendej edhe ai i Charles Telford Erickson-it. Si një vetëtimë që të shkrep në mendje nganjëherë, u vura në kërkim të veprës së tij.

Njeriu që flet në këtë libër për Charles Telford Erickson-in është vetë ai, Erickson-i, sa me veprën e tij të madhe në dobi të Shqipërisë, aq edhe me shkrimet e lëna trashëgim. Libri u botua në prag të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Periudha kur jam marrë me të, për mbledhjen dhe përpunimin e tërë materialit deri në hedhjen përfundimtare në letër, është pikërisht periudha kur u mbushën 100 vjet që kur heroi im, Ch.T.Erickson shkeli për herë të parë në Shqipëri. Tanimë asgjë nuk i ngjan kohës kur Erickson-ët erdhën në Shqipëri, në vitin 1908**,** madje, as kur ikën prej saj, tridhjetë vjet më vonë. Gjithçka ka ndryshuar që nga peizazhi, infrastruktura, mënyra e jetesës, edukimi, vetë jeta. E vetmja gjë e njëjtë, e pandryshueshme dhe që na pëlqen të jetë ashtu siç është, është shpirti i shqiptarit: ashtu siç e gjeti,

e pa, e zbuloi, e përshkroi, e nderoi, e himnizoi dhe e la Erickson-i.

Brenga e atij njeriu, që e deshi aq shumë Shqipërinë do t'i ishte kthyer në gëzim, nëse do ta shihte se sa shumë ka ndryshuar ky vend. Përkundër prapambetjes së patregueshme që lanë pas osmanët, shkatërrimit që shkaktuan luftërat ballkanike, copëtimi i trojeve shqiptare dhe intrigat evropiane për zhdukjen nga harta të Shqipërisë, pushtimit fashist dhe më pas vendosja e një regjimi diktatorial komunist, prapë Shqipëria arriti të mbijetojë dhe t'i bashkohet familjes së kombeve të qytetëruara. Dhe të mendoje se ora e shqiptarëve kishte ngecur shumë herë në historinë e saj. Kur ai shkeli në Shqipëri, tik-taku i orës së shqiptarëve sapo kishte filluar të trokiste përsëri, pas 430 vjetësh.

Puna për zbulimin, përzgjedhjen, digjitalizimin, sistemimin, përkthimin dhe jetëshkrimin e veprës së Erickson-it, sado e vështirë të më jetë dukur, ka qenë më e lehtë sesa gjetja e përgjigjes për pyetjen:

Çfarë e shtyu këtë njeri t'i kushtonte jetën Shqipërisë?

Kjo pyetje më ka shoqëruar edhe kur kërkoja në bibliotekën e Presidentit Herbert Hoover, edhe në bibliotekën e Universitetit Minesota, në Arkivin e Departamentit të Shtetit apo në bibliotekën "Yale University Divinity School Library" në New Haven në shtetin Connecticut, në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar apo në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, në arkivin e Kantonit Somerset në Angli apo në atë të British Museum, aq sa edhe në faqet e pafund të Internetit. Janë me qindra-mijëra faqe dokumente të lëna trashëgim prej tij, të shkruara, të ruajtura, të pabotuara, të botuara ose edhe të ribotuara.

Pra, çfarë e bëri amerikanin Charles Telford Erickson të merrte udhën drejt Shqipërisë në moshën dyzetedyvjeçare, bashkë me familjen dhe fëmijët, atëherë kur njeriu kujdeset më shumë se çdoherë për të konsoliduar rehatinë dhe të ardhmen e vet dhe të familjes? Dhe nëse ai e mori këtë udhëtim për një mision që bazohej në bindjet e tij fetare, çfarë e lidhi atë kaq shumë me Shqipërinë dhe shqiptarët? Përgjigjen do ta gjejmë në tërë ato çfarë ai ka shkruar dhe në mënyrë të veçantë në materialet e përzgjedhura dhe të botuara në atë libër, të cilin e botoi me shumë sqimë profesor Bardhyl Musai.

Erickson-i kishte ardhur në Shqipëri si misionar, si pastor i përgatitur në mënyrën më të shkëlqyer nga institucionet e shërbimeve fetare protestante, nga njëra anë, si edhe me dijenitë e marra nga një prej universiteteve më në zë të

botës, Universiteti Yale. Por në Shqipëri ai vuri re menjëherë se:

> "*Gjëja më e fundit për të cilën kishte nevojë Shqipëria e vitit 1908 ishte evangjelizmi*".

Për këtë, pasi preku me dorë realitetin, studioi, hulumtoi, perceptoi, kuptoi thellë virtytet e mrekullueshme të popullit shqiptar, u kthye nga një pastor i thjeshtë kishe, nga një misionar fetar, në një korife përhapës arsimi, kulture, shkence, kulture, dijenish bujqësore, diplomacie, politike…

Erickson-i u kthye në një figurë, që e lidhi emrin e tij me disa nga momentet më të rëndësishme të zhvillimit të Shqipërisë në disa fusha. Ai shumë shpejt kuptoi se në Vendin e Shqiponjave jetonin vërtet "Bijtë e Shqipes", siç i quan ai në çdo libër të tij. Jetonin njerëz të cilët, edhe pse të zhytur në prapambetje, për shkak të natës së gjatë e të errët osmane, ruanin brenda vetes virtytet më të larta njerëzore. Ai kuptoi se ky popull nuk e meritonte këtë fat. Andaj luftoi tërë jetën e tij, që kur u njoh me shqiptarët, për ta ndryshuar atë. Ai luftoi për ta nxjerrë popullin tonë nga kjo skëterrë, herë i vetëm, herë i ndihmuar nga shqiptarët, herë nga miq të tij të huaj. Ai asnjëherë nuk e pati të lehtë, për shkak të armiqve të popullit shqiptar, të cilët u kthyen pa dyshim edhe në armiq të tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Libri doli nga botimi dhe u përurua në Tiranë më 5 nëntor 2012. Pjesëmarrës në përurimin e tij në Hotel "Tirana", ishin njerëzit e mi më të dashur, nëna ime tetëdhjetëvjeçare, fëmijët e mi, pjesëtarë të familjes dhe të farefisit. Merrnin pjesë edhe njerëzit më të rëndësishëm të Shqipërisë, Kryeministri, anëtarë të kabinetit qeveritar, Ministri i Jashtëm, Ambasadori Amerikan në Tiranë, kolegë diplomatë. Midis pjesëmarrësve ishin edhe nipat dhe mbesa e Erickson–it, Paul Erickson, i Riu, Dan Johnson, dhe Mary Morris. Paul Erickson i Riu, recitoi vjershën kushtuar Skënderbeut, shkruar nga gjyshi i tij në gjuhën angleze. Paralel me të, vjershën në gjuhën shqipe sipas variantit që e kisha përkthyer dhe ishte botuar në libër, e recitoi aktori i njohur i teatrit shqiptar, Mjeshtri i Madh, Mirush Kabashi:

SKËNDERBEG

Ti dorën nuk e zgjate drejt skeptrit njollagjak,
As i trishtë nuk kërkove të shprishurën kurorë,
Përballë i dole, që vet të merrje hak,
ndaj atij tirani djemrrëmbyes e idhnak,
Që dheun tënd kishte shtënë në dorë.

I flake tej nderet e pafundme imperiale,
Dhe lavdinë ndër vite të fituar,
të mbroje folenë e vendit tënd, trazuar,
Si shqipe-shqipëtare gjoks-zbuluar,
Prej morisë së pafund të shigjetave, i sulmuar.

U zhveshe nga një fé që të kishte ndarë,
Nga shtëpia, babai, nëna dhe altari,
Dhe varrose një dashuri,
Tinëzare, por të bukur, tretur, ëmbëlsi,
Për at' dhe, fé e truall që t'la i pari.

Si dikur Zoti yt, drejt vdekjes ti shkove,
Ndërsa bota krejt e qetë të kundronte,
Pa luajtur qoftë dhe gishtin për shpëtim,
Pa rrahur një herë duart për tëndin guxim,
Kur kombit tënd si shi gjaku i kullonte.

Shpirt martir, eja prapë dhe hakmerru!
Nga pluhuri ngrije atë flamur, në lartësi!
Bëhu edhe një herë për ne, frymëzim,
Për kryqin e ndritur deri në amshim,
Dhe pamjes së largët të Lirisë silli përjetësi!

Më 23 janar 2013, ky libër u përurua edhe në Ambasadë në Londër nën kujdesin e Shoqatës Anglo - Shqiptare. Aty morën pjesë Ambasadorët e Sllovenisë,

Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë; diplomatë nga Ambasada Amerikane, Bosnja e Hercegovina, Moldavia, lordë, parlamentarë, përfaqësues të bashkësisë shqiptaro-britanike dhe shoqatat e tyre, si dhe rabinë nga bashkësia hebraike. Për përmbajtjen e librit dhe rëndësinë që ka, foli profesori i Oxford-it dhe Presidenti i Nderit i Shoqatës Anglo - Shqiptare, Sir Noel Malcolm.

MIQËSIA ME ARTISTEN RITA ORA DHE FAMILJEN E SAJ

Njohja me familjen Ora - Sahatçiu është ndër kënaqësitë, që mund të provojë një përfaqësues i shtetit shqiptar në Londër. Në takimin e parë me artisten, në gushtin e vitit 2012, pata rastin të isha i ftuar në përurimin e albumit të saj me këngë, emetuar nga Roc Nation dhe Columbia Records.Veprimtaria u zhvillua në mjediset e kompanisë së Versacit në Londër.

Në prag të festimeve të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë pata një takim shumë vëllazëror me Besnik Sahatçiun, të atin e Ritës. Ai është intelektual, i biri i Besim Sahatçiut, kineasti i parë i Kosovës, autori i shumë filmave dhe dokumentarëve kosovarë, ndër ta filmi "Era dhe Lisi" i vitit 1979. Më pas u takuam edhe me zonjën Vera, e shoqja e Besnikut dhe nëna e Ritës. Gjatë bisedës iu propozova që Rita të performonte në Tiranë më 28 nëntor 2012 për nder të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. Familja Sahatçiu - Ora e mirëpriti ftesën dhe e lamë të më njoftonin në kohën e duhur, pasi ta diskutonin këtë çështje me ekipin menaxhues të Ritës. Nuk vonoi dhe erdhi përgjigjja pozitive. Ata më thanë se ishin të nderuar të udhëtonin për në Tiranë, me shpenzimet e veta, përfshirë edhe grupin muzikor, që e shoqëronte. Familja Ora shkoi në Tiranë dhe Rita performoi në Sheshin "Nënë Tereza", duke entuziazmuar mijëra pjesëmarrës në festën tonë kombëtare.

Kur Rita u kthye në Londër, organizuam në ambasadë një takim me bashkësinë shqiptaro - britanike. Ajo ishte ndër ditët e bukura të asaj periudhe në Londër. Në mes të sallës së takimeve *"Edith & Herbert"* kishim veshur një manekin me kostum kombëtar gruaje, me xhubletë të Malësisë së Madhe, 100-vjeçare, sa mosha e shtetit tonë. Kostumi i ishte bërë dhuratë Rita Orës nga qeveria shqiptare në mirënjohje të performimit së saj në Tiranë. Po ashtu iu

dhurua një edicion jubilar i Lekut Shqiptar me tri monedha bronzi, argjendi dhe ari, vendosur në një kuti shumë të bukur. Pas fjalëve të rastit, Rita bëri fotografi thuajse me të gjithë pjesëmarrësit. Bashkë me Ambasadorin e Republikës së Kosovës, z. Lirim Greiçevci, i bëmë pritje zyrtare dhe zhvilluam një bisedë shumë të përzemërt për rolin, që ajo luan në njohjen e Kosovës dhe të kulturës shqiptare, edhe pse interpreton në gjuhën angleze.

Kostumi 100-vjeçar i "Rita Orës" në Muzeun Antropologjik të Universitetit Cambridge - përkrah koleksionit të Miss Edith Durham

Disa ditë më vonë, Familja Ora më kontaktoi përsëri. Ata shprehën falënderimet dhe kërkuan "leje", që atë vlerë të madhe të kombit tonë, xhubletën 100-vjeçare, t'ia dhuronin Muzeut Antropologjik të Universitetit Cambridge. Aty, mendonin ata, ai kostum do të kishte shumë më tepër vlerë sesa në shtëpinë e tyre. Gjuhëtari dhe historiani Agim Morina, pjesëtar aktiv i Bashkësisë Shqiptaro - Britanike, iu kishte sugjeruar se ai kostum me aq vlerë do të përbënte një eksponat shumë të rëndësishëm të kulturës sonë materiale në Universitetin e Cambridge-it.

Një gjesti fisnik të tillë nuk do t'i përgjigjesha kurrë negativisht. Në emër të Rita Orës, kostumi iu dorëzua universitetit nga prindërit e saj, Vera dhe Besniku. Ata u ndihmuan nga antropologia dhe arkeologia ligjore e atij universiteti, Nora Weller, dhe bashkëshorti i saj, Marc Weller. Ndihmesë dha, si përherë, studiuesi i njohur Bejtullah Destani. Kostumi u ekspozua përkrah vlerave të tjera materiale të vendosura aty në koleksionin e marrë nga Shqipëria nga Miss Edith Durham. Familja Sahatçiu - Ora dhe vetë Rita disponojnë një dokumentacion të plotë të dorëzimit të kostumit, si dhe foto të relikteve të tjera të Miss Durham-it. Ndër to janë fotot e shumë gjerdanëve dhe ornamenteve të përdorura nga gratë në Veriun e Shqipërisë, e veçanërisht ato zadrimore.

Më pas mora një mesazh nga Rita, në të cilin shkruante:

I dashur Ambasador!

Ka qenë një nder i madh dhe kënaqësi e veçantë për mua dhe familjen time të merrnim pjesë në festimet e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar,

më 28 nëntor 2012. Unë kurrë nuk do ta harroj atë moment kur dhamë shfaqje në Sheshin Nënë Tereza, në Tiranë, nën rrebeshin e një shiu, që nuk pushonte. Tek shihja sesi njerëzit, edhe në atë mot të keq, qëndronin në shesh, duartrokisnin dhe gëzonin bashkë me ne muzikantët nga Londra, ndjehesha edhe më e lumtur për atë, që po bënim. Unë ju dëshiroj juve çdo të mirë, jetë të sigurt dhe mirëqenie për brezin e fëmijëve të gjeneratës së re. Ju jeni tanimë në një botë të re, kur mund të përfitoni nga çdo mundësi që jeta iu ofron.

Me respekt: Rita Ora

RITAKIM RASTËSOR ME NJË PJESËTARE TË MILIARDA AZIATIKËVE

Në një takim në "London School of Economics" me Kryeministrin e Republikës Çeke, Petr Nečas, më datën 20 prill 2013, vura re se në krahun tim ishte një zonjë, me pamje krejt aziatike, me sy të zgjatur, fytyrë pak të verdhë dhe flokë të shkurtra. Më dukej si fytyrë e njohur, por nuk mund ta besoja se, në një rrethanë të tillë, aq rastësore mund të takoja dikë nga Azia e largët që mund ta njihja ose do të më njihte!?

Në të vërtetë droja ime se midis miliarda njerëzve të "verdhë" do të kisha pranë një prej atyre që e njihja, u largua menjëherë sapo zonja pranë meje më tha:

- A jeni ju zoti filani, dhe më tha emrin tim të plotë?
- Po, - i thashë, - unë jam.
- Dhe nuk më mban mend mua?
- Më ndihmo sadopak, të lutem, - i thashë dhe u skuqa.

Në fakt kisha të drejtë të ndjehesha si në faj sepse nuk kisha takuar aq shumë aziatikë në jetën time. Pra, nga aq pak që kisha takuar, do të duhej ta kujtoja këtë zonjë, me domosdo. Në një grimëherë u përmenda. Po ishte diplomate e një vendi aziatik, por në fakt as emri, as vendi, as momenti kur e kisha njohur nuk po më vinin në mendje. Po, tani po! Ajo ishte një zonjë, me të cilën ishim takuar në Ankara në Universitetin Hacetepe, të mbledhur dhe sponsorizuar nga Ministria e Jashtme Turke në vitin 1993. Atë kohë një grup diplomatësh, që sapo ishin përfshirë në shërbimin diplomatik ku bënin pjesë anëtarë të trupit diplomatik nga Kyrgyzstani, Turkmenistani, Bullgaria, Rumania, Maqedonia dhe Qipro e Veriut ishim mbledhur në Ankara dhe merrnim leksione nga diplomatët më të mirë të Republikës Turke. Ndër ta ishte edhe kjo zonjë.

- Unë jam Bahtygul Kalambekova nga Kyrgyzstani, - m'u kthye ajo.

- Ndërsa juve jeni filani, dhe ne kemi qenë tre muaj së bashku në Hacetepe University në Ankara. Bashkë me ne ishte edhe diplomati maqedonas me origjinë turke, Salim Kerim dhe më numëroi edhe disa tjerë.

Ishte e vërtetë. Ne patëm kaluar ditë të bukura në atë kohë dhe mësuam shumë prej diplomatëve më të çmuar turq.

Pas këtij rasti, me Baftygylin takoheshim shpesh në Londër, pasi ajo ishte Ambasadore e Republikës së Kyrgyzstanit në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe. Ajo i kishte paraqitur letrat kredenciale te Madhëria e Saj Elizabeth II e veshur në një kostum fantastik popullor të vendit të saj. Ndërsa gjatë vizitës, që i bëra në kancelarinë e saj, në Ascot të Londrës, ajo më dhuroi një kamxhik të bërë gërshet më lëkurë sholle shumë të bukur, që është edhe simbol kombëtar i atij populli, si kampion i mbarështimit të kuajve. Ajo më shpjegoi edhe për garat e Kok Borusë në vendin e saj dhe lojërat me kuaj, që shkojnë pas në histori më se 2500 vjet më parë.

Ndodh, pra, që të ritakohesh me një aziatik, edhe pse është një individ midis miliarda njerëzve.

KREU I PESTË

LONDËR - AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM DHE FUQIPLOTË

2013 - 2015

Kryetemë:

Deviza ime diplomatike në Londër:

"Jo forca e parasë, as madhësia numerike e popullsisë së një vendi, as forca ushtarake dhe agresiviteti por pasuria shpirtërore, kontributi në kulturën e njerëzimit, virtyte dhe cilësi të veçanta këto, mund t'i bëjnë edhe kombet e vogla të duken interesante. Që kjo të bëhet sa më mirë duhet që të gjithë faktorët e interesuar për progresin e një kombi të bashkëveprojnë. Dhe mbi të gjithë qëndron Diplomacia, ajo publike, kulturore, promovuese."

Sipas, "Soft Power" të prof. Joseph Samuel Nye, Universiteti Harvard, SHBA

AMBASADOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE, IRLANDËS SË VERIUT DHE REPUBLIKËS SË IRLANDËS

Më 28 shkurt 2013, Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh.T Z. Bujar Nishani, dekretoi emërimin tim si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës. Pas kësaj, duhej njoftuar Madhëria e Saj Mbretëresha Elizabeth II nëpërmjet të Foreign Office-t. Nuk vonoi shumë dhe Marshalli i Mbretëreshës, z. Charles Grey, më njoftoi për audiencën që do të kisha me Madhërinë e Saj, e cila do të ndodhte më 27 qershor 2013.

Forca e pushtetit të butë – (Soft Power)

Përvoja e deriatëhershme jo vetëm në fushën e marrëdhënieve diplomatike, konsullore, rajonale por edhe në një fushë tjetër shumë të rëndësishme, siç është Diplomacia Publike apo ajo Kulturore sa në Stamboll, sa jashtë shërbimit dhe aq më shumë gjatë shërbimit të deriatëhershëm në Londër, më kishte shtyrë drejt njohjes së një teorie të re filozofike të njohur si Forca e pushtetit të butë, - Soft Power. Prej shumë kohësh isha dhënë me pasion pas teorisë së profesorit harvardian Joseph Nye, e quajtur "Soft Power". Nuk e di a do t'i shkonte përkthimit të këtij termi " Pushteti i butë", por në të vërtetë kjo teori ka të bëjë pikërisht me atë që kombet e vogla mund të bëhen simpatike përpara botës, nëse dinë të demonstrojnë ato vlera, që i bëjnë ato interesante.

"Jo forca e parasë, as madhësia numerike e popullsisë së një vendi, as forca ushtarake dhe agresiviteti, por pasuria shpirtërore, ndihmesa në kulturën e njerëzimit, virtyte dhe cilësi të veçanta këto, mund t'i bëjnë edhe kombet e vogla të duken interesante. Që kjo të bëhet sa më mirë duhet që të gjithë faktorët e interesuar për progresin e një kombi të bashkëveprojnë. Dhe, mbi të gjithë, qëndron diplomacia, ajo publike, kulturore, promovuese."

Kjo kishte qenë deri atëherë motoja e veprimtarisë sime në shërbimin diplomatik.

Gjeta rastin ta vizitoja dhe ta takoja profesor Joseph Nye-in dhe t'i tregoja se si e kisha zbatuar teorinë e tij të " Pushtetit të butë" në veprimtarinë time si përfaqësues i shtetit shqiptar.

Atëbotë profesor Nye më priti në zyrën e tij në Kennedy School of Government, në Cambridge. Me mua ishte edhe im bir Kreshnik Berisha, i cili kryente master në filozofi dhe shkenca politike po në atë shkollë.

Profesor Nye më priti me shumë respekt. Ai e kishte vizituar Shqipërinë në pozitën e zëvendës-Sekretarit Amerikan të Shtetit për Mbrojtjen, gjatë mandatit të Presidentit Bill Clinton dhe dinte shumë për vendin tonë. Ai kishte kontribuar për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. U interesua shumë për mbarëvajtjen e punëve, çështjet politike, kushtetutën. Më pas u interesua për Kosovën dhe dinte me hollësi çfarë ndodhte tek ne. Më pas donte të dinte për shqiptarët e Maqedonisë dhe "prirjet unifikuese të shqiptarëve në Ballkan".

Pastaj u përqendruam në bisedë te të drejtat e shqiptarëve në Mal të Zi dhe Serbi.

Për të gjitha këto, natyrisht që i dhashë këndvështrimin shqiptar të trajtimit të secilit problem, me theks te roli që luan Shqipëria në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe paqes në Ballkanin e gatshëm përherë për konflikte. Profesori donte të dinte për aspiratën shqiptare për bashkim të të gjitha trojeve. Një interesi të tillë iu përgjigja se si vëllezër të një gjaku dhe të një race e gjuhe, do të dëshironim të ishim të bashkuar, por shqiptarët janë të vetëdijshëm se një sipërmarrje e tillë sjell shumë trazira në Ballkan e megjithatë, ne ende vazhdojmë të besojmë te projekti i Bashkimit Evropian ku do të jemi të bashkuar dhe anëtarë të denjë.

"Çdo shqiptar që jeton në gjashtë shtetet ballkanike, në trojet e veta etnike, dëshiron të ndihet i barabartë dhe të gëzojë të drejtat kombëtare që i takojnë",

– i thashë profesorit.

Ajo pjesë e bisedës me profesor Nye-in rreth teorisë së tij të "Pushtetit të butë" ishte shumë interesante. Pashë që zbatimi i asaj teorie në praktikën dhe përvojën time diplomatike ishte në përputhje me tezat e Profesorit. Harmonia fetare, aq e dëshiruar sot, figurat e shquara që kombi shqiptar i ka dhënë botës, katër Papë, Skënderbeun, burrështetasit shqiptarë në botë, si Muhamet Aliu i Egjyptit, Francesko Krispi, roli i shqiptarëve në revolucionin grek, Nënë Tereza, Besa dhe ndihmesa që shqiptarët iu dhanë hebrenjve gjatë gjithë historisë dhe veçanërisht gjatë Holokaustit etj., ishin të mjaftueshme për të dëshmuar përputhjen e teorisë me praktikën e punës në diplomacinë e një vendi si yni.

Ndoshta profesori, i cili beson te teoria e tij, u ndie po aq i lumtur me zbatimin e atyre tezave sa unë që isha përpara atij njeriu të madh të shekullit tonë.

Në ikje ai më dhuroi librin e tij "The Soft Power" me autograf.

Tani teoria e "Pushtetit të butë" do të përdorej për zbatim në një pozitë të re, atë të ambasadorit. Promovimi i vlerave të kombit tonë kishte filluar vite më parë, por tani do të evidentohej shumë më shumë që nga takimi me Madhërinë e Saj, Elizabeth II e në vazhdim deri në fund të këtij misioni fisnik e atdhetar.

BUCKINGHAM PALACE - NGA DËBIMI NË SHPËRDHET TEK MBRETËRESHA ELIZABETH!

Agimi i ditës 27 qershor i vitit 2013 do të ishte ndër mëngjeset më të rëndësishme, më interesante dhe më të bukura të jetës sime. Ishte dita kur do të paraqisja letrat kredenciale para monarkes më të vjetër të botës në moshë dhe në detyrë, Madhërisë së Saj, Elizabeth II. Mbi rrotat e karrocës mbretërore britanike po kaloja rrugëve të Londrës me barrën e kujtimeve të ngjarjeve, që më kishin sjellë deri aty, me vështirësitë, sakrificat, arritjet dhe sukseset, pse jo ndonjëherë edhe dështimet. Pranë meje kisha njeriun tim që nuk më la asnjëherë vetëm, sado e vështirë apo e bukur të ishte jeta: Donikën, me të cilën e kishim lidhur jetën që prej vitit 1978.

Kthim në kohë:

Nga dëbimi në Shpërdhet për te Mbretëresha Elizabeth!

Në gushtin e vitit 1966 im atë, në një moment dobësie prindërore, nën hijen e arrës pranë një kroi të freskët malor në fshatin Ahmataj, më pat thënë: - "Je djalë i vogël, por ja se ndodh që rrethanat t'i rritin fëmijët para kohe. Shumë shpejt t'i mund të mbetesh jetim, sepse një kurth i pabesë i Sigurimit të Shtetit është duke u ngritur kundër meje. Dhe nëse kjo ndodh, me shumë gjasë, jeta ime mund të shkojë dhe ju do të mbeteni jetimë. Unë kam dy vëllezër këtu, dhe do të kujdesen për ju. Atë të arratisurin nuk e numëronte dhe as nuk e zinte në gojë kurrë. Ju jeni tre fëmijë dhe ty të ka qëlluar të jesh i pari. Prandaj do të lë amanet të kujdesesh për vëllain dhe motrën.

Vëllai ishte dhjetë vjeç, ndërsa motra gjashtë vjeçe. Atë ditë u trishtova. Babai më fshiu lotët dhe më dha kurajë.

"Jetojmë këtu, ku jeta e njeriut është në nishanin e vdekjes", - më tha, - "edhe nëse nuk ke bërë ndonjë të keqe. Thjesht nëse dikush në rrethin tënd familjar mund të ketë bërë një gabim. Por do t'ja dalim!"

Ai kurth u ngrit, por kur dështoi dhe jeta e babait tim shpëtoi, ndaj nesh u zbatua një masë tjetër:

Dëbim politik!

Për shkak të atij dështimi, dhe sikur të mos mjaftonin vështirësitë, që i jetonin të gjithë bashkëmoshatarët e mi, afërsisht një muaj pas asaj bisede, në mbrëmjen e 24 shtatorit të vitit 1966, shteti i kohës na detyroi të xhvendoseshim me forcë, neve dymbëdhjetë anëtarëve të familjes, me një kamion me karroceri, nga ato që u hapen dhe u mbyllen spondat dhe ndejtëset anësore për ushtarët, që shkonin në frontin e Luftës së Dytë Botërore. Ishim katër fëmijë, pesë gra dhe tre burra. Pas dymbëdhjetë orësh udhëtimi, pasi na tundi e na shkundi kthesave të rrugëve të pashtruara të Shën Mërisë dhe Qafës së Malit, Gjegjanit të Pukës dhe Shën Palit të Mirditës, pasi na dërrmoi fizikisht e na shkatërroi shpirtërisht, makina na lëshoi buzë rrugës së një vendi, që asnjëherë në jetë nuk ia kishim dëgjuar emrin:

Quhej Shpërdhet.

Po vija pra nga një udhëtim i largët:

Nga dëbimi në Shpërdhet për te Mbretëresha Elizabeth!

Atë ditë do të takoja njërën prej legjendave të politikës botërore, atë që ka qëndruar në fron më shumë se askush tjetër në historinë e njerëzimit, një ndër personalitetet më të respektuara në botë, Madhërinë e Saj, Mbretëreshën Elizabeth II. Do të realizoja një ëndërr, që e kanë aq shumë njerëz në këtë botë, por pak prej tyre e arrijnë, dhe akoma më pak janë ata që e realizojnë në kushtet si ato në të cilat do ta takoja unë.

Çfarë kontrasti!?

U vesha me *morning coat*, me frak të zi dhe pantallona gri me vija, këmishë të bardhë me jakë të veçantë. Përgatitjet për atë ditë kishte kohë që kishin filluar. Jo vetëm unë, por një grup prej pesë zonjash do të më shoqëronte në këtë ngjarje kaq të rëndësishme të jetës sonë, si ekip. Secila ishte përkujdesur më shumë se tjetra për t'u paraqitur sa më serioze por edhe elegante. Në traditën

e pritjeve të Mbretëreshës, e cila atë vit mbushte 61 vjet në krye të Monarkisë së Saj, çdo gjë bëhej sipas një protokolli të rreptë dhe të mirëpërgatitur në çdo aspekt. Ishte ditë e bukur me diell, kur rrugët e Londrës mbushen me njerëz, të cilëve ky lloj moti iu mungon jashtëzakonisht shumë.

Mbretëresha Elizabeth II në një përshkrim shumë të shkurtër

Mbretëresha Elizabeth II, ka lindur më 21 prill 1926 dhe e ka marrë Fronin Mbretëror më 6 shkurt 1952, ose më mirë të them, shtatë muaj përpara se të lindja unë. Unë pata nderin të merrja pjesë në festimet e "Jubileut Diamand" në vitin 2012. Tani kur po botohet ky libër ajo është 95 vjeç, ka 4 fëmijë, tetë nipër e mbesa dhe pesë stërnipa e stërmbesa. Ajo është stërmbesa e 32-të e Mbretit Arturi i Madh, i cili ka qenë Mbreti i Anglisë në vitin 871 - 899, dhe është mbretëresha, që ka jetuar më gjatë në Dinastinë Angleze. Në vitin 2015 ajo la pas edhe Mbretëreshën Viktoria, e cila ka sunduar plot 63 vjet, që nga viti 1837 deri në vitin 1901. Mbretëresha është e martuar me Princin Filip, Duka i Edinburgut, i cili këtë vit do të mbushte 99 vjeç.

Në Ambasadë duke pritur karrocat mbretërore

U mblodhëm në Ambasadë dhe bëmë një bisedë të këndshme me njëri- tjetrin në pritje të ardhjes së shoqërueseve mbretërore me kuaj dhe karroca. Pastaj bëmë fotografi brenda dhe jashtë ambasadës. Nuk vonoi dhe në rrugën St. George u dëgjuan trokëllimat e dy baterive me kuaj të Mbretërisë të shoqëruar nga Marshalli i Pallatit Mbretëror, z. Charles Grey. Ai ishte veshur me kostumin e tij tradicional, zyrtar, me kapelen me pupla me veshë shumë të gjerë që të kujtonte kohërat e hershme të Mbretërisë. Karrocat erdhën dhe u ndalën përpara ambasadës në ndërtesën me numër 33. Siç e donte puna, njëra karrocë ishte e caktuar për çiftin ambasadorial, ndërsa e dyta për personelin e ambasadës. Me një delikatesë të papërshkrueshme, gardianët e Mbretërisë na ndihmuan të hipnim në karroca, duke hapur e mbyllur shkallët portative dhe kthyer dyert në pozicionin e duhur.

Rrugëve të Londrës në një parakalim mbretëror

U nisëm bashkë me trokun karakteristik të hapave të kuajve nëpër sokakët e Westminister-it, në Londër. Ecëm nëpër rrugën Warwick, kaluam në Vauxhall Bridge Road, u kthyem në Viktoria dhe u drejtuam për te Buckingham Gate. Aty arritëm te nyja kryesore përpara Pallatit Mbretëror Buckingham. Një nga gjërat, që e bënte atë ditë edhe më të bukur ishte fakti që në atë orë mesdite, në atë mot të bukur, nën ato rreze dielli shndritëse, në atë peizazh mahnitës ku spikatnin lulet, pemët, shpendët, kompleksi madhështor monumental Viktoria Memorial, përpara Pallatit, fasadat dhe veprat e pafund të artit skulpturor, gëlonin mijëra e mijëra turistë të huaj, të cilët kapnin me kamerat e tyre digjitale çfarëdo që atyre u vinte për mbarë dhe që ishte e veçantë në atë udhëtim të tyre. Ndodhi që edhe udhëtimi ynë 'kalorsiak', me katër kuaj pararojë dhe katër praparojë, me dy karroca me nga dy kuaj me ushtarë të gardës mbretërore me kostumet e kuqe dhe kapelet e zeza të ngjeshura në kokë, të gjitha të përbënin diçka nga e veçanta e asaj dite edhe për ata turistë, që spontanisht gjendeshin aty.

Ndërsa po udhëtonim drejt Pallatit Mbretëror, bëmë një bisedë shumë të këndshme me Marshallin e Mbretërisë. Ai kishte shumë dijeni për Shqipërinë. Kishte lexuar dhe ishte në gjendje të fliste me një kompetencë prej historiani për vendin tonë, veçanërisht për periudhën e mbretërisë. Disa kohë më parë i kisha dhuruar librin, "*Lindja e Shqipërisë*" e autores Nicola Guy, vënë në qarkullim nga shtëpia botuese IB Tauris, për nder të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së vendit tonë. Ne e patëm përuruar atë libër në ambasadë më 16 maj 2012. Charles Grey ma kujtoi atë dhuratë si nder që i kisha bërë dhe më tregoi se e kishte lexuar dhe ishte shumë i lumtur për këtë.

Historia e karrocave mbretërore, me të cilat udhëtuam atë ditë

Marshalli filloi të më tregonte për historinë e karrocave që po na transportonin.

"Këto karroca", - më tha, - "janë shumë të vjetra. Tani kanë mbushur 160 vjet, që përdoren. Riparimi i tyre bëhet vetëm nga mjeshtra të veçantë, por tani kemi vështirësi, sepse pak kush pranon ose dëshiron të bëjë punë të tilla pasi

nuk ka më karroca përveç tonave të mbretërisë. Kjo na e vështirëson punën. Por ia kemi dalë deri tani".

Ndërsa po më tregonte këtë, unë e ndiqja me shumë vëmendje, respekt dhe simpati atë. Ai ishte i preokupuar për mirëmbajtjen e tyre.

Eh, çfarë hallesh kanë bota, thashë me vete! Nuk kanë para të ndërrojnë karrocat me të reja dhe as ustallarë për të riparuar të vjetrat!?

Me këto mendime në kokë ne po kalonim kangjellat e Pallatit Mbretëror nën vështrimin kureshtar dhe shkrepjet e mijëra blicave dhe aparateve fotografike të atyre njerëzve që atë ditë u gjetën atypari.

Brenda rrethojave të Buckingham Palace

Kaluam Portën e Madhe të Mbretërisë, nëpërmes kolonave deri sa karrocat ndaluan. Rojet mbretërore menjëherë zbritën dhe hapën dyert e tyre, ulën shkallët e vogla dhe ne zbritëm me kujdes të ndihmuar prej tyre. Neve na ngjante sikur po xhironim një film të kohës së Mbretëreshës Viktoria. Pastaj arritëm në vendin e duhur, u futëm në një sallë, e cila për nga bukuria nuk kishte as të krahasuar as të përshkruar. Gjithçka ishte fantastike dhe shkëlqente. Orenditë, pikturat, qilimat, të tëra, edhe pse të vjetra, dukej sikur ishin vënë sot. Dhe pikërisht në atë vjetërsinë e tyre fisnike shkëlqenin edhe më shumë. Ato ishin në fakt dëshmitare të ritualeve të tilla të ndodhura tashmë që prej 176 vjetësh, kohë kur Mbretëresha Viktoria u ngjit në Fronin Anglez në vitin 1837. Çfarë mrekullie! Takimi do të bëhej saktësisht në orën 12.00.

Ne kishim arritur gjashtë minuta para kohe. Fat i mirë, që nuk kishte asnjë vonesë në rrugë.

Në pritje me Mbretëreshën Elizabeth II

Ra ora. Një burrë i veshur me rroba të shërbimit mbretëror, të cilin unë e konsideroja si lajmësin e Shekspirit, i ra me një send të metaltë e të rrumbullakët tri herë një dere të madhe. Pas asaj dere u dëgjua një zë i hollë:

Hyr!

Menjëherë u hapën dy kanatat e dyerve nga dy mbretërorë të tjerë, që ishin brenda ndërsa lajmëtari thirri me të madhe:

"Madhëria Juaj! Ambasadori i Republikës së Shqipërisë!"

Përpara meje u shfaq ajo grua me shtat mesatar, me fytyrë të bardhë dhe të mbushur si kuleçë, me sy të mëdhenj, shumë të kaltër dhe shprehës, si të qelqtë, me një çantë në dorën e majtë, krejtësisht e thinjur, e veshur me një fustan shumë të bukur, ku spikaste ngjyra e gjelbër, dhe me qëndrimin e Saj mbretëror.

Dy tri ditë përpara atij takimi ne kishim bërë prova, njësoj siç bëjnë aktorët e teatrit. Siç isha instruktuar në ato prova, unë hyra me këmbën e majtë, avancova në atë mënyrë që të isha me hap të plotë tek rrethi përpara Madhërisë së Saj. Në dorën e majtë mbaja dosjen e letrave kredenciale. Ndalova pikërisht në atë vend ku isha dhe prita deri sa Ajo të më zgjaste dorën. Shtrënguam duart. Tani duhej recituar ajo formulë, për të cilën kisha bërë prova shumë herë:

> *"Madhëria juaj! Kam nderin dhe privilegjin t'ua përcjell Juve dëshirat më të mira të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani, për mirëqenien Tuaj dhe prosperitetin e vendit tuaj pasi jam veshur me fuqinë e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën Veriore. Ndërkohë dua të kthej edhe letrat kredenciale të paraardhësit tim të respektuar. Unë jam besimplotë se gjatë qëndrimit tim do të promovoj lidhjet shumë të forta të miqësisë dhe bashkëpunimit që ekzistojnë midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Faleminderit!"*

Recitimi i një formule të tillë në gjuhën angleze, përbën një ndër përgjegjësitë më të mëdha të një ambasadori, në atë çast solemn. Duhet thënë se Gjuha elitare Angleze, ndikohet shumë prej mënyrës sesi e flet atë Mbretëresha Elizabeth II. Për këtë ka edhe shumë studime që e pasqyrojnë atë zhvillim. Ajo gjuhë ndjek evolucionin e saj ndërkohë që pasurohet vazhdimisht edhe nga leksiku i Madhërisë së Saj. Për shembull, në një nga fjalimet e Mbretëreshës, në vitin 1992, kur në Familjen Mbretërore kishin ndodhur shumë gjëra të papëlqyera ajo tha:

"Viti 1992 nuk është një vit, kujtimeve të të cilit do t'i kthehesha me kënaqësi. Po të përdorja fjalët e njërit prej korrespondetëve të mi më të dashur,

ky vit u kthye në një *annus horribilis*."

Kjo fjalë ka si antonim fjalën *annus mirabilis*.

Shembuj të tillë, se si e folmja e Madhërisë së Saj ka ndikuar mbi Gjuhën Angleze janë të shumtë dhe shtriheshin deri atherë, në një hark kohor prej 60 vitesh. Ky moment më ktheu pas në kujtimet e hershme të marëdhënies sime me atë gjuhë.

Siç dihet deri në vitin 1990 çdo gjë kaloi si në gjendje somnambuli, mbushur me drojë dhe frikë. E ndërsa shumëkush mbase ishte pajtuar me atë fat të përgjumjes, mua diçka e brendshme më shtynte të mendoja se, edhe asaj etape të historisë së vendit tonë, do t'i vinte fundi. Dhe kur të vinte ai moment, duhej të ishim të përgatitur për një botë të re e të ndryshme.

Kisha shumë miq të mirë që më këshillonin, por njëri prej tyre më pat thënë dikur, kur më gjeti, gati si në "faj" mbi tavolinën time të punës një metodë të Gjuhës Angleze, "Essential English". Ai e pa dhe më pyeti:

"Po kjo...?"

"Hiç", - i thashë, - "ja, bëj ndonjëherë sikur kaloj ndonjë fjalë anglisht nëpër duar kur kam ndonjë libër si, për shembull, ky, "The Old Man and the Sea" (Plaku dhe Deti) i Heminguejt, të cilin e kam siguruar nga një botim kinez".

"Dëgjo!", - më tha miku im. – "Ju jeni punëtor dhe këtë e keni dëshmuar. Por unë do t'iu jap një këshillë: Të gjitha gjërat që ti i bën kaq bukur, i bën sot për sot. Mësimi i kësaj gjuhe është një punë, që ti e bën jo sot për sot, as sot për nesër: Sot për pasnesër! Një ditë do të më kujtosh!" Dhe doli nga zyra ime.

Frika e dyshimeve se mësimi i gjuhës angleze mund të merrej si ndonjë parapërgatitje për ndonjë aventurë, më bënte që ato libra t'i mbaja fshehtë dhe t'i përdorja vetëm në orët e vetmisë sime.

Të mësoje anglisht ndërkohë që punoje në fshat!?

Ajo gjuhë në fakt u bë arma ime më e rëndësishme e jetës së re, të asaj jete që solli demokracia në Shqipëri. Edhe atë ditë përpara Monarkes Britanike.

Gabimet e ambasadorëve përpara Mbretëreshës Elizabeth II

Çështja e dorëzimit të Letrave Kredenciale më ishte bërë si obsesion. E para, dëshiroja të mos bëja asnjë gabim, pasi gjatë instruksioneve që më bënë në

Protokollin Mbretëror më thanë:

"Mundohu të jesh sa më i saktë dhe i sigurt, por mos harro se asnjë ambasador nuk ikën pa bërë ndonjë gabim. Kështu që mundohu të mos bësh shumë gabime pa për ndonjë, edhe do të bësh!"

E dyta, më thanë se kishte qëlluar që një ambasador kishte shkuar të paraqiste letrat kredenciale, por kur kishte hyrë në sallën e dorëzimit të tyre dhe ishte prezantuar me Mbretëreshën, kishte vënë re se dosjen e kishte harruar në shtëpi. Mbretëresha kishte qeshur dhe i kishte thënë:

"Nuk ka gjë, mos u mërzit, dërgoji me postë ose dorazi me një diplomat të ambasadës suaj".

Kaq shumë më ishte ngulitur kjo gafë sa edhe pse i kisha në dorë letrat kredenciale gjatë udhëtimit në karrocë, më dukej sikur i kisha harruar.

Dialogu me Mbretëreshën Elizabeth II

Tani që i hoqa letrat nga dora, prita që Madhëria e Saj të hapte bisedën. Pasi i mbaroi edhe Ajo fjalët e kortezisë, më tha se ishte e lumtur që shqiptarët tanimë jetojnë në liri se kanë shtet demokratik, se iu respektohen të drejtat e tyre dhe se e dinte dhe i vinte shumë keq që një popull i tillë kishte vuajtur aq shumë, sa në një regjim në një tjetrin. Shumë kohë nën otomanët e më vonë në luftërat botërore dhe regjimin komunist.

"Por tani", - tha Ajo, - "ju jeni të lirë dhe po bëni progres të madh drejt demokracisë dhe lirisë së vërtetë, sipas modelit perëndimor".

Pasi heshti pak, mua m'u dha mundësia, ta falënderoja Madhërinë dhe qeverinë e Saj për ndihmat e pakursyera, që i kanë dhënë popullit shqiptar në Shqipëri për kalimin nga një sistem i ashpër komunist në atë demokratik. I fola për zhvillimin dhe për ecurinë në vendin tim, dhe me kujdes i kujtova se asnjë anëtar i familjes mbretërore nuk e kishte vizituar ndonjëherë Shqipërinë, gjë që ishte si një farë kërkese diplomatike. E falënderova për ndihmën që Ajo dhe qeveria e saj i kishin dhënë Kosovës dhe popullit shqiptar atje, për t'u çliruar nga zgjedha serbe.

Ajo menjëherë reagoi dhe tha:

"Po. Edhe ata kanë vuajtur shumë, madje edhe më shumë. Por tani jeni të

lirë dhe kjo ka një domethënie të madhe, shumë të madhe".

Kështu po kalonin ato minuta, nga më të bukurat e jetës sime, por që m'u dukën shumë të shkurtra. Stresi, emocioni, një farë hutimi, që më kishin kapur përpara se të futesha, tanimë ishin larguar tërësisht dhe ndihesha sikur njiheshim që prej shumë kohësh.

Lahuta në filigramë e "Pirros" në Koleksionin Mbretëror Britanik

Pas kësaj Madhëria e Saj, më tha:

"Ambasador, ju më keni sjellë një dhuratë shumë të bukur. A mund të më thoni se çfarë përfaqëson kjo?"

Ajo u kthye në anën e majtë të asaj ose të djathtën time dhe më tregoi një tripod mbi të cilin gjendej një kornizë me blu të thellë, në të cilën gjendej imitacioni i një lahute shqiptare e bërë prej filigrani, të cilën e kisha porositur enkas për t'ia dhuruar Madhërisë së Saj. Unë ia kisha dorëzuar Marshallit atë dhuratë disa ditë përpara takimit. Pasi më falënderoi më kërkoi të shpjegoja se çfarë ishte ajo.

Atë dhuratë e kisha porositur në Tiranë në Argjendarinë "Pirro". Mjeshtri e kishte punuar plot kujdes e mjeshtëri, pikërisht për Mbretëreshën Elizabeth II. Tani duhej të shpjegoja se si kjo ishte një vegël muzikore, e imituar në filigramë, e cila personifikon instrumentin, me të cilin shqiptarët kanë përcjellë traditën e tyre brez pas brezi në mënyrë gojore. Ajo, si në kohërat e lashta homerike, ka qenë vegla muzikore, me të cilën janë kënduar heroizma, por edhe vaje, dhe në traditën shqiptare përbën atë që, ju e quani bard këtu në Angli, ndërsa tek ne janë rapsodët. Ndërsa po i shpjegoja, ajo vazhdonte ta shihte lahutën e pastaj u kthye dhe më tha:

"A nuk është një mrekulli, a nuk është një gjë kaq e bukur? Faleminderit, faleminderit!"

Pesë zonja shqiptare në takim me Mbretëreshën Elizabeth II

Ndërsa bisedës me Madhërinë e Saj po i vinte fundi, ajo më tha se donte të

takonte pjesëtarët e personelit tim. Dera u hap dhe në kolonë ishin pesë zonjat.

E para ishte dr. Teuta Starova. E veshur shumë bukur, me kapele në kokë, ajo bëri hapat e duhur, bëri një përkulje elegante dhe iu afrua Mbretëreshës. Ajo i zgjati dorën, e përshëndeti, e pyeti për punën që bënte, a kishte fëmijë dhe ajo u largua sipas protokollit të paracaktuar.

Pastaj erdhi zonjusha Entela Gjika, e veshur po ashtu shumë bukur, përparoi deri te "rrethi i Mbretëreshës", bëri përkuljen nderuese, shtrëngoi duart me të dhe u largua. Të njëjtën gjë bëri edhe e treta, që quhej Greta. Më pas i erdhi radha njërës nga punonjëset më të kulturuara, më të talentuara më të zgjuara dhe më të vëmendshme, që kam njohur në diplomaci. Ajo vinte nga një familje intelektualësh, kishte mbaruar në Durrës shkollën e mesme, pastaj kishte studiuar në Itali në Universitetin "La Sapienza" dhe ishte martuar me një mjek italian. Quhej Xhoana dhe vërtet ishte siç është ajo kënga amerikane "Xhoana". Kishte një vajzë të vogël, Anja, që ne e donim jashtë mase shumë. Erdhi, ashtu e ndrojtur, e veshur sa s'ka më bukur, me një kapele superelegante të vënë në njërën anë të kokës, bëri përkuljen nderuese, i tregoi Mbretëreshës për Anja-n e saj të vogël dhe u largua.

Shqipëria vend i emancipuar - Zonjat te Madhëria e Saj

E fundit do të vinte bashkëshortja ime, Donika. Si përherë, e qetë, jo pa emocion, pakëz e ngadaltë, por shumë e vendosur, me një rrobë, që do ta kishin lakmi edhe princeshat në oborrin e Mbretëreshës. Ajo u përkul lehtë. Ende pa filluar bisedën me të, Mbretëresha më tha:

Ambasador, po ju e paskeni tërë personelin me gra! A nuk keni burra ju aty?

Kështu është personeli ynë, me zonja, i thashë, - gjë që tregon se sa e emancipuar është Shqipëria sot.

Keni shumë të drejtë, - më tha. - Bravo! Ju përgëzoj për këtë!

Pastaj Mbretëresha vazhdoi me pyetjet për Donikën.

Sa fëmijë keni? Ku janë? A kanë bërë shkolla? Çfarë të pëlqen më shumë në Londër?"

Pasi i tregoi për fëmijët, Donika i dha një përgjigje, që Mbretëreshës i pëlqeu shumë.

Mua, këtu më shumë se çdo gjë më pëlqen kujdesi që bën qeveria e Madhërisë Suaj për edukimin e fëmijëve dhe veçanërisht kur shoh se si tërë muzeumet janë me hyrje të lirë, që u lejojnë atyre të marrin edukim pa pagesë, për artin dhe kulturën.

Mbretëresha qeshi, gati e përqafoi Donikën, gjë që ishte jo e zakontë, e falënderoi për këtë konstatim kaq të thjeshtë, por kuptimplotë dhe…

Këtu u mbyll edhe biseda jonë. U tërhoqëm ngadalë dhe dolëm nga ajo sallë mbretërore me kujtime të paharrueshme.

Hipëm përsëri në karroca, sipas ritualit mbretëror, dhe dolëm me trokun e kuajve nëpërmes oborrit të pallatit mbretëror. Në rrugë kishte mijëra turistë, të cilët vazhdonin punën e tyre me aparatet fotografike, kamerat, lëvizjet kaotike. Blicat nuk pushonin së "godituri" mbi ne, sado që ata mijëra njerëz as që dinin se cilët ishim ne, që hymë dhe dolëm në atë pallat mbi ato karroca mbretërore.

"Paradë nëpër qytetin e Londrës"

E lamë turmën përpara Monumentit Viktoria dhe u drejtuam drejt Sheshit Trafalgar. Kaluam Portën e Madhe, të quajtur Harku i Admiralit, e ndërtuar në vitin 1911 nga Sir Austin Web, një hyrje dhe dalje madhështore, që të çon dhe të nxjerr nga Pallati Buckingham. Pastaj morëm poshtë për në White Hall për t'u ndalur përpara hotelit, ku do të na ofronin atë që njihet si *vin d'honneur* ose Vera e Nderit. Kjo gotë verë ofrohet për miq shumë të nderuar, në raste shumë të veçanta si ky rast i letrave kredenciale.

Sipas traditës, para se të largoheshin, unë iu dhashë kuajve të hanin racionin e tyre të karotave, të cilat i kishim blerë që përpara. Ata ishin mësuar të hanin karota në çdo rast të tillë dhe unë duhej t'ua jepja me kujdes me dorën time, në mënyrë që mos t'u ngeleshin nëpër dhëmbë.

VIN D'ONOR OSE VERA E NDERIT

U përshëndetëm me personelin mbretëror të shërbimit të asaj dite dhe hymë brenda në hotel me tërë miqtë e ambasadës, lordë, ambasadorë, parlamentarë, shkrimtarë, aktivistë, të cilët kishin ardhur për të festuar bashkë me miqtë e shokët tanë nga bashkësia shqiptare. Pasi të gjithë të pranishmit morën në dorë gotat e verës, ngrita dollinë e rastit për shëndetin e Mbretëreshës. Përfaqësuesja e Oborrit Mbretëror po ashtu ngriti dolli për Presidentin tonë. Pas kësaj më duhej të mbaja edhe një fjalim të shkurtër. Kjo ishte një rutinë, por që në fakt duhej bërë me shumë kujdes, pasi sytë e më shumë se njëqind e njëzet pjesëmarrësve ishin drejtuar tek unë. Në disa raste të tilla kisha vënë re se disa ambasadorë flisnin për gjëra krejt pa interes si, për shembull, për shëndetin e Mbretëreshës.

Veç fjalëve të përgjithshme të fillimit m'u kujtua një histori e rinisë sime, e cila ishte pak a shumë si kjo që e tregova aty:

"Kur isha nxënës në gjimnaz, kisha shkrim të bukur dhe nënshkruaja po ashtu bukur. Shoku im i ngushtë, Danieli, më thoshte:

"Sa të bukur e ke nënshkrimin! E ke aq të bukur sa mund të them se ke firmë diplomati. Po, po, ti do bëhesh diplomat! Do të bëhesh diplomat, madje një ditë do të takosh edhe Mbretëreshën e Anglisë".

Ai predikim i shokut tim të rinisë, në kohën kur as që mund ta ëndërroje një gjë të tillë, sepse përbënte rrezik për jetën, u bë realitet. Ishte një ëndërr, që nuk ishte guxuar të shfaqej për njëzet vjet, që nga koha kur e përmendte Danieli, në vitin 1970. Dhe ja, pas 43 vjetësh, më 27 qershor 2013 kisha fiksuar foton me Mbretëreshën Elizabeth II të Britanisë së Madhe".

The dream comes true!

Lum kush të rrojë!

HISTORIA E VENDOSJES SË BUSTIT TË SKËNDERBEUT NË FSHATIN MUNXHUFUNI NË ZONËN ARBËRESHE, MOLISE REGIONE, ITALI

Si lindi ideja për një bust të Skënderbeut në fshatin arbëresh Munxhufun (Montecilfone) - Molise Regione - Itali?

Siç është thënë më sipër në këtë libër, më 28 nëntor 2012, ditën e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, bashkë me bashkatdhetarët tanë në Britaninë e Madhe, e vendosëm bustin e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Aty, përveç shqiptarëve dhe britanikëve ose shqiptaro - britanikëve, kishin ardhur edhe arbëreshë. Midis atyre, të cilët festuan me madhështi vendosjen e bustit ishte edhe një vajzë italiane me zanafillë arbëreshe. Ajo pas inaugurimit më përshëndeti dhe më tha me një shqipe me theks të fortë italian:

> *"U jam Mavi, Mavi Victoria. U fjas arbërisht. U jam italiane. Si je mirë? U jam mirë. U fjas arbërisht më shpi me nona, tata dhe mama ime".*

U habita dhe këmbëngula të mësoja nëse ishte arbëreshe përderisa fliste shqip. Ajo ishte arbëreshe nga Munxhufuni (*Montecilfone*), fshat në rajonin e Molises të Italisë. Mbarova bisedën me të dhe u ndamë me shijen që të lë përherë kënaqësia kur dëgjon një të huaj që flet gjuhën e nënës sate dhe premtimin që do të shiheshim shpejt. Disa javë më vonë mora një e-mail prej Mavit, ku më kërkonte ta prisja në ambasadë. Ashtu ndodhi. Erdhi dhe më habiti kur pashë që më kishte sjellë një revistë të botuar nga Bashkia e Molises, ku gjendej edhe një

foto e imja të cilën ajo e kishte gjetur në fshatin e saj arbëresh. Ishte një foto e bërë bashkë me Ambasadorin tonë të atëhershëm në Romë, z. Llesh Kola, kur emëruam Konsullin e Nderit të Shqipërisë, Dr. Savine Cannone. U gëzova pasi, për hir të vërtetës, nuk e kisha parë atë foto ndonjëherë. Ajo më solli edhe disa DVD, broshura dhe fjalorë më fjalë të gjuhës shqipe në variantin e saj arbëresh, që i përdornin në Itali.

Konsulli ynë i Nderit, ishte Drejtori i Spitalit "Gemeli" në Campobasso, dhuratë për atë zonë e Papa Gjon Pavlit II. Papa ua dhuroi atyre banorëve atë spital pasi doktori që e shëroi atë, pas atentatit të kryer nga Mehmet Ali Aga, ishte nga ajo anë. Por asnjëherë nuk më kishte shkuar mendja se një ditë do të shkoja me një mision tjetër në atë zonë. Ishte pikërisht Mavi, që do të më nxiste ta bëja këtë.

Gjatë bisedës në zyrën time në ambasadë ajo më tha se në fshatin e saj kishte mbi treqind vjet që ekzistonte një shesh me emrin "Skënderbeg", por Skënderbeg aty nuk kishte pasur asnjëherë. Prandaj m'u lut, në emër të bashkëfshatarëve të saj arbëreshë, që ta ndihmoja që aty të vendosej një bust i heroit. Ajo kishte biseduar me kryetarin arbëresh të Bashkisë z. Franko Pallota. Por, natyrisht që kërkonte ndihmën tonë për të bërë një bust si ai i Londrës dhe ta vendosnim në sheshin kryesor të fshatit.

Menjëherë u vura në lëvizje dhe brenda pak ditësh komunikova me autorin e bustit të Londrës, skulptorin Kreshnik Xhiku, ndërsa sponsorizimin ia kërkova pronarit të firmës "Kastrati", z. Shefqet Kastrati, nëpërmjet të birit Leonardit. Ata e pranuan me bujari kërkesën time dhe kështu u zgjidh edhe puna e veprës artistike. Me organizimin e ceremonisë u mor arbëreshja Mavi Victoria D'Inzeo, diplomatja jonë dr. Xhoana Papakostandini dhe kryetari i Bashkisë z. Franko Pallota. Ne e ndiqnim tërë procesin nga Londra në bashkëpunim me Ambasadorin tonë në Romë, prof. Neritan Ceka me zonjën e tij Angjelina Ceka - Luarasi.

Këtë radhë do të shkoja në Molise Regione për ta vendosur atë bust të Skënderbeut bashkë me vëllezërit tanë arbëreshë, autoritete vendore italiane, Kryetarin e Bashkisë së Munxhufunit, Ambasadën tonë në Itali, diplomatë të ambasadës sonë në Londër dhe në Romë, si dhe me Konsullin tonë të Nderit në Campobasso. Natyrisht që Mavi Victoria D'Inzeo me familjen e saj përfshirë edhe gjyshen, siç e thërriste ajo - Nona, 90-vjeçare do të ishin të parët.

Përurimi i bustit të Skënderbeut në Munxhufun, më 4 gusht 2013

Busti u vendos me një ceremoni shumë të bukur, më datën 4 gusht 2013. Fshati Munxhufun është një prej 52 fshatrave arbëreshe të Italisë Jugore. Të vendosur aty pas thyerjes së qëndresës së shqiptarëve ndaj turqve, me vdekjen e Skënderbeut, banorët arbëreshë i kanë ruajtur mrekullisht gjuhën, traditat dhe zakonet shqiptare, deri në ditët e sotme. Busti u vendos në praninë e autoriteteve rajonale dhe vendore, të një numri të madh pjesëmarrësish arbëreshë dhe italianë, si edhe të shqiptarëve të emigruar drejt asaj zone në ditët tona. I pranishëm ishte Ambasadori i RSh-së në Itali prof. Neritan Ceka me zonjën e tij. Gjithashtu, morën pjesë Princi Georgio Maria Castriota Scanderbeg, person që pretendonte se ishte një nga pasardhësit e familjes Kastrioti. Ishin edhe konsujt e nderit të Shqipërisë në Molize, prof. Savino Cannone, Vincenzo Cannone në Kalabri dhe Vincenzo Chimisso, në Brescia.

Ai bust qëndron krenar në atë shesh dhe i ka rezistuar edhe tërmetit të tmerrshëm, që goditi pak më vonë atë zonë të Italisë, duke shkaktuar shumë dëme por jo bustin.

Me Liliana Corfiatin dhe "Ibrahim Kodrën" në Këmarinin arbëresh të Molises

Në ditët në vijim kaluam nëpër disa fshatra arbëreshe, me radhë, duke filluar nga Këmarini (*Campomarino*), Porkatuni *(Portokanonne*) dhe Ruri (*Ururi*). Në Këmarin përjetuam diçka shumë të rrallë. Në fillim morëm pjesë në përurimin e një libri arbëresh. Pastaj ndoqëm një shfaqje shumë të bukur me muzikë arbëreshe të interpretuar nga disa vajza të veshura me kostume kombëtare, që këndonin këngë malli për Arbërinë. Ajo që na habiti më shumë në atë fshat arbëresh ishte dekorimi i tërë fasadave me piktura me subjekt nga eksodi i shqiptarëve drejt Italisë pas thyerjes së qëndresës së shqiptarëve ndaj turqve, pas vdekjes së Skënderbeut në shekullin XV.

Ato ishin vepra të një piktoreje, bijë e atij fshati, zonjës Liliana Corfiati.

Takimi me Lilianën ishte ndër ngjarjet më të bukura të atij udhëtimi.

Ajo e pranonte me krenari përkatësinë e saj arbëreshe dhe kishte filluar të pikturonte qëkur ishte fëmijë në fshat. Pas martesës ajo kishte shkuar në Milano dhe kishte punuar me mjeshtra si Aldo Fornoni dhe Luigi Reggianini. Temat e veprave të saj janë të larmishme, por pikturimi i fasadave të mureve të Këmarinit kanë qenë përparësia e krijimtarisë së saj. Aq i rëndësishëm është bërë arti i saj figurativ në atë fshat, saqë çdo vit mijëra turistë shkojnë dhe i vizitojnë ato katunde. Aty, përveç natyrës së bukur, ushqimeve të shijshme dhe bregdetit të pastër, njeriu gjen edhe pamjen e bukur të rrugicave me fasadat e pikturuara prej saj. Me këtë, ajo i ka bërë një shërbim të madh vendlindjes dhe ka përjetësuar në penel historinë tragjike të para-ardhësve të saj, arbëreshëve që kapërcyen detin nga ana tjetër, Shqipëria.

Në pikturat e saj pasqyrohet lidhja e fortë që ka ajo me traditat e vendlindjes së saj, si dhe dashuria e thellë për natyrën, të cilën ajo e konsideron mësuesen e saj të vërtetë, prandaj edhe synon të nxjerrë në pah këndet më joshëse: diellin, detin, erën dhe natyrën e bukur të Këmarinit, siç e quajnë arbëreshët atë fshat. Liliana merr pjesë me vepra në qendrat muzeale të artit Mediolanum, Forlanini Monluè dhe në jetën artistike milaneze. Në tematikën e saj të lidhur me atdheun e të parëve gjen vend edhe figura e Nënë Terezës. Piktorja Liliana Corfiati ka marrë pjesë në ekspozita vetjake dhe ka marrë vlerësime në qytete të ndryshme të Italisë dhe në vende të tjera jashtë saj. Punimet e saj gjenden në muze dhe koleksione prestigjioze private. Ajo ka realizuar piktura murale edhe në Barbavara dhe Muggiò.

Në një bisedë me Lilianën mësova se ajo paskësh qenë edhe mike e ngushtë e të ndjerit Ibrahim Kodra, kubistit shqiptar me famë evropiane, që jetoi për shumë kohë në Milano. Ajo më tregoi se, sa herë shkonte në Milano drekonin bashkë. Piktori i madh përherë merrte me vete kavaletin dhe bojërat dhe i vendoste në anën e djathtë të karriges së tij. Gjatë tërë drekës ai pikturonte portretin e Lilianës dhe, kur dreka kishte mbaruar, ai ia dhuronte asaj portretin e radhës. Liliana kishte njëzet portrete të tilla të bëra nga mjeshtri Kodra në kohëra të ndryshme. Ajo më tha se këto portrete i ruante si gjërat më të çmueshme të jetës. Kodra ishte dashamirës i jashtëzakonshëm i arbëreshëve.

"Njëherë, - thotë ajo, - Ibrahim Kodra na ftoi në shtëpi. Kur hyra aty rashë në një pamje të tillë, ku dukej se nuk kishte zonjë shtëpie. Ishte thjesht shtëpi

burri. Kishte shumë piktura, kavaleta, ngjyra, relikte, telajo, korniza, objekte të paorganizuara aq mirë. Në tavolinë kishte dhjetëra çeqe bankare të lëshuara nga blerës të pikturave të tij. Kur e pyeta, - thotë Liliana, - ai më tha se janë çeqe, por që 'nuk i kam dërguar në bankë pasi jam i zënë me pikturat'. "Im shoq", - thotë ajo, - "i cili është një bankier, i mori të gjitha çeqet, i kërkoi Kodrës që t'i nënshkruante, vajti në bankë, dhe i depozitoi. Mund të them se në ato letra - çeqe që preheshin në tavolinë, kishte një shumë të konsiderueshme të hollash".

Pas Këmarinit vajtëm në fshatin tjetër arbëresh Ruri, ose Ururi siç e quanin italianët. Aty u pritëm nga kryetari arbëresh i bashkisë, i cili na trajtoi miqësisht me prodhime vendase që nga reçelrat, glikotë, fiqtë dhe sa e sa ushqime të tjera. Tani do të vazhdonim për në jug, në fshatrat e tjera arbëreshe.

VIZITË NË QYTETIN ANTIK POMPEI DHE NË MAJËN E VEZUVIT

Pas përurimit të bustit të Skënderbeut, në Munxhufun, dhe vizitave në fshatrat e tjera arbëreshe të Kampobasos dhe Molisës, vendosëm të vijonim udhëtimin drejt jugut italian në ngulimet arbëreshe të Kalabrisë. Ndalesën e parë e bëmë në qytetin antik të Pompeit, tek ai vend, i cili kishte mbetur i mbështjellë dhe i fshehur nën hirin e llavës së Vullkanit të Vezuvit, që nga viti 79 i erës së re deri në shekullin e 17-të. Në guidën turistike të qytetit thuhej:

"Pompei është qytet romak në Campania të Italisë, 23 km në juglindje të Napolit, në anën juglindore të malit Vezuv, rreth 20 kilometra larg prej kraterit të vullkanit me të njëjtin emër. Rreth mesditës së 24 gushtit të vitit 79 të erës tonë, një shpërthim i madh nga mali Vezuv e lëshoi llavën mbi qytetin e Pompeit. Ndërtesat u shkatërruan, popullsia u përmbyt ose u asfiksua dhe qyteti u varros nën një shtresë të trashë hiri dhe shtufi. Për shumë shekuj Pompei flinte nën pluhurin e ngrirë të hirit, i cili ruajti në mënyrë të përsosur mbetjet. Kur u zbulua rastësisht, në vitet 1700, bota u habit prej atij qyteti të sofistikuar greko-romak, të ngrirë në kohë. Ndërtesat e mëdha publike përfshinin një forum mbresëlënës dhe amfiteatër. U zbuluan gjithashtu, vila të bollshme dhe të gjitha llojet e shtëpive, që datojnë që nga shekulli IV para erës së re. Brenda tyre u gjetën skelete njerëzish të ruajtura ashtu siç i kishte zënë shpërthimi. Të tjerë ishin të varrosur nën hi, ndërsa iknin. Nëpër furra u gjetën bukë siç ishin atë ditë. Gjetjet e mëvonshme aty zbuluan jetën e përditshme të botës antike dhe nxitën interesin e botës së shekullit të 18-të për t'i njohur të gjitha gjërat klasike".

Atë ditë nuk lamë as rrugë, as objekt dhe as amfiteatër pa vizituar. Ndërsa kalonim në udhëkryqet e rrugëve, tashmë të zbuluara tërësisht, ato të dëshmonin

projektet e mrekullueshme urbanistike antike të atij qyteti. Kryqëzimet e sotme të Avenuve me Rrugët e Manhatanit me siguri kanë kopjuar pikërisht atë model urbanistik. Amfiteatrot të mahnitnin me bukurinë e tyre e sidomos njëri, i cili kishte 25 mijë vende. Tek shëtisnim nëpër qytet, vazhdimisht ndeshnim në arkeologë me skatulla (lopatëza) në dorë, që gërmonin me kujdes për gjetje objektesh të tjera të pazbuluara. Skeletet e njerëzve, ashtu siç ishin varrosur atë ditë, gjendeshin në muzeun e qytetit.

Ditën tjetër u nisëm drejt majës së Vezuvit me një minibus të shërbimeve turistike. Kur arritëm në majë e shikonim që aty qytetin e Pompeit. Nga krateri i vullkanit dilte ende mjegull dhe tym vullkanik. Aty u sollëm rreth kraterit për rreth dy orë duke vështruar atë pamje magjepsëse me kureshtjen, habinë po (pse jo?) edhe frikën se në çdo çast mund të ndodhte ndonjë shpërthim i ri. Aty pamë atë gropë aq të madhe, e hapur nga shpërthimi, e cila mund ta përpinte Majën e Shkëlzenit tonë, po ta kthenim me kokë poshtë.

Në një çast meditimi për atë forcë të jashtëzakonshme natyrore, duke soditur që andej prenë e Vezuvit, Pompein, më erdhi në mendje një kontrast i madh midis forcave shkatërrimtare dhe historisë së tyre. Ishte një përsiatje se ashtu si Vezuvi shkatërroi Pompein, edhe në jetën e përditshme, ka njerëz të pajisur me forcë djallëzore, të cilët e shkatërrojnë jetën e njerëzve, pa u prekur aspak. Dhe kjo ka ndodhur dhe ndodh edhe sot, kur egoja e një njeriu shkatërron miliona jetë njerëzish vetëm që të mbetet në histori. M'u duk një krahasim shumë i gjetur dhe në iPodin tim, të cilin nuk e ndaj nga vetja, shkrova:

Vezuvi dhe Pompei

Atje lart, krater - tymosur, rri Vezuvi i menduar,
Sheh Pompein nën' vete, anë e mbanë hi - mbuluar.
Nuk e di vallë a të jetë: I mërzitur, i penduar,
Apo roje i viktimës, dhe të ndjehet i gëzuar?
Shekuj luftërash e rrënime,
Prapë do t'zhduknin dhe Pompeun,
Porsi Trojën dhe qytete,
Që e mbushnin mbarë Egjeun.

Thërret Pompei: O Vezuv!
A do duhej t'më varrosje, kaq të bukur si qytet?
Dhe të mbaje poshtë hirit,
Mrekullinë e botës vet?
I penduar, në tymnajë, flet Vezuvi hijerëndë:
E mjerë ishte ajo ditë, e tmerruar vaj e gjëmë.
Unë të gjallë vetëm dy mijë, vërtet poshtë i varrosa,
Por milionat nëpër luftëra n'ato kohë i griu kosa.
Dhe u zhdukën tërësisht, pa një shenje e pa një dokë,
Veç ca shkrime, tretur mbetur, mezi gjetur nënë' tokë.
Ndërsa ti, Pompe i dashur, dole paq nën' hi, pa tym,
Që të sillje deri sot, të paprishur preun tim.
Ajo ditë, zjarr e llavë, zllap prej flake të pushtoi
Me teatro, me statuja gjithçka hiri e mbuloi.
Për të ardhur te kjo ditë, pas aq shekujsh krejt harruar
Një qytet kaq' i bukur, për njerëzimin tash' zbuluar.
Vërtet, tmerr sa shumë të mbytur,
Të ngurosur, "balsamosur", poshtë atje rrinin nën' hi,
Qindra vite krejt siç ishin, mbetur shtypur,
Ngrirë, vdekur, syrgjynosur, brenda territ pis të zi.
Duhet vallë që të ankohesh frymë-zënë, o Pompe!?
Do shpëtoje vallë pa mua përmbi tokë' a përmbi Dhé!?
Dy mijë jetë, të gjallë t'i mora dhe i mbajta peng ndër shekuj,
Por një ditë jashtë dolën: Të pazhdukur, të patretur.
Mjer' ata që shkuan vanë, të varrosur në të gjallë!
Pa Vezuvin kësaj dite, do të ishin me ne vallë?
Jo se jo, kush ka jetuar në këtë botë përgjithmonë,
Tërë kanë vdekur, një pas një: një më herët, një më vonë.
E tillë qenka historia: Njëri vret e tjetri pret,
Njëri t'ngre tjetri të ul, një të zhduk nga bota krejt,
Një të nxjerr nga dhé i zi, tjetri n'dhe të fut' gjithmonë,
Tërë një fat do ta kemi: kush më herët, kush më vonë.

Është Vezuvi shkatërrimtar, a një lider çmendurak?

Që rrënon jetët e njerëzve pa ju dhimbsur hiç - aspak.
Strehë mbetet, e shkartisur, dëshmitare - historia,
Që mban mend edhe i shkruan - krejt të tyret marrëzira.

VIZITË NË KOZENCË TEK ARBËRESHËT

Pas asaj vizite mbresëlënëse në Pompei dhe në Vezuv, na priste një udhë e gjatë gati 300 kilometra drejt jugut të Italisë në fshatrat arbëreshe të Kozencës.

Në katundin arbëresh Çift (it. Civita)

Çifti është një katund i vendosur në mes të një lugine të rrethuar tërësisht me shkëmbinj. Në fakt, të duket sikur aty je në një hon të krijuar për të kujtuar Kështjellën e Krujës dhe atë të Ali Pashë Tepelenës së bashku. Nga ana tjetër sikur je në këmbët e Kështjellës së Rozafës.

Në Çift, tradita e respektit ndaj Skënderbeut vazhdon. Në hyrje, objekti i parë me të cilin ballafaqohesh është busti i Skënderbeut. Ne mes të fshatit gjënden dy piktura murale të mëdha, Muzeu i Katundit si dhe Kisha. Aty vërehet qartë tradita shqiptare e ndërtimit e kombinuar me atë të Italisë së jugut. Gëzim dhe krenari për vëllezërit e "*Gjakut tonë të Shprishur*" që e ruajtën identitetin në shekuj. Por kohërat kanë bërë që arbëreshët të ballafaqohen me plakje popullsie, largim masiv të rinisë, rënie drastike të lindshmërisë … Pikturat në fshat të kujtojnë dekorin e fshatrave arbëreshe në Rajonin e Molises.

Fshatrat arbëreshe, si edhe ato italiane të Kalabrisë, kanë një karakteristikë të përbashkët: Shtëpitë janë shumë afër me njëra-tjetrën. Rrugicat kalojnë nëpër korridore që gjarpërojnë pas çdo cepi shtëpie. Duket sikur nga ballkoni i katit të dytë mund t'i zgjasësh kafenë gjitonit. Dyert vijnë njëra pas tjetrës. Mjerisht, një numër i madh i atyre dyerve kishin vite që ishin mbyllur.

"*Njerëzia kanë ikur në perëndim". "Dikur" – na thotë një zonjë, – "ne i linim*

çelësat në derë dhe askush nuk merakosej për këtë. Por tani, tani jo…ka keqbërës që vijnë nga larg dhe na i rrëmbejnë gjërat nëpër shtëpitë tona".

Kalojmë mespërmes fshatit. Një rrap shekullor lëshon hije të rëndë dhe një çezmë freskon me ujin e vet të ftohtë. Më kujton rrapin e Libohovës dhe atë të Shën Vasilit në Sarandë. Aty janë grumbulluar burrat e fshatit dhe kuvendojnë arbërisht. Afrohemi dhe flasim me ta. Kemi vështirësi të kuptohemi, por jo se nuk merremi vesh. Pasi na pyesim se nga jemi dhe iu tregojmë që jemi nga Shqipëria, njëri prej tyre na thotë:

"*Ah mirë, mirë! Thamë se mos jeni nga Kosova. Ata nuk na kanë harruar asnjëherë*".

Pastaj përshëndetemi me një zonjë që ka dalë në ballkon. Ajo menjëherë na tregon që është arbëreshe dhe fshati është i tëri i populluar me arbëreshë.

"*Katundi"*, – na thotë ajo, – "*kishte pesë mijë vetë, por tani nuk jemi as tre mijë. Njerëzia po ikin*".

Ecim dhe shohim se në mes të fshatit gjendet kisha. Pranë saj ndodhet edhe muzeu etnografik.

Vizitë në "Muzeo Etniko Arbëresh" në Çift

Në katund të orientojnë tabelat: "*Këstjeli i Krujës*", "*Udhëtim Mëmëklisha*", "*Grykat e Rrakanjelit*", "*Ura e Djallit*", "*Muzeo Etniko Arbëresh*". I kalojmë të gjitha dhe vijmë tek muzeu. Hyjmë brenda dhe para nesh shfaqet një muzeum që të bën të ndalësh frymën. Ai është i mbushur me gjërat më përfaqësuese të arbëreshëve: Veshje popullore, qëndisje me dorë, vegla pune, libra, koleksioni i revistës "*Katundi Ynë*", botime, fotografi njerëzish të shquar, historira të fshatit. Muzeu funksionon që prej vitit 1970. Cicëroni na tregon dhe për kujdesin e treguar nga diplomatët shqiptarVisar Zhiti dhe Gerarta Zheji Ballo për studimet e fshatit. Dhimitri (*Demetrio Emmanuele*), botuesi i revistës, na citon në arbërisht:

> *"Kur isha i vogël gjith folëjin arbrisht. Edhe kushërinjët ka Kasana folëjin arbrisht,sepse e jëma cje Maria, ish çiftjote. Edhe sot, na miq, cë nëngë jemi aq trima, folëmi, me hir dashje, arbrisht. Edhe kur përpiqemi me miqtë ka Frasinta,*

ka Ungra, ka Spixana, ka Shën Mitri, ka Mbuzati, ka Strigari, edhe ka Picilia folmi arbrisht. Po trimat me ata më të voglit folëjin vetëm arbrisht."

"Bukë dhe Verë" arbëreshe në Shën Sofi (Santa Sofia d'Epiro)

Ndalemi në fshatin Shën Sofi (*Santa Sofia d' Epiro*). Aty menjëherë dallojmë dy gjëra shqiptare: Flamurin shqiptar përkrah flamujve italian dhe evropian, që valviten pranë e pranë në fasadën e kishës. Në krah të kishës gjendet një restorant mbi derën hyrëse të të cilit shkruhet në gjuhën shqipe:

Bukë dhe Verë.

Ndalemi dhe flasim me arbëreshët e klubit. Ndjejmë mikpritjen e njerëzve të gjakut tonë. Na ftojnë të pimë diçka të freskët. Njëri më thotë:

"*Eja me mua të shohësh Fjamurin tënë mbi kishë*"!

Dhe vërtetë ashtu ishte. Aty, në një dyqan të thjeshtë gjejmë edhe disqet e këngëve për arbëreshët të incizuara nga këngëtari shqiptar Lirio Nushi nga Vlora. Në njërën prej tyre thuhej:

"Askush nuk mund të më kthej nga rruga që jam nisur,
Askush nuk më ndalon dot të shkoj ndër arbëreshtë,
Atje më janë vëllezërit e mi të lashtë,
Atje më janë vëllezërit e mi antik,
Bijtë e arbërit me gjak të pashprishtë".

Pastaj njëri syresh, më jep një letër me një vjershë me dymbëdhjetë strofa të fotokopjuar në dy anët. Ai e konsideron atë si dhuratë të madhe dhe më thotë:

"*Unë quhem Angelo, arbërisht Engjëlli. Ky fshat ka patur Angelo Mascin. Merre këtë, e kam shkruar vetë".*

Më pëlqejnë veçanërisht vargjet e mëposhtme: Janë vargje nga vjersha e quajtur:

"Shënjtjes Vener"

Shënjtja Vener, vashë Hadhjare,
Gjith'o mir, gjith lipisjare;
Na të truhemi me lot
Ndihma neve Ti nga mot.
……
Ti ndëlona gjithë ftesën,
Zgjona mallin e rritna besën;
E kur të vinjë e sosmja dit,
Dil përpara e na prit.

Mikelanxhelo La Luna, studiuesi arbëresh i ditëve tona

Në vitin 2001 im bir, Kreshniku, studionte në Universitetin Rhode Island në SHBA. Një ditë, futet në klasë një profesor i ri dhe, pasi prezantohet, bën apelin e studentëve. Pasi i shkon listës një për një në rend alfabetik, ndalon tek shkronja "K" pra tek emri i Kreshnikut dhe i drejtohet atij në gjuhën shqipe:

- Kush është ky shqiptari këtu?

Djali, i cili nuk e priste që ai të kalonte nga gjuha angleze në shqip, stepet dhe nuk reagon. Ai e pyet përsëri:

- Kush është shqiptari këtu, apo nuk din shqip?

Kreshniku i përgjigjet:

- Jam unë!

Profesori e pyet se nga ishte dhe, kështu, në prani të studentëve amerikanë ai zhvillon një bisedë në gjuhën shqipe me Kreshnikun. Nuk vonoi shumë dhe kur shkuam për të takuar djalin, u takuam edhe me profesorin dhe kaluam edhe një darkë të këndshme. Ishte arbëreshi Mikelanxhehelo La Luna. Ai ishte bashkëfshatar i Jeronim De Radës dhe i profesor Francesco Altimarit. Që atëherë mbetëm miq me Mikelanxhelon dhe i kisha premtuar se do ta vizitonim Kolegjin e Shën Adrianit, Shën Mitër Koronën dhe fshatin e lindjes

së Jeronim De Radës, në Maqin arbëresh.

Kaluan vite të tëra dhe ja ku erdhi dita të udhëtonim drejt atij fshati të bekuar nga zoti, qendra embrionale e Rilindjes dhe Rimëkëmbjes së kulturës shqiptare. Profesor Mikelanxhelo na priti plot gëzim e dashuri vëllazërore. Ai na nderoi në kafen e qendrës së fshatit. Pastaj na udhëhoqi në një vizitë shumë interesante brenda Kolegjit, ku kishte mësuar dhe pastaj edhe kishte dhënë mësim Jeronim De Rada. Na përmendi shumë emra të shquar të kulturës sonë kombëtare, që kishin studiuar aty ndër ta, Imzot Feliçe Samuel Rodota, Mehdi Frashëri, Aleksandër Xhuvani, Jul Variboba, Zef Serembe, Luigj Gurakuqi, Avni Rrustemi, për të përmendur këtu vetëm disa prej tyre.

Në vitin 1732 Papa Klementi XII ngriti "Kolegjin Korsini" të Shën Benediktit për arbëreshët e Kalabrisë dhe, më pas, u ngrit Kolegji i "Shën Adrianit" në Shën Mitër Koronë, në vitin 1794.

Pikërisht këtu ishte edukuar edhe Mikelanxhelo la Luna, i lindur në vitin 1967 në atë fshat arbëresh. Pas kolegjit ai u diplomua në Universitetin e Kalabrisë dhe mbrojti tezën e diplomës me një studim mbi "Këngët e Milosaos" të Jeronim De Radës. Më pas ai e dha mësimin e gjuhës italiane në universitete me emër në Amerikë, si në Pitsburg, Harvard dhe Rhode Island. Në vitin 1997 ai u doktorua për Albanologji në Universitetin e Kalabrisë. Sot Mikelanxhelo La Luna konsiderohet si një nga njohësit dhe studiuesit më të mirë të jetës dhe veprave të De Radës. Ai është edhe poet dhe vargëzon në gjuhën origjinale të të folmes së Maqit e Shën Mitër Koronës me të gjitha veçoritë e saj, ku ai beson se ruan veçoritë e të folmes së vërtetë të gjuhës shqipe. Midis vjershave të tij, të shkruara në shqip kam veçuar këtë:

NJ'POET I SHKRET

Ndihem si nj'poet i shkret,
Ç'do t'shkrunj gjë të ri
E ç'di se fjaljet ç'thot
Jan vetim pika ljot
Për këtë kultur
Ç'ësht e vdes.

Mikelanxhelo e kanë pasur emrin edhe babai i De Radës edhe njëri nga djemtë e tij. La Luna është krenar për origjinën e vet, jo vetëm si arbëresh, por edhe si bashkëvendas i De Radës. Ai na pret me tërë dashamirësinë e vëllait që e pret për shumë kohë një takim të tillë. Pastaj na tregon për udhëtimet studimore dhe seminaret që organizon me të huajt, veçanërisht me studentë amerikanë, të interesuar për arbëreshët. La Luna na tregon për fshatin, historinë e tij dhe, mbi të gjitha, për historinë e Kolegjit të Shën Adrianit dhe të Shën Mitër Koronës dhe për Maqin (it. *Macchhia Albanese*) fshatin e lindjes së De Radës.

Në Maqi – Në vendlindjen e De Radës

Fshati Maqi është rreth katër kilometra larg nga Shën Mitri, rreth katër kilometra. Sapo hymë në fshat na shfaqet busti i De Radës, përpara Kishës. E nderojmë atë dhe hymë në rrugën me emrin "Jeronim De Rada", e cila hapet pasi lemë kishën në të djathtë dhe bustin e poetit në të majtë. Aty shohim një derë harkore, që të shpie në një oborr. Është një portik oborri pa derë. Ne shohim fasadën ballore të murit të shtëpisë së De Radës. Në hyrje, në krahun e majtë gjendet një pllakë mermeri e bardhë në të cilën shkruhet në gjuhën italiane:

> *Në këtë vend në vitin 1814, ka lindur Jeronim De Rada, poeti dhe themeluesi i letërsisë shqipe. Vdiq në vitin 1903.*

Brenda oborrit të rrethuar nga shtëpitë tjera shfaqet edhe një pllakë tjetër mermeri ku shkruhet:

> *Poetit të madh shqiptaro-italian, në 150-vjetorin e Lindjes, nga populli i qytetit të tij.*

Aty gjëndet edhe guri në të cilin De Rada vinte këmbën për të hipur në gomar çdo ditë kur shkonte nga Maqi në Shën Mitër për të dhënë mësim në kolegj. Ai mbetet një shenjë e varfërisë së tij, thjeshtësisë, përunjësisë, modestisë e sot për ne e madhështisë së tij. Studiuesit e jetës së tij thonë se deri pak kohë

para se të vdiste ai vazhdonte të shkonte nga Maqi në Shën Mitër dhe jepte mësim.

Jemi pikërisht aty ku jetoi njeriu më i rëndësishëm i letrave shqipe të deri asaj kohe. Jeronim De Rada. Tek ecën kalldrëmeve aq të pastra të atyre rrugëve të fshatit, nuk rri dot pa imagjinuar Jeronimin fëmijë tek luante, djalosh tek projektonte të ardhmen, burrë, tek ndërtonte veprën e tij të pavdekshme, plak të urtë e mendimtar që vuante dhe përballonte mjerimin shpirtëror, sa për vdekjen e parakohshme të katër djemve, aq edhe për atdheun.

Eh këta poetët! Mendja më shkon edhe tek "Lum Lumi" i Ali Podrimjes! De Rada i mbylli sytë me brengën e madhe për Shqipërinë, duke lënë një emër dhe trashëgimi të madhe.

Altimari dhe arbëreshë të tjerë vazhdues të traditës De Radiane

Pak më tej, ndoshta jo më shumë se pesëdhjetë metra, brinjas rrugës "De Rada" gjendet një shtëpi e madhe, shumë e vjetër, me mure të ndërtuara me teknika të ndryshme, tullë, dru, gur, hekur. Është shtëpia e Altimarëve, njëri prej të cilëve është sot studiuesi e filologu shumë i njohur në botën arbëreshe, madje edhe në atë mbarëshqiptare dhe italiane, si njëri prej emrave të më shquar në fushën e albanologjisë. Ai është një studiues i zoti aq sa edhe një mbrojtës i flaktë i pastërtisë së gjuhës shqipe dhe ruajtjes së saj nga ndikimi dhe futja e fjalëve të huaja në të. Është profesor *Francesko Altimari* me të cilin jemi njohur nga afër në kremtimet e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit në Shkup, Manastir e Tetovë, në nëntor të vitit 2008. Aty, ai bashkë me arbëreshë të tjerë e nderuan atë 100-vjetor të Kongresit të alfabetit me studimet dhe ndihmesat e tyre për gjuhën shqipe. Por le të kthehemi sërish tek De Rada.

Historia jonë deri në kohën e De Radës

Ai njeri që mbartte brengën shqiptare të shekullit të pesëmbëdhjetë, ishte vetë njeriu që, pas gati katër shekujsh gjumi letargjik, e ringjalli gjuhën shqipe të

shkruar. Pas vdekjes së Skënderbeut, shenja e parë e shqipes ishte «Meshari» i Gjon Buzukut, i botuar në vitin 1555 dhe i zbuluar vetëm në vitin 1740. Pastaj vijnë dhe « Doktrina e Krishterë » (1592) e Lekë Matrëngës, që vazhdon shkrimin e shqipes në mjediset e diasporës arbëreshe të Italisë, në Horën e Arbëreshëve (*Piana degli Albanesi*) ; pastaj veprat e Pjetër Budit (1618-1621), « Fjalori latinisht-shqip » (1635) i Frang Bardhit dhe dhe « Cuneus Prophetarum » (1685) e Pjetër Bogdanit.

Po përpara, gjatë dhe pas kësaj periudhe, çfarë bëhej me ne shqiptarët? Duket se ora e kombit kishte ndalur. Mijërat e shqiptarëve kishin emigruar drejt jugut të Italisë. Të mbeturit ishin ballafaquar me shtypjen dhe shfarosjen. Një pjesë e kombit mbijetoi. Breza të tërë u shuan. Të rinjtë u morën me forcë si jeniçerë. Kontaktet me botën e qytetëruar u ndërprenë. Në atdhe, e vetmja mënyrë jetese ishte t'i shërbeje Perandorisë Osmane, ose të zhyteshe në terrin otoman, për të mbijetuar pa ndërgjegje, pa abetare e libra në gjuhën shqipe, pa komunikim kombëtar të shkruar.

Në anën tjetër të detit, në Italinë fqinje ishin vendosur arbëreshët, masa të shumta, në krye të herës, prej më se treqind mijë shqiptarësh që nuk e duruan dot dhunën osmane dhe as kishin më forca për ta vazhduar qëndresën. Ata morën me vete lavdinë e Skënderbeut për ta mbajtur gjallë deri në ditët e sotme e, bashkë me të, edhe krenarinë e madhe të të qenit pjesëtarë të një kombi që kishte bërë rezistencën më të madhe anti – osmane në Ballkan, duke mbrojtur edhe Gadishullin Apenin në pengesën që u vunë osmanëve në anën lindore të Adriatikut dhe Jonit. Ata i dhanë botës së krishterë një Papë, Clementin XI, të quajtur Papa Albani, dhe Italisë një kryeministër, Francesko Crispin nga ngulimet arbëreshe të Sicilisë. Prej mjediseve arbëreshe të Italisë Shqipëria dhe kultura shqiptare do të kishin një yjësi (plejadë) burrash të shquar, të cilët do ta bënin të njohur kombin dhe çështjen shqiptare në Itali e më gjerë, si: *Jul Variboba, Zef Serembe, Gavril Dara i Riu, Vinçenz Dorsa, Dhimitër Kamarda etj*. dhe mbi të gjithë *Jeronim De Radën*. Dhe jo vetëm kaq. Në oborrin e Kolegjit të Shën Mitër Koronës, kur je ballë për ballë me të, në krahun e djathtë, qëndron krenar një bust i Xhuzepe Garibaldit, i cili prej ish-studentëve të Kolegjit arbëresh të Shn Mitër Koronës, pati « ballin e luftëtarëve » që u dalluan në betejat garibaldine për bashkimin e Italisë. Ai nderohet aty për bashkimin e Italisë, por edhe për rolin që arbëreshët kanë luajtur si trimat dhe luftëtarët më të vendosur

e më besnikë. Dhe ky rol nuk është i thjeshtë: Ka të bëjë me bashkimin e njërit prej kombeve e shteteve më të fuqishme të botës. Në kthim Garibaldi i dha një fond të madh kolegjit arbëresh që të vazhdonte veprimtarinë si dhe hapi katedrën e gjuhës shqipe aty. Sipas profesor Gjovalin Shkurtaj, ai "Me kërkesën e arbëreshëve që bënin pjesë në ushtrinë e tij, e shkëputi përsëri kolegjin nga Rosano dhe dhuroi një kontribut prej 12 mijë dukatësh për rindërtimin e pajisjen e tij, si dhe caktoi një komision për ta drejtuar atë.

Kolegji i Shën Mitrit

U hap për here të parë më 1732 në godinën e abacisë në Shën-Benedikt Ulano. Siç shprehej De Rada, ky kolegj u çel

> "*si një derë e madhe drite të re e të butë, për të gjitha shtëpitë arbëreshe, nga të cilat, ata që patën mundësi, menjëherë dërguan bijt e tyre për të mësuar e për t'u arsimuar*".

Siç ka shkruar edhe profesor Shkurtaj "Kolegji i Shën-Adrianit u bë shpejt një vatër që përgatiti dijetarë e shkrimtarë të njohur, që i lanë nder e lavdi gjuhës amtare e letërsisë shqiptare. Kolegji i Shën-Adrianit, pikërisht në kohë të vështira e të turbullta për Shqipërinë, shërbeu edhe si qendër kulture e edukimi për rininë shqiptare. Që prej vitit 1898 deri më 1919 aty ndoqën mësimet mbi njëqind intelektualë shqiptarë, të cilët u bënë veprimtarë entuziastë në shërbim të atdheut e të arsmit kombëtar. Aty qenë nxënës Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Ziaudin Kodra, Ibrahim Kushta etj."

Të njëjtën gjë pohon edhe studiuesi kanadez, dr. Robert Elsie dhe shton edhe emrat e profesorëve nga Shqipëria, si Gaspër Jakova Mërturi, Nikoll Martin Camaj, Mehdi Frashëri, etj.

377 vjet "heshtje" deri te Milosao e Jeronim De Radës

Po ta marrim të mirëqenë përdorimin e shkrimit të gjuhës shqipe deri në ditën

kur vdiq Skënderbeu, atëherë do të shihnim se deri në botimin e "Milosaos" kishin kaluar 377 vjet. 377 vjet "heshtje" është një periudhë e gjatë. Shqiptarët ishin shfaqur ndër luftëra të mëdha dhe kishin bërë histori. Ata lanë emra dhe vepra të mëdha në historinë e Mesdheut. Po sa ndikonte kjo në jetën e shqiptarëve?

Arbëreshi De Rada – Vija ndarëse midis errësirës otomane dhe dritës shqiptare që po lindte

Brenda Kolegjit të Shën Mitrit në vetë kishën e atyshme, La Luna na shpjegon me durim për atë çfarë ishte kolegji para De Radës, me gjallje të De Radës dhe pas tij deri më sot. Kolegji i Shën Mitrit, na thotë ai, është ndërtuar, këtu, rreth truallit të Kishës së Shën Adrianit e ngritur rreth vitit 1000. Kolegji e ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 1470 i themeluar nga paraardhësit tanë shqiptarë. Kisha është një shembull i arkitekturës Normano – Bizantine dhe në të gjënden shumë vepra arti, mozaikë dhe relikte të vjetra antike. Bien në sy kolonat korinthiane, të zbukuruara me gdhendjet në krye me formën e gjetheve të bimës mesdhetare *acanthus mollis.*

Në mënyrë të veçantë ai na shpjegon për mozaikët origjinalë të gjarpërinjve në dysheme, ndër të cilët dallohet njëri i cili ka tre nyje të përdredhura në trup në formë unazash, dëshmi e trinisë (trinitetit). Më pas ai na tregon bustin e De Radës, i cili gjendet brenda oborrit të kolegjit, ballë për ballë me atë të Garibaldit. Dhe vijon me tregimin rreth historisë së De Radës:

"Këngët e Milosaos", "Këngët e Serafina Topisë", "Skënderbeu i Pafan"…

De Rada fitoi emër me poemën epiko – lirike "*Këngët e Milosaos*", botuar në vitin 1836. Këtu e ka bazën edhe fillimi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe i letërsisë sonë të romantizmit. Më pas ai vazhdon me një vepër tjetër, edhe kjo me subjekt nga Shqipëria, e njohur me emrin "*Këngët e Serafina Topisë*". Por vepra më e rëndësishme e De Radës mbetet "*Skënderbeu i Pafan*", të cilën e botoi në vitin 1896. Veprat e tij mendohet se i njihte edhe vetë Viktor Hygoi

por në veçanti ato njiheshin nga poeti i shquar francez La Martin.

"De Rada lindi në vitin 1814 në Maqi të Kalabrisë. Mësimet e para i mori këtu në ketë kolegj ku jemi sot" na tregon La Luna. Më 1834 ai shkoi për të studiuar drejtësi në Napoli, ku mori pjesë gjallërisht në lëvizjen politike dhe kulturore të kohës. Më 1848 nxori të parën gazetë shqiptare "*Shqiptari i Italisë*". Më 1848 ai u kthye në Maqi deri në fillim të viteve 60 të shek. XIX. Në vitin 1861, boton librin "*Parimet e Estetikës*" (Principi di estetica), pastaj "*Lashtësia e Kombit Shqiptar*" ("*Antichità della nazione albanese*"). Në vitin 1864 boton "*Rapsodi të një poeme arbëreshe*" ("*Rapsodie d'un poema albanese*"). Këto vepra ndikuan fuqishëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve. Ai kishte letërshkëmbim me veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare, ndër të cilët me Dora D'Istrian. Ai përkrahu lëvizjen për bashkimin e Italisë. Ndërkohë përkrahu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në vitin 1878. Revista e tij "*Fjamuri i Arbërit*" botuar nga viti 1883 e ndihmoi jashtëzakonisht shumë çështjen kombëtare shqiptare. Në vitin 1902, pak para vdekjes ai botoi një "*Testament politik*" për çështjen shqiptare.

De Rada ka një meritë të veçantë në studimin e gjuhës dhe gramatikës shqipe. Ai ka botuar dy vepra gramatikore ku argumenton lashtësinë e gjuhës shqipe. Po ashtu ai organizoi dy kongrese të gjuhës shqipe njërin në vitin 1895 në Corigliano Calabro dhe një në vitin 1897 në Lungro. Ai e dha mësimin e gjuhës shqipe këtu në Kolegjin e Shën Adrianit – Shën Mitër Coronës për dhjetra vjetë.

Pas këtij rrëfimi të La Lunës mendja të shkon tek shumë studjues, të cilët janë marrë dhe merren me çështjen e arbëreshëve të Italisë. Duke respektuar punën e tyre, në këtë shkrim, e gjej me vend t'i referohem një shkrimtari të famshëm austriako – anglez, i cili konsiderohet si rrëfimtari më i mirë midis udhëtarëve britanikë të kohës. Dhe këtë emër ai e ka fituar me librin e tij të njohur "*Kalabria e Vjetër*" . Ai është:

Norman Dauglas – "Shqiptarët dhe Kolegji i tyre" dhe "Një Profet Shqiptar" në librin: "Kalabria e Vjetër"

Norman Dauglas ka studiuar tërë grupet etnike dhe jetën e tyre në Kalabri,

duke u ndalur tek arbëreshët. Ndër të tjera për arbëreshët ai shkruan:

"Këto fshatra jo-italiane datojnë nga shekujt pas vdekjes së Skënderbeut kur Sulltani (The Grand Signor) e përforcoi pushtetin e tij. Refugjatët arritën grumbuj – grumbuj nga deti. Atyre iu dhanë toka të egra ku do të vendoseshin. Të ardhurit e rinj u morën për bizantinë.

Kolonitë e shqiptarëve u shpërndanë nëpër tërë Italinë e Jugut më së shumti në Pulia, Kalabri dhe Sicili. Disa u vendosën dhe në veri edhe në qendër. Ishte edhe një vendbanim në Lumin Po, por që është reduktuar në 200 banorë; shumica e tyre më vonë janë absorbuar dhe shkrirë brenda elementit italian. Sipas Angelo Masci (1846), janë 59 fshatra të tyre, me 83 mijë banorë – veçanërisht në Sicili; Morelli thotë se numri i përgjithshëm i arbëreshëve për Italinë dhe Sicilinë është tek 103.466. Nëse ky numër është i vërtetë, atëherë kjo shumë tani duhet të kalojë të dyqind mijët. Unë mora vesh se tani gjenden 80 fshatra të populluara prej arbëreshëve me nga 2500 banorë secili, po të llogarisim edhe ata që kanë emigruar në ShBA. Gjuha shqipe tashmë zotëron më shumë se tridhjetë alfabete të ndryshme, secili me më shumë se tridhjetë germa. Gjithsesi, në këto katërqind vjet ata nuk e kanë ndarë mendjen se cilin do të mbajnë."

Më pas Norman Dauglas ndalet tek themeluesi i vërtetë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Jeronim De Rada. Ai pasi përshkruan jetën e tij, vështirësitë, dramat e tmerrshme familjare, faktin që ai nuk kishte udhëtuar kurrë jashtë, madje as në vise të tjera arbëreshe brenda Italisë, thotë:

"Shkrimet e tij të shumëllojshme – dhe padyshim risia e temës së tij qendrore – tërhoqën vëmendjen e gjuhëtarëve dhe filologëve gjermanë të kohës, të tërë të dashuruar pas lirisë, folklorit dhe poezisë. Shkrimtari i njohur italian Cantù, e vlerësoi atë shumë lart. Lamartini, në vitin 1844 i shkroi atij: ''Unë jam i lumtur për vëllazërinë poetike dhe politike që ekziston midis teje dhe meje. Poezia erdhi nga brigjet tuaja dhe duhet të kthehet andej nga erdhi''. Herman Buchholtz zbulon tek ai skena të denja për shkrimet e Shekspirit dhe pasazhe madhështore të denja për skena eskiliane në tragjedinë e tij Sofonisba. Dijetari i madh Gladstone thuhet se i shkroi një kartolinë ku e lavdëronte për përpjekjet e tij në emër të vendit të vet".

Ishte ai që krijoi gjuhën letrare të vendit të tij, që hyjnizoi lidhjet midis

Shqipërisë dhe Pellazgëve dhe që formuloi ambiciet e saj politike. Deri në atë kohë ajo ishte thjesht një mit".

Dhe shton:

"De Rada ishte një patriot i flaktë prej të cilit morën trajtë aspiratat e stuhishme të Shqipërisë. Ideali që e drejtoi krejt jetën e tij ishte ringjallja e vendit të tij. Dhe nëse vëmendja e kongreseve ndërkombëtare dhe gjuhësisë e folklorit është tërhequr tek ai cep i vogël i botës, nëse në vitin 1902 njëzet e dy gazeta i kushtoheshin çështjes shqiptare, (vetëm në Itali botoheshin tetëmbëdhjetë të tilla dhe një në Londër), e tëra ishte merita e tij. Biografët e tij numërojnë dyzet e tre vepra të dala nga pena e De Radës. Në krye të tëra veprave të tij qëndron "Fjamuri i Arbërit". Gazetaria, folklori, poezia, historia, gramatika, filologjia, etnologjia, estetika, politika, morali – asnjë prej tyre nuk mungon në penën e tij të talentuar."

Shënimet e këtij udhëtimi do t'i mbyllja me një falënderim për të gjithë ata arbëreshe, të cilët i shërbyen çështjes sonë kombëtare. Ndaj, duke u larguar nga Kalabria më vjen t'i shkruaj këto vargje**:**

Në Kalabri!
Sa shumë vetë kanë ardhur
Dhe kanë ikur?
Tek ty Kalabri' e Vjetër?
Për të parë dhe ndjerë gjithçka:
Deri tek kujtimet e mugëta'
Hi-mbetur.
Të arbëreshëve,
Anës detit, një kujtim,
I qenies sonë ilirike,
Një Vegim.
Thirrje e "Gjakut të Shprishur",
I pa tretur, i pasosur,
Kurrë!
Që buron dashuri dhe mall,

Si uji i pastër:
Në një gurrë.
Një ditë është pak,
As një jetë nuk mjafton,
Të shuash mallin shekullor
Që të pushton.
Mes vëllezërish dikur,
humbur deteve,
Përplasur në Itali,
Që të falin sot kaq ndjenjë,
Dramë, dhimbje, dashuri dhe…
Krenari:
Në Kalabri!

Kalabri, verë e vitit 2013

VEPRA MUZIKORE "VJESHTA NË SHQIPËRI" DHE HISTORIA E SAJ

Kompozitorja Roxanna Panufnik, shkruan muzikë për Shqipërinë

Çdo formë e promovimit të vlerave shpirtërore, materiale, artistike, kulturore të popullit tonë, ngado që të vinte apo të shfaqej, përbënte një rast për njohjen e Shqipërisë. Ishte kjo arsyeja pse e ndoqa me aq vëmendje dhe përkushtim ekzekutimin - premierë në Londër dhe më vonë edhe në Tiranë, veprës muzikore "Vjeshtë në Shqipëri" të kompozitores Roxanna Panufnik. Ajo është e bija e Sir Andrzej Panufnik, muzikant e famshëm polak, e lindur në Londër në vitin 1968. Gjyshja e saj ishte violiniste e njohur në Poloni, ndërsa gjyshi ishte mjeshtër i prodhimit të violinave dhe muziktar amator. Më i famshmi në familjen e saj ishte i ati, Andrzej, drejtor i Orkestrës Simfonike të Varshavës në vitin 1954. Ai e kishte nisur veprimtarinë e vet muzikore që në vitet '30, për t'u bërë ndër muzikantët më të mëdhenj të kohës së vet. Si dirigjent i orkestrës, pas një turneu në Bashkimin Sovjetik, ai u gjend para mëdyshjes fatale: ose t'i bindej shërbimit sekret stalinist, që e trysnonte, ose të ikte nga Polonia.

Në këto rrethana ai vendosi të arratisej nëpërmjet Zvicrës dhe përfundoi në Britaninë e Madhe. Veprimtaria e tij muzikore ishte aq e gjerë dhe e spikatur sa Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II, e nderoi me Urdhrin kalorësiak me titullin Sir. Vajza e tij, Roxanna u bë po ashtu shumë e njohur në jetën muzikore londineze, si kompozitore. E edukuar në shkollat më e famshme të muzikës angleze, ajo është nderuar me çmime të para, në shumë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kryefjalë e suksesit të Roxanna Panufnik ishte "Katër Stinët e Botës" me

Vjeshtën Shqiptare.

Në marsin e vitit 2012, "Katër Stinët e Botës" u ekzekutua nga Orkestra "London Mozart Players". Atë natë ishim të ftuar specialë të autores. Koncerti transmetohej drejtpërdrejt nga Radio BBC 3 dhe u komentua në stilin tradicional anglez, nga njëra prej folësve më të shquara të saj me përhapjen më të madhe botërore.

Në një nga shkrimet e veta "*Classical Source*", një prej enteve më prestigjoze kritike të muzikës angleze, thotë për kompozitoren:

"*Roxanna Panufnik mishëron fuqinë e muzikës për t'i shndërruar jetët dhe për të përcjellë mesazhe universale*".

Gazeta *"Observer"* e quan atë:

"…një kompozitore, fama e së cilës po rritet me shpejtësi falë punës së saj që e bën me zemër, entuziazëm dhe individualitet. Ajo është e veçantë në zërin e saj, serioze, e plotë, e guximshme dhe tërheqëse".

Gazeta tjetër, *"Wiener Zeitung"*, shkruan:

"Muzika e saj nuk ka asgjë prej trilleve të modës. Sa herë kompozon, ajo merr guximin të shfaqet e thjeshtë, por me integritet të lartë, duke ndërthurur emocionet e saj të drejpërdrejta me harmoni elegante".

Revista *"Gramafoni"* shprehet midis të tjerave:

"…Çfarë kompozitoreje madhështore për vepra korale është ajo! Më shumë sesa shkathtësia për ta mbajtur fuqinë e korit, tek ajo del në pah ndjesia natyrale e panufnikëve! Unë nuk besoj se jam i vetmi që, pasi kam dëgjuar këtë disk, të më ketë lindur dëshira e menjëhershme për të kërkuar dhe dëgjuar më shumë muzikë të shkruar nga Roxanna Panufnik".

Roxanna Panufnik ka studiuar për kompozim në Akademinë Mbretërore të Muzikës dhe është kompozitore e një serie veprash, ku përfshihen opera, baleti,

muzikë për teatër, vepra korale, orkestrale, muzikë dhome si dhe muzikë për filma të luajtur në të gjithë botën. Opera e saj "Silver Birch" (*Thupra e Argjendë*), e vënë në skenë nga Opera Garsington, e klasifikoi atë ndër kompozitoret më të mira të brezit të sotëm në Britani.

Kritika muzikore e ka quajtur veprën e saj "Katër stinët e botës" si: *"Një kulminacion muzikor të kohës"*. Në zemër të kësaj vepre është muzika shqiptare.

Orkestra "London Mozart Players"

Themeluar në vitin 1949 nga Harry Blech, e njohur si *"Orkestra që nuk di të bëjë gabime",* London Mozart Players ka interpretuar jo vetëm Mozartin, emrin e të cilit mban, por edhe kompozitorët më të shquar të botës. Kjo orkestër luan në sallat më prestigjioze të Londrës dhe merr pjesë në BBC Proms, në Cadogan Hall, South Bank Hall e sa të tjera, gjithmonë me një repertor të zgjedhur, veçanërisht për veprat në premierë.

"Katër stinët e botës" kishte premierën e saj. Mjeshtër e orkestrës atë natë ishte violinistja e famshme angleze Tasmin Little - një ndër artistet më të famshme të skenës britanike të kohës së sotme. Ajo ka interpretuar në salla të tilla, si Carnegie Hall, Musikverein, Concertgebour, Filarmonia e Berlinit, Vienna Konzerthaus, South Bank Centre, Barbican Centre, Royal Albert Hall, Lincoln Center, Suntory Hall e sa e sa të tjera. Mbajtëse e dhjetëra çmimeve për virtuozitetin e saj, interpretimi i *"Vjeshtës në Shqipëri"* shënjonte një sprovë profesionale për violinisten e kalibrit botëror, Tasmin Little.

Miqësia me muzikanten Panufnik u forcua, kur e ftova për të vizituar Tiranën. I kërkova të drejtën e autores për interpretimin e veprës së saj në hapjen e sezonit muzikor të orkestrës sonë në shtatorin e vitit 2013. Kisha biseduar me drejtorin e orkestrës, muzikantin e njohur David Tukiçi. Ai e pranoi me kënaqësi dhe ofroi mikpritjen shqiptare për artisten britanike. Roxanna erdhi në Tiranë, punoi me orkestrën tri ditë dhe doli në skenën e Akademisë së Arteve, duke e nderuar audiencën me pjesëmarrjen e saj. Shfaqja ishte një sukses i plotë. Të nesërmen ajo doli edhe në Televizionin Shqiptar bashkë me Davidin dhe i dhanë publikut një pasqyrë të asaj vepre, që nga ideja e deri tek ekzekutimi në Tiranë.

Kur u kthyem në Londër Roxanna më ftoi në shtëpinë e saj. Biseduam mbi përshtypjet e saj gjatë vizitës në Tiranë, dhe ajo tha:

"*Mund të jenë tri ditët më të bukura, më interesante dhe më të këndshme të jetës sime. Tirana më kujtoi vendlindjen e babait tim, Varshavën. Dashuri të tillë nuk kisha provuar*".

Kur e pyeta për artistët, nënqeshi dhe më tha:

"*Ishin artistë shumë të talentuar por… duhet më shumë disiplinë".*

Mamaja e saj, Camila e vështroi me një notë ca kritike ndaj konstatimit të dytë: Disiplinës.

Unë, në heshtje i dhashë të drejtë, pasi Roxanna duket se kishte vënë re dy tiparet tona - mikpritjen e dashurinë për mikun edhe mungesën e disiplinës.

Letër nga Roxanna Panufnik

Kur vendosa ta përfundoja këtë material, i dërgova kompozitores një mesazh shumë miqësor, bashkë me njoftimin se do ta përfundoja në këtë libër. Në përgjigje më dërgoj letrën, të cilën po e botoj siç ma dërgoi ajo:

I dashur Mal!

Sa kënaqësi të lidhemi përsëri pas kaq kohësh, qëkur jeni larguar nga Londra!

Këtu po të dërgoj disa fjalë dhe shpresoj të mos e zgjas dhe të jem sa më objektive.

Kur një ditë në vitin 2008, violinistja Tasmin Little më kërkoi të shkruaja një seri me pjesë të shkurtra muzikore për të, për t'u luajtur nga një orkestër për muzikë dhome, pranova të shkruaja diçka që të ishte për të gjitha shijet muzikore.

Duke pasur parasysh se jetojmë në një botë ku shqetësimet për ndryshimet klimaterike dhe shkundjet sizmike në peizazhin politik ndërkombëtar, ndikojnë mbi ne të gjithë, vendosëm të marrim si shembull veprën muzikore "Katër stinët"

e kompozitorit Vivaldi, aq të dashura për publikun, duke i dhënë konceptin e kalimit në shekullin e 21–të, si dhe duke krijuar një vepër tërësisht të re me çdo stinë, (5 minuta secila), të frymëzuara prej secilit vend që do të ishte kulturalisht i shoqërizuar me të.

E kompozova "Pranverën në Japoni", në fillim, pastaj "Dimrin në Tibet" dhe më pas "Verën në Indi". Kur erdhi puna te Vjeshta, më kujtohet që më ra në dorë një CD me muzikë folklorike shqiptare (e luajtur nga Shkëlzen Doli), të cilën ma dhuroi një mik i imi nga Kosova. Unë rashë menjëherë në dashuri me atë muzikë.

Ishte një këngë vajtimtare dashurie, nga qyteti jugor shqiptar i Vlorës. Kjo melodi aq e bukur që të linte pa frymë sapo ta dëgjoje, më çoi menjëherë në një lidhje me stinën e vjeshtës. Ajo kishte një bukuri të dhimbshme, që përfshin zbukurime dhe kthesa të papritura që më kujtuan rënien e gjetheve që valëviten nga era derisa prekin tokën. Por Tasminë donte edhe diçka që vallëzohet. Në këtë pikë unë iu qasa Ambasadës Shqiptare në Londër dhe gjeta mbështetje nga sekretarja e tretë e Ambasadës, dr. Xhoana Papakostandini, e cila e pëlqeu shumë zgjedhjen që kisha bërë nga Shqipëria. Vjeshta atje është një stinë vitale - jo vetëm nga ana bujqësore, por edhe për shkak të festimeve të plota të përbashkëta kulturore dhe fetare (myslimane e të krishtera).

Dr. Papakstandini më prezantoi edhe me koreografin shqiptar me banim në Londër, Tomor Kokona. Ai më tregoi "Vallen e zileve" nga Shqipëria e Mesme. Ritmi melankolik në fillim të merr me vete në një mënyrë krejt të shkujdesur pa e vënë re, por në harmoninë e një ëmbëlsie të hidhur, ilustron konfliktet që kanë shpërthyer në atë vend nën sipërfaqen e dukshme politike. Dhe prapëseprapë, fuqia e shpirtit shqiptar triumfon dhe një kadencë e shkurtër, në fillim në harmoni (duke imituar lahutën e përdorur në Veri të Shqipërisë), e ul ngadalë ritmin e valles dhe të shpie në një zonë më të qetë, ndërkohë qe stina shtyhet më tej drejt një fundi të mugët dhe të ftohtë.

"Katër stinët e botës" ishte sukses i plotë dhe u zgjodh nga BBC Radio 3, për të festuar hapjen e Lojërave Olimpike, London 2012. Më pas ajo u regjistrua në CD nga Orkestra Simfonike e BBC–së. Asnjëherë, as në ëndrrat e mia më të guximshme nuk mund të imagjinoja që një pjesë e kompozuar prej meje do të udhëtonte drejt vendit që më frymëzoi. Kështu që është e lehtë të merret me mend se sa e lumtur kam qenë kur Ambasadori shqiptar në Londër, z.

Mal Berisha më propozoi një udhëtim për Tiranë. Me ndërhyrjen e tij, Orkestra e Radio Televizionit Shqiptar më ftoi në koncertin e vet për të parë Premierën Shqiptare të Vjeshtës së vitit 2013. Kjo ishte një përvojë e jashtëzakonshme frymëzuese, duke punuar me muzikantë, që luajnë muzikën e vet tradicionale, madje, duke më dhënë edhe rastin të flisja në Radio Televizionin Shqiptar. Aty përjetova edhe ngrohtësinë e popullit shqiptar, e pasqyruar edhe në muzikën e bukur të tyre. Unë gjithashtu krijova një version të veçantë të "Vjeshtës në Shqipëri" për t'u interpretuar me violinë dhe piano për veprimtarinë unike të Ambasadës Shqiptare në Londër, "Notes On Albania" në King's Place. U ndjeva aq e emocionuar kur pashë se të gjithë e përqafuan veprën time dhe deklaruan se unë duhej të ndihesha si qytetare nderi shqiptare. Disa vjet më vonë, kur bëra provën e ADN-së, më rezultoi se kisha në gjenet e mia rrënjë ballkanike.

Tani ndjehem se jam përgjithmonë e ndërlidhur me kulturën mahnitëse dhe të veçantë të Shqipërisë dhe mezi pres të vij atje përsëri, ndonjë ditë".

Me dashuri,
Roxanna

LETRAT KREDENCIALE TE PRESIDENTI I IRLANDËS, MICHAEL D. HIGGINS

Në Dublin përpara paraqitjes së kredencialeve

Motorkada e makinave, që do të na dërgonte në Pallatin Presidencial të Irlandës të quajtur Áras an Uachtaráin, përbëhej nga tre Mercedesë të zinj. Ata parapriheshin nga një bateri prej dhjetë motoristësh, të ndarë në një vijë konike me majë në fillim, një përpara dhe tre radhë nga tre si dhe katër makina policie.

Atë 10 tetor të vitit 2013, Michael D. Higgins priste në rezidencën e tij presidenciale tre ambasadorë: Ambasadorin e Zelandës së Re, atë të Luksemburgut dhe të Shqipërisë. Të tre ambasadorët, secili në mënyrën e vet, do të paraqitej përpara atij burri, i cili reflektonte shumë mirësi dhe kulturë.

Drejt Pallatit Presidencial të Irlandës

Motorkada e tre ambasadorëve po i afrohej pallatit presidencial. Në rrugë çdo makinë ndalonte, hapte krahun dhe vëzhgonte me simpati atë lëvizje aq të bukur e harmonike. Më në fund arritëm. Ishte një shesh madhështor aty ku ndaluam. Ambasadorët dolën solemnisht nga makinat dhe u drejtuam nga punonjësit e protokollit të shtetit irlandez drejt holleve të pallatit presidencial. Në një kortezh të bukur, në një ditë fantastike me diell por e freskët, hyra bashkë me zonjën time, Donikën, në atë pallat të thjeshtë, por plot hije e hir shtetëror.

Të njohësh Irlandën dhe irlandezët përpara paraqitjes së letrave kredenciale

Irlandezët janë nga popujt më luftarakë dhe më të vjetër të Evropës. Irlanda në fakt është një ishull ose ishulli i tretë më i madhi në Evropë dhe i njëzeti më i madhi në botë. Ai vend ndahet politikisht në dy pjesë: Njëra është Republika e Irlandës, ndërsa tjetra është Irlanda e Veriut. Kjo e dyta është njëra nga katër shtetet që përbëjnë Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe. Populllsia e njërës nuk i arrin të pesë milionët, ndërsa tjetra as dy milionë.

Historia e atij vendi është sa e lavdishme po aq edhe e dhimbshme. Irlanda Gaelike u shfaq në mijëvjeçarin e parë dhe zgjati deri në shekullin e 17-të. Irlandezët u kthyen në të krishterë aty nga shekulli i 5-të. Duke vijuar me pushtimet normane, në shekullin e 12-të, Anglia kërkoi të merrte sovranitetin mbi Irlandën, por ata nuk arritën ta nënshtrojnë atë deri në shekullin 16 – 17, në kohën e pushtimit të Tudorit dhe dinastisë së tij. Kjo çoi në kolonizimin e Irlandës prej Britanisë. Në vitin 1690 aty u vendos sistemi i sundimit protestant anglez mbi katolikët. Në vitin 1801 Irlanda bëhet pjesë e Mbretërisë së Bashkuar. Lufta për çlirimin e Irlandës mbaroi me ndarjen e ishullit në dy pjesë: Irlanda e Lirë dhe Irlanda e Veriut, e cila mbeti pjesë e Mbretërisë së Bashkuar. Historia e kësaj pjese është e mbushur me shumë konflikte, akte të quajtura terroriste etj. Gjithsesi të dy pjesët, që nga viti 1973 janë anëtare të Bashkimit Evropian.

"Mallkimi" i patates

Irlanda ka përjetuar periudha urie masive të pashembullta në historinë e Evropës, prej të cilave një pjesë e madhe e populllsisë është zhdukur. Uria e Madhe ishte një periudhë e tmerrshme për këtë komb heroik dhe të mrekullueshëm. Në vitin 1845 uria masive shkaktoi humbjen e një të katërtës së populllsisë, të cilët ose vdiqën ose u larguan nga vendi i tyre dhe kaluan në anën tjetër të oqeanit. Kjo kohë njihet si periudha e Urisë së Patates Irlandeze. Mendohet se shkaku i kësaj urie ishte sëmundja, që kapi pataten, e cila ishte baza e ushqimit të populllsisë. Në fakt ka mendime që edhe pse kjo situatë urie mbretëronte në

tërë vendin, prapëseprapë shumë ushqime eksportoheshin nga Irlanda për në vende të tjera dhe kjo interpretohet si një gjenocid ndaj këtij populli i njohur me emrin "Mallkimi i patates". Ligjet që vepruan atëherë mbi irlandezët mund të kenë qenë të tilla që nxisnin zhdukjen e popullsisë vendase të krishterë katolike. Por patatja, e cila ishte kthyer në ushqimin bazë të familjeve irlandeze, sidomos atyre të varfra, luante një rol të jashtëzakonshëm në jetën e këtij kombi. Ata ishin ballafaquar disa herë me uri të përgjithshme, të cilat si rrallë në ndonjë popull tjetër, kishin luajtur një rol të madh, sa tragjik aq edhe historik.

Emigrimi irlandez

Krahas me urinë vinte edhe emigrimi. Në shekullin e 18-të, më shumë se një çerek milioni irlandezë e kaluan Oqeanin Atlantik për në anën tjetër të rruzullit. Gjatë periudhave të urisë mendohet se, prej një deri në një milion e gjysmë irlandezë, u larguan nga vendi i vet dhe emigruan drejt Amerikës. Pas shumë përpjekjesh historike, në vitin 1919, Irlanda arriti të bëhej shtet i pavarur, por duke lënë një pjesë të mirë jashtë territorit të saj politik. Periudha e gjatë e pushtimit i kishte kushtuar shumë njerëz dhe po ashtu, edhe më keq, humbjen e gjuhës amtare. Por nga ana tjetër Irlanda e mbushi Amerikën me njerëz të shquar, përfshirë edhe njëzet e dy presidentë, ndër të cilët: Roosevelt, Wilson, Truman, Kennedy, Reagan, Clinton madje edhe Presidenti Obama, nga nëna, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Në anën kulturore Irlanda ka një pasuri të jashtëzakonshme e njohur për shkrimtarë, muziktarë dhe grupe ansamblesh me famë botërore.

Ngjashmëri midis kombeve tona

Ndërsa po i drejtoheshim atij pallati të bukur, i cili i shkonte shumë për shtat historisë së Irlandës dhe mundësive të një vendi thuajse të vogël, mendoja për jetën e kombeve të vogla nën sundimet e perandorive të mëdha. Në fakt shumë studiues përpiqen të gjejnë një lidhje gjenetike midis shqiptarëve dhe irlandezëve, skocezëve etj. Por unë gjeja një lidhje tjetër:

Të dy kombet tona kishin vuajtur shumë nën perandoritë e kohës. Ne shqiptarët rreth pesëqind vjet vuajtëm nën Perandorinë Osmane. Lufta ndaj nesh ishte bërë për të na shndërruar nga të krishterë në fenë islame, dhe osmanët ia kishin arritur në një masë të madhe. E njëjta gjë kishte ndodhur në Irlandë, jo vetëm me anglikanët në Republikën e Irlandës, por edhe me ata që ishin në Veriun e saj, të cilët mbetën jashtë territorit politik të vendit të vet. Po a nuk ishte edhe Kosova e njëjta histori? Luftëra me turqit, me serbët, pastaj për shkak të ndërrimit me forcë të fesë nga turqit, luftë ndaj shqiptarëve, të cilët merreshin qëllimshëm për turq nga fqinjët ortodoksë?

Por mendova prapëseprapë ndoshta ne shqiptarët kemi diçka, për të cilën duhet të mburremi. Edhe pse një abetare e gjetur në shtëpinë e një shqiptari deri në vitin 1912 ishte njësoj sikur të gjendej një arsenal armësh, gjuha shqipe mbijetoi. E nëse kombe të tjera, si edhe irlandezët, i lidhte kisha, qoftë ajo katolike apo protestante, neve nuk na lidhën fetë me njëri-tjetrin dhe për fat as mundën të na përçajnë. Na lidhi *gjuha* që u ruajt, u trashëgua dhe na identifikoi si vëllezër të një gjaku. Dhe kjo nuk është pak, natyrisht.

Në mburremi me Skënderbeun tonë, si mbrojtës i kombit dhe i fesë, ndërsa irlandezët mburren me Shën Patrikun. Në të vërtetë Shën Patriku më kujton përherë paradat e mrekullueshme të irlandezëve në New York, ku kam pasur rastin disa herë të jem i pranishëm. 17 marsi është dita e tij kur tërë amerikano - irlandezët vërshojnë në Lexington Avenue dhe shpalosin tërë bukurinë e tyre të kostumeve, veglave muzikore, reparteve të policisë së New York-ut, New York Police Department (NPD) të Departamentit të Luftës Kundër Zjarrit, i cili thuajse i tëri kontrollohet prej tyre. Sepse janë burra trima!, të sprovuar. Aty vërshojnë mijëra e mijëra studentë, nxënës shkollash, bij të breznive të ndryshme irlandeze, ndoshta edhe që në kohën e urisë. Muzikantë me instrumente popullore, gajde, fyej, sa e sa grupe muzikore interpretojnë në atë ditë.

Një herë, kisha pasur rastin të shihja tek interpretonte grupi i famshëm, i përbërë nga vëllezër e motra, i quajtur *The Chorrs.* Dhe natyrisht birra Ginnes përbën pijen e tyre të preferuar, e cila pret që në mbrëmjen e asaj nate të dehë mijëra e mijëra irlandezë. Ata e kanë ditën e tyre dhe çdo gjë që bëjnë e që ruan caqet etike, që nuk përbën shkelje të rëndë ligji, është e lejuar. Tërë kombësitë e botës në New York shohin me simpati dhe ndjekin me vëmendje rreshtat e policisë me shkrimin "*Be aware of irish people today*!" (Ruhuni prej irlandezëve

sot!) Në tërë qytetin duken shenjat e flamurit të gjelbër irlandez. E ndërsa Shën Patriku mund të jetë një figurë e legjendarizuar nga irlandezët, Skënderbeu ynë është figurë reale historike, e cila luan rol po aq të madh në ruajtjen e dinjitetit dhe të identitetit tonë kombëtar.

Të njëjtën gjë bëjnë shqiptaro - amerikanët në New York në ditën tonë të flamurit kombëtar.

Kush është z. Michael D. Higgins?

Përpara se të nisesha për Dublin, i kisha dhënë rëndësi shumë të madhe takimit me Presidentin Michael D. Higgins. Lexova shumë për jetën e tij. Mësova se ai ishte intelektual i shquar, poet dhe shkrimtar. Mbi të gjitha, ai ishte atdhetar i madh i vendit të tij. Ai fliste gjuhën e të parëve të vet, e cila tanimë është thuajse e vdekur dhe ishte nga ata burra që bënin përpjekje të jashtëzakonshme për ta ringjallur atë që në fakt duhej të ishte boshti, palca dhe shtylla kurrizore e ekzistencës dhe identitetit të vendit të tij. Ishte gjuha kelte e Irlandës ose siç e quajnë ata "Gaeilge".

Ajo që pashë e vura re aty ishte një thjeshtësi e pasur me gjëra krejt të nevojshme, asgjë të tepërt dhe krejt në harmoni estetike. Aty na prisnin me një koktej të lehtë punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe na treguan radhën e takimit. I pari hyri ambasadori i Zelandës së Re. Pastaj isha unë dhe më pas ambasadori i Luksemburgut.

Kredencialet te Michael D Higgins Áras an Uachtaráin

Sipas tërë rregullave të protokollit irlandez, hymë brenda në atë sallë të bukur dhe, përpara nesh, u shfaq Presidenti i Irlandës. Michel D. Higgins ishte një burrë flokëbardhë, i shkurtër dhe shumë i pashëm. Ai ka lindur në vitin 1941 dhe ishte presidenti i nëntë i Irlandës. Atë post e kishte marrë më 11 nëntor 2011. Është politikan, sociolog, poet, shkrimtar dhe gazetar televiziv e radiofonik, madje ka shërbyer edhe si Ministër Kulture. Fjalëmbël dhe zëulët, i qetë dhe i këndshëm, ai filloi të më fliste në gjuhën e kombit të tij:

Fáilte go dtí mo oifig
Táim sásta go bhfuil tú anseo.

Unë isha instruktuar të mos habitesha kur presidenti të fliste në një gjuhë të panjohur, pra në gjuhën e popullit të vet, thuajse të vdekur dhe që ai e bënte këtë pikërisht për të dhënë ndihmesën e vet në ringjalljen e saj.

E dëgjova me respekt dhe reagova sikur kisha kuptuar çdo gjë. Pastaj ai i pranoi letrat kredenciale, të cilat ia dorëzova bashkë me urimin e Presidentit të Republikës sonë, Sh.T. Z. Bujar Nishani. E urova për prosperitetin e popullit irlandez dhe të tij personal, e falënderova për qëndrimet e vendit të tij ndaj Shqipërisë gjatë presidencës së radhës së BE-së (të cilin sapo e kishin dorëzuar), si dhe për ndihmesën e pakursyer që kishte dhënë vendi i tij për Kosovën.

Po ashtu e falënderova për njohjen, që i kishin bërë Kosovës, duke mos e lidhur aspak me problemin e tyre kombëtar, për të cilin kishte shumë interpretime, nëse politikanët irlandezë do t'i futeshin një diskutimi të tillë.

Një surprizë në takimin tonë "privat" kokë më kokë - Libërth me vjersha i Presidentit irlandez, i përkthyer në shqip nga Ndrekë Gjini

Pasi kisha dorëzuar kredencialet zyrtare dhe kishim përfunduar ceremoninë zyrtare, ai më ftoi në takimin tonë *"privat"* kokë më kokë. Aty, të dy palët shkëmbyem mesazhet, që nuk jepen në prani të të tjerëve. Pasi mbaroi edhe kjo fazë, unë i dorëzova një dosje tjetër të bardhë të madhe. Atë e kisha bërë gati si surprizë.

Ishte një printim i bukur estetik i vjershave të shkruara nga ai vetë, Presidenti i Irlandës, të cilat poeti dhe gazetari shqiptar Ndrek Gjini, i vendosur në Galway të Irlandës, i kishte përkthyer në gjuhën shqipe dhe botuar në një gazetë në Shqipëri.

Ato vjersha i kisha marrë që përpara, rishkruar, korrektuar, printuar dhe krijova një libërth të vogël si dhuratë për presidentin irlandez. Gjatë dorëzimit të librit i thashë:

"Ju jeni i njohur në Shqipëri jo vetëm si president, por edhe si poet dhe unë kam nderin dhe kënaqësinë, që t'Ju dorëzoj pikërisht këtë përmbledhje të vogël të vjershave tuaja në gjuhën shqipe".

Presidentit i shndritën sytë. Me siguri që nuk e priste. Në të vërtetë punonjësja e protokollit më pat thënë që te presidenti nuk mund të shkoja me ndonjë gjë tjetër, përveçse me dosjen e letrave kredenciale. Por unë guxova t'i "thyeja rregullat" dhe e pashë që kisha bërë mirë.

Presidenti e shfletoi libërthin dhe më tha:

> *"Jam shumë i nderuar dhe i lumtur. Kam libra të mitë të përkthyer në gjuhë të tjera, të cilat gjenden në bibliotekën time, por nuk kam asnjë të tillë të përkthyer në shqip. Ky do ta zbukurojë koleksionin tim, madje do ta vendos në krye të tyre, - tha ai."*

I thashë me të qeshur se i takon, sepse emri i vendit tim fillon me shkronjën "A". Ai qeshi dhe më tha: "Jo, jo thjesht për këtë arsye".

Prej tij mësova se ai ishte anëtar themelues i Shoqatës së njohur *"Irish Friends of Albania"*, organizatë mjekësh, të cilët kishin bërë aq shumë për shqiptarët që vuajnë nga disa sëmundje, për të cilat Shqipëria ende nuk kishte një shërbim të plotë shëndetësor.

Pas takimit me presidentin vijoi parada ushtarake. Ishte hera e parë në jetën time që do të parakaloja me truprojë ushtarake nderi. Për të mos bërë asnjë gabim, isha stërvitur dhe kisha bërë prova me protokollin irlandez. Ishte vërtet diçka interesante, solemne dhe shumë emocionuese.

Ekzekutimi i Himnit Kombëtar Shqiptar në Pallatin Presidencial të Irlandës

Është ndoshta e pabesueshme ndjenja që provova, kur banda e ushtrisë irlandeze ekzekutoi Himnin Kombëtar Shqiptar. Jo vetëm që u ndjeva krenar që po nderoja kombin tim në atë mënyrë aq solemne ceremoniale, por pata edhe ndjesinë e respektit për punën. Për punën që ne shqiptarët duhet të mësohemi ta bëjmë ashtu siç duhet, me tërë përgjegjësinë e nevojshme.

Para se të shkoja në Dublin për këtë ceremoni, autoritetet e atjeshme të

Ministrisë së Jashtme më kontaktuan dhe më kërkuan partiturat e Himnit tonë Kombëtar. U ndjeva shumë i detyruar dhe bëra çmos, që t'ua dërgoja sa më parë. Por në kërkimet për partin muzikor të Himnit Kombëtar Shqiptar mësova se ai, ndonëse kishte një vijë melodike dhe ritmike, ishte i trajtuar në mënyra shumë të ndryshme nganjëherë shumë profesionale, por nganjëherë edhe shumë amatoreske dhe pa nivel. Për këtë thirra në ndihmë disa muziktarë.

Kurrë nuk e kisha dëgjuar Himnin tonë Kombëtar të interpretuar aq bukur

Kur ai Himn po ekzekutohej atë ditë, ndieja një emocion dhe rrëqethje të fortë, dashuri të zjarrtë për vendin tim, adhurim hyjnor për krijuesin e asaj melodie, edhe pse jo shqiptar, një ndjesi të pafund respekti për Asdrenin, që i kishte shkruar ato vargje dhe po ashtu për atë mësuese të thjeshtë muzike, një muzikanteje që i ka dhënë aq shumë Shqipërisë me botime për artistët, zonja Adelina Shehu Hoxha, e cila më dërgoi disa variante të orkestruara, por që më pat thënë:

"Si muzikante unë të them se atë që ka bërë Çesk Zadeja me orkestrimin e Himnit tonë Kombëtar, nuk ka mundur ta bëjë ndonjë tjetër. Të rekomandoj ta përdorësh pikërisht këtë".

E dërgova në Irlandë dhe ishte pikërisht ai variant që po luhej atë 10 tetor 2013. Isha unë që ndjeva se sa krenar na bëjnë njerëz të tillë nëpër botë. Sepse çdo punë e mirë, sado e vogël të duket, e ka vlerën e vet. Por, u ndjeva edhe xheloz, sepse kurrë nuk e kisha dëgjuar Himnin tonë të interpretuar aq bukur, nga ndonjë bandë ose orkestër shqiptare sa e ndjeva atë ditë nga irlandezët.

Shpura ceremoniale na mori përsëri bashkë me ata dy ambasadorë nga cepa të ndryshëm të botës dhe na ktheu në hotelin, ku ishim vendosur.

U largova duke lënë pas një kujtim të rrallë të jetës. Një moment që nuk harrohet kurrë. Një gur të vogël edhe në historinë e vendit tim, dhe në thesarin e kulturës irlandeze.

Dublin, Irlandë, 10 tetor 2013

"NOTES ON ALBANIA", EDICIONI I PARË, 16 DHJETOR 2013

Në kërkim të një metode sa më efikase për njohjen e Shqipërisë në Britaninë e Madhe, dhe në zbatim të teorisë së "Pushteti të butë", të cilin po e zbatoja në atë kohë në praktikën e punës sime, bashkë me anëtarët e personelit të Ambasadës u munduam të gjenim forma, të cilat do të tërhiqnin një masë sa më të madhe anglezësh në audiencat tona, shqiptare. Gjatë një diskutimi me diplomatet e ambasadës, dr. Teuta Starova dhe dr. Xhoana Papakostandini, vendosëm të hartonim një platformë për organizimin e një veprimtarie të ndërthurur me artistët shqiptarë, që performonin në Britaninë e Madhe. Ishin disa, por në atë kohë ata nuk kishin arritur të kapnin skenat e mëdha të Londrës, me përjashtime të vogla. Kështu bënim një rrugë e dy punë: Edhe promovimin e tyre edhe rrisnim emrin e shqiptarëve në Britani.

Emërtimi "Notes on Albania" i përdorur dikur nga Rose Wilder Lane

Më së pari na u desh të emërtonim atë veprimtari me një emër, i cili të bënte përshtypje. Në atë kohë po lexoja shumë materiale nga gazetarja e famshme amerikane, Rose Wilder Lane, e cila ka lënë një mori veprash të shkruara për Shqipërinë, të cilat ruhen në Koleksionin e Presidentit Herbert Hoover, në Stanford të Kalifornisë. Ndër to spikaste libri "Majat e Shalës". E veç atij libri të saj, ishte edhe një bllok shënimesh të marra në Shqipëri me një titull mbresëlënës:

"*Notes On Albania*".

Ky titull u përdor prej asaj zonje qysh në vitin 1925 në udhëtimet e saj madje qëndrimin edhe në kryeqytetin tonë, Tiranë. Atëherë vendosëm që atë aktivitet ta quanim pikërisht me këtë emër.

Reputacioni lëndues i disa shqiptarëve në Londër

Nga shtëpia ime në Vaxhual Bridge Road, pranë stacionit të metrosë Pimlico, çdo ditë një person më zgjaste një gazetë falas, të quajtur "Evening Post". Ajo ishte e mbushur me lajme sensacionale, kronika të zeza dhe… më e keqja, shumë herë në faqet e saj përmendeshin edhe shqiptarë. Nuk ka ndjenjë më të keqe sesa kur je në atë detyrë, dhe sheh në shtyp ose televizion lajme të tilla për bashkatdhetarët tanë. Një mijë arsye më shtynin për të bërë diçka, që deri në atë kohë nuk ishte organizuar në Londër, për ta sfiduar atë përshtypje që krijonin gazetat sensacionale...

Platforma dhe pjesëmarrësit

Pasi ndërtuam platformën, duhej bërë lista e pjesëmarrësve. Artistja e parë që na shkoi në mendje ishte sopranoja e njohur dhe një vizitore e shpeshtë e Operas Mbretërore në Londër, ROH, Ermonela Jaho. Njohja që kisha me të nëpërmjet fotografit të mirënjohur në New York, Fadil Berisha, më dha mundësinë të komunikoja dhe t'i paraqitja idenë, që kishim. Ajo e priti me shumë gëzim dhe premtoi se do të vinte në shfaqjen e Ambasadës dhe nuk kërkonte ndonjë lloj shpërblimi, duke e konsideruar nder që i bënte vendi i saj dhe nderi, që ajo do t'i bënte vendit të vet.

U vendos që edicioni i parë i "Notes on Albania" të bëhej më 16 dhjetor 2013. Kjo do të ishte një ditë ndërmjetëse midis ditëve kur ajo do të performonte në Operan Mbretërore të Londrës. Me atë rast do të festonim edhe Ditën e Shpalljes së Pavarësisë, kuptohet me më shumë se dy javë vonesë. Në Londër kjo ndodhte shpesh me ambasadat, të cilat i kremtonin festat e tyre kombëtare në një ndër datat, që atyre iu përshtatej, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë, si për shembull, mospërplasja me veprimtari të tjera, të cilat mund të

mbivendoseshin. Kishim vënë gurin e parë të kësaj gjëje, që rezultoi të ishte shumë e bukur. Pas kësaj bisedova me artistët që vepronin në Londër, duke iu adresuar më së pari violinistes së njohur shqiptare, Alda Dizdari. Ajo e pranoi me gëzim dhe respekt ftesën dhe premtoi se nuk do të kishte ndonjë pretendim financiar. Më tej vendosa kontakt me mezo-sopranon shqiptare, që performonte në Operan Rumune, Arlinda Morava, e cila u tregua e gatshme të vinte dhe t'u bashkohej artistëve të tjerë shqiptarë.

Koncerti u zhvillua në sallën *"Amaryllis Fleming Concert Hall"* të Kolegjit Mbretëror të Muzikës në Londër. Ai u ndoq nga një audiencë e gjerë prej më se 400 spektatorësh, ku kishte ambasadorë, diplomatë, lordë, parlamentarë, profesorë universitetesh, muzikologë, anëtarë të Shoqatës Anglo - Shqiptare, biznesmenë, dashamirës anglezë të muzikës, bashkatdhetarë me banim në Britaninë e Madhe etj.

Historia e këtij kolegji shkon shumë larg dhe është themeluar në vitin 1882. Ai është i vendosur në South Kensington. Aty organizohen trajnimet e nivelit më të lartë në të gjitha aspektet e muzikës perëndimore. Ai është njëri nga pjesëtarët e Bordit të Asociuar të Shkollave Mbretërore të Muzkës dhe pjesë e Konservatorit të Britanisë së Madhe. Ky kolegj është i vendosur pranë Pallatit Mbretëror të Artit, që mban emrin e Albertit, bashkëshorti i Mbretëreshës Victoria.

Salla e koncerteve të këtij kolegji mban emrin "Amaryllis Fleming", e cila është një hapësirë performuese e standardit më të lartë ndërkombëtar, që mund të strehojë koncerte të mëdha orkestrale dhe korale. Salla ka marrë emrin e Amaryllis Fleming për nder të muzikantes dhe edukatores së muzikës me të njëjtin emër.

Në qendër të koncertit ishte emri dhe frymëzimi i artistes tashmë me famë botërore, Ermonela Jaho, ndërsa programi i saj u plotësua me zërin e sopranos tjetër shqiptare e ardhur enkas në Londër nga Bukureshti, Arlinda Morava, shoqëruar në piano nga Maestro Petrescu dhe violinçelistja Klara Bregu, me tingujt e violinës së Alda Dizdarit dhe meloditë e mrekullueshme të luajtura nga Alb - Trio e Londrës, e drejtuar nga pianistja Mariela Cingo.

Hapjen e koncertit e bëri prezantuesja Kristale Rama, vajzë amerikane me prindër shqiptarë nga Tuzi, dhe më pas u urova mirëseardhjen artistëve dhe spektatorëve.

Shfaqja u përshkrua nga ritëm i lartë, plot emocione dhe u ndoq me interes të jashtëzakonshëm. Në mënyrë të veçantë u mirëpritën ariet e operave, si ajo e Puçinit "O mio babbino caro" nga Opera "Gianni Schicchi", "Manon" nga Opera me të njëjtin titull e Jules Massenet-it, interpretuar nga sopranoja Ermonela Jaho, pastaj këngët shqiptare, "Moj e bukura More", "Perëndeshë e bukurisë" kënduar nga Arlinda Morava. Alb - Trioja London, luajti Mendelson, ndërsa muzika e bukur e Limos Dizdarit u interpretua nga e bija e tij, violinistja e njohur, Alda Dizdari. Koncerti arriti kulmin me "Sempre Libera" nga "Traviata" e Verdit, interpretuar nga Diva shqiptare dhe u mbyll në mënyrë madhështore me këngën "Të duam më shumë Shqipërinë" ekzekutuar nga të gjithë artistët.

"Të duam më shumë Shqipërinë"

Kjo veprimtari madhështore na mësoi shumë gjëra: E para, kur ka dëshirë dhe vullnet, çdo gjë arrihet. Nga buxheti i ambasadës nuk u shpenzua asnjë cent (le që ku kishte buxhet për atë punë!). Marrëveshja me sallën u bë me një paradhënie (jo nga ambasada), që e siguronte teatrin se ata nuk do të humbisnin gjë në rast (mos e thashtë Zoti!) të dështimit të veprimtarisë. Biletat e shitura on-line përballuan më së miri shpenzimin e bërë për sallën, teknikën dhe shërbimet e tjera. Së dyti, u provua se artistët shqiptarë janë aq atdhetarë sa janë të gatshëm të performojnë pa ndonjë kusht, për ta ndritur emrin e vendit të tyre, mjafton që dikush t'i mobilizojë.

Pas kësaj veprimtarie, njëri nga atdhetarët tanë nga Kosova, inxhinieri Përparim Rama, shtroi një darkë për trupën interpretuese dhe personelin e ambasadës. Përpara se të organizohej veprimtaria, kishim porositur tek Argjendaria "Pirro" 13 pllaketa të bukura në bakër, të personalizuara me emrat e të gjithë pjesëmarrësve, të cilat certifikonin pjesëmarrjen e tyre në atë veprimtari. Kështu filloi një rrugëtim, i cili u zhvillua edhe dy herë të tjera dhe do të ishte bërë traditë e mrekullueshme, nëse nuk do të ndërpritej nga qeveria shqiptare.

Pas kësaj veprimtarie vërshuan kërkesat e artistëve shqiptarë, që performonin nëpër skena të ndryshme të Evropës dhe Botës, dhe ishin gati të jepnin ndihmesën e tyre në Londër, në nderim të atdheut të tyre. Kjo do të pasqyrohet

në artikullin, që pason për veprimtaritë "Notes on Albania" 2, dhe 3.

Në referencë të këtij edicioni të parë të "Notes on Albania" dëshiroj të sjell tre mesazhe: Të parin nga sopranoja jonë shumë e njohur dhe e suksesshme, që e nderon Shqipërinë në sallat më të mëdha të botës, edhe sot që po ju jepet në dorë ky libër.

Diva Ermonela Jaho:

Ta ndiesh veten shqiptare dhe ta nderosh emrin e Shqipërisë

"Të jesh artiste e ardhur nga një vend kaq i vogël, por me një histori shekullore si kjo e Shqipërisë sonë të dashur, është privilegj i madh. Për më tepër, të performosh në teatrot më të mëdhenj të botës, ku konkurrenca me artistët e tjerë është mjaft e madhe dhe të arrish të dalësh në majë, kjo është arritje e jashtëzakonshme. E të demonstrosh shpirtin e madh të kombit tonë, artin dhe kulturën, në formën e vet më sublime është detyrim dhe nder.

Shqipëria ka nxjerrë aq shumë artistë saqë, në përpjesëtim me popullsinë e saj, mund të përbëjë një fenomen, që nuk mund dhe nuk duhet të kalojë pa u vënë re. Në çdo skaj të botës do të gjesh një artist shqiptar, që ka lënë gjurmën e vet. Për habinë e të gjithëve, ky fenomen vihet re më shumë prej të huajve sesa prej nesh, shqiptarëve, vetë. Në fakt, ne duhej të ishim të parët që të krenoheshim me arritjet personale të secilit prej figurave të shquara të artit, kulturës, sportit nëpër botë. Por duket se jemi ne pikërisht ata, që nuk i vlerësojmë aq sa duhet.

… Koha ka treguar që, nëse ne nuk duam, nuk respektojmë dhe nuk vlerësojmë punën e njëri- tjetrit, nuk kemi pse të presim që këtë ta bëjë bota për ne!

Ky fenomen e zgjoi këtë ndjenjë te ne artistët shqiptarë për të bërë diçka të përbashkët për t'u bërë shembuj krenarie për brezat që do të vijnë, duke mos i lakuar thjesht emrat e përveçëm të secilit prej nesh, por si një tufë emrash e vlerash që përbëjnë shpirtin e vendit tonë.

Artistët janë ambasadorët e vërtetë të një vendi. Nevoja për t'i bërë të njohur vlerat kulturore të kombit tonë është detyrim patriotik i secilit prej nesh.

Shqipëria ka kaluar shumë peripeci për të prezantuar vlerat e saj nëpërmjet artit dhe kulturës. Ajo shpesh ka hasur edhe në mosnjohjen e këtij detyrimi nga ana e institucioneve, që përfaqësojnë Shqipërinë nëpër vendet e ndryshme të botës. Këtu e kam fjalën për ambasadorët tanë. Ata duhet ta drejtojnë vëmendjen drejt një prezantimi të tillë të denjë.

Sipas meje, të jesh ambasador i vendit tonë nuk do të thotë të jesh thjesht nëpunës i emëruar "nga lart", por përfaqësuesi me gamë 360 gradë, i tërë kombit.

Shumë pak raste kam hasur, nëpër vendet e botës ku kam performuar, që një përfaqësues i vendit tim të ketë prezantuar anën më të bukur, për të cilën ai ose ajo paguhen dhe që ndihemi krenarë, që vijmë nga i njëjti vend.

Ndër këto raste dua të veçoj Ambasadën tonë në Londër, kur përfaqësuesi ynë atje ishte zoti Mal Berisha, njeriu që nuk ka reshtur ndonjëherë për të nxjerrë në pah anët me pozitive të popullit tonë, duke kapërcyer atë rutinën administrative të dokumenteve të njerëzve pa dokumente…

Që në takimet e para, kryefjala e bisedave tona ka qenë dashuria për vendin, kulturën, artin, historinë, duke theksuar anët më pozitive, aq të çmueshme që ishin rreze drite në mjegullnajën e gjerë të problemeve të një vendi, si ky i yni, gjatë periudhës së tranzicionit.

Gjithmonë kemi folur për këtë apo atë emër të përveçëm, që fliste gjuhën tonë dhe jehonën e suksesit të asaj apo atij bashkatdhetari nga njëra anë e botës, në anën tjetër. Ideja shkonte te bashkimi i disa prej artistëve që, së bashku, të tregonim diçka më shumë sesa një vlerë folklorike, që i përket vetëm vendit tonë. Duhej të prezantoheshim duke folur një gjuhë të përbashkët artistike me botën. Të loznim jo vetëm napolonin apo muzikën e dasmave, sado të bukura që të jenë ato, por bash atë arsenalin e muzikës botërore, ku teatrot më të mëdha të krenoheshin, kur të kishin brenda edhe artistët shqiptarë.

Propozimi për të organizuar veprimtarinë artistike "Notes on Albania" m'u duk si hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm për ta prezantuar Shqipërinë në Londër, në një dritë tjetër. Ishte fjala që të performonim në një ndër sallat më të rëndësishme të kryeqytetit anglez, atë të Kolegjit Mbretëror të Muzikës, të njohur me emrin "Amaryllis Fleming Concert Hall".

Prezantimi i "Notes on Albania" pati kureshti të madhe. Publiku përbëhej nga shumë të ftuar të trupit diplomatik të akredituar në atë qytet, nga spektatorë anglezë me shijet më të holla artistike, nga shqiptarë, që jetonin në Londër,

artdashës të muzikës klasike dhe shumë admirues të mi. Këta të fundit mezi prisnin të më shihnin ndërsa këndoja operën "Manon" të Jules Massenet, në Operan Mbretërore ROH. Ne do të interpretonim në sallën ku janë përgatitur muzikantët më të mirë, jo vetëm të Britanisë por edhe më gjerë. Pranë asaj salle gjëndet edhe Albert Hall organizohet çdo vit ajo që njihet si BBC Proms.

Programi ishte përzgjedhur me repertor me muzikë të kultivuar shqiptare dhe botërore. Edhe pse jeta ime është një udhëtim i pandërprerë, nga një vend i botës në tjetrin, duke interpretuar për një publik të larmishëm multinacional, të performoje para një audience të tillë kishte padyshim peshën e vet emocionale dhe një përgjegjësi tepër të madhe.

Çdo pjesë e programit përftonte energji të veçantë te publiku dhe shfaqja shkonte në një kreshendo që kulmoi me himnin:

"Ta duam më shumë Shqipërinë".

Ajo krijoi një emocion kaq të fortë sa "miqtë e huaj" mbetën pa fjalë nga kjo mbyllje madhështore, ndërsa ne të gjithë, në skenë dhe në sallë u shkrehëm në lot. Ndërsa bashkatdhetarët tanë u ndien si asnjëherë tjetër të barabartë dhe krenarë për identitetin e tyre ndaj atyre të huaj që kishin në krah.

Ky ishte hap i madh drejt një promovimi vlerash të kombit tonë që e kemi detyrim të gjithë së bashku dhe vetëm së bashku mund ta arrijmë. E ndjeva dallimin në produksionin tim të radhës në ROH një vit më vonë. Prania shqiptare ishte më e madhe në numër sesa më përpara. Unë nuk shikoja në sytë e tyre ndonjë ndjenjë inferioriteti, përkundrazi dalloja krenari. Çdo vend ka kohën e tij për të ecur përpara, por vendin e bëjmë ne, njerëzit e vendit tonë. Ky koncert do të mbetet përjetë në zemrën time. Jam e sigurt që edhe të tjerët që kanë pasuar në edicionin e dytë dhe të tretë të "Notes on Albania" ruajnë të njëjtat mbresa.

Kur të duam, respektojmë dhe vlerësojmë njëri-tjetrin, atëherë do të jemi qenie humane më të mira, patriotë më të mirë dhe një komb i tërë, edhe më i mirë.

Në fund dua të them se pllakatin me emblemën e aktivitetit, i rrethuar me emrin e Ambasadës sonë në Londër dhe me emrin tim në mes, sikundër e morën edhe të gjithë pjesëmarrësit, e mbaj si një ndër dhuratat më të bukura që kam marrë ndonjëherë në jetën time si artiste.

Faleminderit "Notes on Albania", që na mblodhe dhe na bëre aq krenarë për atë që jemi: shqiptarë!

Maestro Alexander Petrescu, dirigjent, rumun

"Kam pasur kënaqësinë të drejtoj grupin muzikor rumun me soliste sopranon Arlinda Morava në një veprimtari të organizuar nga Ambasada Shqiptare në Londër, e titulluar "Notes on Albania". Ajo që pashë, atë natë të 16 dhjetorit 2013, ishte diçka e rrallë dhe unike. Rumania është vend mik i Shqipërisë që prej shekullit të 19-të, që me princeshën Dora D'Istria e deri tek Ismail Qemali, Asdreni e Viktor Eftemiu, e me radhë. Edhe sot një numër i madh artistësh shqiptarë vazhdojnë të marrin mësim dhe të performojnë në konservatorin dhe teatrot tona. E tillë ishte sopranoja Arlinda Morava, violinçelistja Klara Bregu nga Tirana, madje edhe violinistja Alda Dizdari, që morën pjesë atë natë. Aty pashë se sa i fortë është shpirti shqiptar, shpirti patriot i artistit shqiptar. Falë atij organizmi aq të denjë.

Sopranoja Arlinda Morava

Ftesës që morëm nga Ambasada Shqiptare në Londër për të marrë pjesë në edicionin e parë të "Notes on Albania" nuk mund t'i thoshim jo! E ndjeja se do të jepnim shfaqje në një mjedis shumë të rrallë dhe para një audience shumë të zgjedhur. Veç të tjerash, më joshte ideja se do të performoja përkrah divës shqiptare, tashmë shumë të njohur nëpër botë, Ermonela Jaho. Edhe pse jam një shqiptare e edukuar në Rumani, unë e adhuroja dhe e adhuroj muzikën e vendit tim dhe traditën e mrekullueshme të lënë nga Tefta Tashko - Koço, Marije Kraja, Jorgjie Truja e sa e sa të tjera. Në Bukuresht kisha patur rastin të interpretoja përkrah divës më të madhe të Rumanisë, Angela Georgiu, por asnjëherë me Ermonelën. Këtë mundësi na e dha Ambasada në Londër dhe kjo më bëri që ta shënoj në biografinë time një nga gjërat më të çmuara - interpetimin në sallën e Kolegjit Mbretëror të Muzikës, "Amaryllis Fleming Concert Hall" me artistët shqiptarë, që rrallë na takon të mblidhemi jashtë vendit tonë. Për mua, ajo mbrëmje mbetet një nga ngjarjet më të bukura artistike të jetës sime. E kujtoj me mall atë mbrëmje të madhe.

Violonistja, Alda Dizdari

"Isha vetëm 15-vjeçe kur u largova nga Shqipëria dhe mora rrugët e jetës që të integrohesha në një vend të huaj, pa ditur asnjë fjalë në gjuhën e vendasve. E trashëgova dashurinë për muzikën. që kur isha e vogël, përveç talentit edhe për faktin se isha bijë e dy muzikantëve shumë të njohur në Shqipëri. Që në fillim u mëkova jo vetëm me notat muzikore, por edhe me vendin që zinte arti dhe muzika në jetën e njeriut. E konceptova artin ashtu siç e thoshte muzikanti i madh gjerman Robert Schuman:

"Detyrë që të shpërndaj dritë aty, ku zë vend errësira në zemrat njerëzore".

Për shumë vjet u ndjeva shumë e vogël, por pas çdo përvoje të re, pas çdo shkalle që ngjisja në ecurinë time si artiste, pas çdo shkolle që përfundoja, apo vendi ku shkoja, ndieja se po rritesha edhe si muzikante edhe si njeri.

Me kalimin e kohës, me interpretimet e mia në violinë fillova të hapja dyer të gjera jo vetëm për jetën time. Prej kësaj violine filluan të më njohin edhe ata që nuk dinin gjë për vendin nga vija unë dhe, me kohë, u bëra një nga fijet lidhëse midis tyre dhe Shqipërisë tonë të dashur. Nëpërmjet meje, ata njiheshin me Shqipërinë interesante, me një histori, gjuhë e traditë të lashtë. Njohja e tyre me vendin tim, me kalimin e kohës, u kthye në një detyrë të rëndësishme për mua. Unë kam në dorë tingullin e instrumentit tim magjik, violinës, por nuk e konsiderova atë sikur është vetëm i imi. Ai i përket edhe prindërve të mi, shokëve të mi, vendit ku jam lindur e rritur. Ai tingull përmban ecjen e një jete të tërë. Më shumë se çdo gjë tjetër, shpirti i një muzikanti është i ndërthurur me shpirtin e vendit nga vjen. Është ky shpirt që mua më jep identitet, më bën të veçantë. Duke mos harruar kurrë muzikën e vendit tim, arrita të sillja jo vetëm përpara audiencave angleze, por edhe në shumë vende të tjera të Evropës, tingujt e njërit prej kompozitorëve më të mëdhenj anglezë dhe botërorë Edward Elgar, veprën e të cilit tanimë e kam bërë pjesë të repertorit tim më të zgjedhur i cili thotë:

"Ideja ime për muzikën është se ajo gjendet gjithkund rreth e rreth nesh, edhe në ajrin që na rrethon dhe frymojmë, pasi bota është e mbushur me të".

Duke përmbushur rolin tim si artiste, kam pasur fatin që këtë rol ta vë në shërbim të vendit tim. Këtë jam munduar ta bëj jo vetëm në skenat, ku jap shfaqje, por edhe në përfaqësinë tonë diplomatike në Londër.

Fatmirësisht disa nga diplomatët tanë nëpër botë e kanë kuptuar mirë këtë rol që mund të luajmë ne artistët për vendin tonë. Ndonëse vend i vogël, Shqipëria ka mundësinë e një prezantimi shumë më të fuqishëm, shumë më të gjerë, të bëhet e njohur përpara botës nëpërmjet të talenteve, që kanë spikatur në skenën botërore.

Ruaj me shumë dashuri përshtypjet nga mbrëmjet e bukura të organizuara nga Ambasada jonë në Londër në edicionet e saj "Notes On Albania".

Edicioni i parë ishte një mbrëmje muzikore me artistë shqiptarë nga bota, që komunikuan me publikun anglez dhe me shqiptarët e pranishëm me banim në Mbretërinë e Bashkuar. Ishte mbrëmje me shumë domethënie. Shqiptarët në sallë i mbushi me krenari, ndërsa britanikët i bëri më të ngrohtë dhe më dashamirës ndaj Shqipërisë. Ajo iu zgjoi kureshtjen që të vizitojnë e të njohin vendin tonë. Për ne artistët ishte një sallë si pak të tjera, ku u ndjemë më afër se kurrë me atdheun tonë, dhe në të njëjtën kohë, ambasadorë shpirtërorë të Shqipërisë në botë.

Londër, 16 dhjetor 2013

NJË DEBAT PËR HISTORINË ME AMBASADORIN SERB, OGNJEN PREBIČEVIČ, NË LONDËR

Pritjet diplomatike "madhështore" të vendeve të vogla

Në pritjet diplomatike secila ambasadë përpiqet të paraqesë vetveten sa me më shumë sharm, bukuri dhe sa më shumë elemente të veçantë për vendin që përfaqëson në dallim nga vendet e tjera. Edhe ne shqiptarët nuk bëjmë përjashtim. Në secilën prej këtyre pritjeve, sidomos në rastin e vendeve të vogla gjen me tepri elemente plot larmi e ngjyrim kombëtar.

Është më interesante kur sheh se si disa vende të vogla përpiqen të tregojnë "madhështinë" e tyre me një megalomaní të tepruar, deri në kufijtë e sforcimit të skajshëm. Njerëzit shkojnë aty, urojnë njëri-tjetrin, dëgjojnë fjalimet, kthejnë ndonjë gotë, bëjnë ca biseda, kapin ndonjë fjalë nga njëri-tjetri dhe largohen për t'i raportuar ato sa më parë në qendrat e tyre.

Kjo është rutinë e përgjithshme, por kur ambasadorët mbajnë fjalimet e tyre, aty shfaqet përpjekja për të treguar jo vetëm cilësitë e veta personale, por edhe të vendeve, që i kanë dërguar në përmbushje të atij shërbimi, që mbart misioni diplomatik.

Në mes shumë syresh dua të ndalem te një pritje, e cila më kujton pikërisht këtë lloj performance megalomane, me vetëmburrje publike të pamerituar, si dhe me përvetësim të historisë së të tjerëve, për interesa "diplomatike".

Ambasadori serb deklaron: 18 perandorë romakë ishin serbë?!

Ambasadori serb, dr. Ognjen Pribićević, është diplomat me një prejardhje

familjare intelektuale. Babai i tij kishte qenë profesor, xhaxhai, ambasador i Jugosllavisë në Tiranë, në fundin e viteve '70 të shekullit të kaluar. Në pritjet e tij ai përpiqet ta tregojë vendin e tij si "qendër të botës", si "vend i paqes", "viktimë e padrejtësive", "me kontribut të jashtëzakonshëm në historinë e njerëzimit", "vendi që i ka dhënë njerëzimit figura nga më të shquarat". Kjo e fundit na kishte ndodhur në kohërat antike kur sllavët ishin nëpër stepat përtej maleve Urale dhe asnjë këmbë e tyre nuk ishte vendosur ende në Evropë.

Pikërisht në një rast të tillë, në fjalimin që mbajti për nder të Festës Kombëtare të Serbisë, ai deklaroi para një audience të gjerë, ku merrnin pjesë ambasadorë, diplomatë, lordë, anëtarë të parlamentit britanik, zyrtarë të administratës qendrore dhe londineze:

> *"…të paktë janë ata që e dinë se Serbia i ka dhënë Romës as më pak e as më shumë por plot 18 perandorë, ndër ta edhe Kostandinin e Madh"…*

Një deklaratë e tillë bëri shumë njerëz të ditur të shfryjnë nën hundë, por shumë të tjerë të paditur të pranojnë atë "fakt" si një meritë e madhe e kombit serb. Dihej mirë se kjo ishte një deklaratë flluskë alla serbe, e bërë për një periudhë historike, fundi i së cilës ishte rreth 200 vjet larg nga fillimi i ngulimeve sllave në Ballkan, me rënien e perandorit të fundit romak Romulus Augustulus në vitin 476 si rezultat i rrëzimit të tij prej mbretit gjerman Odoacer, i cili mbretëroi deri në vitin 493. Edhe unë nënqesha dhe u largova atë natë nga pritja serbe, duke menduar se kisha rikonfirmuar atë që shumëkush nga Kosova ma kishte thënë:

> "*Serbët janë të tillë që mund të thonë publikisht edhe gjërat më të pavërteta, e të mos skuqen fare".*

Pse a nuk kishin thënë se Betejën e Kosovës të vitit 1389 në Gazemestan e kishin bërë vetëm ata, serbët, ndryshe nga çfarë thonë studiuesit seriozë të botës?

Sado që isha i sigurt që Ambasadori kishte bërë "detyrën që çdo serb duhet të bëjë", edhe pse e kisha studiuar me vëmendje historinë e Romës, iu ktheva edhe një herë asaj. Dhe ja, çfarë më rezultoi:

Në vitin 410 visigotët e drejtuar nga Alariku arritën t'i shpërthenin muret e Romës. Pas një mijë vjetësh Roma, që kishte pushtuar tërë Evropën, e shihte për herë të parë veten në duart e pushtuesit. Një prej arsyeve pse Roma ra, ishte se feja e krishterë kishte marrë hov të madh dhe po shpërndahej me shpejtësi. Ishte Perandori Romak Konstandini i Madh (272 - 337), i cili me organizimin e Këshillit të Nikeas (në Izmitin e sotëm të Turqisë) në vitin 325 i dha fund persekutimit të të krishterëve. Krishterimi u bë fe zyrtare dhe u përhap në çdo skaj të Perandorisë. Në vitin 330 Konstandini e ndau Perandorinë në dy pjesë - atë të Perëndimit me Romën si qendër dhe atë të Lindjes me Kostandinopojën, pra qytetin, të cilit ai i vuri emrin e vet.

Në Selinë e Nuncios Apostolik të Vatikanit, Kardinal Antonio Menini

Historia e 18-të "Perandorëve serbë" dhe e Konstandinit u përsërit edhe një herë në një darkë të shtruar nga Nuncio Apostolik i Vatikanit në Mbretërinë e Bashkuar, Imzot Antonio Menini. Ai e shtronte darkën për nder të përfundimit të misionit diplomatik në këtë vend të Ambasadorit të Malit të Zi, z. Ljubisha Stankoviç. Aty ishin edhe ambasadorët e Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë. Në një moment, Ambasadori serb Pribićević hapi përsëri të njëjtën bisedë. Ai tregoi para Nuncios për jetën e Konstandinit të Madh, i cili, sipas tij, "ishte nga Serbia". Sa krenarë ishin serbët, që kishin nxjerrë nga gjiri i popullit të tyre një figurë kaq të rëndësishme historike dhe sa shumë kishin kontribuar serbët për krishterimin, të cilin e mban sot perëndimi! Ai në fakt injoronte faktin se, veç tjerash, perandorët romakë deri te Konstandini, i cili e ndau Perandorinë në dy pjesë, të gjithë kanë qenë paganë dhe i kanë persekutuar të krishterët. I parafundit pagan, një ilir tjetër, Diocletiani (244 - 311), i cili sundoi nga viti 284 deri në vitin 305 e zbuti luftën, pasi e shoqja dhe e bija të dyja ishin kthyer në të krishtere dhe shkonin fshehtas për t'u falur në kishë.

Kur mbaroi ligjëratën, në mënyrë shumë të kujdesshme ndërhyra dhe e pyeta:

- Ambasador, më ndjeni nëse ju kërkoj diçka të parregullt, por a mund të më thoni kur ka lindur, kur ka sunduar dhe kur ka vdekur Konstandini i

Madh?

Ai nuk ishte aq i sigurt. Pasi i kujtova se kur kishte lindur dhe sunduar Konstandini, i drejtova një pyetje tjetër:

- Po sllavët, kur u vendosën në Ballkan?

Ai heshti pak dhe më tha:

- Po ç'rëndësi ka, ai ishte nga Nishi, Naisius dhe Nishi është në Serbi.

Por unë insistova në timen dhe i drejtova pyetjen tjetër:

- E vërtetë është kjo, po cilët ishin banorët e Nishit në atë kohë?

Nuncio përsëriti pyetjen time:

- Vërtet, cilët ishin?

- Ishin Ilirët, - iu përgjigja unë, - paraardhësit e shqiptarëve të njohur botërisht nga historia. Kostandini ishte ilir, siç ishte edhe Diocletiani. Pallati i këtij të fundit gjendet më në veri, në Split - Kroaci - Spalato. Në atë periudhë sllavët të gjithë jetonin përtej Uraleve dhe nuk është korrekte të thuash se perandorë, që kanë lindur në një tokë të populluar më vonë prej një kombi tjetër i përkasin kombit ripopullues.

Kështu u mbyll kjo darkë e këndshme diplomatike, ku u fol shumë për historinë e vërtetë, pas një shtrembërimi tipik sllav.

Londër, 15 shkurt 2014

MANDELA DHE ARBNORI - PËRSIATJE NË DITËN E NOBELISTIT NELSON MANDELA NË LONDËR

Në fundin e viteve '70 - '80 të shekullit të kaluar mbaj mend se përmendej nga organet e shtypit dhe të medies një regjim diktatorial i quajtur Aparteidi, i drejtuar nga një farë Peter Botha. Ky ishte regjimi i kolonizatorëve të bardhë kundër vendasve me ngjyrë në Afrikën e Jugut. Flitej për shtypje, dallim racor, përjashtim të njërës palë nga jeta publike dhe kthimi në skllavëri, privilegje dhe favore pa fund për palën tjetër. Thuhej se ai vend kishte 40 për qind të pasurive të arit të botës, por përsëri ishte shumë i varfër për shkak të kolonizatorëve. Më tej thuhej se ishte vendi i dytë me rezervën më të madhe të kromit në botë dhe, sipas statistikave të kohës, i pari ishte Bashkimi Sovjetik, ndërsa e treta ishte Shqipëria dhe e para në botë për banorë, në rezerva kromi. Më vonë filloi të flitej se familja mbretërore shqiptare kishte lëvizur nga Spanja, pas rënies së Frankos në vitin 1974 dhe ishte vendosur në Johanesburg. Flitej edhe se ishte një i burgosur i quajtur, Nelson Mandela. Natyrisht që edhe pse mësonim aq pak histori të vërtetë, e dinim emrin e gjeneralit Nelson, fitimtarit të madh të luftës së britanikëve kundër franko-spanjollëve në vitin 1805 në Kepin e Trafalgarit. Me njëzet e shtatë anijet e veta të vendosura në rresht, Lordi Nelson nën komandën e vet arriti të mposhtte tridhjetë e tre syresh nga pala franko - spanjolle të drejtuara nga admiral Francez Villeneuve në Kepin e Trafalgarit. Koalicioni i drejtuar prej tij humbi njëzet e dy anije, ndërsa britanikët asnjë. Por Nelson Mandela, për të cilin po flas, ishte njeriu, që zhvillonte një betejë tjetër, krejt ndryshe nga Lordi Nelson. Ai ishte një i burgosur, që luftonte kundër atij Aparteidi, me mjetet e tij, i burgosur, por i vendosur në një ideal, në një kauzë të lartë të kombit dhe në fakt të njerëzimit.

Westminster Abbey (Abacia Uestminsiter) - Londër në kujtim të Mandelës, 3 mars 2014

Në kujtim të Nelson Mandelës, në Abacinë më të madhe anglikane në botë, Westminster Abbey, do të mbahej një meshë e madhe me pjesëmarrjen e dinjitarëve më të rëndësishëm në Londër. Nga familja Mbretërore ishte i pranishëm Princi Harry, nga qeveria Kryeministri Cameron, zv/Kryeministri Clegg, lideri i opozitës Miliband; nga Afrika e Jugut pjesëtar të familjes së Mandelës dhe zv/presidenti i vendit; nga klerikët Peshkopi Desmond Tutu; nga trupi diplomatik tërë ambasadorët e akredituar në Court of St James's (Oborri i Shën Xhejmsit).

Është e vështirë të përshkruhet përjetimi në atë abaci. Nëse fjala "mahnitje" do të kishte kuptim për t'u përdorur, këtu e ka vendin e vet më të gjetur.

Pritja në dyert e atij institucioni fetar është e paimagjinueshme. Janë me dhjetëra ata të cilët i presin njerëzit me një respekt prej dinjitarësh. Secili njeri i ftuar e ka vendin e vet të caktuar dhe emrin në ulësen që e pret. Në qendër të kishës gjenden ballë për ballë disa rreshta ulësesh për njerëzit më të shquar në katër hollet e mëdha, të cilat mblidhen në qendër. Kjo krijon një kryq gjigand, ndërkohë që i tërë mjedisi thuajse në të njëjtën trajtë e formë jehon nga tingujt e muzikës së Bah-ut, luajtur nga një organo aq e fuqishme sa të mbajë tërë pjesëmarrësit në gjendje emocioni, në pritje të fillimit të asaj meshe të paharrueshme.

Mandela vs - vs Pjetër Arbnori

Ne dinim shumë pak për Mandelën sa ndoshta asnjë popull tjetër. Por përsëri dinim më shumë për Mandelën, që ishte mijëra kilometra larg nesh, sesa për Pjetër Arbnorin, që e kishim brenda vendit tonë. Dinim më shumë se për Osman Kazazin dhe sa e sa tjerë, të cilët shpesh herë na i rrëmbente regjimi ynë i Aparteidit tonë "nëpër duar", duke i deklaruar pa asnjë faj si "armiq të popullit".

Tani është e lehtë të gjykosh, por shumë herë ne shqiptarët kemi arsye të mos jemi aq krenarë, kur mendojmë sesi arrestoheshin njerëzit rreth nesh, ditën dhe natën, në kafe dhe në rrugë. Dhe e vetmja rezistencë ishte të stigmatizonim policinë, që kryente arrestimet, me ato tregimet me humor të zi si si ky:

"Në emër të popullit jeni i arrestuar", - i thoshte polici viktimës së tij kur e arrestonte."

"Ik, mor ti" i kthehej viktima, "se populli është në kokërr të gjumit".

Në të vërtetë po, ne populli ishim në kokërr të gjumit. Jo vetëm në gjumin e parë të mesnatës, por në gjumin letargjik të injektuar nga një Aparteid i një forme tjetër, i formës së ruajtjes së një regjimi diktatorial që vetëzgjidhej, vetëvritej, vetështohej, vetëngrihej, për të shtypur të tjerët.

Unë kam pasur rastin e lumtur, që të takoja dhe të bashkëpunoja me "Mandelën shqiptar", Pjetër Arbnorin, në fillimet e demokracisë shqiptare, madje edhe ta pres, ta shëtis dhe ta nderoj gjatë shërbimit tim në Stamboll. Ai ishte një burrë i qetë, shumë i matur në fjalë, me një sens humori dhe shumë i butë. E të mendoje atë çfarë kishte përjetuar ai në 28 vjetët e burgimit të tij të gjatë!

Takimet me Pjetër Arbnorin

Sa herë vinte në Stamboll z.Arbnori, sillte me vete librin e tij të radhës që kishte botuar dhe na e dhuronte me dedikim me shkrim dore, gjë që na gëzonte pa masë. Edhe sot i ruaj librat e tij të dhuruara me autograf: "Nga jeta në burgjet komuniste", "Kur dynden vikingët", "Mugujt e mesjetës", "Bukuroshja me hijen", "Letra nga burgu", "E bardha dhe e zeza", "E panjohura" dhe "Vdekja e Gebelsit".

Gjatë atyre takimeve ai më tregoi sesi librat që kishte shkruar në burg, i kishte shkruar në letrat e holla të cigareve ose në pjesën e bardhë të gazetave, që lejoheshin të hynin brenda mureve të qelive. Dhe në fakt, kur mësova për jetën e Arbnorit dhe të Mandelës gjeta dy gjëra të përbashkëta të tyre në ato vite të tmerrshme burgu.

Gardianët e burgut Christo Brand dhe Xhevdet Dani

Mandela i shkruante letra familjes, të afërmve dhe politikanëve, si dhe personaliteteve të ndryshme të botës, te të cilët kërkonte mbështetje. Ato letra të shkruara nga qelia e burgut të ishullit Robben nuk arritën kurrë në destinacion, pasi shërbimi sekret afrikano-jugor, i ndalonte. Por gardiani i tij i bardhë i qelisë, Christo Brand, u impresionua aq shumë nga sjellja dhe dinjiteti i Mandelës, saqë e ndihmoi atë t'i ruante letrat e tij. Mandela e dinte se letrat e tij nuk shkonin në adresën e duhur, kështu që çdo letër e shkruante në dy kopje. Njërën e niste me postë për të mos arritur kurrë në destinacion, ndërsa tjetrën ia jepte gardianit të vet, Christo Brand-it. Kështu, vite më vonë, kur Mandela doli nga burgu, ky djalë, të cilin Mandela e inkurajoi, që të vazhdonte shkollën, i ktheu të gjitha letrat, të cilat i ka botuar tashmë e bija e Mandelës, ndërsa Christo Brand-i është Drejtori i "Muzeut Mandela" në atë burg famëkeq të ishullit.

Sa shumë ngjet kjo histori e Mandelës me atë që i kishte ndodhur edhe Pjetër Arbnorit me gardianin e tij në burgun e Spaçit. Gardiani i tij, Xhevdet Dani, duke e njohur për ditë e më shumë të burgosurin që ruante, kishte rrezikuar seriozisht, duke e trajtuar me dinjitet dhe respekt prenë e shtetit, uniformën e të cilit e mbante veshur. Gardiani i Arbnorit, në vitet e demokracisë, shërbeu në policinë rrugore të shtetit dhe shpesh herë ishte drejtues i grupit shoqërues të z. Arbnori, kur ai drejtoi Kuvendin e Shqipërisë. Ai polic i thjeshtë iu gëzua edhe vetë lirisë dhe ndihej krenar, për atë që kishte bërë në atë burg. Kur e takoja, gjë që më ka ndodhur shumë herë, më habiste me rrëfimet e tij për marrëdhëniet midis tyre.

Si e mbrojti Skocia Nelson Mandelën

Gjatë një vizite në Glasgow pata rastin të bisedoja me një çift nga ai qytet. Ata u interesuan shumë për Shqipërinë dhe sidomos si do të kishte qenë jeta në kushtet e thundrës komuniste dhe izolimit të thellë. Iu shpjegova shumë gjëra, të cilat ishin shumë të vështira për t'u kuptuar prej tyre. Pastaj ata më treguan një histori shumë interesante nga jeta e Glasgow-t, me Nelson Mandelën dhe

për diktaturën në Afrikën e Jugut.

Ajo grua skoceze kishte qenë punonjëse e bashkisë së qytetit. Në vitin 1981, kur Mandela ishte në burg në Rodezi, Këshilli Bashkiak i Glasgow-t kishte vendosur t'i jepte emrin "Nelson Mandela" rrugës ku ishte e vendosur Konsullata e Përgjithshme e Afrikës së Jugut. Qëllimi ishte që çdo letër që do t'i shkonte kësaj konsullate të kishte emrin e Mandelës në zarf. Dhe kjo ishte mënyra më efikase për t'i turpëruar ata për sjelljen ndaj këtij liberatori. Kjo ishte një lloj mbështetje që ky qytet i jepte heroit të rezistencës kundër Aparteidit. I tregova se si edhe ne që e kishim vendin plot me të burgosur si Mandela, e dënonim persekutimin ndaj tij.

U habita me veten! Si ka mundësi që një regjim më i egër se Aparteidi, na tregonte ne në atë kohë për Mandelën dhe na fshihte qindra mijëra të burgosur shqiptarë të ndërgjegjes!

Mesha e drejtuar nga nobelisti i paqes - Destmond Mpilo Tutu

Destmond Mpilo Tutu, i lindur në vitin 1931 vinte nga një familje e varfër afrikano-jugore. Ai është një ndër luftëtarët më të paepur kundër Aparteidit dhe mbrojtës i të drejtave të afrikanëve. Ai ishte mbështetës i Nelson Mandelës e megjithatë arriti të bëhej Peshkopi i Johanesburgut, nga vitit 1985 deri në vitin 1986, dhe më pas Kryepeshkop i Cape Town, nga viti 1986 deri në vitin 1996, duke u bërë në të dyja rastet i pari afrikan me ngjyrë, që u ngjit në atë pozitë.

Ai mbajti meshën e asaj dite në Westminster. Gjëja e parë që më erdhi ndërmend ishte paralelja e karrierës së këtij njeriu me atë të priftërinjve katolikë në Shqipëri. Edhe pse Aparteidi konsiderohej si regjimi më i ashpër shtypës në botë, madje edhe te ne në Shqipëri, feja lejohej dhe bashkësia me ngjyrë e Afrikës nxirrte nga gjiri i vet një Kryepeshkop të tillë si Destmund Tutsu, i cili më vonë mori edhe Çmimin Nobel për Paqe.

Nobelisti Tutsu, foli aq bukur atë ditë dhe e ktheu atë meshë në një moment reflektimi ndaj lirisë për tërë ata njerëz në atë abaci. Ai tha:

"Mandela na bëri të gjithëve të besojmë se secili prej nesh është krijuar prej

mirësisë, se jemi krijuar për t'u kujdesur për njerëzit, për t'i dashur, jemi bërë për të treguar dhembshuri, për të qeshur, për të jetuar në paqe. Pa lëvizjen anti-Aparteid, pa ndihmesën tuaj njerëzore të jashtëzakonshme, Mandela fare lehtë mund të kishte vdekur në burg", tha Arkipeshkopi Tutu.

Më pas ai citoi fjalimin e Mandelës në ditën e përurimit të tij si President i Afrikës së Jugut, pjesë të së cilës i mora shënim atë ditë:

"Të nderuar miq!

Sot, të gjithë ne, me praninë tonë këtu dhe me festimet tona në pjesë të tjera të vendit tonë dhe gjetiu në botë, i japim lavdi dhe shpresë lirisë së porsalindur. Nga përvoja e një fatkeqësie të jashtëzakonshme njerëzore, që zgjati shumë vite, duhet të lindë një shoqëri, ku gjithë njerëzimi do të jetë krenar.

Veprimet tona të përditshme si afrikano-jugorë të zakonshëm duhet të prodhojnë një realitet të vërtetë afrikano-jugor, që do ta përforcojë besimin e njerëzimit në drejtësi, do ta forcojë besimin e tij në fisnikërinë e shpirtit njerëzor dhe do t'i mbështesë të gjitha shpresat tona për një jetë të denjë për të gjithë.

Ne kemi triumfuar në përpjekjet për ta ngjallur shpresën në zemrat e miliona njerëzve tanë. Ne hyjmë në një besëlidhje, që do të ndërtojmë shoqërinë, në të cilën të gjithë afrikanët e jugut, me ngjyrë apo të bardhë, do të jenë në gjendje të ecin krahas e për kohë të gjatë, pa asnjë frikë në zemrat e tyre, të sigurojnë të drejtën e tyre të patjetërsueshme për dinjitetin njerëzor - një komb në paqe me veten dhe me botën.

Këtë ditë ua kushtojmë të gjithë heronjve dhe heroinave në këtë vend dhe pjesës tjetër të botës që sakrifikuan në shumë mënyra duke dhënë edhe jetën për të bërë që ne të dilnim në liri."

Ëndrrat e tyre janë bërë realitet. Liria është shpërblimi i tyre.

Ne e kuptojmë shumë mirë se nuk ka rrugë të lehtë për ta fituar lirinë.

Ne e dinim më mirë se askush se po të vepronim vetëm, nuk mund ta arrinim suksesin.

Prandaj duhet të veprojmë së bashku, si popull i bashkuar, për pajtimin kombëtar, për ndërtimin e kombit, për lindjen e një bote të re.

Le të ketë drejtësi për të gjithë!

Le të ketë paqe për të gjithë!
Le të ketë punë, bukë, ujë dhe kripë për të gjithë!
Le të sundojë liria!
Zoti e bekoftë Afrikën!

Westminster Abbey, 11 qershor 2014

"GJENERAL KUTUZOVI IM" DHE INCIDENTI I PARTITURËS SË HARRUAR NË CADOGAN HALL, LONDËR

Me kompozitorin Mark Stephenson në Teatrin "Cadogan"

Salla "Cadogan" në Sloane Square është një ndër qendrat kulturore më të famshme në Londër, e njohur për traditën e saj të koncerteve dhe pritjen e artistëve nga e tërë bota. Mbrëmjen e 11 qershorit 2014 pata rastin të isha mysafir i ftuar nga Mark Stephenson, muzikant i njohur, dirigjent dhe organizator veprimtarish muzikore. Me Markun na lidhi një miqësi e madhe, kur ai mësoi për cilësinë e performancës së artistëve shqiptarë në veprimtarinë e organizuar në dhjetor të vitit 2013, të titulluar "Notes on Albania". Marku menjëherë kishte rënë "në dashuri" me artistët dhe sidomos me muzikën qytetare shqiptare, të cilën e konsideroi si vlerë të madhe në fondin botëror të muzikës.

Atë natë salla ishte e mbushur plot, siç ndodh përherë në "Cadogan Hall", i cili ka kapacitet prej 900 vendesh dhe ka si bazë Orkestrën Filarmonike Mbretërore.

Ajo është gjithashtu pjesë e asaj që tani njihet si *BBC Proms*, veprimtaria më e bukur dhe më e zgjatur, plot 56 ditë rresht me tërë krijimtarinë e mundshme muzikore të Britanisë së Madhe dhe muzikës klasike botërore. Aty ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe orkestra të tjera londineze, ku shquhet Orkestra e Harqeve të London Mozart Players etj.

Me balerinën Anna Dwyer - stërmbesa e gjeneralit rus, Kutuzov, që kishte mundur Napoleon Bonapartin në Betejën e Borodinos

Ndër gjërat që më bëri shumë përshtypje atë natë ishte fakti që Marku jo vetëm

që na kishte ftuar në koncertin e tij pianistik me katër artistë të ndryshëm, të cilët do të luanin në një tastierë pianoforte me tetë duar, por edhe, për të na nderuar, kishte caktuar një zonjë të sjellshme të quajtur Anna Dwyer. Arsyeja përse e kishte caktuar pikërisht këtë ishte se Anna na qenkësh stërmbesë e gjeneralit rus Kutuzov, që fitoi mbi Napoleon Bonapartin në betejën e Borodinos.

- Ambasador, - m'u drejtua ai mua. - Sonte juve do t'iu shoqërojë Anna, e cila është stërmbesa e gjeneralit rus, që mposhti Napoleonin.

- Oh, - i thashë, - stërmbesa e Kutuzovit?

- Ajo të tregon vetë, - më tha Marku.

Dhe kështu hymë në një bisedë, e cila ishte interesante.

Ajo kishte gjak nga Kutuzovi, i cili është aq i njohur për ne shqiptarët e brezit tim, pasi ai ka pasë zënë një vend të rëndësishëm në historinë e botës, të cilën na e kishin mësuar në shkollë.

I lindur në vitin 1745, ai ishte një ndër ushtarakët më të mëdhenj të Rusisë Cariste dhe iu shërbeu Romanovëve me radhë, duke filluar nga Katerina II, Pavli I dhe Aleksandri I. Ajo që e bëri atë të pavdekshëm është Beteja e Borodinos dhe fitorja mbi trupat franceze të Napoleon Bonapartit. Nën drejtimin e tij rusët korrën një fitore me sakrifica, e cila e vuri Kutuzovin në radhën e gjeneralëve fitimtarë të pavdekshëm. Ky emër ishte shumë familjar për mua, edhe sepse në zboret e përvitshme që bënim në Institutin e Arteve kishim një student të pikturës, me mbiemër Topallaj, i cili vinte nga Shkolla e Bashkuar. Me një fjalë, ai do të bëhej piktor ushtarak. Ai do të bëhej piktor, por profesioni i tij i parë ishte ushtarak. Dhe si i tillë, kur shkonim në zbor ai bëhej komandant. E tërë shkolla e thërriste *Kutuzov*. Kutuzovi i ILA-së të urdhëronte të zgjoheshe me "alarm" në mes të natës, të rreshtoheshe me shpejtësi, madje mund të aplikonte edhe masa ndëshkuese në rast mosbindjeje. Të zgjonte herët dhe nuk të linte të flije deri vonë. Ishte vërtet oficer, të cilit nofka Kutuzov ia ledhatonte sedrën, por nga ana tjetër e bënte shumë simpatik dhe pedant. Kthimi i tij në jetën civile studentore ishte pak i vështirë për të, pasi kështu ai bëhej si të gjithë ne të tjerët.

Por Anna, që kisha në krah atë natë, nuk kishte asnjë tipar as të Kutuzovit të Borodinos as atij "Kutuzovit" të ILA-së. Ajo ishte zonjë bukuroshe e mrekullueshme, balerinë që, nën muzikën magjike të Çajkovskit, Prokofievit, Rrahmaninovit, Nikolai Kapustinit, Lutoslawskit, gjithë këtyre rusëve, kishte

pushtuar skenat e botës.

Me interpretimin e saj ajo i bënte njerëzit të ndiheshin si në një botë tjetër. Po për mua ajo kishte edhe një lidhje me historinë përveçse me muzikën.

Anna, e cila mund të ishte një brez ndoshta i teti i largët me Kutuzovin, ishte aq krenare për këtë dhe nuk pushonte së foluri, se ajo atë natë ishte aty jo si artiste, as si pedagoge e baletit, as si mikeshë e Markut, por si pasardhëse e Kutuzovit për të nderuar Ambasadorin e Shqipërisë. Në fakt, nuk kishte si mos të më përkëdhelej sedra e shqiptarit, sedra e ambasadorit dhe, pse jo, sedra e një burri, që dëgjonte fjalë të zgjedhura nga një zonjë e kulturuar super-aristokrate.

Koncerti i madh dhe defekti i "vogël"

Pjesa tjetër e koncertit mund të konsiderohet shumë e bukur. Por, si për t'ia prishur syrin asaj mbrëmjeje, ndodhi diçka, e cila nuk pritet të ndodhë në një sallë magjepsëse si ajo dhe në një organizim aq të përsosur.

Atë natë performuan katër artistë nga vende të ndryshme: Arsha Kaviani, Grace Francis, Julian Clef dhe Salih Can Gevrek. Repertori i tyre ishte i përsosur, pa dyshim. Grace Francis, artiste angleze, kishte një pamje mistike dhe një veti, të cilën nuk e kisha parë ndonjëherë. Ajo, para se të interpretonte në piano, e fshinte tastierën nga fillimi në fund me një napë të pastër e të bardhë. Kjo më ngjau me një pedagoge, që e kisha pasur në shkollë, e cila kishte fobi nga dorezat e dyerve apo çdo gjë që preknin të tjerët dhe i hapte dyert, duke mbajtur në dorë një shami. Më vonë mësova se Grace vuante nga një variant i autizmit. Kur e përshëndeta pas koncertit dhe i shtrënguam duart, duart e saj ishin akull të ftohta dhe të lagëta, sikur i kishte nxjerrë nga një enë me ujë me akull.

Koncerti dhe Gezi Park në Stamboll

Arti dhe politika janë përherë të lidhura. Sado të mundohet dikush t'i ndajë, ato prapëseprapë janë bashkë. Pianisti turk Sali Can Gevrek kishte ardhur me një pjesë kushtuar Ataturkut. Ky burrë i madh ende vazhdonte të frymëzonte brezat e artistëve turq. Gevreku e kishte shkruar pjesën për të rënët në Gezi Park.

Përpjekjet e rinisë stambollite për të mbrojtur parkun kishin dështuar përpara makinës shtypëse të shtetit. Por ai e kishte përjetësuar ato në një elegji pianistike rrëqethëse për nga përmbajtja, emocionuese nga interpretimi dhe fisnike për nga ideja. Në bisedën me ambasadorin turk atë natë pashë gëzimin e këtij të fundit për krijimtarinë e atij djali. I tregova se për katër vjet e gjysmë, thuajse çdo ditë kisha shëtitur në atë park, ose i kisha kaluar anash me makinë ose kisha pirë kafe dhe pushuar në mjediset e tij. Gezi Park u bë arenë përleshjesh. Kjo na e bëri bisedën edhe më interesante. Por ajo që më kënaqi edhe më shumë ishte kur ambasadori turk Ahmet Ünal Çeviköz iu drejtua atij:

> *"Ambasadorin shqiptar në Londër e kam si akraba, pasi gjyshja ime ishte shqiptare nga Shkodra. Ajo ishte e vetmja e shpëtuar nga një luftë e Ballkanit në vitin 1913 dhe iku nëpër flakë pasi iu dogj e tërë familja nga malazezët. Ajo kurrë nuk harronte të na tregonte për vendin e saj dhe vdiq me merakun e madh për ta parë atë, ndonëse nuk kishte askënd të gjallë që ta njihte nga fisi i saj".*

Por le të kthehemi te koncerti. Ai ishte vërtet shumë i bukur. Arsha Kaviani ishte iranian, Julian Clef ishte indian, Grace Francis - angleze ndërsa Gevreku - turk. Në pjesën e dytë të koncertit ata do të bënin një spektakël, që do të mbahej mend gjatë. Në fillim do të luanin në një piano me katër duar, domethënë, dy pianistë në një tastierë.

Ngjashmëri me pianistët Julia Kruger dhe Victor Bunin në Kosovë dhe në Shqipëri

Kjo më kujtoi mrekullinë që kam përjetuar duke parë Julia Kruger dhe Victor Bunin, dy miq të mirë; njëra amerikane nga Austini, Teksas, zv/Presidente e Shoqatës Amerikane të Pianistëve dhe tjetri Artist i Merituar i Bashkimit Sovjetik nga Moska. Ata të dy luajnë me katër duar dhe loja e tyre është përherë një magji e rrallë muzikore. Njohja me Julian dhe me Viktorin është një histori e veçantë dhe interesante, por ajo që më bën përherë t'i kujtoj me respekt është kur mendoj se ata, thjesht si miq, erdhën për të dhënë shfaqje pa shpërblim në Prishtinë, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë, si edhe te Pallati i Kulturës tek

Ura e Ibrit në Mitrovicë. Më pas me ta udhëtova për në Butrint, dhanë shfaqje në Kalanë e Gjirokastrës dhe në Teatrin e Operas në Tiranë. I prita si mysafirë edhe në Londër dhe, që prej asaj kohe, nuk e kemi harruar kurrë njëri-tjetrin.

Incidenti - Partitura muzikore që do të luhej me katër duar, e harruar në shtëpi

Koncerti në Cadogan shkoi shumë bukur deri në një moment. U kalua në një piano me gjashtë duar ose me tre pianistë. Ishte vërtet mrekulli dhe një kombinim virtuoz. Por, përherë del diçka, që e prish syrin e keq. Ndërkohë që salla priste të luhej pjesa me tetë duar, Marku, i skuqur deri te veshët, doli para spektatorëve dhe iu adresua:

"Ju keni qenë sonte audienca më e mirë në botë. Ju na keni mbështetur dhe na keni bërë të ndihemi artistë. Por një incident i vogël nuk do të na lejojë të luajmë pjesën e fundit, pjesën pianistike me tetë duar. Duket e thjeshtë, por një prej pianistëve nuk e ka sjellë partiturën me vete".

Në fakt ky ishte një farë zhgënjimi për sallën, por bëri edhe atë që kjo shfaqje të mos mbahet mend thjesht dhe vetëm për mrekullinë e këtyre artistëve, por edhe për këtë incident të vogël.

Ngjashmëri në kohë të ndryshme

Kjo më kujtoi një ngjarje që qarqet artistike në Tiranë në vitet e shkollës sime e tregonin për një nga artistët tanë të talentuar, kur studionte në Moskë. Në një shfaqje muzikore në Teatrin Balshoi artisti shqiptar ishte solisti kryesor. Salla ishte plot. Në numrin e radhës ai duhej të ndërronte kostumin për të interpretuar. Kur u vesh me shumë nxitim, një pjesë e këmishës së bardhë i mbeti jashtë pantallonave në pjesën e përparme. Ai po këndonte Rigoleton me një pasion të jashtëzakonshëm, ndërsa salla gajasej së qeshuri. Kjo vazhdoi thuajse gjatë tërë kohës kur ai po interpretonte dhe në fund salla e përcolli me ovacione të papërmbajtshme. Të nesërmen gazetat moskovite të artit shkruan: "Debutim i jashtëzakonshëm i një artisti të madh shqiptar dhe një incident i

vogël". Në ballë të faqes së gazetave ishte fotoja e artistit tonë të madh me cepin e këmishës së bardhë të dalë nga pantallonat.

Kështu ndodh me ngjarjet e mëdha të artit. Të jesh dëshmitar i tyre është kënaqësi.

Cadogan Hall, 14 qershor 2014

EPISODE NGA NJOHJE ME NJERËZ TË NDRYSHËM

Në mjediset e "Rathbones" në Soho, Londër

Kompania angleze "Rathbones" është ndër më të famshmet në atë vend. Ajo është formuar në vitin 1742 prej William Rathbone dhe e ka filluar biznesin me tregtinë e drurit. Në shekullin 19-të ajo arriti të bëhej kompani drejtuese në tregtinë e pambukut me Shtetet e Bashkuara. Në vitin 1941 ajo u bë kompania përfaqësuese e Kompanisë India Lindore. Në vitin 1982 i la veprimet tregtare dhe u kthye në një kompani menaxhimi financiar në fillim për familjen Rathbones dhe më vonë për publikun e gjerë. Në vitin 1988 ajo u rendit si një nga kompanitë më të rëndësishme në Bursën e Londrës. Asetet dhe veprimtaria e saj llogariten në miliarda sterlina.

Pak histori nga Rathbones

Në vitin 1720 djali i një bujku u nis nga fshati Cheshire për të shkuar në Gausurth të Liverpulit. Atij i duhej të bënte 40 milje në një rrugë pa rrugë krejt me baltë dhe të vështirë për t'u kaluar. Këtu filloi edhe udhëtimi i kësaj kompanie mbi dyqindvjeçare.

Qendra e veprimtarisë së saj gjendet në Londër dhe pata rastin të merrja pjesë në një drekë, i ftuar nga miku im Michael Larry, drejtuesi administrativ i Ambasadës Kristiane në Londër.

Në këtë drekë merrnin pjesë lordë, diplomatë, komisionarë të lartë. Dreka u shtrua në një sallë shumë elegante dhe me një thjeshtësi, që i shkonte luksit

të atij mjedisi. Përveç shkëmbimit të kartave personale, duhej bërë edhe një prezantim. Secili prezantoi veten, ashtu veprova edhe unë.

Ambasadori i Ambasadës Kristiane Michael Larry

Michael Larry, në përmbushje të qëllimeve të tij të ngarkuara nga ungjillorët e vet në SHBA, kishte bërë kujdes që të siguronte një pjesëmarrje, e cila të sillte jo vetëm një farë bashkësie të pjesëmarrësve, por edhe larmi. Unë duhej të isha ai, që bënte dallimin më të madh. Arsyeja ishte se të gjithë folën për lidhjet me Jezusin dhe se si ai ua kishte ndërruar jetën.

Si i "shpëton" jetët Jezus Krishti?

Robert Rathbones, përfaqësuesi i firmës na paskësh qenë në ushtri dhe një thirrje e brendshme i kishte thënë të kalonte në biznes dhe kështu kishte bërë që prej njëzet vjetësh. Në intervistën që kishte dhënë te "Rathbones" kishte shkëlqyer. Kur kishte shkuar për të marrë përgjigjen ai ishte pyetur se cila ishte fjala më e ëmbël, që donte të dëgjonte dhe përgjigja kishte qenë: Jezusi. Kështu që ai kishte fituar dhe po kështu kishte ndodhur mrekullia.

Përfaqësuesi i Sierra Leones

Folësi më i shquar i tavolinës na doli të ishte Edward M. Turay, Komisionari i Lartë i Sierra Leones. Një burrë i qethur krejt zero, me syze, bishtat e të cilave kishin formuar një kanal të thellë mbi veshë, me sy të zgjuar e vështrim të thellë dhelparak, e një anglishte tipike afrikane, që unë kam pasur përherë vështirësi ta kuptoj (përveç kur e fliste Mandela), na shpjegoi jetën e vet dhe si e kishte shpëtuar Jezusi.

- Unë, - tha ai, - jam vetë i gjashtëdhjeti fëmijë, vëllezër e motra.

Dikush aty i tha:

- Ju doni të thoni i gjashtëmbëdhjeti?

- Jo, jo, - tha Eduardi! I gjashtëdhjeti, gjashtë, zero, - bëri me shenjë në tavolinë me gishtin tregues.

Kjo bëri që ai të merrej seriozisht. Djali kishte pesëdhjetë e nëntë vëllezër e motra. Vallë, a i njihte të gjithë, thashë me vete!?

- Unë, - tha ai, - kam drejtuar parti, kam bërë politikë, kam fituar dhe humbur në zgjedhje. Jam burgosur pesë herë, kam vuajtur shumë vite në burg, kam parë edhe më të keqen. Por shpëtova falë Jezusit.

Ai filloi të na tregonte një histori, e cila ma tërhoqi edhe më shumë vëmendjen.

- Pas shumë peripecish politike, - tha ai, - në vendin tim ndodhi grusht shteti. Ai që e mori pushtetin, gjëja e parë që bëri burgosi 25 politikanë. Unë isha një ndër ta. Burgu kishte kushte të tmerrshme. Një ditë tek po rrija në oborrin e burgut, Jezusi më tha: "Përpiqu të ikësh, sepse sonte do të ekzekutohesh". Në fillim m'u duk si ëndërr ose përsiatje. Por kur u kthjellova, mendova se fjalët e Krishtit Mbret nuk duheshin të neglizhoheshin kurrë. Prandaj vendosa të bëja çfarë të mundja.

Kështu z. Turay na shpjegoi mënyrën sesi e përgatiti dhe arriti arratisjen nga burgu. Kështu bëri. Ai u largua nga burgu dhe vajti në shtëpinë e tij në mes të zombive. Atje ai u fsheh, por nuk harroi të ndizte një radio për të dëgjuar lajmet. Të nesërmen mësoi se 24 shokët e tij të burgut u ekzekutuan. Që andej ai ia doli të largohej nga Sierra Leone. Jeta e tij nuk përfundoi këtu, madje as karriera. Ai sot është Komisionar i Lartë i atij vendi dhe e ka takuar Mbretëreshën Elizabeth II, nëntë herë deri në ditën, që e tregoi historinë.

Ku e di njeriu i gjorë me kë i takon të drekojë e të darkojë. Mund të jenë edhe "heronj" si Edward Turay, bij të një vendi të mbushur me histori të pafundme, madje të përgjakshme.

FQINJËT E MI NË PIMLICO - LONDËR DHE TAKIME ME NJËRËZ TË SHQUAR

Penguin Random House

Banesa ime në Londër ishte e vendosur në Rrugën Vaxhuall Bridge Road, Nr. 8. Ndërtesa qëndronte midis tre prej objekteve më interesante të Londrës. Në të djathtë, kur dilja nga dera kryesore, gjendej menjëherë Penguin Random House, shtëpia më e madhe botuese anglo - amerikane në botë. Ajo ishte si pikë orientimi për gjithë qytetin e Londrës. Sa herë kaloja aty, shihja me respekt atë ndërtesë të thjeshtë me fasadë të mermertë, që mbante brenda saj të botuara veprat më të mira të letërsisë botërore, të të gjitha llojeve. Midis veprave që janë botuar prej saj, gjenden edhe shumë libra për Shqipërinë si dhe një kolanë librash të Ismail Kadaresë, të përkthyera në anglisht, siç janë: "Një vajzë në azil", "Koncerti", "Ura me tre harqe", "Piramida", "Tre vaje për Kosovën", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Pallati i ëndrrave", "Dosja H", "Prilli i thyer". Aty botohen edhe disa nga veprat e Sir Noel Malcolm për Shqipërinë siç është libri "Agjentët e Perandorisë", si dhe vepra të autorëve të tjerë të huaj për Shqipërinë.

Ambasada e Lituanisë

Ngjitur me ndërtesën e apartamentit tim ishte Ambasada e Lituanisë. Ajo është një ndërtesë pesëkatëshe, e bardhë, e bukur, me kolonada të stilit dhe kohës gjeorgjiane.

Ajo ndërtesë ka qenë ambasadë, që prej vitit 1918, kur Lituania, pas një

historie të gjatë luftërash mijëravjeçare u konsolidua si shtet demokratik. Ajo mbeti shtet i pavarur deri në qershor të vitit 1940 kur Bashkimi Sovjetik, bazuar në marrëveshjen Molotov - Ribentrop, ajo bashkë me vendet e Baltikut u pushtuan nga Bashkimi Sovjetik. Ai vend qëndroi i pushtuar për pesëdhjetë vjet. Në vitin 1991 Lituania e përfitoi përsëri pavarësinë nga sovjetët. Më interesantja për mua ishte se ky objekt i Ambasadës u ruajt nga anglezët i paprekur dhe nuk iu dorëzua kurrë diplomatëve sovjetikë. Britania e Madhe kurrë nuk e njohu pushtetin sovjetik mbi Lituaninë. Madje, edhe marrëdhëniet midis dy shteteve, Britanisë dhe Lituanisë, edhe pse kjo e fundit nuk ekzistonte më si shtet, nuk u ndërprenë me akt zyrtar. Ndërsa ndërtesa iu dorëzua lituanezëve, e ruajtur dhe e paprekur, kur ata shpallën pavarësinë. Ambasadorja, Asta Skaisgiryte Liauskiene, me të cilën shiheshim shumë shpesh, si fqinjë të mirë që ishim, më tregonte me krenari për historinë e marrëdhënieve të shtetit të saj me Britaninë e Madhe dhe kujdesin, që kjo e fundit kishte treguar për Lituaninë. E dëgjoja me kureshtje e jo pa xhelozi. Kryeministri britanik, Chamberlain, atë ditë të pushtimit të Shqipërisë nga Italia vazhdoi të gjuante peshk, pa e prishur terezinë. Këtë e përshkruan më mirë se kushdo Faik Konica, fill pas pushtimit fashist të 7 prillit, 1939.

Takime me Simon Schamën, rrëfimtari më i shquar i BBC-së

Kafeja e vogël "Lebanise Garden" ishte ngjitur me daljen e pallatit tim. Ajo, në ditë të mira pa shi, gjë që ishin shumë të rralla në Londër, nxirrte dy tavolina me nga dy karrige në trotuar. Në një ditë të tillë dola nga shtëpia, mora djathtas për të kaluar rrugën drejt stacionit të metrosë, Pimlico. Sytë e mi u ndeshën me sytë e një zotërie, që menjëherë e njoha. Ai ishte një burrë me flokë të përvjelë, të thinjur, me fytyrë me vija të thella në anën e gojës, me sy të mëdhenj, shumë shprehës. E njoha menjëherë. Ishte një ndër rrëfimtarët më të famshëm të televizionit BBC, Simon Schama. E pashë dhe menjëherë ndalova. Isha në mëdyshje: t'i flisja apo jo një njeriu, që e adhuroja aq shumë për emisionet e tij fantastike në televizion, edhe pse nuk e kisha takuar kurrë personalisht, por thjesht e kisha parë në ekran? Ai ishte njohësi më i mirë bashkëkohor i historisë hebraike, historisë së Francës dhe Holandës, profesor i historisë së

artit në Universitetin Columbia, kalorës i Mbretërisë Britanike, autori i shumë librave të botuara nga Penguin Random House aty pranë. U ndala dhe i thashë:

- A mund të shtrëngoj dorën dhe të shpreh tërë respektin dhe simpatinë time për ju, i nderuar profesor Schama?…

- Ai u ngrit me një thjeshtësi krejt njerëzore, më përshëndeti dhe më tha: Patjetër, por a mund ta di, ju kush jeni?

- Po, - i thashë, - unë jam filani, ambasador i Shqipërisë këtu në Londër.

- Uh, - më tha, - çfarë kënaqësie! Jeni pasardhës Ilir. Jeni populli më i vjetër i Ballkanit. E njoh historinë tuaj shumë mirë. Më vjen mirë që ndalove dhe e vlerësoj.

Ishte një bisedë e shkurtër, krejt blic, por që më mbeti në kujtesë. Në dhjetorin e vitit 2014, pata rastin që të isha në një panel me profesor Schamën dhe profesor Jonathan Brent, në një veprimtari rreth hebrenjve të shpëtuar nga nazizmi, organizuar nga Instituti i Studimeve Hebraike YIVO nga New York – u në Londër.

Takim me Placido Domingon

Në Teatrin e Operas në Londër po luhej opera "Rigoleto" e Xhuzepe Verdit. Artisti ynë i madh, tashmë me famë botërore, tenori Saimir Pirgu, do të interpretonte Dukën e Mantovës në atë vepër. Një natë përpara shfaqjes ambasada organizoi një takim shumë të bukur me artistin shqiptar. Aty ai rrëfeu rrugën e karrierës së tij dhe interpretoi pjesë nga fondi i tij muzikor.

Natën tjetër vajtëm në Royal Opera House për të parë shfaqjen e tij. Ishte padyshim sukses i jashtëzakonshëm. Salla nuk pushonte së duartrokituri dhe perdja, edhe pse kishte mbaruar shfaqja, u hap dhe u mbyll disa herë, duke iu dhënë artistëve mundësinë të përcillnin dhe të merrnin emocione shumë të forta.

Me të mbaruar, Donika dhe unë u futëm në skenë, brinjas, te kuintat e djathta të skenës për të takuar artistin tonë të madh. Sapo zhvendosëm kuintat, përpara nesh u shfaq: Placido Domingo, tenori i famshëm spanjoll. Saimiri, i cili ishte ende me emocionet e shfaqjes, na përqafoi dhe menjëherë na prezantoi me Domingon. Ai ishte njeri aq i thjeshtë, i dashur dhe i këndshëm. Biseda ishte

e shkurtër, por komplimentet e tij për artistët shqiptarë nuk kishin të mbaruar. Pastaj bëmë foto dhe u ndamë me atë kënaqësinë, që të jep takimi me figura të tilla të skenës botërore.

Takim me Angeline Jolie dhe Brad Pitt

Në Londër organizohej një takim me artistë të shquar dhe politikanë të njohur për mbrojtjen e grave nga dhuna në zonat e konflikteve të armatosura. Nismëtare e kësaj veprimtarie ishte artistja e madhe e Hollivudit, Angeline Jolie. Ajo kishte ardhur bashkë me të shoqin e atëhershëm, Brad Pitt. Sekretari britanik, William Hague, dhe ai amerikan, John Kerry, kishin organizuar atë veprimtari. E ftuar si folëse kryesore ishte edhe Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga. Kjo e fundit bëri një ekspoze të shkëlqyer dhe shumë mbresëlënëse rreth atyre, që kishin ndodhur në Kosovën e saj. Ajo e përfaqësoi Kosovën me dinjitetin më të madh të mundshëm. Në radhën e ambasadorëve të vendeve, që kanë përjetuar konflikte, ishte Ambasadori i Kosovës dhe, pranë tij, unë. Tri karrige më tej ishte i shoqi i Angelinës, Brad Pitt. Në fund të veprimtarisë, pasi kishin folur vetë artistja, William Hague, Sekretari i Jashtëm Bitanik dhe John Kerry, Sekretari i Shtetit Amerikan, ata zbritën në hollin e sallës së madhe të njohur si O2. Ishte një rast i shkëlqyer për t'i takuar ata dy artistë, të cilët prej vitesh mbushin ekranet televizive të botës me filmat e tyre. Ishte ditë e veçantë dhe takim për t'u mbajtur mend.

Takim me gazetarin e CNN, Richard Quest

Në një nga pritjet e Ambasadës Amerikane për nder të Ditës së Pavarësisë pata rastin të takoja aty gazetarin e njohur të stacionit CNN, Richard Quest. Ai është i njohur për mënyrën e tij të habitshme të sjelljes, komunikimin, shprehësinë... Ishim në një zonë të livadhit të bukur para rezidencës së Ambasadorit Amerikan. Ishte zonja ime, Donika, e cila e dëgjoi dhe e dalloi një zë të njohur dhe më tha:

- Shih kë paskemi këtu mbrapa!

U ktheva menjëherë. Iu afrova dhe iu prezantova.

- Albania! - Bërtiti ai. - Uau!- Sa mirë që takoj dikë nga Shqipëria. Kam qenë në vendin tuaj. Ishte tepër interesant.

- Kur keni qenë? - e pyeta, - Kur, si?

- Në vitin 1989.

- Çfarë? - i thashë me habi, - ju gazetar i CNN-it keni vizituar Shqipërinë e izoluar?

- Po, - më tha. - Isha me ekipin anglez të futbollit në ndeshjen e zhvilluar më 26 prill 1989 dhe fituam. Me vështirësi, por fituam. Unë jam tifoz i madh i ekipit anglez.

- Kushedi çfarë kujtimesh keni për atë kohë, - vazhdova unë. - Tani vendi ka ndryshuar shumë.

- Oh, po, - tha, - ishte vend i bukur, por i çuditshëm. Nuk na lanë të shëtisnim të lirë në qytet. Por kam një kujtim shumë interesant.

Iu luta të ma tregonte dhe ai vijoi...

- Për herë të parë kam provuar "kënaqësinë" e të rruarit me brisk rroje, që mprehet me rrip. Në katin e parë kishte një berberhane. Shkova të rruhesha dhe e di ç'më gjeti?

- Hë? - i thashë, - ma thuaj edhe këtë!

- Ai berberi më rroi dhe më gjakosi tërë fytyrën me briskun, që e mprehte me një rrip. Nuk do ta harroj kurrë këtë. - Qeshi me të madhe, siç e kishte zakon, me atë zërin e tij të çjerrë dhe pasi u përshëndet me ne, u largua...

U largua, por mua më la shijen e atyre kujtimeve, që ishin përditshmëria jonë e trishtë e asaj kohe.

NJË DITË ME EDITH DURHAM-IN NË INSTITUTIN MBRETËROR ANTROPOLOGJIK TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS

Në vijim të veprimtarive të ambasadës në bashkëpunim me Shoqatën Anglo - Shqiptare më 23 qershor 2014, organizuam një veprimtari përkujtimore në nderim të Margaret Hasluk, kësaj gruaje të famshme, e cila i kushtoi jetën Shqipërisë dhe vdiq nga marazi i ekzekutimit të mikut të saj, patriotit dhe nënshkruesit të aktit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Lef Nosi. Lektor i kësaj veprimtarie ishte dr. David Shankland, Drejtor i Institutit Antropologjik Mbretëror të Britanisë së Madhe. Pas aktivitetit që organizuam në ambasadë, ai më ftoi të bëja një vizitë në muzeun e tij, aty ku gjendet koleksioni i albumeve të Edith Durham-it me foto të marra nga Shqipëria dhe Ballkani.

Dr. David Shankland

Dr. David Shankland është Drejtori i Institutit Antropologjik Mbretëror. Ai ka studiuar antropologjinë sociale në Universitetin e Edinburgut, ndërsa doktoraturën e ka mbrojtur në Universitetin Cambridge. Ai jep mësim në universitete të rëndësishme si në atë Wells-it, Lampeter, atë të Bristolit dhe është ndër organizatorët e Shoqatës Evropiane të Antropologjisë Sociale, që luan një rol të rëndësishëm në këtë fushë të rëndësishme studimore. Dr. Shankland është edhe ndër orientalistët më të shquar të kohës dhe ka botuar disa libra, ku një ndër to është: "Islami dhe Shoqëria në Turqi, Struktura dhe Funksionimi në Shoqërinë Turke".

Instituti Mbretëror Antropologjik i Britanisë së Madhe dhe i Irlandës

Instituti Mbretëror Antropologjik i Britanisë së Madhe dhe i Irlandës, (RAI) është një organizatë e hershme antropologjike me anëtarësi globale. Ajo shtrihet në studime mbi fusha të shumta dhe të ndryshme dhe synon të kombinojë traditën e studimeve me shërbimet e antropologëve, ku përfshihen edhe studentët.

Ky Institut promovon mirëkuptimin publik të antropologjisë si dhe kontributin që kjo shkencë mund të japë ndaj çështjeve publike dhe atyre sociale. Brenda saj ajo përfshin jo vetëm antropologët akademikë, por gjithashtu dhe ata me interes të përgjithshëm mbi subjektet dhe ata të trajnuar dhe që punojnë në atë fushë.

Instituti vijon traditën e themeluesve të tij të Shoqërisë Etnologjike të Londrës, e cila në shkurt të vitit 1843 formoi një grup të veçantë të Shoqërisë së Mbrojtjes së Aborigjenëve, e cila ishte themeluar në vitin 1837. Shoqëria e re do të ishte "një qendër dhe rezervuar për koleksionimin dhe sistematizimin e të gjitha vëzhgimeve të bëra nga raca njerëzore".

Edith Durham e gjeti me vend të linte koleksionin e saj pikërisht në këtë Institut dhe vizita ime aty ishte sa prirje personale aq edhe detyrë zyrtare. Aty pamë me sytë tanë koleksionin e Miss Durhamit të titulluar: "Blloku im i Shënimeve mbi Ballkanin"

Në ato tre albume gjenden vizatime, komente, diçitura, fotografi dhe shënime të lëna prej saj që nga viti 1900 deri në vitin 1914.

Mbi to shkruhet "Londër 1840" dhe janë të përmbledhura në 3 vëllime me format 30.5 x 40.5 cm, të veshura me cohë ngjyrë kafe të errët, të shkruara me ngjyrë të kuqe të shurdhët, nën etiketa rrethore sipër kapakëve.

Këto foto dhe vizatime janë bërë midis viteve 1900 dhe 1914. Durham,-i ka lënë këtë shënim me makinë shkrimi:

"Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Turke, por - siç bënin edhe tërë subjektet e tjera të pushtuara prej turqve, - shqiptarët i ruajtën gjuhën dhe zakonet e tyre të vjetra dhe fiset e maleve të veriut ruajtën një formë autonomie të drejtuar prej Këshillave fisnore të Pleqve, të cilët zbatonin ligjet tradicionale.

Qyteti i Shkodrës ishte vendi ku qëndronte administratori turk dhe ku tërë zonat e ulëta sundoheshin nga ligji turk. Baroni Nopça, nga Hungaria, më pat thënë, kur e takova pas luftës së viteve 1914-1918, se ai ishte personi, i cili i pa…

"Të fundmit e Muhikanëve dhe jetën e fundit fisnore në Evropë."
"Detajet e kësaj janë të regjistruara në librin tim"
Thotë Miss Durham.

Për një shqiptar, i cili emrin e parë anglez, që ka mësuar në shkollë është ai i Edith Durham-it, kontakti me një koleksion të tillë përbën një ngjarje të veçantë. Pasi kisha lexuar librat e saj siç janë "Shqipëria Malore" (High Albania), "Barra e Ballkanit", etj, tani kisha në dorë materiale të mbledhura, të vizatuara, fotografuara, sistemuara dhe komentuara nga vetë ajo: Edith Durham.

Atë ditë fotografova gjithçka që përmbanin ato të tre albume të Miss Durhamit dhe më vonë i botova në shtypin shqiptar si dhe i prezantova në audienca të ndryshme për studentët e universiteteve, me titull: Një ditë me "Mbretëreshën e Malësorëve", Edith Mary Durham.

NË AMBASADËN AUSTRIAKE, 100-VJETORI I FILLIMIT TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Në Ambasadën austriake, Londër

Në selinë e Ambasadës austriake në Belgrave, Londër, na qëllonte të shkonim shpesh. Festat, pritjet, Viti i Ri, koncertet me muzikë klasike aty zhvilloheshin në mënyrë të vazhdueshme. Tërë kësaj i shtohej kënaqësia, që na jepte mikpritësi i kësaj ambasade, Ambasadori Emil Brix dhe e shoqja Elizabeta. Ata janë një çift i mrekullueshëm. Në fakt ata dëshmojnë në mënyrën më të shkëlqyer aftësinë se si një çift i ndan punët me njëri-tjetrin. Për shkak se Emili vuan nga një sëmundje e rëndë, e cila gati e ka paralizuar, e shoqja tregon përkujdesje të veçantë për të.

Që në ditët e para të punës në Londër, ky çift ishte më i afërti për ne. Kjo na dukej se vinte nga të dy anët, mbasi edhe ne i respektonim shumë. Së pari, si përfaqësues i Austrisë, i këtij vendi mik për Shqipërinë, e donim shumë. Por edhe sepse në fillimet e punës sonë ai vinte me karrocë, i shtyrë nga e shoqja, nëpër pritje për shkak të asaj sëmundje të papritur, që e kishte pllakosur gjatë pushimeve në Korsikë, kur e kishte pickuar një insekt i cili gati sa nuk i kishte marrë jetën.

100-vjetori i vrasjes së Arkidukës Franz Ferdinand

Mbrëmjen e përvjetorit të 100-të të vrasjes së Arkidukës Franz Ferdinand, dhe si rezultat i kësaj, i fillimit të Luftës së Parë Botërore, Emili na mblodhi të

tërë ambasadorët e vendeve të Ballkanit për ta kujtuar këtë datë dhe për të reflektuar ndaj tëra atyre ngjarjeve që kishin ndodhur në gadishullin e luftërave të përgjakshme, në atë hark kohor të historisë.

Në fjalën e tij ai përmendi shumë fakte lidhur me vrasjen e Franz Ferdinand-it. Ai tregoi se si Arkiduka kishte vizituar Londrën vetëm pak kohë përpara se të shkonte në Sarajevë, ku do të gjente vdekjen. Po ashtu, në shenjë nderimi për figurën e tij, vetë Mbreti George kishte trokitur në derën e asaj ndërtese, ku jemi sonte, më 30 qershor 1914, kishte hyrë brenda dhe kishte paraqitur ngushëllime. Është e njëjta ndërtesë, janë të njëjtat vepra arti, e rrethon i njëjti mjedis.

Kjo ngjarje ka mbetur në ndërdijen e tërë njerëzimit. Edhe pse kanë kaluar mbi 100 vjet, sot ajo ngjan sikur nuk është aq e largët. Para kësaj vrasjeje kanë ndodhur edhe vrasje të tjera të mbretërve ose familjeve të tyre. Mbreti Aleksandër i Serbisë bashkë me të shoqen qenë vrarë në vitin 1903. Po kështu Mbreti italian Umberto në vitin 1900 dhe Mbreti George i Greqisë në vitin 1913. Edhe Perandori Austriak, Kaizeri Franz Joseph gati sa nuk ishte vrarë në Sarajevë në vitin 1910, ndërkohë që një anarkist italian kishte vrarë të shoqen, Perandoreshën Elizabeth, në vitin 1898. Edhe fati i Romanovëve të Rusisë, tanimë dihet. Ata u ekzekutuan të gjithë prej sovjetëve në vitin 1918.

Por ato kishin pasur jehonë të madhe më shumë për efekt politik vetëm në vendet e tyre. Vrasja e këtij çifti mbretëror nxiti atë që njihet me emrin "Kriza e Korrikut", e cila i tërhoqi këmbëzën shpërthimit të Luftës së Madhe, siç u njoh nga historianët ajo luftë, deri sa shpërtheu Lufta e Dytë dhe që pastaj të dyja u emëruan me numra. Lufta e Parë dhe Lufta e Dytë Botërore. Dhashtë Zoti mos të ketë një të Tretë!

Në vendin ku u vra Arkiduka Franz Ferdinand - vizitë në Sarajevë

Ajo ngjarje në mes të Ballkanit, ndodhi prej atyre që i kanë krijuar shumë herë luftërat në këtë rajon të botës. Dëshmitarë më të mirë se sa ne shqiptarët për këtë vështirë se mund të gjenden gjëkundi. Ishin po ato qarqe nacionaliste e shoviniste, të cilat grabitën territore shqiptare në vitin 1878 dhe, përherë, sa më

shumë dobësohej Perandoria Osmane, aq më shumë territore na shkëputnin ata.

Ndërsa Emil Brix-i fliste për ngjarjen e asaj dite, unë u ktheva te kujtimet dhe përshtypjet që kisha marrë nga Sarajeva, atë ditë qershori të vitit 2011, kur bashkë me mikun tim, Ambasadorin Flamur Gashi, bëmë me këmbë trajektoren, që kishte kaluar Arkiduka Franz Ferdinand, ditën fatkeqe të vrasjes së tij bashkë me të shoqen, Sofia.

Atë të dielë Franz Ferdinand-i dhe e shoqja do të udhëtonin nga stacioni i trenit të Sarajevës për në bashkinë e qytetit. Përpjekja e parë për ta vrarë princin u bë nga serbi, Nedeljko Čabrinović, i cili hodhi një bombë që ra poshtë makinës me çati të hapur ku gjendej çifti perandorak. Bomba shpërtheu poshtë makinës, plagosi disa nga ata që ishin në makinë si dhe njerëz, që po shikonin mysafirët e lartë. Arkiduka nuk u plagos fare, ndërsa e shoqja mori një plagë të lehtë në faqe.

Pas kësaj, Franz Ferdinand-it i thanë ta ndërpriste vizitën. Por ai nuk pranoi, madje kërkoi të shkonte në spital dhe të vizitonte disa të plagosur të atentatit. Më pas dëshironte ta vazhdonte vizitën zyrtare, siç ishte planifikuar. Atëherë, ata vendosën që kthimi të bëhej nëpër një rrugë alternative të qytetit, për të shmangur ndonjë atentat tjetër. Por kjo duket se nuk iu komunikua si duhet shoferit, që i printe karvanit dhe ai në kthim kaloi nëpër të njëjtën rrugë, duke e dërguar Arkidukën dhe tërë shpurën e tij drejt e te grupi i serbëve të *"Dorës së Zezë",* të cilët ishin duke pritur rastin për ta mbaruar punën e tyre të ndyrë. Kështu ndodhi dhe makina e Arkidukës u ndalua prej Gavrilo Princip-it, i cili rastësisht ndoshta, gjendej i gatshëm pikërisht në vendin, ku do të arrinte të kryente krimin. Nga një largësi, prej disa metrash, ai arriti të qëllonte mbi Arkidukën në qafë dhe të shoqen në bark. Sofia vdiq aty për aty, ndërsa Arkiduka ndërroi jetë sapo arriti në rezidencën e guvernatorit.

Tani, bashkë me Ambasadorin Gashi e përshkuam tërë rrugën ku ndodhi vrasja dhe na u duk sikur po rikonstruktonim atë skenë krimi. Ishte e vështirë të kuptohej naiviteti i një veprimi të tillë. Por nuk ishte e vështirë të kuptohej se vrasja ishte preteksti, pasi gjërat në Ballkanin e asaj kohe ishin aq të ndërlikuara dhe aq të përkeqësuara e të infektuara nga nacionalizmat, saqë ky rajon kurrë nuk do të qetësohej pa luftë. Dhe lufta kuptohet që nuk ishte zgjidhja. Por cila ka qenë ndonjëherë zgjidhje në Ballkan?! Gjithsesi vdekja e këtij njeriu

shkaktoi vdekjen e miliona të tjerëve në Evropë. Atë ditë në Sarajevë bëra një fotografi përpara pllakës përkujtimore ku është vrarë Arkiduka.

Mbesa e Arkidukës, Maria Thereza e Habsburgermonarchie, mike e Ambasadës shqiptare në Londër

Le të kthehemi në Belgrave, në Londër. Të marrësh pjesë në veprimtari të tilla përkujtimore si kjo në Ambasadën Austriake në Londër është vërtet një shtysë, që të bën të biesh në mendime. Por të kesh mundësi të takosh pasardhës të drejpërdrejtë të gjakut të Arkidukës Franz Ferdinand është kënaqësi, ose, më mirë të themi, një kureshtje ndryshe. E pra, në Londër sot jeton stërmbesa e Arkidukës, të cilën e thërrasim Her Highness, Maria Teresa. Ajo ka trashëguar emrin e *Maria Theresa Walburga Amalia Christina,* e cila ishte e vetmja femër që sundoi zotërimet e Habsburgëve dhe Austrinë, Hungarinë, Kroacinë, Boheminë, Mantovën, Milanon, Galicinë. Maria Theresa është urbaniste e njohur dhe shumë e aftë. Ajo është mike e shqiptarëve dhe Shqipërisë dhe e ka vizituar Shqipërinë disa herë.

Muzikë dhe poezi në përkujtim të 100-vjetorit

Mbrëmjen e 100-vjetorit në Ambasadën austriake, Ambasadori Emil Brix prezantoi grupin e instrumentistëve, që do të luanin muzikë klasike. Artistët ishin violinistja e famshme, Elena Denisova, dhe pianisti, Kornienko. Por ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte ajo që ambasadori tregoi për poetin Grodek ose Georg Trakl. Ai kishte nxjerrë nga veprat e tij poetike, një fragment të cilin e përktheva gjatë asaj mbrëmjeje aq të bukur e prekëse:

GRODEK (Georg Trakl)

Edhe drurët qajnë në muzgjet vjeshtore,
Edhe armët vrastare edhe fushat pjellore,
Ujërat e errëta kaltëroshe të liqeneve, mbi të cilat edhe më errësisht,

Vërtitet dielli si i trembur, tinëzisht.
Luftëtarë që vdesin, këngë vajtimtare,
Nga gojëshqyerja e luftës shkatërrimtare.
Qetësisht atje, në lugun shelgjor,
Re-kuqja mban të fjetur zemërimin njerëzor.
Gjaku i derdhur mblidhet në ftohtësi hënore,
Tëra rrugët të çojnë tek dumat mortore.
Nën fijet e arta vjedhacake dritë hëne dhe yje,
Motra e hijes tani shton trishtim qetësie.
Koka të përgjakura, shpirtëra heronjsh,
Butësisht fyej të errët zërash vjeshtorë në zë krojsh,
O fatzinj krenarë! Altar të bronxtë atje lart ku qëndroni,
Sot një dhimbje e thellë ushqen flakët e zjarrta, Kujtoni!
Për nipërit e palindur ende, Mendoni!

Në përfundim desha të mësoja më shumë për poetin. Ambasadori më tha se ai ishte poet polak. Shkruante shumë bukur. Por lufta e vrau aq shumë shpirtërisht saqë vendosi t'i jepte fund jetës me vetëvrasje në një spital në Krakov. Trakl, siç njihet, kishte lindur në Salzburg me baba hungarez dhe nënë çeke. Ai filloi të shkruante poezi në moshën trembëdhjetëvjeçare, por ra shumë shpejt nën efektin e drogës dhe mendohet se vuante nga skizofrenia. Profesionin e vet e lidhi me farmacinë. Në fillimin e Luftës së Parë Botërore, pas disa tentativash për vetëvrasje, ai më në fund vdiq nga mbidoza në një spital ushtarak në Krakov. Kështu ai i dha fund jetës më 6 nëntor 1914, pra fill pas shpërthimit të Luftës së Madhe. Emil Brix-i më tregoi se ai ishte aq i dhënë pas këtij poeti saqë, kishte shkuar vetë dhe i kishte ngritur një muzeum në dhomën e spitalit ku kishte ndërruar jetë.

Emil Brix-i e vazhdoi karrierën e tij si Ambasador i Austrisë në Moskë. Më vonë ai u emërua Drejtor i Akademisë Vjeneze të Diplomacisë. Më 29 nëntor të vitit 2018 ai më ftoi të mbaja një ligjëratë në Akademinë Vjeneze në lidhje me atë që e quaj "Pushteti i Butë" i shqiptarëve.

Belgrave, Londër, 28 qershor 2014

NË LOJËRAT OLIMPIKE TË KOMUNUELTHIT NË SKOCI, GUSHT 2014

Ftesa për pjesëmarrje në finalet e Lojërave Olimpike të vendeve anëtare të Commonwealth-it më erdhi shumë kohë përpara se ato të zhvilloheshin. Miku i madh i shqiptarëve dhe menaxheri shumë i zoti i "British Petroleum-it", Peter Mather, më kishte vënë në listën e miqve të tij të afërt dhe, prej kohësh, nuk harronte të më bënte pjesë të veprimtarive të këtij konglomerati gjigant me shtrirje botërore.

Gjatë ndeshjeve eleminatore për Kampionatin Botëror të Brazilit 2014, kisha pasur fatin që, bashkë me Peter-in dhe disa ambasadorë, të ndiqja ndeshjen Angli - Mali i Zi në Stadiumin "Wembley" në Londër. Hyrja në atë stadium është ëndërr për tërë shqiptarët, për shkak të historisë së tij futbollistike, ku kanë debutuar emra nga më të respektuarit e këtij sporti - shpikje angleze. Në ballë të stadiumit qëndronte shtatorja e të mirënjohurit Bobby Moore.

Në korrikun e vitit 2014 z. Mather, më ftoi të ndiqja operën "La Bohema", e cila luhej në "Royal Opera House" në Covent Garden, me soliste divën e famshme rumune, sopranon Angela Georgiu. Opera ndiqej nëpërmjet monitorëve të mëdhenj televizivë të instaluar në pesëmbëdhjetë qytete të Britanisë së Madhe dhe transmetohej drejtpërdrejt nga salla. Atë natë, me të zhvilluam një bisedë të gjatë lidhur me debutimin e sopranove dhe tenorëve shqiptarë nëpër botë dhe në vetë "Royal Opera House". I propozova që, në ndonjë rast tjetër, të transmetonte ndonjë prej operave të interpretuara në atë sallë nga sopranoja jonë më famë botërore, Ermonela Jaho. Vetëm dy ditë më vonë diva jonë do të interpretonte po në atë sallë. Peter Mather-i më premtoi se një ditë do t'i transmetonte edhe shfaqjet operistike të interpretuara nga shqiptarët.

Në qytetin skocez Glasgow

Qyteti Glasgow është qytet shumë i vjetër. Ai është i mbushur plot me histori dhe me legjenda. Është qytet skocez dhe këtu krenaria i kalon kufijtë e imagjinatës dhe nganjëherë mund të marrë forma arkaike ose edhe të tepruara, si diku në Labërinë tonë ose në Malësinë e Madhe. Veshjet popullore vazhdojnë të jenë të pranishme. Fustanella dhe gajdja janë të kudogjendura dhe përçojnë idenë që, edhe pse të gjitha gjërat që kanë modernizuar sot botën gjenden në këtë qytet, ato përsëri duket se nuk mund të ekzistojnë pa tingullin e gajdes dhe ngjyrat e mrekullueshme të fustanellës plot me kinde. Një popull krenar, i cili pret në më pak se nëntë muaj të zgjidhë të ardhmen e vet: të vazhdojë të jetojë nën kurorën mbretërore, si pjesë e Mbretërisë së Bashkuar dhe si pjesë e Bashkimit Evropian për rrjedhojë, apo të ndahet prej të dyjave dhe të fillojë të hartojë marrëveshjet, që i duhen me të dyja qysh ditën e parë të ndarjes, pas referendumit, nëse kjo do të ndodhë. Historia duket se është në të bërë në këtë vend.

Teuta, Toni, Hana dhe Zana në Glasgow

E nisëm udhëtimin për në Glasgow nga Stacioni Euston në Londër. Pas disa orësh zbritëm në stacionin Qendror në Glasgow. Degët e lisave shqiptare janë shpërndarë anë e mbanë botës. Edhe në Glasgow ka shqiptarë. Dhe ne preferuam që ndalesën e parë ta bënim pikërisht te miqtë tanë të Kosovës, Teuta e Toni, dhe vajzat e tyre të mrekullueshme, Hana e Zana. Me ta njiheshim qysh në Prishtinë. Teuta, vajzë bukuroshe shqiptare e Kosovës, pasi kishte kaluar disa kohë në Glasgow, si refugjate e detyruar prej luftës së vitit 1999 në Kosovë, ishte kthyer dhe kishte punuar disa kohë për UNMIK-un. Aty patëm rastin të njiheshim në vitin 2001. Më pas ajo u njoh me Tonin dhe në një farë mënyre ata ma dedikojnë mua fillimin e flirtit, më pas dashurinë dhe martesën midis tyre. Meqë ajo më thoshte vazhdimisht "unë kam një shoçe të ngushtë në Shqipëri, e cila quhet Sarranda", unë përherë qeshja me atë rr-në e saj të fortë e shumë të theksuar. Në një moment të rëndësishëm të jetës sime në Kosovë, ajo më ishte gjetur aq shumë sa ndihesha shumë borxhli.

Unë "shkuesi" rastësor i martesës së Teutës dhe Tonit nga Prishtina

Një ditë ndodhi që të kisha blerë dy bileta për një shfaqje teatri në Prishtinë. Papritmas më doli një angazhim tjetër dhe u detyrova ta anuloja vajtjen në teatër. Në fakt më erdhi shumë keq, jo vetëm se nuk do të shkonim për të parë shfaqjen, por se gjithmonë kam menduar se të lësh vendin bosh në një shfaqje të prenotuar është mungesë e thellë e respektit ndaj përpjekjeve të atyre artistëve, që kanë punuar shumë për ta realizuar atë.

Duke ecur në sheshin "Nënë Tereza", pashë Teutën që vinte përballë meje. U përshëndetëm, si përherë me shumë dashuri, dhe kur po ndaheshim i thashë:

- Oh Teuta, se desh harrova. Sonte është një shfaqje shumë e bukur në teatër. A ke dëshirë të shkosh?

- Po, e di por nuk kam biletë, - u përgjigj ajo.

- Për biletë mos u bëj merak, i thashë, ja ku e ke dhe i zgjata njërën biletë, vetëm më premto që do të shkosh, sepse nuk dua ta lësh karrigen bosh.

- Ua, shumë faleminderit, si do e lë karrigen bosh!? - m'u përgjigj ajo.

- Në qytet njerëzit nuk po gjejnë bileta për atë shfaqje. Faleminderit shumë!

Dhe kështu u ndava me Teutën. Pas jo më shumë se pesëdhjetë metrash takova një djalë të quajtur Toni, të cilin pothuajse rastësisht e kisha takuar nja dy herë nëpër lokalet e Prishtinës. U përshëndetëm me shumë dashuri dhe, menjëherë më vajti në mendje t'i ofroja biletën tjetër, që kisha në xhep. Bëra thuajse të njëjtin dialog me Tonin, siç kisha bërë pak më parë me Teutën. Edhe Toni mori biletën e "tij" dhe shkoi atë natë në teatër.

Pa u njohur fare, sipas radhës dhe karrigeve që kishin në bileta, Toni dhe Teuta u gjendën pranë njëri - tjetrit. Toni ishte hutuar nga bukuria e Teutës, por jo më pak Teuta ishte hutuar nga pamja e Tonit. Kështu që, në një farë mënyre, e kishin harruar shfaqjen, pasi ishin përfshirë në një bisedë pësh-pësh. Në fillim të dy i kishin treguar se nga i gjetën biletat, pastaj biseda ishte shtrirë drejt njohjes dhe pas shfaqjes kishin përfunduar në një lokal aty pranë për të kthyer ndonjë gotë. Miqësia e tyre ishte "trashur" dhe kishin arritur në një pikë, kur një ditë Toni kishte gjetur një mënyrë shumë origjinale për t'i propozuar Teutës:

"Teuta, a do të më japësh kënaqësinë, që unë të jem njeriu, që do të kujdeset për jetën tënde?"

Teuta, e cila mesa dukej mezi priste të dëgjonte pikërisht diçka të tillë, pasi kishte bërë sikur po mendohej pak, i ishte përgjigjur:

"Jeta ime nuk do të ketë kujdestar tjetër veç teje, Toni".

Ajo kishte shpërthyer në vaj. Në fakt lotët e saj ishin të lidhura edhe me humbjen e prindërve në luftë dhe me nevojën për një njeri, që do t'i merrte jetën në dorë dhe të ndanin gjërat më të bukura të kësaj bote bashkë. Dhe ky ishte Toni.

Tani Teuta dhe Toni bënin një jetë shumë të lumtur në Glasgow, bashkë me dy vajza si yje, Hanën dhe Zanën. Në një farë mënyre unë isha "shkuesi" ose sebebqari i fatmirësisë së tyre. Teuta nuk kursehej të thoshte se "ti u bëre shkaku i njohjes sime me Tonin, por edhe Toni më propozoi në atë mënyrë sa ma këputi shpirtin".

Të katër, Toni, Teuta, Hana dhe Zana na pritën në stacionin e trenit në Glasgow. Prej andej shkuam në shtëpinë e tyre, ku na priste një drekë shumë e shijshme. Pa vonuar shkuam në Edinburg, në atë qytet, që e kisha ëndërr ta shikoja. Arritëm në qytet dhe filluam të shëtisnim.

Edinburgu i asaj nate gushti...

Qyteti ziente nga turistët. Festivali "Fringe" ishte në kulmin e vet. Kështjella qëndronte mbi qytet sfiduese ndaj tërë thepave të kishave, që ishin të panumërta. Ajo më ngjante me kështjellën tonë të Beratit. Muret më kujtonin Krujën dhe Gjirokastrën. "Eh, - thashë me vete, - me pak mirëmbajtje dhe kujdes më shumë, edhe ne do të kishim mundësinë të krenoheshim me ato mrekulli të historisë sonë". Edhe kalatë tona i mbronte UNESCO-ja, po a i mbronim ne vallë?! Kjo ishte çështja.

Mbrëmja po binte mbi qytet dhe po ngriheshin siluetat e majave të kullave të kishave krejt të nxira nga koha dhe vitet. Kubetë filluan të ndriçoheshin dhe

magjia ditore e qytetit duket se ia lëshoi vendin një magjie tjetër, asaj të natës. Nuk mund të thotë më shumë njeriu sesa: Aty mbetesh pa gojë. Oh, po çfarë të mire i kanë bërë Zotit ata njerëz, që jetojnë aty? Kjo pyetje të vjen ndërmend sapo t'i shohësh ata. Si gjysh e gjyshe të rinj që ishim, blemë dy dhurata për Andrën tonë, e cila kishte mbushur atë ditë 21 ditë, që kishte ardhur në jetë. Dhe çfarë ishin ato? Një palë opinga të vogla kelte dhe një minifund po ashtu kelt. Le t'i kishte Andra kujtim nga Edinburgu këto relikte kuptimplote të një qyteti, që nderonte jo vetëm Skocinë, por tërë trashëgiminë kulturore të njerëzimit.

Gjurmë shqiptare në Glasgow - Futbollisti Rudi Vata dhe sopranoja Miranda Sinani

Pasi kaluam një darkë shumë të këndshme me Tonin, Teutën, Hanën dhe Zanën, shkuam në hotel. Stuarti që na priti dhe mori valixhet na përshëndeti plot respekt dhe na pyeti edhe se nga vinim. I treguam se ishim nga Shqipëria.

- Oh, - tha ai, - ju jeni nga vendi i Rudi Vatës? Ai është shumë popullor këtu.

Ai kishte luajtur me Celtik-un nga fillimi i vitit 1993 deri më vitin 1996, duke u bërë i pari futbollist shqiptar pjesëtar i një klubi futbollistik evropian si ai, që do të fitonte një kupë. Davidi, stuarti ynë, që ishte tifoz i Celtik-ut, ishte shumë i dhënë pas tij dhe na kujtoi atë djalosh nga vendi ynë në atë qytet të largët verior britanik.

"Oh, - thashë me vete, sa mirë që një njeri i tillë na ka nderuar kaq shumë, edhe pse kaq larg!!! Mirënjohje. Degët e Lisit Ilir janë shtrira edhe këtu".

Paraditja e Olimpiadës së Komunuelth-it ishte e lirë. U mblodhën shumë miq të Peter Mather-it. U njohëm me disa prej tyre. Jashtë binte një shi i paparë. Kjo nuk ishte e habitshme për vendasit, pasi ndodhte thuajse çdo ditë verë e dimër. Pasi morëm pajisjet e mysafirëve, çantat, badget etj., do të pinim kafe në lobin e hotelit. Pas pak hyra në bisedë me një prej miqve, me të cilin kishim ndjekur Operën "La Bohema". E pyeta për veprimtarinë e atyshme dhe i tregova se në Operën e qytetit të Glasgow-t interpretonte që prej njëmbëdhjetë vjetësh një soprano tjetër shqiptare. Ishte Miranda Sinani. Fatkeqësisht ato ditë

ajo nuk ishte aty, sepse gjendej në atdhe. Por zëri i saj ishte i njohur në operën e atij qyteti. Një gjurmë tjetër e bukur e pranisë së Shqipërisë në atë qytet. Një degë tjetër nga Lisi Ilir.

Camil Coro i "Gruas së re shqiptare" në Muzeumin e artit Kelvingrove

Më pas u interesova për Galerinë e Arteve të Glasgow-t. Morëm një taksi dhe vajtëm te "Kelvingrove Art Gallery & Museum". Ishte një galeri shumë e bukur, me një sallë të madhe, që të përpinte me madhështinë e saj, sapo futeshe brenda. Salla kishte një organo gjigante në fasadën ballore. Në dy orët e vizitës në atë galeri patëm rastin të shihnim një prej koleksioneve më interesantë ndoshta në tërë Evropën. Ishte diçka e ngjashme me atë që kishin arritur fiorentinët në kohën e De Mediçit. Aty gjendej një pavijon me piktura të atyre që njihen si djemtë e Glasgow-t. Koleksioni i punëve të tyre përmban afro 200 vepra. Ata njihen me emrin Boys (djelmoshat) e Glasgow-t, pasi jetuan dhe krijuan në të njëjtën periudhë, diku nga viti 1880 deri në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit të njëzetë. Më pas u ndalëm te një vepër origjinale e Van Gogut kushtuar një mikut të tij piktor skocez në kohën e studimeve në Paris. Ishte po ai stil, që e gjen te portretet e tij apo te vepra e famshme "Lule Dielli". Pas kësaj vinin shumë vepra, por mua si shqiptar më mbeti mendja te *Madmauzel De Foudras*, vepër e Jean Baptist Camille Corot-it e vitit 1872, vaj në kanavacë.

Ai është portret i një gruaje misterioze të paidentifikuar, që shton misticizmin me anonimitetin e saj, ashtu siç ndodh me Xhokondën e Leonardos. Ndoshta kjo ka qenë ideja e tij. Por mua nuk më shtyu aq shumë kureshtja ndaj kësaj vepre, sesa dëshira për ta krahasuar atë me veprën "Grua e re shqiptare" e të njëjtit autor, origjinali i së cilës gjendet në Muzeumin e Artit në Brooklyn në New Jork. Një dëshirë e flaktë për të krahasuar kryeveprat lind natyrshëm kur je pranë tyre. Njëra anonime dhe intriguese si Madona, tjetra e thjeshtë, e bukur, impozante, shqiptare! Do kisha dëshirë që me mua të ishte studiuesi ynë i madh dhe i respektuar i kësaj vepre dhe tërë veprave të autorëve të huaj për Shqipërinë, Ferid Hudhri.

Me kampionët e botës në 100 metër vrapim - Usain Bold dhe Michael Johnson - dy njerëzit më të shpejtë në botë

Ditën tjetër Peter Mather-i organizoi një takim me Michael Duane Johnson-in, sprinterin amerikan, fitues i katër Medaljeve të Arta Olimpike dhe tetë Medaljeve të Arta si Kampioni i Botës në Atletikë. Për shumë kohë ai konsiderohej si vrapuesi më i mirë i tërë kohërave, deri sa e la sportin. I vetmi që e tejkalon atë, si nga shpejtësia ashtu dhe nga numri i medaljeve të arit, del të jetë Usain Bolt. Jonson-i mbajti një fjalim mbresëlënës, ku tregoi sesi i kishte arritur rezultatet e veta në atletikë. Sigurisht ky ishte një mësim i madh për ata drejtues ekzekutivë të "British Petroleum-it", të cilët operojnë në të gjithë botën dhe në Shqipëri po ashtu. Aty shihej sesi kompani të mëdha, si BP, mësonin nga përvoja e individëve më të suksesshëm në botë. Aty gjendej edhe njëra prej drejtuesve të British Petroleum-it, e cila mbulonte punimet e Trans Adriatic Pipeline, i njohur si TAP - linja e gazit, e cila po ndërtohet prej kësaj kompanie dhe kalon nëpër Shqipëri, Emily Chinball Olson, me të shoqin Bill, me të cilët na lidhi një miqësi e sinqertë dhe mjaft e këndshme që vijoi shumë gjatë.

Pasditja kishte si destinacion Lojërat Olimpike. Shkuam në Stadiumin "Celtik" dhe ndoqëm garat e atletikës. Ishte hera e dytë që do të shihja anga afer njeriun më të shpejtë në historinë e njerëzimit: Usain Bolt-in. E kisha parë në Lojërat Olimpike, Londër 2012, po ashtu drejtpërdrejt dhe tani përsëri. Këtë natë ai garoi me ekipin e vet xhamajkian në 400 metra stafetë dhe askush në botë nuk i afrohet atij. Treshja e parë erdhi në pozicionin e tretë paralel me ekipet e tjera. Por ndryshimin e bëri Bolt. Gara mbaroi. Ai fitoi pa shkaktuar habi. Më pas, filloi ritualin e vet prej djali të llastuar, duke bërë veprime, të cilat tregojnë se një personalitet në fushë mund të jetë si medalje me dy anë: njëra anë shpreh aftësinë mbinjerëzore dhe tjetra foshnjërinë njerëzore. Si dhe më parë, ai bënte veprime të habitshme, vërdallosej kot, bënte poza, tregonte stilin e tij shigjetë dhe largohej papritur nga ata që e takonin.

Kështu ndoqëm lojërat e 71 vendeve, të cilat vazhdojnë të qëndrojnë nën kurorën e Mbretëreshës Elizabeth II dhe, në një mënyrë apo në një tjetër, mbajnë shenjat e flamurit britanik. Ceremonia përmbyllëse ishte e tëra skoceze

apo keltike. Qindra gajdexhinj, veshur me fustanella, në një orkestër të paparë ndonjëherë si atë natë, vërshuan në stadium në ceremoninë përmbyllëse, ndërsa turma me pesëdhjetëmijë vetë nuk pushonte së brohorituri. Ndërkaq, këngëtarja e shquar Adele mbushte me tingujt e zërit të saj jonet e qytetit nëpërmjet të altoparlantëve që mbulonin çdo skaj të tij.

Ishin Glasgow dhe Edinburgu, qytete me kaq shumë kujtime, edhe pse për një kohë kaq të shkurtër.

Glasgow dhe Edinbourg - Skoci, 4-6 gusht 2014

NJË JETË "NË UDHËTIM ME SHEKSPIRIN" DERI NË STRATFORD MBI AVON

Mësimet e Shekspirit për ditë të vështira: Stamboll, mars 1997

Atë ditë marsi të vitit 1997, kur e përcolla djalin në aeroportin "Ataturk" të Stambollit, m'u duk se do më shqitej zemra prej gjoksit. Ishte vetëm 17 vjeç dhe do të merrte rrugën e kurbetit. Më dukej se ajo plagë e rëndë, e cila e kishte ndjekur familjen tonë që prej gati pesë dhjetëvjeçarësh, do të përsëritej. Do të shkonte në Amerikë dhe atje do të përplasej me jetën ballë për ballë, fare i ri dhe i vetëm. I vetëm. E kishte bërë atë rrugë një herë si turist më parë dhe e dinte mirë se çfarë e priste.

Meraku i prindit është i pakufi, i pashpjegueshëm, i pagjumë. Si do të arrinte?! Si do të rregullohej, si do të jetonte, si do të shkollohej, si do të integrohej në jetën e përditshme... si… si... si...?

Por, nga gjërat më të rëndësishme të jetës së tij, për mua do të ishin virtytet, ruajtja e tyre në një botë kaq komplekse, shmangia dhe largimi prej veseve të këqija, ruajtja e identitetit, Besa. I vetëm në një botë aq të madhe dhe me aq mundësira edhe për të përparuar, por edhe për të gabuar, sa vështirë do ta kishte të zgjidhte udhën e drejtë, atë të duhurën në kaosin dhe pafundësinë e alternativave kozmopolite?

Polloni, Laerti, Erioni dhe unë

Përpara se Erioni të dilte nga shtëpia i kisha dhënë një copë letër të shkruar bukur me disa këshilla, postulate, të cilat më kishin udhëhequr shpesh herë në

jetën time, që kur rashë në kontakt me shkrimtarin më të madh të të gjitha kohërave, William Shekspirit. Në atë letër ishin shkruar këshillat, që Poloni i jep të birit, Laertit, kur e nisi për studime në Francë, te tragjedia "Hamlet". Në një përkthim virtuoz të Fan Nolit, ai ndër të tjera i thotë të birit:

Shkruaji në mendje këto që po të them!
Në kokë ç'ke, mbi gjuhë mos e nxirr,
Mos shfaq me vepër një mendim pa vend.
Ji familjar, po jo vulgar aspak.
Mikun, që ia provove dashurinë,
E lidh në shpirt me rrathë prej çeliku;
Po mos lodh dorën, duke përkëdhelur
Çdo shok të ri, çdo zog pa pendë.
……
Mos merr as mos jep hua kurrë;
Se shpesh humbet dhe mikun dhe paranë,
Kursimit huaja ia thyen qipin.
Këtë përmbi të gjitha:
Mbaji Besë vetes;
Edhe kështu, siç vjen pas natës dita,
S'i del dot i pabesë asnjeriu.

Dhe kështu babai e këshillon të birin për paranë, për besën, miqtë, virtytet dhe veset njerëzore. Ia dhashë letrën tim biri. Ai ishte i njomë dhe i brishtë. I fola butësisht me dashurinë e prindit dhe përkujdesjen e mësuesit, zgjuarsinë e Shekspirit dhe zërin e Polonit, dhe iu luta:

- Mbaji këto këshilla me vete! Lexoji, shikoji, kujtomë dhe medito! Mirë është t'i ngjisësh në murin e dhomës, aty ku do të flesh. Hidhu nga një sy, por jo vetëm, lexoji për çdo ditë dhe përpiqu "t'i mbash besën vetes!"

U ndava me të, por shikimi nuk ndahej. Mjegullt e ndiqja nga xhamat e këtej kufirit të aeroportit, teksa u ul në një stol, e vështrova me sy të përlotur. Ai e hapi atë letër dhe me sy të ngulitur m'u duk se po e lexonte me vëmendje. E shoqërova me sy deri sa i erdhi koha për të ikur. Diçka m'u këput në shpirt, kur ai më humbi nga sytë dhe vazhdoja ta kërkoja në morinë e njerëzve që

largoheshin. Por unë kisha shumë besim se do të shiheshim shpejt. Dhe do të shiheshim si dy njerëz të virtytit, që e kishim mësuar, sa prej familjes aq edhe prej Shekspirit, se si t'i mbash besën vetes dhe mos t'u dalësh të tjerëve i pabesë.

Tre Hamletët e Teatrit tonë Kombëtar

Kam qenë gjimnazist atëherë kur mësuesi ynë i dashur dhe i nderuar i letërsisë, Asllan Bami, na lexonte me një pasion të pashoq veprat e Shekspirit. Ai na impononte mësimin përmendësh të vargjeve të tij, dhe unë ia kushtoj këmbënguljes së tij aftësinë që edhe sot të di të recitoj përmendësh vargje të tëra nga ky autor.

Më vonë, gjatë studimeve në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, pata rastin fatlum, që të njihja pedagogë të dramës, ndër të cilët Kujtim Spahivogli, Naim Frashëri dhe Kadri Rroshi. Dy të parët m'u dha mundësia t'i shihja në skenë, ndërsa me Kadriun më ka lidhur një jetë e gjatë pune dhe kam mësuar prej tij ato gjëra, të cilat jo shumë njerëz kanë pasur fatin t'i mësonin. Naimi, Kadriu dhe Kujtimi ishin aktorët më të mirë që skena e teatrit shqiptar kishte parë ndonjëherë. Ata të tre luanin rolin e Hamletit. Në fillim të viteve shtatëdhjetë, kur luanin në Teatrin Popullor (ashtu quhej atëherë), në qarqet e ndryshme në Tiranë flitej se në botë aktori më i madh, që luante Hamletin ishte Lorenc Oliver-i. Ndërsa në Shqipëri kishim tre të tillë... Në fakt të tre ishin yje, që ndriçonin skenën. Por ishin tre, se ashtu jemi ne shqiptarët… dykrerësh dhe, në këtë rast, tresh. Naimi qe jetëshkurtër. Ai u largua nga kjo jetë në shkurt të vitit 1975.

Kujtim Spahivogli

Kujtim Spahivogli ishte mbase njëri nga pedagogët më të mirë që dramaturgjia shqiptare ka njohur ndonjëherë. Në vitin 1973 në kuadër të atij, që u njoh si "revolucion kulturor", i frymëzuar nga ai kinez, Kujtim Spahivogli u bë pedagogu- barrierë, i cili kërkonte nivel shumë të lartë në degën e dramaturgjisë në Institutin e Lartë të Arteve. Prej tij e kam dëgjuar shprehjen angleze: *"Ne nuk*

jemi aq të pasur sa të blejmë gjëra të lira", e cila kishte për qëllim përgatitjen me nivel të lartë të studentëve. Por kjo gjë shkoi shumë kundër tij. Si një predikim për fatin e tij të zi, ai në një diskutim të vrullshëm "kundër-revolucionar" me brigadat e kuqe të Rajonit nr. 3 të Tiranës, ai citoi tekstin e epitafit të shkruar mbi varrin e Bertold Brehtit, të cilin vetë shkrimtari e kishte lënë amanet:

"Nga tigrat munda të shpëtoj.
Me gjakun tim ushqeva çimkat,
Por jetën time e hëngri mediokriteti".

Në fakt prej kësaj pësoi Kujtim Spahivogli. Mediokriteti dhe ideologjia vrastare komuniste e bëri që ai, kur ishte vetëm 41-vjeç, me një karrierë të shkëlqyeshme në teatrin tonë, u internua dhe iu ndalua aktrimi, drejtimi regjisorial dhe botimi i veprave dramatike, që shkruante. Vdiq në mënyrë tragjike, në internim dhe në vetmi në vitin 1987. Ai pësoi tragjedi me një dramë hamletiane, jo vetëm në shpirt.

Kadri Roshi

Kadri Roshi jetoi për të bërë vepra të mëdha në skenën shqiptare. Me të na lidhën shumë gjëra që nga skena, në të cilën ai interpretonte, ndërsa unë merresha me organizimin, duke arritur kulmin me vënien në skenë të dramës "Tokë e ndezur", vepër që tronditi spektatorët me tragjedinë e Kosovës, konkurrente në një olimpiadë kombëtare të teatrit.

Hamleti i luajtur nga shqipfolësi - Sir John Anthony Quayle - Anëtar i Shoqatës Anglo - Shqiptare

Sir John Anthony Quayle, aktor i madh i teatrit anglez, shërbeu si oficer i shërbimit të fshehtë anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1943 ai mbërriti në Tragjas, Shqipëri, dhe u takua me një oficer tjetër të SOE-së, të quajtur Jerry Field, të cilin e zëvendësoi, pasi ai ishte plagosur në një ditë peshkimi.

Pas luftës iu kushtua aktrimit dhe drejtoi *Teatrin Memorial të Shekspirit*, ku dhe hodhi themelet e krijimit të Kompanisë Mbretërore të Teatrit Shekspirian. Ai ka luajtur rolet e Falstafit, Otellos, "Henry VIII" si dhe ka interpretuar edhe me Lorenc Oliverin dhe ka një galeri të pafund rolesh. Për ne, shqiptarët, mbetet figurë e dashur, sepse jo vetëm që shërbeu në Shqipëri, por edhe ishte anëtar aktiv i përhershëm i Anglo - Albanian Association. Vdiq në vitin 1989.

Simbioza Shekspir - Fan Noli, dashuri e lindur qysh në vitet e rinisë

Në rininë tonë Shekspiri dhe Fan Noli ishin sinonimi i njëri - tjetrit. Ndërsa i pari për ne ishte i njohur për veprat e tij të shkruara, i dyti shquhej për përkthimet e tij të mrekullueshme. Thuhet se Shekspiri "fliste shqip" po aq mirë sa në gjuhën e vet. Vepra e Shekspirit krijon emocione tronditëse. Përkthimi i Nolit, ku në shumë raste ka futur elemente që nuk gjenden në anglisht, e bën Shekspirin të shprehet po aq bukur edhe në gjuhën tonë. Ai i ka veshur me figura aq të bukura veprat e Shekspirit saqë, shpesh, duket sikur vetë origjinali është në shqip. Për shembull, përkthimi i Hamletit nga Noli në disa pjesë është krejt shqiptar:

"Oh, le të qajë i plagosur dreri,
e le të lozë e pangarë dhia;
Se njëri fle dhe tjatrin e ha vreri,
Kështu na qenka bota, gjithësia!"…

Është një përkthim virtuoz, me vlerë dhe, ndoshta ky art i përkthimit bëri që shqiptarët të dashuroheshin me Shekspirin, i cili foli aq bukur nëpërmjet Nolit në gjuhën tonë.

Në Stratford mbi Avon

Të gjitha këto ngjarje dhe detaje të jetës të lidhura më emrin e Shekspirit m'u

shfaqën ato ditë të vizitës në Stratford mbi Avon. Ishte një ëndërr e kahershme dhe ja ku u bë realitet.

Fan Noli në dijeninë e Ciceronit Paul Earl, që "fliste" shqip

Gjatë vizitës në atë që njihet si shtëpia, ku ka jetuar Shekspiri në Stratford mbi Avon, mësuam diçka shumë interesante. Njeriu i parë, të cilin e takova në atë muzeum ishte një burrë i madh, i shëndoshë, i veshur me rroba të kohës së Shekspirit, me xhaketë të kuqe, kapele të gjerë dhe kilota të gjera. Ishte i plotë, i buzëqeshur dhe detyra e tij ishte t'i priste miqtë dhe t'u thoshte "Mirëserdhët" në gjuhën e Shekspirit, pra në atë angleze, kuptohet. Por, fill pasi ai kishte kryer këtë detyrë, pyeste:

- Nga jeni ju?

Pasi pyeti disa vizitorë, të cilët ishin amerikanë, na erdhi radha edhe neve. I thashë se jemi shqiptarë.

- *Mirëdita*, - ma ktheu në gjuhën shqipe. - *Mirësevini në këtë shtëpi*!

Mbeta i shtangur... Ai burrë aty të fliste në shqip?!

- *Mirësejugjeta*! - iu përgjigja.

Pastaj ai vijoi në anglisht, dhe e kishte kuptuar shikimin tim të befasuar nga shqipja e tij.

- Po, ju, hmm, si ka mundësi sa mirë që dini shqip! - i thashë në gjuhën angleze por me një lloj krenarie të brendshme shqiptare.

- Di disa fjalë, - më tha, por jo se mund të flas shqip. Ju a jeni nga Tirana? - më pyeti në anglisht.

- Po andej jam, - e gjeta me vend t'i thosha.

- Shumë mirë.

- A keni qenë ndonjëherë në Shqipëri? - e pyeta.

- Jo, - më tha, - por kam dëshirë të shkoj. Dua të shoh Scutari, Kruxha (Kruja) dhe Elbasani.

- Sa mirë, - i thashë, - po çfarë të bën të ndjehesh kështu, i interesuar për Shqipërinë?

- Hm, këtu vijnë turistë shqiptarë. Jo përditë, natyrisht, as për çdo javë, por vijnë. Unë bisedoj me ta. Kam mësuar se Kruja është qyteti i heroit tuaj

kombëtar, Skënderbeut, ndërsa Sheshi kryesor në Tiranë mban emrin e tij. Kaq di, por kam një dëshirë të madhe të di më shumë për të. Edhe pse Shekspiri ka lindur më se 100 vjet pas vdekjes së Skënderbeut, ata janë të dy pjesa e historisë së kombeve përkatëse. Pastaj, Shekspiri ka shkruar edhe për ju ilirët diku në Iliri.

– Oh, – i thashë me një pasthirrmë, që nxitoi të dilte nga shpirti, – kjo është shumë e vërtetë. Ai e ndërtoi një vepër të tërë në Iliri, "Nata e dymbëdhjetë". Madje edhe Teatri ynë Kombëtar ka luajtur dhe luan pjesë të tij. Lidhur me këtë vepër të Shekspirit dy autorë kanë shkruar një libër analitik, me titull "Udhëtim në Iliri". Në kreun XXIX libri analizon pikërisht veprën në fjalë.

Biseda me të nuk mund të zgjaste më, por edhe unë nuk mund të isha kurrsesi më i lumtur se sa të gjeja një bashkëbisedues të tillë. U largova për ta lënë të vazhdonte me pritjen e mysafirëve, që vinin e vinin varg. Por ndjeja se nuk isha i qetë. Si nuk e pyeta për emrin? U ktheva pa ngurrim dhe e pyeta. Paul Earl më tha se quhej. Një foto me të, në mirënjohje dhe kujtim të njeriut, që donte të vizitonte Shqipërinë, do të hynte menjëherë në albumin e kujtimeve të mia.

Kështu e filluam vizitën në një prej vendeve më simbolike të letërsisë botërore, në vatrën e më gjenialit të saj, ku zë fill ajo lloj veprimtarie universale letrare, që do të mahniste tërë botën.

Shtëpia e William Shekspirit

Shtëpia e Shekspirit në Stratford është shtëpi si gjitha të tjerat në atë qytezë. Ajo mbart tërë karakteristikat arkitektonike të kohës. Në të ruhen elemente, që në Shqipëri i quajmë pasuri e kulturës materiale. Pra, ka orendi, shtretër, enë kuzhine, që veshin mjediset, ku ai ka jetuar dhe punuar. Për të gjitha mendohet se janë ruajtur dhe përcjellë nga ajo kohë. Po t'i referohemi kulturës angleze dhe famës që kishte arritur Shekspiri, nuk ka ndonjë gjë të habitshme, që ato të jenë ruajtur pikërisht ashtu. Por ndërprerja e natyrshme e trashëgimisë biologjike të këtij njeriu të madh mund të lërë vend për diskutim rreth vërtetësisë së origjinës, siç edhe ka ngjallur jo pak mëdyshje dhe diskutime.

Duke shkelur në gjurmët e William-it

Duke vijuar vizitën në këtë qytet dhe veçanërisht aty ku Shekspiri ka kaluar orë, ditë e javë të tëra duke ecur, mediuar, krijuar, shkruar, ndoshta, njeriu ndjen se shkel mbi shenjat e njërës nga epokat më të lavdishme të historisë së njerëzimit. Në çdo hap që hedh të duket sikur sheh diçka, ndjen se aty, pikërisht aty, ai djalë i ri, e filloi jetën si i biri i një prodhuesi apo tregtari dorezash, që e ndihmonte të atin të mbante familjen në ditët e vështira për t'u bërë më pas një gjeni, i të gjitha kohërave.

Vizitë në shtëpinë e të shoqes së Shekspirit, Anne Hathaway

Në guidën e njohjes me jetën e Shekspirit është edhe vizita te shtëpia e të shoqes Anne Hathaway. Aty njeriu mund të prezantohet me mënyrën se si jetonin ata me orenditë, enët dhe stilin. Ajo që të bie në sy është një tavolinë, mbi të cilën thuhet se ai shkruante. Po cilën nga ato vepra vallë, cilën e shkroi mbi atë tryezë penda e tij?! Cilët personazhe u formësuan në atë shtëpi? Si u krijuan ato figura aq të famshme, ato karaktere? Si u krijuan tragjedi të tilla si "Hamleti" e "Makbethi", "Romeo e Zhuljeta", "Jul Qesari" etj.? Po komeditë si "Gratë Gazmore të Windsorit" apo "Komedia e Keqkuptimeve"?! Si u krijuan seriali i Mbretërve Henry, po "Nata e Dymbëdhjetë"? Po "Henry IV"?

"Henry IV" në Teatrin Mbretëror Shekspirian - Stratford mbi Avon

Këtë të fundit do ta shoh në skenën e madhe të teatrit të Stratfordit, në një variant tërësisht shekspirian. Teksa ecim rrugës për në teatër, vazhdojmë të jetoj dhe ndjejmë efektin e madh që shkakton fakti që po shkelim nëpër gjurmët e një njeriu të madh, gjenialit të letërsisë së çdo kohe.

Me hapa të lodhur, por mendjen plot kureshti dhe mistere, që të krijon takimi nga afër me gjenitë e mëdhenj, i drejtohem teatrit për të parë tashmë

personazhet që ndërtoi penda e tij. Kam vizituar tërë qytetin. Tani pres të dëgjoj frymën e kohës së tij përmes teatrit, ku duket se "koha nuk lëviz" dhe Shekspiri është ende i gjallë…

Teatri Shekspirian i qytezës Stratford përmbi Avon është teatër madhështor, krejt buzë lumit dhe kanaleve ujore që lidhin tërë Anglinë me anije të vogla nëpërmjet të pritave artificiale të quajtura "Locks". Ai është një teatër ku luajnë disa nga aktorët më të mirë jo vetëm në Angli, por në gjithë botën e teatrit. Veprimtaria e tij njihet botërisht dhe mban emrin *"Kompania Mbretërore Shekspir"*. Brenda gjashtë vjetëve të ardhshme kjo kompani teatrore synon të vërë në skenë 40 veprat e plota të Shekspirit.

Sivjet është 450 -vjetori i lindjes së Shekspirit, prandaj edhe veprimtaria për vënien në skenë të veprave të tij është intensifikuar shumë. Kështu, "Hamleti" do të shfaqet në *Teatrin Globus*, në Londër, i krijuar prej tij, ku marrin pjesë teatro nga të gjitha vendet e botës, përfshirë këtu edhe Shqipërinë e Kosovën. Kompania Mbretërore e Teatrit ka 130 vjet që ekziston dhe luan veprat e Shekspirit në mënyrën më origjinale, më unike dhe më tërheqëse për shikues nga e gjithë bota.

Henry IV - të, luajtur nga Kompania Mbretërore "Shekspir"

Në mbrëmjen e shfaqjes së "Henry IV", ndjeva se do bëhesha dëshmitar i një ndodhie të vërtetë, e cila më merrte dhe më përfshinte duke më kthyer mbrapa në kohën e Mbretit Henry IV, kohë kur Shekspiri i kushtoi këtë vepër dhe pikërisht në vitin 1600. "Henry IV" përbëhet nga dy pjesë dhe është shkruar në një hark kohor disavjeçar. Anglia kishte përjetuar dhunë të tmerrshme gjatë shekullit të pesëmbëdhjetë. Njëqind vite lufte kishin filluar në vitin 1337 e do të vazhdonin deri në vitin 1453, ndërkohë që lufta civile ngrinte krye herë pas here midis viteve 1399 - 1487. Një numër i madh ushtarësh mobilizoheshin për të luftuar jo vetëm përtej La Manshit ose Kanalit Anglez, siç e quajnë anglezët, por edhe në truallin e Wellsit – t dhe të Anglisë. Kjo luftë merrte mijëra jetë njerëzore. Vetëm në një betejë, atë të Towton-it, thuhet se u vranë njëzet e tetë mijë burra brenda një dite.

Por beteja, e cila e lidh emrin Henry IV me veprën e Shekspirit është ajo e

21 korrikut të vitit 1403 e zhvilluar midis trupave mbretërore dhe rebelëve të Henry Percyt-it ose i ashtuquajturi "Hotspour", i biri i Earlit Northumberland, që angazhoi katërmbëdhjetë mijë burra. Një e dhjeta e burrave, që morën pjesë në atë betejë vdiqën. "Henry IV" natyrisht është vepër shekspiriane, që ka rëndësinë e saj, por konsiderohet jo e atij niveli të veprave të tjera, që i dhanë pavdekësinë autorit. Megjithatë, kur mendon se ajo që parashikoi Shekspiri nëpërmjet kësaj vepre ndodhi njëzet e pesë vjet më vonë, kur Anglia u përfshi në luftë civile, madhështia e autorit vetëm sa shtohet.

"Henry VI" shqiptar në Teatrin "Globe" të Shekspirit në Londër

Interesi shtohej edhe kur mendoj se më 12 maj 2012 Teatri Kombëtar Shqiptar dha shfaqje për herë të parë në historinë e tij 70-vjeçare në "Shakespeare's Globe Theatre", në Londër. Ishte një shfaqje e jashtëzakonshme, ku aktorët tanë i lanë pa frymë shikuesit tek interpretuan një Henri tjetër, atë VI, nën regjinë e Adonis Filipit si pjesë e "Triologjisë Ballkanike". Pjesa I dhe III u luajtën nga trupat e teatrove të Serbisë dhe Maqedonisë. Kjo ishte hera e parë që "Henry VI" luhej në skenën e Teatrit "Globe" dhe këtu, edhe ne shqiptarët, bëmë një farë historie të këtij teatri. Aktorët shqiptarë Yllka Mujo, Kristaq Skrami, Vasjan Lami, Ahmet Pasha, Fatos Sela dëshmuan bukurinë e fjalës artistike shqipe dhe forcën e madhe interpretuese. Por aktori që e pushtoi skenën, që rrëmbeu ato lozha të vjetra dhe i tronditi shikuesit me lojën e tij të jashtëzakonshme, me fjalën shqipe të shqiptuar bukur, me emocionet tronditëse, plastikën e rrallë dhe figurën madhështore që krijoi, ishte pa dyshim Bujar Asqeriu. Por le të kthehemi në Stratford mbi Avon.

Në fermën e nënës së Shekspirit - Mary Arden

Pas mbarimit të shfaqjes në Stratford on Avon, vendosa të mos largohesha pa vizituar fermën e nënës së Shekspirit, e njohur me emrin Ferma e Mary Arden-it. Ajo është ruajtur ashtu siç ishte në të gjallë të saj. Është fakt i pikasur me shumë kujdes nga historianët, sipas të cilëve, Shekspiri kalonte mjaft kohë në

fermën e nënës së vet, ose dajave, siç i themi ne. Këmbëngulja ime për ta vizituar fermën merrte shkas, në fakt, edhe nga këto kërkime historiografësh. Ferma gjendet në Stratford, Warwickshire, buzë një rruge vendore, në një botë pafundësisht të gjelbër.

Ajo është e ruajtur dhe e trajtuar me të gjitha tiparet e kohës si atëherë, kur jetonte shkrimtari i madh. Aty shtrihet një fushë, ku rriten pula, zogj, pula deti. Më tej sheh dele, të cilat mbarështohen nën kujdesin e disa grave, të cilat ishin të veshura me rroba të kohës, me skufje të bardha të shtrënguara në qafë. Të duket sikur teatri shekspirian shtrihet edhe përtej sallës së shfaqjes, në fushën e gjelbër, ku gjëja e gjallë, kujdestarët e tyre nuk janë bashkëkohës të Shekspirit, por trashëgimtarë rigorozë të çdo cilësie, që karakterizonte kohën e tij. Të duket sikur je bashkëkohës i Shekspirit, kur rrethohesh nga ky mjedis i ruajtur me kaq kujdes, përkushtim dhe gati fanatizëm. Gratë krehin gjënë e gjallë, pastrojnë plehun, mjelin bagëtinë përpara syve të vizitorëve dhe turistëve... Ato nuk janë aktore, janë personazhe reale jetësore, që sjellin historinë e kohës së shkrimtarit. Ato jetojnë në fermën që ruan, rrit dhe përjetëson kujtimet e jetës së tij. Pak më tutje gjendet një thark me thi, më tej stalla e kuajve, pastaj mjetet e punës dhe punishtja, që shërben për mirëmbajtjen e veglave të punës në bujqësi dhe ato që iu duhen blegtorëve dhe bujqve të fermës gjatë proceseve të punës.

Fajkonjtë e Shekspirit

Në një lëndinë pranë, një njeri me uniformë gati si ushtarake bën shfaqje me fajkoj. Ai i ka mësuar ata t'i ulen në sup. Fajkonjtë rrinë sipër pemëve apo mbi tarracat e ndërtesave më të larta. Mjeshtri i tyre ka një sinjal të veçantë për secilin. Fishkëllimat që lëshon ai janë të ndryshme, por secila thërret vetëm një fajkua. Dhe fajkoi "i lajmëruar" me fishkëllimën e tij, lëshohet me furi drejt e te koka e tij. Ulet mbi sup, përpëlit krahët, rri aq sa i thotë ai dhe fluturon atje ku dëshiron. Pas tij e ka radhën tjetri, pastaj tjetri. Kështu ai argëton turistët me një shfaqje, që i le të gjithë pa gojë.

Njeriu mund të kalojë disa orë të këndshme dhe çlodhëse aty, duke soditur mbajtjen e atyre bagëtive. Për njerëz, të cilët janë mësuar me jetën urbane dhe nuk e kanë parë sesi zhvillohet bujqësia dhe jeta në fshat, ajo përbën një

surprizë të këndshme me efektet e një ekskursioni studimor. Ajo trajtohet si një ngjashmëri me përputhshmëri historike të jetës në kohën e Shekspirit. E gjitha kjo ka filluar të trajtohet si e tillë nga *"Bordi i të besuarve të Shekspirit*" qysh në vitin 1930 dhe ashtu vazhdon të funksionojë edhe sot e kësaj dite. Për mua, si njeri që jam lindur në fshat dhe i di thuajse të gjitha proceset e trajtimit dhe rritjes së gjësë së gjallë, kjo formë ekspozimi më sjell në vëmendje dhe imagjinatë imazhin se aty ka shkelur Shekspiri, si një nipçe, të cilin e ëma e sillte te ferma e prindërve të saj dhe ai argëtohej aty në fshat, ose mund të bënte edhe punë ferme. Pse jo?

Në qasjen ndaj kësaj "shpikjeje" interesante të "Bordit të të besuarve të Shekspirit", më ngacmoi ideja se sa largpamës, sa të mençur, sa tolerantë dhe të respektueshëm e aspak paragjykues kanë qenë ata njerëz, kur e kanë kthyer fermën e Nënës së Shekspirit, nga një tokë ndoshta e braktisur, në një fermë shumëfunksionale, që është edhe fermë prodhimtare, vend historik dhe vend turistik në të njëjtën kohë. Dhe kjo ka ndodhur në një vend kur ndarja klasore sipas rangjeve: në një shoqëri me shtresa aristokrate dhe të thjeshtë, mbretër e mbretëresha dhe subjekte të tyre, dukë dhe dukesha, markezë, viskontë e earls, aristokratë dhe njerëz të thjeshtë, me lordë dhe hamej, është kaq e theksuar, ndoshta më e dukshme se në çdo vend tjetër të botës. Dhe Shekspiri vetë, gjeniu i tërë kohërave në letërsi vinte nga kjo shtresë fshatare. E, megjithatë, shoqëria e lartë angleze e pranoi atë pa as më të voglën shpërfillje.

Ndërsa shoh kaq shumë gjëra në këtë fermë, më kujtohet fëmijëria ime dhe gjej thuajse çdo gjë në të. Madje edhe krevatet e fjetjes, ku fëmijët flenë të gjithë bashkë për të ngrohur njëri - tjetrin, ose edhe me prindërit. Diçka që sot, jeta urbane nuk e pranon.

Epitaf mbi varrin e Shekspirit

Epitafet mbi varret e njerëzve të mëdhenj janë shpesh aq parathënës, saqë brezave të mëvonshëm iu duhet shumë kohë t'i deshifrojnë. Çdokush, që vjen në këtë vend, do ta mbyllë udhëtimin duke vizituar varrin e Shekspirit dhe duke rrudhur ballin dhe mëtuar ta kuptojë domethënien e epitafit të shkruar në pjesën anësore të varrit të tij, siç e kishte lënë amanet ai vetë. Është një tekst, i

cili ka lënë vend për shumë interpretime. Janë të shumtë arkeologët, studiuesit, shekspirologët, të cilët kanë dashur shumë herë edhe ta hapnin atë varr, por askush nuk ka "guxuar" deri më sot. Ai epitaf le shumë hapësirë për bestytni, paragjykime dhe frikë. Ai e ka mallkuar atë që do ta prekë atë varr, që do t'i heqë pluhurin, që lëviz gurët apo, larg qoftë, që ia trazon eshtrat e tij.

Njerëzit i tremben edhe idesë se Shekspiri ishte "vrasësi më i madh" i personazheve të tij në historinë e letërsisë. Madje "vrasës" mbretërish, princash, heronjsh dhe viktimash. Ja vargjet:

O mik, pash Krishtin, mos u mundo!
K'te pluhur t'ma fshish, mos guxo!
Bekuar ai që këta gurë nuk i ngacmon,
Mallkuar ai që eshtrat e mi i trazon.

Stratford on Avon 15-17 shtator 2014

EDICIONI I DYTË I "NOTES ON ALBANIA", NË TEATRIN KINGS PLACE

"Notes On Albania" nuk duhej të mbyllej vetëm me një veprimtari. Ajo duhej të kthehej në traditë. Përvoja e edicionit të parë ishte bazë e mirë për të vijuar më tej. Kështu, për nder të 102-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, u organizua Edicioni i Dytë, i cili u vu nën patronazhin e Lordit Robert Maclennan i Rogartit. Veprimtaria u mbajt në Teatrin "Kings Place", një nga qendrat më prestigjioze të muzikës dhe teatrit në botë.

Nata e Parë: "Apologjia e vërtetë e Sokratit" me Mirush Kabashin

Natën e parë të edicionit të dytë të kësaj veprimtarie të madhe ishte aktori ynë i mirënjohur, Mirush Kabashi, i cili interpretoi "Apologjinë e vërtetë të Sokratit". Salla e mbushur me anglezë shtangu përpara një interpretimi të tillë. Shumë prej pjesëmarrësve e krahasuan atë me një shfaqje shekspiriane dhe aktorin - të denjë për trupën e Teatrit Mbretëror Shekspirian. Kjo shfaqje u ndoq nga një publik shumë i zgjedhur dhe u publikua online për 53 mijë anëtarët e klubit të teatrit "Kings Place" në tërë botën. Me këtë monodramë, Mirush Kabashi ka lartësuar gjuhën dhe teatrin shqiptar në skenat më prestigjoze si ajo e Parisit, Vjenës, Kajros, Kievit, Torontos, Athinës, Beogradit, Prishtinës, Lionit, Plovdivit, Gjenevës etj., duke marrë duartrokitje dhe vlerësime të veçanta.

Një natë përpara shfaqjes, artisti Kabashi pati një takim shumë emocionues me bashkatdhetarët në sallën e Ambasadës. Ai foli për karrierën e tij dhe interpretoi pjesë të zgjedhura me karakter të theksuar patriotik nga letërsia shqiptare.

Artistët britanikë dhe shqiptarë së bashku dhe…

Natën e dytë shfaqja e vënë nën patronazhin e Lordit anglez Robert MacLeenen i Rogartit solli një gërshetim të rrallë e të bukur të artit shqiptar me atë britanik.

Në koncert morën pjesë rreth 420 vetë. Një pjesë e audiencës ishin të ftuar, ndërsa pjesa tjetër shikues me interesim të lartë për artin dhe artistët shqiptarë. Audienca përbëhej nga 15 ambasadorë me zonjat e tyre, nga shefja e Prezencës Evropiane në Mbretërinë e Bashkuar, znj. Jacqueline Minor, Lord Mayor of City of Westminster, Robert Davis, shumë diplomatë, lordë, parlamentarë, profesorë universitetesh, muzikologë, anëtarë të Shoqatës Anglo - Shqiptare, biznesmenë, dashamirës anglezë të muzikës, bashkatdhetarë me banim në Britaninë e Madhe, studentë etj.

Shfaqja u hap me një fjalë të shkurtër të Ambasadorit shqiptar dhe u pasua me një fjalim shumë të bukur të Lordit MacLeenen, i cili nënvizoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve tona. Perdja u hap me një kolazh të harmonizuar të motiveve të Himnit Kombëtar Shqiptar "Rreth Flamurit të Përbashkuar" me atë britanik - "Zot, Ruaje Mbretëreshën!", interpetuar nga pianisti i talentuar Genc Tukiçi. Më pas kompozitorja Roxanna Panufnik paraqiti kompozimin "Vjeshtë në Shqipëri", luajtur nga "Alb - Trio"; violinisti anglez Peter Sheppard Skærved interpretoi si premierë botërore një vepër me motive me çifteli, të kompozitorit shqiptar Thomas Simaku, pedagog në Konservatorin e Yorkut në Angli; Sopranoja me famë botërore Inva Mula, shoqëruar nga pianisti Genc Tukiçi, interpretoi pjesë lirike shqiptare dhe arie operistike nga më të njohurat në fondin e muzikës. Pianistja Mariela Cingu, po ashtu, luajti pjesë nga fondi pianistik shqiptar. Ishte një gërshetim i mrekullueshëm i veprimtarisë artistike të artistëve shqiptarë dhe atyre britanikë.

Midis tyre spikati interpretimi dhe fjalimi i diplomatit Robert Wilton, shkrimtar dhe poet, autor i librit "Spider of Sarajevo", si dhe, mbi të gjitha, përkthyes i letërsisë shqiptare në gjuhën angleze -.

Anglezi Robert Wilton për letërsinë "shekspiriane" shqiptare

Robert Wilton-i erdhi nga Tirana enkas për këtë veprimtari me shpenzimet

e veta drejt e në sallën e teatrit. U vesh me papion të zi, doli në skenë dhe recitoi në gjuhën angleze përkthimin e vjershave shqipe nga De Rada - "Çfarë është më e ëmbël se një puthje", elegjinë "Vajtimi i Ajkunës" nga Eposi i Kreshnikëve, poemën "Kristal" nga Ismail Kadare dhe këngën "Moj e bukura More".

Salla shpërtheu në duartrokitje pas çdo interpretimi të tij. I inkurajuar nga suksesi ai bëri një deklaratë, për të cilën çdo shqiptar duhej të ndihej krenar. Ai, pak a shumë tha:

> *"Nëse ne anglezët do të kishim pasur fatin e lumtur që të kishim të përkthyer letërsinë shqipe aq bukur sa ç'është e përkthyer letërsia jonë angleze në shqip, e veçanërisht Shekspiri nga i madhi Fan Noli, atëherë do të kishim kuptuar se shqiptarët kanë një letërsi të madhe dhe shumë të bukur që, në shumë raste, shkon krahas me letërsinë tonë angleze".*

Kompliment më të madh për letërsinë shqipe nuk kisha dëgjuar. Aq më tepër që Robert Wilton-i e zotëron në mënyrë përsosur gjuhën shqipe.

Ndërsa Lordi MaCleenen i Rogartit u shpreh:

> *"Një popull që ka nxjerrë nga gjiri i vet artistë kaq të talentuar meriton respekt, nderim dhe vëmendje shumë më të madhe nga vendi ynë, populli ynë, Mbretëria jonë dhe qeveria jonë".*

Ky ishte edhe produkti i kësaj sipërmarrjeje në atë edicion të dytë.

Kur po e shkruaja këtë libër i kërkova zotit Wilton të më bënte një koment, i cili do të më nderonte. Këtu poshtë po sjell letrën, që më dërgoi Robert Wilton-i:

> *I dashur Mal,*
>
> *Si qytetar britanik, i cili zyrtarisht është bërë qytetar i Kosovës, pra si dikush që ka punuar dhe jetuar në Ballkan për dy dekada, besoj fort se ngritja e urave gjithnjë e më të forta midis dy kulturave është përfitimi më i madh për të dyja palët. Për mua, leximi dhe më pas përkthimi i letërsisë shqipe, fillimisht ka qenë një mënyrë unike në një vend aq shumë mikpritës dhe pastaj është kthyer në një detyrim, që ta mbështesja atë sipas mënyrës sime më të mirë.*
>
> *Për vende si Kosova dhe Shqipëria, që akoma pajtohen me trashëgiminë*

e shtypjes dhe dobësisë sistemike, duke u përpjekur të gjejnë vendin e vet në identitetet e tyre në botë, kultura mund të jetë forma më e frytshme e veprimtarisë diplomatike. Ndërsa reputacioni i politikanëve dhe institucioneve mbetet i dobët, reputacioni i artistëve tashmë ka marrë përmasa globale.

Angazhimi i shqiptarëve në fushën e artit, në të gjitha format e tij, vazhdon ta rritë mirëkuptimin dhe afinitetin ndërkombëtar. Takimi me artistë shqiptarë - veteranë të shquar, që janë dalluar në tranzicionin demokratik, si dhe me të rinjtë e pasionuar, të cilët gjenden në vijën e parë të krijimtarisë evropiane - do të thotë të ndiejmë respekt dhe të kemi shpresë te përparimi i këtyre trojeve.

Ata të huaj që kanë fatin ta lexojnë poezinë shqipe, të dëgjojnë një soprano shqiptare apo të shikojnë një dramë shqipe, gjejnë elemente unike dhe të veçantë si dhe elemente që janë të njohura për kënaqësinë që japin edhe pas dy mijëvjeçarëve të baticave dhe zbaticave, që rrjedhin në të gjithë kontinentin.

Kjo është arsyeja pse mbrëmja artistike "Notes on Albania", kushtuar kulturës shqiptare dhe lidhjet e saj me kulturën angleze, e organizuar nga Ambasada shqiptare në Londër, ishte një mënyrë e mrekullueshme dhe jetike e përfaqësimit kombëtar. Ja pse ndihesha kaq i nderuar të isha një nga interpretuesit! Të ndaja një skenë me instrumentistët, kompozitorët dhe këngëtarët shqiptarë dhe anglezë, përpara një publiku britanik dhe ndërkombëtar dhe të interpretoja poezinë shqipe në anglisht, ishte një festë jo vetëm e identitetit shqiptar, por edhe e identitetit tim, si dhe i vetë identitetit që na bashkon të gjithë ne evropianëve. Ajo ishte një mbrëmje tipike e përfaqësimit dinjitoz, energjik dhe krijues të kombit shqiptar.

Aty ishin të shkrira, mund të themi, traditat malore të përfaqësuara nga titullari i ambasadës me ato urbane të Shqipërisë, që e bëri ambasadën jo vetëm bastion të interesit kombëtar, por edhe një forum të gjallë të veprimtarisë artistike. Aty u shpalos kultura shqiptare, e cila mund të përjetohej në karakteristikën e saj krenare. Aty gjendej vazhdimësia e shkëmbimit të përjetshëm, që ka karakterizuar gjithmonë si shqiptarët, në udhëkryqet e botës, ashtu edhe traditën artistike evropiane.

Si miku juaj i përhershëm:
Robert Wilton
Shkrimtar, diplomat, përkthyes, aktor anglez, ish zevendës ambasador i OSBE-së në Tiranë

Letër nga diva jonë, sopranoja Inva Mula

Dëshira për të pasur në këtë libër edhe një opinion të divës sonë të njohur, sopranos Inva Mula, më shtyu t'i kërkoja të më shprehte kujtimet e veta, parë në këndin e vështrimit të saj si promotore e përhapjes së kulturës dhe artit shqiptar nëpër botë. Ajo me shumë bujari m'u përgjigj:

> *"Në rrugëtimin tim të gjatë me shumë ndalesa, mbeten të pashlyera ato momente, të cilat flasin vetë me peshën e emocionit që mbartin. Fatmirësisht këto kujtime janë të shumta për mua, me njerëz të njohur e të panjohur, me të cilët bashkëpunimi i frytshëm i fikson në kujtesë ngjarjet, duke lënë edhe mbresa si këto që dua t'i shpreh në këta rreshta.*
>
> *Në fillim të vitit 2014, ndërsa isha në Paris, pranova një thirrje telefonike nga zoti Mal Berisha, që më thërriste nga Londra. Ai, me një zë të qetë, më shpjegoi gjithë përpjekjet e tij dhe të personelit të tij, si Ambasador i RSH-së në Londër, për të promovuar kulturën shqiptare. Pastaj më kërkoi t'i jepja një rendezvous, në një kohë sa më të përshtatshme për mua në Paris, pasi do të vinte të më takonte enkas për një aktivitet, që kishte të bënte me promovimin e Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Ramë dakord për datën, orën dhe vendin. Ai erdhi bashkë me të shoqen, me të cilën njiheshim prej kohësh, pasi ishim takuar në shtëpinë e fotografit të njohur shqiptaro - amerikan, Fadil Berisha, në New Jersey. Me ta ishte edhe një diplomate tjetër e ambasadës. Unë me Genc Tukiçin dhe ata të tre, u takuam në një kafe në Champs-Élysées në Paris.*
>
> *Biseda u zhvillua rreth një ftese që mua dhe pianistit tim të preferuar, Genc Tukiçi, na ofrohej nga Ambasada Shqiptare në Londër, për të marrë pjesë në edicionin e dytë të veprimtarisë komplekse, që ata e quanin "Notes on Albania".*
>
> *Unë jam mësuar të marr ftesa pa ndërprerë, por jo të gjithave mund t'ju përgjigjem pozitivisht për shkak të angazhimeve të mia të përditshme. Megjithatë, një ftesë e tillë më bëri të ndalesha, ta mendoja mirë dhe t'i jepja rëndësinë e duhur. Unë e mora si detyrim, pasi ftesa vinte nga një autoritet shtetëror. Megjithatë, shpejt e kuptova se më shumë se detyrim zyrtar ato veprime ishin të bazuara në përpjekje personale dhe dëshirë reale për të bërë gjëra të bukura për Shqipërinë, nëpërmjet artit dhe artistëve të vërtetë shqiptarë.*

Veprimtaria ishte vijim i një edicioni të mëparshëm dhe do të zhvillohej në një nga sallat më prestigjoze në botë, në Teatrin Kings Place, në zemër të Londrës.

Ky edicion ishte i dyti që organizohej në Londër. Pas suksesit të parë, Ambasada ishte siguruar se kjo mënyrë e promovimit të Shqipërisë funksiononte shumë mirë dhe i jepte edhe një kombi të vogël si Shqipëria një vend shumë të madh në morinë e aktiviteteve artistike, kulturore të pafund, që organizoheshin në Londër. Kjo ishte kartëvizita më me vlerë, e cila flet vetë sesi atë që nuk e bëjnë shkresat për vite me radhë, e bëjnë disa minuta muzike dhe art, me shkëndinë e pazëvendësueshme, që nxitin ato tek emocionet më të bukura njerëzore.

Kështu, më 26 nëntor 2014 u gjendëm në Londër bashkë me pianistin Genc Tukiçi, ku u pritëm me përzemërsi atdhetare dhe elegancë diplomatike, në një sallë superdinjitoze, gjë që i tejkaloi pritshmëritë tona.

Aty u rrethuam prej artistëve të tjerë shqiptarë dhe anglezë. Skena kishte në sfond një ekran televiziv gjigant, ku projektoheshin pamje të mahnitshme nga Shqipëria jonë e bukur.

Pajisjet e ndriçimit dhe zërimit ishin të sofistikuara nën sytë e kamerave profesionale për rregjistrim të drejtpërdrejtë të koncertit. Gjithçka kontrollohej në mënyrë kompjuterike dhe sinkronizohej në formë digjitale.

Mbi të gjitha, në sallë gjendej një publik i zgjedhur shumë artdashës, që shpërthente në ovacione pas çdo numri të programit. Ajo që dua të nënvizoj është sa krenare u ndjeva nga mënyra sesi u përshfaq Shqipëria jonë përpara atyre ambasadorëve, lordëve, parlamentarëve, spektatorëve anglezë dhe shqiptaro - britanikëve.

Do të kisha dëshirë që një paraqitje e tillë aq dinjitoze të ndodhte edhe në metropole të tjera në mbarë botën, atje ku veprojnë ambasadat tona. Aty mësova se nuk pengon thjesht mungesa e fondeve, që veprimtari të tilla të organizohen edhe në vende të tjera, sado që edhe fondet kanë rëndësinë e tyre. Më shumë se financa duhen atdhedashuria, shpirti, zemra, impenjimi, që janë elementet kryesorë.

Neve na duhet ta tregojmë Shqipërinë tonë siç është, një realitet të bukur në sytë e botës së qytetëruar.

Falemnderit, Londër!"

Kings Place Theater, Londër, 25 - 26 nëntor 2014

HERMAN BERNSTEIN NË YIVO INSTITUTE OF JEWISH RESEARCH MANHATTAN NEW YORK

Prej vitesh kisha lexuar disa gjëra rreth jetës dhe veprës së ish-Ambasadorit Amerikan, Herman Bernstein, i cili shërbeu në Mbretërinë Shqiptare si përfaqësues i SHBA-së në vitit 1930 - 1933. Në marsin e vitit 2013 vizitova qendrën më të madhe të studimeve hebraike, YIVO, në New York. Isha i interesuar të njihesha me koleksionin e Bernstein-it.

Punonjësja e Institutit, zonja Fruma Mohrer, u tregua shumë e gatshme të më ndihmonte dhe madje të më vinte në dispozicion tërë arkivën "Bernstein". Aty arrita të fotografoja tërë materialet dhe dokumentet e lëna trashëgim prej tij. Më pas, i thellova studimet rreth kësaj figure kaq interesante hebraiko - amerikane, i cili kishte lënë një trashëgimi të veçantë në historinë e marrëdhënieve tona me atë shtet të madh. Një ndihmë të posaçme më dha Drejtori i "Zërit të Amerikës", gazetari shumë i njohur dr. Elez Biberaj, si dhe historiani i njohur dhe gazetari i po atij radio - televizioni, z. Ilir Ikonomi. Disa gjëra i gjeta edhe në Arkivin e Shtetit Shqiptar. Kështu filloi një punë intensive për njohjen e kësaj figure shumë të ndritur.

Pas rreth një viti e kisha sistemuar tërë materialin dhe e kisha sjellë në formën e një broshure në gjuhën angleze, me rreth 60 faqe. Broshura u ilustrua me fotografi, tituj librash të botuar prej tij si dhe fragmente nga fjalimet e mbajtura gjatë shërbimit në Shqipëri. Për ta bërë sa më konkret dhe bindës këtë botim, i sigurova nëpërmjet të Amazonit tërë kolanën e librave të këtij autori. Ishin plot 23 të tilla.

Një ditë mora një letër nga Drejtori i Institutit YIVO, Prof. Jonathan Brent, i cili më ftonte të bëja një prezantim në sallën e YIVO-s në Manhattan. Ramë dakord që kjo të bëhej më 14 dhjetor 2014. Letra:

YIVO Institute of Jewish Research
15 West 16th Street, New York, NY 10011
14 Tetor 2014

I dashur Ambasador Berisha,

Është nder dhe kënaqësi për mua t'ju dërgoj këtë letër me anën e së cilës ju ftoj të mbani një leksion në Institutin YIVO për Kërkime Hebraike në New York, të Djelën me datën 14 dhjetor 2014. Siç është përshkruar në broshurën e printuar dhe në programin tonë të vjeshtës së vitit 2014, leksioni juaj është titulluar: "Marrëdhëniet Shqiptaro Hebraike dhe Kontributi i Ambasadorit Amerikan në Shqipëri, Herman Bernstein (1876 – 1935)".

Po ashtu titulli është bazuar në kërkimet që ju keni bërë duke përdorur dokumentet e Bernstein-it në Arkivën e YIVO - s.
Ky leksion është pjesë e serisë vjetore të leksioneve të YIVO - s, të quajtur "Seminari Ruth Gay në Studimet Hebraike". Misioni i kësaj serie leksionesh është të inkurajojë studiuesit, të cilët kanë shfrytëzuar burimet e koleksioneve të YIVO - s që t'i bëjnë gjetjet e tyre të njohura për publikun e gjerë dhe të nxisin dialogun rreth kërkimeve të reja në fushën e kulturës dhe historisë hebraike.
Kërkimet origjinale që ju keni ndërmarrë mbi jetën e Herman Bernstein - it dhe marrëdhëniet e tij me Shqipërinë, janë të një interesi dhe rëndësie të veçantë, prandaj ne presim me entuziazëm që ta mbani leksionin në YIVO, në dhjetorin që po vjen.

Sinqerisht
Jonathan Brent
Drejtor Ekzekutiv.

Profesor Brent është autor i shumë librave për hebraizmin, por ato që bien në sy më shumë janë librat "Krimet e fundit të Stalinit" dhe "Brenda arkivave të Stalinit – Duke zbuluar Rusinë e Re".

Prezantimi në YIVO

Biografia e Herman Bernstein-it tanimë është e fiksuar në dy libra; njëri në anglisht dhe tjetri në shqip. Por ajo që dua të nënvizoj në lidhje me këtë veprimtari është prezantimi në sallën e YIVO-s në Manhattan. Atë ditë salla u mbush plot me hebrej - amerikanë dhe shqiptaro - amerikanë, këta të fundit kryesisht nga Federata Pan- Shqiptare e Amerikës, "Vatra". Zonja Fruma Mohrer dhe profesor Jonathan Brent bënë prezantimin dhe e hapën aktivitetin. Pastaj me ilustrime të projektuara në ekranin e madh të sallës përreth një orë u "zbulua" jo vetëm jeta e Bernsteinit në Shqipëri dhe trashëgimia e tij, por edhe jeta e hebrenjve në vendin tonë dhe historia e shkëlqyer e marrëdhënieve të tyre me shqiptarët.

Duke cituar shkrimtaren hebreje amerikane Gertrude Stein, e cila pat thënë një herë: *"Historia kërkon kohë. Historia e gjen vet rrugën drejt kujtesës",* nënvizova faktin se kjo histori që do të tregoja, kishte mbetur e mbyllur në sirtar për afro 46 vjet të sundimit komunist.

Historia më e shkëlqyer e hebrenjve të shpëtuar në Shqipëri mori kohë për t'u ndriçuar. Ne kemi arritur të mësojmë përmes historisë dhe kujtimeve të të shpëtuarve se Shqipëria ishte kombi i vetëm evropian që kishte më shumë hebrenj në fund të Luftës së Dytë Botërore, sesa në fillim të saj.

> *"Asnjë jetë e vetme hebreje nuk humbi në vendin tonë. Përkundrazi, numri i hebrenjve, që ishin strehuar nga vendet e tjera evropiane kryesisht nga Austria, Gjermania, Jugosllavia, trefishoi popullsinë hebreje".*

Që nga ajo kohë, shumë organizata hebraike, kryesisht në Shtetet e Bashkuara, së bashku me politikanë shqiptarë, studiues dhe familje të atyre që ndihmuan hebrenjtë, kanë bërë përpjekje për të zbuluar këtë histori përpara botës. Përmes atij prezantimi dhashë një ide dhe kuptim të përgjithshëm të marrëdhënieve të xhentilëve (jo-hebrenjve) shqiptarë me popullatën hebreje të Shqipërisë dhe me të sapoardhurit, më vonë, gjatë periudhës naziste.

Prezantimi kishte të bënte me jetën e Herman Bernstein - it që nga Lituania deri në Shtetet e Bashkuara, 1876 - 1935. Pastaj me veprimtarinë e tij

si gazetar dhe udhëtar dhe se si e mbuloi ai Revolucionin Sovjetik të Tetorit, 1917 dhe Konferencën e Paqes në Paris, 1919 për gazetat amerikane "New York Times", "New Yorker Magazine", "Washington Post" etj. Pastaj u ndala tek ai si shkrimtar dhe intelektual i shkëlqyer, autor i rreth 23 librave dhe përkthyes i autorëve rusë Çehov, Tolstoi, Andrejev etj.

Më tej u ndala tek ai si aktivist hebre dhe praktikisht te polemika me Henry Ford në librat e tij "Historia e një gënjeshtre", "Njeriu i mençur i Sionit", "Në Portën e Izraelit", për punën e tij si themelues i revistës "Jewish Tribune" etj. Po ashtu nënvizova përpjekjet për krijimin e një shteti hebre në Palestinë dhe 65 telegramet Wicky – Nicky, të shkëmbyera nga dy mbretër evropianë, Kaiseri Gjerman, Wilhelm II dhe Cari Rus, Nikolla II, të cilët komplotonin kundër Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara si dhe mbytjen e anijes "Lisutania", që mori me vete 1198 jetë njerëzish. Nënvizova faktin se ai ishte mik i Presidentëve Teodor Rooslvelt, Woodrow Wilson dhe Herbert Hoover. Pas kësaj vinte veprimtaria e tij si diplomat i shkëlqyer amerikan në Shqipëri.

Nënvizova miqësinë me Mbretin e Shqiptarëve, Ahmet Zogu, korrespondencën me atdhetarët shqiptarë, Gjergj Fishta, Lef Nosi etj. Me interes ishte edhe përkthimi prej tij i dramës së Aleksandër Moisiut "*I Burgosuri*" kushtuar Napoleon Bonapartit. Po ashtu theksova aftësitë e tij si historian dhe nënvizova punën për evidentimin e rrënjëve të hebrenjve në Shqipëri e veçanërisht jetën e Rabinit Sabattai Zevi, i konsideruar si Mesia False, që vdiq në Berat në vitin 1676.

Me interes ishte edhe kontributi i Bernstein-it në regjistrimet e jetës shqiptare, Besës, kulturës, fesë, gjuhës, folklorit, traditës, historisë, arkeologjisë, etnografisë, kostumografisë etj. Ajo që e bën edhe më interesante figurën e tij është veprimtaria si diplomat kundër ndikimit italian të Duçes në Shqipëri dhe parashikimi, që ai bëri në gazetën "New York Times" më 28 janar 1934, se Shqipëria do të pushtohej prej Italisë fashiste, gjë që ndodhi pikërisht ashtu, pesë vjet më vonë. Në mbyllje nënvizova faktin që Bernstein është figurë e rëndësishme e historisë së marrëdhënieve shqiptaro - hebraike dhe amerikane: Ai është një nga intelektualët më të mëdhenj që u bë ambasador, duke vendosur një standard të ri intelektual në diplomacinë e SHBA-ve.

Ajo ishte ditë e shënuar edhe për shqiptaro – amerikanët e New York – ut. Dhjetëra syresh u njohën me hebrenj të pranishëm. Ndërsa pas asaj veprimtarie

bëmë një foto me pjesëmarrësit, kryesisht vatranë, në mes të të cilëve, Kryetari i Federatës Pan Shqiptare të Amerikës, Vatra, dr. Gjon Buçaj, nënkryetari i saj z. Agim Rexha, veprimtari i njohur i çështjes kombëtare z. Harry Bajraktari, e plot zonja dhe zotërinj të tjerë.

Pas disa kohësh, biografinë e Herman Bernstein - it e botova në gjuhën shqipe. Kësaj radhe ajo ishte shumë më e plotë në vëllim, fakte dhe materiale. Atij libri i shtova edhe një pjesë të dytë, në të cilën pasqyrohet vepra e këtij burri të madh si hebre i njohur për veprimtarinë e tij në dobi të kombit të vet dhe si një nga gazetarët më të shquar amerikanë të kohës. Në udhëtimin e parë pas botimit librin e dhurova në dy kopje në arkivin YIVO si dëshmi në gjuhën shqipe të veprës së tij.

New York, YIVO Institute for Jewish Research, Manhattan, 14 dhjetor 2014

LUM LUMI - ATIONI - ALI PODRIMJA - VISAR ZHITI

Pas emërimit në Londër, lidhjet me Visar Zhitin i mbaja thuajse të përditshme. Ndër gjërat e rëndësishme për të cilat flisnim ishin librat që po shkruanim ai dhe unë dhe veçanërisht vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër dhe në Rajonin arbëresh të Molizes në Itali.

Projekti im i 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë ishte monografia e Erickson-it. Puna për të më kishte kushtuar shumë mund e punë, por ai libër do të ishte pjesë e krenarisë së jetës time. Ndaj, kur të bëhej përurimi, duhej të ishte "Haveli" shqiptar i letrave shqipe, Visar Zhiti, që do ta bënte hapjen e kësaj ceremonie. Dhe kështu ndodhi. Libri u botua më 5 nëntor 2012. Përurimi ishte ngjarje e rëndësishme jo vetëm për mua. Shumë më shumë se kaq.

Erickson-i përfaqëson një figurë shumë të ndritur amerikane, që i ka dhënë aq shumë Shqipërisë. Një jetë e kushtuar për ne shqiptarët duke sakrifikuar familjen dhe fëmijët e vet. Dhe ishte harruar fare që nga koha kur ai ishte larguar në vitin 1937. Ai ishte marrë intensivisht me çështjen shqiptare. Nuk ishte politikan aq më pak komunist. Thjesht e donte kombin shqiptar. Si amerikan ai kishte tërhequr dashurinë e popullit shqiptar, por pas luftës edhe urrejtjen absurde të komunistëve. Tani ai po "kthehej" dhe po "rikthehej" jo vetëm në libër por edhe me nipat e vet, Paulin, Donin dhe mbesën Mary Morris. Nëpërmjet At Liolinit, kreut të Kishës Ortodokse Shqiptare të Shën Gjergjit në Boston, gjeta mundësinë të lidhesha me nipat dhe mbesat e Ercikson-it në Amerikë. I ftuam dhe erdhën në Shqipëri. Për ta u kujdesën dy djemtë e mi, Erioni dhe Kreshniku.

Ata shkuan në Elbasan dhe morën titullin "Qytetar Nderi" për gjyshin. Pastaj shkuan në Golem të Kavajës, dhe panë shkollën me emrin e gjyshit të tyre, e cila

me rastin e 100-vjetorit mori emrin: Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Eickson" - 20.09.1925. Në Tiranë ata morën medaljen ''Qytetar Nderi" për gjyshin e tyre "tirons".

Në mbrëmjen e 5 nëntorit ata do ishin në Hotel "Tirana Internacional", bashkë me Kryeministrin Berisha, Ambasadorin Amerikan, Aleksandër Arvizu, botuesin e librit, profesor Bardhyl Musai, familjarët e mi përfshirë edhe nënën time Sibe Berisha si dhe një audiencë tejet të madhe.

Mbrëmjen e hapi Visar Zhiti. I urtë dhe fisnik, poet në shpirt dhe në sjellje. Në të vërtetë unë e ndoqa nga Londra veprimtarinë, dhashë edhe një prononcim via Skype, pasi një përkeqësim i shëndetit nuk më lejoi të udhëtoja.

Po në atë periudhë po merresha me një projekt tjetër të 100-vjetorit. Ishte vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër. Përpjekjet për atë bust janë shpjeguar, por dua të nënvizoj një fakt të rëndësishëm: Ndërsa ende nuk kisha as bust, as fonde, më duhej të mendoja mirë për emërtimin në piedestalin e bustit. Ai do të vihej në Londër, në Londrën e madhe, në konglomeratin apo "poçin ku ishin shkrirë tërë racat dhe fetë e botës".

Në këtë qytet njerëzit vijnë të dëshpëruar dhe shpejt mësojnë të sillen si zotërinj, si zengjinë. Liritë janë aq të pakufizuara e prapëseprapë aq të rregulluara mirë me ligj. Kështu, Skënderbej do vihej në një qytet ku do të kishte njerëz që mbase dinin për të, por do të kishte edhe nga ata që nuk e njihnin dhe as që kishin dëgjuar ndonjëherë për të.

Por kishte edhe nga ata që nuk donin të dinin për të. Duhej marrë leje në çdo familje që banonte aty afër pasi edhe mund ta kundërshtonin. Por si do të ishte diçitura që mos të prekej askush. "Çelësi" i kësaj pune do të ishte Visari. I thashë se ka shumë etiketime për Skënderbeun, por unë kam frikë nga ndonjë ekstremist që e ka bezdi aty. I dhashë variantet e mia. Por ai është Visari me mendjen visar që më dha emërimin më të mirë që më pas u vendos në piedestalin e bustit.

Me Visarin dëgjoheshim shumë shpesh në telefon. Dhe pyetja e parë që i bëja ishte përherë:

- Si e kam shokun tim të ngushtë?

- Mirë, - më thoshte - ja përpiqet që të mësojë atje. Ai i di vetë gjërat. Nuk i ndërhyj aq shumë. Mirë duket. Kjo ishte përherë hyrja në bisedën me Visarin dhe që lidhej me Ationin, të birin.

Ationi! Tragjiku! I riu! Bukuroshi. Dhimbja!

Ationin e kisha njohur në një mbrëmje në Ministrinë e Jashtme, kur një grup të rinjsh, nxënësit më të mirë të disa gjimnazeve të Tiranës, kishin ardhur në ministrinë tonë. Ata do të dëshmonin se çfarë do të bënin nëse ata do të ishin në të ardhmen kryeministrat e vendit tonë. Ationi ishte njëri ndër ta. Vetësiguria, përqendrimi, qartësia në mendime, të gjitha më bënë përshtypje të madhe. U miqësuam dhe shkëmbenim mesazhe. Më dukej sikur flisja me një shok të moshës, një njeri që ia vlente të komunikoje. Më dukej sikur isha bërë shok me të po aq sa edhe me të jatin. Më pas shkoi në Milano për studime. U gëzova shumë kur më shkroi se unë tani jam student filozofie. Uau! Sa bukur! U gëzova për Edën dhe Visarin, pasi ata e kishin dritën e syrit dhe ëndrrën e tyre të realizuar. Por nuk ishte e thënë. Një mbrëmje, mora sms nga një miku im në Londër, që më njoftonte për kumtin e kobshëm. Nuk doja t'u besoja syve për atë që lexova. Më erdhi një vuajtje që pak më shumë se një vit më parë e kisha provuar me humbjen e Sokol Olldashit. Me të ndjerin mund të më lidhnin shumë ideale, por kurrë nuk kisha pirë kafe. E megjithatë, edhe sot trishtohem dhe nuk e besoj çfarë ka ndodhur, si iku!? Po kjo e Ationit? E pabesueshme. Mora telefonin dhe formova numrin e Visarit. E prisha prapë. Çfarë do t'i thosha!! Hapa kompjuterin e gjeta lajmin. Nisa të pres biletën. Mirë thashë me vete, po a e ngushëllon vallë kjo Visarin, asgjë nuk i hyn në sy. As vajtja ime. Për disa orë mbeta i tulatur, i mpirë, i mbaruar. Isha vetëm dhe doja vetëm të qaja dhe të vajtoja.

Në atë gjendje m'u kujtua dita e vdekjes së mikut tim, poetit kombëtar Ali Podrimja. Enigma e vdekjes së tij zgjati dy -tre ditë. Ai ishte dehidratuar gjatë një vizite në Paris. Pastaj u gjet i vdekur në një stol.

Komunikova me Visarin dhe ai më tha se do të shkonte në Prishtinë. I shkrova një letër personale Fitores, së shoqes së Ali Podrimjes si edhe Akademisë së Arteve të Kosovës. Iu luta Visarit ta lexonte dhe ai ashtu bëri. Më nderoi pasi e desha shumë atë poet të madh. Teksti ishte ky i mëposhtmi:

Londër 25 korrik 2012

E dashur Fitore,

Të dashur vëllezër të Akademisë!

Në këtë 100-vjetor të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, sjell disa vargje të njohura nga lexuesi i mësuar me poezitë e Ali Podrimjes së Madh të Letrave Shqipe:

"Unë, biri yt, Kosovë t'i njoh dëshirat e heshtura,
t'i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj,
t'i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet,
t'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua të kulluara;
ta di gjakun që të vlon në gji,
dallgën kur të rrahë netëve t'pagjumta
e të shpërthej do si vullkan: -
më mirë se kushdo tjetër të njoh, Kosovë.
Unë biri yt".

Ai ia donte aq shumë ëndrrat që i vlonin Kosovës në Gji, më shumë se kushdo tjetër, ndaj do të na mungojnë poezitë e reja, që do të shkruante ai.

…do të na mungojnë veprat që ai do t'i shkruante ashtu spontanisht, sikur i dilnin nga burimet e freskëta të bjeshkëve të Kosovës, do të na mungojnë shpirti, pena, dashuria, stoicizmi, vendosmëria dhe dashuria e tij.

E humbëm Ali Podrimjen, njeriun që kur nuk e njihja personalisht e kisha bashkëkombës, kur e lexoja e kisha poetin tim të zemrës, por kur e njoha nga afër m'u bë vëlla; njeriun që ia kisha lexuar vjershat, por nuk ia kisha parë fytyrën; njeriun që më bënte të qaja dhe këndoja për Kosovën, edhe pse Kosovën kurrë nuk e kisha parë; njeriun që më bëri të dua edhe njëqind herë më shumë atë vend të bukur, që ai i këndoi me aq patos e dashuri: Ali Podrimja.

Në këto ditë të rënda për Ju dhe familjen Podrimja, unë dua t'ju kujtoj, jo t'ju ngushëlloj. Ai nuk ka vdekur. Ai vërtet nuk do të jetë fizikisht as në mes të njerëzve të dashur të familjes, as në mes të shoqërisë së tij, as në mes të lexuesve të tij, as në Akademinë e tij, por do ta kemi në çdo raft librash, në çdo konkurs poezie, në çdo klasë ku mësohet letërsia shqipe, në qindra këngë, që janë kompozuar me tekstet e tij dhe që do të kompozohen në të ardhmen.

Ai do të na mungojë, por jo edhe vepra e tij.

Podrimja u nda nga ne, po na la poezinë. Kjo e fundit fitoi edhe një akt tjetër humbje tipike poetësh, ndarjen e Tij në një udhëtim të fundit misionar për vetë poezinë", e mbyllja atë letër.

Visari e dërgoi letrën në vendin e duhur me ato fjalë, që më dolën nga dhimbja e shpirtit. Nuk vonoi shumë, ndoshta në shtatorin e atij viti, ndërsa isha në Tiranë me pushime mora një mesazh telefonik të thjeshtë:

"I dashur Mal, nëse je në Tiranë dhe nëse mundesh le të takohemi te Tajvani me zonjën Fitore Podrimja."

Pashë orën, kishte kaluar dhjetë e mbrëmjes. Me vrap u vesha dhe dola. U takuam të tre si dhe një djalë, nip i Podrimajve, Genti Saliu, student në Oxford. Ndenjëm gjatë dhe kujtuam shumë episode të jetës me Aliun, Profesor Rexhep Ferrin, mikun e tij të afërt, si dhe poetë e artistë të tjerë të Kosovës.

Që kur kisha mësuar për Ali Podrimjen, dija që ai e kishte kthyer në një vlerë të poezisë shqipe një tragjedi, një humbje të madhe të shpirtit të vet: Lum Lumin, djalin që i vdiq në një klinikë në Paris. Dhe pikërisht këtu qëndronte edhe njëfarë themeli mbinjerëzor i poetit, i cili atë vuajtje, që askush mos e provoftë, e kishte kthyer në art, në penë, në ndjenjë, në mesazh, në dashuri, në fisnikëri, në stoicizëm, në qëndresë, në shqipëtari, në burrëri, nëpërmjet vetë poezisë: "Lum Lumi". Ai që i kishte këputur shpirtin, që i shkrehej në duar dhe nuk mund ta ndihmonte. Lumi Lumi siç e ka thënë kritika shqiptare, mund të emërohet si lirikë e pikëllimit me prirje elegjiake.

Unë e dija se Podrimja dhe Zhiti ishin lidhur prej poezisë. Por kurrë nuk do të më shkonte ndërmend se ata do t'i lidhte edhe një gjë tjetër:

Dhimbja.

E kur mora lajmin e kobshëm për Ationin, më erdhën të gjitha këto përsiatje, kjo lidhje e tillë kaq e pamëshirshme. E tani, të dy poetet tanë u vunë në provën më të madhe të jetës. Ndoshta Visari në një provë edhe më të madhe. Papritmas. Papandehur. Atë natë nuk fjeta. Meditova dhe gjeta atë që e quajta:

LUM LUMI I VISAR ZHITIT

Ndjej dhimbje për vuajtjet tua,
Visar!
Sa herë të shkoj nëpër mend!
Dhe kjo nuk ndodh rrallë herë!

Ndjehem krenar që të kam mik,
Visar!
Dhe kjo ndodh për ditë.
Sepse në raftin e librave të mia
Tuajat janë të parat.

U njoha vonë me ty,
Për të të bërë pjesë të rëndësishme të njohjeve të mia,
Miku im Visar!
Ndoshta vonë.
Vonë sepse ti ishe atje…!

Pastaj u njoha me Edën dhe…një ditë
Edhe me Ationin.
Ationin, me të cilin,
Edhe pse ishim mbi dyzet vjet të ndryshëm,
U bëmë shumë miq.

Dukej se na lidhnin shumë gjëra,
Librat e tu, poezia…
Pse jo edhe vuajtjet!
Dëshira e tij për t'u shkolluar…

Dhe ja, erdhi ky fund dhjetori!!!
Fatkeq.
Le t'mos vinte kurrë!
Dhe viti i Ri që po vjen!

Që të na gjente të gjithëve…

Ah! Nuk ma thotë goja.
M'u thaftë!
Pa të!

Pa Ationin,
Bukuroshin e babit e të mamit!
E mikun tim të Ri.

Eh!
Nuk ka forcë në botë ta kthejë mbrapsht atë që ndodhi!
Se po të ishte ashtu,
Do ishte dhimbja ime që do ta bënte,
E para, fill pas jush!

E megjithatë,
Nëse fjala e ëmbël ngushëlluese e një dashurie,
Prej miku, vëllai, shoku, njeriu,
të vlen, të shëron…
Të lutem, vendose edhe këtë timen,
Thellë aty ku ajo dhimbje të lehtësohet sado pak!

E di, pesha e saj është aq e rëndë,
Sa edhe bota vetë të vendosej në anën tjetër,
Nuk do ta peshonte dot.

Kështu qenkeni ju poetët!
Jepni dashuri të pafundme për të tjerët,
I mësoni si të gëzohen, qeshin, qajnë…
Që pastaj të vuani vetë për LUM LUMIN TUAJ!

ATIONI u preftë në paqe, miku im!
Dhe lotët, dhimbja, dashuria, brenga

E Edës dhe e jotja,
Si dhe tërë miqve tuaj, që të duan kaq shumë
Iu bëftë dritë!

Londër, 21 dhjetor 2014

TOKA E SHPRESËS DHE LAVDISË

Në Ditën e Fitores mbi Fashizmin në Westminster Abbey (Victory DAY) - 2015 - LONDËR

Sot është 9 maji 2015, 70 - vjetori i fitores mbi fashizmin. Në Abacinë e Westminster-it arrijnë njëri pas tjetrit veteranë, pjesëtarë forcash të armatosura, anëtarë familjesh pjesëmarrëse në Luftën e Dytë Botërore, intelektualë, pjesëtarë të administratës së lartë të shtetit, anëtarë të kabinetit qeveritar, deputetë të qeverisë dhe opozitës dhe thuajse të gjithë ambasadorët dhe kryekomisionerët e akreditуar në Oborrin e Shën Xhejmsit.

Banda muzikore e Wells - it ekzekuton muzikë të kompozuar nga Davidi i Gurit të Bardhë, baladë nga Filip Spark dhe Elegji nga George Thalben - Ball. Nën tingujt e kësaj muzike në Abaci shfaqet ndërkaq Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II me Dukën e Edinburgut, Princin e Wells - it dhe Dukeshën e Kornuellit. Është një moment solemn nga ato kur e tërë makina protokollare shtetërore e këtij vendi është në funksion të plotë. Me dhjetëra stuartë, zonja mondane me kapele, ushtarakë me grada, të rinj që shërbejnë në kishë, pjesëtarë të Protokollit të Shtetit, kanë vënë tërë energjitë në shërbim të kësaj dite solemne.

Abacia dhe Parlamenti

Po përse pikërisht në këtë Abaci do të festohet 70-vjetori i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore?!

Arsyeja është e thjeshtë: Ajo gjendet pranë Parlamentit Britanik. Në të

prehen eshtrat e thuajse tërë mbretërve anglezë. Aty u mbajt edhe Mesha e Fitores mbi Fashizmin. Aty organizohen Lutjet e Falënderimeve për të mirat që iu ka dhënë zoti britanikëve, bashkë me të huajt. Dita e Lutjeve në botën anglo-saksone është një ndër ditët më të shënuara. Ajo festohet në Amerikën e Veriut si një festë që i ka rrënjët në traditën angleze nga koha e Reformës së Protestantëve. Ajo është në fakt edhe si një festë e të lashtave, edhe pse ato merren shumë kohë përpara datës së shënuar, që është e enjtja e katërt e nëntorit të çdo viti. Kjo ditë është bërë e rëndësishme gjatë Reformimit nën mbretërimin e Henry VIII, si reagim ndaj shumë festave fetare të kalendarit katolik. Përpara vitit 1536 kishte 95 festa fetare në kishë, plus 52 të diela, në të cilat njerëzit duhej të shkonin dhe të merrnin pjesë, madje edhe të paguanin shtrenjtë për to. Kështu lindi një lëvizje për thjeshtimin e tyre deri në dy ose tre siç janë Krishtlindjet, Pashkët dhe Dita e Falënderimeve. Kjo ditë mori këtë emër pas fitores ndaj Armatës Spanjolle në vitin 1588 dhe u pasua prej vendimit të Mbretëreshës Anne në vitin 1705. Një kremtim i përvitshëm i Ditës së Falënderimeve filloi në vitin 1606, fill pas dështimit të Komplotit të Barutit në vitin 1605.

9 maj 1945

Atë ditë, Kryeministri Winston Çurçill, (Winston Churchill) pasi njoftoi publikisht dhe zyrtarisht, nëpërmjet një transmetimi të drejtpërdrejtë radiofonik, kapitullimin pa kushte të Gjermanisë, shkoi në Dhomën e Komunave për t'iu drejtuar anëtarëve të parlamentit. Aty ai ndoqi një meshë, ku njerëzit faleshin për arritjen e kësaj fitoreje dhe për shpirtrat e tërë atyre që dhanë jetën. Festimet në Londër dhe në tërë Britaninë e Madhe shpërthyen menjëherë si një vullkan. Populli u lëshua në rrugë. U zbrazën me mijëra fishekzjarrë. Njerëzit të mbytur në lot gëzimi e dhimbje, këndonin pa ndërprerë këngën:

"Unë nga gëzimi do t'ndizem i tëri gjer n'agim".

(Ja një pjesë e refrenit):

"Kur kombet të humbasin ndjesinë e luftës, mjerim!
Dhe bota prapë të kthehet në të mbarin drejtim,
Oh, çfarë ditë feste do të jetë ajo atëherë,
Kur trimat të sjellin të paqes' pranverë!
Dhe vjen koha që dritat të llamburisin pa pushim
Dhe unë nga gëzimi do t'ndizem i tëri gjer n'agim".

Në radhën e parë vetëm tri karrige para meje është ulur Mbretëresha Elizabeth II. Sot ajo ka veshur një rrobë tërësisht të zezë përfshi edhe kapelen. E qetë, e bardhë, e emocionuar, ajo ndjek me kujdes meshën. Ngrihet dhe ulet sa herë që pastorët e kërkojnë këtë për të tërë meshtarët. Ajo sivjet mbush vitin e 63-të që kur ka ardhur në fron dhe e ndjek këtë meshë që kur ishte vajzë e re dhe e bukur.

Kjo ditë për Mbretëreshën Elizabeth II

70 vjet më parë ajo ishte Princesha Elizabeth. Nga gëzimi i madh i fitores Ajo kishte dalë nga Pallati Mbretëror, pa u vënë re se kush ishte, bashkë me princeshën tjetër, Margaret, duke u përfshirë në turmat, që gëzonin. Ato ishin të shoqëruara nga roje që nuk binin në sy. Në rrjedhë të ditës Çurçilli kishte mbajtur dy fjalime. Të parin në White Hall nga ballkoni i Ministrisë së Shëndetësisë të cilin e filloi me fjalët:

"Kjo është fitorja Juaj!"…
Ndërsa turma iu përgjigj atij:
"Jo! Kjo është fitorja Jote!"…

Më pas në fjalimin e dytë ai e tërhoqi turmën në këndimin e himnit "Toka e Shpresës dhe Lavdisë", kompozuar nga Sir Edward William Elgar:

Tokë e Shpresës dhe Lavdisë, o Nënë e Lirisë,
Si ta shpërblejmë ne që na linde, Ti,
Si t'i zgjerojmë kufijtë e tu të pafundësisë,

Si të mbrojmë atë që Zoti të dhuroi me aq dashuri
Dhe fuqinë tënde ta kthejmë në begati?!

Që prej asaj kohe në këtë Abaci, fitorja mbi fashizmin përkujtohet çdo dhjetë vjet me një meshë të tillë. Mbretëresha Elizabeth II e përkujton atë për të shtatën herë si Mbretëreshë.

Një paralele midis "fitimtarëve"

Në këtë ceremoni përkujtimore të super-organizuar deri në imtësi dhe kaq mbresëlënëse, e pamundur të mos shkojë mendja te shumë fjalime që janë mbajtur në atë kohë, pikërisht në këtë datë ose edhe në ditë të shënuara si kjo mbi çlirimin e vendeve nga nazi-fashizmi.

Ndërsa shoh sesi e festojnë britanikët këtë ditë, mendja shtegton te vendi im, atje ku luftërat, kujtesa, protagonistët përbëjnë një amulli, që venit fitoret dhe zvetënon të vërtetat që duhet t'i ndriçojnë kombet.

Edhe në Tiranë, në kryeqytetin tim plot histori, një njeri ka mbajtur një fjalim, të cilin na e kanë ngulitur në shkollë si një moment patriotizmi. Edhe shqiptarët kanë pasur të drejtë të shpërthejnë në festime pas fitores kundër nazi-fashizmit. Kanë pasur arsye të ëndërronin për ditë më të mira... Por eh ...dallimi është shumë i madh: Nazizmi në Shqipëri u zëvendësua me një formë tjetër diktatoriale edhe në të keqe për popullin shqiptar. Ndërsa këta këtu e sollën vendin e tyre në lartësitë më të mëdha që ndonjë komb e ndonjë popull ka arritur, Shqipëria ra në duart e Diktaturës së Proletariatit, simotra e fashizmit e nazizmit.

Veteranët

I shoh me respekt veteranët britanikë të luftës. Të vjetër, të plakur, por të veshur bukur, me gjokset të mbushura me dekorata. Dhe mendja prapë më shkon te mijëra luftëtarë shqiptarë, shumë prej të cilëve përfunduan nëpër burgje, kampe, internimi dhe ekzekutime të pashembullta. Heronjtë na dolën "tradhtarë" dhe

luftën e paskëshin bërë armiqtë...

Mesha është përherë moment meditimi. Edhe unë sot meditova thellë. Ndjeva keqardhje. E dëgjova me ëndje, por jo pa zili "Tokën e Shpresës dhe Lavdisë" dhe u luta për vendin tim:

''Kurrë mos pafsh fitimtarë luftërash, që të vrasin më shumë se hasmi yt! Amen!"…

Westminster Abbey, Londër, 9 maj 2015

PROFESORESHA E OXSFORD-it, KALYPSO NICOLAIDIS, RRËFEN SE SI U REALIZUA VIZITA E CAROLIOS PAPULIAS-it NË SHQIPËRI

Oxford: Me profesoren greko - franko - britanike Kalypso Nicolaidis

Profesore Kalypso Nicolaidis është akademike me shtetësi të dyfishtë, greke dhe franceze, që punon në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në SEESOX, Oxford. Ajo jep leksione për integrimin evropian, marrëdhëniet dhe ekonominë politike ndërkombëtare. Profesore Kalipsoja më tregoi një ngjarje shumë interesante, e cila kishte pasur efekte mjaft të rëndësishme historike në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë, dëshmitare e së cilës ishte ajo vetë. Ajo më rrëfeu pak a shumë këtë histori, të cilën po e sjell në ligjëratë të drejtë:

Dr. Stylianos Nicolaidis viziton "rastësisht" Shqipërinë

> *"Në vitet '80 të shekullit të kaluar, babai im, dr. Stylianos Nicolaidis, punonte doktor në Paris të Francës. Ai ishte neurokirurg me shtetësi franceze dhe drejtonte Institutin e Neurologjisë që prej vitit 1962. Prej kësaj veprimtarie, kishte marrë çmimin e lartë të Akademisë Franceze të Shkencave. Nga viti 1982 deri në vitin 1990 ai ishte zëvendës President i Akademisë Greke të Shkencave. I lindur në vitin 1933 në Veria të Maqedonisë Greke, ai që në vitin 1952, ishte vendosur në Francë".*

Kalipsoja më tregoi se diku nga mesi i viteve tetëdhjetë, babai i saj, dr.

Stylianos, ishte takuar në një pritje diplomatike me ambasadorin shqiptar në Paris.

Ata kishin shkëmbyer një bisedë shumë të shkurtër për shkak të pengesave serioze që ekzistonin për diplomatët shqiptarë në komunikimin me të huajt. Megjithatë, ata kishin gjetur aq kohë sa babai t'i tregonte Ambasadorit shqiptar se "ne si familje do të shkonim, pas disa kohësh, për pushim në Athinë dhe dëshironim, që rrugën ta bënim me makinë përgjatë bregdetit dalmat, nëpër Jugosllavi pra, duke filluar nga Sllovenia, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, të hynim në Shqipëri nga pika kufitare e Hanit të Hotit dhe të dilnim për në Greqi nëpërmjet të pikës kufitare në Kakavijë".

Ambasadori shqiptar nuk premtoi gjë. E megjithatë, nuk vonoi dhe e njoftoi babain që nëse dëshironin të udhëtonin nëpër Shqipëri, Ambasada do t'i pajiste me viza. Dhe kështu ndodhi.

"Të gjithë, babai me mamanë dhe ne fëmijët udhëtuam për në Jug. Kaluam bregdetin dalmat dhe arritëm në pikën kufitare të Hanit të Hotit, midis Malit të Zi dhe Shqipërisë. Në fakt, aty gjithçka ishte ndryshe. Shumë tela me gjemba, bunkerë, policë të vrazhdë. Sapo na u kthyen pasaportat e kontrolluara me imtësinë më të madhe dhe të vulosura dhe u nisëm, vumë re se para nesh printe një motoçikletë policie, që hapte rrugën dhe një makinë policie, që na shoqëronte nga pas. Kishte shumë pak makina. Ato që dukeshin, ishin më së shumti makina bujqësore të vjetra, zetorë, karroca dhe ndonjë xhip me tenda jeshile të markave kineze. Më vonë mësuam se makina jonë ishte ndoshta e para makinë private që hynte në Shqipëri, që prej kohës së Luftës së Dytë Botërore.

"Arritëm në Tiranë dhe u vendosëm në Hotel "Dajti". Ishte një hotel i vjetër, antik, por i mirëmbajtur. Kaluam aty një darkë të këndshme."

"Të nesërmen erdhi një zyrtar i lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe e takoi babain. Autoritetet shqiptare na trajtuan me shumë nderime dhe respekt. Na mbajtën dy net të tjera në një hotel tjetër në qytetin e Durrësit në bregdet dhe nuk pranuan asnjë pagesë. Babai, i cili duhej të kishte marrë porosi nga Athina nëpërmjet Ambasadës Greke në Paris, u takua në atë rast me autoritete shumë të larta shqiptare dhe mori me vete porosi shumë të çmuara për Athinën. Ishin kohërat pas vdekjes së diktatorit shqiptar. Pas këtyre ditëve në Tiranë, ne vazhduam udhëtimin për Athinë. Isha rreth 24 vjeçe dhe shumë kureshtare. Ndonëse babai nuk më tha shumë gjëra, unë e kuptova se ai udhëtim ishte shumë historik, pasi u vu themeli i një gjëje shumë të rëndësishme në

marrëdhëniet midis vendit tim, Greqisë, dhe Shqipërisë. Kjo pasi vetëm pak kohë pas këtij udhëtimi, Shqipërinë e vizitoi për herë të parë një Ministër i Jashtëm Grek. Ishte Carolios Papulias".

Kalipsoja ndihej shumë krenare për faktin, se kishte qenë dëshmitare e një ngjarjeje që i dha kthesë marrëdhënieve me grekët pas dekadash lufte të ftohtë dhe armiqësie të tejzgjatur. Por ajo kishte qenë edhe drejtuese e Programit "The Socrates Kokkalis" mbi Evropën Jugperëndimore, dhe Evropën Lindore e Qendrore në "John F. Kennedy School of Government".

Dr. Stylianos Nicolaidis, mund të jetë arkitekti i restaurimit të marrëdhënieve Greqi - Shqipëri

I nxitur nga kjo bisedë e shkurtër me profesore Kalypsonë, nëpërmjet asaj unë u vura në një korrespondencë me të atin, dr. Stylianos Nicolaidis. Ai u tregua shumë i gatshëm të më rrëfente diçka nga ai udhëtim historik për marrëdhëniet shqiptaro - greke. Prej tij mësova se udhëtimi i tij nuk ishte qenë thjesht për turizëm, as për konferencë mjekësore dhe as i paorganizuar nga qeveria greke. Atë e kishte nisur dhe ndjekur Ambasada Greke në Paris. Ai më shkruante se udhëtimi i tij u mbulua si vizitë e një personaliteti mjekësor, prandaj edhe u organizuan takime me disa mjekë shqiptarë. Por në mesin e tyre ishte edhe një person, i cili nuk kishte lidhje me mjekësinë. Një zyrtar nga shërbimet greke me emrin Rocophilos, i kishte thënë dr. Nicolaidis se personi jo mjek në atë takim, ishte këshilltari numër një i Presidentit të Republikës, Ramiz Alia. Ai kishte bërë shumë pyetje gjatë takimit. Po ashtu, viza e lëshuar nga Ambasada Shqiptare ishte vizë për një "*mision special*" për të pesë personat dhe ishte paguar nga qeveria shqiptare bashkë me tërë shpenzimet e udhëtimit nëpër Shqipëri. Madje ai shpjegoi edhe se ata shëtitën me një makinë Volvo të shtetit shqiptar, e re fringo, të shoqëruar nga një përfaqësues i qeverisë që nga hyrja deri në dalje, ndërsa shoferi, thotë dr. Nicolaidis, ishte një anëtar i vërtetë i Partisë Komuniste, pasi ai dinte çdo gjë që nuk e dinin të tjerët.

Profesore Kalipsoja shton edhe se ata ishin takuar me një mjek shqiptar, i cili ishte njohur me babain në Paris gjatë specializimit të tij në neurologji.

Ishte një djalosh i pashëm, elegant, që shprehej shumë bukur në frëngjisht, me besim në vetvete, me natyrë prej atleti me mbiemrin Petrela. Doktor Petrela i kishte shoqëruar gjatë pjesës së dytë të udhëtimit në Shqipëri, në kohën kur po largoheshin.

Me Profesore Kalipso Nicolaidis, babain e saj Stilioans dhe vëllain Dimitris vazhdoj të kem edhe sot korrespondencë. Në të vërtetë, ai akti i madh i rregullimit të vizitës së Carolios Papulias në Shqipëri mbetet nga ngjarjet e rëndësishme të përmirësimit të fqinjësisë së mirë me grekët. Ai vetë vinte nga fshati Pogon, fshat kufitar dhe kishte pasur si fqinj dhe shok fëmijërie aktorin e Teatrit të Estradës së Fierit, Fuat Boçin, të cilin e takoi në atë kohë. Ai vërtet vuri themelet e marrëdhënieve të reja, disa kohë përpara rënies së komunizmit, por një ndër ngjarjet e asaj kohe, që nuk u publikua ishte edhe kërkesa e tij për të vizituar Kishën e Shën Kozmait në Libofshë. Kjo i vuri autoritetet komuniste në pozitë të keqe pasi ajo ishte kthyer në stallë bagëtish. Komunistët e pastruan, por nuk mundën t'i heqin erën e keqe të plehut, gjë që u bë edhe objekt diskutimesh në mediat greke. Gjithsesi, Papuliasi e vizitoi kishën.

Oxford, 25 maj 2015

"NOTES ON ALBANIA - EDICIONI I TRETË - JAVA E KULTURËS SHQIPTARO – BRITANIKE

Në vijim të ciklit "Notes On Albania", Edicioni i tretë, nuk ishte më një veprimtari e vetme. Ajo u organizua si Javë e Kulturës Shqiptaro – Britanike, që u konceptua si përzierje e arteve dhe letrave të ndryshme. Kësaj radhe do të kishte një seri veprimtarishë, ekspozita të artit figurativ, përurime librash dhe leksione historike.

Vështirësitë e panevojshme dhe një thirrje për "ndihmë" drejtuar nobelistit Rudyard Kipling

Ndërkohë që merresha me promovimin e Shqipërisë me të gjitha mjetet e mundshme, në zbatim të teorisë së Profesor Nye-it, "Soft Power", nga Tirana vinin mesazhe që shkonin tërësisht në drejtim të kundërt.

Çfarëdo që të bëja, dukej se ministrisë as që i interesonte. E vetmja gjë që donin ata ishte të jepja dorëheqjen nga ai vend pune, madje edhe pa kaluar në procedurën ligjore që shoqëron emërimin dhe largimin e një ambasadori. Nga qendra merrja telefonata dhe mesazhe të tilla si kjo:

> *"Kur do na e lëshosh atë vend pune? Kur do të ikësh, se boll ke qëndruar aty? Duhet të ikësh! E çuditshme si nuk e kupton xhanëm!?"…*

Kjo, natyrisht, sado që kishte një ndikim stresues, nuk më ndaloi të organizoja edhe një ndër veprimtaritë më të bukura që shqiptarët, pas vendosjes

së bustit të Skënderbeut, kishin organizuar ndonjëherë në Londër. Për ta zbutur atë stres krejt artificial "thirra" nobelistin anglez, Rudyard Kipling që të më "ndihmonte" me poemën e tij "If" (Në qoftë se).

Ajo vjershë ishte botuar për herë të parë në vitin 1910 për nderim të Leander Starr Jameson - it. Ajo ka formën e një poeme të shkruar si shembull i stoicizmit dhe qëndresës ndaj meskinitetit të periudhës viktoriane.

Kjo poemë është përkthyer në shqip nga disa autorë. Ndër ta Fan Noli, Skënder Luarasi, Robert Schvarc-i, Vedat Kokona, Ukzenel Buçpapaj e të tjerë. Unë e nisa përkthimin e saj si një shtysë, sesi të tejkaloja atë stres, që më mundonte dhe sesi të përgjigjesha me stoicizëm me një veprimtari, që i shërbente më së miri punës së ngarkuar në të mirë të vendit tonë, ndryshe nga çfarë impononte mediokriteti dhe verbëria politike. Prandaj, përpara se t'i futesha sfidës së radhës, e përktheva poemën e Kipling-ut, të cilën po e sjell më poshtë:

NË QOFTË SE!

Mos e humb toruan kur të tjerëve përreth teje iu është tretur!
Dhe veçse të fajësojnë ty asgjë nuk iu ka mbetur…
Nëse i beson vetes kur të gjithë njerëzit tek ty dyshojnë,
Lëri të qetë, hapur dyshimin ndaj teje ta tregojnë!
Nëse pret dot, e nga pritja e gjatë nuk lodhesh,
Ose i rrethuar prej gënjeshtrash atypari ndodhesh,
I urryer po qe, urrejtjen - me urrejtje mos e zëvendëso!
Dhe përsëri as si më i miri, as më i zoti mos u trego!

Nëse ëndërron – bëje, por ëndrra mos të të sundojë!
Nëse mendon – mendo, por mendimi thjesht mos të të mundojë!
Nëse njësoj i duron edhe triumfin edhe dështimin,
Dhe këta, si dy mashtrues ta vënë në provë durimin,
Nëse arrin të dëgjosh të vërtetën që vetë e ke thënë,
Të shpërdredhur prej kopukëve, në kurthin e tyre për të shtënë,
Ose të shohësh gjërat që iu kushtove jetën, në rrënim,
Ndalo dhe hop! Rindërto bash prej mbetjeve në shkatërrim!

Nëse do mund t'i mblidhje tërë fitimet e jetës sate në një!
Dhe të rrezikoje t'i humbësh në një bast: Kokë a Pilë,
Të filloje nga e para, dhe tash pa asgjë, pa shtëpi a vilë,
Të mos e kthesh kokën mbrapa për atë, që nuk vjen më.
Nëse do bëje të të bindeshin trupi, zemra e nervi zemërak,
Edhe për shumë kohë për ato që nuk kthehen më kurrë,
Dhe kështu të mbahesh kur s'ka mbetur më për ty, aspak,
Përveç ofshamës që të ysht pa ndarë: Mbahu, bre burrë!

Nëse flet dot me turmat pa e humbur virtytin,
Ecën përkrah mbretërish, i thjeshtë e njerëzor,
Nëse nuk e sheh të keqen tek armiqtë as tek miqtë që të cytin,
Nëse njerëzia besojnë tek ti, por nuk të shohin si hyjnor,
E nëse mund të mbushësh minutën e mosfaljes, aq e vështirë,
Me gjashtëdhjetë sekonda të gjata që të qetësojnë, si shërim:
E jotja është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, e qetë dhe e dlirë,
Dhe çfarë është më e vlefshmja: Ti do të jesh Burrë - O biri im!

Ishte kjo poezi motoja e punës në ato kohë, ku duhej të tejkaloja çdo pengesë, të mos kthehej koka mbrapa dhe të mbushja minutën me gjashtëdhjetë sekonda qetësie, si shërim ndaj stresit.

HOMAZH PËR EDWARD LEAR-in EKSPOZITË E ARTIT FIGURATIV E PIKTORIT BASHKIM AHMETI – IZANO

"Notes on Albania", Edicioni i tretë, do të hapej me Ekspozitën e artit figurativ "Homazh për Edward Lear", e cila do të ishte një përkushtim i piktorit Bashkim Ahmeti - Izano ndaj piktorit të njohur anglez.

Si lindi ideja e ekspozitës së piktorit Izano në Londër?

Në vjeshtën e vitit 2013, të ftuar nga miqtë tanë, piktori Bashkim Ahmeti - Izano dhe zonja e tij muzikante, Pranvera, shkuam bashkë me Donikën të vizitonim Galerinë e Arteve të Universitetit Yale, në New Haven, në Connecticut. Kaluam urën George Washington dhe morëm drejt veri-lindjes nëpër një rrugë vendore përbri Lumit Hudson. Natyra e kishte zbukuruar pyllin e asaj dite me ngjyra magjepsëse, të cilat mahnitnin çdo njeri, e aq më tepër piktorin me të cilin po udhëtonim. Pas rreth tri orësh udhëtim e pushim, arritëm në Yale. U futëm në Galerinë e Artit dhe, pasi pamë veprat e Robert Field, Peter Paul Rubens, John Trumbull, Vincent Van Gogh si dhe koleksionin Turner, shkuam të shihnim atë për të cilin kishim udhëtuar:

Edward Lear "Zagoria" dhe "Butrinti"

Gjurmët shqiptare të lëna prej artistësh të huaj janë përherë shumë intriguese, interesante, të bukura dhe të rëndësishme për ne shqiptarët. Aq më tepër për një sy të kujdesshëm si i imi. Të tilla ishin edhe dy pikturat, që po i vështronim me

kureshtje, përqendrim, respekt, admirim dhe nderim.

"Zagoria" dhe "Butrinto" janë pikturuar nga Edward Lear-it në vitet 1860 dhe 1861. Të përjetosh ndjesinë, që të japin këto vepra është kënaqësi e veçantë. Por kur je në shoqërinë e një piktori, që është edhe për vete i shquar dhe e dëgjon atë që të shpjegon edhe si pedagog, edhe si historian arti, është një kënaqësi tjetër, edhe më e madhe.

Prandaj dua që atë bisedë me piktorin Izano në Yale ta përshkruaj fjalë për fjalë, në ligjëratë të drejtë, siç e shpjegoi ai vetë:

> *"Ky zotëri anglez e nisi udhëtimin e tij nëpër Shqipëri nga Liqeni i Ohrit. Në rrugëtimin e tij ai ndaloi disa ditë në Gjirokastër. Disa nga akuarelet që ka lënë pas, janë të asaj periudhe. Kam pasë fatin që disa nga ato punë t'i shikoja të printuara dhe të ekspozuara në një muze të vogël të qytetit tim, që kur isha fëmijë. Sa herë i shikoja, magjepsesha prej tyre. Me kohë mësova ta çmoj dhe të lidhem me artin e tij. Edhe sot, punët e tij i gjej të përsosura e të frymëzuara, veçanërisht akuarelet. Lear-i më ka ndihmuar që ta shoh punën time nga një këndvështrim tjetër përmes artit të tij, që më bën të reflektoj për ndjenja të veçanta siç janë identiteti, malli dhe përkatësia. Me të kam të përbashkët dëshirën për të pikturuar të njëjtat modele: Gjirokastrën, Tepelenën, Borshin dhe Luginën e Drinos, të cilat kishin mbetur të pandryshuara deri në ditët e fëmijërisë sime.*
>
> *Pikturat e Edward Lear-it për Shqipërinë i kam ndjekur me interes të veçantë. Këto këtu të quajtura "Zagori" dhe "Butrinto", janë piktura në vaj dhe kanavacë, shumë të veçanta dhe kanë nderin të jenë ekspozuar në koleksionin e Paul Mellon Collection, këtu në Galerinë e Arteve të Univesitetit Yale. Pikturat janë varur në këtë pinakotekë në këtë mënyrë kaq të këndshme ekspozimi.*
>
> *Piktura "Zagori" besoj se paraqet Zagorinë tonë, por të parë në atë kohë nga ana tjetër e kufirit, që ndan sot Shqipërinë me Greqinë. Peizazhi paraqet figurat e tre burrave me guna të bardha, të cilët mbajnë në kokë qylafë dhe janë të veshur me fustanella. Më poshtë lëviz drejt tyre një prift ortodoks. Kjo është pikturë tipike romantike dhe një nga më mjeshtëroret ndër pikturat në vaj të Edward Lear-it, edhe pse dihet që ai shkëlqen më shumë në pikturimin me bojërat e ujit. Pamja piktoreske është e jashtëzakonshme, e paharrueshme, mbresëlënëse. Në sfond gjendet një manastir me mure guri, që tërheq rrezet diellore të fundit të ditës. Përtej honeve të thella duket Mali i Nemërçkës i*

mbuluar me borë, ashtu siç e shohim edhe nga ana shqiptare e kufirit të sotëm që nga Qafa e Selckës, në të majtë të Libohovës. Puna është përmbyllur me shumë kujdes dhe çdo detaj është vendosur me durim dhe me dashuri. Në hartën e Greqisë së sotme, Zagoria gjendet në buzë të kufirit ose, më mirë të themi, në vijim të vetë Zagorisë. Kuptohet që është e njëjta Zagori, pasi nuk ka një të dytë në këtë botë. Sa bukur do të ishte sikur të ishim ngjitur ndonjëherë atje ku u ngjit piktori i madh anglez, Eduard Lear!

Më tej piktori ynë vazhdon të na shpjegojë për pikturën tjetër, "Butrinto".

"Piktura "Butrinto", ashtu si "Zagori", është e mrekullueshme. Ngjyra e kaltërt e Liqenit të Butrintit është mbresëlënëse dhe të kujton pikturat impresioniste. Këtë përshtypje ta jep drita mëngjesore, që ndriçon kodrat me kulla. E kaltra e liqenit të Butrintit është e cilësive të pikturave impresioniste. Kjo përshtypje të krijohet nga drita mëngjesore, që ndriçon kodrat me kulla, liqenin dhe më tutje malet e mbuluara me dëborë. Aty gjen një barí me sharkun e zi dhe me qylaf të bardhë, ndërsa thellë në luginë duken shtëpi e kulla të zhytura në një heshtje e qetësi të ëmbël. E gjithë natyra është e ngopur me dritë. Liqeni është pikturuar me një prekje elegante të penelit me një blu në gurkali, që nuk e kam parë gjetiu. Pos të tjerash, reflektimi i dëborës së maleve mbi liqen dhe nga ana tjetër i liqenit mbi malet me dëborë është diçka që nuk është hasur diku tjetër. Madje as në pikurat e anglezit tjetër shumë të famshëm, Joseph Turner.

Vizita në këtë muze të bën të mallëngjehesh jo vetëm se gjen "Zagorinë" dhe "Butrintin", në Yale, por se vetë pikturat janë të jashtëzakonshme, gjë që rrjedh sa nga peizazhi shqiptar ku ai e merr frymëzimin aq edhe nga teknika dhe ndjenja koloristike e Edward Lear-it, i cili hidhte dritë hyjnore mbi Shqipërinë në veprën e tij dhe jo vetëm në këto piktura, por edhe në shumë të tjera.

Ai shëtiste andej këndej nëpër Shqipëri në shoqërimin e Gjergj Kokalit (në Gjirokastër njihej si Kokalari), që të zbulonte bukuritë e vendit tonë dhe të thithte ajrin e freskët dhe të gjente hijet nëpër tejdukshmërinë e natyrës madhështore, që t'i hidhte pastaj në telajo ngjyrat e mrekullueshme të peizazhit të vendit tonë".

Më pas z. Izano bën edhe një konstatim tepër emocionues:

> *"Shqipëria në veprën e Lear-it ishte sa madhështore aq edhe tronditëse - pafundësisht e bukur, tmerrësisht e lënë në padituri dhe varfëri - fisnikërisht e lartë, armiqësisht e lënë në prapambetje, jashtë-natyrshëm e bukur - shumë pak e pasqyruar në art. E prapëseprapë, ja tek gjenden vepra që të tronditin me vlerën e tyre dhe atë që pasqyrojnë. Një popull në një skaj të botës, i panjohur, marrëzisht fisnik por frikshëm i lënë në padije. Mirëpo, prapëseprapë një botë shqiptare që të bën krenar në mënyrën sesi e dëshmon Edward Lear-i në këtë muze, njëri nga më prestigjiozët në botë".*

Kishim dëgjuar një shpjegim të jashtëzakonshëm rreth atyre veprave të piktorit të madh anglez. Në atë gjendje emocionale, ku ne të tre kishim mbetur gojëhapur, më shkrepi menjëherë në mendje dhe i thashë piktorit:

- Po sikur të kishim hapur një ekspozitë tënden në Londër?

Duket se ideja ime, sado e lindur në një moment emocional, kishte shumë bazë për t'u konsideruar. Kështu filluam ta zhvillojmë idenë, e cila edhe pse aq embrionale, na çoi deri tek emërtimi i asaj ekspozite:

- A mund ta quajmë "Homazh për Edward Lear"?

Ishte homazh për piktorin anglez. Pikërisht ky emërtim i një nisme aq spontane, i frymëzuar përpara dy pikturave të Edward Lear-it në Yale, doli të ishte një ndër projektet e realizuara më bukur në historinë e hapjes së ekspozitave personale, madje edhe të vetë artit figurativ shqiptar në Londër.

Me Jeremy O'Sullivan-in në Misionin Britanik pranë Komisionit Evropian në Londër

Pasi u ktheva në Londër, takova atasheun kulturor të Bashkimit Evropian në Londër, z. Jeremy O'Sullivan. I paraqita atij kërkesën për hapjen e ekspozitës së z. Izano në sallën "12 Star Gallery", e cila gjendej brenda ndërtesës së Misionit Britanik pranë Komisionit Evropian.

Dikur ajo ndërtesë kishte qenë qendra e shtabit të Partisë Konsevatore të drejtuar nga Margaret Thatcher-i dhe gjendet në mes të Londrës, vetëm disa

qindra metra larg nga Parlamenti Britanik. Me vete kisha edhe librat e artit të piktorit Izano që i mora në New Jersey, të printuara me cilësi të lartë dhe plot ngjyra. Po ashtu i shpjegova çfarë ishte:

Simbioza Lear - Izano në Londër

I shpjegova z. O'Sullivan se ishte pikërisht kjo lidhje me Shqipërinë e Lear-it, që e kishte frymëzuar piktorin Izano për të sjellë në Londër ekspozitën, me qëllim që të krijonte një përqasje midis kulturës shqiptare dhe asaj angleze. Për këtë kisha me vete biografitë e të dy piktorëve, Lear dhe Izano:

Edward Lear

Edward Lear (1812 - 1888) ishte artist, ilustrues, muzikant, autor dhe poet anglez. Ai ishte piktor i pasionuar dhe filloi të vizatonte në moshën 16 vjeç. Lear-i u bë artisti kryesor natyror në Britani. Pikturat e Lear janë të rëndësishme, pasi ato pasqyrojnë një pjesë interesante të jetës së Shqipërisë së mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ai përshkruan në detaje arkitekturën, veshjet tradicionale, qindra pelikanët e Zvërnecit, modën e veshjeve të grave në Gjirokastër dhe shumë më tepër.

Në vjeshtën e vitit 1848 udhëtoi për në Shqipëri, kaloi nëpër Manastir më 20 shtator 1848. Prej aty ai kaloi në Ohër, Strugë, Elbasan, Tiranë, Krujë, Lezhë dhe Shkodër, ku arriti më 2 tetor. Pas disa ditësh në Shkodër, ai u kthye në Tiranë dhe Durrës dhe vazhdoi udhëtimin drejt jugut për në Berat (14-18 tetor), Ardenicë, Apolloni, Vlorë, bregdeti i Himarës (21-30 tetor), Tepelenë, Gjirokastër dhe në Janinë (5 nëntor). Rrëfimi i atij udhëtimi u botua në revistën e tij me titull "Një Piktor Peizazhi në Greqi dhe Shqipëri, Londër 1851", i ribotuar si "Edward Lear në Shqipëri", Londër 2008.

Bashkim Ahmeti - Izano

Bashkim Ahmeti - Izano ka lindur në Gjirokastër në vitin 1949. Ai ka studiuar në Liceun Artistik në Tiranë, në klasën e piktorit Guri Madhi. Në vitin 1968 filloi studimet në Institutin e Lartë të Arteve, Dega e Pikturës, dhe mësoi katër vjet në klasën e piktorit Sali Shijaku, ndërsa në vitin e pestë e përgatiti diplomën nën kujdesin e skenografit Shaban Hysa, dhe u diplomua si skenograf në vitin 1972. Pas një periudhe një-vjeçare si asistent pedagog në Institut, emërohet skenograf në Teatrin e Dramës dhe të Estradës "A.Z.Çajupi" në Gjirokastër. Krahas punës në teatër, ai mori pjesë në ekspozita kombëtare të arteve figurative si dhe bën skenografi për Teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë.

Në vitet 1979 - 1981 drejtoi punën e grupit të piktorëve që projektuan dhe zbatuan pjesën paraqitëse të Muzeut "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Krujë. Aty pikturoi edhe afreskun "Kuvendi i Lezhës" si dhe punime të tjera. Në vitin 1984 hap ekspozitën e parë personale.

Në vitet 1988 - 1995 ushtroi detyrën e profesorit të pikturës në Akademinë e Arteve në Tiranë deri sa po atë vit, bashkë me familjen emigroi drejt Amerikës, në shtetin e New Jersey-t. Që aty ai i ekspozoi veprat e tij në shtetin ku banon, pastaj në Pensilvani, si dhe në atdhe dhe në Evropë. Piktori Izano ka marrë çmime dhe tituj nderi, ku spikatin titulli "Mjeshtër i Madh" dhënë nga Presidenti i Republikës dhe "Qytetar Nderi i Gjirokastrës".

Jeremy O'Sullivan i mbajti ato dhe më premtoi se do ta merrte kërkesën time shumë seriozisht, veçse kishte një problem: Radha për të ekspozuar aty ishte shumë e gjatë e mbase duhej të pritej afro dy vjet. Nuk vonoi dhe erdhi përgjigje pozitive. Datat e lira për piktorin shqiptar ishin nga 28 maj deri më 19 qershor 2015.

Pas afro njëzet muajsh që nga dita kur lindi kjo ide, piktori dhe zonja e tij, Pranvera, zbritën në aeroportin e Londrës me një rul, që ngjante me një qilim iranian nga Ifsahani, brenda të cilit ishin të mbështjella pikturat, për lehtësi transporti.

Tani pikturat duheshin shtrirë në korniza. Edhe për këtë ishin marrë masat te studio e arkitektit britanik nga Kosova, z. Përparim Rama, i cili na ofroi të

tëra mjetet e duhura. Pastaj i transportuam ato për në galeri, e cila kishte një infrastrukturë të përsosur ekspozimi, që nga kavot varëse, shinat lëvizëse në tavan, mjetet e fiksimit e deri te një ndriçim i butë, që i bënte veprat edhe më tërheqëse.

"12 Star Gallery" Evrope House - Londër

Veprimtaria e parë e Javës së Kulturës Shqiptaro - Britanike "Notes On Albania" filloi me këtë ekspozitë, e cila u vu nën patronazhin e Kreut të Misionit Përfaqësues Evropian në Britaninë e Madhe, zonjës Jacqueline Minor dhe Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Oborrin e St. James-it.

Ekspozita u hap në "12 Star Gallery". Në mjediset e asaj ndërtese hyjnë çdo ditë shumë persona nga administrata britanike dhe ajo evropiane, si edhe ambasadorët e 28 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Në hapjen e ekspozitës morën pjesë ambasadorë, diplomatë, artistë, lordë, profesorë, britanikë, dashamirës të artit figurativ, bashkatdhetarë me qëndrim në Britaninë e Madhe, studentë shqiptarë në universitetet e Londrës, si dhe Konsullja e Nderit të Shqipërisë në Oksford, znj. Bryony Bethel.

Ekspozitën e deklaroi të hapur znj. Jacqueline Minor, Kreu i Komisionit Evropian në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo vlerësoi jo vetëm punën e artistit të madh shqiptar, Bashkim Ahmeti - Izano, por edhe artin shqiptar si pjesë integrale e artit evropian. Radha e donte të flisja edhe unë. Më pas foli piktori, i cili shpjegoi lidhjet e tij shpirtërore me Edward Lear-in, që në fillimet e tij në kalldrëmet e Gjirokastrës.

Ekspozita qëndroi e hapur deri më 19 qershor 2015.

Atë natë i pranishëm ishte edhe Ambasadori grek Sh.T. Konstantinos Bikas. Ai vlerësoi lart ekspozitën e artistit shqiptar dhe kur po shihte pikturat me fustanellën shqiptare më tha:

> *"Ambasador! Dikur ky kostum ishte i juaji, i arvanitasve, shqiptarëve. Por tani është i yni dhe përbën një ndër simbolet dhe krenaritë e Greqisë".*

Çfarë do t'i thosha unë, kur shihja përpara Parlamentit Grek rojet që

ndërroheshin çdo ditë të veshur me ato kostume aq të bukura shqiptare! E çfarë nuk kanë përvetësuar grekët, i thashë Ambasadorit, por mirë që është një, që e pranon të paktën!?

Të pranishëm ishin shumë anëtarë të Shoqatës Anglo - Shqiptare. Në një moment, kryetari i kësaj shoqate, ish-ambasadori britanik në Tiranë, z. Stephen Nash, iu afrua piktorit Izano. Me vete kishte një pikturë të ambalazhuar. Ai e hapi me kujdes dhe i kërkoi ta nënshkruante. Ishte një pikturë e dhuruar nga Izano, në vitet kur z. Nash-i shërbente në Shqipëri, por e panënshkruar. Ishte edhe ky një moment emocional sesi arti jeton ndër vite, dekada e shekuj, njësoj si ai i Edward Lear-it.

Në ekspozitë morën pjesë gazetarë të enteve të ndryshme londineze. Në një shkrim të Revistës Prestigjoze "Newsweek", gazetari Harry Eires, stërnipi i ambasadorit të parë të Britanisë së Madhe në Shqipëri, Sir Harry Charles Augustos Eires, i cili shërbeu nga viti 1922 deri në vitin 1926, botoi një artikull me titull:

"Newsweek" - Kufiri i brendshëm i Evropës: Shqipëria ka qenë prej kohësh një mister për Perëndimin

"Gjithmonë mendoja se personazhi jashtëzakonisht i lashtë, i ashpër, me flokë të bardha në serialin televiziv të gjatë "The Wombles" ishte quajtur keq: Ai duhej të ishte Shqipëria e Xhaxhait të Madh, jo Bullgaria e Xhaxhait të Madh. Në fund të fundit, Bullgaria është anëtare e BE-së.

Duhet të pranoj që interesi im për Javën e Kulturës Shqiptaro - Britanike në Londër dhe marrëdhëniet anglo - shqiptare në përgjithësi, kanë rrënjë personale dhe familjare: Stërgjyshi im ishte ambasadori i parë britanik në Shqipëri në vitet 1920 dhe mbante lidhje të ngushta me atë vend deri në vdekjen e tij, më 1944.

Ai nuk ishte i vetmi anglez i brezit të tij, pasi edhe të tjerë kanë shfaqur interes për atë vend të bukur, të fortë dhe mjaft romantik; një vend i mbërthyer nga turbullirat misterioze të kohës, hapësirës, kulturës dhe fesë.

Poeti dhe artisti Edward Lear kaloi disa muaj duke vizituar Shqipërinë dhe Maqedoninë në 1848 dhe botoi një ditar të bukur dhe tërheqës të ilustruar të udhëtimit, "Revista të një piktori të peizazhit në Ballkan", më 1851. Lear-i

dhe vepra e tij nderohen në një ekspozitë, në Evrope House me piktura të artistit shqiptar, Bashkim Izano, frymëzuar nga Lear-i.

Një romantizëm i hollë e përshkon punën e të dy piktorëve, por ai i Izano-s është më fantastik dhe surreal. Në fakt, pikturat e mëdha dhe mjaft interesante në vaj të Izano-s duken më të ndikuara nga vargu i pakuptimtë i Lear-it, dhe rrëfimet e aventurave të tij në "Revista", sesa nga peizazhet e tij relativisht konvencionale dhe të imta.

Dervishët me kapele të gjata kërcejnë ose hidhen në ajër. Peizazhet fantazmagorike të kujtojnë pikëpamjen e El Greco-s për Toledon. Folklori përdoret për t'u përmbysur më pas, veçanërisht në pikturën, në të cilën një grup vajzash lirohen nga veshjet e rënda tradicionale.

Lear,-i përmend "disa vajza… shumë të bukura", por skenat më të forta janë me dervishët: Një natë në një stallë "derrkucësh" Lear-i rri zgjuar nga "zërat vrungullues, të zhurmshëm, i ndjekur nga fishkëllima të çuditshme dhe murmuritje". Doli se këto zhurma vinin nga një dervish, që flinte në katin sipër Lear-it…!

Dashuria dhe magjepsja e Lear-it për Shqipërinë shkëlqejnë nëpër pamjet e veprave të tij. Ai e donte peizazhin e mrekullueshëm, florën dhe faunën, dhe duket se ka përjetuar dashuri dhe dëfrim mes njerëzve që takoi: imitimet e tij të një treni dhe anijeje me avull e zvogëlojnë një fisnik të ri turk.

Izano ia kthen komplimentin, duke e portretizuar Lear-in si një lloj dervishi anglez, një hierofant i butë i botëve imagjinare.

I ndikuar nga surrealizmi dhe puna e Chagall-it, homazhi i Izano-s ndaj Lear-it është i lirë nga kufizimet ose maturia e Anglisë Viktoriane. Erotizmi është më i sinqertë dhe nuk ka pse të shprehet në mënyrë të zhdrejtë, përmes pamundësive prekëse të bufave dhe maceve ose të Yonghy-Bonghy-Bo. E nëse Izanoja e ka çliruar seksualitetin e Lear-it, ky i fundit mund të ketë çliruar imagjinatën e Izanos".

Ky shkrim u botua në revistën "Newsweek" më 11 qershor 2015

Erisa Zyko, gazetarja e talentuar e televizionit ABC News nga Brukseli e mbuloi këtë veprimtari me një kronikë, që do të mbetet gjatë në kujtesën e shikuesve.

Newsletter e Shoqatës Anglo - Shqiptare

Adam Yemey, editori i botimit Newsletter të Shoqatës Anglo – Shqiptare, i kushtoi një shkrim të gjerë ekspozitës. Midis tjerash ai tha:

> *"Pikturat e ekspozuara ishin homazhi i piktorit shqiptar për Edward Lear dhe arriti të ndërthurë fantazinë romantike me realizmin. Disa nga kanavacat e tij kishin figura simbolike të pikturuara në kontrast të fortë me tokën mbresëlënëse impresioniste shqiptare dhe peizazhet e qytetit, që formuan sfondet shumëngjyrëshe. Një nga imazhet, që më pëlqeu veçanërisht, ishte një përshkrim gati komik i një artisti, që vrapon drejt greminës me një pikturë nën krah ndërsa qentë lehin në këmbët e tij. Ky imazh që më kujtoi pikturat e Marc Chagall patjetër, që duhet të jetë pasqyrimi që Izano i bën Lear-it të varfër të moshuar, që u përball me situata të tilla. Unë isha me fat, që pata një bisedë të këndshme me z. Izano.*
>
> *E pyeta nëse e njihte autorin Ismail Kadare, edhe ai nga Gjirokastra. I thashë se më pëlqente romani i tij "Prilli i Thyer". Ai tha se e njihte mirë dhe se e kishte pikturuar portretin e Kadaresë disa herë. Do të kisha dashur të kisha parë të paktën një nga ato portrete, por ekspozita kësaj radhe ishte një "Homazh për Lear-in".*

Pas hapjes së ekspozitës, në ditët në vijim, gjetëm kohë të vizitonim shumë galeri arti londineze, si Tate Britain, Albert Hall Museum, National Gallery dhe atë të Portreteve. Pozimi përpara portretit të Lordit Byron në kostum shqiptar, pikturuar nga Thomas Phillips do të mbetet ndër kujtimet më të bukura të atyre ditëve.

Dita e dytë - 30 maj 2015 - në Ambasadën e Republikës së Kosovës - DIPLOMACIA SHTRËNGUESE E NATO - s NË KOSOVË - Prof dr. Enver Bytyçi

Në ditën e dytë të kësaj veprimtarie javore, Ambasada organizoi përurimin e

librit të dr. Enver Bytyçit "Diplomacia Shtrënguese e NATO-s në Kosovë" (Coercive Diplomacy of NATO in Kosovo) në gjuhën angleze. Veprimtaria u zhvillua në selinë e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër. Morën pjesë diplomatët e dy ambasadave, studiues britanikë, lexues, shkrimtarë, dashamirës të historisë, miq të ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës, bashkatdhetarë me banim në Britaninë e Madhe, drejtues shoqatash shqiptare etj. Gjithashtu, në veprimtari ishte i pranishëm edhe anëtari i Parlamentit Britanik z. Mark Prichard. Moderator ishte diplomati Arjon Krasniqi, i cili bëri prezantimin e autorit dhe librit.

Dita e tretë - 31 maj 2015 –"KËNGËT E ATDHEUT" - Libër për nxënësit shqiptarë në Britaninë e Madhe

Në ditën e tretë u organizua ceremonia e dorëzimit të Albumit muzikor "KËNGËT E ATDHEUT" mësuesve dhe nxënësve shqiptarë në Londër. Ky libër muzikor është një dhuratë e muzikantëve Adelina Hoxha dhe Robert Radoja, të përkrahur nga botuesi Flamur Hudhri, kushtuar fëmijëve shqiptarë në Britaninë e Madhe. Rreth njëqind mësues dhe drejtues shkollash shqipe në Londër morën pjesë dhe u pajisën me atë libër, i cili përmban 100 këngët më të zgjedhura atdhetare për mësim në klasat e muzikës në shkollat shqipe në emigracion, deri në nivelin e gjimnazit.

Dita e katërt, 2 qershor 2015 - "AGJENTËT E PERANDORISË" I SIR NOEL MALCOLM PARAQITET NË AMBASADËN SHQIPTARE NË LONDËR

"Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane, ishte shumë e rëndësishme të njihte një shqiptar".

Në ditën e katërt, më 2 qershor 2015 Sir Noel Malcolm, profesor i kolegjit All Souls College, në Oxford, përuroi librin e tij të radhës, "Agjentët e Perandorisë". Ai shtjellon në këtë vepër aftësitë drejtuese të shqiptarëve në

elitën veneciane dhe në atë osmane. Sir Noel Malcolm-i, na tregoi një histori të panjohur të vendit tonë deri më sot. Pas njëzet vjet hulumtimesh në dokumentet më të pluhurosura të arkivave më të mëdha, si ato të Vatikanit, Vienës, Stambollit, Venedikut, Raguzës, Varshavës, Maltës, ai vinte me një histori sa interesante aq edhe intriguese të një familjeje shqiptare në Ulqinin e shekullit XVI, aty ku ndahej kufiri Lindje - Perëndim.

Familja e madhe shqiptare ndahet në dy pjesë me dy bijtë e saj - Brunin dhe Brutin. Njëri i shërben Perandorisë së Venecias, tjetri - asaj Osmane. Dhe vjen një ditë që ata do të ndesheshin midis tyre në krye të ushtrive të dy Perandorive në Betejën e Lepantos. Në atë betejë, ku njëri prej tyre vritet, tjetri mund të ketë qenë 100 metra larg, duke luftuar në anën tjetër të frontit.

Në lidhje me këtë libër, Revista prestigjioze "The Economist" shkruan:

"Libri i Noel Malcolm-it tregon në mënyrë gjeniale ekuilibrin ndryshues të forcave midis Perandorive Veneciane dhe asaj Osmane, ku fuqitë detare ishin në konkurrencë se kush do të zotëronte Mesdheun Lindor dhe se si disa të krishterë jetonin mirë, duke i shërbyer Perandorisë Osmane, ndërsa disa myslimanë depërtonin brenda Perandorisë Veneciane".

Gazeta tjetër "The Telegraph" në dy numra e quan librin:

"Një arritje e mrekullueshme e gërshetimit të historive të fituesve dhe humbësve të shekullit XVI, me ndërmjetësuesit, kalorësit, piratët, priftërinjtë dhe spiunët".

Gazeta "The Guardian" shkruan:

"Kjo vepër e mrekullueshme e Noel Malcolm-it i përdor historitë e ndërthurura të dy familjeve shqiptare Brunit dhe Brutit - si një prizëm, nëpërmjet të cilit të shohim kontaktet dhe konfliktet, që e karakterizonin Mesdheun në fazën e tij të hershme të periudhës moderne. Si diplomatë, spiunë, priftërinj, ushtarë, tregtarë dhe përkthyes, ata janë të lëvizshëm dhe flasin shumë gjuhë. Prej rrënjëve të tyre shqiptare, lidhjeve farefisnore dhe kontakteve të shtrira

gjithandej, ata i tejkalojnë pengesat e fesë dhe kombësisë… Rezultati i kësaj vepre është mahnitës (dhe do të duhet kohë që të tejkalohet për nga rëndësia). E pasur dhe e detajuar; aty gjendet ndërthurja e hollësishme e historisë mesdhetare, që përfshin "tërë shqiptarët, kaq të neglizhuar, që enden brenda historisë së Evropës së shekullit XVI".

Ky libër ka pasur vlerësime shumë pozitive nga media britanike, e cila njihet për natyrën e vet tepër kritike. Një prej gazetarëve më të njohur në Britaninë e Madhe, Harry Eyres, i cili ka lidhje të veçantë me Shqipërinë, pasi stërgjyshi i tij, ka qenë Ambasadori i parë britanik në Shqipëri nga viti 1922-1926, ka shkruar në revistën prestigjioze "Newsweek":

"Shqipëria mbart shumë vlera që prej lashtësisë, por vazhdon të mbetet mister për Perëndimin".

Në lidhje me këtë libër të tij të radhës, vetë Sir Noel Malcolm-i thotë se në shekullin XVI kishte shumë mënyra për të qenë shqiptar:

"Ata luajnë rol të rëndësishëm për fuqitë e mëdha në Perëndim dhe, nga ana tjetër, kanë pozicione kyçe në Perandorinë Osmane. Në librin tim kemi një pjesëtar të familjes, që është kryepeshkop shumë i rëndësishëm i Kishës Katolike, ndërkaq një tjetër punon për Papën si oficer i lartë ushtarak. Ata gjenden në ushtrinë e Mbretit të Spanjës dhe janë kalorësit më të shquar. Në anën tjetër, një kushëri i tyre bëhet një nga pashallarët më të rëndësishëm në Stamboll dhe arrin të bëhet Vezir i Madh. Më në veri, në Moldavi, një tjetër shqiptar luan një rol të jashtëzakonshëm. Është e vështirë ta përgjithësosh rolin e shqiptarëve në atë periudhë, por kur sheh pozicionet e rëndësishme që ata kanë mbajtur në politikë, shoqëri dhe ushtri, vjen në përfundimin se ata gjendeshin kudo. Madje shumë prej shqiptarëve janë kaq të talentuar, sa kapin bash majat e pushtetit. Nuk dihet saktësisht numri i tyre, pasi përkatësia etnike e pashallarëve mbetet ende një çështje e paqartë, por në Perandorinë Osmane ka pasur dyzet vezirë të mëdhenj shqiptarë. Mendoj se periudha, për të cilën bëhet fjalë në librin tim, është periudha më e mirë e shqiptarëve në postet më të larta të qeverisë osmane. Unë ndalem te Sinan Pasha Topojani, që ishte Vezir i Madh, pesë herë. Gjatë

qeverisjes së tij, gjendeshin edhe dy a tre shqiptarë të tjerë në Divan, që ishte Këshilli i Ministrave i asaj kohe. Unë i jam referuar një raporti të një diplomati austriak, që thoshte: "Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane ishte shumë e rëndësishme që të njihte një shqiptar".

Gjatë përurimit në Ambasadë, foli edhe historiani dhe shkrimtari më i madh anglez, Paul Johnson, ende i gjallë sot. Ai shprehu pikëpamjen se Noel Malcolm-i ka paraqitur një histori të jashtëzakonshme të shqiptarëve dhe vijon traditën angleze rreth Shqipërisë, e njohur që nga veprat e Lord Bajronit dhe Edward Lear-it, në perceptimin e britanikëve për shqiptarët. Ai tha, mes të tjerash:

"Shqipëria është një vend shumë i bukur. Është përshkruar në një mënyrë të tillë edhe nga Lordi Bajron. Edward Lear-i e pikturoi mrekullisht dhe shkroi një libër të bukur për Shqipërinë. Shqipëria ka tërhequr syrin e personazheve kryesorë britanikë. Ata e deshën Shqipërinë, shkruan për të dhe e pikturuan. Shqipëria mund të bëhet sërish shumë e rëndësishme. Kjo për shkak të pozicionit të saj gjeografik. Ajo është çelësi i Adriatikut. Është vend shumë i rëndësishëm. Vetë shqiptarët janë njerëz shumë të zgjuar, dinamikë dhe origjinalë. Kanë shumë cilësi, që i favorizojnë. Unë mund të vë bast për Shqipërinë. Ata do të luajnë rol të rëndësishëm në botë".

Ky libër i Sir Noel Malcolm-it zë tashmë një vend nderi jo vetëm në literaturën historike në Shqipëri, por edhe në çdo bibliotekë të botës sot. Gazetat më prestigjioze angleze e kanë sjellë çështjen e neglizhuar shqiptare në vëmendjen e lexuesit elitar britanik dhe më gjerë për disa ditë rresht, duke i dhënë shqiptarëve vend të rëndësishëm në historinë e atyre kohërave të përshkruara nga Noel Malcolm-i. Në vijim të librave për shqiptarët, ai boton edhe librin tjetër kushtuar Ernesto Cozzi-t, prift katolik italian, që i kushtoi jetën albanologjisë.

Dita e Pestë: 4 qershor 2015 - Prezantim në Ambasadën e SHBA-së në Londër, 24 Grosvenor Square, London W1K 6AH

"Notes On Albania" dhe Java e Kulturës Shqiptaro - Britanike u mbyll me një aktivitet, ku për herë të parë në historinë e Shqipërisë, brenda në auditorin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Londër, u valëvit flamuri shqiptar, si dhe një perlë e historisë së Shqipërisë e titulluar:

> *"Jeta e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Herman Bernstein dhe Marrëdhëniet Shqiptaro - Hebraike si model i tolerancës fetare".*

Në atë rast pata nderin dhe privilegjin ta bëja një prezantim në Power Point në prani të një audience shumë të zgjedhur nga vetë Ambasada Amerikane. Kjo veprimtari u zhvillua me nismën e Ambasadorit Shqiptar, nën kujdesin e Ambasadorit Amerikan në Londër, Sh.T. z. Matthew Barzun, në bashkëpunim me Ambasadorin e Shtetit të Izraelit z. Daniel Taub dhe Ambasadoren e Lituanisë, zonjën Asta Skaisgiryte Liauskiene. Si u arrit deri këtu:

Një libër i një ambasadori, shkruar për një ambasador, dhuruar një ambasadori – Ambasadori Amerikan Matthew Barzun

Në dhjetorin e vitit 2014, kur kisha botuar dhe prezantuar librin kushtuar Ambasadorit Amerikan Herman Bernstein, vendosa t'u dërgoja nga dy kopje tre ambasadorëve të tre vendeve mike të akredituara në Londër. I pari ishte Ambasadori Amerikan, z. Matthew Barzun, mik dhe koleg shumë i dashur për mua. Arsyeja ishte e thjeshtë: Po i dhuroja një libër të shkruar një ambasadori, për një ambasador, prej një ambasadori. Librin e shoqërova me një shënim personal dhe e dërgova me postë diplomatike.

Të njëjtën gjë bëra edhe me ambasadorin e Shtetit të Izraelit, SH.T. Z. Daniel Taub. Arsyet ishin të njëjta, por me një dallim. Bernstein-i ishte hebre i deklaruar për identitetin e vet.

Pastaj i dërgova dy kopje edhe Ambasadores së Lituanisë SH.S. Znj. Asta Skaisgiryte Liauskiene, pasi Bernstein ishte hebre i Lituanisë dhe kishte lindur pikërisht atje dhe kishte jetuar deri në moshën 8 vjeç.

Pas disa ditësh mora një letër shumë të bukur nga Ambasadori Amerikan.

SH.T. Z. Barzun. Ai shkruante se ishte shumë i lumtur që kishte marrë një libër të tillë në dorë dhe se, së shpejti, shefja e departamentit të kulturës së ambasadës do të më kontaktonte për të biseduar në lidhje me një propozim, që i kisha bërë në letrën përcjellëse të librit për mundësinë e organizimit të një veprimtarie të përbashkët me ambasadën amerikane. Nuk vonoi shumë dhe dy diplomate amerikane kërkuan takim në zyrën time. Ato erdhën dhe më sollën mesazhin e Ambasadorit, i cili ofronte auditoriumin e Ambasadës Amerikane dhe të gjitha shpenzimet, që kërkonte rasti. Njëra quhej Stefani. Në të vërtetë ai ishte një çast i gëzueshëm, pasi nuk kishte mundësi më të artë për një ambasador sesa të ligjëroja për një temë të tillë, për vendin tonë, historinë e hebrenjve në Shqipëri, para një audience, e cila do të zgjidhej nga të dy ambasadat. Në moment më shkrepi ideja se përfshirja e ambasadave të Izraelit dhe të Lituanisë do ta ndihmonte shumë veprimtarinë. Pas tërë harmonizimeve të nevojshme, kështu u bë.

Në auditoriumin e Ambasadës Amerikane në Londër

Më 4 qershor 2015, auditoriumi i Ambasadës Amerikane në Londër u mbush plot e përplot me dinjitarë, ambasadorë, diplomatë, intelektualë, lordë, parlamentarë, diplomatë të Foreign Office, rabinë, drejtues të bashkësive fetare të shqiptarëve të Londrës, intelektualë të dalluar shqiptaro - britanikë, gazetarë e shumë të tjerë. Ishin 23 ambasadorë, ndër të cilët spikaste SH.S. Jacqueline Minor, Shefe e Zyrës Përfaqësuese të Komisionit Evropian në Mbretërinë e Bashkuar.

Prezantimi zgjati më se një orë e gjysmë dhe në skenë dolëm katër ambasadorë të katër vendeve, që na "bashkonte" më shumë se një njeri, një filozofi, një miqësi dhe përkatësia në familjen e kombeve demokratike të kombeve. Vendosja e Flamurit Shqiptar në skenën e atij auditoriumi ishte vërtet akt jashtëzakonisht solemn dhe i rëndësishëm në dobi të diplomacisë publike të vendit tonë.

Këtu u mbyll edhe edicioni i tretë i "Notes On Albania" me Javën e Artit dhe Kulturës Shqiptaro - Britanike, duke i lënë asaj ambasade një trashëgimi dhe një përvojë, e cila do të ishte mirë të vijohej në vitet më pas nga personeli diplomatik që zëvendëson njëri-tjetrin.

Pas disa ditësh mora një letër nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, Shkëlqësia e Tij, z Matthew Barzun, të cilën nuk do ta lija dot pa e vënë në këtë libër, pasi për çdo ambasador të Shqipërisë, kjo do të përbënte nder dhe kënaqësi të veçantë.

Ai më shkruante:

AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, LONDËR

Londër, 16 qershor 2015

I dashur Ambasador Berisha!
Dua të përfitoj nga ky moment për të shprehur vlerësimin tim të sinqertë mbi jetën dhe trashëgiminë e Herman Bernsteinit!
Ata që e ndoqën veprimtarinë rreth jetës së tij, mësuan rreth një figure të fuqishme dhe frymëzuese që i lidh dy kombet tona. Unë të falënderoj që e solle atë histori deri tek ne!
Faleminderit gjithashtu për DVD – në e filmit "Besa – Premtimi" që më dhurove me atë rast.
Aty shfaqej vërtetë një histori, sa e vërtetë aq edhe prekëse, në një kryqëzim udhësh të jetës midis personazhit (Rexhep) Hoxha dhe familjes Alajdem, si dhe të familjeve të cilat përfituan nga BESA shqiptare, gjatë kohës së Hollokaustit. Kjo përbën edhe sot një frymëzim në këtë kohë kur ende na duhet të luftojmë me intolerancën dhe konfiktin.
Unë jam një besimtar i madh i forcës së historisë si mjet që na kujton të përbashkëtat tona dhe na frymëzon të ndryshojmë.
Vlerësoj jashtëzakonisht shumë përpjekjet tuaja të cilat bënë të mundur zhvillimin e një veprimtarie kaq të bukur.

Sinqerisht
Matthew Barzun
Ambasador
Nënshkruar

Londër, 28 maj – 4 qershor 2015

SHEMBUJ PAQEJE DHE MIRËKUPTIMI NORDIK

Atë mbrëmje të 12 qershorit 2015, lashë çdo gjë, disa ftesa pritjesh, dhe vendosa të shkoja të dëgjoja muzikë në hollin e Ambasadës finlandeze. Një ndër arsyet ishte se Ambasadori i atij vendi, Pekka Huhtaniemi, para disa kohësh kishte marrë një medalje, që për mua ishte më e veçanta dhe vështirë se do të më shkonte ndërmend, se dikush do të dekorohej për një gjë të tillë me motivacionin:

"Ambasadori që ndiqte më shumë veprimtari artistike dhe kulturore, që organizoheshin nga ambasadat në Londër."

Me z. Huhtaniemi na lidhte një miqësi e fortë për disa arsye. Ai ishte mik i Ambasadorit të Republikës së Kosovës, prof. Muhamet Hamitit, ndiqte veprimtaritë e ambasadës sonë dhe çdo shfaqje që organizonim ne, ishte tifoz personal i sopranos së njohur shqiptare, Ermonela Jaho dhe nuk linte rast pa folur për të.

Ambasada finlandeze gjendet në "Rrugën "Kesington", ku ndodhen ambasadat kryesore. Po ta krahasosh me ne, në Tiranë, është si të thuash tek "Rruga Skënderbeg" ose "Rruga e Ambasadave". Vetëm dy dyer më tutje është Ambasada e Federatës Ruse. Në hyrje të rrugës, në krahun e majtë, është ajo e shtetit të Izraelit e kështu me radhë.

Atë natë aty do të jepnin shfaqje tre artistë finlandezë, të organizuar në atë që njihej me emrin "The Backman Trio". Pianisti Mareus Andreus ishte anglez, ndërsa violinistet, Frida Beckman dhe Ruth Beedham, ishin finlandeze.

Ata prej pesë vjetësh ishin bërë një trio e famshme me një pjesë të quajtur "Fantazia", që përbënte repertorin e tyre anglo - finlandez.

Koncerti u luajt pothuajse në një nivel virtuoz. Të tre artistët jo vetëm interpretonin bukur, por edhe flisnin shumë bukur. Por ajo që e bëri këtë koncert më interesant ishte mënyra si ishte organizuar dhe kush e kishte sponsorizuar.

Trioja më së pari luajti pjesë nga Erik Bergman, Trio Opus 2, e cila nuk ishte luajtur, që kur ishte kompozuar, në vitin 1939. Ata kishin vajtur në Finlandë dhe e kishin ekzekutuar atë të shoqëruar nga Orkestra e Muzikës së Dhomës Finlandeze në vitin 2012. Po ashtu edhe nga Jean Sibelius kishin luajtur veprën e tij "Finlandia", e cila njihet si vepra më e bukur, që e ka ngritur aq lart shpirtin atdhetar finlandez.

"Finlandia Opus 26" është një poemë simfonike e kompozuar nga Jean Sibelius. Ajo u kompozua në vitin 1899 dhe kishte si qëllim të protestonte kundër censurës ruse. Kjo është arsyeja pse ajo nuk përmendej për shumë kohë me emrin e saj të vërtetë. Muzika e Sibelius luajti rol shumë të madh në formimin e kombit të tij. "Finlandia" u bë pjesë e Himnit Kombëtar Finlandez dhe krijoi tek ta ndjenjën e një krenarie kombëtare të pashoqe.

Po ndiqja atë koncert, duke u thelluar gjithnjë e më shumë në mrekullinë e muzikës së Sibeliusit dhe në rolin, që ka luajtur ai për kombin e vet. Por edhe më shumë se për atë, mendja më rrinte te një fakt, që ambasadori Pekka na e zbuloi atë natë:

Koncerti premierë ishte organizuar në Helsinki të Finlandës nga Instituti i Kulturës Suedeze në Helsinki me partiturat e zbuluara të Erik Bergman-it, kompozitorit finlandez. Muzika e tij dhe ajo e Jan Sibeliousit kishin për qëllim rritjen e ndjenjës kombëtare finlandeze nga një fqinj i saj - Suedia.

- Uau, - thashë me vete, - a mund të ndodhte kjo në vendin tim, që një vepër që rrit patriotizmin shqiptar në Tiranë, të sponsorizohet nga një fondacion kulturor grek apo serb po në Tiranë, dhe të himnizojë ta zëmë interpretimin e këngës "Për ty, Atdhe" të Pjetër Gacit?

M'u duk kaq e pamundshme kjo, sa është e pamundshme, që unë t'i bie violinës. Në dy anët e kontinentit, krejt në veri dhe krejt në jug, dy gadishuj, ai i Ballkanit dhe ai Skandinav, jepnin shembuj krejt të ndryshëm, të ndryshëm aq sa janë edhe gjeografikisht të tillë.

Kesington, Londër, 12 qershor 2015

DEBAT ME MINISTRIN E JASHTËM GREK NIKOS KOTZIAS NË SEESOX

Në fillim të qershorit të vitit 2015 mora një ftesë nga SEESOX (South East Evropian Studies at Oxford) për të marrë pjesë bashkë me të gjithë ambasadorët e vendeve të Ballkanit, në një takim me Ministrin e Jashtëm të Greqisë z. Nikos Kotzias. Me këtë organizatë Ambasada kishte marrëdhënie të mira, kryesisht për faktin se ai ishte vendosur në një institucion shumë prestigjioz në Kolegjin e Shën Antonit në Oxford.

E vërteta është që, edhe pse SEESOX ishte i vendosur në Oxford, atë e drejtonin akademikë grekë, të cilët, natyrisht nuk i shmangeshin njëanshmërisë. E megjithatë ata ishin mjaft të kujdesshëm, për të mos rënë në sy. Aty bëheshin shumë veprimtari të natyrës akademike dhe ne shqiptarët kishim një farë historie të pranisë aty. Një ndër pjesëmarrësit e veprimtarive të tyre ishte Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, i cili promovonte libra statistikash, me sa kisha dëgjuar, të shoqëruara edhe me ndonjë donacion. Ajo traditë vazhdon edhe sot.

Debat me Ministrin e Jashtëm Grek, Nikos Kotzias

SEESOX ishte, pra, një vend ku ndodhnin shumë gjëra. Një e tillë ndodhi edhe më 15 qershor 2015. Atë ditë në sallën e Shën Andonit do të ligjëronte Ministri i Jashtëm Grek, Nikos Kotzias.

Shkova bashkë me djalin tim, Kreshnikun, i cili kishte ardhur nga Universiteti i Harvardit në Cambridge, Massachusets, ku po studionte dhe ishte shumë i interesuar të shihte sesi do të mbahej një seminar i tillë me një Ministër të Jashtëm të një vendi fqinj me Shqipërinë. U ulëm në radhën e parë përkrah

ambasadorëve të Kosovës, z. Lirim Greiçevci, atij të Bosnjës e Hercegovinës, z. Mustafa Muezinoviç, të Malit të Zi. z. Lubomir Stankoviç, të Serbisë Ognin Prebilevic dhe atij të Maqedonisë.

Pasi u paraqit nga mikpritësi, dr. Othon Anastasakis, Ministri Grek e mori fjalën. Ishte jashtëzakonisht i shëndoshë dhe kjo e bënte të dukej edhe pak fodull. Fliste bukur dhe kishte anglishte të pasur, por me një theks shumë të fortë grek. Që në fillim i thashë djalit tim, Kreshnikut:

"Dëgjo, unë po mbaj shënime, por këtë bëje edhe ti, sepse kam një farë droje që ky këtu sot do të thotë diçka, të cilën unë duhet ta marr shënim në mënyrën më të saktë".

Që të dy morëm shënim fjalë për fjalë çdo gjë që tha ai.

Ministri grek foli për çdo gjë, vetëm për situatën në vendin e vet nuk tha asnjë fjalë, edhe pse gjithë mediat e botës krizën financiare greke e kishin në edicionet e tyre kryesore të lajmeve. E "zgjidhi" Krizën e "Majdanit" në Kiev të Ukrainës, foli për Evropën deri në Baltik, nuk tha asnjë fjalë për krizën financiare greke, që po rrezikonte monedhën evropiane dhe u ndal te rajoni i Ballkanit. Kur erdhi fjala për Shqipërinë, Niko Kotzias ishte shumë kritik dhe tha:

> *"…Këto plane janë të njëjta me - dhe po aq kundërproduktive sa - planet e atyre që ëndërrojnë për një Shqipëri të Madhe dhe prodhojnë harta (të një Shqipërie të Madhe), e cila përfshin pjesë të Greqisë së Veriut dhe ishujve në Detin Jon. Në veçanti, partneri i ri në qeveri partia PDIU-së, e cila është "pasardhëse" e partive naziste nga koha kur rajoni ishte në pushtimin nazist, i dëmtojnë marrëdhëniet tona".*

Ai gjithashtu shprehu shqetësimin mbi, siç tha ai, *"shkeljen e të drejtave të minoritetit grek indogjen në Shqipëri".* Pastaj ai u ndal te "mosrespektimi" i marrëveshjeve ndërkombëtare, siç e cilësoi ai, nga ana e Shqipërisë. Kotzias shtoi se shqiptarët duhet ta vlerësojnë faktin se Greqia vazhdon të jetë burim të ardhurash monetare nga emigrantët shqiptarë, që punojnë në Greqi, dhe se iu është dhënë e drejta e shtetësisë fëmijëve të emigrantëve të lindur në Greqi.

Sikur të mos mjaftonte ky sulm i paprecedent, vetë biseda e tij u zhvillua në

një sfond, ku projektohej një hartë e vjetër e Evropës.

Mora shënim çdo gjë që tha dhe, pasi kishte mbaruar na u dha fjala neve të audiencës. Ngrita dorën dhe e mora fjalën. E pashë të nevojshme se duhej të ndërhyja menjëherë.

E mora mikrofonin i pari. Bëra një hyrje kortezie, me mirësjelljen, që e kërkonte vendi dhe fill më pas i kujtova atij se harta, me të cilën po ilustronte bisedën ishte një hartë gjeopolitike të cilës i mungonte një vend i Ballkanit - Kosova. Pastaj shtova se ishte e papranueshme për inteligjencën e një audience akademike dhe ambasadoriale, që të hiqej Kosova prej hartës ilustruese të prezantimit të tij.

"Ne e dimë, - i thashë, - se Republika Helenike ende nuk e ka njohur Kosovën, megjithatë ju e keni një zyrë ndërlidhjeje atje. Në asnjë rrethanë kjo nuk ju jep të drejtën që ta hiqni nga harta një vend që njihet nga rreth 100 shtete të botës".

Pas kësaj shtova se në Shqipëri nuk ka pasur kurrë dhe as që ka parti naziste. Një parti e tillë dihet se ekziston në Greqi me emrin "Agimi i Artë" dhe, sipas mediave greke, ajo është anëtare e parlamentit grek me 17 anëtarë ekstremistë. Nëse bëhet fjalë për nënkryetarin e parlamentit shqiptar, i cili sapo është zgjedhur dhe që vjen nga një parti legale, ai nuk ka asnjë lidhje me nazizmin. Në Shqipëri nuk ka asnjë parti ekstremiste, as të djathtë, as të majtë. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në Shqipëri garantohet me Kushtetutë dhe Parlamenti Shqiptar, i cili është organ sovran. Ndërkaq, asnjë organizatë ndërkombëtare nuk ka përmendur ndonjëherë praninë e partive ekstremiste në Shqipëri.

Sa i takon trajtimit të pakicës greke në Shqipëri, iu drejtova audiencës:

"Ata gëzojnë tëra të drejtat sipas kartave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Shqiptarët, trajtimin njerëzor të grupeve tjera etnike e kanë në traditën e tyre".

Po ashtu, shtova se Shqipëria është shembulli më unik në Evropë në mënyrën se si i trajtoi hebrenjtë gjatë periudhës së Holokaustit, duke e trefishuar popullsinë e tyre, pa humbur asnjë jetë të tyre, në një kohë kur në tërë Evropën numri i tyre u tkurr për shkak të bashkëpunimit të vendeve të pushtuara me nazistët. Sa iu takon emigrantëve shqiptarë, theksova se është e vërtetë, që ata kanë sjellë të ardhura në Shqipëri, por janë po ata që në 25 vjet kanë kontribuar

për ta ndryshuar dhe ndërtuar Greqinë.

Ministri Kotzias dhe drejtuesit e SEESOX-it u gjendën një pozitë shumë të palakmueshme, sidomos për çështjen e hartës. Ministri bëri sikur kërkoi ndjesë për hartën dhe shtoi se në Universitetin e Peloponezit, ku ai jepte mësim, studentët më të mirë ishin ata shqiptarë. Diskutimet e tjera nuk patën ndonjë rëndësi të madhe.

Sapo dola nga salla, telefonova Shpëtim Idrizin, Kryetar i Partisë së çamëve, i cili pikërisht ato ditë kishte hyrë në Kuvendin e Shqipërisë dhe ishte bërë nënkryetar i tij. Kjo shkaktoi tërheqjen nga koalicioni qeverisës të një partie të vogël të pakicës greke.

U kthyem vonë në Londër dhe u ula të shkruaja me kujdesin më të madh raportin për atë ngjarje në Oxford. Pashë tërë shënimet që kisha marrë. I ripashë disa herë bashkë me Kreshnikun. Prapë, duke ditur gravitetin dhe bujën që do të shkaktonte ai debat me ministrin Kotzias në median shqiptare, u mata shumë para se ta nënshkruaja dhe ta nisja për në ministri. Kur e kisha përfunduar fare, Kreshniku e kontrolloi edhe një herë websit-in e Ministrisë së Punëve të Jashtme Greke dhe pa se u bë publik leksioni i Nikos Kotzias, i cituar fjalë për fjalë siç e kishte thënë në Oxford atë ditë dhe siç e kisha shënuar në bllokun tim diplomatik.

Tanimë edhe më i sigurt për vërtetësinë e raportit, e përktheva fjalën e tij dhe shtova në material edhe linkun e fjalës në website. Aty rreth orëve të para të mëngjesit e nisa materialin për Tiranë.

Të nesërmen e gjithë media shqiptare ishte e mbushur me lajmin sencaional që doli nga Oxfordi.

800-vjetori i Magna Carta-s dhe një kërkim i vetvetes

Përvjetori i tetëqindtë i dokumentit të parë bazë mbi të drejtat e njeriut, i njohur botërisht si *Magna Carta* u festua me shumë veprimtari jubilare në Londrën e vitit 2015. Ishte 800-vjetori dhe, natyrisht, krenaria për një dokument të tillë me 61 artikuj, ku organizohet jeta mbi rregulla dhe ligje, ku bashkëjetesa e njerëzve, përbën një monument për të cilin çdo popull do të krenohej, ishte legjitime. Kuptohet që një gjë e tillë merr edhe më shumë vlerë në Anglinë e

ligjit, të letrave, shkrimeve të hershme, gjuhës, e cila tashmë ka marrë dhenë, dhe natyrisht Anglinë e Shekspirit, i cili do të vinte 400 vjet më vonë në këtë jetë. Në këtë Angli që jo vetëm *Magna Carta* si dokument i tyre autentik, por edhe një variant më i hershëm i *Kuranit* i zbuluar në Universitetin e Birmingam-it, trajtohen si pasuri të rralla, që u takojnë jo vetëm anglezëve, britanikëve, por edhe mbarë njerëzimit.

Origjinali i Magna Carta-s në City of London

Në mbrëmjen e dhënë nga Lord Mayor i City of London Corporation, fillimi i veprimtarisë, së të cilit shënohen pothuajse njëherazi me kohën kur është shkruar *Magna Carta*, në vitin 2015 ishte vendosur një kopje e saj për t'u parë nga mbi 700 të pranishëm nga e gjithë bota. Mund të ketë edhe dokumente të tjera, të lidhura me këtë entitet interesant brenda Londrës së Madhe, por ai që e bën atë autentik është karta e parë e regjistruar, e cila daton në vitin 1067. Një trashëgimi e tillë dokumentare e një populli tregon natyrisht për një ndërgjegje të lartë kombëtare, dhe mbi të gjitha formim të një individualiteti, i cili ka pasur ndikim jo vetëm në territorin ku është lindur, zhvilluar dhe formuar ky komb, por edhe më gjerë. Kjo pastaj ka pasur ndikimin e vet në territore të tjera, madje më të largëtat të globit që nga Zelanda e Re deri në Alaskë. Ruajtja e dokumenteve të tillë historike është pjesë e krenarisë së çdo kombi.

Me Robert Elsie-në dhe Bejtullah Destanin

Në një ditë të bukur korriku të vitit 2015 prita në zyrë dy miq të mirë. Ishin Robert Elsie dhe Bejtullah Destani. I pari është shtetas kanadez, studiues i historisë, letërsisë dhe kulturës shqiptare me plot kuptimin e fjalës. Ai ka botuar në anglisht me dhjetëra libra të përkthyera nga shqipja, ndërkohë që dhjetëra tjerë, të cilat ishin të panjohur i ka botuar në anglisht. I njohur për pasionin e tij për historinë, letërsinë dhe kulturën shqiptare, lista e librave të tij për Shqipërinë, shqiptarët dhe çështjen tonë e kalon numrin 60. Bashkë me të ishte studiuesi nga Prizreni, Bejtullah Destani, emri i të cilit gjendet në çdo botim të këtij autori dhe jo vetëm, përfshirë edhe librat e Sir Noel Malcolm-it.

Roberti e flet gjuhën shqipe me një pastërti të admirueshme. Zëri i tij është i njohur për dëgjuesin shqiptar kudo që të jetë, për shkak të përkthimeve në seancat gjyqësore të zhvilluara kundër Milosheviçit në Hagë. Jeta e tij është pazgjidhshmërisht e lidhur me atë të shqiptarëve dhe mund të thuhet se pak kush në botë, shqiptar ose jo, di aq sa di ai për çështjen tonë.

Teksa po e përcillja, në të dalë nga ndërtesa e Ambasadës, ai u ndal te disa fotografi të atdhetarëve shqiptarë, ndër të cilët atë të Isa Boletinit. Madhështor, epik, heroik, stoik, siç është ai në atë foto, na nxiti në një bisedë rreth fotografisë, Marubit dhe atyre fotove.

Johann Georg von Hahn dhe Josef Székely

Roberti ka zbuluar fotografi të bëra nga diplomati austriak me kombësi gjermane, Johann Georg von Hahn (1811-1869), në udhëtimin e tij nëpër Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni në vjeshtën e vitit 1863. Ai ishte i shoqëruar në atë udhëtim nga fotografi vjenez, Josef Székely. Han-i konsiderohet si "babai" i studimeve shqiptare. Fotografitë janë marrë në Prizren, Shkodër, Ohër, Manastir. Ato kishin mbetur të pashtypura, të paprintuara, për shkak se albanologu i famshëm i asaj kohe nuk mundi të gjejë një financues, që do t'i paguante, ndërsa fotografia në atë kohë kushtonte tej mase shtrenjtë. Kuptohet ishte fillimi i fotografisë dhe metodat ishin fillestare, të bëra në xhama të mbuluar me një blozë, ku mbeteshin shenjat e dritës nga ku dilte fotografia. Robert Elsie i ka zbuluar ato dhe ka sjellë në sytë tanë historinë, që flet me gjuhën e atyre fotografive. Në këtë aspekt Han-i dhe Elsie-ja, të dy kanë vend nderi në altarin e kulturës shqiptare. Por jo vetëm për këtë. Ndërsa po vizitonim fotografitë, Elsie-ja më bëri një pyetje:

> - Kjo këtu është fotoja e dokumentit themelues të shtetit modern shqiptar. Këto janë firmat e nënshkruesve të Shpalljes së Pavarësisë. Ku gjendet ky dokument sot? - më pyeti ai, jo me cinizëm.

Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë vs - vs Magna Carta

Kjo pyetje hapi një bisedë interesante. Ku gjendet dokumenti origjinal i shpalljes

së Pavarësisë së Shqipërisë? Hamendje të shumta e shoqërojnë fatin e këtij dokumenti. Ai u nënshkrua ditën e 28 Nëntorit 1912. Më pas fati i shtetit shqiptar dihet. Pushtimet, njohja e përgjysmuar e territoreve, rënia e qeverisë së Ismail Qemalit, ardhja e Princ Vidit, pushtimi italian, Kongresi i Lushnjës, Revolucioni i Qershorit, Mbretëria Shqiptare, pushtimi fashist italian dhe gjerman, regjimi komunist dhe… demokracia. Po dokumenti themelor ku është?

Robert Elsie-ja është njeriu i interesuar kushtimisht për të. Ai flet me dhimbje për humbjen e saj. Kush ta ketë pasur vallë? Lef Nosi? Ky intelektual nënshkrues i këtij dokumenti, që përfundoi në plumb? Apo mos ishte Margaret Hasluck-u, që e solli atë dokument në Britani? Ajo vdiq shumë shpejt, në vitin 1948, dy vjet pasi i ishte lutur Enver Hoxhës të mos e vriste mikun e saj të zemrës, Lef Nosin. Ta ketë sjellë në Britani? Po ajo ka vdekur që herët? Ku të jetë vallë?

Hamendjet për vendin ku gjendet, ky dokument janë të shumta. Por ku janë ata, që e nënshkruan këtë dokument? Kjo pyetje është edhe më intriguese se ajo se ku është dokumenti?

I përmendëm me emra disa prej nënshkruesve. Emrat e tyre njëherë e njëkohë u fshinë nga dokumenti fillestar. Njëri pas tjetrit ata jo vetëm që u ekzekutuan, por edhe u fshinë nga faqja e historisë. Sajoheshin emra të tjerë njerëzish, që nuk kishin qenë aty, ose mbuloheshin me bojë të zezë ata që konsideroheshin si njerëz kundërshtarë të regjimit. Atdhetarë që kishin dhënë gjithçka, shqiptarë të cilët kishin dhuruar jetën, pasurinë, familjen, zhdukeshin.

Carta, 703 vjet më e vjetër se dokumenti ynë i shpalljes së pavarësisë qëndron e ruajtur si thesar i vlefshëm i një kombi. Ndërsa, Deklarata jonë e Pavarësisë nuk dihet se ku gjendet edhe sot e kësaj dite. Edhe pse mosha e tyre është e ndryshme: Magna Carta 800-vjeçare, Deklarata jonë 103-vjeçare. Mjerim që duhet të mos e përjetojë ndonjë komb. Harresa po aq sa manipulimi, manipulimi po aq sa harresa e bëjnë kombin tonë të jetë në kërkim të vetvetes.

Dhe këtë nuk kanë pse ta bëjnë të huajt, ose tek e fundit nuk mund ta bëjnë vetëm të huajt, sado të na duan ne. Sepse jemi ne që duhet ta duam vetveten, pikësëpari.

Manson House - Londër, 16 qershor 2015

DITA E PAVARËSISË NË AMBASADËN AMERIKANE NË LONDËR

4 korriku është festa e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe pse është një shtet i ri, krahasuar me vende tjera të Evropës dhe të botës, ka arritur që këtë ditë ta përkujtojë më mirë se kushdo tjetër. Realisht është bukur kur popujt festojnë dhe në mënyrë prapavështruese çmojnë të kaluarën, nga ku ka nisur e ardhmja e tyre. Në 4 korrikun e vitit 1776, përfaqësuesit e trembëdhjetë shteteve u bashkuan për të nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë. Themeluesit e këtij shteti të ri ishin të vetëdijshëm për rreziqet dhe vështirësitë, që mbartte një veprim i tillë. Por rëndësia e formimit të një shteti të tillë i tejkalonte interesat individuale të secilit prej tyre. Koha tregoi se ajo që shpallën dhe ndërtuan ata burra të guximshëm, solli në jetë shtetin më të fuqishëm, më demokratik dhe më të zhvilluar në botë.

Festa e 239 - vjetorit në Londër

Të festosh përvjetorin e 239-të të Amerikës me Ambasadorin e saj në Londër, Matthew Barzun, është kënaqësi e veçantë. 4 korriku festohet në të gjitha ambasadat e Shteteve të Bashkuara nëpër botë. Ajo është në kuptimin më të plotë një Festë Amerikane e Popujve. Flamujt, banderolat, ushqimet e veçanta amerikane, ku shquhen burgers, hotdogs, birrat Budweiser, Coca Cola etj, ... janë ato që e bëjnë plotësisht amerikane festën. Bandat muzikore, paradat e marinsave, koncertet dhe lirshmëria protokollare, pa stres për pjesëmarrësit; është edhe kjo një dukuri e veçantë që e bën edhe më speciale këtë festë.

Rezidenca e Ambasadorit Amerikan në Londër: Winfield House

Kjo festë në Londër mbahet në "Winfield House", e cila është një manson, që ka rreth pesë hektarë tokë pranë "Parkut Regent", duke u konsideruar kështu si shtëpia me parkun e gjelbër më të madh në Londër, pas Pallatit Mbretëror Buckingham Palace, ku qëndron Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II. Ajo është një shtëpi e modelit neo-gjeorgjian.

Historia e kësaj shtëpie fillon që në kohën e Mbretëreshës Viktoria. E gjendur afër "Parkut Regent", ajo e përdorte atë vend për zbavitje, gjueti dhe pritje për mbretërorët. Më vonë u bë një ndërtesë me dy krahë, por aty nga viti 1920, ajo thuajse u braktis. Për më keq, në vitin 1936 asaj i ra zjarri. Pas kësaj, shtëpia u ble nga një zonjë e quajtur Barbara Hutton, e cila trashëgoi një pasuri prej 40 milionë dollarësh nga gjyshi i saj Frank Winfield Woolworth. Shtëpia u mbush plot me vepra arti dhe porcelane kineze. Por Barbara Hutton-i nuk qëndroi gjatë aty. Në vitin 1939 ajo u largua për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kohë shtëpia u kthye në bazë të Forcave Ajrore Mbretërore, por në vitin 1944 u bombardua nga gjermanët, duke pësuar shumë dëme dhe vrasjen e një kadeti ushtarak.

Një vit pas luftës Barbara Hutton-i u kthye në shtëpinë e saj. Ajo e gjeti atë të stërkequr. Menjëherë vendosi t'ia dhuronte atë Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si shenjë bujarie dhe mirënjohjeje për vitet e saj të Luftës të kaluara në Amerikë. Ajo i dërgoi një letër Presidentit Truman, i cili e mirëpriti shumë këtë dhuratë. Zonja Hutton i vuri një çmim simbolik: Vetëm një dollar. Kështu shtëpia u kthye në Rezidencë të Ambasadorit Amerikan në Oborrin e Shën Xhejmsit dhe e tillë është që prej 18 janarit 1955. Vit pas viti shtëpia është pasuruar me shumë orendi e vepra arti. Ajo e ka ruajtur strukturën dhe stilin e saj fillestar edhe në kujtim të njeriut që aq bujarisht e fali. Këtë shtëpi e kanë vizituar Mbretëresha Elizabeth II dhe Princesha Diana. Po ashtu, aty kanë qëndruar presidentët amerikanë gjatë vizitave të tyre në Londër. Presidenti Bush, i vjetri, e ka takuar aty Gorbaçovin në vitin 1991 në Samitin e G-8-ës. Atë e vizitonte shpesh Presidenti Reagan. Shumë artistë dhe njerëz të famshëm amerikanë e kanë vizituar atë ndërtesë. Dhe ja, sonte, në festën e 4

korrikut 2015, gjendemi pikërisht në këtë ndërtesë fantastike.

Kjo nuk është hera e parë, që marrim pjesë në këtë pritje. Në festën e vitit 2013 pata nderin që Ambasadori i atëhershëm Luis Susman më dha mundësinë ta vizitoja tërë atë objekt aq të bukur dhe sidomos koleksionet e artit, të cilat gjendeshin aty. Por përherë ka diçka të re dhe të bukur në çdo organizim, madje edhe pjesëmarrësit e festimeve të tilla janë kaq të larmishëm.

Regent's Park, Londër, 4 korrik 2015

HISTORIA E SKËNDERBEUT BRENDA HISTORISË SË PËRGJITHSHME TË TURQVE NGA ANGLEZI RICHARD KNOLLES, 1603

Në një nga pritjet e shumta të mbrëmjeve të trupit diplomatik në Londër pata rastin të zhvilloja një bisedë të ngrohtë me ambasadorin turk Sh.T. Z. Abdurrahman Bilgiç, i sapoemëruar në atë detyrë. Ai ishte burrë i thjeshtë dhe shumë skrupuloz. Si në çdo rast, kur kisha të bëja me diplomatët turq, edhe në atë mbrëmje bisedën e solla te historia jonë dhe lidhjet midis dy vendeve dhe popujve tanë. Në bisedë e sipër i përmenda se kisha dëgjuar që në rezidencën e tij gjendej një libër shumë i vjetër dhe i rrallë, rreth krijimit të Perandorisë Osmane. Ambasadori turk e pohoi këtë fakt, por më tha se, edhe pse ai vet kishte disa muaj që kishte ardhur në Londër, ende nuk ishte ulur që ta shihte atë libër me vëmendje dhe të mësonte përmbajtjen e tij. Ankaraja kërkon që libri të dërgohet në kryeqytet, shtoi ai, por ai tha se e shihte më të rëndësishme, që libri të mbetej aty ku është. Ai më premtoi se një ditë do të më ftonte për një çaj në rezidencën e tij dhe aty do ta shihnim dhe të bisedonim rreth atij libri.

Në rezidencën e Ambasadorit Turk, z. Abdurrahman Bilgiç, në Portland

Ajo ditë nuk vonoi shumë. Unë e mora ftesën prej ambasadorit. Shkova në rezidencën e tij në Portland. Ambasadori i bëri adetet e tij të çajit si në një shtëpi mikpritëse turke. Një garson shumë i sjellshëm na solli ëmbëlsirat, llokumet dhe çajin në takëmet alla-turka të argjendit dhe porcelanit të dekoruara aq bukur

me ornamente orientale.

Ndërsa një punonjës tjetër i rezidencës nuk vonoi dhe erdhi me një kuti të bukur në dorë, e cila ishte e mbështjellë në një kadife të thellë blu mbretërore. Ai e vendosi atë me kujdes në tavolinë sipër një cohe të lëmuar all të kuqe, po prej kadifeje, dhe e la aty, duke u tërhequr mbrapsht, pa na e kthyer shpinën. Nuk ishte vetëm ai libër, që do të më kthente mbrapsht në shekuj me historitë, që përmbante për Perandorinë Osmane, por edhe sjellja e atij memuri më kujtoi vitet e Stambollit kur kisha shërbyer në Konsullatën Shqiptare si edhe kortezinë perandorake të njerëzve të shërbimit, që kisha parë në atë qytet mahnitës. E njëjta gjë shfaqej tanimë edhe nëpër filmat turq, të cilët kanë pushtuar programet televizive të Ballkanit e veçanërisht të Shqipërisë dhe Kosovës.

Ndjeva një si drithërimë pasi m'u duk se një pushtim tjetër po e priste këtë rajon. Këtë herë jo me forcën e shpatës dhe as të zjarrit, por me historitë e atyre sulltanëve, që dikur na kishin djegur mbarë e mbrapsht. Unë pikërisht për këtë gjendesha atë ditë në atë ndërtesë perandorake; për të mësuar për një histori, që e prisja të shkruar për vendin tim.

Ambasadori e hapi me kujdes kutinë dhe nxori prej saj një libër të madh me një kopertinë të dizajnuar shumë bukur. E hapi mbi tavolinë dhe po e vështronte me kureshtje si një relike shumë të rrallë. Vërtet ai libër i tillë ishte. Libri kishte 3500 faqe të shkruara me makinë shkrimi të markës Gutenberg. Shkrimi ishte shtypur në shkronja të vogla, uniforme, mbi një letër aq të hollë sa një cipë qepe. Ai libër ishte shkruar prej një autori të quajtur Richard Knolles.

Pashë me vëmendje mbi atë libër aq sa mund të shohësh në më pak se një orë. Sulltanët turq dhe mbretërit e krishterë të Evropës në një ballafaqim historik të pashoq përballeshin me njëri tjetrin në çdo kapitull të librit. Por ajo që kërkoja unë ishte e fshehur në ato faqe të ngjitura të librit, të cilat ndoshta nuk ishin shfletuar, qysh kur libri kishte dalë nga botimi në vitin 1603. Në dijeninë time, deri në atë kohë, kjo ishte përmendja e dytë e shqiptarëve nga ndonjë autor anglez. Herën e parë këtë e kishte bërë Shekspiri (William Shakespeare) në komedinë "Ëndrra e një Nate Vere" në vitin 1602. Dhe ja tani një tjetër anglez - Richard Knolles. Shfletova sa munda për të ardhur te pjesa që mua vetë më interesonte - periudha e Sulltanëve Mehmeti i Parë, (1413 - 1421), Murati i Dytë, (1421 - 1444), Mehmeti i Dytë (1444 - 1446) Murati i Dytë (1446 - 1451) Mehmeti i Dytë (1451 - 1481).

Historia e Skënderbeut brenda "Historisë së Përgjithshme të Turqisë"

E tërë kjo periudhë përkonte me kohën kur familja e Kastriotëve dhe biri i tyre, më i shquar i kombit shqiptar, Gjergji, ishte në konflikt me këta sulltanë dhe me vetë Perandorinë Osmane. I hodha një sy të shpejtë, për aq kohë sa kisha, por pashë se mikpritësi im nuk kishte ndonjë dëshirë, që unë të thellohesha aq shumë, mbase edhe duke ndjerë se kureshtja mund të çonte në ndonjë teme, e cila nuk do të ishte aq e këndshme për të.

Pasi rashë në emrin e heroit tim, për të cilin në fakt e kisha ndërmarrë atë vizitë, i kalova disa faqe shpejt e shpejt për të arritur në fundin e librit. Aty me shpejtësi pashë treguesin dhe rrëshqita menjëherë tek shkronja "S" dhe kërkova referencat për emrin *Skënderbeg*. Pashë menjëherë se ajo periudhë e sulltanëve të përmendur më lart në periudhat e tyre kishin të bënin me Skënderbeun. Kaq m'u desh që ta falënderoja nga zemra ambasadorin. E dija që në atë rezidencë dhe në ato kushte nuk mund të bëhej asgjë më shumë se aq. E falënderova atë shumë dhe u largova.

Sapo u ktheva në shtëpi, menjëherë unë iu përvesha punës për ta gjetur librin në atë version, që do të arrija të kisha atë pjesë, që do të jepte sa më shumë informacion rreth Heroit tonë Kombëtar. Ky do të vinte nga një burim i besueshëm anglez, i paanshëm, por për habinë time krejtësisht i panjohur nga studiuesit tanë. I vetmi person që dinte diçka për Richard Knolles ishte Sir Noel Malcolm. Ai dinte për autorin, por jo për librin dhe përmbajtjen e tij rreth Skënderbeut.

Po n***ë*** fakt kush ishte ky autor, i cili kishte shkruar një histori kaq interesante në një vëllim kaq të madh sa ç'ishte "Historia e Turqisë", për të cilin po flasim? Çfarë duhej të dinte ai për shqiptarët para se të shkruante këtë vepër?

Shqiptarët në letrat angleze para vitit 1603

Ndoshta një ndër rastet e para kur janë përmendur shqiptarët në literaturën historike angleze daton në 7 qershor 1520. Kontesti i përmendjes është shumë

interesant, po të kemi parasysh se dy mbretër, Henry VIII i Anglisë dhe Mbreti i Francës, në një takim në Calais janë veshur me rroba të modës shqiptare:

> *"…Mbasi ndenjën aty një orë, mbretërit zbritën, ndërsa princeshat e dy vendeve treguan respektin ndaj tyre, të cilët ishin veshur në një modë shqiptare e cila u pëlqye shumë. Mbretërit ndenjën aty deri sa perëndoi dielli pastaj ua hipën kuajve, u përqafuan, në fakt mezi u ndanë me njëri-tjetrin"…*
> *"Në të rënë të mbrëmjes, Mbreti i Anglisë u largua dhe u takuan në mesditën e së nesërmes. Me vete kishin 30 vetë, të maskuar dhe të veshur si një kalorësi greke dhe shqiptare, me rroba të qëndisura me flori e me kadife".*
> *"Dje ata bënë një turne, duke luftuar sipas modës shqiptare, në fillim me heshta dhe pastaj me shpata."*

Autori i parë anglez i cili e përmend Ilirinë, mbetet padyshim Shekspiri në komedinë e tij *''Nata e Dymbëdhjetë"*. Kjo vepër mendohet se është shkruar në vitin 1602, pra, vetëm një vit para veprës së Richard Knolles. Ngjarja zhvillohet në brigjet e Ilirisë dhe kjo përbën ndoshta rastin e parë, kur përmenden ndodhi ilire nga gjeniu më i madh i letrave në historinë e njerëzimit.

Lidhur me këtë vepër dy autorë kanë shkruar një libër analitik rreth veprës së Shekspirit, me titull "Udhëtim në Iliri". Në kreun XXIX të tij libri analizon pikërisht veprën në fjalë.

Dhe fill pas Shekspirit, vjen anglezi tjetër, Richard Knolles, i cili botoi librin shumë të vëllimshëm "Historinë e Turqisë", për të cilin po flasim.

Richard Knolles

Richard Knolles (1545 - 1610) ka qenë historian anglez i famshëm për shkrimet e tij mbi Perandorinë Osmane, i cili ka bërë përshkrimin e parë më të plotë rreth saj në gjuhën angleze. Ai ka lindur në një qytet anglez, të quajtur Northamptonshire. Studimet i kreu në Kolegjin Linkoln në Oxford. Aty nga viti 1565 u diplomua dhe, më vonë, në vitin 1570, mori gradën shkencore. Në vitin 1603 ai botoi *Historinë e Përgjithshme të Turqve*, e cila u shoqërua nga shumë

ribotime të tjera. Kjo histori ishte e para kronikë e aspekteve politike dhe ushtarake të Perandorisë Osmane e shkruar në anglisht. Historitë e mëparshme kanë qenë shkruar vetëm në gjuhën latine dhe po në atë gjuhë shpërndaheshin. Knolles-i ka shkruar edhe *Historinë e Betejës së Lepantos*, si dhe ka botuar një përkthim të librit *Gjashtë Librat e Republikës* të autorit francez Jean Bodin. Në përkthimin e tij ai është bazuar edhe në variantin frëng edhe në atë latin të tekstit të Bodinit. Knolles-i punoi gjithashtu në një përkthim të pabotuar të origjinalit të veprës *Britania e Kamdenit* në latinisht. Edhe pse e pabotuar, vepra e tretë e Knolles-it u ruajt në *Bibliotekën Bodleian* në Universitetin e Oxford-it. Vepra e tij ka merita të veçanta për stilin dhe kompozicionin që mbart.

Dr. Samuel Johnson, shkrimtar i shquar anglez me një ndihmesë të vyer në kulturën angleze si poet, eseist, moralist, kritik, biograf dhe leksikograf e quan Richard Knolles-in si historianin më të mirë anglez, duke thënë:

> *"Me rrëfimin që ofron, në historinë e tij të turqve, Knolles-i ka shfaqur tërë shkëlqimin e tij të mundshëm".*

Richard Knolles-i vdiq në Sandviç, në vitin 1610.

Përmbajtja e shkurtër e "Historisë së përgjithshme të turqve"

Vëllimi i këtij libri prej 3500 faqesh përmban një kurs epik ngjarjesh të familjes otomane përpara themelimit të Perandorisë Otomane deri te fundi i karrierës së Sulltan Mehmetit të Tretë (1603). Në veçanti libri përqendrohet te paraardhësit e familjes otomane dhe krahas me këtë, mbretërit dhe princat e krishterë të Evropës. Ai ia kushton librin Madhërisë së Tij, Princit Xhemjs të Anglisë, Skocisë, Francës dhe Irlandës, mbrojtës i fesë së krishterë.

Libri jep një pasqyrë shumë interesante sesi dinastia turke u ngrit në Persi prej Tangrolipix-ëve, paraprijësit e familjes Selxhuke, me arritjet e tyre. Pastaj libri vazhdon me historinë e shkatërrimit të Perandorisë së Parë Turke në Persi dhe me suksesin e Mbretërisë së tyre të Dytë në Azinë e Vogël, nën mbretërit Aladin. Më pas libri flet për Perandorinë e Parë të familjes Otomane për të ardhur te Sulltani Orhan, i treti i familjes Otomane dhe princërit e tjerë të

Evropës. Më pas ai vjen te Murati I, pastaj tek Bajaziti I, Mehmeti I, Murati II, Mehmeti II, Bajaziti II, Selimi I, e kështu me radhë të gjithë sulltanët turq dhe mbretërit evropianë bashkëkohës të tyre deri në vitin 1603.

Pjesa më e rëndësishme për ne shqiptarët në këtë libër kaq informativ është ajo e cila kap periudhën e sundimit të Sulltan Mehmetit I, Muratit II, Fatih Mehmet Sulltanit, kohë e cila përkon me periudhën e konfliktit otoman kundër Shqipërisë dhe historinë e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Historia e Skënderbeut është shkruar nga dhjetëra autorë nga vende të ndryshme të botës dhe në gjuhë të ndryshme. Ata janë mbështetur në shumë dëshmi të ndryshme. Por libri në fjalë ka disa merita të veçanta:

E para, ky është libri i parë historik në gjuhën angleze për Perandorinë Otomane, përkatësisht edhe për atë pjesë historike, që është e lidhur me vendin tonë. Së dyti, ajo pjesë e historisë, që lidhet me vendin tonë është e "fshehur" brenda atyre mijëra faqeve të librit të Richard Knolles-it.

Mendoj se përkthimi i 280 faqeve libër të Richard Knolles-it rreth origjinës së familjes Otomane ka një rëndësi të jashtëzakonshme për vetë faktet historike që ai ka dhënë për historinë e Skënderbeut.

TAKIM RASTËSOR ME SKULPTORIN E MARGARET THATCHER-IT IVAN SAXTON

Një shëtitje mëngjesi buzë lumit Tamiz

Mëngjes londinez. Është data 9 tetor 2015. Eci buzë Lumit Tamiz, duke mos u ngopur me bukuritë e pafundme, që syri i njeriut rrok këtu. Është ditë e mrekullueshme.

Tamiz-i është lumi më i gjatë në Mbretërinë e Bashkuar, i cili përshkon tërë Anglinë. Ai rrjedh në një vijë prej 346 kilometrave, duke kaluar mespërmes Londrës, dhe lag zona të gjera si ajo e Oxford-it, Henry on Tames, Winsdor-it për t'u derdhur në Detin e Veriut. Një ndër karakteristikat e veçanta të lumit është se ai pëson baticë dhe zbaticë prej shtatë metrash, është tërësisht i lundrueshëm dhe ndërpritet nga 45 prita, të quajtura locks, të cilat hapen dhe mbyllen për anijet duke lëvizur nivelin e ujit për t'i kaluar ato nga një pjesë e lumit në pjesën tjetër. Gjatë lumit shfaqen 80 ishuj të vegjël. Në të dy anët e lumit zhvillohet një florë dhe faunë e jashtëzakonshme, por ka edhe zona kënetore. Tamiz-i është lumi me më shumë çmime në botë për ruajtjen e mjedisit. Janë dhënë rreth 350.000 të tilla.

Në dy anët e lumit, këtë mëngjes, si çdo ditë tjetër, shoh gjëra shumë të bukura. Këtu, ngado të hedhësh vështrimin të shfaqet diçka që të bën përshtypje. Ja, këtu, në anën perëndimore të lumit gjendet Parlamenti Britanik, që mbart tërë atë histori. Pranë i rri, si dëshmitare e kohës që prej 9 majit 1859, ajo që shënon çdo minutë të jetës së tij: Ora e madhe Big Ben. Embarkment-i është i mbushur me aq shumë vepra monumentale, historike, arkitektonike, artistike, skulpturore... Vështrimi i njeriut shkon larg dhe tretet tek *London Bridge* dhe Katedralja e Shën Palit. Më tej shfaqet rajoni financiar, i tëri në xham. Aty

gjendet Teatri Globus i Shekspirit, në të cilin edhe sot pas 400 vjetësh teatrot luhen po njësoj, me teknikën dhe dekorin e vjetër shekspirian. Aty "Henry VI" u luajt për herë të parë nga trupa e Teatrit Kombëtar Shqiptar, më 12 maj 2012.

Statuja e heroinës së SOE-s

Sa herë kaloj në këtë anë të lumit në rrugën që të çon nga Ura Lambeth për tek London Eye (Syri i Londrës) ndalem përpara një shtatoreje. Ajo është përmendorja e një gruaje me një vështrim tejet të mprehtë, portret shumë i bukur, me forma shumë të rregullta që sheh larg. Në të nuk gjen asnjë shformim të shprehur si dukuri e artit modern dhe ruan përmasat dhe raportet natyrale të një skulpture klasike, e skalitur mbi bazën e parimeve të estetikës së realizmit. Në të nuk ka as glorifikim dhe shtesa tiparesh që ta bëjnë atë super-njeri, super-heroinë, super-grua, super... Në të gjen gjithë ato që skulptori i famshëm francez August Roden do t'u mësonte studentëve të tij në lidhje me raportet formë - përmbajtje të një vepre skulpturore. E pse jo edhe Odhise Paskali ynë.

Jam ndalur shumë herë para kësaj shtatoreje. Madje e kam fotografuar sa herë që kam kaluar pranë saj. Në një rast foton e saj e kam përdorur në librin "Realitetet Shqiptaro - Britanike" si ilustrim në atë pjesë ku bëhet fjalë për grupin britanik të njohur me emrin "Special Operations Executive" ose Ushtria e Fshehtë e Çurçillit, që dëshmon veprimet dhe veprimtarët më të guximshëm që Lufta e Dytë Botërore ka njohur.

Çfarë janë "Special Operatives Executives"

Ky portret u është kushtuar pikërisht atyre njerëzve të guximshëm, që arritën të hyjnë në prapavijat e armikut nazist nëpër Evropë, në Francë, Poloni, Çeki, Greqi si edhe në Shqipërinë tonë. Janë ata që i nxorën trenat nazistë nga shinat kur po transportonin ngarkesat e pafund me armë; janë ata që sabotuan fabrikat e prodhimit të armëve, që nxitën rezistencën në prapavijat armike. Këtë bënë edhe në Shqipëri. Ata kanë lënë martirë në të gjithë Evropën. Edhe në Shqipëri kanë lënë 53 martirë, që dhanë jetën në truallin tonë dhe që eshtrat e tyre nuk

i lejuan komunistët të mblidheshin dhe të preheshin në vendin e tyre. Ishin ata që organizuan dhe furnizuan luftën antifashiste shqiptare, ata që ndihmuan në shpëtimin e grupit amerikan të infermierëve, që ranë në Shqipëri në një aksident ajror në nëntorin e vitit 1943.

Kjo histori u mbajt e fshehur deri sa atë e rrëfeu Agnes Jansen Mageritch, në vitin 1985, fill pas vdekjes së Enver Hoxhës. Janë ata heronj të SOE-s, që, në fund të fundit, e shpëtuan botën nga "Uji i Rëndë", të cilin Hitleri ishte thuajse në prag të shpikjes, me të cilin do të prodhonte bombën atomike shfarosëse, e cila do t'i jepte kësaj bote, që kemi sot një trajtë krejt tjetër të paimagjinueshme.

Në tetor të vitit 1942, operativët e SOE-s vendosën sipër rajonit të Pllajës së Hardangerit katër shtetas norvegjezë, si ekip pararojë. Por ky mision, si dhe dy tre të tjerë dështuan dhe nuk ia arritën qëllimit. Zbatuesit e atij plani ranë në duart e Gestapos dhe u ekzekutuan. Në shkurt të vitit 1943 një ekip komandosh norvegjezë të stërvitur prej SOE-s, arritën ta shkatërronin vendin e prodhimit me një përpjekje të dytë. Operacioni i quajtur Gunnerside u konsiderua më vonë si akti më i suksesshëm i sabotazhit i kryer nga SOE në tërë historinë e Luftës së Dytë Botërore.

Këto veprime u pasuan nga bombardimet e aleatëve. Gjermanët e lanë në mes këtë operacion dhe kështu ata i lëvizën mbetjet e Ujit të Rëndë në Gjermani. Rezistenca norvegjeze fundosi në ujë një traget të quajtur SF Hydro në Liqenin Tinn dhe kështu arritën ta pengojnë dërgimin e Ujit të Rëndë atje ku dëshironin gjermanët.

Në lidhje me historinë e operativëve të SOE-s, që ranë në Shqipëri, Roderick Bailey ka shkruar librin "Provinca e Egër", të cilën e patëm përuruar në mjediset e ambasadës shqiptare në Londër.

Ndalem me respekt përpara kësaj shtatoreje sa herë kaloj këtu, pasi ajo përfaqëson ata që e shpëtuan botën nga katastrofa. Dhe të mendosh që mes tyre kishte edhe gra. Ndër to, në Shqipëri vepruan edhe Anthony Quire, aktori i madh që luajti veprat e Shekspirit, përfshirë Hamletin, si dhe aktivistja Margaret Husluck.

Ivan Saxton

Në këtë ditë shoh një njeri, që ka me vete një kovë me ujë, një fshesë, një enë

me detergjent, një peshqir dhe një palë doreza plastike. Ai është duke pastruar.

Ndërsa po afrohesha thashë me vete që si shpeshherë do të bëj atë veprimin e njeriut të çuditshëm, që futet në bisedë edhe me njerëz që nuk i njeh dhe që nuk ka asnjë lidhje me ta. Kam provuar të flas me njerëz, që i kam parë në rrugë, ose në lokal. Kam takuar dhe jam bërë mik me Simon Schaumën, rrëfimtarin më të famshëm të BBC-së, thjesht se i fola në lokal; jam miqësuar me Julia Kruger-in, pianiste e famshme amerikane, vetëm se kam qëlluar të udhëtoj pranë saj në një avion dhe të bisedoj për muzikën dhe historinë e vendit tim.

E pashë atë njeri me kovë, atë "pastrues" dhe menjëherë gjëja e parë, që më vajti ndërmend ishte:

"Epo ky duhet të jetë si ai personazhi i Shekspirit te Hamleti, që rrëmih varre, por thotë gjëra filozofike si ato që "krimbi është mbreti i botës". Prandaj guxova t'i flas.

Po sikur t'i dukem anormal, që nuk ndjek rrugën time, por ndaloj t'i flas atij njeriu në punën e vet, çfarë do të thoshe? Bëre gabim që i fole?!

Kur iu afrova bustit, i qesha dhe i dhashë një përshëndetje të shqiptuar shumë mirë, atij burri me pamje intelektuale, me rroba të mira, por jo të "ndritshme".

- Mirëmëngjes, zotëri! - i thashë.

- Mirëmëngjes! - m'u kthye ai.

Ishte një burrë që u afrohej të gjashtëdhjetave, shumë elegant, pa asnjë kilogram tepër në trup, me flokët të dendura bashkë, plot, të zbardhura, pa asnjë fije mangut, me sy blu të gjallë dhe nënqeshje të këndshme. Iu prezantova. I thashë se ky monument ka shumë kuptim për mua dhe e pyeta me shumë kujdes, se cila ishte arsyeja që ai po e fshinte me aq kujdes, sa që kishte shkaktuar jo pak habi tek unë, se si një njeri me atë pamje aq aristokrate merrej me pastrimin e një shtatoreje në mes të qytetit, në sytë e aq shumë kalimtarëve të rastit.

Edhe ai m'u prezantua pa hezitim.

- Unë quhem Ivan Saxton. Kjo është vepra ime. Kjo është krijesa ime. Më duket sikur ka nevojë herë pas here për mua. E adhuroj këtë vepër. E adhuroj.

Si i papërtueshëm që jam për të hyrë në biseda të tilla, i thashë se sa shumë e çmoja këtë vepër arti dhe aq më shumë edhe atë çfarë përfaqësonte ajo. Kështu u përfshimë në një bisedë, e cila u soll te britanikët, që ranë martirë nëpër

Evropë, duke sabotuar nazistët.

"Special Operations Executive" ka historinë e vet edhe në Shqipëri. Folëm për Roderick Bailey-n e librin e tij "Provinca e Egër" kushtuar Shqipërisë dhe për përmendoren e tyre në Tiranë.

Ivani më tregoi se si ai e kishte bërë këtë vepër, duke pasur si model pikërisht një anëtare të SOE-s, e cila kishte jetuar në atë zonë të Londrës, ku gjendet busti.

- Ajo heroinë më ka frymëzuar për këtë vepër dhe po ajo më ka pozuar", - më tha Ivani. - Në fakt pashë në tiparet e saj aq shumë elemente të një përfaqësueseje të kësaj organizate. U mundova t'i shprehja të gjitha në një portret. Por eh, sa vështirë të gjeja një vend për ta vendosur këtë bust?! - më tha ai.

- Çfarë? - i thashë. - Ju keni pasur vështirësi për ta vënë këtë bust këtu në Londër?

- Po, - më tha. - Madje kam dështuar pesë herë. Pesë herë, në pesë vende të ndryshme të Londrës. U përpoqa të merrja një leje nga Westminster Council. Pesë herë aplikova në pesë vende të ndryshme. Ishte e pamundshme! Nuk u dorëzova. Pesë herë. Herën e gjashtë, kur po shëtisja këtu buzë lumit dhe po mendoja thuajse i dëshpëruar se ku mund ta vendosja, pashë këtë rrip toke të gjelbër këtu midis rrugës këmbësore dhe rrugës së makinave. Ishte një copë vend fare i vogël, i shkurtër, paralel me këto të dyja, por i mjaftueshëm për bustin tim. Shkova për të gjashtën herë në Westminster Council dhe shkurt ia dola. Ja ku është!

- Po si e bëtë për pagesën? - iu ktheva.

- Ah, unë këtë e kam bërë me pasionin e artistit, jo për para. Ngritëm një fondacion dhe mblodhëm fonde. Bashkia nuk na kërkoi për mirëmbajtjen prandaj e mirëmbaj vetë. Edhe për skulpturën nuk jam paguar. Tani kemi një bord të besuarish, që kujdesemi për të. Kjo na siguron atë që kemi nevojë. Unë... hahaha, ja, kam kovën dhe fshesën tani… Por, në nëntor të çdo viti mbledhim shumë njerëz këtu. Do të dëshironim të na vinit edhe ju e të na flisnit për martirët tanë të rënë në Shqipëri. Ne kemi nderim të madh për ata njerëz, që e shpëtuan njerëzimin nga një katastrofë e tmerrshme. Tani kemi një betejë tjetër: Duam të vendosim monumentin e Margaret Thatcher në sheshin para parlamentit Britanik. Bëmë një përpjekje, por Osborne kishte premtuar në Indi, që të vihej monumenti i Matbah Ghandit po në atë vend.

Ai u vu. Veprën e kam gati. Shtatorja e Thatcher-it është gati. Ajo pret për një vend, që meriton Margaret Thatcher. Nuk është e lehtë. Veç kësaj, vajza e Thatcher-it pretendon se shtatorja e kryeministres duhet të ketë edhe një element, i cili, tani për tani, i mungon - çanta, pa të cilën ajo nuk ka dalë asnjëherë në publik.

Mua m'u kujtua tërë odiseja jonë me Westminster Council dhe qeverinë shqiptare për ta vendosur bustin e Skënderbeut në Londër. Leja, planimetria, pagesat…

- Edhe ne kemi një bust që e kemi vendosur këtu në Londër. Është i Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeu, mbrojtësi i qytetërimit perëndimor. Ai gjendet në Bayswater. I tregova për odisenë e vendosjes së atij busti.

- E di ku është, - më tha. - Ai është regjistruar në London Google, në pikat e orientimit dhe turizmit për qytetin. Jam habitur kur kam parë, që shqiptarët kanë një vepër të tillë këtu, pasi i di vështirësitë e vendosjes së një vepre arti në këtë qytet. Ky është një qytet i veprave të artit të çdo lloji. Por skulptura është më popullorja. Ajo nuk ka nevojë të futet në muzeum. Ajo e bën muzeum vetë qytetin.

Me Ivan Saxton-in bëmë një foto. Një vajzë atlete, që vraponte na fotografoi. Ajo as e dinte se ne ishim dy "miq", që sapo ishim takuar.

Ivan Sakson-i më ftoi të mbaja një fjalim para pasardhësve të SOE-s më 8 nëntor të atij viti. Por mua më ishte sosur mandati në Londër. Me datën 1 nëntor unë do të isha në Shqipëri. Por edhe pse nuk mora pjesë në atë ceremoni në Londër, këtë gjë e bëra në varrezat e britanikëve në Tiranë, me ftesën e ambasadorit britanik Nicholas Canonne.

Në këtë botë ka shumë lidhje. Ka lidhje farefisi, lidhje miqësore, lidhje idealesh. Ka edhe lidhje interesash. Por ka lidhje njerëzore, që historia i sjell në mënyrën e vet spontane, por mjaft kuptimplote. Mjafton që të mos e humbasësh rastin. Prandaj, Guxo!

Nuk ka nevojë të guxosh aq sa guxuan ata të SOE-s!

Embarkment, Tames River, 9 tetor 2015

PRITJET DIPLOMATIKE NË LONDËR

Pritjet e trupit diplomatik në Londër janë nga ngjarjet më të bukura në këtë qytet. Rregulli, organizimi i gjërave shumë kohë më përpara, moslënia asgjë spontanitetit, veshja, ndriçimi, pritja prej garsonëve te dyert e hoteleve, gardëroba, e më pas prezantimi me zë të lartë prej tellallëve, referencat, e deri te përcjellja, janë vërtet diçka, që e bën njeriun të ndjehet i rëndësishëm. Të gjithë njerëzit në mjedise të tilla angleze ndjehen njësoj; të respektuar e madje të përkëdhelur në një farë mënyre. Pritjet në Backingam Palace dhe Manson House shënojnë kulmin e kësaj bukurie, që mikpritja dhe kujdesi njerëzor ka krijuar.

Pritja në kopshtin e Mbretëreshës Buckingam Palace, Londër

Pritjet në kopshtin e Pallatit Mbretëror Backingam janë ndër ngjarjet më të bukura, që një diplomat mund të përjetojë në atë vend. Mbretëresha organizon katër pritje të tilla gjatë stinës së të verës. Në të marrin pjesë çdoherë rreth katër mijë e pesëqind vetë. Në njërën nga këto pritje ftohen shefat e misioneve diplomatike. Sipas vjetërsisë në detyrë, ata ftohen pranë çadrës mbretërore në disa nivele. Kjo përcaktohet nga koha kur ambasadori ose komisionari i lartë e ka filluar atë detyrë si përfaqësues i vendit të vet.

Mbretëresha vjen dhe futet në mes të turmës prej mijëra vetësh. Masa e njerëzve, edhe pse e dëshiruar për ta takuar mbretëreshën, ruan distancën dhe etiketën. Njerëzia janë të veshur bukur, të gjithë me kodin e veshjes që kërkon ai vend dhe ai moment. Gratë mbajnë kapele, ndërsa burrat vishen me frak dhe përgjithësisht duhet të kenë me vete çadra të gjata, të cilat iu japin pamjen e *englishman*, por edhe pse ndodh që shiu i Londrës të bjerë krejt papritur, madje

edhe nga një re e vogël kalimtare. Mbretëresha mendohej se kishte takuar nëntë milionë njerëz në kohën kur unë gjendesha në atë pritje, që po e përshkruaj më vonë. Madhëria e Saj, e shoqëruar nga i shoqi, Filipi, Duka i Edinburgut, Princi i kurorës Charles me të shoqen Camilla, i biri Williams me të shoqen, Kate Middleton Dukesha e Cambridge-it. Ata e ndiqnin Mbretëreshën në tërë atë "korridor" të formuar nga njerëzit, deri sa arrinin te çadra e diplomatëve.

Manson House - Londër

Pallati i Manson House është më së pari një ndër mjediset me shkëlqimin më të lartë aristokratik londinez. I ndërtuar si rezidenca zyrtare e Lord Mayor of London-it ajo ndërtesë me bukuri manitëse përdoret për veprimtaritë zyrtare të këtij institucioni kaq unik në botë. Aty organizohen pritje nga më të rëndësishmet me burrështetas, mbahen darkat vjetore, ku Kancelari i Thesarit mban fjalën e rastit, e cila njihet si "Fjala në Manson House". Në të bëhet një paraqitje e gjendjes së ekonomisë së Mbretërisë së Bashkuar për atë periudhë të vitit.

Manson House është ndërtuar midis viteve 1739 dhe 1752 me një stil Palladian prej arkitektit londinez George Dance i Vjetri. Godina origjinale ka pasur dy mure me dritare poshtë çatisë, të quajtura "Foleja e Majorit" dhe "Varka e Noes". Në vitin 1795 arkitekti tjetër, George Dance i Riu, e ribëri oborrin brenda godinës dhe e shembi "Varkën e Noes". Që prej asaj kohe janë bërë shumë meremetime, por është ruajtur në vetvete struktura, destinacioni dhe forma e kësaj ndërtese, e cila përbën një ndër krenaritë më të mëdha arkitektonike të Londrës.

Pritja dhe protokolli në Manson House

Në atë shtëpi hyrja bëhet sipas një protokolli të fiksuar qysh prej kohës kur ajo ka filluar të funksionojë si e tillë. Veshja është e detyrueshme të jetë me frak e papion të zi, ose veshje mbrëmjeje, për burrat, ndërsa fustane të gjata deri në fund të këmbëve për gratë. Në portën e hyrjes të presin stuartët (garsonët) të

gjithë të veshur bukur me rrobat tradicionale. Pastaj dikush nga Manson House të përcjell deri në hollin e katit të dytë. Aty mikpritësit të veshur me rroba tradicionale dhe me tërë dekoratat, që kanë marrë në jetën e tyre, i takojnë mysafirët njëri pas tjetrit. Të ftuarit duhet t'i dorëzojnë ftesën tellallit, i cili e lexon me zë të lartë emrin e individit, të cilin e dëgjon jo vetëm mikpritësi, që të jep dorën, por edhe e tërë salla. Mysafirët shtrëngojnë duart me mikpritësin, shkëmbejnë disa fjalë përshëndetje dhe falënderimi shumë të shkurtra dhe vijojnë drejt hollit të pritjes.

Më pas zhvillohet një recepsion me pije shampanje nga më të mirat në botë. Në një ballkon të lartë një grup luan muzikë nga Hajden, Moxart, Bokerini dhe të tjerë të kohës së barokut të vonë. Nuk vonon dhe dy grupe me vegla frymore tunxhi lëshojnë tinguj të gjatë në dy anët e sallës nga ballkonet, ku janë vendosur. Ata bëjnë një duet që zgjat rreth dy tre minuta me melodi, që vijnë kreshendo. Sapo ata mbarojnë këtë "*dialog*", fjalën e merr një tellall, i veshur në rroba të kuqe dhe me dekorata e ornamente në gjoks. Ai thërret me të madhe dhe i fton mysafirët të shkojnë pranë vendeve të tyre, ku do të darkojnë.

Darka në Manson House

Gjithçka është e organizuar në mënyrë të përsosur. Ndërkohë, secilit mysafir i është dhënë në dorë një listë emërore e gjithë të ftuarve dhe gjen me saktësi vendin, ku do të ulet. Pasi afrohesh aty, qëndron pak në këmbë sa të jenë afruar tërë mysafirët pranë ndenjëses së vet. Me një komandë të njëjtë mysafirët ftohen nga thirrësi, që të ulen. Një folës në krye të sallës e bekon darkën dhe uron për jetëgjatësinë e Mbretëreshës. Ushqimi i parë është shtruar që më parë në tryezat fine dhe kështu fillon darka. Në më të shumtën e rasteve njerëzit ulen pranë njëri – tjetrit, pa u njohur dhe ky është edhe një nga qëllimet e darkës - duhet që të ftuarit të krijojnë lidhje dhe njohje të reja për t'i përdorur më pastaj. Ulja bëhet me shumë kujdes. Ka një rregullim virtuoz të vendosjes: një burrë - një grua. Asnjëherë çiftet nuk vendosen pranë njëri - tjetrit, por me të huaj. Biseda duhet bërë me kortezi dhe duhet respektuar njëlloj si zonja, që ke në anën e djathtë po ashtu edhe ajo që gjendet në të majtën. Pra, duhet ruajtur harmoni në kohë, që mos të mërzitësh njërën palë, duke i kushtuar më shumë kohë palës

tjetër. Një ekuilibër komunikimi, që në vetvete të nxit ta ushtrosh si rregull të pashkruar edhe atij të jetës reale. Njerëzit janë shumë të lirë dhe shprehen me njëri - tjetrin, a thua se njihen prej kohësh. Aty flitet për shumë gjëra në një mjedis ku kureshtja e anglezëve është e pakufi. Ata duan të dinë për kulturën, traditat, historinë, jetën e gjithkujt, i cili qoftë edhe rastësisht i është ulur pranë.

Ndërsa zonja ime, Donika, ishte ulur përballë meje midis dy burrave, njëri nëpunës i Bashkisë së Londrës, me ngjyrë, ndërsa tjetri anëtar i bordit të Majorëve. Unë isha ulur pranë dy zonjave. Në të djathtë ishte:

Mary MacLeenen…

Një irlandeze, menaxhere e 16 hoteleve në Londër, që kishte ardhur me të dashurin. Ishte një vajzë shumë e bukur, shumë fjalamane, krenare për vetveten dhe Irlandën siç janë irlandezët, e interesuar për turizmin në Shqipëri, shumë e lëvizur, krejt e papërqendruar. Përballë kishte të dashurin, i cili dukej edhe ai një njeri shumë i hapur. Folëm për Irlandën e Veriut, kongregacionin, ndarjet fetare, qetësinë e momentit dhe frikën e së ardhmes. Mary ishte shumë e mirë në bisedë, tipike irlandeze e bardhë, katolike nacionaliste, e lumtur që për herë të parë në historinë e marrëdhënieve Britani - Irlandë, një president irlandez, Michel D. Higgins e kishte vizituar ato ditë Mbretërinë Angleze. Pastaj folëm për turizmin në Shqipëri, për pikat historike, detin e pastër, malet e bukura varg, e plot gjëra të tjera të kësaj natyre...

Biseda me Mary-n ishte shumë e këndshme dhe në fakt, si përherë edhe në bisedën me të, gjëja aq shumë paralele midis historisë sonë dhe asaj irlandeze. Irlandezët, sikundër ne shqiptarët, janë po aq të dashur me të huajt, të ngrohtë, mikpritës, gjaknxehtë, punëtorë, pak kokëkrisur. Biseda me Mary-n duhej të ndërpritej, sepse një zonjë tjetër, Samanthia, në krahun e majtë duhej respektuar gjithashtu.

…dhe shkencëtarja Samanthia

Samanthia ishte një grua e moshës sime, shkencëtare e veterinarisë, anëtare e

grupit eksperimental i deles *Dolly* prej nga lindi një epokë e re në gjenetikë për klonimin e qenieve të gjalla. Ajo po më tregonte për arritjet e shkencës në atë fushë dhe m'u duk sikur iu ktheva kujtimeve të hershme të një mikut tim të ngushtë, i cili kishte qenë student në Universitetin e Edinburg-ut dhe bënte eksperimente me minjtë për realizimin e kësaj arritje të madhe shkencore. Ai ishte Güven Güneren dhe e kishte përjetuar gëzimin e asaj arritjeje nën kujdesin e profesorëve të tij britanikë.

Më kishte treguar sesi arrihet sjellja në jetë e kopjes së një individi madje edhe reagimin e shoqërisë civile britanike kundër një gjëje të tillë, e cila për disa prej tyre shkon kundër parimeve të krijimit të njeriut dhe qenieve të gjalla nga Zoti. Edhe detajet e rrëfyera prej tij kur në një rast, natën, ndërkohë që profesori i kishte lënë një detyrë, punë laboratorike me minj, jeta e tij ishte vënë në rrezik pasi kundërshtarët e eksperimentit të deles *Dolly* kishin tentuar të hynin në laborator me dhunë, më ngacmonin kujtesën, ndërkohë që Samanthia rrëfente pafund për arritjet e punës së saj.

Si ndodh që "ne anglezët" i marrim gjërat si të dhëna përgjithmonë?

Biseda me Samanthian ishte vërtet interesante e, ndër të tjera, ajo donte të dinte për Shqipërinë dhe veçanërisht se si ka qenë jeta gjatë periudhës së izolimit komunist...

- A e dinit ju, se çfarë ndodhte në anën tjetër të botës? - më pyeti ajo.

- Pak a shumë po! - i thashë

- Po si e merrnit vesh ju këtë?

-Valët e televizionit italian ishin burimi i parë. Por edhe Jugosllavia deri kur erdhi Milosheviçi ishte burim tjetër, që na tregonte se atje ishte një botë tjetër. Nganjëherë shihnim turistët, që vinin me autobusë të mrekullueshëm, ndërsa ne nuk kishim as biçikleta. Ja kështu...

- Po mirë, ju nuk shpreheshit? - pyeti pa e fshehur habinë.

- Ah, i thashë, - shumë pak dhe në qarqe shumë të mbyllura. Duhej të ruheshim shumë. Dhe m'u kujtua një episod, të cilin ia tregova edhe asaj. Në të vërtetë ai ishte një nga ato episodet e zakonshme të kohës sonë, por për

Samanthian ky ishte një rrëfim që e habiti shumë.

- Në vitet e fundit të komunizmit, - i thashë, - kur në fakt nuk e dinim se sa do zgjatnin dhe nëse do të mbaronin ndonjëherë, kishte njerëz, të cilët dëshironin shumë të dinin çfarë bëhej përtej perdes së hekurt, klonit, vijës së ndarjes me botën. A ishte vërtet bota aq keq dhe ne aq mirë, siç na rrëfehej çdo ditë? Në asnjë gjë nuk na rezultonte, që ne të ishim më mirë se bota, por propaganda na paraqiste si njerëzit më të lumtur në botë. Vërtet në Britani kishte demonstrata, dhe kundërshtime ndaj Thatcher-it, por njerëzit ishin të lirë ta bënin këtë. Po ashtu Britania ishte modeli i zhvillimit në botë.

Dekani i Trupit Diplomatik, Ambasadori i Kuvajtit, Khaled Al-Duwaisan, dhe "alternativat" e tij për jetën

Khaled Al-Duwaisan, ishte ambasadori i Kuvajtit në Londër, qysh kur kishte përfunduar lufta midis Amerikanëve dhe Sadam Hysein-it për çlirimin e vendit të tij. Për rrjedhojë, si ambasadori me kohështrirje më të gjatë në atë detyrë në Londër ishte edhe Dekan i Trupit Diplomatik. Në çdo fjalim ai fuste nota që na shkaktonin jo pak herë edhe humor. Këtë mbrëmje ai foli për alternativat që ka njeriu në jetë. Në fillim kur krijohet njeriu ka alternativën të lindë djalë apo vajzë? Pastaj vjen alternativa, jetë apo vdekje? Nëse jeton, alternativa është të shkosh majtas apo djathtas. Pastaj po të shkojë majtas, alternativa është a të bëhesh komunist apo liberal? Nëse shkon djathtas ose majtas, përsëri ke një mëdyshje: Shumë djathtas apo shumë majtas? Po edhe kur të vdesë, çfarë të bëjë? Të shkosh në Parajsë apo në Ferr?

"Një ditë, - tha ambasadori, - vendosa dhe thashë me vete: Asnjë gjë të keqe nuk kam bërë në jetën time. Pse mos të shkoj në Parajsë? Dhe vendosa të shkoj. Por pastaj m'u kthye mendja: Po të shkoj në Parajsë, do të jem i vetëm, pasi të gjithë ju jeni mëkatarë dhe unë dua të jem me ju. Prandaj dua të shkoj në Ferr dhe ju gjej juve të gjithëve atje".

Dekani kuvajtian i Trupit Diplomatik e bëri sallën të shpërthente në gaz. Në fakt secili prej atyre që ishin aty, edhe pse ishin në sallën më të bukur në botë, mund ta shihte veten si kandidat potencial për te ky vend i dytë.

KREU I GJASHTË

LAMTUMIRË!

Kryetemë:

E pra, Lamtumirë!

E në qoftë se përgjithmonë:

Lamtumirë, për gjithmonë!

George Gordon Byron

DITA E FUNDIT NË LONDËR - 30 TETOR 2015

Pas 1358 ditësh në Londër, erdhi edhe momenti që do t'i thosha lamtumirë atij qyteti vështirësisht të përshkrueshëm për bukuritë, përmbajtjen dhe kënaqësinë, që më kishte dhënë. Jeta e diplomatit është e mbushur me shumë emocione, të papritura, kthesa, nga njëherë edhe me shqetësime, por në fund mbetet një nga përvojat më të bukura që njeriu mund të provojë në jetë.

Po largohesha nga Londra me ndjesinë e njeriut të lumtur dhe po merrja me vete rekordet me shkrim, fotografi, herë në video dhe jo rrallë të transmetuara në televizionet tona të 140 veprimtarive promovuese për Shqipërinë.

Kisha përjetuar festimet e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe i kisha kremtuar me dinjitetin më të lartë me një varg veprimtarish, që janë pasqyruar në këtë libër. Kisha arritur të vendosja bustin e Skënderbeut në Londër dhe të organizoja Konferencën Shkencore brenda mjediseve të Foreign Office për udhëtimin 100-vjeçar të shtetit tonë. Po atë vit prita udhëheqësit e Shqipërisë dhe të Kosovës me rastin e Lojërave Olimpike "London 2012". Më pas erdhi "Jubileu i Diamantit" i Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II, në 60-vjetorin e mbretërimit të saj, që përbënte një gjë të rrallë të përjetimit të një diplomati në atë vend.

Më 4 gusht 2013, në një nismë të përbashkët me arbëreshen Mavi D'Inzeo, vendosëm Bustin e Skënderbeut në Munxhufun, fshat arbëresh në Italinë e Jugut. Më pas organizuam tri edicione artistike për promovimin e Shqipërisë të quajtura "Notes on Albania". Kisha dhënë leksion në auditorin e Ambasadës Amerikane në Londër, dhe kisha dalë në skenë bashkë me Ambasadorin Amerikan Matthew Barzun, atë Izraelit Daniel Toub dhe atë të Lituanisë, Asta Skaiskyryte para një audience me 150 pjesëmarrës, ndër ta 23 ambasadorë të

vendeve të tjera.

Janë të shumta veprimtaritë e zhvilluara dhe për të dhënë një tablo më të qartë, në fund të këtij libri botohet edhe një e të gjitha veprimtarive të organizuara listë ditë pas dite në ato 1358 ditë në Londër.

Ishte mbrëmja e 30 tetorit 2015, kur duhej t'u thosha lamtumirë tërë miqve të mi anglezë, shqiptarë e shqiptaro - britanikë. Largimin do ta bëja me përurimin e dy librave. I pari ishte:

"Realitete Shqiptaro - Britanike" - Një doracak për diplomatët e rinj. Ndërsa po përgatitesha për t'u larguar nga ajo detyrë, kisha punuar për të lënë si trashëgimi atë libër i cili erdhi nga Tirana vetëm në momentin kur po fillonim veprimtarinë. Ai libër, në konceptin tim, është një doracak (*vademekum*) udhëzimesh të vlefshme sesi një diplomat, duhet të mësojë, të dijë dhe të veprojë në vendin ku akreditohet. Në të gjenden rrënjët historike të marrëdhënieve me Britaninë e Madhe, udhëtarët e shumtë britanikë, që e kanë vizituar dhe përshkruar Shqipërinë. Më pas vijnë biografitë e ambasadorëve britanikë në Shqipëri, nga i pari deri tek i fundit i asaj kohe, si dhe ambasadorët shqiptarë në Britani nga i pari deri tek i fundit; miqtë më të shquar britanikë, që po lija pas vetes dhe djemtë e vajzat më të shquara shqiptare, që kishin bërë emër në Britani pasqyrohen aty, po ashtu. Me një pasion të natyrshëm dhe kujdes të posaçëm, në atë libër po lija një model sesi duhej punuar për promovimin e vlerave më të mira të kombit tonë në Britaninë e madhe dhe atë që ata kishin bërë dhe bënin për ne.

Tjetri ishte një album me titull "1358 ditë në Londër", kronikë e ilustruar me foto i të gjitha veprimtarive të organizuara deri natën e fundit.

Miqtë e mi Aqif Neli, Petrit Kuçana, Ben Manaj, Daut Dauti, Vera Ora, Kristale Ivezaj Rama, Rudina Jasini, u kujdesën që në sallën e Universitetit Regent të Londrës të organizonin atë takim lamtumire. Ata kishin përgatitur një video klip me titull:

"Lamtumirë, Ambasador!"

Në të pasqyroheshin të gjitha veprimtaritë e Ambasadës në atë hark kohor midis viteve 2012 - 2015. E pranishme ishte thuajse e tërë Shoqata Anglo - Shqiptare ku nuk mungonte Presidenti i saj i nderit, Sir Noel Malcolm. Ishin të

pranishëm edhe ambasadorë, por më i rëndësishmi për mua ishte ai i Kosovës, z. Lirim Greiçevci, i cili më dhuroi një fotografi të Isa Boletinit të vënë në kornizë.

Ajo ishte një mbrëmje e paharrueshme lamtumire e organizuar prej miqsh të rrallë. Këtu u mbyll edhe jeta ime prej diplomati të karrierës. Më 31 tetor pasdite mbërrita në Tiranë.

Përveç tjerash me vete kisha të shkruar edhe dy materiale, të cilat dua t'i përfshij në këtë libër. Janë histori të shkurtëra të shërbimit diplomatik të Shtetit Shqiptar, njëra nga vitit 1912 – 1939 dhe tjetri prania diplomatike e ndërsjelltë Shqiptaro – Britanike.

HISTORIA E PËRFAQËSIMIT DIPLOMATIK TË SHTETIT SHQIPTAR NË LONDËR DHE ANASJELLTAS

Përfaqësuesit shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar

Shteti shqiptar ka mbajtur një përfaqësi diplomatike në Londër. Ky përfaqësim fillon shumë shpejt, në vitin 1922, thuajse në të njëjtën kohë kur Shqipëria vendos marrëdhënie diplomatike edhe më Shtetet e Bashkuara. Njohja me personalitetet shqiptare që e kanë përfaqësuar Shqipërinë duhet të jetë me interes jo vetëm për diplomatët shqiptar por edhe për një auditor më të gjërë.

Mehmet Konica (1922 – 1924) lindi më1878 dhe vdiq më 1948, Ministër Fuqiplotë, dhe veprimtar politik i shquar (1922–1924). Ka shërbyer si Ministër i Punëve të Jashtme, diplomat karriere. Ai ka meritën e madhe e të qenit diplomati i parë shqiptar në Britaninë e Madhe. Ai vinte nga një e kaluar e lakmueshme atdhetare. Kishte qenë anëtar i delegacionit të Qeverisë së Vlorës dhe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913). Në qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit u emërua Ministër i Punëve të Jashtme, detyrë të cilën e mbajti edhe në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Në vitet 1920-1924 shërbeu si përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Britaninë e Madhe. Në periudhën 1925-1939 ka shërbyer si këshilltar politik pranë kryetarit të shtetit shqiptar.

Mehmet Konica ishte një ndër të paktët dëshmitarë të tragjedisë shqiptare të kufijve. Ai e ndoqi atë nëpër disa etapa, nga viti 1913 deri më 1923, kur më së fundi, një komision ndërkombëtar i kryesuar nga një gjeneral italian, vendosi në Shqipërinë e Jugut gurët që shënonin kufijtë shqiptaro-grekë. Gjenerali quhej

Telini dhe ai nuk u kthye kurrë në Itali, pasi e vranë bandat greke në afërsi të Delvinës dhe trupi i tij, i përcjellë nga Mehmet Konica në emër të Qeverisë Shqiptare, u dërgua në Romë me nderimet ushtarake. Bashkë me të mori fund edhe aventura e kufijve, një aventurë e cila ka sunduar për një kohë të gjatë, gjithë mosmarrëveshjet në Ballkan. Në veprimtarinë e tij si diplomat shqiptar, mund të cilësohen marrëdhëniet me politikanin e shquar dhe dashamirës të Shqipërisë Aubrey Herbert. Në një moment historik, kur Shqipëria kërkonte një aleat të madh siç ishte Britania e Madhe, ai bashkë me amerikanin Charles Telford Erickson, i ofruan Herbertit kurorën e një Mbretërie Shqiptare ende të palindur. Herbert-i e pranoi, por fati i tij i keq ishte se ai vdiq përpara se kjo të ndodhte. Në historinë e Shqipërisë Mehmet Konica mbetet një figurë e ndritur, që luajti rol aktiv dhe mjaft të dobishëm në çdo çast madhor të kthesave të mëdha historike të Shqipërisë.

Iliaz bej Vrioni (1925 – 1926**)** lindi në Berat në vitin1882. Ai ishte djali i Mehmet Ali Pashë Vrionit, patriotit të shquar shqiptar, nënkryetarit të Lidhjes së Prizrenit dhe babai i përkthyesit të shquar Jusuf Vrionit. Qe një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, së bashku me Sami Bej Vrionin. Në vitet 1925 – 1926 ka shërbyer si Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Londër, me rezidencë në Onslo Gardens, SW7. Vrioni rridhte nga një familje e pasur tokash në Shqipërinë Jugore ishte një figurë e shquar politike në periudhën e parë zogiste. I ati, Mehmet Ali Pashë Vrioni, kishte bashkëpunuar me Abdyl Frashërin në kohën e Kongresit të Berlinit. Iliazi mori pjesë vetë në lëvizjen për pavarësinë në Vlorë dhe u zgjodh në senat në vitin 1912. Në vitin 1914 udhëtoi për në Gjermani bashkë me Esat Pashën për t'i dorëzuar kurorën Vilhelm Vidit. Më datën 19 nëntor 1920, pasi mori pjesë në Kongresin e Lushnjës, ishte kryetari i delegacionit të Beratit ku u zgjodh Kryeministër pas rënies së qeverisë së Sulejman Delvinës, post të cilin e mbajti deri me datën 19 tetor 1921. U bë përsëri kryeministër nga 27 maj 1924 deri më 10 qershor 1924, kohë kur ndodhi i ashtuquajturi revolucioni demokratik i Fan Nolit. Në vitet 1925–1926 shërbeu si Ministër Fuqiplotë në Paris dhe në Londër. Nga shkurti 1927-ës deri në janar 1929, ai ishte dhe për një kohë të shkurtër Ministër i Drejtësisë. Ai ishte Ministër i Jashtëm në vitin 1925–1927 dhe nga viti 1931–1933 mbajti marrëdhënie të afërta me Italinë. Ministër i Jashtëm i Shqipërisë pesë herë,

Ministër Fuqiplotë në Britani dhe Francë (1925-1926 dhe1929–1932). Për kontributin e tij të pasur në marrëdhëniet ndërkombëtare, është dekoruar nga Republika Franceze në vitet 1920 me urdhrin e lartë "*Grand Officier de la Légion d'Honneur"*. Vdiq në Paris, Francë më 17 mars 1932. Në vitin 1946, regjimi dikatorial do t'i zhvarroste eshtrat e ish-Kryeministrit Iliaz Bej Vrioni për t'i hedhur ato në Lumin Osum të Beratit. Ato vazhdojnë të mbeten të humbura, duke e lënë ende këtë personalitet të vyer të kombit shqiptar pa varr.

Maliq Libohova (1926 – 1927) Maliq Libohova, ishte i Ngarkuar me Punë në Londër. Ai shërbeu përsëri po në këtë funksion dhe po në këtë Ambasadë nga shkurti 1933 deri në qershor 1933. Ambasada në atë kohë ishte e vendosur në 118 Iverness Terrace, Londër. Fare pranë me këtë adresë, sot qëndron Busti i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, dhe pikërisht në 113 Inverness Terrace, London W2 6JH, i vendosur më datën 28 nëntor 2012. Ndërtesa e atëhershme duket se nuk ekziston për shkak të ndërtimeve të bëra në atë truall.

Eqrem bej Vlora (1927 – 1929) i lindur më 1885 vdekur më 1964, ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë nga shtatori i vitit 1927 deri në maj 1929, kur Ministër Fuqiplotë ishte Iliaz Bej Vrioni, me rezidencë në Paris. Ai ka qenë një veprimtar i çështjes shqiptare, diplomat, politikan, shkrimtar dhe historian. Kreu studimet e mesme dhe universitare në Theresianum, Akademia Orientale Mbretërore e Perandorake në Vjenë, ku u specializua në çështje ballkanike. Më pas i plotësoi studimet për doktoraturë në drejtësi në Stamboll në vitin1904. Gjatë udhëtimeve në Lindje të Mesme do të krijonte njohje me personalitete të larta të kohës si Feld-Mareshalin britanik Herbert Kitchener, shefin e Shtatmadhorisë Austro-Hungareze, Franz Conrad von Hötzendorf, dhe majorin e ri Mustafa Kemal Ataturk, themeluesin e ardhshëm të Turqisë moderne. Në vitin 1906 ishte sekretar i gradës III në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Stamboll. Në vitin 1907, Sekretar i gradës III në Ambasadën e Perandorisë Osmane në Shën Petërburg për tre muaj, ndërsa në vitin 1909, Sekretar II në zyrën e përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Stamboll. Ai bashkë me miqtë e tij hapi të parin klub të quajtur "*Bashkimi*" në Stamboll më1908-ën. Bashkë me patriotin Dervish Hima, mori pjesë në

Kongresin e Manastirit të mbajtur në nëntor të vitit 1908. Ai mori pjesë në shpalljen e pavarësisë dhe më pas u bë nënpresident i senatit. Ka shërbyer si sekretar i jashtëm në qeverinë e Vilhelm Vidit. Gjatë Luftës së Parë Botërore në vitin 1916, ai u internua nga italianët në Cagliari. Në vitin 1924 u zgjodh në parlament. Zogu e dërgoi në Londër si të ngarkuar me punë në vitin 1928. Më pas ai u emërua në Athinë. Eqrem Beu ka meritën e madhe të përkthimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit në gjermanisht bashkë me baroneshën Marie Amelie, Frein von Godin dhe shkruan veprën monumentale prej 1 200 faqesh *"Vështrim historik i kontributit pë historinë e sundimit turk në Shqipëri"*. Ai na ka lënë një trashëgimi të madhe letrare.Vdiq në mërgim në vitin 1964.Veprimtaria e tij aq komplekse dhe detyrat e mbajtura në shtetin shqiptar tregojnë për rëndësinë që Mbreti Zog u jepte në atë kohë marrëdhënieve me Mbretërinë e Bashkuar. Ai ishte anëtar i Akademisë së Shkencave Gjermane, nga ku ka marrë edhe medalje ari, si dhe anëtar i Akademisë diplomatike të Parisit dhe i Institutit të Shkencave në Romë dhe në Tiranë.

Fuad Asllani (1933 – 1934 – 1935) lindur më1897, vdekur më 1981, ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë në Ambasadën Shqiptare në Londër nga viti 1933 në vitin 1934 dhe nga dhjetori 1934 deri në tetor 1935 si Ministër Fuqiplotë. Lindi në Bejrut të Libanit dhe kreu Kolegjin Robert në Stamboll. Ai u diplomua në vitin 1923 në Vjenë. Fuad Asllani ishte anëtar i shoqatës majtiste "*Bashkimi*", drejtimin e së cilës e mori pas vdekjes së Avni Rrustemit. Ai iu bashkua KONAR–s së drejtuar nga Fan Noli. Ishte kundërshtar i hapur i Zogut, por më vonë ata vunë paqe midis tyre. Pas një internimi në Delvinë në vitin 1928, Zogu i ofroi punë në Ministrinë e Jashtme. Më pas shërbeu në disa misione shqiptare jashtë, si në Bullgari, Britaninë e Madhe (1932–1934) dhe në Lidhjen e Kombeve. Ai ka shërbyer përkohësisht si parlamentar dhe Drejtor i Institutit Herbert. Ishte anëtar i Këshillit të Shtetit gjatë okupimit fashist dhe u fsheh disa kohë gjatë vitit 1944. Më pas u arrestua dhe u dënua bashkë me 36 shqiptarë të tjerë, përfshirë edhe Musine Kokalarin. Fuad Asllani nën regjimin e Enver Hoxhës i kaloi vitet e jetës deri sa vdiq, herë në burg, e herë në internim. Veprimtaria e tij si diplomat jep një shembull interesant se si patriotët tanë edhe pse kundërshtarët politikë të Mbretit dërgoheshin në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar dhe në rastin tjetër, nën diktaturë, ata persekutoheshin deri në

pikën më të paimagjinueshme. Fuad Asllani është shembulli më kuptimplotë i këtij dallimi drastik.

Xhemil Dino (1932 – 1933) lindur më 1894, vdekur më1972, ka shërbyer si Ministër Fuqiplotë i Mbretërisë Shqiptare në Britaninë e Madhe nga marsi 1932 – deri në shkurt 1933. Lindi më 1894-ën në Prevezë, në Vilajetin e Janinës në kohën e Perandorisë Osmane, nga një degë e një familjeje fisnikësh të njohur me emrin, familja Dino. Studioi në Universitetin e Gallatasarajit në Stamboll dhe, pas shpalljes së pavarësisë u zgjodh deputet i Dibrës. Ka përfaqësuar Shqipërinë në Asamblenë e gjashtë, të shtatë dhe të tetë të Lidhjes së Kombeve, 1925–1927.

Rauf Fico (1881–1944), lindur më1881, vdekur më 1944 – diplomat dhe politikan, lindur në Gjirokastër. Studioi në Vjenë dhe më vonë në Mekteb-i Mülkiye. Në vitin 1912 u përfshi në qeverinë e Vlorës si këshilltar në Ministrinë e Brendshme. Në vitin 1916, gjatë administratës ushtarake austriake, ai shërbeu si zëvendësprefekt në Tiranë. Në atë pozitë u bë bashkëthemeluesi i Strehës Vorfnore, e para jetimore e ngritur ndonjëherë në Shqipëri. Në vitin 1921 shërbeu si Ministër i Brendshëm i Shqipërisë në kabinetin e Pandeli Vangjelit. Në vitet 1923-1925 u zgjodh deputet i Durrësit. Në fund të viteve 1920, shërbeu si ambasador i Shqipërisë në Turqi dhe në Bullgari dhe në prill të vitit 1929, u emërua Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Por kjo nuk zgjati pasi ai ishte kundër italianëve dhe influencës së tyre në Shqipërinë e asaj kohe. Kështu u bë Ambasador në Jugosllavi në vitet (1933-1836), në Greqi në 1937-ën dhe Gjermani në vitin 1938-1939. U arrestua nga italianët dhe u internua në Itali. Vdiq në Tiranë më datën 23 janar 1944 vetëm pak muaj pas kapitullimit të Italisë dhe kthimit të tij në atdhe. Ai është mbajtës i një numri të madh dekoratash ndër të cilat "Urdhri i Kordonit të Madh të Franc Jozefit", i atij të Leopoldit, të Kurorës së Rumanisë, të Kurorës së Italisë, të Foeniksit të Greqisë, Kurorës së Luksemburgut, Urdhrin e Skënderbeut, Legjion të Nderit të Francës, Palmës së Akademisë Franceze, Urdhërit të Borisit të Bullgarisë, Doktor Honoris Causa të Akademisë së Napolit.

Qatin Saraçi (1903 – 1974), lindur më 1903, vdekur më 1974, ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë i Mbretërisë Shqiptare nga tetori 1935 deri në dhjetor

të vitit 1935. Lindi në një familje të njohur shkodrane dhe u bë figurë publike, diplomat dhe piktor shumë i njohur. Ashtu si edhe Eqrem Bej Vlora, ai ka ndjekur Shkollën e Mesme Theresianum në Vjenë me një bursë austriake. U takua dhe u shoqërua që në atë takim të parë me Ahmet Zogun, duke e ndihmuar më pas që të vinte në pushtet. Zogu e përfshiu atë në karrierë diplomatike, duke e emëruar Konsull të Përgjithshëm në Vjenë dhe pas Anschluss–it e emëroi të Ngarkuar me Punë në Londër. Si piktor ekspozoi mjaft nga punët e tij në Londër në vitin 1948. Aty kishte miqësi me piktorin austriak Oscar Kokoschka (1886-1980), të cilin e ndihmoi gjatë viteve të emigracionit në Angli. Saraçi ka udhëtuar nëpër tërë Evropën dhe ka botuar edhe një libër për Zogun me titull "*Inside the Story*". Ambasada Shqiptare ka qenë e vendosur në këtë godinë, 71 Pont Street London SW, nga viti (1938-1939)

Lec Kurti (1935 – 1939), lindur më 1884, vdekur më1948, ka qenë Ministër Fuqiplotë i Mbretërisë Shqiptare, i cili shërbeu në Londër nga dhjetori i vitit 1935 deri në prill të vitit 1939. Ai është një figurë shumëdimensionale me ndihmesa të mëdha në shumë fusha të jetës shqiptare, si politike, diplomatike dhe muzikore. Ishte i biri i kompozitorit të njohur Palokë Kurti nga Shkodra. Studioi në Liceun e Pesaros pranë Urbanos dhe më pas në Akademinë e Arteve të Bukura në Venecie. Më vonë ai studioi shkenca politike në Romë dhe shërbeu si përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë. Fatkeqësisht, iu dogj shtëpia dhe, mendohet se bashkë me të janë shkrumbuar edhe mjaft krijime të tij muzikore. Nga dorëshkrimet e mbetura mësohet se Lec Kurti kompozoi muzikë në harkun kohor 1908-1916 dhe, më pas, duket se iu kushtua në fillim diplomacisë e pastaj politikës. Lec Kurti e fillon veprimtarinë në diplomacinë shqiptare në vitin 1918 në Bari si konsull i Shqipërisë (1921-1922) dhe, më pas, si "*I ngarkuar me punë*" (1925-1926) në Athinë, ku merr titullin "*Qytetar Nderi*" i qytetit. Më tej e gjejmë përfaqësues të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë (1930-1935), dhe Ministër Fuqiplotë të Mbretërisë Shqiptare në Londër. Ai ka meritën se nuk ia dorëzoi përfaqësuesit italian Ambasadën Shqiptare në Londër. Sipas shtypit anglez të kohës, ai u paraqit në Foreign Office dhe deklaroi dorëheqjen e tij dhe mosnjohjen e qeverisë fashiste të vendosur në Tiranë, në prill të vitit 1939. Gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, Lec Kurti do të ishte nënkryetar i Ballit Kombëtar dhe

disa ditë përpara 29 nëntorit 1944, u largua përfundimisht nga Shqipëria. Vdiq në mërgim më1948-ën.

Dervish Duma (1939 - 1939) ka jetuar nëntëdhjetë vjet dhe ishte një prej të paktëve diplomatë të paraluftës, i cili për gjashtëdhjetë vjet mbeti një shërbëtor i shquar i popullit shqiptar, si përfaqësues diplomatik, si spiker transmetimesh radiofonike të luftës dhe udhëheqës jozyrtar i bashkësisë së shqiptarëve të arratisur nga Shqipëria në Britaninë e Madhe. Ai ishte lindur në Borsh të Sarandës në vitin 1908. Fill pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 1913, Borshi u sulmua nga grekët dhe popullsia e atyshme u shpërnda. Familja Duma shkoi në Vlorë. Dervishi vetë hyri në një shkollë italiane. Në vitin 1920, u transferua në shkollën teknike amerikane në Tiranë si nxënësi i maturës së parë. Në atë kohë kishte pak nga ata që e flisnin anglishten, kështu që ai, në moshën njëzetvjeçare, u caktua Sekretar i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Shqiptare nën komandën britanike. Komandanti i saj, Majori Sir Jocelyn Percy ia njohu aftësitë Dervish Dumës dhe e ndihmoi të shkonte dhe të studionte administratë publike në Angli, në London School of Economics, nga viti 1933, deri në vitin1935.

Me t'u kthyer në Shqipëri, Duma hyri në shërbimin diplomatik dhe iu dha detyra e dyfishtë: Sekretar i Parë i Delegacionit Shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë dhe Sekretar i Dytë i Legatës Shqiptare në Londër. Në fillim të vitit 1939 ai mori detyrën e të Ngarkuarit me Punë. Kur më 7 prill 1939 Musolini pushtoi Shqipërinë, Duma u thirr të kthehej mbrapsht në Tiranë. Ai zgjodhi të rrinte në Britani dhe punoi për kompaninë Bowater dhe që aty ndihmoi shumë për të mbajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet me botues amerikanë. Në vitin 1940 themeloi seksionin shqip të BBC-së. Që aty, ai u bë zëri i shpresës për shqiptarët. Gjatë viteve të mërgimit të Mbretit Zog, e ndihmoi atë dhe familjen e tij veç të tjerash edhe me anglishten e tij. Ai kishte lidhje me emigracionin shqiptar në Amerikë, ndërkohë që ka shërbyer 62 vjet si drejtues aktiv i Anglo Albanian – Association. Pas rënies së komunizmit ai gëzoi një jetë të re. Njëri pas tjetrit atë e vizituan Kryetari i Parlamentit Shqiptar, Pjetër Arbnori, Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova. Në vitin 1992, ai u bë Konsull Nderi i Shqipërisë dhe u ftua të rihapte shërbimin shqip të BBC-së, të cilin e kishte mbyllur qeveria e Willson-it për një shpenzim fare të vogël prej 12 000 sterlinash. Dervish Duma ka lënë të shkruara poezi në gjuhën shqipe dhe

angleze dhe njihej si një përdorues i shkëlqyer i të dy gjuhëve.

RIVENDOSJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE PAS RËNIES SË KOMUNZMIT

Pas një ndërpreje gjysëm shekullore, marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve u rivendosën falë ndryshimeve të mëdha që ndodhën në Shqipëri pas rënies së Murit të Berlinit dhe, një vit më vonë, pas rënies së diktaturës në Shqipëri.

Më datën 29 maj 1991, me deklaratën e përbashkët të lëshuar nga qeveritë e të dy vendeve, që mbylli përfundimisht një periudhë të errët në marrëdhëniet mes nesh Mbretërisë së Bashkuar. Ato rifilluan me një mbulim diplomatik të Mbretërisë së Bashkuar nga Roma, ndërsa në Londër vepronte i biri i diplomatit të fundit shqiptar të Mbretërisë, Dervish Dumës, Aleksandri. Ai veproi në cilësinë e "Të Dërguarit të Posaçëm" të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Vitin e parë të punës së saj, Ambasada Shqiptare ishte e vendosur në shtëpinë e vetë z. Duma. Pas një viti shteti shqiptar vendosi që në Oborrin e Shën Xhejmsit ta përfaqësonte një intelektual i shquar shqiptar, i njohur për ndihmesën e tij në fushën e njohjes së gjuhës angleze në Shqipëri dhe pikërisht z. Pavli Qesku.

Pavli Qesku (1993-1997) Gjuhëtari i njohur Pavli Qesku u emërua në Londër më 14 prill 1993 dhe më pas i paraqiti letrat kredenciale si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar përpara Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II. Ka lindur në datën 16 qershor 1943 dhe ka studiuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë nga viti 1964-1968. Ai ka punuar si përkthyes në shtëpinë botuese "Naim Frashëri" në Tiranë nga viti 1968 deri në vitin 1973. Pas një periudhe si mësues i gjuhës angleze në Gjimnazin e Peshkopisë, ai punoi si përkthyes dhe redaktor në redaksinë e botimeve në gjuhë të huaja në Shtëpinë Botuese "*8 Nëntori*" – më vonë Shtëpia Botuese Enciklopedike (1976-1992). Filloi punë në MPJ në prill të vitit 1992 për një kohë të shkurtër për t'u emëruar më pas Ambasador i RSH-së në Oborrin e Shën Xhejmsit në datën 14 prill 1993, detyrë të cilën

e ushtroi deri në vitin 1997. Gjatë asaj periudhe vendet nënshkruan një seri marrëveshjesh të rëndësishme për të dy palët. Pavli Qesku është përkthyes i njohur dhe autori i fjalorit më të madh shqip - anglisht me 130.000 fjalë, i cili përbën një ndihmesë të jashtëzakonshme, jo vetëm për dy kulturat, por edhe për marrëdhëniet dhe lehtësimin e komunikimit midis dy kombeve tona, si dhe të gjitha kombeve anglishtfolëse.

Agim Fagu (1997-2002) është një ndër sportistët më të njohur në Shqipëri. Si basketbollist i ekipit kombëtar të Shqipërisë ai mbahet mend për aftësitë si lojtar i shquar. Ai ka qenë anëtar i Kuvendit Shqiptar dhe, më pas, nga nëntori i vitit 1997 deri në tetor të vitit 2002, ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Ai ka shërbyer më pas si Drejtor i Drejtorisë së NATO – s në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kastriot Robo (2002-2007) lindi më 30 korrik 1960 në qytetin e Lushnjës. Ai ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar nga tetori i vitit 2002 deri korrik të vitit 2007.

Kreu Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Tiranës dhe më pas studimet pasuniversitare për politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Ai ka punuar si Shef Sektori në Drejtorinë e Marrëdhënieve me vendet fqinjë në MPJ në vitet 1986–1991. Më pas ka punuar në Kabinetin e Ministrit të Jashtëm, dhe pastaj si Sekretar i Parë në Ambasadën e RSH-së, Athinë (1991-1994) dhe në Sofje si dhe në hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Tokio (1995-1996). Pas një periudhe shërbimi si drejtor i Çështjeve Rajonale në MPJ-së ai ka shërbyer si Ambasador i RSH-së në Athinë, në Mbretërinë e Spanjës, në Madrid dhe kohët e fundit Ambasador në Mbretërinë e Danimarkës. Periudha e shërbimit të tij në Londër mbahet mend si një periudhë kur marrëdhëniet e Shqipërisë me Britaninë e Madhe ishin në ngritje të vazhdueshme. Ai ka bërë një punë të lavdërueshme me bashkësinë shqiptaro – britanike. Si vlerësim të punës së tij ka marrë titullin "*Freeman of the City of London*".

Zef Mazi (2007 – 2011) ka qenë Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë në vitet 2007-2011. Më parë ai kishte shërbyer si Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm e Republikës së Shqipërisë

në OSBE, OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare në Vjenë. Në vitin 1997 ishte Ministër Këshilltar dhe i ngarkuar me punë, si dhe Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm në Kombet e Bashkuara, IAEA dhe OSBE, si dhe në organizatat ndërkombëtare të akredituara në Vjenë nga viti 1991, deri në vitin 1997 dhe nga viti 1991 deri në vitin 1992. Ai shërbeu si Ministër Këshilltar dhe i Ngarkuar me Punë në ambasadat shqiptare në Austri dhe Zvicër. Në vitet 1978 deri në vitin 1986, ka qenë përkthyes dhe redaktor në shtëpinë botuese "*8 Nëntori*". Ai ka punuar edhe në shërbimin botëror të Radio Tiranës (1975-1985). Që nga marsi i vitit 2011, Zef Mazi është asistent special i Drejtorit të Përgjithshëm për Strategjinë në Sekretariatin e IAEA.

Dr. Teuta Starova (2008-2011), (2011-2012) ka shërbyer si Ministre Këshilltare dhe për një periudhë kohore e Ngarkuar me Punë në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo ka kryer studimet universitare për filozofi 1985, studimet pasuniversitare (1986-1990) në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike, dhe ka vazhduar studimet pasuniversitare jashtë vendit në Universitetin "*Central European University"* (CEU), në Pragë. Para se të shërbente si diplomate, ajo ka punuar pedagoge në Katedrën e Historisë së Filozofisë pranë Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike, në Departamentin e Filozofisë dhe Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Dr. Starova ka një përvojë pune edhe në fushën e diplomacisë, pasi ka punuar diplomate në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Britaninë e Madhe, si Ministër Këshilltar në vitet 2008–2013. Në periudhën mars 2011 - shkurt 2012, ka shërbyer si e Ngarkuar me Punë dhe më pas i është kthyer mësimdhënies si pedagoge, lektore e Sociologjisë politike dhe Historisë së mendimit sociologjik klasik pranë Departamentit të Sociologjisë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Mal Berisha (2012 - 2015) Ka lindur në vitin 1952, në Tropojë. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin "*Ismail Qemali*" në Laç të Kurbinit dhe u diplomua në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, Dega e Kulturës. Më pas ka studiuar në shkollën e Diplomacisë në Universitetin Hacetepe në Ankara.

Për një kohë të gjatë është marrë me veprimtarinë kulturore dhe artistike në

rrethin e Krujës dhe ka botuar artikuj për trashëgiminë kulturore – etnografike të kësaj zone.

Në vitin 1992 fillon punë në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar si specialist në Drejtorinë Rajonale të MPJ-së dhe, më pas, u emërua në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll, Turqi, ku shërbeu deri në vitin 1997.

Në vitin 1998 – 2000 iu bashkua përpjekjeve të shqiptarëve të Amerikës nën emblemën e Ligës Qytetare Shqiptaro – Amerikane dhe Federatës Pan Shqiptare "Vatra" në Amerikë për çështjen e Kosovës.

Në vitin 2000 fillon punën si anëtar i stafit ndërkombëtar të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Nga viti 2009 drejton Drejtorinë Konsullore dhe më pas atë Rajonale në MPJ-së.

Në 17 shkurt 2012 merr detyrën e të Ngarkuarit me Punë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut dhe Irlandë (jo-rezident). Në 27 qershor 2013, paraqet letrat kredenciale tek Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në atë vend dhe, më datën 10 tetor 2013, para Presidentit të Irlandës, Sh.T. Michael D. Higgins.

Veprimtarinë e tij si diplomat e ka gërshetur e pasuruar edhe me punë studimore, të realizuar dhe në botimin e gjashtë librave rreth historisë së marrëdhënieve të Shqipërisë me botën anglo - saksone. Puna dhe veprimtaria e tij në ambasadën e Londrës janë të lidhura me krijimin e një profili shumë të lartë kulturor dhe artistik të ambasadës me qëllimin e promovimit të vlerave më të mira të kombit shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar. Ndër to spikatin vendosja e bustit të Skënderbeut në Bayswater, organizimi i 145 veprimtarive promovuese me rëndësi, ndër to: Edicionet "*Notes On Albania*" dhe "*Java Kulturore Shqiptaro – Britanike*". Ai mban titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut", akorduar nga Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani, si dhe titullin "*Commendatore*" i Urdhrit Mbretëror të Franceskut të Parë si dhe dekoratën kalorësiake përkatëse. Ky titull nderon individë me merita në jetën publike, shkencore, artistike, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare dhe kombëtare.

PËRFAQËSUESIT BRITANIKË NË SHQIPËRI

Misioni i parë diplomatik britanik në Shqipëri me seli në Durrës, u hap në janarin e vitit 1922. Pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ku britanikët luajtën rol përcaktues si dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, ishte hapur rruga për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Të dyja shtetet shkëmbyen diplomatët në vendet respektive. Diplomati i parë i Shqipërisë në Londër ishte Mehmet Konica, një ndër patriotët dhe njerëzit me më shumë kontribut në historinë e Shqipërisë, ndërsa ai britanik ishte:

Sir Harry Charles Augustus Eyres (1922 – 1926) Është i pari diplomat britanik i dërguar në Shqipëri dhe shërbeu nga viti 1922, deri në vitin 1926. Dihet që britanikët kanë patur një prani konsullore për një kohë të gjatë në qytete të ndryshme të Shqipërisë si në Janinë, Shkodër, Gjakovë, Manastir por këto ishin nën qeverisjen osmane. Prandaj mund të themi se diplomati i parë britanik i akredituar në Shqipërinë si shtet i pavarur ishte Sir Harry Charles August Eyres.

Ai ka lindur me datën 21 korrik 1856 dhe ka vdekur me 17 korrik 1944. Ishte nga Great Melton në Nowfolk dhe kishte studjuar në Merlborough në Wiltshire. Në vitin 1877, pasi kaloi provimet u emërua përkthyes i Ambasadës Britanike në Stamboll. Në vitin 1882, pas një periudhe të shkurtër në Shkodër, mori detyrën e zevendës konsullit në Van, në Turqinë e sotme lindore. Më pas shërbeu si i ngarkuar me punët e zëvendës konsullit në Erzurum (1882-1883) dhe në Bejrut (1885-1887, 1890, 1894) dhe konsull në Damask, 1890. Nga viti 1896, deri sa doli në pension në vitin 1914, ai shërbeu si Konsull i Përgjithshëm britanik në Stamboll. U kthye në shërbimin diplomatik, pas Luftës së Parë Botërore. Posti i tij ishte Konsull i Përgjithshëm dhe Ministër dhe e filloi atë detyrë në janar 1921. Rezidenca e tij ishte në Durrës. Në vjeshtën e atij viti ai bëri një udhëtim në Dibër. Aty ai vizitoi 157 fshatra të shkatërruara nga forcat serbe dhe këtë ia raportoi Lidhjes së Kombeve. Në datën 24 janar 1922, u caktua Konsull i Përgjithshëm dhe Ministër Fuqiplotë. Ai i paraqiti letrat kredenciale para Këshillit të Lartë të Rregjencës më datën 11 mars 1922. Ai shërbeu në këtë detyrë deri në vitin 1926, kur vendin e tij e zuri William Edmond O'Reilly. Kur doli në pension mori titujt Kalorës i Urdhërit të St

Michael-it dhe St Georges (KCMG).

William Edmund O'Reilly (1926) (1873–1934) diplomat britanik, i cili shërbeu në Shqipëri për një kohë të shkurtër në vitin 1926. Ai e kishte filluar shërbimin diplomatik ndaj Madhërisë së tij në vitin 1901. Më pas nga viti 1919, deri në vitin 1924, është emëruar Ministër në Bolovi dhe në Guatemalë.

Sir William Seeds KCMG (1882–1973) ka qenë diplomat britanik i cili ka shërbyer nga viti (1926-1928) si i Dërguar i Jashtëzakonshëm, Ministër Fuqiplotë dhe si Konsull i Përgjithshëm në Shqipëri. Karriera e tij është shumë e larmishme. Ka shërbyer si Ambasador në Rusi dhe në Brazil. Ai ka lindur në Dublin, Irlandë më datën 27 qershor 1882 në një familje protestante të Ulsterit. Ai i hyri shërbimit dilomatik britanik në vitin 1904 dhe shërbeu në Washington nga viti (1904–1907), pastaj në Legatën Britanike në Pekin (1907-1909), në Stokholm 1910 dhe në Ambasadën Britanike në Greqi në vitet (1911–1913), i ngarkuar me punë në Lisbonë të Portugalisë në vitet (1913-1919) dhe me punët e sekretarit të parë në Berlin në vitin 1919.Nga viti (1930-1935) shërbeu si ambasador në Brazil, por posti i tij më i rëndësishëm do të mbetej ai i ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar në Bashkimin Sovjetik në vitit (1939-1940).

Sir Robert Maclead Hodgson (1874 – 1956) KCMG KBE ka qenë Ministër Fuqiplotë në Shqipëri në vitin (1928-1936). Studimet i kreu në vitin 1897 dhe iu bashkua shërbimit konsullor britanik. Nga viti (1901–1904) ai shërbeu në Algjer. Më pas shërbeu si zëvendës konsull në Marsejë, në vitin 1904. Në vitin 1906 u emërua agjent tregtar në Vladivostokun e largët dhe u bë zëvendës konsull e më pas konsull në vitin 1911. Aty qëndroi deri në vitin 1919. Në vitin 1919 u emërua agjent tregtar në Moskë. Në vitin 1924 qeveria Britanike e njohu qeverinë komuniste bolshevike por ai u thirr mbrapsht në atdhe.

Në vitin 1928 u emërua Ministër në Shqipëri dhe shërbeu deri në vitin 1936.

Sir Andrew Ryan ka shërbyer si Konsull i Përgjithshëm në Shqipëri në vitet (1936–1939). Ai ka lindur në vitin 1876 dhe ka vdekur në vitin 1949. Ka studjuar në Christian Brothers College dhe është diplomuar nga Universiteti

i Irlandës në vitin 1896. Ai ishte një diplomat britanik i cili shërbeu si Konsull i Përgjithshëm në Kostandinopul nga viti (1924–1930) dhe më pas në Rabat (1930-1936). Ai është diplomati i fundit që shërbeu në Shqipërinë e para luftës së Dytë Botërore. Ka shërbyer si i Dërguar i posaçëm Durrës që nga tetori i vitit 1936, deri në vitin 1939 dhe mbeti si Konsull i Përgjithshëm në Tiranë pas pushtimit Italian të 7 Prillit 1939, deri më datën 17 korrik të atij viti. Një vit më vonë ai doli në pension. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si ndërmjetës i FCO me Mbretin Zog, i cili kishte kërkuar azil në Britani në vitin 1940. Kujtimet e tij janë përmbledhur në librin e titulluar "*I Fundmi i Dragomanëve*", botuar në vitin 1951. Dokumentet e tij gjenden në Kolegjin e Shën Antonit në Oksford.

Laurence Barton Grafftey, ka shërbyer nga viti 1939–1940 si Konsull i Përgjithshëm në Durrës dhe pak kohë në Tiranë. Ai iu bashkua shërbimit diplomatik britanik në vitin 1914 si një student përkthyes. Nga viti 1916 deri në vitin 1918, shërbeu si zëvendës konsull në Aleksandri. Në vitin 1919, ai shërbeu si Sekretar i Ambasadës në Kajro. Në vitin 1920, u caktua zëvendës konsull në Jedah dhe më pas në vitin 1923 në Kostandinopul. Ai e mbylli karrierën si Komisioner i lartë në Pakistan. Ky është edhe diplomati i fundit që e la Shqipërinë pas pushtimit fashist italian.

Pas një ndërprerje gjysëm shekullore të marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve rifilluan me shkëmbimin e diplomatëve. Në pritje të një shkëmbimi të tillë, Shqipëria e njohu si të Dërguar të Posaçëm z. Alexander Duma, i biri i diplomatit të fundit të Mbretërisë Shqiptare, Dervish Duma. Më pas diplomati i parë britanik me kredenciale që mbulonte Shqipërinë u bë:

Sir Stephen Loftus Egerton, (1991–1992) gjatë shërbimit të tij në Romë (1989–1992) u caktua Ambasador jo-rezident i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, duke shënuar rifillimin e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe vendit të tij. Ai ka shërbyer si Ambasador britanik në Bagdad, Riad dhe Romë, ku dhe është njohur si arabologu më i mirë në shërbimin diplomatik britanik. Shërbimi i tij në Bagdat dhe takimet me Sadam Hyseinin janë pasqyruar nga gazeta Telegraph si një nga tregimet më interesante për një diplomat britanik.

Ai ka lindur në datën 21 korrik 1932 në Indore, në Indinë qendrore dhe iu bashkua shërbimit të jashtëm në vitin 1956. Pas studimeve në Eton kreu studime plotësuese në Liban dhe u dha pas studimeve të arabishtes. Ai ishte dëshmitar i luftërave të Irakut me Iranin dhe Irakut me Kuvajtin.

Sir Patrick Fairweather është një diplomat britanik i cili ka shërbyer si Ambasador në Shqipëri në vitin 1992. Më parë kishte shërbyer edhe në Angola në vitet (1985-1987). Ai ka qenë Drejtor i Fondacionit Butrinti nga viti 1997, deri në vitin 2004. Sir Patrick Fairweather ka kryer Tirinity College në Cambridge i diplomuar për histori. Shërbimi i tij diplomatik përfshin shumë poste ndër të cilat edhe si Këshilltar në Bashkimin Ekonomik Evropian në Bruksel.

Sir John Stewart Duncan, OBE, (1992-1996) është një diplomat britanik dhe ka shërbyer në Shqipëri nga viti (1992-1996). Ai është i specializuar për Kontrollin Shumëpalësh dhe Çarmatimin si dhe Përfaqësues i Përhershëm në Konferencën e Çarmatimit në Gjenevë në vitet (2006–2011). Ai ka qenë emëruar nga Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth e II–të, ta përfaqësonte atë si Guvernator në Ishujt British Virgin Islands dhe *de facto* kreu i shtetit në atë territor. Ai e ushtron atë detyrë që prej gushtit të viti 2014. Ai i është bashkuar shërbimit diplomatik të Britanisë në vitin 1980 pasi kishte studjuar në universitetet e njohura si ai i Sorbonës në Francë. Në Tiranë u spostua si i ngarkuar me Punë në vitin 1992 dhe qëndroi në vendin tone, deri në vitin 1996.

David Arthur Slinn, CMG, OBE, i lindur në vitin 1959 në Nirthampton ka qenë i Ngarkuar me Punë në Shqipëri nga viti (1995-1996). Më parë ka shërbyer si ambasador britanik në Korenë e Veriut. Ai është ambasadori i shtatë i Britanisë në Kroaci. Ka shërbyer gjashtë muaj në Tiranë dhe më pas tre vjet në Beograd në fillim si zyrtar i tregtisë dhe më pas në vitet (1998–1999) si oficer politik mbi Kosovën. Gjatë ngjarjeve në Maqedoni në vitin 2001, ai ka punuar me NATO–n si pjesë e ekipit që prodhoi Marrëveshjen e Ohrit.

Andrew Tesorière, shërbeu në Shqipëri nga viti 1996, deri në vitin 1998. Më pas ai shërbeu si Ambasador në Latvi nga viti 2002, deri në vitin 2005 dhe në

Algjeri nga viti 2005 deri në vitin 2007. Që nga viti 2008, ai ka shërbyer në OSBE dhe Ambasador në Kyrgistan.

Stephen Nash, ka shërbyer dy herë në Shqipëri, një herë si i Ngarkuar me Punë adinterim, (1993-1995) dhe pastaj si Ambasador në vitet (1998-1999). Z. Nash është Kryetar i Shoqatës Anglo – Shqiptare, organizata historike që ka luajtur atë rol të madh historik në fatin e Shqipërisë nën drejtimin e Aubrey Herbert dhe Edith Durham.

Në vitet '90 ai shërbeu Ambasador në Shqipëri, Gjeorgji dhe në Latvia. Ai ka marrë pjesë në misione si vëzhgues i OSBE dhe BE–së për zgjedhje si në Ukrainë, Rusi, Venezuele, Shtetet e Bashkuara dhe drejtues misionesh vëzhguese në Serbi dhe Rumani. Ai është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në vitin 2014 me titullin "*Për Merita Civile*".

Peter January, i lindur në vitin 1952, ka shërbyer në Shqipëri si Ambasador i Britanisë së Madhe nga viti (1999–2001) Më parë ai ka punuar në Qeverinë Qendrore të Madhërisë së saj në agjensitë e komunikimit

David Landsman OBE, i lindur në vitin 1963 ka shërbyer si ambasador në disa vende. Ai ka kryer Kolegjin Oriel të Oksfordit dhe më pas mori një PhD në gjuhësi në vitin 1990 nga Kolegji Claire në Cambridge. Ai iu bashkua shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1990 dhe punoi në departamentin e Evropës Jugore. Në vitin 1997 ai ishte zëvendës shef i Misionit në Beograd. Pas një turneu në Ballkan dhe Hungari Lansman u emërua ambasador në Republikën e Shqipërisë. Në vitin (2009–2013) shërbeu si ambasador në Greqi.

Richard Jones, ka shërbyer në Shqipëri nga Marsi 2003 deri në Nëntor 2006 si ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë. Ai ka kryer studimet në Kolegjin Merton në Oxford në Mbretërinë e Bashkuar për Historinë Moderne. Në vitin1998 ai ishte zëvendës drejor i Departamentit të Bashkimit Evropian në FCO. Në vitin 1999 i hyri mësimit të gjuhës shqipe dhe në mars të atij viti ai u emërua Ambasador në Tiranë, por vetëm për disa muaj. Ai është Ambasador i Bashkimit Evropian në Zvicër dhe Principatën e Lihtenshteinit.

Fraser Andrew Wilson (2006 – 2009) MBE i lindur në vitin 1949 ka shërbyer si Ambasador në Shqipëri nga 27 nëntori 2006, deri në vitin 2009 me daljen e tij në pension. Më parë ai kishte shërbyer si zëvendës Konsull i Përgjithshëm në São Paulo si dhe ambasador në Turkmenistan. Ai ka qenë Komisioner i lartë në Seychelles para se të emërohej Ambasador në Shqipëri. Z. Wilson ka punuar në pozicione të ndryshme në FCO në departamentin e Lindjes, dhe departamente të tjera. Sot ai është anëtar i Anglo Albanian Association dhe merr pjesë rregullisht në veprimtaritë e kësaj shoqate.

Fiona Mcllwham, ka shërbyer si Ambasadore e Jashtëzakonëshme dhe Fuqiplotë e Britanisë së Madhë në Tiranë nga viti 2009, deri në vitin 2012. Ajo ka qenë shumë e njohur si diplomatja e re dhe shumë aktive në Tiranë. U kthye në Whitehall në vitin 2015 pas dy vitesh punë në Bruksel si këshilltare e Komisionerit dhe Drejtorit të Përgjithshëm për Zgjerimin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Znj. Mcllwham i është bashkuar shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1998 pasi kishte kryer studime të larta master në Zhvillimin Ekonomik. Përveç kësaj, në kuadër të G8–tës dhe rolit shumëpalësh në Londër ajo ka shërbyer në Bosnjë, Irak dhe Uashington.

Nicholas Cannon, është pasardhësi i zonjushës Fiona McNeill. Ai i është bashkuar shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1988 dhe ka shërbyer në Paris, Nikosia të Qipros, Islamabad si dhe Komisioner i Lartë në Ruanda dhe ambasador jo-rezident në Burundi. Me rastin e emërimit të tij në Shqipëri ai ka thënë:

> *"Është një nder i madh të emërohesh në këtë post në këtë përvjetor të 100 të Pavarësisë së Shqipërisë. Unë mezi pres ti çoj edhe më tej marrëdhëniet e shkëlqyera midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar".*

Siç shihet, Mbretëria e Bashkuar përherë ka emëruar në Shqipëri diplomatë të zgjedhur dhe me shumë emër në Foreign and Commonwealth Office.

HISTORI E SHKURTËR E SHËRBIMIT DIPLOMATIK, QË NGA THEMELIMI I SHTETIT SHQIPTAR DERI NË VITIN 1939

Ndonëse shteti shqiptar modern e fillon jetën e tij më 28 Nëntor 1912, shqiptarët kanë dëshmuar aftësi të komunikimit diplomatik përpara kësaj date. Për të mos shkuar shumë thellë në histori, le të ndalemi tek diplomacia e Skënderbeut dhe marrëdhëniet e Tij me Mbretërinë e Napolit, Republikën e Venedikut dhe Shtetin e Vatikanit.

Më vonë, kur Shqipëria ra plotësisht nën pushtimin otoman, shqiptarët e treguan veten si shumë të aftë. Ndër ta, dy burrështetas shqiptarë, të cilët drejtuan dy shtete shumë të fuqishme mesdhetare, drejtuan edhe diplomacinë e këtyre vendeve. I pari, Mehmet Ali Pashai i Kavallës, themeluesi i Egjiptit modern, i cili sundoi nga viti 1805 deri më 1849, njihet për diplomacinë e tij, sidomos për atë me anglezet dhe francezët. Po ashtu, Kryeministri i Italisë, arbëreshi Francesko Crispi, e ka drejtuar shtetin italian dhe për rrjedhoje diplomacinë e saj në dy etapa të rëndësishme, 1887 deri më 1891 si dhe 1893 deri 1896. Ndërkohë, marrëdhëniet e Ali Pashë Tepelenës me misionarë të huaj dhe konsullata të vendosura në oborrin e tij janë historikisht të njohura.

Ajo që vlen edhe më shumë për t'u shënuar është fakti që vetë shteti i ri shqiptar u themelua nga njëri prej diplomatëve më të shquar të Perandorisë Osmane, Ismail bej Vlora. Jeta e tij, përpara se të shpallte Pavarësinë e Shqipërisë, me gjithë turbulencat që kishte, ishte kryesisht e lidhur me diplomacinë. Ishte ndjenja e zjarrtë e atdhetarit, e gërshetuar me mjeshtërinë e diplomatit, në rrethanat historike në të cilat u gjend Shqipëria, që solli aksionin e tij më të rëndësishëm historik – Shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912.

Me fillimin e shtetit shqiptar, edhe pse i gjymtuar nga fuqitë e mëdha, i

ndërtuar vetëm në gjysmën e trojeve të veta, një ndër gjërat e para që duhej të bëheshin do të ishte një veprimtari e dendur diplomatike. Qeveria e Vlorës, me aq burime sa kishte, u mundua me çdo mjet të kërkonte njohje dhe mbështetje nga fuqitë e mëdha. Për këtë u shfrytëzuan miqësitë, ose lobimet siç konsiderohen sot, në vendet me fuqi të madhe vendimmarrëse. Mbështetja, që mori Ismail Qemali, mund të thuhet se ishte pjesë e një mjeshtërie të madhe diplomatike.

Në dhjetor të vitit 1918, në mbarim të Luftës së Madhe, shqiptarët arritën të formojnë një qeveri, e cila njihet me emrin Qeveria e Durrësit, me Kryeministër Turhan Pashë Përmetin dhe Ministër të Jashtëm Myfit Libohovën. Diplomacia e kësaj qeverie shënon kulmin e saj me pjesëmarrjen në Konferencën e Paqes në Paris, 1919, ku spikat pjesëmarrja e amerikanit Charles Telford Erickson, si diplomat amerikan dhe delegat nderi i Vatrës. Korrespondenca e tij me Presidentin Willson ka luajtur rol shumë të madh në ruajtjen e Shqipërisë. Pjesëmarrës ishin Imzot Luigj Bumçi, dr. Michael Turtulli, Mehmet Konica dhe vetë Turhan Pasha.

Në vitin 1920 u mbajt Kongresi i Lushnjës prej nga doli Qeveria e Sylejman Delvinës, me Ministër të Jashtëm Mehmet Konicën. Përpjekjet e saj për ruajtjen e territorit të Shqipërisë dhe përzënien e italianëve nga Vlora ishin të jashtëzakonshme.

Akti më i madh diplomatik i kësaj qeverie ishte pranimi i Shqipërisë, më 17 dhjetor 1920, si vend anëtar i Lidhjes së Kombeve dhe përfaqësimi që Peshkopi Fan Noli i bëri çështjes shqiptare në Gjenevë. Diplomacia shqiptare, atë botë, u mbështet nga miku më i madh i shqiptarëve të asaj kohe, politikani britanik, kolonel Aubrey Herbert me ndihmën e pakursyer të Lordit anglez Robert Cecil, kanadezit Rowell si dhe indianit Ali Imam.

Përfaqësues diplomatikë të kësaj qeverie u dërguan vetëm në dy vende: Në Itali, Myfid Libohova dhe në Austro – Hungari, Syrja Vlora.

Në vitin 1921 filluan të hapen përfaqësi konsullore dhe përfaqësi nderi. Me 26 tetor 1926 Regjenca caktoi Dr. Charles Telford Erickson-in komisionar në Washington, ndërsa Fuad Dibrën në Stamboll. Po kështu në Gjenevë u emërua Eugene Pitard-i si konsull nderi, ndërsa në Londër Loyon Thompon. Lec Kurti u caktua konsull në Bari të Italisë. Në vitin 1921 Britania e Madhe dërgoi si Ministër Fuqiplotë Harry Charles Augustus Eyres, gjë që shënon edhe vendosjen

zyrtare të marrëdhënieve diplomatike me këtë vend dhe të parin diplomat të akreditуar në vendin tonë. Vetëm dy muaj më pas, vendi ynë dërgon në Londër Mehmet Konicën, si i pari diplomat yni në Britaninë e Madhe. Ndërkaq, në Bernë të Zvicrës emërohet Benedikt Binishti, si konsull i përgjithshëm.

Në atë kohë Pandeli Evangjeli si Ministër i Jashtëm hapi një seri zyrash diplomatike në Washington, Stamboll, Vjenë, Bukuresht, Paris, Aleksandri e Gjenevë. Në Washington shërben Konstandin Çekrezi dhe më pas dr. Konstandin Tashko. Në Paris shërbeu Mit'hat Frashëri. Ndërkohë Franca emëron Jean Béguin-Billecocq-un si të ngarkuar me punë në Shqipëri. Me rëndësi ishte hapja e misionit të parë të ShBA – së në Shqipëri, me datën 28 korrik të vitit 1922, me përfaqësues Maxell Black-un, i cili zëvendësohet prej Ministrit Fuqiplotë, Grant Smith. Një emër i njohur i diplomacisë italiane, markezi Carlo Durrazo u emërua në Shqipëri në vitin 1922 dhe qëndroi deri në vitin 1925. Ndërsa Ali Asllani u caktua në Trieste të Italisë. Hungaria po kështu emëroi të dërguarin e vet, kontin Albert Menes de Hidveg, në vitin 1922. Duke e zgjeruar hartën e shërbimit diplomatik shteti shqiptar avancoi drejt Sofjes me Viktor Plumbin, dhe më vonë Konstantin Boshnjakun, si të ngarkuar me punë.

Me gjithë përpjekjet e bëra, përbërja e MPJ-së nuk ishte strukturuar ende si duhet. Prandaj, Ministri i Jashtëm Pandeli Evangjeli, më 2 shkurt 1923 kaloi në parlament strukturën me Sekretar të Përgjithshëm, Xhaver Vilën. Në atë kohë u emëruan shumë konsuj nderi në qendra të rëndësishme si në Brindisi, Luksemburg, Torino, Lajpcig, Pragë, Stokholm, Kopenhagë, Munih etj. Ndërkaq, në janar të vitit 1923, Mbretëria Greke hap zyrën e vet në Durrës. Menjëherë qeveria shqiptare dërgoi në Athinë Mid'hat Frashërin si Ministër Fuqiplotë në oborrin e Mbretit Konstantin. Gjermanët e hapën zyrën e vet në Tiranë, në vitin 1923, por Shqipëria për trembëdhjetë vjet rresht u mjaftua me veprimtarinë e konsujve të saj të nderit nëpër ato vende.

Qeveria e Revolucionit të Qershorit, e Fan Nolit, përjetoi izolim shumë të madh diplomatik ndërkombëtar, sidomos pas kërkesës për hapje përfaqësie diplomatike sovjetike në Tiranë. Kjo bëri që një delegacion sovjetik i ardhur në Tiranë të largohej pa asnjë takim diplomatik.

Pas kthimit të Zogut dhe shpalljes së Shqipërisë Republikë, Ministër i Jashtëm u emërua Myfid Libohova, ndërsa në Romë u dërgua i vëllai, Eqremi. Gjatë kësaj periudhe pati një zëvendësim thuajse të plotë të trupit

diplomatik me njerëz të besuar të Zogut, kryesisht prej atyre që kishin studiuar në shkollat italiane dhe në ato ushtarake. Megjithatë emra të njohur të qeverive të mëparshme gjendeshin nëpër misionet diplomatike shqiptare, siç ishin:

Iliaz Vrioni, Eqrem Libohova, Xhemal Frashëri, Medi Frashëri, Xhemal Dino, Eqrem Vlora, Ali Asllani.

Në këtë kohë, dalin në skenë emra të tjerë të diplomacisë shqiptare, si Rauf Fico dhe shkrimtari e atdhetari i njohur Faik Konica, i cili hap Legatën Shqiptare në Washington, me sekretar Hito Sadikun. Në vende tjera si në Rumani shërben Selahudin Blloshmi.

Në marrëdhëniet me Greqinë, të cilat ishin jashtëzakonisht të tensionuara, vjen një epokë e re për shkak të ndihmesës së dhënë nga arvanitasi Pangalltos, i cili doli në krye të qeverisë greke dhe që i shpërndau organizatat pan - verio – epirote dhe i shuajti për pak kohë përpjekjet e sillogjit për pretendime territoriale ndaj Shqipërisë.

Ndërkaq, në listën e trupit diplomatik shfaqet një emër shumë i vyer i këtij shërbimi, Eqrem Bej Vlora i cili emërohet në Londër për të ndjekur ecurinë e mbështetjes angleze ndaj Shqipërisë në telashet e pandërprera, që i dilnin me Beogradin.

Një skandal me një spiun serbo - malazez, i quajtur Vuk Gjurashkoviç, solli ndërprerjen e marrëdhënieve të Beogradit me Tiranën dhe tërheqjen e Ceno beg Kryeziut, nga kryeqyteti jugosllav.

Më 22 nëntor 1927 u nënshkrua ai që njihet si Pakti i Dytë i Tiranës prej Ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme, Iljaz Vrioni dhe atij Italian, Ugo Sola. Ai mbante pjesën e tretë të paktit të parë të vitit 1925 dhe pranonte shtesa të tjera. Ndërkaq, qeveria greke nuk po iu përmbahej zotimeve të veta për popullsinë çame, madje situata po përkeqësohej, aq sa Iljaz Vrioni paraqiti ankesë tek Sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Erich Drummond, me nënshkrimin e MPJ-së shqiptar Iliaz Vrioni. Si përherë, grekët, nëpërmjet të ministrit të tyre të jashtëm, Politis nuk pranuan asnjë kërkesë shqiptare.

Pas shpalljes së Shqipërisë Mbretëri, diplomacia shqiptare përjetoi një situatë të re. Fakt është që, brenda pak ditëve, atë e njohën mbi njëzet e pesë shtete, por pati edhe shtete si Turqia, e cila jo vetëm nuk e njohu, por për rreth tre vjet i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Iljaz Vrioni vazhdoi të mbetej Ministër i Jashtëm. Në vitin 1932 marrëdhëniet me Turqinë

u rivendosën dhe Nezir Leskoviku u emërua si i ngarkuar me punë në Ankara. Në këtë periudhë del edhe ligji organik për shërbimin diplomatik, i cili duhet konsideruar si shumë modern për kohën. Ai përmbante detyrat dhe të drejtat që ka çdo diplomat shqiptar, i të gjitha niveleve të asaj kohe.

Ligji u nënshkrua nga kryeministri Koço Kota dhe Ministri i jashtëm Rauf Fico. Sekretari Ministrisë në atë kohë u bë Xhafer Vila. Shqipëria ndërtoi një trupë diplomatike relativisht të admirueshme dhe të shpërndarë mjaft mirë nëpër botë, sigurisht në pajtim me mundësitë e saj buxhetore.

Ne vitin 1932-1933 pllakosi një krize e rëndë ekonomike, e cila e detyroi shtetin të shkurtojë buxhetin e shërbimit diplomatik me 50%. Prandaj edhe e tërë Ministria mbeti vetëm me 14 punonjës, përfshirë Ministrin, Hysen Vrionin, dhe Sekretarin e përgjithshëm, Dhimitër Beratin. Pati shkurtime edhe në personelin jashtë vendit dhe diplomatët më të mirë u dërguan në qendrat më të rëndësishme, si p.sh. Xhemal Dine në Londër, Rauf Fico në Beograd, Nezir Leskoviku në Ankara.

Një numër diplomatësh të asaj kohe kanë lënë gjurmë me veprimtarinë e tyre. Ndër ta shquhen Dhimitër Kosturi, Konstandin Mima, Kosta Meksi, Pandeli Nase, Zef Prenushi, Asaf Xhaxhuli, Qemal Jusufati, Remzi Çelo, Sofokli Comorra, Tahir Shtylla. Në Ministri filloi të funksiononte shumë mirë konkursi për marrjen në detyrë të diplomatëve.

Në vitin 1936 konkurruan shumë kandidatë dhe fituan të tillë, si: Hamid Kokalari, Angjelin Kakarriqi, Mikel Çoba, Stavri Katundi. Më vonë Jani Evangjeli, Felatun Vila, Petro Kisi, Rexhep Shazi, Asllan Ypi, Xhahid Koka, Sotir Avrami, Nush Bushati, Lazer Çetta, Mikel Çoba, Ferid Dervishi, Qenan Dibra, Rasi Dino, Xhemil Dino, Vasil Dogani, Alexander Stavre Drenova, (Asdreni), Dervish Duma, Dhimiter Engjelli, Jani Evangjeli, Rauf Fico, Medi Frashëri, Mid'hat Frashëri, e sa e sa të tjerë.

Një gjë që bie në sy në tekstin e dekretimeve të diplomatëve titullarë (Ministra Fuqiplotë) në kohën e Republikës së Parë ishte teksti që e shoqëron:

> *"…Pres prej tij besnikëri dhe zell në detyrë, shërbime të drejta me ndërgjegje të pastër e kombëtare për Republikën tonë Shqiptare."*

Me ardhjen e Mbretërisë, iu kushtua shumë rëndësi edukimit atdhetar. Këtë

e vërteton edhe teksti i shtypur në çdo pasaportë shqiptare.

Po në këtë kohë shërbimi diplomatik amerikan forcohet me një emër shumë të madh me reputacion të njohur ndërkombëtar: Në Tiranë vjen Ministër Fuqiplotë Herman Bernstein-i, një poet, shkrimtar, gazetar investigativ, zbulues, historian, mik i tre presidentëve amerikanë, Theodor Roosevelt, Woodrow Wilson dhe Herbert Hoover. Ai shërbeu nga viti 1930-1933. Ai la një vepër të rëndësishme pas e cila e nderon Shqipërinë. Ai është edhe biografi i parë i Mbretit Zog. Një diplomat i atij kalibri nuk është akredituar as përpara as pas tij nga asnjë vend i botës në Shqipëri deri më sot.

Në vitet '30 trysnia ndaj Mbretërisë Shqiptare për ta ripërtërirë Marrëveshjen e Tiranës, me kushte të reja që e kthenin vendin në një protektorat të plotë dhe shtet vasal ndaj Italisë, u rrit shumë nga Musolini. Në këto rrethana, diplomatët shqiptarë u gjetën në kushte të vështira kudo që ishin. Ministri i Jashtëm Italian dhe dhëndër i Duçes Konti Galeazzo Ciano po ashtu ushtronte trysni të madhe ndaj diplomacisë shqiptare. As përpjekjet e Jakomonit dhe as manovrat e tradhtarit Zef Serreqi, nuk e bindën Mbretin që ta pranonte projektin e Musolinit për kalimin e sovranitetit në duart e Viktor Emanuelit të Tretë.

Kështu pasoi pushtimi fashist Italian, më 7 prill 1939. Në atë kohë veprimtaria e shërbimit diplomatik shqiptar, ku më shpejt e ku më vonë, u ndërpre. Diplomatët në përgjithësi mbetën në vendet ku ishin, por tani si emigrantë. Disa prej tyre u kthyen në atdhe ose emigruan për në vende demokratike si në ShBA, Britani, Francë etj. Shumica e atyre të cilët mbetën në Shqipëri, pas vitit 1944, u ndëshkuan nga qeveria komuniste, u dënuan me vdekje ose burgje dhe internime. Nuk dihet nëse ndonjë prej tyre e arriti rënien e komunizmit në vitin 1990.

TË NOTOSH ME DHE KUNDËR RRYMËS

Në mbyllje të këtij libri më duhet të them diçka, që nuk kam dashur ta prek deri sa mora shkrimin e gazetarit të njohur të BBC dhe televizionit Top Channel Z. Ben Manaj: Ky ka të bëjë me përkatësinë time politike, e cila "rëndonte" mbi mua në atë emërim që pata nderin të marr për të shërbyer në Londër.

Vetëm pak ditë pas arritjes në Londër, takova një mikun tim, edhe ai ish-gazetar i BBC – së, zotin Gëzim Guri. Ai është një burrë i urtë, shumë i dashur dhe fjalëpaktë, i mençur, nga ata që flasin pak, por kurrë nuk thonë gjëra të paduhura. Ai me shumë kujdes më tha:

"Më është bërë shumë qejfi që jeni emëruar këtu në Londër. Është vend me rëndësi dhe zyrë me shumë mundësi për të bërë gjëra të bukura. Por më vjen keq që më duhet të të them që sapo u mor vesh emërimi yt këtu, pat reagime shumë të ndryshme: Disa janë gëzuar shumë dhe flasin sikur tani po na vjen "*njeriu ynë*"! Le ta shohin tani këta beniaminët e ambasadës a do të shkelin dot aty më, ashtu siç kanë bërë deri tani!? Të tjerë thonë se ai është njeri i kryeministrit, një partiak që vjen këtu thjesht për t'iu bërë një favor, por do ta shohë se ç'do t'i punojmë ne atij! Do t'ja nxijmë jetën!"

E dëgjova me vëmendje dhe jo pa kërshëri, madje edhe me shqetësim. I etiketuar në këtë mënyrë kaq të skajshme, ndjeva një lloj emocioni, i cili më vuri në mendime.

"Po mirë, i dashur Gëzim", i thashë, "ju që keni kaq vite në Londër, dhe e njihni shumë mirë bashkësinë shqiptare të këtushme, çfarë do më sugjeronit?"

"Unë", tha ai, "do të sugjeroja që të vendosësh kontakt miqësor, me të gjithë, pavarësisht se nga cili krah i politikës janë ata."

Në fakt dukej se ai më kishte lexuar mendjen, pasi më sugjeroi pikërisht atë që e kisha menduar përpara se të nisesha për në Londër.

Ai më përmendi disa prej atyre që kishin formuar shoqata, kishin themeluar gazeta, ishin korrespondentë të mediave në Shqipëri, disa intelektualë që jepnin mësim nëpër universitete etj. Midis shumë emrave ai më foli edhe për z. Ben Manaj.

Natyrisht që unë emrin dhe veprimtarinë e tij e njihja shumë mirë, pasi që ai ishte shumë i njohur në mediat shqiptare. Kërceva menjëherë dhe i thashë:

- A keni numër telefoni të zotit Manaj?

"Sigurisht që po", më tha Gëzimi dhe menjëherë më citoi atë numër.

Ditën tjetër u ula pranë tavolinës së punës dhe fillova të bëja një seri telefonatash njerëzve që më dhanë punonjësit e Ambasadës. Më së pari thirra kryetarët e shoqatave, si: Ardhmëria, Shpresa Program, Nënë Tereza, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Bisedova dhe i ftova të vinin në ambasadë. Ishte kënaqësi.

Pastaj thirra në telefon zotin Manaj.

Në anën tjetër të linjës dëgjova tingullin e zërit të tij mikrofonik shumë të njohur.

Iu prezantova kush isha dhe ai menjëherë reagoi:

"Mirë se ke ardhur zoti Berisha! E kemi marrë vesh që keni arritur në Londër!"

"Faleminderit! Lajmi "*i mirë*" përhapet shpejt", i thashë, jo pa qesëndi.

"Sigurisht! më tha!"

"Zoti Manaj", i thashë, "unë e di se emri im ka mbërritur përpara meje në Londër! Jam i sigurt që shumë shqiptarë këtu janë gëzuar, por ka prej atyre që më presin me skepticizëm, për shkak të afinitetit tim politik dhe natyrisht mbiemrit që mbaj. Unë desha t'i takoja të gjithë dhe po filloj me ju si një zë shumë i fuqishëm i medias dhe i bashkësisë shqiptare këtu. Jeni i ftuar për një kafe në rastin më të parë të mundshëm në mënyrë që të njihemi nga afër."

U ndamë miqësisht nga telefoni dhe të nesërmen pimë kafe në zyrën time. Biseda ishte tërësisht vëllazërore, por ajo që predominoi ishte:

"Unë kam ardhur në Londër si përfaqësues i Shtetit Shqiptar, jo i Partisë Demokratike, pavarësisht se ajo është në pushtet sot. E ndiej veten thjesht dhe vetëm përfaqësues të shtetit. Prandaj kam dëshirë që çdo gjë që do ta bëj në këtë zyrë, sa kohë që do të jem këtu, ta bëj me djemtë dhe vajzat *shqiptare,* duke e theksuar këtë fjalën e fundit, jo me djemtë dhe vajzat demokrate, socialiste,

republikane apo monarkiste! Është e drejta e secilit që në jetën e tij të besojë ku të dëshirojë, siç e kam edhe unë atë të drejtë. Në ballë të kësaj ambasade valëvitet vetëm një flamur – Flamuri Ynë Kombëtar Shqiptar!"

Ajo që pasoi atë bisedë është puna e përbashkët për të mirën e kombit tonë pa asnjë lloj divergjence apo afërsie politike me asnjë palë, madje as me debate të thjeshta. Ajo punë është pasqyruar në këtë libër dhe nuk ka vend për t'u përmendur më. Në fakt të gjithë çfarë është vënë në evidencë në këtë libër është transmetuar edhe në kanalin televiziv Top Channel.

Falë zotit Manaj! Pa koment!

Kur po e mbyllja punën me këtë libër, iu kërkova shumë miqve të mi nga një prononcim. Ato gjenden nëpër faqet e librit ndërsa atë të Ben Manajt dëshiroj ta vendos në fund: Ai më dërgoi shkrimin e mëposhtëm me kërkesën ultimative:

"Nëse e vendos shkrimin tim në librin tënd, nuk dua ta ma prekësh të drejtën e autorit!"

Kështu që unë po e vendos këtu tekstin e letrës. Në fakt nuk e mbajta fjalën në lidhje "me të drejtën e autorit" pasi fjalët e tij e tejkalonin masën. Dhe prapë se prapë mbetën disa nga teprimet e z. Manaj. Në fund të fundit, ai ashtu e ka ndier, ashtu e ka shkruar, ndërsa unë po e botoj deri diku të censuruar.

MË KA MARRË MALLI

Ben Manaj ish gazetar i BBC
Londër, Shkurt 2021

Më ka marrë një mall kadarean për Ambasadën Shqiptare në Londër! Për gjithçka! Siç të merr malli kur je larg shtëpisë tënde prej vitesh, edhe pse jetoj në të njëjtin qytet! Jo aq për muret dhe orenditë e Ambasadës, sesa për një mik që e patëm për ca kohë aty!

Për atë mikun me të cilin më ndante një *Mal* i tërë bindjesh politike, por s'kishte *Mal* që të na ndante dhe të na ndalte për të qenë vëllezër shqiptarë! Për të ndier të njëjtën atdhedashuri, që vetëm kur jeton jashtë e kupton sesa e fortë është ajo. Për ta trajtuar bashkëkombësin tënd siç e përshkruan Pasaporta Mbretërore Shqiptare e kohës së Zogut:

> *"Çdo shqiptar asht vllau i yt: Nderoje kurdoherë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë. Dashnija për atdhe ndihet ma shumë në mërgim"*

Më ka marrë malli pikërisht për atë që solli zyrën e lëshimit të pasaportave shqiptare për ne ishullorët britanikë!

Më ka marrë malli ta vizitojmë së bashku më 17 janar bustin e Skënderbeut, Mbrojtësin e Qytetërimit Perëndimor që shkëlqen në Londër e që është absolutisht trashëgimi e hipotekuar e tij.

Më ka marrë malli për veprimtaritë e përjavshme, që nga përurimet e librave të Sir Nol Malcolm - it tek, ato të autorëve shqiptarë; Për "Apologjinë e Vërtetë të Sokratit" të luajtur me aq mjeshtri përpara audiencës me shijet më

të larta për teatrin, përpara anglezëve, luajtur nga Mirush Kabashi; për koncertet në sallat më prestigjioze të Londrës, Royal College of Music dhe King's Place, ku interpretuan divat tona të muzikës si dhe tërë artistët e shquar shqiptarë të Britanisë së Madhe, bashkë me artistët anglezë; për dekorimet e lordëve, miqve tanë dhe të Shqipërisë; për takimet mbretërore në Manson House, apo festat kombëtare në Hotelin Corinthian ku ne shqiptarët edhe midis aristokratëve anglezë, ndiheshim krenarë për identitetin tonë; për leksionet në Universitetet, Sinagogat, Foreign Office – in e deri edhe në Ambasadën Amerikane; Për promovimin e Besës dhe Trashëgimisë së pashoqe të popullit tonë.

E të mendosh se më ka marrë malli për njeriun, miqësia me të cilin mund të dukej më e "panatyrshmja" brenda natyrshmërisë së bashkëpunimit dhe qasjes për të promovuar, bashkëpunuar apo kontribuar gjithsecili sa mundej, edhe me gjënë më të vogël, për shqiptarët, Shqipërinë dhe Kosovën!

Më ka marrë malli, pa mëdyshjen më të vogël, siç e pranojnë të gjithë, pasi pavarësisht se me të mund të mos mendonim njësoj, prapëseprapë ndiheshim shumë, ama shumë shqiptarë, të përfaqësuar denjësisht në Londër. Përfaqësoheshim nga një shqiptar që na mungon përmallshëm!"

"PUSHTETI I BUTË" I PUNËS KULTURORE PROMOVUESE I NJË AMBASADORI

Shkrimet e dy gazetarëve shumë të njohur shqiptarë.

Petrit Kuçana
Botues i gazetës "The Albanian"

"Në fillim - vitin 2012, ishin jo të pakta kronikat e zeza për shqiptarët e Britanisë. Duhej një nxitje, një shtysë, një frymëzim nga ana e përfaqësisë tonë në Londër që të na mobilizonte që këtë hije të keqe ta davaritnim dhe në vend të saj të vinim në pah me tërë shkëlqimin e vet, elementet më të mirë të bashkësisë sonë shqiptaro – britanike. Kështu filloi, u ngjiz dhe u afirmua rubrika "Udhëtimi Im" e cila pasqyronte suksesin e shumë individëve, të cilët i bënin dritë emrit tonë shqiptarë.

E filluam me identifikimin e atyre që konsiderohen si përfaqësuesit më të mirë të vlerave shqiptare në ishull dhe pasqyrimin e rrugëtimit të tyre. Shpejt u "zbuluan" doktorët e shkencave të këtushëm, profesorët e universiteteve dhe sipërmarrësit shqiptarë me tërë historitë e tyre fantastike. Më pas edhe fituesit e çmimeve britanike dhe ndërkombëtare. E ku më mirë se në ambasadë mund të bëhej promovimi i tyre!? Aty e "gjetëm" vendin e ngrohtë dhe mikpritës.

Në kujtesën e shqiptarëve të Britanisë të asaj periudhe del se ishte e pamundur që të kalonin dy javë që në Ambasadë të mos kishte një aktivitet, duke e shndërruar atë në një qendër të kulturës shqiptare.

Shumë shpejt u pa se mjediset e Ambasadës ishin "të ngushta" për idetë krijuese që vlonin aty, me qëllim prezantimin e vlerave më të mira shqiptare. Frymëzimi ynë rridhte që nga realizimi i një ëndrre të kahershme, që ishte

vendosja e bustit të Skënderbeut. Ne shqiptarët e Londrës i dinim vështirësitë e pafundme për realizmin e kësaj ëndrre dhe ishim mësuar me premtimet e çdonjërit që vinte e shkonte në Ambasadën tonë. Po ja që një ditë e pamë atë bust të ngrihej krenar në mes të Londrës, vendi i nderit dhe krenarisë sonë kombëtare.

Më pas veprimtaria u zgjerua deri në qendrën më të madhe lindineze, "O2".

U mësuam edhe me "Notes on Albania" ku performuan yjet shqiptare të botës, Inva Mula, Ermonela Jaho etj., etj., pa përfshirë dhjetëra e dhjetëra simpoziume, ekspozita në Shtëpinë e Evropës në Londër, konferenca me lordë e deputetë britanikë etj, që çdo media do të dëshironte t'i kishte për t'i pasqyruar. E padyshim ne ishim të privilegjuar t'i raportonim në mediat tona. Ngadalë po mësoheshim me zbatimin në praktikë të teorisë "Soft Power" që po e zbatonte asokohe Ambasada jonë e dashur.

A ishte "Soft Power" "mjeti" me fuqinë më të jashtëzakonshme për ndryshim? Kjo është tashmë e vërtetuar në Londër madje vazhdon të shkëlqejë edhe pas kaq vitesh. Shkëlqen jo thjesht si teori moderne e zbatuar në ato vite, 2012 – 2015 por duket se do të mbetet edhe rruga, mënyra se si mund dhe duhet të bëhen shumë gjëra, në diplomacinë tonë publike, kulturore, promovuese e njohëse të vlerave tona.

NJË SHËNIM PËRMBYLLËS PËR LIBRIN

Ilirian Agolli

Korrespondent i Zërit të Amerikës (VOA)

Në këto faqe shënimesh, autori shfaqet krejt njerëzor dhe krejt shqiptar, po aq sa edhe një diplomat profesionist në detyrë, duke dëshmuar transformimet e mëdha të diplomacisë dhe të kombit shqiptar në dekadat midis dy shekujve, gjatë tranzicionit demokratik dhe çlirimit kombëtar. Pamjet që sjell, janë shpesh larg syve të njerëzve, të fshehura si mekanizmi prapa fushës së orës, të cilës i shihen vetëm akrepat e kohës, por jo ingranazhet dhe kurdisësi i tyre.

Autori rrëfen me sinqeritet zhvillimet ashtu si i kaluan para syve dhe lanë gjurmë mbi jetën e tij, i vetëdijshëm se ishte njëkohësisht aktor dhe spektator në to. Ai shpërfaqi gjerësisht dashurinë e tij të thellë për kombin e vet, për Kosovën dhe Shqipërinë, një dashuri pa të cilën ai kurrë nuk do të ishte një diplomat i suksesshëm. Përkushtimi dhe vetëdija për detyrat shtetërore dhe kombëtare arrijnë në nivele sipërore në gjithë periudhën e mandatit të tij diplomatik.

Stili i tij rrëfimtar është i lehtë dhe i ngrohtë, me fjalor të pasur shqip, tipar kryesor i patriotëve të ditur, që donin Atdheun me një pasion vetëmohues. Libri mbështillet fund e krye nga një patriotizëm i ëmbël romantik, siç na ka marrë malli prej shumë kohësh ta shohim dhe tepër rrallë e gjejmë në shkrime historike të kësaj natyre, aq më pak tek autorët diplomatë.

Si diplomat dhe Ambasador ai e ka zgjidhur me kohë mëdyshjen e njohur midis ndjenjave dhe detyrave dhe gjatë shërbimit diplomatik ishte në kohën dhe vendin e duhur për ta zbatuar atë me përulësi të admirueshme. Ai e dinte fort mirë se ndjenja për kombin ishte detyra e tij dhe se detyra për kombin ishte

ndjenja e tij më e lartë.

Ajo që autori sjell me këtë libër, është se kombin nuk mund ta duash në boshllëk pa i bërë shërbime, por as detyrat burokratike nuk mund t'i kryesh me sukses ndaj kombit pa e dashur fort atë.

Ky libër meriton të lexohet me vëmendje të madhe për të ndjekur me kujdes këtë leksion, në shërbim të kombit dhe kulturës kombëtare.

LAMTUMIRË!

Më 10 nëntor 2015 e dorëzova detyrën në zyrën Ministrit të Jashëm të atëhershëm të Republikës së Shqipërisë, bashkë me materialet e rëndësishme, që mendoja se i vlenin shtetit shqiptar.

Njësoj si më 25 shtator 1997, edhe kësaj radhe, kisha hartuar një material të gjerë, në të cilën mishëroheshin lidhjet tona diplomatike me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandën e Veriut dhe Republikën e Irlandës.

Në dalje nga zyra m'u kujtuan vargjet e poetit të madh anglez, George Gordon Byron, kur u largua nga Anglia:

E PRA, LAMTUMIRË!
E NË QOFTË SE PËRGJITHMONË:
LAMTUMIRË, PËR GJITHMONË!

SHTOJCË

KRONIKË E VEPRIMTARIVE DIPOMATIKE, 1358 DITË NË LONDËR

2012 - 2015

17 shkurt 2012: Pjesëmarrje në pritjen e Ambasadës së Republikës së Kosovës me rastin e 4-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë në Hotel Corinthia, Whitehall, Londër.

14 mars 2012: Ambasada organizoi një veprimtari në bashkëpunim me Shoqërinë Anglo-Shqiptare (AAA) dhe me Ambasadën e Kosovës në Londër për hapjen e siparit të një sërë aktivitetesh, që do të organizoheshin në Londër me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, përvjetor që përkon edhe me 100-vjetorin e vet Shoqërisë.

13 prill 2012: Në Ambasadë u prit një grup fëmijësh shqiptarë, të shoqëruar nga drejtori i shoqatës "Nënë Tereza", z. Esat Braçe, dhe mësueset e gjuhës shqipe të kësaj shoqate. Fëmijëve iu fol për rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe dhe për punën e mirë të prindërve dhe mësuesve që i transmetojnë këtij brezi shqiptarësh të lindur në Britani vlerat e kombit dhe të identitetit tonë.

19 prill 2012: Ambasada në bashkëpunim me IBDE organizoi Forumin Ekonomik Shqipëri - Britani. Shqipëria është portretizuar nga gazeta "The Guardian" si një nga vendet më të bukura në botë për t'u vizituar, veçanërisht prej Butrintit, ndërkohë që "Lonely Planet" e quan Shqipërinë si destinacionin numër një në botë për vitin 2011.

20 prill 2012: AAA, (Anglo Albanian Association) në bashkëpunim me Ambasadën organizuan një takim me Gilain Gloyer për të promovuar librin e saj të ripunuar "Albania Revisited". Në atë libër autorja thotë se Shqipëria është një ndër vendet më të mrekullueshme për t'u vizituar në shekullin e 21-të.

12 maj 2012: Teatri Kombëtar Shqiptar dha shfaqje për herë të parë në historinë e tij 70 - vjeçare në "Shakespeare's Globe Theatre", në Londër. Trupa luajti "Henry VI", të Shekspirit nën regjinë e Adonis Filipit si pjesë e "Triologjisë Ballkanike".

16 maj 2012: Ambasada në bashkëpunim me AAA, Qendrën për Studime Shqiptare në Londër dhe Shtëpinë Botuese "IB Tauris Publishers", organizuan përurimin e librit "*The Birth of Albania*" (Lindja e Shqipërisë) të autores Nicola Guy. Libri jep një pasqyrë të gjerë sesi Shqipëra erdhi në jetë si shtet pas rënies së Perandorisë Osmane.

27 korrik 2012: Me rastin e ceremonisë së hapjes së Lojërave Olimpike - "London 2012", Ambasada organizoi një pritje për Ekipin Olimpik Shqiptar. Në pritjen e organizuar me këtë rast morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë Prof. dr. Sali Berisha me zonjën Berisha, Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, lordë dhe deputetë të Parlamentit Britanik.

27 korrik 2012: Kryeministri Berisha u prit në një takim të veçantë, në mjediset e Pallatit Mbretëror, në Londër (Buckingham Palace), nga Madhëria e Saj Mbretëresha Elizabeth II dhe Kryeministri i Britanisë së Madhe z. David Cameron.

23 korrik 2012: Në Fshatin Olimpik të "London 2012" u zhvillua ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar me pjesëmarrjen e sportistëve, sportdashëve, titullarëve dhe diplomatëve të Ambasadave të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Republikës së Kosovës.

17 gusht 2012: Bashkë me diplomatin, studiuesin dhe historianin Bejtullah Destani u bë një vizitë në Arkivën Historike të Kantonit Somerset në Angli, aty ku u gjetën dokumente me rëndësi për historinë e vendit tonë. Në arkiv gjendet një fond i veçantë i dokumenteve të kolonelit anglez Aubrey Herbert,

ish-deputet i parlamentit britanik, studiues dhe folës i gjuhës shqipe, i njohur për veprimtarinë e tij në dobi të çështjes shqiptare. Diplomatë të dy ambasadave vizituan shtëpinë, ku kishte jetuar Koloneli Herbert.

10 shtator 2012: Studiuesi i mirënjohur dhe Drejtor i Institutit për Studime Shqiptare në Londër, z Bejtullah Destani mbajti një ligjëratë rreth historisë së Shoqërisë Anglo – Shqiptare dhe disa prej botimeve të Qendrës për Studime Shqiptare në Londër. Ky Institut ka botuar mbi 38 libra të autorëve britanikë rreth Shqipërisë dhe botës shqiptare në përgjithësi. Anëtarë të kësaj qendre studimore janë: Ismail Kadare, Sir Noel Malcolm, dr. Robert Elsey, dr. Elez Biberaj, prof. Nicolas Pano, prof. Ferit Hudhri etj.

19 shtator 2012: Ambasada në bashkëpunim me AAA organizoi një bisedë të ilustruar me Neil Rees me titull, "*Mbreti Zog në Mërgim*". Libri tregon jetën e Mbretit Zog në Buckingamshire në vitet e mërgimit në Angli.

17 tetor 2012: Ambasada në mjediset e veta organizoi në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë një Ditë të Shijimit të Verërave Shqiptare.

18 tetor 2012: Në Dhomën e Komunave në bashkëpunim me anëtarin e Parlamentit Britanik z Adam Holloway, u organizua një mbrëmje për testim verërash. Aty morën pjesë prodhuesit e verërave nga Shqipëria dhe Kosova si; *Arbëri, Bardha, Çobo, Skënderbeu, Kokomani* dhe *Stone Castle* dhe u servir verë autoktone shqiptare si *Shesh i Bardhë* dhe i *Zi*, *Mereshnik*, *Mjaltëz*, *Serine* etj.

16 nëntor 2012: Në mjediset e Ambasadës u inaugurua ekspozita "100 Vjet Filateli Shqiptare", dhe "Koleksion librash për Skënderbeun", një bashkëpunim i Postës Shqiptare dhe koleksionistes angleze të librave për Skënderbeun, Patricia Nugee. Aty u ekspozuan 70 seri pullash postare në nderim të përvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 800-vjetori i shtetit të Arbrit, emisionet për Nënë Terezën, kostumet kombëtare shqiptare apo emblemat e ndryshme. Kjo ekspozitë festoi edhe 100-vjetorin e themelimit të Postës Shqiptare, e cila ishte një nga institucionet e para që ngriti qeveria e Ismail Qemalit.

22 nëntor 2012: Ambasada dhe Wiener Library, Londër, organizuan aktivitetin mbi historinë unike të shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri gjatë Hollokaustit,

në mjediset e kësaj biblioteke. Ishin të pranishëm organizatorët e këtij aktiviteti, diplomatët shqiptarë si dhe z. Ben Barkow, Drejtor i Bibliotekës Wiener, qendër e specializuar e studimeve për genocidin. Të ftuar nderi në këtë mbrëmje ishin Ambasadori i Shtetit të Izraelit në Mbretërinë e Bashkuar, z. Daniel Taub dhe Dr. Liri Berisha, Presidente e Fondacionit "Nënë Tereza". Në qendër të kësaj mbrëmjeje kulturore ishte Prof. Scarlett Epstein OBE, e cila ishte një dëshmi e gjallë e mikpritjes shqiptare dhe kujdesit, që shqiptarët kanë treguar për hebrenjtë gjatë periudhës së Luftës II Botërore. Aty u shfaq dokumentari: "*Shqipëria shpëtoi jetën time*" si dhe në dëshminë e vetë znj. Epstein e ka pasqyruar edhe në librin e saj "Të notosh kundër rrymës".

23 nëntor 2012: Në bashkinë e qytetit Galway të Irlandës u hap ekspozita fotografike "100 Vjet Pavarësi e Shqipërisë". Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë komuniteti shqiptar në Galway i drejtuar nga bashkatdhetari ynë, z Ndrekë Gjini. Përshëndetën edhe Nënkryetari i Parlamentit të Irlandës, deputeti Michael Kitt dhe Dr. Jack McCann, President i Shoqatës "Miqtë Irlandezë të Shqipërisë". Kjo shoqatë ka patur bashkë-themelues të saj edhe Presidentin e sotëm të Irlandës, z Michael D. Higgins.

23 nëntor 2012: Lordi Alan Watson i mundësoi Ambasadës nëpërmjet një sponsorizimi nga British Petroleum që në Muzeun e Westminster Abbey të zhvillohej një ceremoni në kujtim të Nënë Terezës. Veprimtaria u nderua nga autoritetet më të larta të Kishës Anglikane, parlamentarë britanikë, diplomatët e Ambasadave të Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, diplomatë, miq të Shqipërisë. Kjo veprimtari organizohej nga Fondacioni Kulturor "Nënë Tereza", nën kujdesin e Presidentes dhe themelueses, Dr. Liri Berisha.

25 nëntor 2012: Ambasada, në përpjekjet e saj për të treguar harmoninë fetare të kombit tonë, pati nderin të ndiqte një meshë në kuadër të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në mbrëmjen e datës 25 nëntor, 2012, në Kishën e Apostujve të Shenjtë në Pimlico, për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

26 nëntor 2012: Ambasada, për nder të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, organizoi pritje zyrtare për trupin diplomatik në Hotel Corinthia. Në pritje merrnin pjesë rreth 350 të ftuar ndër ta Marshalli i Mbretëreshës z. Charles

Grey, ambasadorë, diplomatë, anëtarë të Dhomës së Komunave dhe të Lordëve, përfaqësues të FCO, miq të Shqipërisë, bashkatdhetarë me banim në Britaninë e Madhe. Për këtë me datë 6 janar 2013 Revista "*Embassy"*, organ i pavarur që pasqyron jetën e trupit diplomatik në Londër, i kushtoi një reportazh fotografik kësaj pritje.

28 nëntor 2012: Për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së vendit tonë, në Londër u vendos Busti i Skënderbeut, në adresën: 113 Inverness Terrace, London W2 6JH. Vendosja e këtij busti është fryt i një pune këmbëngulëse disamujore të Ambasadës Shqiptare në Londër, Westminster City Council, të ndihmuar bujarisht nga miku i dëshmuar i Shqipërisë, z. David Lloyd. Skulptura është vepër e skulptorit tashmë të njohur, Kreshnik Xhiku.

29 nëntor 2012: Në mjediset e *Foreign and Commonwealth Office* u mbajt një tryezë e rrumbullakët, ku u diskutua mbi 100 vjet të historisë së marrëdhënieve midis Britanisë së Madhe dhe shtetit shqiptar. Organizimi i tryezës u bë në bashkëpunim të ngushtë mes Ambasadës Shqiptare në Londër dhe Departamentit për Ballkanin Perëndimor dhe Zgjerimin Evropian në *Foreign Office.* Diskutimet i drejtoi z. Owen Jenkins, Drejtor për Ballkanin Perëndimor dhe zgjerimin e BE-së. Tryeza e rrumbullakët u hap nga Ministri për Evropën, z. David Lidington. Nga pala shqiptare ishin të pranishëm znj. Edith Harxhi, Zv. Ministre e Punëve të Jashtme, dhe i gjithë stafi i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës.

5 dhjetor 2012: Shoqata e studentëve shqiptarë "LSE Albanian Society" organizoi një takim të hapur në London School of Economics (LSE) me rastin e 100-Vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Veprimtarinë e drejtoi dr. Arjan Gjonçaj, pedagog në LSE. Diplomatët shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova folën mbi "Aftësitë shtet-formuese të shqiptarëve në kushtet e mungesës së shtetit të tyre" duke nënvizuar se shpallja e pavarësisë nuk erdhi dhe as u zhvillua në një truall bosh. Përkundrazi.

12 dhjetor 2012: AAA dhe Ambasada organizuan në mjediset e ambasadës një veprimtari mbi artistin britanik Edward Lear dhe udhëtimin e tij në Shqipëri në vitin 1848. Gjatë mbrëmjes u shfaq dhe u diskutua filmi dokumentar "*An*

Exile in Paradise. The Adventures of Edward Lear" i regjisorit Derek Smith.

16 janar 2013: Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, dhe homologu i tij britanik z. Jeremy Wright nënshkruan gjatë një takimi në Londër marrëveshjen bilaterale për transferimin e personave të dënuar.

17 janar 2013: Në kuadër të përkujtimit të 545-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, Ambasadorët dhe diplomatët e Ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës në Londër, Shoqatës AAA dhe të bashkësisë shqiptare, miq të Shqipërisë, u mblodhën pranë bustit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Ky tubim synonte të shënonte fillimin e një tradite, e cila do të vijohet çdo vit në përkujtimin e heroit tonë kombëtar.

20 janar 2013: Mbahet një kumtesë me titull: "BESA Shqiptare dhe Historia e Judaizmit në Shqipëri" gjatë Ditës së Përkujtimit të Hollokaustit në Universitetin Middlesex. Kjo veprimtari u organizua nga Worshipful Mayor of Barnet, Councillor Brian Schama. Shqipëria u cilësua vendi i 69 fisnikëve midis kombeve të gdhendur në Memorialin e Yad Vashemit.

23 janar 2013: Në mjediset e Ambasadës u përurua libri "*Charles Telford Erickson - Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë*" i autorit Mal Berisha. Morën pjesë Ambasadorët e Sllovenisë, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë diplomatë nga Ambasada Amerikane, Bosnja e Hercegovina, Moldavia, si dhe rabinë nga bashkësia hebraike, dhe përfaqësues të bashkësisë shqiptaro - britanike nga shoqata Anglo - Shqiptare dhe shoqatat e tjera.

27 janar 2013: Diplomatët e Ambasadës nderuan piktorin shqiptar Petraq Pecani, i cili mori pjesë në Bienalen e Londrës, midis 140 artistëve nga e tërë bota, në sallën e Bashkisë Chelsey. Ai ekspozoi punimet e tij të quajtura "*Mëngjes në Sotir",* dhe *"Mëhalla e vjetër".*

3 shkurt 2013: Ambasada ftoi për një vizitë në mjediset e saj këngëtaren e njohur britanike, e lindur në Prishtinë, Rita Ora. Qëllimi i kësaj ftese ishte t'i shprehej këngëtares së re e shumë të famshme, e cilësuar si më e mira e vitit 2012 në Britaninë e Madhe, mirënjohje për atë që ajo ka arritur jo vetëm në

planin individual, por edhe në promovimin që iu ka bërë vlerave të kombit shqiptar nëpër botë. Asaj iu shpreh mirënjohja e thellë për pjesëmarrjen e saj në festimet e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në koncertin madhështor të organizuar në Sheshin "Nënë Tereza" më 28 nëntor 2012.

10 shkurt 2013: Ambasada përuroi Konsullatën e Nderit në Oxford, me Konsulle Nderi znj. Bryony Bethell. Ajo ka në juridiksionin e saj rajonet e Oxfordshire, Berkshire, Wiltshire and Gloucestershire. Diplomatët i dorëzuan asaj Ekzekuaturën e qeverisë shqiptare.

10 shkurt 2013: Takim me studentët shqiptarë që studiojnë në universitetet dhe kolegjet e qendrës më të madhe të edukimit në Britaninë e Madhe, në Oxford. Në këtë takim ishte gjithashtu e pranishme zv/Ministrja e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, znj. Edith Harxhi.

15 shkurt 2013: Zonja Majlinda Bregu, Ministre e Integrimit Evropian të Republikës së Shqipërisë, zhvilloi një takim me Ministrin britanik të Çështjeve Evropiane, z. David Lidington, në Ministrinë e Jashtme Britanike.

16 shkurt 2013: *International Business and Diplomacy Exchange* (IBDE), në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve për Evropën Juglindore në Universitetin e Oxford-it (SEESOX), organizuan Konferencën "Vlerësimi i zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor: Përparimi dhe Sfidat".

23 shkurt 2013: Diplomatët shqiptarë në Londër përgëzuan ushtarët britanikë, të cilët kaluan gjashtë ditë në Tiranë për të marrë pjesë në festimet e 100-vjetorit të Pavarësisë, në qendrën e tyre ushtarake në Windsor atyre iu dorëzuan çertifikata nderi, të lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Shqiptare.

26 shkurt 2013: AAA dhe Ambasada organizuan një takim në mjediset e Ambasadës me Dr. Roderick Bailey, i cili mbajti një kumtesë me titull *"SOE në Shqipëri"* - Tregime nga arkivat britanike. Dr. Bailey dha një tablo shumë interesante të fillimit të shkarkimit të britanikëve në Shqipëri.

27 shkurt 2013: Violinistja shumë e njohur shqiptare me banim në Britani Alda Dizdari promovoi bashkë me Orkestrën e Lehtë Simfonike, CD-në e saj të radhës në Galerinë Menier në Londër. Morën pjesë diplomatë të Ambasadës

Shqiptare, Ambasadori i Finlandës dhe mjaft diplomatë të vendeve tjera si dhe dashamirës të artit muzikor.

21 mars 2013: Kryetarja e Kuvendit, zonja Jozefina Topalli u prit në një takim të veçantë nga Kryetari i Dhomës së Komunëve, z. John Bercow, ndërsa Kryetarja e Dhomës së Lordëve në Britaninë e Madhe, Baronesha D'Souza, i shtroi asaj një drekë pune. Të dy zonjat shprehën dëshirën për të punuar së bashku dhe për të bërë hapa konkrete në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit jo vetëm midis dy parlamenteve, por edhe më tej.

21 mars 2013: Ambasada e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës bashkë me AAA organizuan në mjediset e Ambasadës prezantimin e librit: "Çështja shqiptare në diplomacinë britanike, 1877 - 1880" të autorit shqiptar nga Kosova, z. Daut Dauti.

7 prill 2013: Ambasadori shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar mori pjesë në natën përkujtimore të Yom Hashoah - të quajtur 'Një Mbrëmje Përkujtimore në Sinagogën Pinner" në rastin 70 vjetorit të Kryengritjes në Geton e Varshavës. Tema e mbrëmjes ishte "Resistence and Rescue". Folësi i parë i mbrëmjes ishte Ambasadori i Polonisë në Mbretërinë e Bashkuar SH.T. Z. Witold Sobkow dhe më pas fëmijët e të mbijetuarve të Getos Polake, Janine Webber and Lili Stern-Pohlmann. Ishin të pranishëm, Ambasadorët e Shqipërisë, Gjermanisë, Polonisë, Hungarisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Austrisë.

17 prill 2013: Kryeministri Berisha mori pjesë në ceremoninë zyrtare funebre të ish - kryeministres britanike Margaret Thetcher, një nga figurat politike dhe shtetarët më të shquar në historinë jo vetëm të Britanisë së Madhe, por edhe të mbarë botës

17 prill 2013: Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dr. Sali Berisha, pas funeralit të Baroneshës Thatcher, në Katedralen e Shën Palit, bëri një vizitë te monumenti i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe vendosi një kurorë lulesh në shenjë nderimi për heroin.

23 prill 2013: Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak me Britaninë e Madhe, me ftesë të palës britanike, një grup ushtarakësh shqiptarë, i përbërë nga Kolonel

Roland Berzani, Atashe Ushtarak në Londër, N/Kolonel Ilirjan Dauti, Oficer Shtabi në Drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm dhe Kapiten Lejtnant Emrush Bejdo nga Forcat Detare, morën pjesë në rolin e vëzhguesve në stërvitjen "Joint Warrior 2013", e cila u zhvillua në Skoci. Gjithashtu, në stërvitje mori pjesë edhe Atasheu Britanik në Shkup, N/Kolonel Phil Osment.

26 prill 2013: Diplomatët e Ambasadës morën pjesë në një meshë të veçantë ceremoniale në Kishën italiane të Shën Pjetrit në Londër, të cilën e mbajti Eminenca e Tij, Kardinal Renato Raffaele Martino, Priori i Madh i Urdhrit të Shenjtë Konstandinian të Shën Gjergjit, Presidenti Emeritus i Këshillit Papnor të Drejtësisë dhe Paqes dhe Këshillit Papnor për Migrantët, një nga figurat më të shquara të Vatikanit. Kjo meshë organizohej nga Delegacioni i Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës i Urdhrit Kostandinian të Shën Gjergjit, i kryesuar nga Sir Anthony Bailey, OBE, me rastin e ditës së Saint George, shenjtorit protektor të Anglisë. Ambasadorit të Shqipërisë z. Mal Berisha, iu dorëzua nga Kardinal Martino titulli "Commendatore" i Urdhërit Mbretëror të Franceskut dhe dekorata kalorësiake përkatëse.

30 prill 2013: Ambasada dhe AAA organizuan në sallën e Ambasadës shfaqjen e filmit "Koncert në Vitin 1936". Pas shfaqjes së filmit vijuan biseda rreth filmit dhe subjektit të tij.

15 maj 2013: Në mjediset e *UCL*, AAA organizoi një takim me Ambasadorin Britanik në Tiranë, z. Nicholas Cannon. Ai dha një pasqyrë të situatës momentale në Shqipëri dhe theksoi se Britania e Madhe është një vend mik i Shqipërisë e se do të vazhdojë të mbështesë vendin tonë në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.

16 maj 2013: Në mjediset e Arena O2 në Londër, u festua 9-vjetori i themelimit të gazetës *"The Albanian*", gazetë e bashkësisë shqiptare në Britaninë e Madhe e drejtuar nga gazetari dhe publicisti Petrit Kuçana, si dhe përurimi i albumit "*100 Shqiptarët e Britanisë*". Në këtë veprimtari, përveç miqve britanikë, morën pjesë edhe drejtuesit dhe stafet e dy Ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës. Po ashtu morën pjesë edhe drejtues të komunitetit shqiptar në Britaninë e Madhe.

22 maj 2013: Në mjediset e Ambasadës, dr Eckehard Pistrick, lektor në Etnomuzikologji nga Universiteti i Martin Luther Halle, mbajti një ligjeratë mbi këngën polifonike shqiptare. Ai shfaqi një përmbledhje nga filmi i tij dokumentar *"Polifonia - zërat e harruar të Shqipërisë"*. Në vitin 2005, UNESCO shpalli iso-polifoninë "një kryevepër e trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit".

23 maj 2013: Lord Mayor i Londrës, Alderman Roger Gifford, i cili është 685-ti në atë detyrë, ka nderuar Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha me titullin *Qytetar i Lirë i Londrës (Freeman of London)*.

23 maj 2013: Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha gjatë vizitës së tij në Londër bëri një vizitë në Ambasadën Shqiptare. Në një ceremoni zyrtare ai nderoi me medaljen *"Mirënjohja e Tiranës",* ish-Lordin Mayor of the City of London, Sir Gavyn Arthur dhe Delegatin e Urdhrit të Kostandinit për Britaninë e Madhe dhe Irlandën, Sh.T. z. Anthony Bailey.

31 maj 2013: Në Ambasadë u themelua rrjeti *UK Albanian Professionals (UKAP)*. Ky rrjet përbëhet nga profesionistë shqiptarë në profesione të ndryshme, kryesisht në industrinë financiare në Londër, por edhe në fusha të tjera si arkitekturë, informatikë etj.

9 qershor 2013: Në Ambasadë filloi procesi i pranimit të aplikimeve për pasaportën dhe kartën biometrike shqiptare. Hapja e zyrës kryhet në vijim të kujdesit, që shteti shqiptar tregon ndaj bashkatdhetarëve tanë të vendosur në vende të ndryshme të Evropës dhe të botës.

27 qershor 2013: Në Bukingham Palace u zhvillua ceremonia e dorëzimit të Letrave Kredenciale të Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut, Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II. Me këtë rast, më 10 gusht 2013 Revista "DIPLOMAT" i kushtoi një artikull të plotë Shqipërisë dhe Ambasadës në Londër. Shkrimi është shkruar nga shefja e redaksisë së revistës, *Venetia de Blocq van Kuffeler.*

4 korrik 2013: Dy artistë të shkëlqyer shqiptarë me famë botërore, sopranoja Ermonela Jaho dhe balerini Kledi Kadiu vizituan Ambasadën e RSH-së në

Londër. Sopranoja Ermonela Jaho ndodhej në Londër për të luajtur rolin e heroinës Magda të operës së Puçinit "La Rondine" nga Royal Opera House në Londër.

14 korrik 2013: Në Dublin të Irlandës u përkujtua Dita e të Rënëve Irlandezë në shërbim të Misioneve të Ndryshme në Kombet e Bashkuara. Në këtë ceremoni merrnin pjesë. përveç autoriteteve vendase, edhe Ambasadorët e akredituar në Dublin, përfshirë Ambasadorin shqiptar si dhe ata që e mbulojnë atë vend nga qendra tjera siç është Londra. Ceremonia, u kryesua nga Presidenti i Irlandës, SH.T. Z. Michael D. Higgins.

17 korrik 2013: Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (FA), Gjeneral Major Xhemal Gjunkshi, me ftesë të homologut të tij britanik, Gjen. David Richards, zhvilloi një vizitë zyrtare në Londër. Ishte i pranishëm edhe Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen, zoti Philip Hammond.

4 gusht 2013: Me nismën e Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar Mal Berisha dhe me praninë e Ambasadorit të Shqipërisë në Itali, prof. Neritan Ceka, dhe bashkinë vendase, në fshatin arbëresh Munxhufun (*Montecilfone)*, Rajoni Molize, Itali, u vendos busti i Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeg, vepër e skulptorit të njohur Kreshnik Xhiku.

10 shtator 2013: Në Ambasadë u organizua një takim me përfaqësues të shoqatave shqiptaro - britanike, që veprojnë në këtë vend. Kryefjalë e këtij takimi, ishte ftesa për bashkëpunim mes palësh për veprimtari kryesisht me karakter kulturor dhe social, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, me ndikim si brenda bashkësisë shqiptaro - britanike ashtu edhe më gjerë.

12 shtator 2013: Në kinemanë "Rich Mix" në Londër u shfaq filmi shqiptar "Nëntori i Dytë". Me nismën e Ambasadës, në bashkëpunim me *Albanian Cinema Project*, Arkivin Qendror të Filmit Shqiptar dhe me mbështetjen e AAA, u organizua një mbrëmje mbi kinemanë shqiptare, arkivin mjaft të pasur të filmit shqiptar si dhe punën që po bëhet për ruajtjen dhe restaurimin e filmave.

13 shtator 2013: Nën kujdesin e Ambasadës Shqiptare në Londër, kompozitorja Roxanna Panufnik udhëtoi në Tiranë për të qenë e pranishme gjatë ekzekutimit

të veprës së saj nga Orkestra e Radio Televizionit Shqiptar me dirigjent Artan Liçaj dhe solist Lorenc Radovani, në sallën e Universitetit të Arteve, *"Katër Stinët e Botës"* që vjen për herë të parë në Shqipëri.

23 shtator 2013: Forcat Detare Britanike dhe Forcat Detare Shqiptare zhvilluan në Shqipëri stërvitjen dypalëshe me emërtimin "Albanian Lion - 13". Kjo ishte stërvitja me pjesëmarrjen më të madhe dypalëshe të zhvilluar ndonjëherë në territorin shqiptar ku morën pjesë mbi 3,000 forca britanike, helikopter-mbajtëset "Bulwark" dhe "Ilustrius", 5 anije të mëdha (fregata, anije amfibe), rreth 35 anije të tjera shoqëruese dhe ndihmese, avionë luftarakë dhe helikopterë.

1 tetor 2013: Ministri i Drejtësisë z Nasip Naço mori pjesë në hapjen e Vitit Gjyqësor të Mbretërisë së Bashkuar i cili fillon me një ceremoni në Westminster Abbey. Në këtë ceremoni marrin pjesë tërë autoritetet gjyqësore të Britanisë së Madhe.

2 tetor 2013: Në Ambasadë, në bashkëpunim me AAA, u organizua një prezantim dhe bisedë mbi librin *"Edith dhe Unë"* i autores britanike Elisabeth Gowing, në praninë e kësaj të fundit.

10 tetor 2013: Ambasadori shqiptar i paraqiti letrat kredenciale tek Presidenti i Irlandës, Sh.T. Z. Michael D. Higgins. Ceremonia u zhvillua në Dublin, në Pallatin e Presidencës Áras an Uachtárain, në praninë e Ministrit Alex White, me përfaqësues të qeverisë irlandeze dhe zyrtarëve të lartë të Presidencës dhe Ministrisë së Punëve Jashtme. Paraqitja e kredencialeve u shoqërua nga një ceremonial i plotë shtetëror protokollar, me ekzekutimin e himnit kombëtar shqiptar nga Banda Ushtarake, me paradë ushtarake dhe parakalim truproje nderi si dhe me një audiencë të veçantë private që Presidenti i dha Ambasadorit.

12 tetor 2013: Ambasada në bashkëpunim me shoqatat shqiptaro - britanike, shkrimtarë dhe lexues që jetojnë në Britaninë e Madhe, organizoi një takim me shkrimtarin Arbër Ahmetaj, me banim të përhershëm në Zvicër.

21 tetor 2013: Në Kishën e Apostujve të Shenjtë në Pimlico, Londër, u mbajt një shërbesë fetare e veçantë në përkujtim të përvjetorit të Lumturimit të Nënë Terezës. Mesha, e cila u kremtua në gjuhën shqipe dhe atë angleze, u udhëhoq

nga Eminenca e Tij, Kardinali britanik Cormac Murphy O'Connor dhe u bashkëkremtua nga At Gary Walsh, prift kanadez, shqipfolës, i cili ka shërbyer dhjetë vjet në Shqipëri.

8 nëntor 2013: Ambasada organizoi një takim me fëmijët më të talentuar të shqiptarëve me banim në Londër. Në qendër të takimit ishte shkrimtari i ri 13-vjeçar, Arlind Mala, i cili ka shkruar tre libra deri tani në gjuhën angleze, dy prej të cilave janë botuar. Ato titullohen "*The Time Machine"* dhe *"The Old Bagger"*.

18 nëntor 2013: Në kinemanë "Triclycle Theatre Kilburn" Londër u shfaq filmi "*Besa - The Promise"*, një produksion amerikan, i cili sjell përpara publikut hebraik të Londrës një histori të jashtëzakonshme të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe hebrenjve gjatë periudhës së Hollokaustit.

17 nëntor 2013: Kryeministri Edi Rama u takua me Kryeministrin Britanik z David Cameron në 10 Downing Street.

26 nëntor 2013: Për te festuar Ditën e Pavarësisë, Diplomatë nga Ambasada shqiptare në Londër ishin të ftuar nga Drejtori i Drejtorisë Arsimore të qytetit Galway. Ata vizituan muzeun e hapur të trashëgimisë së kulturës materiale Bunratty Castle & Folk Park, një qendër e rëndësishme kjo e trashëgimisë së kulturës materiale të Irlandës.

28 nëntor 2013: Me rastin e 28 Nëntorit, përvjetorit të 101-të të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Ambasada dhe AAA organizuan shfaqjen e filmit "Skënderbeu" të shoqëruar nga një koktej festiv. Veprimtaria u zhvillua në sallën kryesore të Ambasadës me pjesëmarrjen e dhjetëra anëtarëve të shoqatës, midis të cilëve Presidenti i saj i nderit profesor Noel Malcolm.

16 dhjetor 2013: Ambasada, në kuadër të veprimtarive të saj për Diplomacinë Kulturore dhe promovimin e vlerave të vendit tonë, organizoi koncertin e titulluar: Notes On Albania. Koncerti u zhvillua në sallën *Amaryllis Fleming Concert Hall* të Kolegjit Mretëror të Muzikës në Londër.

16 janar 2014: Në Pinner Sinagogë, në një nga zonat me numrin më të madh

të banorëve hebrenj në Londër, u organizua shfaqja e filmit dokumentar "BESA" me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman. Më shumë se katërqind pjesëmarrës, prej të cilëve edhe një numër i mirë shqiptarësh me banim në këtë qytet, ndoqën me vëmendje, respekt dhe emocion këtë veprimtari, e cila u hap me fjalën e zonjës Gaby Glassman, Kryetare e Këshillit Organizativ të Sinagogës Pinner.

17 janar 2014: Për herë të dytë, Ambasadat e Republikës së Shqipërisë dhe ajo e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar organizuan një tubim përkujtimor dhe bënë homazhe tek monumenti i Skënderbeut në Londër, i vendosur në nderim të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 2012.

4 shkurt 2014: Ambasada në bashkëpunim me AAA organizoi një mbrëmje për nder të Prof. Noel Malcolm-it, Presidenti aktual i Nderit i Shoqatës. Profesor Malcolm ka marrë nga Madhëria e saj Elizabeth II, titullin Kalorsiak Sir, i cili përbën një ndër nderet më të mëdha dhe titujt më të nderuar, që një individ mund të marrë në Mbretërinë e Bashkuar.

18 mars 2014: Ambasada organizoi takim me përkthyesin e librit të Marin Barletit, *"Rrethimi i Shkodrës"* David Hosaflook. Autori është një amerikan nga Teksasi i ShBA-ve, që jeton prej 23 vjetësh në Shqipëri.

20 mars 2014: Violinistja shqiptare Alda Dizdari luan Sonatat e Bramsit për violinë dhe piano e shoqëruar nga Tom Boch. Ajo interpretoi në një nga sallat më prestigjioze "Cadogan Hall" në Londër.

18 prill 2014: Ambasada organizoi mbrëmjen me titull "TI SHQIPËRI MË JEP NDER" me pjesëmarrjen e bashkatdhetarëve tanë me banim në Britaninë e Madhe. Morën pjesë drejtues shoqatash, mësues, nxënës, intelektualë, botues gazetash etj.

21 maj 2014: Në Sallën e veprimtarive të Ambasadës Shqiptare në Londër, në bashkëpunim me AAA, dr. Agata Filjakowski, Profesore e Kriminalistikës në Universitetin Lancaster, solli për të pranishmit figurën e Musine Kokalarit,

një nga figurat disidente shqiptare më të njohura dhe kundërshtare e regjimit komunist në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

4 qershor 2014: Hapja e Vitit të Ri Parlamentar bëhet me një ceremoni madhështore. Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II, e shoqëruar nga Duka i Edinburgut, Filip, kalojnë mespërmes sallave të Parlamentit për t'u ulur në Fronin Mbretëror në Dhomën e Lordëve. Aty ajo për çdo vit shpalos programin e qeverisë së Saj.

6 qershor 2014: Shkrimtarja e njohur Flutura Açka bëri prezantimin e librave të saj në Ambasadën Shqiptare në Londër në prani të një audience të gjerë lexuesish dhe miqsh të saj. Nëpërmjet prezantimit të librave si dhe përgjigjeve që iu dha pyetjeve nga salla ajo pasqyroi veprimtarinë e saj krijuese ndër vite.

7 qershor 2014: Ambasada dhe AAA organizuan shfaqjen e filmit "Tomka dhe Shokët e Tij", me praninë e aktorit kryesor, Herion Mustafaraj. Merrnin pjesë diplomatë nga Kosova dhe vendet fqinjë, historianë si Sir Noel Malcolm, studiues, gazetarë të revistës "Diplomat" si Elizabeth Stjuart, punonjës të FCO-së etj. Shumica e pjesëmarrësve ishin anglezë.

23 qershor 2014: Ambasada në bashkëpunim me AAA organizoi një veprimtari përkujtimore në nderim të Margaret Hasluck. Lektor i kësaj veprimtarie ishte Dr David Shankland, Drejtor i Institutit Mbretëror të Antropologjisë kushtuar kësaj gruaje të shquar, që i kushtoi jetën Shqipërisë, Margaret Hasluck.

19 qeshor 2014: Ministrja e Integrimit, znj, Klajda Gjosha, zhvilloi një vizitë pune ne Londër. Gjatë kësaj vizite, Ministrja zhvilloi takime me Ministrin e Shtetit për Evropën, z. David Lidington, Ministrin e Shtetit për Drejtësinë dhe Liritë Civile, z. Simon Hughes, dhe Drejtorin e Përgjithshëm për Strategjitë dhe Emigrimin, z. Mike Anderson në Home Office.

12 qershor 2014: Pianistia shqiptaro - britanike zonja Marjela Cingo luajti nën drejtimin e dirigjentit Mike Fago Koncertin Pianistik në La Minor, kompozuar nga Edward Grieg në kuadër të një koncerti të BBC-së për mbledhje fondesh. Zonja Marjela është një ndër ato bashkatdhetare, që i bën nder Shqipërisë.

20 qershor 2014: Ambasada organizoi takim të bashkësisë shqiptare me z. Kastriot Berberi, i pari shqiptar i zgjedhur në organet drejtuese lokale në Britaninë e Madhe. Z Berberi është zgjedhur këshilltar në Bashkinë e Walthamstow Londër. Ambasada i dhuroi atij një Letër Mirënjohje për përfaqësimin denjë të bashkësisë shqiptare në Londër. Cllr Berberi është shpallur gjithashtu Freeman of London.

23 korrik 2014: Televizioni CBBC pjesë e rrjetit të BBC - England, BBC London, BBC 1 West, BBC East, BBC C1, Channel 4 East, dhe BBC World transmetoi intervistat, që iu kishte marrë Ambasadorit të Shqipërisë dhe atij të Kosovës në Londër për përkatësinë shqiptare të këngëtares së njohur Rita Ora. Emisioni mori shkas veçanërisht nga vizita e saj në Ambasadën tonë në Londër dhe pjesëmarrja në festimet e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.

24 korrik 2014: Shoqata Global Woman Network prezantoi revistën "Migrant Woman Magazine" në Universitetin Regent. Po ashtu Ambasada organizoi një veprimtari të bukur me drejtoren dhe botuesen Mirela Sula. Ajo prezantoi librin e saj *"Mos e Ler Mendjen të Ikë*".

9 gusht 2014: Diplomatët shqiptarë morën pjesë në ceremoninë e diplomimit të zonjushës Ana Allani, një vajzë shqiptare e talentuar në një nga shkollat ushtarake më prestigjioze të botës të njohur me emrin "The Royal Military Academy Sandhurst" në Mbretërinë e Bashkuar.

11 gusht 2014: Në mbrëmjen e datës 11 gusht, Ambasada mori pjesë në një koncert të Korit Kombëtar të të Rinjve të Britanisë së Madhe të mbajtur në Katedralen e qytetit Tontown. Koncerti kishte në program këngë të zgjedhura nga disa vende të Evropës, ndër to, tre këngë shqiptare të përpunuara nga kompozitori shqiptar Thoma Simaku.

16 gusht 2014: Ambasada organizoi një takim me diplomatin, historianin, gazetarin dhe studiuesin Robert Wilton. Atë e ndoqën Ambasadorë si ai i Bosnjë Hercegovinës dhe Moldavisë, diplomatë nga Kosova dhe vendet fqinjë, historianë si Sir Noel Malcolm, studiues, gazetarë të revistës "Diplomat" si Elizabeth Stuart, punonjës të FCO-së etj. Robert Wilton foli me një pasion të rrallë për letërsinë shqipe, duke e ilustruar atë me recitime të përkthyera prej tij.

5 tetor 2014: Ambasada organizoi një takim me tenorin e famshëm shqiptar Saimir Pirgu, me bashkatdhetarët në Londër.

11 tetor 2014: Google Map ka vënë në hartën e rinovuar të qytetit Londër, si një shenjë dalluese, bustin e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeg. Ai gjendet në Inverness Terrace - Porchester Gardens - Bayswater - London W26JH.

22 - 23 tetor 2014: Në sallën e Ambasadës u organizua takim me artistin e njohur Mirush Kabashi. Në prani të një audience të gjerë ai intepretoi pjesë nga veprat më të mira të letërsisë, të cilat i ka interpretuar ndër vite. Mbrëmja u organizua në vigjilje të shfaqjes: *"Apologjia Vërtetë e Sokratit",* e cila u luajt në Teatrin "Kings Place" më 23 tetor 2014, nën kujdesin e Ambasadës Shqiptare në Londër.

4 nëntor 2014: Më 3 dhe 4 nëntor 2014 u organizua një Forum Ekonomik midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në Forum morën pjesë shumë biznesmenë, sipërmarrës nga Shqipëria dhe nga MB. Merrte pjesë artisti i madh i Hollivudit më origjinë shqiptare Jim Belushi.

26 nëntor 2014: Për nder të 102 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, Ambasada organizoi Edicionin e Dytë të "NOTES ON ALBANIA" me mbështetjen e Lordit Robert Maclennan Rogart. Veprimtaria u mbajt në Kings Place.

28 nëntor 2014: Të ftuar nga Këshilltari Kastriot Berberi, Ambasadori shqiptar bashkë me një grup drejtuesish vendorë, miq nga Shqipëria, vizituan Bashkinë e Walthamstow në Londër. Z. Kastriot Berberi i pari shqiptar i zgjedhur në Britaninë e Madhe, i priti mysafirët nga Shqipëria dhe bashkë me autoritetet e Bashkisë organizoi ngritjen e Flamurit Shqiptar nën tingujt e Himnit tonë Kombëtar në një ceremoni shumë unike dhe të veçantë.

6 dhjetor 2014: Ambasada organizoi një leksion publik me temë "Intelektuali dhe Mallkimi i Vegjetimit" - "Harresa e Imponuar në Veprën Letrare të Fatmir Terziut" mbajtur nga dr. Gëzim Alpion.

8 dhjetor 2014: Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, dhe Zonja e Parë, Odeta Nishani, u pritën në një takim zyrtar në Clarence House, nga Princi i Wells - it, Charles. Presidenti Nishani dhe Zonja e Parë në prani edhe të Ambasadorit Shqiptar të akredituar në Oborrin e Shën Xhejmsit, patën nderin dhe kënaqësinë të ndanin me Princin e Wells-it mendimet dhe opinionet mbi zhvillimet e ndryshme në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit.

8 dhjetor 2014: Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani, merr pjesë si i ftuar i Nderit në banketin vjetor të Familjes Mbretërore bashkë me 700 anëtarët e Shoqatës së "Njerëzve të Lirë". Ai ishte folësi kryesor i mbrëmjes dhe u prit me një ceremonial protokollar të Manson House, i cili organizohet në të njëjtën mënyrë që prej 800-vjetësh.

9 dhjetor 2014: Në kuadrin e vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bujar Nishani dhe Zonja e Parë, Odeta Nishani, të shoqëruar nga delegacioni zyrtar, vizituan dhe vendosën një kurorë me lule tek busti i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

9 dhjetor 2014: Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, ishte i ftuar nderi në një Mëngjes Pune në Dhomën e Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar, me ftesë të Fort të Nderuarit Lord Alan Watson të Richmondit, një mik i mirë e i nderuar i shqiptarëve dhe Shqipërisë.

9 dhjetor 2014: Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani nderoi personalitete të shquara britanike për kontributin e veçantë e të çmuar në forcimin e miqësisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, si dhe për promovimin e vlerave historike e kulturore dhe të çështjes shqiptare.

10 dhjetor 2014: Instituti i Studimeve Hebraike YIVO me qendër në New York organizoi një takim me historianin dhe rrëfimtarin e BBC, Profesor Simon Schama. Në takim merrnin pjesë edhe ambasadori i Shqipërisë si dhe ajo e Lituanisë prej nga e ka origjinën Arkiva e YIVO-s.

14 dhjetor 2014: Mal Berisha mbajti një prezantim në YIVO Institute of Jewish Research në New York City përpara një audience të gjerë ku të pranishëm

ishin amerikanë, amerikanë - hebrej, shqiptaro - amerikanë, studiues dhe të interesuar për lidhjet e Shqiptarëve me hebraizmin. Ky prezantim dha një pamje të gjerë të asaj se përse në Shqipëri gjatë kohërave më të vështira të Hollokaustit dhe në etapa të tjera nuk u dëmtua asnjë hebre.

17 dhjetor 2014: AAA dhe Ambasada organizuan shfaqjen e filmit të parë të aktorit më të dashur anglez në Shqipëri, Norman Wisdom, "Trouble in Store", prodhim i vitit 1953.

22 dhjetor 2014: Ambasada organizoi koncert pianistik me pianisten e re Tara Neli, para një audience te gjerë bashkatdhetarësh.

23 dhjetor 2014: Ambasadorët e vendeve të ndryshme të akredituara në Oborrin e Shën Xhejmsit shpesh herë nderohen për veprimtarinë e tyre dhe shërbimet, që i kryejnë vendeve të tyre në Londër. Edicioni i fundit i vitit 2014 i kushtoi një vend të gjerë Ambasadës së Shqipërisë.

19 janar 2015: Përfaqësuesi i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës Botërore të Deteve (IMO) Ambasadori Mal Berisha u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të IMO-s, z. Koji Sekimizu, për të depozituar instrumentat e hyrjes së Shqipërisë në Protokollin e Përgatitjes, Përgjigjes dhe Bashkëpunimit të shpejtë ndaj incidenteve të shkaktuara nga lëndët e rrezikshme dhe substancave helmuese.

25 janar 2015: Në Ditën Ndërkombëtare të Kujtesës sëViktimave të Hollokaustit, Ambasadorët e Shqipërisë dhe të Kosovës morën pjesë në mbrëmjen e organizuar nga Qendra Hebraike JW3. Për këtë veprimtari u botua edhe një shkrim në "Jerusalem Post".

12 shkurt 2015: Në Dhomën e Lordëve në Londër, një grup shqiptaro-britanikësh u mblodhën për të marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit nga ana e Ambasadorit shqiptar të dekoratës *"Gjergj Kastrioti Skënderbeu"* akorduar Lordit Anglez Michael Bates nga Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani.

5 mars 2015: Ambasada në bashkëpunim me AAA organizoi prezantimin e librit "Nga Shqipëria në Sicili" (From Albania to Sicily) i autorit Adam Yamey.

20 mars 2015: Ambasada organizon një veprimtari kushtuar librit të diplomatit anglez Norman Douglas, Kalabria e Vjetër (Old Calabria), një libër që jep një përshkrim të detajuar të jetës në ato vise arbëreshe.

21 mars 2015: Ambasada në bashkëpunim me gazetarin, pronarin dhe botuesin e gazetës "The Albanian" z. Petrit Kuçana, dhe me stafin e tij organizuan promovimin e numrit të parë të revistës "Udhëtimi Im".

24 mars 2015: Bashkë me Ambasadorin shqiptar në Londër, atasheu ushtarak në Mbretërinë e Bashkuar, Kolonel Ardian Lulaj morën pjesë në "Ditën e Ambasadorëve" e organizuar nga Komanda e Forcave Detare të NATO-s në Northwood, Angli. Merrnin pjesë tërë ambasadorët e vendeve anëtare të NATO-s.

22 prill 2015: Një prezantim interesant u organizua në Ambasadën Shqiptare në Londër, rreth Rrëshqebullit ose Lynx Balcanus, mbajtur nga Dr Aleksandër Trajcev për këtë lloj kafshe të rrallë, i cili tërhoqi vëmendjen e anëtarëve të shoqatës AAA.

15 maj 2015: Për dy ditë rresht në hollin kryesor të Bashkisë Chelsea Kensington në Londër, u organizua Panairi i 65-të Pranveror Ndërkombëtar i Mallrave dhe Ushqimeve. Midis zonjave të ambasadave ishin edhe zonjat e Ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës.

28 maj 2015: Filloi Edicioni i tretë i "NOTES ON ALBANIA" me Javën e Kulturës Shqipëri - Britani me hapjen e Ekspozitës *Homage per Edward Lear* në "12 Star" në Evrope House.

30 maj 2015: Ambasada organizoi promovimin e librit të Dr. Enver Bytyçit, "Diplomacia Shtrënguese e NATO-s në Kosovë" në gjuhën angleze.Veprimtaria u zhvillua në selinë e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër.

31 maj 2015: Ambasada organizoi ceremoninë e dorëzimit të Albumit Muzikor "KËNGËT E ATDHEUT" mësuesve dhe nxënësve shqiptarë në Londër. Ky libër muzikor është një dhuratë e muzikantëve Adelina Hoxha dhe Robert Radoja të përkrahur nga botuesi Flamur Hudhri, kushtuar fëmijëve shqiptarë në Britaninë e Madhe.

2 qershor 2015: Në Ambasadë u bë prezantimi i librit të botuar së fundmi i autorit Sir Noel Malcolm "Agents of Empire".

4 qershor 2015: Java e Kulturës Shqiptaro - Britanike u mbyll me një aktivitet, ku për herë të parë në historinë e Shqipërisë, brenda në Auditorin e Ambasadës Amerikane në Londër, u shpalos flamuri shqiptar si dhe një xhevahir i historisë së Shqipërisë i titulluar: "Jeta e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Herman Bernstein, dhe Marrëdhëniet Shqiptaro - Hebraike si një model i tolerancës fetare", mbajtur nga Ambasadori shqiptar në Londër.

15 qershor 2015: Ambasada në bashkëpunim me Michele Grimaldin e "Daily Telegraph" realizoi botimin e shkrimit më të gjerë, më të plotë dhe më pozitiv rreth Shqipërisë në historinë e shtypit britanik.

12 korrik 2015: Si edhe më parë në Dublin të Irlandës u përkujtua Dita e të Rënëve Irlandezë në shërbim të Misioneve të Ndryshme në Kombet e Bashkuara. Ceremonia u kryesua nga Presidenti i Republikës, z Michael D. Higgins.

28 korrik 2015: Zoti Adriatik Mema diplomohet nga Kolegji Mbretëror për Studimet e Mbrojtjes në Londër (Royal College of Defence Studies - RCDS). Merr pjesë atasheu ushtarak i R.Sh-së, z Ardian Lulaj.

2 shtator 2015: Ambasadori shqiptar viziton Kështjellën Highclere, aty ku kanë jetuar tre njerëz të një familje aristokrate angleze shumë të rëndësishëm për Shqipërinë: - Koloneli Aubrey Herbert, Nëna e tij, Kontesha Mary Herbert, e veja e Kolonelit Herbert.

9 shtator 2015: Ambasadori paraqet rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajonin e Ballkanit përpara Forumit të Diplomatëve të Rinj në një audiencë me diplomatë nga mëse 30 vende të ndryshme të botës.

13 shtator 2015: Ambasadori mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Qendrës për Studime Islamike në Oxford. Me atë rast aty u mboll një pemë në një ceremoni të drejtuar nga Dekani i Trupit Diplomatik, Ambasadori i Shtetit të Kuvajtit, Sh.T. Z. Khaled Al-Duwaisan.

5 tetor 2015: Në mjediset e Përfaqësisë së Komisionit Evropian në Londër

u mbajt "Forumi i Energjisë Evropiane 2015": "Perspektiva e Energjisë Evropiane - Sfidat dhe Zgjidhjet".

30 tetor 2015: Në sallën kryesore të Universitetit Regent në Londër u organizua mbrëmja me titull "Lamtumirë, Ambasador!". Një audiencë mbi 300 pjesëmarrës ndoqën një video - dokumentar për veprimtarinë e 1358 ditëve në Ambasadën Shqiptare në Londër. Po atë natë u përurua edhe libri "Realitete Shqiptaro - Britanike".

31 tetor 2015 - Lamtumirë, Londër!

28 Janar 2016: Përurim i librit "Realitete Shqiptaro – Britanike" në mjediset e Ambasadës Britanike në Tiranë, organizuar nga Ambasadori britanik, Sh.T z Nicolas Cannone. Pjesmarrës, Kryetari i Parlamentit, Lideri i opozitës Shqiptare, deputetë nga të dy krahët e parlamentiti shqiptarë, miq të ambasadës dhe të autorit.

20 shkurt 2016: Prezantim i librit "Naltësimi i Iskanderit", në sallën UNESCO të Muzeut Historik Kombëtar, përkthim i veprës së Benjamin Disraelit.

28 nëntor 2016: Prezantim në Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës në Prishtinë - "Forca e Pushtetit të Butë si mjet për promovimin e kombit tonë në fushën e marrëdhënieve diplomatike ndërkombëtare". Pjesëmarrës, punonjës të MPJ së RK si dhe shumë diplomatë të huaj të akreditуar në Prishtinë.

20 Nëntor 2017: Prezantim përpara studentëve të Geneva School of Diplomacy në Gjenevë, Zvicër: "Forca e Pushtetit të Butë dhe njohja e të huajve me Besën Shqiptare, që mbrojti hebrejtë gjatë kohës së Hollokaustit".

29 nëntor 2018: Prezantim përpara Akademisë Vjeneze të Diplomacisë, në selinë e kësaj Akademie në Vienë, i ftuar nga Ambasadori Emil Brix, Drejtor: Forca e Pushtetit të Butë dhe njohja e të huajve me Besën Shqiptare, që mbrojti hebrejtë gjatë kohës së Hollokaustit.

25 nëntor 2019: Në mjediset e Fondacionit "Ivanaj" në Tiranë, Prezantim me Power Point i jetës dhe veprës së Amerikanit "Charles Telford Erickson".

17 janar 2020: Në mjediset e Fondacionit "Ivanaj" në Tiranë, Prezantim me Power Point i Veprës së Benjamin Disralit, "Naltësimi i Iskanderit".

25 shkurt 2020: Në mjediset e Fondacionit "Ivanaj" në Tiranë, Prezantim me Power Point i jetës dhe veprës të Herman Bernstein, Ambasadori i SHBA-ve në Mbretërinë Shqiptare, 1930 - 1933.

TREGUES

A
Abdel Nasser 25
Abdyl Frashëri 470
Abdyl Latif Arnaut 187, 190
Abdylmexhidi II 111
Adam Yemey 220, 426
Adelina Hoxha 427, 521
Adelina Irby 232
Adem Demaçi 64
Adriatik Mema 522
Adnan Menderes 45
Anit Mezari 45
Adonis Filipi 382, 503
Agata Filjakowski 515
Agim Aliçkaj 142,143,176
Agim Fagu 477
Agim Karagjozi 163
Agim Morina 264
Agim Pasholli 212
Agnes Ethel Conway 232
Agnes Jansen Mageritch 454
Agron Alo 125
Agjentët e Perandorisë 352, 427
Ahmet Pasha 382
Ahmet Zogu 25, 235, 236, 395
Akland 234
Aleksandër Trajcev 521
Al Mura 186, 187, 195
Alariku 334
Alb - Trio e Londrës 324
Albanian Airlines 117
Albanian Cinema Project 512
Albert Hall 310, 328, 426
Albert Menes de Hidveg 488
Alda Dizdari 324, 325, 329, 330, 508, 515
Alderman Roger Gifford 511
Aleksandër Meksi 103
Aleksandri 25, 344, 476, 482, 488
Aleksandropullis 61
Ali Asllani 488, 489
Ali Imam 487
Ali Pashë Tepelena 294, 486
Ali Sami Yen 130
Aliev Kelliç 66
Almona Bajramaj 212
Amaltheia 110
Amaryllis Fleming Concert Hall 324, 327, 329, 514

Ambasada Finlandeze 434
American Board of Foreign Missions 168
Ana Allani 517
Andrea Demçe 112
Andrew Carnegie 205
Andrzej Panufnik 308
Angjelin Kakarriqi 490
Angjelina Ceka (Luarasi) 286
Ankara 83, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 266, 267, 478, 490
Anna Dwyer 343, 344
Anne Hathaway 380
Antalia 124
Antonio Menini 334
Antropologji, Muzeu 264
Anthony Bailey 510, 511
Anthony Quayle 211, 376
Anvar Sadat 191
Aparteidi 336, 340
Aqif Neli 467
Arafati,Yaser 191
Arbër Ahmetaj 513
Arbër Xhaferri 175
Ardian Lulaj 521, 522
Arjon Krasniqi 427
Arlinda Morava 324, 325, 329
Armend Agolli 67, 125
Armend Spahia 67, 125
Armeni-a 209, 211
Arsha Kaviani 345, 346
Artan Liçaj 513
Asaf Xhaxhuli 490
Asdreni 329, 490
Asllan Ypi 490
Asta Skaisgiryte Liauskiene 353, 431
Ataturk 57, 67, 86, 87, 88, 110, 117, 373, 471
Atifete Jahjaga 355, 503
Athinë 107, 411, 472, 474, 477, 488
Aubrey Herbert 16, 173, 220, 229, 230,231, 232, 233, 234, 235, 236, 238, 239, 470, 484, 487, 503, 522
August Roden 453
Aung San Suu Kyi 225, 226, 227, 228
Austro – Hungari 487
Avni Zajmi 242

B
Bahtygul Kalambekova 267
Barack Obama 226
Barbara Hutton 444
Baroni Nopça 359
Bassel Fleihan 196
Bashar Al Asad 187, 191
Bashkim Ahmeti – Izano 417, 422, 423
Bashkimi Evropian 271, 315, 366, 420, 423, 484
Bashkimi Sovjetik 336, 353
Bayswater 217, 248, 250, 259, 256, 257, 457, 479, 518
BBC Proms 310, 328, 343
Bejrut 24, 185, 193, 194, 195, 196, 201, 472, 480
Bejtullah Destani 16, 219, 234, 250, 264, 440, 503, 504
Bektashi 73, 198
Belgrave 360, 363, 364
Ben Barkow 505
Ben Manaj 467, 492, 493, 495

Benazir Buto 103
Benedikt Binishti 422
Benjamin Disraeli 523
Benjamin Gilman 138, 139, 147
Beograd 66, 135, 152, 386, 483, 484, 489, 490
Berat 109, 395, 421, 470
Berlin 310, 470, 476, 481,
Bertold Breht 376
Besa Shqiptare 433, 507
Besim Sahatçiu 263
Besnik Mustafaj 20, 101, 102
Besnik Sahatçiu 263
Beteja e Borodinos 344
Beylerbey Saray 58
Bibël 155
Bizanti 48, 104, 303, 305
Bobbi Moor 365
Bokerini 460
Borodino 343, 344
Bosnjë e Hercegovina 411
Boston 24, 150, 227, 397, 164
Brad Pitt 222, 355
Brazili 200
Brian Schama 507
Brindisi 422
Bristol 457
Britania e Madhe 131, 217, 222, 235, 257, 253, 470 ,427, 510
British Petroleum 240, 243, 365, 371, 505
Bruksel 483, 485
Bryony Bethel 250, 423
BSEC 44, 209, 210, 212, 213, 215
Buckingham Palace 273, 277, 444, 503
Bujar Asqeriu 382
Bujar Bukoshi 64
Bujar Nishani 221, 270, 278, 319, 479, 519, 520
Bullgaria 60, 111, 266, 424
Burma 168, 226, 227
Butrint 347, 419, 502

C
Cadogan 310, 343, 347, 348
Cambridge 264, 271, 357, 436, 459, 483, 484
Camille Corot 370
Campobasso 286
Cape Town 340
Carlo Durrazo 488
Carnegie Hall 310
Carolios Papulias 410, 412, 413
Carrington 81
Cate (Institute) 142
Celalettin Őlmezcan 65
Celtik 369, 371
Chagall 425, 426
Chamberlain 353
Charles Grey 270, 275, 276
Charles Telford Erickson 168, 169, 171, 172, 227, 228, 234, 235, 238, 258, 259, 470, 487, 507, 523
Cheshire 349
Christo Brand 206
Christopher Hill 144
Chuck Shumer 147
Cindy McCain 177
City of London 440, 477, 511

Clarence House 519
CN8 Comcast Network 149
Columbia Records 263
Commonwealth 365, 485, 506
Concertgebour 310
Connecticut 168, 259, 417
Corinthia 218, 219, 502, 505
Cornucopia 108, 110
Court of St James's 337
Covent Garden 365
Cumberland 231

Ç
Çajkovski 344
Çanakala 61
Çehov 395
Çeki 453
Çesk Zadeja 321
Çevçenko 212, 214
Çirağan Saray 58

D
Dalai Lama 222
Damask 24, 185, 186, 189, 191,192, 480
Daniel Taub 431, 505
Danimarka 205
Danubi 210
Daut Dauti 467, 509
David Balaj 176
David Cameron 226, 503, 514
David Lloyd 16, 221, 248, 506,
David Smail 248
David Shankland 357, 516
David Tukiçi 310
Davidi i Gurit të Bardhë 405
Dayton 144
De Mediçi 370
De Rada 298, 299, 300, 302, 303, 304, 305, 306, 370, 388
Dervish Duma 475, 482, 490
Destmond Mpilo Tutu 340
Deti i Zi 45
Detroit 247, 253
Dibra 490
Diplomatic Exhange (IBDE) 244
Donika Berisha 15, 41, 67, 68, 69, 92, 256, 282, 354, 355, 461
Dosja H 352
Downton Abbey 233
Drita Roshi 56
Dublin 314, 318, 320, 321, 481 ,512, 513, 522
Durrës 17, 236, 282, 421, 480, 482, 488
Dhimiter Engjelli 490
Dhimitër Kosturi 490

E
Edinburg 275, 357, 368, 462, 516
Edit Mihali 87, 90
Edita Kruniç 151, 152
Edith Durham 16, 173, 220, 230, 232, 264, 357, 358, 359, 484
Edith Pierpont Stickney 97, 113, 172
Edith Harxhi 185, 506, 508
Edward Lear 247, 417, 418, 419, 420, 421, 423, 424, 426, 430
Edward Melotte 239
Edward Turay 351

Edward William Elgar 407
Edwin Jacques 164
Egjypti 185, 191, 272
El Greco 425
Elbasan 51, 52, 168, 228, 236, 397, 421
Elena Denisova 363,
Elez Biberaj 392, 504
Elita Alo 65, 67, 116
Elizabeth Dowager Herbert 231
Elizabeth Gowing 513
Elizabeth II 226, 246, 267, 270, 272, 273, 274, 275, 277, 278, 279, 280, 281, 284, 308, 351, 371, 405, 407, 408, 444, 466, 476, 479, 503, 511, 515, 516
Elizabeth Stuart 517
Emil Brix 360, 362, 363, 364, 523
Emily Chinball Olson 371
Emin Sahatçiu 108, 110, 112
Emrush Bejdo 510
Enigma e Ballkanit 172
Enver Tali 64, 66, 67, 68, 70, 71, 100, 125
Enver Zeneli 25, 34
Epiri i Veriut 97, 113, 172
Eposi i Kreshnikëve 388
Eqerem bej Vlora 474, 489
Eqerem Libohova 489
Ergün Zoga 124
Erich Drummond 489
Erik Bergman 435
Erion Berisha 15, 32, 131, 155, 373, 397
Erisa Zyko 425
Ermonela Jaho 323, 324, 325, 326, 329, 365, 434, 498, 511
Ernesto Cozzi 430
Erqani Harbije 102
Esat Braçe 502
Ethem Beu 196
Eugene Pitard 487
Ezer Weisman 79

F
Fadil Berisha 153, 323, 390
Fahri Balliu 51, 55
Falstaf 377
Fan Noli 73, 111, 164, 165, 167
Faraoni 232, 233
Fatos Zajmi 242
Felatun Vila 490
Ferid Dervishi 490
Ferikğy 130
Ferit Hudhri 504
Fernando de Boullion 197
Fier 413
Filipe Gonzales 144
Fiona - Kontesha e Tetë Carnarvon 233
Fisher, M 230
Flamur Hudhri 247, 521
Flutura dhe Julian Hivzi 125
Fondacionin Rockefeller 231
Foreign Office 173, 245, 270, 432, 466, 474, 496, 506
Fort Dix 149, 154, 156, 157, 158
Francesko Crispi 486
Francë 75, 76, 144, 237, 353, 374, 410, 449, 450, 453, 471, 473, 483, 491
Frank Winfield Woolworth 444
Franko Pallota 286
Franz Ferdinand 360, 361, 362, 363

Franz Joseph 361
Fruma Mohrer 392, 394
Fuad Asllani 472, 473
Fuad Dibra 488
Fuat Boçi 413

G
Gallata Kulesi 58
Gallatasaray 473
Gary Walsh 514
Gavyn Arthur 511
Gazmend Barbullushi 203
Gazmend Leka 90, 91
Genc Tukiçi 39, 387, 391
Georg Trakl 363
Georg von Hahn 441
Georgina Muir Mackenzie 232
Georgio Maria Castriota 287
Gëzim Alpion 518
Scanderbeg 252, 287
Gertmandrin Hasandoçi 40
Glasgow 339
Gligorov 81
Grand Haliç 123, 124
Grant Smith 488
Greqi 60, 90, 131, 209, 411, 412, 421, 437, 438, 453, 473, 481, 484
Guci 32, 98
Gjakovë 32, 33, 99, 480
Gjenevë 24, 245, 247, 474, 475, 483, 487, 488, 523
Gjermani 122, 394, 406, 454, 470, 473, 509
Gjilani 65
Gjoni Baptist (Jahja) 188
Gjovalin Shkurtaj 17, 302

H
Habsburg 363
Habsburgermonarchie 363
Hacetepe 266, 267, 478
Hafez Al Asad 191
Hafiz Shala 176
Hagë 202, 203, 204, 208, 441
Hagia Sofia 32, 57
Halil Metin 65, 124
Hamid Kokalari 490
Hamlet 324, 375, 454,
Hana e Zana 366
Hardangeri 454
Harish Dogra 115, 116, 243
Harvard 269, 298, 436
Harry Bajraktari 396
Harry Blech 310
Harry Charles Augustos Eires 424
Harry Eires 424
Hasan Hysein Şener 42
Harris Silajxhiç 165
Haxhi Goci 240
Hayri Içli Kelmendi 31, 65, 88, 121
Helmut Kol 144
Helsinki 48, 485
Heminguej 279
Henry Hyde 138
Henry IV 380, 381, 382,
Henry Kissinger 140, 141, 142, 148
Henry VIII 377, 406, 449
Herbert Hoover 259, 322, 395, 491
Hercegovinë 144, 258, 437, 517

Herion Mustafaraj 516
Herman Bernstein 83, 392, 393, 394, 396, 431, 491
Hicklere Castle 233, 234
Hisashi Owada 206
Hito Sadiku 489
Hollandë 202, 208
Hollokaust 142, 433, 504, 507, 514, 520, 523
Home Office 516
Hoti 411
Howard Carter 233
Hungaria 359, 488
Hüsref Gerede Caddesi 130
Hysen Vrioni 490

I
Ibrik Tepe 108, 111, 112
Ibrahim Rugova 475
ICJ 202
Ilana Navaro 125
Iliaz bej Vrioni 470, 471
Ilir Ikonomi 392
Ilirian Agolli 17, 499
Ilirjan Dauti 510
Iljaz Rrahmajli 66
Iljaz Vrioni 489
Imzot Luigj Bumçi 487
India 115, 116, 117, 118, 136, 242, 349
Instituti i Kulturës Suedeze 435
Iraku 191, 483
Irish Friends 320
Irlanda e Veriut 315
Irlandë 317, 321, 461, 477, 479, 481
Isa Boletini 441, 468
Ismail Haki Karadaĝi 23, 107
Ismail Kadare 388, 426, 220, 250, 352
Ismail Qemali 26, 30, 98, 329, 442, 504
Israeli 72, 79, 395, 431, 432, 434, 466, 505
Istiklal Caddesi 30
Ivan Dias 198
Ivan Saxton 452, 454, 455, 457
Izet Salihi 123
Izetbegoviçi 144
Izmir 29, 127, 128, 227

J
Jack McCann 505
Jacqueline Minor 387, 423, 432
Jakobin 230
Jani Evangjeli 490
Jawaharlal Nehru 205
Jean Sibelius 435
Jeane Kirkpatrick 140, 141
Jedah 24, 482
Jeremy O'Sullivan 422
Jeremy Wright 507
Jerusalem Post 520
Jerry Field 376
Jewish Tribune 395
Jim Belushi 518
John Anthony Quayle 376
John Bercow 226, 227, 509
John Freely 16, 58, 108, 109, 112, 113
John Hall 240
John Hodgson 220, 250
John Kerry 355
John Major 144
John McCain 176, 178, 179

Jonathan Brent 354, 392, 393, 394
Jordan 191
Josef Székely 441
Joseph DioGuardi 81, 82, 83, 134, 136, 144, 145, 146, 149, 175
Joseph Nye 270, 271
Jugosllavia 241, 394, 462
Julia Kruger 346, 455
Julian Clef 345, 346
Justinian i Parë 57

K
Kadri Ates 65
Kadri Roshi 50, 52, 53, 55, 56, 376
Kadri Turker 125
Kalabria 304, 306, 521
Kalipso Nicolaidis 413
Kamil Bitis 65
Kastriot Berberi 517, 518
Kastriot Robo 477
Katerina II 344
Kelmendi 31 ,65, 88, 121
Khaled Al-Duwaisan 463, 522
Kiazim Kokeli 229
Klara Bregu 324, 329
Koço Kota 490
Koji Sekimizu 52
Kok Boru 267
Kombet e Bashkuara 24, 83, 478, 512, 522
Kongresi i Lushnjës 442, 469, 487
Konstandin Çekrezi 167, 488
Konstandin Mima 490
Konstandin Tashko 488
Konstandini i Madh 334
Konsullata Shqiptare në Stamboll 94
Kontesha Mary Herbert 522
Köprülü Mehmet Pashai 110
Kosova 19, 51, 52, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 83, 87, 88, 89, 99
Kosta Meksi 490
Kreshnik (Berisha) 15, 32, 131, 297, 397, 439
Kreshnik Xhiku 217, 251, 253, 254, 256, 286, 506, 512
Kroaci 199, 334, 335, 483
Kronos 110
Krujë 197, 240, 421, 422
Kujtim Spahivogli 375, 376
Kutuzovi 343, 344
Kyrgyzstan 266, 267

L
La Bohema 365, 369
Lady Almina 233
Lajpcig 488
Lancaster 515
Lazer Çetta 490
Lec Kurti 474, 487
Lefkosha 24
Lekë Dukagjini 472
Liban 192, 193, 185, 193, 194, 195, 196, 201, 472
Lidhjes së Kombeve 473, 480, 487, 489
Liga Qytetare Shqiptaro – Amerikane 176, 180
Lili Stern-Pohlmann 509
Limos Dizdari 325
Lindita Kotorri 86
Liri Berisha 240, 243, 505

Lirim Greiçevci 264, 437, 468
Lituani 352, 353, 431, 432, 466, 519
London 2012 312, 466, 503
London Mozart Players 309, 310, 343,
Lonely Planet 502
Lord Alan Watson 519
Lorenc Oliveri 377
Lorenc Radovani 513
Loyon Thompon 487
Lubomir Stankoviç 437
Lufta e Dytë Botërore 453
Luigj Bumçi 487
Luis Susman 445
Luksemburg 314, 318, 473, 488
Lyn Doyle 150, 151, 152
Lynx Balcanus 521
Llesh Kola 286

M
Maestro Petrescu 324
Magna Carta 439, 440, 441, 442
Mahatma Ghandi 205, 249
Mal i Zi 253, 365, 411
Maliq Libohova 471,
Malit të Shkëlzenit 197,
Mamurras 43, 52, 53, 56, 98, 242
Manhattan 82, 176, 392, 394, 396
Manson House 442, 458, 459, 460, 496, 519
Maqedonia 60, 266
Marc Weller 264
Margaret Fitsherbert 230
Margaret Hasluck 232, 442, 516
Margaret Thatcher 420, 452, 456, 457
Maria Theresa Walburga Amalia 363
Mariela Cingo 324
Marjeta Ljarja 90
Mark Gorayev 193, 196
Mark Stephenson 343
Marmara 46, 82
Marubi 441
Mary Adelaide Walker 232
Mary Arden 382
Mary Herbert 232, 522
Masakra e Reçakut 144
Mata Harri 30
Matthew Barzun 431, 433, 443, 466
Maurine John Freely 113
Mavi Victoria D'Inzeo 286
Maxell Black 488
Mbretëria Shqiptare 442
Mbreti Aleksandër 361
Mbreti George i Greqisë 361
Mbreti Italian Umberto 361
Mbreti Zog 30, 472, 504
Medi Frashëri 489, 490
Mehmet Ali Ağca 286
Mehmet Konica 169, 171, 172, 234, 238, 469, 470, 480
Mery Melotte 234
Mary Herbert 232, 522
Michael D. Higgins 314, 318, 479, 505, 512, 513, 522
Michael Garrote 46, 124
Michael Kit 505
Michael Larry 349, 350
Mid'hat Frashëri 488, 490
Middlesex 507

Mikel Çoba 490
Mikelanxhelo La Luna 297, 298
Milosheviç 33, 68, 81, 133, 141, 145, 150, 153, 154, 441
Miranda Sinani 369
Mirela Sula 517
Mirush Kabashi 260, 386, 496, 518
Mohamed Al-Amin 196
Moldavi 209, 211, 262, 429, 507
Molise 285, 286, 287
Moskë 24, 209, 210, 211, 214, 215, 347, 364, 481
Muhamet Ali Pashë Kavalla 24, 210
Muhamet Hamiti 219, 434
Muhamet Mufak Arnaut 190, 191
Munxhufuni 112, 285, 534
Müşir Fuad Paşa Yalısı 210
Musolini 475, 491
Mustafa Muezinoviç 437
Myslim Mulliqi 69

N
Nabih Berri 196
Nahit Bejtullahu 125
Naim Hasani 251
Napoleon Bonaparti 343, 344, 395
NATO 146, 158, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 160, 180, 194, 239, 271, 426, 427, 483, 521
Ndrekë Gjini 319, 505
Nedeljko Čabrinović 362
Neil Rees 504
Nelson Mandela 205, 206, 266, 340
Neritan Ceka 286, 287, 512
Nevruz Çarkaxhiu 125
New York 19, 24, 48, 72, 83, 108, 126, 134, 135, 136, 145, 149,163, 174, 175, 181,184, 205, 233, 258, 317, 318, 323, 354, 392, 393, 395, 396, 519
Nezir Leskoviku 490
Nënë Tereza 115, 221, 240, 241, 242, 263, 265, 272, 367, 493, 502, 505, 508
Nicholas Canonne 457
Nickles-D'Amato 138
Nicola Guy 276, 503
Nihat Islami 67, 191
Nikolai Kapustin 344
Nikolla II 395
Nikos Kotzias 436, 439
Nilüfer 131
Nişantaşı 67, 29, 82
Noel Malcolm 16, 220, 250, 262, 352, 427, 428, 429, 430, 440, 448, 467, 504, 514, 515, 516, 517, 522
Norman Douglas 521
Norman Gershman 515
Notes on Albania 313, 322, 323, 326, 327, 328, 329, 331, 343, 386, 389, 390, 414, 417, 423, 431, 432, 466, 479, 498, 514, 518, 521
Nush Bushati 490

O
Odeta Nishani 519
Odhise Paskali 453
Ognjen Pribićević 332
Ohri 418, 483
Oksford 108, 423, 482

Oliver & Hasani 251
Orhan Zarshati 26, 31, 45, 64
Orkestra e Radio Televizionit Shqiptar 313, 513
Othon Anastasakis 437
Osborne 456
Ossining 135, 136, 137, 149
Otello 377
Owen Jenkins 506

P
Pandeli Evangjeli 488
Pandeli Nase 490
Papa Benedikti XVI 226
Paris 48, 101, 102, 145, 164, 167, 168, 169, 170, 173, 226, 230, 370, 390, 385, 399, 499, 411, 412, 470, 471, 485, 487, 488
Partia Republikane 134
Pashk Përvathi 87, 88
Pashko Camaj 98
Pashko Vasë Shkodrani 195
Patricia Nugee 220, 250, 504
Paul Earl 378, 379
Paul Mellon Collection 418
Pavli Qesku 471, 477
Pekka Huhtaniemi 434
Penguin Random House 352, 354
Perandoria Osmane 362
Peter Botha 336
Peter Mather 240, 243, 365, 369, 371
Peter Tomka 206
Petrit Kuçana 467, 497, 510,5 21
Petro Kisi 490
Përmeti 487
Pimlico 247, 323, 352, 353, 505, 513
Pinner Sinagogë 514
Pirro 281, 325
Pixton Park 231, 233, 234, 237, 238
Pjetër Arbnori 337, 475, 339
Placido Domingo 354
Plavë 32, 98
Poloni 308, 374, 453, 509
Polloni 373
Portofino 232
Portugali 197
Presidenti Bush 444
Presidenti Bush, i vjetri 444
Presidenti Regan 241
Presidenti Rugova 56
Princeton 151
Princi Harry 337
Prishtinë, Kosovë 185
Prizren 67, 117, 175, 241, 440, 441
Protokolli i Korfuzit 97
Provinca e Egër 454, 456
Puçini 325, 512

Q
Qafë Morinë 239
Qamil Gavoçi 191
Qatin Saraçi 473
Qemal Jusufati 490
Qenan Dibra 490
Qerbela 197
Qeveria e Vlorës 487
Qipro e Veriut 108

R
Radio Ankara 82
Raguzë 428
Raif e Veli Terziu 65, 125
Rambuje 146, 144, 145
Ramiz Alia 46, 48, 412
Random House 352, 354
Rasi Dino 490
Rathbones 349, 350
Rauf Fico 473, 489, 490
Refik Hariri 196
Remzi Çelo 490
Rescue in Albania 142, 147
Revolucioni i Qershorit 442
Rexhep Ferri 401
Rexhep Shazi 490
Richard Hollbrook 144
Richard Quest 355
Rita Ora 263, 265, 407, 517
Robert Cecil 230, 487
Robert Davis 250, 387
Robert Dole 133, 135, 138, 140, 141, 142
Robert Elsie 302, 440, 441, 442
Robert Kolegji 108
Robert Maclennan 386, 518
Robert Owen 68
Robert Radoja 427, 521
Robert Wilton 327, 388, 389, 517
Rocophilos 412
Roderick Bailey 454, 456, 508
Rodezi 340
Rohingya 225
Roland Berzani 510
Roland Evans 126, 129
Roland Xhoxhi 87
Romanovë 344, 361
Romë 168, 147, 150, 470, 472, 474, 482, 488
Romulus Augustulus 333
Roosevelt 316, 491
Rose Wilder Lane 322
Roxanna Panufnik 308, 309, 311, 387, 512
Royal Opera House 354, 365, 512
Rozafë 294
Rudi Vata 369
Rudina Jasini 467
Rumani 173, 209, 211, 266, 329, 484, 489
Rumeli 227
Rusia 205, 209, 212
Ruth Beedham 434
Ruth Pennington 23
Rrahmaninov 344

S
Sabattai Zevi 395
Sali Berisha 44, 45, 56, 79, 242, 244
Saimir Pirgu 354, 518
Sandhurst 517
Sarajevë 361, 363,
Savino Cannone 287
Selaudin Blloshmi 489
Selim Belortaja 215
Sema Pezakoglu 124
Sergej Lavrov 214
Simon Schama 353, 519

Skënder Luarasi 415
Skënder Thaçi 32
Skënderbe 112, 221, 247, 248, 252, 255, 285, 303, 318, 422, 448, 451, 457, 471, 504, 507, 509, 514, 519, 520
Sofokli Comorra 490
Sotir Avrami 490
South Bank Hall 310
Special Operations Executive 453, 456
Stambolli 19, 26, 32, 42, 58, 70, 73, 77, 78, 83, 92, 94, 95, 98, 104, 110, 117, 112, 130, 191
Stavri Katundi 490
Stone Castle 504
Stylianos Nicolaidis 410, 412
Sulltan Mehmeti i Katërt 109
Susan Burbridge 245
Suzana Varvarica 87, 89, 94, 251
Sylejman Delvina 487, 470
Sylejman Demirel 56, 66, 107
Syrja Vlora 487

SH
Shakespeare's Globe Theatre 503
Shën Antoni 30, 197, 436, 482
Shën Gjergji 232, 397, 510
Shën Kozmai 413
Shën Pali 73, 196, 244, 274, 452
Shën Patriku 317, 318
Shën Xhejms 218, 337, 405, 444, 476, 519, 520
Shirley Cloyes 82, 136, 142, 149, 175
Shkodër 75, 78, 191,4 21, 441, 480
Shoqata Anglo - Shqiptare (AAA) 220, 230, 467, 507

T
Tahir Shtylla 490
Tamiz 452
Tansu Çiller 23, 66, 103, 107
Tanush Çabej 77, 78
Tapenzi, Ura 136
Tasmin Little 310, 311
Tara Neli 520
Tekirdag 61, 130, 131
Teksas 346
Ten Tour 124
Teşvikye 25
Tetova 175
Teuta Dhima 17
Teuta Starova 282, 322, 478
Tibet 222, 312
Tiranë 24, 26, 28, 32, 34, 37, 39, 40, 42, 43, 56, 66, 73, 75, 76, 77, 84, 87, 89, 92, 93 ,94, 105, 106, 116, 117, 118, 120, 127, 131, 134, 168, 179,1 84, 196, 210, 214, 215, 218, 232, 239, 242, 250, ,260, 263, 265, 281, 308, 310, 311, 313, 323, 333, 347, 375, 379, 389, 398, 401, 408, 411, 421, 422, 424, 434, 435, 439, 456, 457, 468, 472, 473, 474, 475, 476, 478, 482, 483, 484, 485, 488, 491, 508, 510, 512, 523, 524
Tokio 229, 477
Tom Boch 515
Tom Lantosh 135, 139, 140, 147
Tomor Kokona 312
Tony Blair 245

Top Kapi 42, 48, 49, 69
Towton 381
Trafalgar 283, 336
Trakë 108
Traktati i Fshehtë i Londrës 170
Trans Adriatic Pipeline 371
Triclycle Theatre Kilburn 514
Tripoli 200
Tropoja 253
Truman 316, 444
Turgut Őzal 44, 45, 209
Turkish Daily News 23, 82, 83, 84, 94, 107
Turkler Naklyat Firmasi 124
Turqia 23, 32, 36, 45, 102, 103, 104, 106, 107, 128, 210, 211, 489
Tutankhamun 229, 232, 233
Tuxhman 81, 144
Tyrbja e Elez Kurtit 197
The Albanian 497, 510, 521
The Backman Trio 434
The Birth of Albania 503
The Economist 428
Theodora Benson 232
Theofan Stilian Noli 108, 111
Thoma Simaku 517

U
Ugo Sola 489
UK Albanian Professionals 511
Ukrainë 209, 484
Ulqin 109, 428
UNESCO 511, 523, 368
Universiteti Bosphorus 108
Universiteti i Arteve 89
Universiteti Yale 260
UNMIK 176, 184, 366, 479
Ura Lambeth 453
Ura London 452
Urat e Bosforit 59
Usain Bold 371

V
Varshavë 308, 428, 509
Vasil Dogani 490
Vaso Pashë Shkodrani 195
Vatikan 72, 198, 334, 428, 486, 510
Vatra 16, 70, 135, 137, 163, 164, 166, 167, 168, 172, 173, 384, 386, 479
Venecian 108
Venedik 428,486
Venetia de Blocq van 511
Kuffeler 511
Veton Hoxha 65, 125
Venizellosi 166
Vera Cara 185,186, 199
Vera Ora 467
Victor Bunin 346
Viktor Çernomyrdin 144
Viktor Emanueli 491
Viktor Plumbi 488
Vilma Lorenc Antoni 65
Vincent dhe Peter Saljani 176
Visar Zhiti 252, 295, 397, 398
Vivaldi 312
Vjenë 471, 472, 473, 474, 478, 488
Vladimir Zhapa 51
Vlora 296, 471, 487
Vorio Epiri 98, 107, 104, 173

Vredespaleis 205
Vuk Gjurashkoviç 489
Vuk Jeremiç 204, 215

W
Washington 24, 135, 137, 140, 145, 164, 179, 251, 395, 417, 481, 487, 486, 488, 489
Wesley Clark 147, 180
Westminster Abbey 240, 243, 337, 342, 405, 409, 505, 513
Westminster Council 45, 256, 457
Wiener 504, 505
Wiener Zeitung 309
Wilhelm II 395
William Cohen 147
William Habibi 195
William Hague 355
Winfield House 444
Winston Çurçill 406
Wolfgang F. Danspeckgruber 151
Woodrow Wilson 151, 168, 170, 395, 491

Xh
Xhafer Vila 490
Xhahid Koka 490
Xhamia Blu 58
Xhamia e Madhe e Damaskut 188
Xhamia Umayyad 188
Xhemal Dino 489
Xhemal Frashëri 489
Xhemal Gjunkshi 512
Xhemil Dino 473, 490
Xhevdet Dani 339
Xhoana Papakostandini 245, 286, 312, 322
Xhuzepe Verdi 354

Y
Yale University 168, 259
Yasemin Dobra Manço 81, 82, 83, 84, 125,
YIVO 354, 392, 393, 394, 396, 519
Yom Hashoah 509

Z
Zagori 418, 419
Zagreb 194, 199
Zef Bala 176
Zef Mazi 477, 478
Zef Prenushi 490
Zef Serreqi 491
Zefir Harxhi 125
Zelanda e Re 440
Zëri i Amerikës 17, 392, 499
Zvërnec 421
Zvicra 131, 205
Zhak Shirak 144

Në zyrën e Kryekonsullit të Republikës së Shqipërisë në Stamboll. Ulur, Kryekonsulli, z. Orhan Zarshati (1992-1995).

Nga e majta në të djathtë: Ilir Tufa, Konsull i Shqipërisë në Stamboll; Agron Alo dhe bashkëshortja Elita, anëtarë të stafit të Përfaqësisë së Kosovës; Sekretari i Parë i Ambasadës shqiptare në Ankara, z. Nexhat Pilku; Enver Tali, Përfaqësues i Qeverisë së Kosovës (në mërgim); Ambasadori i RSH në Ankara, Skënder Shkupi dhe bashkëshortja e tij, Merita; Nesrinë Tali, bashkëshorte e Enver Talit, Mal dhe Donika Berisha (1996).

Me një grup diplomatësh nga vendet ish-komuniste në Universitetin Hacetepe të Ankarasë, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë për një trajnim diplomatik.

Joseph DioGuardi në Stamboll. Në foto: Shirley Cloyes, Joseph DioGuardi, Alişan Dobra Yasemin Dobra Manço, Donika Berisha, Mal Berisha (1995).

Joseph DioGuardi, me mbështetës të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në Stamboll (1994).

Konferenca e NATO-s në Stamboll Pjesëmarrës, Presidenti e Republikës, dr. Sali Berisha, Ministri i Jashtëm dr. Alfred Serreqi (1993).

Me Fahri Turkhan, Kryetar i Shoqatës "Vëllazëria Turko - Shqiptare", natën e lamtumirës nga Stambolli ndërsa më dorëzon Medaljen e Nderit të Shoqatës (20 shtator 1997).

Lamtumirë Stamboll! Fjala përcjellëse e mbajtur në Hotelin Haliç nga patrioti, poeti, intelektuali shqiptaro - turk, Ergűn Zoga (20 shtator 1997).

Varri i Sami Frashërit në Ferikőy (majtas) ndërsa në qendër është varri i të birit Ali Sami Yen, themeluesi i klubit të parë futbollistik të Turqisë, Gallatasaray (21 shtator 1997).

Familja e ngushtë, Donika dhe djemtë

Një foto pas takimit me Kongresmenin Benjamin Gilman, mik i LQSHA.

Pas një takimi me kongresmenë në Capitol Hill, LQSHA.

Në një nga mjediset e Capitol Hill.

Capitol Hill: Nga seanca dëgjimore në Komitetin e Jashtëm të Kongresit Amerikan (mars 1999).

Përpara ndërtesës së Capitol Hill: Pjesëmarrës në protestën e shqiptarëve kundër genocidit serb në Kosovë organizuar nga LQSH, "Vatra" dhe shumë shoqata të tjera shqiptaro – amerikane (mars 1995).

Anëtarë të LQSH në Capitol Hill pas takimit me Kongresmenin Benjamin Gillman, mik i shquar i shqiptarëve në Kongres. Në qendër Gilman dhe Presidenti i LQSHA-së, ish-kongresmeni Joseph DioGuardi (1998).

Në dalje nga Capitol Hill me aktivistët e LQSHA-së. Si përherë, Presidenti i Ligës e drejton grupin e mbështetësve nëpër labirinthet e Capitol Hill-it.

"Maksimalistët" e Çështjes Kombëtare Shqiptare: Zërat më të fuqishëm, Joseph dhe Shirley Cloyes - DioGuardi, të cilët nuk pranojnë asgjë më pak se një Shqipëri brenda kufijve të saj etnikë në Ballkan.

Me Kongresmenin Benjamin Gilman, Kryetar i Komisionit të Jashtëm të Kongresit Amerikan në një takim për Kosovën. Lart nga e majta në të djathtë: Mal Berisha, Hon. Ben Gilman, e bashkëshortja Xhorxhia, Hon Joseph DioGuardi, e shoqja Shirley Cloyes -DioGuardi, gazetari Beqir Sina. Ulur: Ing. Zyhdi Karagjozi, Dr. Gjon Buçaj, z. Zef Përndocaj, z. Florim Xhema.

Përpara Capitol Hill, në një marshim për çlirimin e Kosovës me drejtorin e VOA (Zëri i Amerikës), dr. Elez Biberaj (mars 1995).

Pas takimit në Capitol Hill, LQSHA del me shpresën e madhe se Amerika do e ndihmojë Kosovën.



Kartolinë nga ish-pretendenti për nominim si kandidat Republikan për President i ShBA-ve, Senatori John McCain. Viti 2000.

CN8 Comcast Television, New Jersey, USA, debat i drejtpërdrejtë për Kosovën në 11 emisione në studion e gazetares Lyn Doyle.

Foto me Gjeneralin Wesley Clark, mik i Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane, pas botimit të librit "Waging Modern War".

Me Kryeministrin Dr. Sali Berisha dhe Ing. Agim Karagjozi President i Federatës Pan Shqiptare të Amerikës "Vatra" New York, 2012.

Me z. Agim Rexha nënkryetar i Federatës Pan Shqiptare të Amerikës, "Vatra" e që prej vitit 2019, President Nderi i saj.

Me delegacionin shqiptar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, New York (shtator 2010).

Në Moskë me delegacionin tonë, nga e majta në të djathtë, Ligor Cullufe, Sokol Gjoka, Selim Belortaja, Almona Bajramaj, Agim Pasholli dhe Mal Berisha.

Vendosja e bustit të Skënderbeut në 113 Inverness Terrace, Bayswater, London W2 6JH. Inagurimi i bustit u realizua bashkë me miqtë anglezë, Cllr. Susie Burbridge dhe Cllr. Robert Devis nga Westminister Concil, Londër (28 Nëntor 2012).

Councilor Susie Burbridge, Mayor of Westminster Council (në qendër) dhe z. David Lloyd (ulur) midis diplomatëve shqiptarë. Ishin këta dy miq të Ambasadës që lobuan fuqishëm deri te Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II, për vendosjen e Bustit të Skënderbut në Bayswater, Londër.

Shqiptarë dhe anglezë së bashku, në ditën e hapjes së siparit të një seri aktivitetesh që do të organizoheshin në Londër, me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë (14 mars 2012).

Një grup fëmijësh shqiptarë mirëpriten në ambasadë (13 prill 2012).

Forumi Ekonomik Shqipëri – Britani e Madhe, organizuar nga Ambasada në bashkëpunim me IBDE (19 prill 2012).

Shfaqja "Henry VI", të Shekspirit nën regjinë e Adonis Filipit, si pjesë e "Triologjisë Ballkanike" në "Shakespeare's Globe Theatre", Londër nga Teatri Kombëtar Shqiptar. Bujar Asqeriu, aktori më i mirë i turneut (12 maj 2012).

Promovimi i librit "Lindja e Shqipërisë", i autores Nicola Guy, Qendra për Studime Shqiptare në Londër dhe Shtëpia Botuese "IB Tauris Publishers", organizuar nga Ambasada në bashkëpunim me AAA (16 maj 2012).

Në Arkivën Historike të Kantonit Somerset dhe në shtëpinë e Aubrey Herbert, ku u zbuluan dokumente me vlerë historike (17 gusht 2012).

Inaugurimi i ekspozitës "100 vjet Filateli Shqiptare", dhe "Koleksion librash për Skënderbeun", bashkëpunim i Postës Shqiptare dhe koleksionistes angleze të librave për Skënderbeun, Patricia Nugee, në mjediset e Ambasadës (16 nëntor 2012).

Prof. Noel Malcolm në Promovimin e librit "Charles Telford Erickson - Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë" (23 janar 2013).

Ambasadën e vizitoi Rita Ora së cilës iu shpreh mirënjohja e thellë për pjesëmarrjen në festimet e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (3 shkurt 2013).

Buckingam Palace, ceremonia e dorëzimit të Letrave Kredenciale, Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II (27 qershor 2013).

Dy artistë të shkëlqyer shqiptarë me famë botërore, sopranoja Ermonela Jaho dhe balerini Kledi Kadiu, në Ambasadën e RSH-së në Londër (4 korrik 2013).

Në fshatin arbëresh Munxhufuni (Montecilfone), Rajoni Molize, Itali, u vendos busti i Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeg (4 gusht 2013).

Ceremonia e dorëzimit të letrave kredenciale Presidentit të Irlandës, Sh.T. Z. Michael D. Higgins nga Ambasadori shqiptar (10 tetor 2013).

Me Scarlet Epstein, e mbijetuar e Holokaustit në Shqipëri në shfaqjen e filmit dokumentar "BESA" në Pinner Sinagogë, me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman (16 janar 2014).

Notes On Albania, edicioni i parë – shfaqja në sallën Amaryllis Fleming Concert Hall të Kolegjit Mretëror të Muzikës në Londër (16 dhjetor 2013).

Pritje e dhënë nga Mbretëresha Elzabesht II në kopshtin e Bukingham Palace (verë 2015).

Hapja e Vitit të Ri Parlamentar bëhet me një ceremoni madhështore. Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II, e shoqëruar nga Duka i Edinburgut, Filipi, kalojnë përmes sallave të Parlamentit për t'u ulur në Fronin Mbretëror në Dhomën e Lordëve ku për çdo vit shpalos programin e qeverisë së Saj.

Takim, i organizuar nga Ambasada, me diplomatin, historianin, gazetarin dhe studiuesin Robert Wilton, i cili recitoi vjersha shqipe të përkthyera në anglisht prej tij si dhe rreth librit "The Spider of Sarajevo" (16 gusht 2014).

Me Divën shqiptare Inva Mula.

Takim me rrëfimtarin më të shquar të BBC – së Simon Schauma, prof. Jonathan Brent dhe ambasadoren e Lituanisë Asta Skaisgiryte Liauskiene në degën e YIVO -s në Londër (10 dhjetor 2014).

Panairi i 65-të pranveror ndërkombëtar i mallrave dhe ushqimeve në Bashkinë Chelsea Kensington në Londër. Për herë të parë morën pjesë Kosova dhe Shqipëria, të përfaqësuara nga zonjat Lindita Greiçevci, Donika Berisha, Migena Baholli, Fatmira Seferi dhe Mirela Gashi (15 maj 2015).

Hapja e Ekspozitës "Homazh për Edward Lear" në "12 Star" në Europe House, me vepra të piktorit Bashkim Ahmeti – Izano, organizuar nga Ambasada Shqiptare (28 maj 2015).

Me Ambasadorin e Kosovës, prof. Muhamet Hamiti dhe zonjën e tij Vjosa, në shoqërinë e gazetarit të njohur të CNN International, Richard Quest, në festën e Pavarësisë së SHBA – ve, në Ambasadën Amerikane në Londër (4 korrik 2012).

Forumi i Energjisë Europiane 2015: ''Perspektiva e Energjisë Europiane – Sfidat dhe Zgjidhjet" në mjediset e Përfaqësisë së Komisionit Europian në Londër (5 tetor 2015).



Me profesorin e Kennedy School of Government, Joseph Nye, formuluesi i filozofisë së Soft Power, në studion e tij në Cambridge, Massasuchets.

Duke i dhuruar librin "Shqiptarët, Lisa mbi Truallin Ilir" shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare.

Në mjediset e Regent University, Bashkësia Shqiptaro – Britanike organizoi mbrëmjen e lamtumirës. Pas 1358 ditësh në krye të misionit diplomatik të Shqipërisë, në Mbretërinë e Bashkuar, po ndahesha me një përshëndetje të ngrohtë vëllazërore. Me këtë rast iu prezantova të pranishmëve librin: "Realitete Shqiptaro – Britanike" një studim historik i mardhënieve midis dy vendeve dhe albumin e quajtur "1358 ditë në Londër" (29 tetor 2015).

Dekorimi me titullin "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" me motivacionin: "Në vlerësim të veprimtarisë së shquar diplomatike dhe publicistike për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë dhe të vlerave më të mira kombëtare e shtetërore, kudo ku ka shërbyer si diplomat e Ambasador, brenda e jashtë vendit".

Me bashkëshorten Donika